

ANTONIO BELLUSCI
ORNELA RADOVICKA

RRUGËTIM NË NGULIMET ARBËRESHE

50 kartolina gjigante arbërore në tokën italiane



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

QENDRA E STUDIMEVE DHE
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

RRUGËTIM NË NGULIMET
ARBËRESHE

*(50 kartolina gjigante arbërore
në tokën italiane)*

Antonio BELLUSCI
Ornela RADOVICKA



Recensentë: Prof. dr. Neritan Ceka, Prof. dr. Sadik Bejko

Këshilluese shkencore: Prof. dr. Pranvera Bogdani

Redaktorë shkencorë: Dr. Jolanda Lila, Dr. Dorina Arapi,
Alma Tirana, Mira Leka

Redaktore teknike e korrektore letrare: Arnisa Kasa

Përgatiti për botim: Dr. Jolanda Lila

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra e Studimeve
dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA)

Tiranë, 2020

ISBN 978-9928-4664-2-6

Përmbajtja

Hyrje	13
Parathënie	17
KAPITULLI I	21
1.1. Prejardhja dhe shteti i Arbrit	21
1.1.1. Dokumenti që flet për shtetin e parë të Arbrit	23
1.1.2. Rënia e Principatës së Arbrit	24
1.2. Gjuha që flet arbëreshi dhe fillesat e shkrimit shqip	25
1.2.1. Prejardhja e gjuhës shqipe	25
1.2.2. Fakte për pikënisjen e gjuhës shqipe	26
1.2.3. Alfabeti i gjuhës shqipe	27
1.2.4. Struktura e alfabetit	28
1.2.5. Alfabeti shqip	28
1.2.6. Veprat e para të shqipes	29
1.2.7. Shqipja me alfabet grek	30
1.3. Arbëreshët dhe ngulimet e tyre në Itali	31
1.3.1. Harta e ngulimeve arbëreshe në Itali*	34
1.3.2. Riti që praktikonin arbëreshët	35
1.3.3. Termi “greco-albanese”	35
1.3.4. Populli arbëresh, pa ndihmën e askujt, hodhi bazat e një atdheu të dytë	36
1.4. Figura e Dhimitër Reres (Demetrius Reres)	37
1.4.1. Misioni i Dhimitër Reresit	38
1.4.2. Dyshime mbi figurën e Dhimitër Reres	38
1.4.3. Origjina e Dhimitër Reresit	39

KAPITULLI II	41
2.1. Dukuria e mercenarizmit të shqiptarëve	41
2.1.1. Pushtimi osman	43
2.2. Kultura anzhuine në shqipëri	44
2.2.1. Dukët e Durrësit dhe Princat e Tarantos	44
2.2.2. Vetëpromovimi politik i principatave shqiptare	45
2.2.3. Shqipëria katolike me Italinë e Jugut në shek. XV	46
2.3. Emigrimet e shqiptarëve në itali	46
2.3.1. Fillimi i emigrimeve	46
2.3.2. Emigrimi i parë i arbëreshëve	47
2.3.3. Migrimi i dytë (1416 dhe 1448)	49
2.3.4. Migrimi i tretë (1461-1468)	49
2.3.5. Migrimi i katërt (1468-1506)	56
2.3.6. Migrimi i pestë (1532-1534)	58
2.3.7. Migrimi i gjashtë (1647 - 1680)	63
2.3.8. Migrimi i shtatë (1743)	64
2.3.9. Migrimi i tetë	65
 KAPITULLI III	 67
3.1. Arbëreshët dhe trashëgimia e tyre kulturore	67
3.2. Arkitektura dhe urbanistika rrethore e katundeve arbëreshe	69
3.3. Trashëgimia shpirtërore arbëreshe	71
3.3.1. Arbëreshët trashëguan gjitoninë	71
3.3.2. Arbëreshët trashëguan ritin	72
3.3.3. Arbëreshët trashëguan besimin	73
3.3.4. Arbëreshët trashëguan mitin e Skënderbeut	73
3.3.5. Arbëreshët trashëguan rapsoditë dhe besën	74
3.3.6. Arbëreshët trashëguan kostumin e gruas arbëreshe	74
3.3.7. Arbëreshët trashëguan gjuhën e kulturën	76
3.3.8. Arbëreshët trashëguan guximin	77
3.4. Kisha ilire dhe Kostandinopoja	77
3.5. Arbëreshët, identitet që ngjall admirim	81
 KAPITULLI IV: NGULIMET ARBËRESHE NË KALABRI	 95
4.1. Ngulimet në rajonin e Kozencës	95
4.1.2. San Demetrio Corone (Shën Mitri)	95
4.1.2. Macchia Albanese (Maqi)	107

4.1.3. Frascineto (Frasnita)	111
4.1.4. Eianina (Purçilli)	128
4.1.5. Civita (Çifti)	131
4.1.6. San Cosmo Albanese (Strigari)	143
4.1.7. Vaccarizzo Albanese (Vakarici)	149
4.1.8. San Benedetto Ullano (Shën Benedhiti)	156
4.1.9. Marri (Llimarri)	174
4.1.10. Santa Sofia D' Epiro (Shën Sofia E Epirit)	176
4.1.11. San Basile (Shën Vasili)	185
4.1.12. Firmo (Ferma)	187
4.1.13. Lungro (Ungra)	190
4.1.14. Acquafamosa (Firmoza)	198
4.1.15. San Giorgio Albanese (Mbuzati)	201
4.1.16. Santa Caterina Albanese (Picilia)	207
4.1.17. Falconara Albanese (Fallkunara)	211
4.1.18. Plataci (Pllatani)	216
4.1.19. Castoregio (Kastëjnexhi)	228
4.1.20. Farneta (Farneta)	233
4.1.21. Cervicati (Çervikati)	237
4.1.22. Mongrassano (Mungrasana)	240
4.1.23. Cerzetto (Qana)	246
4.1.24. San Giacomo Di Cerzeto (Shën Japku)	251
4.1.25. Cavallerizzo (Kajverici)	253
4.1.26. San Martino Di Finita (Shën Mërtiri)	256
4.1.27. Spezzano Albanese (Spixana)	263
4.2. Ngulimet në rajonin e Katanxaros	295
4.2.1. Andali (Andalli)	296
4.2.2. Marcedusa (Marcedhuza)	297
4.2.3. Zangarona (Xingarona)	298
4.2.4. Vena Di Maida (Vina)	301
4.2.5. Gizzeria (Jazeria)	305
4.2.6. Caraffa (Garrafa)	307
4.3. Ngulimet arbëreshe në rajonin e Krotones	312
4.3.1. Carfizzi (Karfici)	312
4.3.2. San Nicola Dell'alto (Shën Kolli)	314
4.3.3. Pallagorio (Puhëriu)	316

KAPITULLI V: NGULIMET ARBËRESHE NË BAZILIKATË	323
5.1. San Costantino Albanese (Shën Kostandini)	323
5.2. San Paolo Albanese (Shën Pali)	327
5.3. Barile (Barilli)	329
5.4. Ginestra (Zhura)	331
5.5. Mascito (Mashqiti)	333
KAPITULLI VI: NGULIMET ARBËRESHE NË KAMPANJË	337
6.1. Greci (Katundi)	339
6.2. Abruzzo	345
6.3. Villa Badessa (Badhesa)	346
KAPITULLI VII: NGULIMET ARBËRESHE NË MOLISE	351
7.1. Campobasso (Portkanuni)	352
7.2. Campomarino (Këmarini)	358
7.3. Ururi (Rùri)	359
7.4. Montecilfone (Munxhufuni)	363
KAPITULLI VIII: NGULIMET ARBËRESHE NË PULJA	365
8.1. Ngulimet arbëreshe në rajonin e Foxhas	367
8.2. Monte Sant'angelo	368
8.3. Casalvecchio (Kasallveqi)	368
8.4. Chieuti (Qefti)	370
8.5. San Marzano di San Giuseppe (Shën Marcani)	372
KAPITULLI IX: SICILIA	375
9.1. Fillimet e emigrimeve në Sicili	375
9.2. Piana Degli Albanesi (Hora e Arbëreshëvet)	381
9.3. Santa Cristina Gela (Sëndahstinë)	406
9.4. Contessa Entellina (Kundisa)	407
9.5. Palazzo Adriano (Pallaci)	412
9.5. Mezzojuso (Munxifsi)	418
9.6. Krahina e Agrigento-s	423
9.7. Krahina e Catania-s	426
9.8. Krahina e Mesinë	427

KAPITULLI X: GJURMËT ARBËRESHE NË VENECIA	429
Bibliografia kryesore e shfrytëzuar:	439
Bibliografia e konsultuar:	441

Arbëria e arbëreshëve ngjason me një grua, e cila mban veshur një fustan të sajuar nga fijet e mitit e të historisë, të stolisur me perla “të gjakut të shprishur”, të zbukuruar me lule të egra, ku dielli dimëror derdh pikëza të arta. Flladi i kujtimeve vjen si një serenatë me motivin e Moresë dhe koha vijon të lërë gjurmët e saj.

Arbëreshit i veshën tipare greke, por në ofshamën e zërit të lodhur rrëfehet historia e tij e largët, e lashtë, ku shpirti mbledh në amforën e vet antike arbëreshët madhështorë.

Një “stoli tinëzake” është asimilimi i tyre; një piron, që po i tkurr, duke i shndërruar ata në një fragment jo më të madh se një pullë poste, por të mos harrojmë: janë ende 50 kartolina, plot 50 puzzle-a gjigantë arbërorë në tokën italiane.

Autorët

Hyrje

I nderuar lexues,

Në bibliotekën albanologjike ka munguar deri më sot një përmbledhje tërësore që të hedhë dritë mbi aspekte të realitetit dhe të historisë së vendbanimeve arbëreshe në Itali.

Kjo është arsyeja pse bota shqiptare pret me një gëzim të veçantë botimin e këtij libri, të titulluar “Rrugëtim në vendbanimet arbëreshe të Italisë”, realizuar falë nismës, angazhimit energjik e misionar, përkushtimit ndër dekada, skrupulozitetit e njohjes në detaje, deri në ato më të imta të jetës së arbëreshit dhe forcës e intuitës sintetizuese për të shpjeguar e kuptuar gjithçka (deri në të vërtetat e pakundërshtueshme, gati absolute) të universit arbëresh me rrënjë familjare shekullore studiuesi i talentuar, Anton Belushi (Antonio Bellusci).

Në këtë libër, autori e plotëson më së miri këtë boshllëk dhe i jep në dorë publikut shqipfolës një “enciklopedi” në kuptimin e vërtetë të fjalës, përmes një vështrimi tërësor gjeografik, historik, kulturor, mbushur me ngjarje e personalitete të shquara të jetës politiko-kulturore, figura të spikatura të penës e të shkencës. At Anton Belushi kapërcen e tejkalon haptazi kështu dëshirën e tij modeste (siç shprehet në parathënie të librit) për t’i paraqitur lexuesit 50 kartolina të vendbanimeve arbëreshe, sepse libri i tij është një celuloid i vërtetë i jetës disashekullore në këto vendbanime dhe më gjërë, duke nisur me valën migratore të arbëreshëve aty, një

proces me tetë momente kulmore dhe duke vazhduar me luftën për mbijetesë që i përball me sfida të njëpasnjëshme.

Kjo ndodh sepse më mirë se kushdo më parë, At Belushi e ndjen dhe e kupton se gjithçka bëjnë dhe veprojnë arbëreshët e Italisë është shprehje e misterit të kodit të tyre komunikues. Postulati biblik “e para është fjala”, i jep atij fillin bazë për të endur dhe kuptuar pëlhurën historike, lëndën e librit. Vocërraku a vocërrakja arbëreshe merr përmes fjalëve të para të nënës a familjes së saj, aq të ndryshme e të pakuptueshme në mjedisin italian, medaljonin e vyer dhe vulën e dashur të identitetit të veçantë që e bën pjesë të një komuniteti me tradita të lashta, ku spikat mbi të tërë, figura e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, simbol i shpirtit liridashës, human, altruist.

Në këtë kuptim, libri i Belushit është fryt jo vetëm i një pune të madhe në një studio të mbyllur, thjesht mbi libra, por është rezultat edhe i një vëzhgimi të imët në terren, të shkelurit me këmbë dhe të prekurit me dorë, të parit nga afër të realitetit sot dhe të gjurmëve të së kaluarës, në arkitekturë, veshje, këngë e valle, etj. Vizita në muzetë lokalë ka pasuar ndjeshëm e dukshëm lëndën e kësaj vepre, e cila ka rikonsideruar punën kërkimore të të apasionuarve vendas e të huaj.

Takimet dhe kontaktet personale në konferenca shkencore dhe tryeza frytdhënëse me një plejadë studiuesish bashkëkohorë shqiptarë dhe të huaj janë një tjetër burim që e frymëzoi dhe e mbështeti autorin. Me respekt ai veçon, ndër të tjerë, dy korifenj të studimit të gjuhës shqipe, profesorët Androkli Kostallari dhe Jup Kastrati.

Për të gjitha këto arsye, libri “Rrugëtim në vendbanimet arbëreshe të Italisë” është një libër që të grish, të ndjell, të fton dhe të mundëson një vizitë imagjinare, një udhëtim, apo qoftë dhe një pushim si turist a turiste kur të pajis dhe me hartën aq të qartë e të lexueshme të Universitetit të Kalabrisë, që sqaron adresën e saktë të secilit vendbanim arbëresh në krahinat italiane të Kalabrisë, Kampaniës, Bazilikatës, Abrucos, Molises, Puljës e Sicilisë. Mrekullinë që zgjon brenda nesh libri i At Belushit do ta shijojmë në një rast të tillë

me të gjitha nuancat siç na siguron dhe Ornela Radovicka, që meriton një falënderim të posaçëm përderisa vetë autori ndan me të bashkautorësinë.

Pranvera Novi Bogdani
Tiranë, dhjetor 2020

Parathënie

Historia përbëhet nga personazhe, luftëra, beteja, simbole dhe, mbi të gjitha, nga vende. Territori, nga ana tjetër, nuk duhet të konsiderohet spektator pasiv ose një realitet amorf e i pashpirt; përkundrazi, është një dëshmitar i vërtetë i përpjekjeve të dëshpëruara, të historive e ndarjeve. Historia arbëreshe është një interpretim i vazhdueshëm. Personalisht, mendoj se historia është një ajsberg, ku ne po anashkalojmë pjesën e zhytur.

Identiteti dhe feja janë elemente shumë të ndjeshme të shpirtit të njeriut; ato janë koncepte, që kërkojnë një qasje të ekuilibruar, të vetëdijshme, të qetë e tolerante, duke synuar rritjen e diversitetit, por jo për ta luftuar atë. Të jesh ndryshe, por i integruar, është një vlerë, një element i pasurisë dhe i rritjes morale para të qenurit civil. Identiteti kulturor e trashëgimia duhet të ruheshin e të vlerësoheshin jo vetëm si të tilla, por edhe si një forcë lëvizëse e mundshme për zhvillimin social-ekonomik.

Në këtë përmbledhje ka të dhëna të grumbulluara për jetën, historinë, gjuhën, ritin, zakonet e për përpjekjet e këtyre njerëzve të mrekullueshëm arbërorë, të shtrirë në hapësirë e në kohë. Të vizitosh fshatrat arbëreshe nuk është njësoj si të njohësh arbëreshët nga maja e katedrës, apo të shfletosh ndonjë libër ku shkruhet për ta. Arbëreshi është një epike, që duhet kodifikuar.

Qëllimi i materialeve të mbledhura është pikërisht krijimi i një teksti të kodifikuar në gjuhën shqipe dhe një kopje të shpërndahet në komunat arbëreshe. Deri më sot, nuk ekziston asnjë lloj libri, ku të përmbliidhen në një libër të vetëm shqip historiku, riti, urbanistika, apo dhe zakonet karakterizuese të 50 fshatrave.

Në këtë përmbledhje do të gjeni informacione, por, më së shumti, do të gjeni arbëreshin me dëshirën për t'u ringjallur; do të ndesheni me jetën e tij, historikun e tij, ku do të pikasë një popull shumë i përzemërt gjatë ditëve të festave; do të ndieni se mikpritja arbëreshe është diçka e shenjtë. Do të zbuloni hijeshinë e rrugëve, të sokakëve dhe ndjenjën e vërtetë të gjitonisë. Do të gjeni bustin e Skënderbeut, rrugët në dy gjuhë, do të përshëndeteni shqip, do të dëgjoni shpesh fjalën "*bregu*", do të shijoni bukurinë e lindjes së diellit, përndimin mitik të tij në sfond të shkrirë me relievin ku u vendosën, do të shijoni ritin e kostumet e bukura dhe të arta, që stilistët më të mëdhenj i kanë marrë si model.

Ne, arbëreshët, nuk dinim nga e kishim prejardhjen. Shqiptarëve mund t'u duket çudi ky fakt, por mos harroni se ne në shkolla nuk mësonim shqip. Unë mësova për herë të parë për gjuhën shqipe falë prof. Ernest Koliqit; gjurmët e para të shqipes i mësova prej tij. Më kujtohet edhe miku im Joseph J. Dioguardi, i cili më rrëfeu se e kishte kuptuar shumë vonë se gjuha që flisnin gjyshërit e tij ishte e ndryshme nga ajo gjuhë anglo-amerikane, ishte pikërisht gjuhë shqipe.

Nuk gjendeshin fjalorë që të studionim. Fjalori i parë, më ra në dorë rreth vitit 1975. Më vonë, më ra në dorë dhe fjalori i botuar në vitin 1980 nga prof. Androkli Kostallarit, që u bë dhe miku im. Ku ta dija unë që fjala "*agim*" korrespondonte me fjalën arbërisht "*me-nat*" e kështu me radhë. Sistemi sinonimik i atij fjalori të limituar, përcillej "nga babai te djali".

Ne e dinim se i përkisnim ritit bizantin e flisnim gjuhën e nënës, pa ditur asgjë për prejardhjen e saj. E flisnim gjuhën siç e dëgjonim dhe kështu e transmetonim. Mendoj se është shumë e rëndësishme që të njohim prejardhjen dhe se cilës popullsi i përket etnia jonë arbëreshe.

U bënë disa vite që nuk shoh akademikë, përveçse nga maja e katedrës apo thjesht në ndonjë konferencë. Filozofojnë dhe flasin vetëm për figurat e shquara të 800-ës, apo fillimi i 900-ës. Shumë prej tyre i kushtohen vetëm poezisë, imagjinatës, krijimit poetik, por nuk mjafton kjo. Arbëreshi është *popullsi*, nuk është një shprehje e shkuar. Arbëreshi nuk është “fantazi”. Arbëreshi është “situatë” dhe “fakt” e, si i tillë, arbëreshi nuk fillon dhe mbaron te Jeronim De Rada. Arbëreshi nënkupton një vazhdimësi dhe po jeton në një kontekst të tillë, që po i reziston atij pitonit asimilues, që dalëngadalë po e tkurr; ndaj dhe duhet kodifikuar çdo kontekst sa nuk është vonë. Deri tani, historinë tonë e kanë shkruar të tjerët, por ka ardhur koha ta kodifikojmë ne.

Shumë studiues kritikojnë dhe kërkojnë deri një formë akademike për të shprehurit gjuhësor të arbëreshit, po këta akademikë harrojnë se arbëreshët nuk kanë shkolla shqipe. Ne nuk kemi pasur dhe nuk kemi shkolla shqipe. Vetëm prindërit na folën shqip.

Kur drejtoja revistën “Lidhja”, sa e sa herë, u thosha miqve të mi “shkruani siç e flisni!”, sepse ne përdorim në gjuhën italiane karakterin latin në të shkruar, kështu që ishte forma më e thjeshtë për të shkruar shqip e për të mbajtur gjallë komunikimin shqip. Qëllimi ishte të kodifikohej çdo gjë arbëreshe, që mos të asimiloheshim.

Mendoj se klisheetë nuk dëshmojnë plotësisht për pasurinë e trashëgimisë arbëreshe (pasi këngët nuk janë të përsosura te arbëreshët – në gjuhën arbëreshe ose në shqip; kostumet po ashtu, nuk janë më lart se niveli i rrobaqepësisë– nuk janë me qëndisje origjinale ari), por është e qartë se përdorimi i përhapur i kostumit tradicional femëror (kostumi mashkullor shqiptar nuk është i vërtetuar historikisht për arbëreshët) dhe këngët janë formë identiteti, janë elemente që i shërbejnë kauzës arbëreshe.

Elementet bazë të mosasimilimit nuk përforcohen me serinë e takimeve dhe të udhëtimeve në Shqipëri, apo në vendet europiane, ku të presin shqiptarët; dhe as nuk ruhet identiteti arbëror me ribotimin e një broshure që nuk do ta lexojë askush, apo me zhvillimin e një konference vjetore me tematikë sesi të ndryshohet ligji për mbrojtjen e pakicave. Këto veprime mund të quhen thjesht një investim vetëm

për një pakicë intelektuale, që mbetet “hermetike” dhe një sfidë për investimin e tyre akademik personal. Nëse askush nuk flet arbërisht, nuk mban veshjet arbëreshe, nuk këndon në arbërisht, nuk mendon në arbërisht (sepse “vetëdija arbërore është vetëdija më e përparuar”), është e kotë të gjenden fonde ndërkombëtare për të financuar aktivitete dhe botime të librave, të cilat mbeten pa shpirtin e vetë popullit.

Akademikët, kërkuesit, janë ata që zbresin në terren e të tillë janë studiuesit, hulumtuesit, si: Robert Elsie, Alain Ducillier, Jean de Micelis, Gabriele Ciampi, Nasho Jorgaqi, Mahir Domi, Ali Xhiku etj. Të tillë studiues nuk sheh më. Dua të veçoj edhe dy miq të mëdhenj, të cilët, për mua, mbeten figurat më poliedrike të ndershmërisë intelektuale, profesorët Jup Kastrati dhe Androkli Kostallari. Këta dy të fundit, për mendimin tim, nuk janë vlerësuar ashtu si duhet. Punuan shumë. Janë një minierë e madhe, e çmueshme që vetëm duhet “të gërmohen”. Prof. Jup Kastrati ka lënë pas një thesar. Ishte i ndritur mendërisht e gjigant në shpirt.

Duhet punuar me këtë kategori njerëzish, qoftë dhe me ata me rezultate të vakëta, por që, me angazhim e krenari në rrugët e vendeve arbërore kanë prekur realitetin, duke ndihmuar për hapjen e shkollave në bazë, në fshatrat arbëreshe, ku pak rëndësi ka nëse shkruajnë shqip apo arbërisht, rëndësi ka që të fillojnë një herë. Arbëreshi nuk pret më, arbëreshi po lëngon.

Antonio Bellusci

Kapitulli I

Arbëresh e Arbëri, ndonëse në pamje të parë duken si dy rrugë të ndara paralele, janë një sintezë e shkëlqyer, e cila shprehet në mënyrë të përsosur te ky popull “i panështruar ndaj ligjeve të asimilimit të plotë”. Prirja për t’u ringjallur, mund të sfidojë shekujt, duke skalitur përgjithmonë kujtesën e duke mposhtur heshtjen, tek e cila kanë mbetur disa vepra njerëzore.

1.1. PREJARDHJA DHE SHTETI I ARBRIT

Albanët kanë hyrë në analet e historisë së dokumentuar, në gjysmën e dytë të shekullit XI. Vetëm në këtë periudhë mund të flitet me qartësi për një popull shqiptar, ashtu siç e njohim sot. Në “Historinë” e tij të shkruar gjatë viteve 1079–1080, historiani bizantin Mihaelis Ataliates (Michaelis Attaleiates) ishte i pari që përmendi se, *Albanët* kishin marrë pjesë në një kryengritje kundër Kostandinopojës në vitin 1043 dhe se *Albanët* ishin nënshtetas të dukës së Dyrrahiumit. Po ashtu, historiani Gjon Skilices (*Ioannis Scylitzes*) përmend (rreth vitit 1081) *Albanitës*, si pjesë të trupave të mbledhur në Durrës nga Niqifor Basilaku (*Nicephorus Basilacius*). Për herë të parë, për ekzistencën e gjuhës shqipe flitet aty nga fillimi i shekullit XIV. Në

të vërtetë, ka katër përmendje të qarta e të padyshimta ndërmjet viteve 1285 dhe 1332 mbi ekzistencën e gjuhës shqipe.¹

Lidhur me ndryshimin e papritur të emrit të popullsisë që jetonte në këto troje, që përfshin kalimin nga popullsia me fise ilire shqipfolëse në *Arbëri* dhe *Arbër*, nga *Epir* dhe *Epirotë*, e nga *Shqipëri* dhe *Shqiptarë*, në mënyrë të veçantë, për atë që në histori quhet periudhë e mesjetës, ka ende paqartësi. Por, në vijim, le të ndalemi në ato fakte, për të cilat historia mesjetare ka dhënë konfirmime përmes bazës dokumentare.

Rreth viteve 1190, trevat e Arbrit (territoret në Gadishullin e Ballkanit) fituan tiparet e një shteti të pavarur. Themeluesi i këtij shteti të ri ishte Progoni (1190–1198), pushteti i të cilit u pasua nga bijtë e tij, Gjini (1198–1206) dhe Dhimitri (1206–1216). Familjeve fisnike arbërore filluan t’u jepeshin tituj e, në këtë mënyrë, gëzonin edhe privilegje.

Papa Inocenti III i dha titullin “princ” (principatë) edhe një fisniku arbëror të quajtur Dhimitër, principata e të cilit rezulton nga historiografët që nga viti 1208 si “Principata e Arbrit”. Pikërisht, nën sundimin e Dhimitrit, kjo principatë pati lulëzimin e saj. Në një traktat paqeje, që nënshkroi me Republikën e Raguzës, Dhimitri përmend familje të tjera arbërore, si: Jonimet, Plitët, Shtëpanët etj., të cilët i quan “njerëzit e mi” (*homines mei*).

Principata e Arbrit i ka fillesat në shekujt XI–XII, kohë kur përplasjet ndërmjet normanëve të Italisë dhe Perandorisë Bizantine ishin në kulmin e tyre. Fiset shqiptare u gjendën përsëri në mesin e luftërave, për shkak të pozitës së tyre gjeografike. Arbrit u bë një faktor i rëndësishëm dhe një mburojë për Bizantin, ndaj dhe Perandoria Romake e lindjes u mundua t’i mbante në anën e saj, duke i shpërblyer me tituj dhe poste në ushtri e në politikë. Që nga fillimi i shekullit XI fillojnë të përmenden emra të familjeve të mëdha të Arbrit, si: Muzaka, Topia, Meksha, Pliti, Blinishti, Kamona, Shpata, Dukagjini, Albani, Araniti, Balsha, Beçikemi, Bogdani, Dushmani,

¹ Shih për më gjerë: Robert Elsie, *History of Albanian literature*, 1995. Botimi shqip: Robert Elsie, *Histori letërsisë shqiptare* (përktheu Abdurrahim Myftiu), 2001, f. 17.

Engjëllorët, Gazuli, Golemi, Gropa, Jonima, Kastrioti, Komneni, Maneshi, Matranga, Muzaka, Skura, Spani, Zaharia. Këto familje mbajtën tituj të lartë në Perandorinë Bizantine.

1.1.1. Dokumenti që flet për shtetin e parë të Arbrit

Në vitin 1966, studiuesi, shkrimtari dhe akademiku Dhimitër Shuteriqi botoi në gazetën “Drita”² një dokument historik për shtetin e Arbrit. Ai shkruan: “Përpara shtatë muajsh, në katundin Gëziq të Mirditës, mbi xhadenë e Rrëshenit për Shën Pal, te muri i një qele të rrënuar të kishës së Shën Mërisë, zbuluam gurët e copëtuar dhe të dëmtuar keq të disa mbishkrimeve mesjetare latine, që, menjëherë, dukeshin të një interesi të madh”^{3*}.



Më vonë, duke kërkuar nëpër dokumentet e kohës dhe nëpër autorët që janë marrë me to, me qëllim që të shkruajmë për ato

² Dhimitër Shuteriqi, “Drita”, Tiranë, 4 dhjetor 1966, f. 2.

³ *Fragmente të gurëve të skalitur në latinisht, që vërtetojnë ekzistencën e shtetit të Arbrit, si dhe të sundimtarëve Progon e Dhimitër gjenden në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.

mbishkrime, vumë re se Teodor Ippen (*Teodor Ippen*) i kishte njohur e botuar një pjesë të tyre në vitin 1901⁴, veçse pa bërë ndonjë përpjekje interpretimi. Vëmendjen e tij e tërhoqi më shumë një shqiponjë njëkrerëshe, e skalitur mbi mermer dhe që ai, me të drejtë, e quajti “heraldike”. Studiuesi Shuteriqi interpreton edhe mbishkrimin e këtyre gurëve:

“Pasi mundëm t’u bëjmë atyre fotografimin e qartë në fillim të tetorit që kaloi, patëm mundësi t’i studiojmë. Që në krye të herës, na kishte tërhequr vëmendjen emri DIMITRI(S) dhe fjala (I) VDICIBVS (gjykatësve) që lexoheshin shumë kthjellët në dy prej fragmenteve të gurëve. Më vonë, na tërhoqi vëmendjen edhe emri i P(R)OGON i një fragmenti të tretë. Ishte krejt e natyrshme që menjëherë të na shkonte mendja te princi Dhimitër (1208-1216) dhe babai i tij Progoni (1190-1198).”⁵

Dokumenti është i një rëndësie vërtet të jashtëzakonshme për historinë e Shqipërisë, sepse është i pari dokument vendas që flet për shtetin e parë të Arbrit.

1.1.2. *Rënia e Principatës së Arbrit*

Pas rënies të Principatës së Arbrit (1255), më 21 shkurt të vitit 1272, në skenën e historisë arbërore shfaqet *Regnum Albaniae*, me mbretin Karli I Anzhu, i ashtuquajtur mbreti i dy Sicilive. Mbreti Karli I Anzhu mobilizoi shumë arbëreshë në shërbim të ushtrisë në Durrës dhe në gardën e oborrit mbretëror në Napoli. Kuptohet, kemi të bëjmë me transferimin e një grupi ushtarakësh arbëreshë, të cilët nuk u kthyen më në vendlindje, por morën familjet e tyre dhe u sistemuan përfundimisht në Napoli e në qytete të tjera të mbretërisë. Këta ushtarë arbëreshë u quajtën *stratiotë*. Nga ky moment e në shekujt në vijim, nisin fillimet e emigrimit të asaj popullsie që i quajmë *arbëreshë*. Venecia dhe Napoli (si dy kryeqendra të

⁴ Teodor Ippen, *V. Stare crkve*, në Glasnik Bosni i Herzeg, 1901, f. 385-386.

⁵ Dhimitër Shuteriqi, *Drita*, Tiranë, 4 dhjetor 1966, f. 2.

rëndësishme italiane) rezultojnë “portat” kryesore të marrëdhënieve historike midis Gadishullit Italian dhe Gadishullit Ballkanik, si dhe midis viseve italiane dhe atyre shqiptare, falë veprimtarisë së dendur ekonomike dhe ushtarake që ushtronin (bashkë me shtetet që ato drejtonin) në Mesdhe, para dhe gjatë sundimit osman.

1.2. GJUHA QË FLET ARBËRESHI DHE FILLESAT E SHKRIMIT SHQIP

1.2.1. *Prejardhja e gjuhës shqipe*

Lidhur me ekzistencën e gjuhës shqipe, për herë të parë, kjo gjuhë dëshmohet në vitin 1462 kur u shkrua me alfabet latin, “Formula e pagëzimit”, që njihet si dokumenti i parë në gjuhën shqipe. Formulën e shkroi Pal Engjëlli. Megjithatë, ekzistojnë dëshmi më të hershme mbi ekzistencën e shqipes, të cilat duke qenë se nuk janë vërtetuar shkencërisht si burime të drejtpërdrejta, mbeten ende të dyshimta e të diskutueshme. Ato i përkasin periudhës midis viteve 1285 dhe 1332 dhe janë si më poshtë:

- Në vitin 1285, në Dubrovnik (Raguza), ku jetonte një bashkësi shqiptare. Në hetimin e një grabitjeje në shtëpinë e Petro del Volcios nga Belena (më vonë, Prati), një farë Mateu, bir i Markut të Mançes, që del se ka qenë dëshmitar i krimit, thotë: “*Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca.*” (Dëgjova një zë që thërriste në male në gjuhën shqipe.).⁶
- Në vitin 1308, në një tekst latin mesjetar “*Anonymi Descriptio Europae Orientalis*”, gjenden në një radhë kodikësh mesjetarë: “*Habent enim Albani prefati linguam distinctam a Latinis, Grecis et Sclavis ita quod in nullo se intelligunt cum aliis nationibus.*” (Shqiptarët e sipërpërmendur kanë një gjuhë që

⁶ Jirecek (1904), cituar sipas Idriz Ajeti, *Onomastika e Kosovës*, Instituti Albanologjik i Kosovës, 1977, f. 693.

dallohet nga ajo e latinëve, grekëve dhe sllavëve, kështu që kurrsesi nuk mund të merren vesh me popuj të tjerë).

- Në vitin 1322, kur dy pelegrinë anglo-irlandezë, *Symon Semeonis* dhe *Hugo Illuminator*, gjatë udhëtimit për në Tokën e Shenjtë, u ndalën në Shqipëri. *Symon Semeonis* bëri një përshkrim të gjallë të asaj që kish parë.⁷
- Në vitin 1332, murgu domenikan frëng *Brokard* ose *Frëre Brochard* (lat. *Brocardus monacus*), në një vepër latinisht të titulluar “*Directorium ad passagium faciendum*”, shkruan: “*Licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris.*” (Shqiptarët, në të vërtetë, kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, ndonëse përdorin shkronjat latine në të gjithë librat e tyre.)⁸.

1.2.2. Fakte për pikënisjen e gjuhës shqipe

Në një botim të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë në vitin 1941⁹, shkrimi më i vjetër shqip njihet ai i vitit 1167, i zbuluar nga historiani *Nikolae Jorga* në dorëshkrimet e bibliotekës “*Laurentiana*”, në Firence (*Ashburnham 1167 Laurentiana*) – në faqen e parë shpjegohet se dokumenti ndodhej në Bibliotekën Laurentiane të Firences, ndërsa në vitin 1915 e ka shënim në katalog, ku ruhet: “*Ashburuham*” 11, 1167.

Një tekst tjetër që mund të përbëjë pikënisjen për shkrimin shqip është i ashtuquajturit teksti *Bellifortis*, që ruhet në Muzeun Konde (*Musée Condé*) në Shato të Shantiji (*Château de Chantilly*) në veri të Parisit. I datuar prej 1405-s, ai përbën një shtojcë prej 29 rreshtash ndaj të ashtuquajturit dorëshkrimi *Bellifortis* (ms.348/663, fol. 153v).¹⁰

⁷ Robert Elsie, *Albanian literature: a short history*, Palgrave Macmillan, New York, 1991.

⁸ *Recueil* 1906, Facsimile Publisher, f. 484 (kjo vepër nganjëherë i atribuohet gabimisht *Guillelmus Adam*-it ose *Adae*-s).

⁹ *Shkrimtarët shqiptarë* (pjesa e parë 1462-1878), Ministria e Arsimit, Tiranë, 1941.

¹⁰ Robert Elsie, *Albanian literature: a short history*, Palgrave Macmillan, New York, 1991.

1.2.3. Alfabeti i gjuhës shqipe

Arbëreshët zhvilluan aktivitetin e parë tekniko-gjuhësor e patriotik për krijimin e alfabetit. Konkretisht, më 2 tetor të vitit 1895 u zhvillua Kongresi i Korilianos me pjesëmarrjen e 25 arbëreshëve shqipfolës, të cilët hartuan e miratuan alfabetin e gjuhës shqipe me grafema latine. Pjesëmarrësit në Kongresin e Korilianos miratuan themelimin e Shoqërisë Kombëtare Shqiptare, statutin dhe këshillin drejtues:

Kryetar: Jeronim De Rada;

Nënkryetarë: Pietro Kamodeka (*Pietro Camodecca*), Anselmo Lorekio (*Anselmo Lorechio*) dhe Akile Toçi (*Achile Tocci*).

Në nenin 1 të statutit theksohet:

“Është themeluar një Shoqëri Kombëtare Shqiptare, e cila do të përkujdeset:

- a) Për njësimin e një alfabeti të vetëm
- b) Për përpilimin e një fjalori
- c) Për përpilimin e abetares në gjuhën shqipe
- d) Për botimin e një reviste italo-shqiptare
- e) Për të filluar marrëdhëniet me Mëmën–Atdhe.”¹¹

Kongresi përshtati alfabetin e gjuhës shqipe që kishte përdorur Jeronim De Rada në vitin 1848 në gazetën “*L’albanese d’Italia – Shqiptari i Italisë*”; në vitin 1888, në gazetën “*Fiamuri i Arbrit*”, si dhe në shtypjen e “*Rivista italo-albanese*”, me nëntitullin “*Illu i arbreshvet – Ylli i arbreshëve*”, me drejtor Antonio Argondica (*Antonio Argondizza*).

Alfabeti i Korilianos përmbante 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore, që u përkonin tingujve të gjuhës së folur në dialektin arbëresh:

Zanoret: a, e, i, o, u, è, ë;

Bashkëtingëlloret: b, c, d, f, g, j, l, m, n, p, q, s, t, v, x (si në italisht) dhe

gj, gh (e egher – e egër), h (herë), ñ (një), r, rh – rr, ș (sh), k – q, dh – đ, th – θ, z – ç (Zot), sg – zh.

¹¹ Lidhur me përmbajtjen e nenit, është reflektuar varianti i paraqitur nga vetë autori. (Shën. red).

1.2.4. *Struktura e alfabetit*

Gjuhëtarët arbëreshë ishin të ndikuar nga italishtja. Për tingujt e gjuhës së folur arbëreshe, kongresistët huazuan edhe germa të veçanta: p.sh. shtuan germën “ë” me theks si gjuha frënge, për tingullin “z” huazuan germën greke ζ, për bashkëtingëlloret dyshe “dh” përdorën grafemën greke “δ”, ndërsa për tingullin “th”, grafemën greke “θ”. Alfabeti i Korilianos u përdor nga autorët arbëreshë në shumë vepra letrare, në tekstet mësimore për kolegjin e Shën Adrianos, në shtypin arbëresh të kohës e në shumë vepra të botuara pas Kongresit.

1.2.5. *Alfabeti shqip*

Kongresi i Manastirit (1908) e unifikoi dhe e standardizoi alfabetin e gjuhës shqipe. Ai u bazua tek alfabeti i Korilianos dhe bëri disa modifikime: u shtua zanorja Y, u hoq zanorja ë – e theksuar dhe u strukturuan bashkëtingëlloret dyshe: gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh.

Fjalori i parë është shkruar nga Frang Bardhi (1606-1643), mban titullin “*Dictionarium latino-epiroticum, una cum nonnullis usitatioribus loquendi formulis*” (Fjalor latinisht-epirotisht me disa shprehje të përditshme) dhe është botuar në Romë, në vitin 1635. Ai e shkroi në vitin e fundit të kolegjit të “Propaganda Fides”. Në moshën 29-vjeçare botoi fjalorin 238-faqësh latinisht-shqip, për të cilin ka mbetur në histori. Ky fjalor përmban 5640 zëra latinisht të përkthyer shqip, plus një shtojcë me pjesë të ligjëratës, proverba dhe dialogë. Fjalori i Bardhit është vepra e parë në leksikografinë shqiptare dhe deri diku, vepra më e rëndësishme ndër 22 fjalorët shqip, që do të botoheshin më pas deri në vitin 1850.¹²

¹² *Archivio storico della S. Congregazione ‘de Propaganda Fide’, SC Stamperia 2, f. 257.*

1.2.6. *Veprat e para të shqipes*

Françesk Maria da Leçe, misionar e gjuhëtar italian, u dërgua në Shqipëri nga “Propaganda Fide” në vitin 1692 si prefekt apostolik i misioneve, ku mësoi shqipen gjatë veprimtarisë së tij misionare. Një çerek shekulli më pas, ai botoi librin “*Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*” (“Vëzhgime gramatikore mbi gjuhën shqipe”), Romë, 1716, që u njoh si gramatika e parë e shqipes.¹³

Kleriku françeskan **Da Leçe** ka qenë edhe autori i një fjalori italisht-shqip të shkruar para vitit 1702, i përmendur si më i zgjeruar se ai i Frang Bardhit (1635). Një kopje e këtij fjalori gjendej në Palermo deri në vitin 1890, kurse për një kopje tjetër thuhet se ruhet në arkivin e “Propaganda Fides” në Romë.^{14*}

E para histori e rëndësishme e letërsisë shqiptare rezulton “*Manuale di letteratura albanese*” (Doracak i letërsisë shqiptare), Milano 1896, nga Albert Stratiko (*Alberto Straticò*, 1863-1926). Kjo vepër me 280 faqe mbulon kryesisht letërsinë gojore, disa autorë të hershëm shqiptarë, si: Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani, si dhe autorët më të shquar arbëreshë deri te bashkëkohësit e Stratikoit. Është e çuditshme se Stratikoi nuk ndalet fare te zhvillimi i letërsisë shqipe të shekullit XIX. P.sh., nuk përmenden Naim dhe Sami Frashëri, veprat e para të të cilëve kishin dalë në vitet 1880. Për Stratikoin, letërsia shqiptare do të thoshte letërsi arbëreshe, kurse krijimtaria letrare matanë detit në Gadishullin Ballkanik ishte vetëm një kujtim i largët i së kaluarës.

Proza e parë e shkruar në gjuhën shqipe

Pjetër Bogdani (*Pietro Bogdano*, rreth 1630-1689), lindur në Gur të Hasit afër Prizrenit, shkrimtari i fundit dhe dukshëm më origjinali i letërsisë së hershme në Shqipëri, është autori i veprës së parë të

¹³ Bartl 1972 dhe 1975/1979, Stadtmüller 1956, P. Malaj 1971-1972, Bartl 1972, 1975 dhe 1979, dhe Ismajli 1985.

¹⁴ * Shënim: Një gramatikë e shqipes dhe një fjalor italisht-shqip më i hershëm, që i atribuohet *Diego da Desios* (*Didacus a Desio*), mbetën të pabotuara asokohe. Një kopje e vitit 1710 ruhet në manastirin e *Grottaferrata-s*.

rëndësishme në prozë, shkruar drejtpërdrejt në shqip (d.m.th. jo përkthim), “Çeta e profetëve” (“*Cuneus prophetarum*”). Traktati i tij i gjerë për teologjinë u botua në shqip e në italisht në Padova, në vitin 1685, me ndihmën e kardinalit Gregor Barbarigo (Gregorio Giovanni Gaspare Barbarigo). Bogdani e kishte përfunduar variantin shqip dhjetë vjet para se ta botonte, por nuk i qe dhënë leja e botimit nga “Propaganda Fide”, e cila urdhëroi që dorëshkrimi të përkthehej paraprakisht për të lehtësuar punën e censorit.¹⁵

Drama e parë origjinale në gjuhën shqipe njihet “*Emira*” e autorit Françisk Anton Santorit (1819-1894), i cili lindi më 16 shtator në Picilia (*Santa Caterina Albanese*), në krahinën e Kozencës. U botua në mënyrë mjaft të çrregullt; disa pjesë, në revistën “*Fiamuri Arbrit*”, në nëntor 1887, kurse të tjera në antologjinë shqiptare të De Radës, të vitit 1896. Vepra u ribotua nga Françesko Solano në vitin 1984.

1.2.7. *Shqipja me alfabet grek*

Alfabeti grek ka qenë krijim i grekëve të lashtë, i ndikuar në një periudhë fillestare të historisë së tyre nga fenikasit. Ai u formësua për t’iu përshtatur sistemit tingullor të gjuhës së tyre. Ai vazhdoi të përdorej për greqishten e re, ndonëse shumë nga shkronjat e këtij alfabeti ishin bërë të panevojshme në rrafsh sinkronik, si pasojë e ndryshimeve fonologjike në shekuj. Kur përshtatej për gjuhën shqipe, ky sistem shkrimi nuk kishte shkronja të tepërta, por vetëm të gabuara. Për shembull, në shkrimin grek është e pamundur të bëhet dallim midis *s*-së dhe *sh*-së ose *z*-së dhe *zh*-së, të shprehen bashkëtingëlloret *c*, *xh*, *gj*, *q* të shqipes, apo të përdoret zanorja asnjënjëse *ë*. Por, natyrisht, me vullnet bëhet gjithçka dhe, vërtet, shumë dijetarë ortodoksë të shekullit XVIII u përpoqën të përdorin alfabetin grek, si të vetmin mjet të mundshëm që kishin për të shkruar shqipen.

¹⁵ Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqipe*, 1995, (<http://www.elsie.de/pdf/B1997HistLetShqip.pdf>).

Dokumenti më i vjetër i shqipes me alfabet grek është *Ungjilli i Pashkëve*, ose *Perikopeja*, që i përket shekullit XV, ose fillimit të shekullit XVI; ka pesëmbëdhjetë radhë të përkthyer nga *Ungjilli i Shën Mateut* (27: 62-66). Ai u zbulua nga historiani grek Spiridon Lampros (1851-1919) më 1906, në një dorëshkrim grek që ruhej në Bibliotekën Ambrosiane të Milanos. Kjo vepër përbën një farë përjashtimi nga tradita ortodokse: së pari, sepse duket se është dyqind vjet më e hershme se tekstet e tjera të shqipes me shkrim grek dhe, së dyti, sepse është gjetur në Italinë e Veriut. Sidoqoftë, duhet të prisnim plot dy shekuj për rizbulimin e shkrimit grek.

1.3. ARBËRESHËT DHE NGULIMET E TYRE NË ITALI

Termi “*arbëresh*” përmbledh si gjuhën e folur, ashtu edhe emrin e shqiptarëve të Italisë, ndërsa *Arbëria* identifikon zonën gjeografike të vendbanimeve arbëreshe. Kultura arbëreshe karakterizohet edhe sot nga elemente specifike, që e bëjnë praninë e komuniteteve shqiptare një element pasurimi të fortë për komunitetin vendas.

Arbëreshë quhen emigrantët e ardhur nga Gadishulli i Ballkanit, si: Shqipëria dhe trevat e saj, nga Peloponezi e komunitetet e tjera shqiptare në Greqi, të cilët u vendosën në territorin e Italisë në fund të shekullit XIV dhe gjatë shekujve XV-XVIII, për shkak të pushtimit osman. Ata u regjistruan në rajone të ndryshme të Italisë (sot, komunitete të quajtura italo-shqiptare, ose arbëreshe), të shpërndara midis zonave, si: Abruco (*Abruzzo*), Molize (*Molise*), Kampania (*Campania*), Pulja (*Puglia*), Bazilikata (*Basilicata*), Kalabria (*Calabria*), Sicilia (*Sicilia*), ku themeluan një atdhe të dytë, ruajtës të identitetit e, deri diku, të gjuhës së tyre origjinale (shqipe).

Arbëreshët kanë qëndruar 600 vjet larg vendlindjes dhe gjithnjë kanë kërkuar të ruajnë të gjallë identitetin, traditat e pasura, veshjet, ritet, rapsoditë dhe gjuhën amë.

Disa vendbanimeve, si fshatrat: Falconara Albaneze (*Falconara Albanese*) dhe Strigari (*San Cosmo Albanese*) apo Hora e Arbëreshëve (*Piana Degli Albanesi*), Mbuzati (*San Giorgio*

Albanese), Specano Albaneze (*Spezzano Albanese*), arbëreshët i kthyen në vendbanime të mirëfillta “shqiptare”, duke ruajtur përjetësisht identitetin.

Vendbanimet e arbëreshëve, përfshirë këtu fshatrat e shpërndara nga pjesa qendrore në jug, shkojnë në pesëdhjetë. Emrat e tyre në italisht, duke i pranëvendosur edhe variantin arbëresh, sipas rendit alfabetik,^{16*} janë:

1. Aquaformosa (Firmoza, CS),
2. Andali (Andalli Cz),
3. Barile (Barilli, PZ),
4. Campomarino (Këmarini, CB),
5. Carafe di Catanzaro (Gharrafa, CZ),
6. Carfizzi (Karfici, KR),
7. Casalvecchio di Puglia (Kazallveqi, FG),
8. Castroregio (Kastëjnexhi, CS),
9. Cavalerizzo (Kejverici, CS),
10. Cerzeto (Qana, CS),
11. Chieuti (Qefti, FG),
12. Civita (Çifti, Cs),
13. Contessa Entellina (Kundisa, PA)
14. Eianina (Ejanina, CS),
15. Falconara Shqiptar (Fallkunara, CS),
16. Farneta (Farneta, CS),
17. Firmo (Ferma, CS),
18. Frascineto (Frasnita, CS),
19. Ginestra (Zhura, PZ),
20. Grekët (Katundi, AV),
21. Lungro (Ungra, CS),
22. Macchia Albanese (Maqi, CS),

¹⁶ *Kjo mënyrë paraqitjeje është ruajtur edhe në vijim të këtij libri, në mënyrë që të jetë më i thjeshtë identifikimi i ngulimeve arbëreshe. Pra, nuk është zbatuar parimi fonetik i shqipes në vendosjen e emrit sipas sistemin grafemor të shqipes dhe në kllapa trajta origjinale në italisht e vendbanimit, por është vendosur emri në origjinal (njëlloj siç shenjohe në hartë) dhe në kllapa i është pranvënë trajta në arbërisht e secilit ngulim.

23. Marcedusa (Marçedhuza, CZ),
24. Marri (Llimarri, CS),
25. Maschito (Mashqiti, PZ),
26. Montecilfone (Munxhifuni, CB),
27. Pallagorio(Puhëriu, KR),
28. Piana degli Albanesi (Hora, PA),
29. Plataci (Plluturi, CS),
30. Portocannone (Purtkanuni, CB),
31. San Basile (Shën Vasili, CS),
32. San Benedetto Ullano (Shën Bendhiti, CS),
33. San Cosmo Albanese (Strighari, CS),
34. San CostantinoShqiptar (Shën Kostandini, PZ),
35. San Demetrio Corone (Shën Mitri, CS),
36. San Giacomo di Cerzeto (Sënd Japku, CS),
37. San Giorgio Albanese (Mbuzati, CS),
38. San Martino di Finita (Shën Murtiri, Cs),
39. San Marzano di S. Giuseppe (San Marcani, TA),
40. San Nicola dell’Ato (Shin Koghi, KR),
41. San Paolo Albanese (Shën Pali, PZ),
42. Santa Caterina Albanese (Picilia, CS),
43. Santa Cristina Gela (Sëndahstina, PA),
44. Shën Sofia e Epirit (Shën Sofia, CS),
45. Spezzano Albanese (Spixana, CS),
46. Ururi(Ruri, CB),
47. Vaccarizzo Albanese (Vakarici, CS),
48. Vena di Madia (Vina, CZ),
49. Villa Badessa (Badhesa, PE),
50. Zangarone (Xingarona, CZ).

1.3.1. Harta e ngulimeve arbëreshe në Itali^{17*}



BASHKËSITË ARBËRISHTFOLËSE TË ITALISË
COMUNITÀ ALBANOFONE D'ITALIA



A CURA DELLA CATTEDRA DI LINGUA E LETTERATURA ALBANESE DELL' UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA



¹⁷ * *Harta e mësipërme paraqet të gjitha ngulimet e sotme arbëreshe në Itali. Kjo hartë, e punuar nga *Katedra e gjuhës dhe e letërsisë shqipe në Universitetin e Kalabrisë* tregon, përmes rendit alfabetik, vendodhjen e bashkësive arbëreshe, me emërtimin italisht dhe arbërisht. Kjo hartë është një bazë e rëndësishme orientimi, por duhet pasur parasysh se në librin “Rrugëtim në ngulimet arbëreshe” renditja e vendbanimeve dhe përshkrimi i tyre nuk është bërë sipas kriterit alfabetik, por sipas atij gjeografik. Ky “rrugëtim” është zhvilluar duke iu referuar shtatë krahinave të mëdha ku janë vendosur arbëreshët, si dhe fshatrave që përfshihen në secilën prej tyre. Një kopje e hartës së zmadhuar gjendet në fund të këtij libri. (Shën. red.)

1.3.2. Riti që praktikonin arbëreshët

Në mesjetë, veriu i Greqisë dhe Shqipëria e jugut, atëherë Epiri antik, ishin të banuara nga një popullsi e ritit lindor bizantin, ku shumica e tyre flisnin shqip. Popullsia vendase që fliste italisht nuk mund të dallonte në vitin 1500 se cilës etni i përkisnin refugjatët, që sapo kishin mbërritur nga Ballkani. Ishte periudha ndërmjet shekujve XIV-XV; kishte njerëz të paarsimuar e fermerë analfabetë. Ata panë që refugjatët e sapoardhur praktikonin ritin fetar lindor-bizantin e menduan se ishin grekë; padyshim që nuk ishin në gjendje të dallonin përkatësinë etnike dhe gjuhën e ndryshme.

Riti fetar i nënshtrohej censurës së vazhdueshme, ku shpesh riti bizantin i arbëreshëve ndalohej nga autoritetet katolike. Një njohje e parë kanonike e ritit bizantin grek të praktikuar nga shqiptarët e Italisë është “Bolla Etsi pastoralis”, lëshuar më 26 maj të vitit 1742, nga Papa Benedikti XIV (*Lorenzo Lambertini*). Në zbulimin e saj, kontribuoi ndjeshëm Pietro Pompilia Rodota.^{18*}

1.3.3. Termi “greco-albanese”

Termi “greco” përdorej si etnonim të arbëreshët gjatë mesjetës, për të identifikuar personat që ndiqnin ritin fetar greko-bizantin përkundërt atij latin. Ky emërtim vijoi edhe në shekujt e mëvoshmën dhe për shkak të përdorimit të gjerë, u përhap edhe në rrafshin e toponimisë së ngulimeve të ndryshme arbëreshe në Italinë e Jugut.

Më vonë, gjejmë fjalët “*Greqisht-Epirot-Coroneo*”, që filluan të përdoren e që përkrijnë me institucionin e kolegjit “Korsini”. Në disa regjistra tokash, në veçanti në Farneta, edhe sot, shfaqet shprehja “*greko-shqip*”. Një dekadë më vonë, rreth vitit 1761, Alessandro Marini, në kopertinën e njëres prej veprave të tij filozofike, nën emrin e tij shton shprehjen “*Italo-Albanese*”. Kjo do të thotë se tashmë,

¹⁸ *Gjithashtu, studimi i Vittorio Perri-t (f. 5-60) rindërton për herë të parë, përmes një dokumentacioni të panjohur më parë, angazhimin e Rodota-s në Bibliotekën e Vatikanit, që nga maji 1736 deri në vdekjen e tij, më 15 maj 1770.

në shekullin XVIII, kishte një lëvizje të mendimit që pretendonte identitetin shqiptar. Në Sicili njihej “Piana degli Greci” dhe vetëm më vonë, me të drejtë, u ndërrua në “Piana degli Albanesi”. Pra, nga etnonimi me karakter identifikues të ritit fetar u kalua në etnonimin me ngjyresat kombëtare.

Mikel Belushi (*Michele Bellusci* – 1754-1806) shkroi një apologji për traditat fisnike të arbëreshëve, që e publikoi më 1794-n në Napoli. Ndërsa në vitin 1796, peshkopi i Rossano-s po bënte të pamundurën për t’iu imponuar komuniteteve arbëreshe, që të ishin nën mbikëqyrjen e kishës latine, por arbëreshi Mikele Belushi iu drejtua me këto fjalë:

“Zotëria juaj bën një gabim trashanik kur, duke përzier grekët me shqiptarët, i quan këta të fundit grekë kryelartë dhe gënjeshtarë. Shqiptarët, që përbëjnë popullsinë e Mbuzatit dhe të bashkësive të tjera të Kalabrisë, të cilët ruajnë ritin grek, nuk janë njësoj si grekët; kanë origjinë të ndryshme, dallohen prej gjeneze, prej natyre e prej zakoni. Njëllojshmëria e ritit fetar që ushtrojnë nuk mjafton për të futur një përputhje të përgjithshme në të gjitha karakteret e tjera, që zakonisht dallojnë kombet mes tyre”.

1.3.4. Populli arbëresh, pa ndihmën e askujt, hodhi bazat e një atdheu të dytë

Populli arbëresh gërreu me thonjtë e veta tokën djerrë dhe fushat e pakultivuara që gjeti, për t’i bërë ato produktive, ku me shekuj ushqyen e ushqejnë familjet e tyre. Ky popull ka paguar taksat ndaj zotërve (pronarëve feudalë) të ndryshëm, që i ngacmonin dhe u bënin padrejtësi, por edhe ndaj peshkopëve latinë, që i detyronin në forma të ndryshme arbëreshët që të ndryshonin ritin, nga bizantin në atë latin. Prandaj, nëse do të ekzistonte ndonjë fron a ndonjë kurorë, ajo do t’i atribuohet popullit arbëresh, i cili ishte i vetëm e jetim dhe kurrsesi, mbretërve apo princërve që i pritën. Për 5 shekuj, popullin arbëresh e sulmuan dhe e ngacmuan, por, me sakrificat dhe

pa ndihmën e askujt, qenë në gjendje të ruanin identitetin, gjuhën e kulturën e tyre.

Kush e do vendin e tij, e shpreh atë në të gjitha format e saj. Mjafton pak, sikur “një simbol”, “një nyjë”, “një copëz kohe” dhe kështu, çdo pikë e vogël mund të bëjë ndryshimin. Le të bëhemi protagonistët e një historie të mrekullueshme, të “jetës arbërore”.

1.4. FIGURA E DHIMITËR RERES (DEMETRIUS RERES)^{19*}

Konfliktet e brendshme në mbretërinë e Napolit fillojnë me revoltën e baronëve kalabrezë kundër Alfonsit V të Aragonës, mbretit të Napolit dhe Sicilisë, i quajtur *Magnanimo* (fisniku dhe shpirtmiri). Ky rebelim i nxitur nga anzhuinët dhe i organizuar nga markezi Antonio Centelles (zëvendësmbret për Kalabrinë) destabilizoi situatën në Kalabri, por mbreti Alfons V i Aragonës, i pafuqishëm ta shuante këtë revoltë, i kërkoi ndihmë Gjergj Kastriotit. Në vitin 1444, Skënderbeu iu përgjigj kërkesës së Alfonsit V, duke dërguar 200 kalorës të komanduar nga Dhimitër Rëra, ose Dhimitër Reres (Demetrius Reres) e dy djemtë e tij, Gjergji dhe Vasil Reres, me një kontingjent të përbërë nga tri reparte kalorësish shqiptarë, të cilët

^{19*} Parimi fonetik (fonologjik) është përdorur gjerësisht në emrat e përveçëm, të cilët kanë hyrë në traditën shkrimore të shqipes me përshtatje në shqip, p.sh. *Giuseppe* është përshtatur si Zef, apo *Girolamo* si Jeronim. Në rastin e emrave të tillë, të njohur në kulturën amë është respektuar parimi i vijueshmërisë. Ndërsa për emra të tjerë, më pak të njohur, përshtatja fonetike e fonologjike është gjykuar e panevojshme nga grupi i punës së redaktorëve e këshilluesve të këtij libri. Kjo është vendosur me arsyetimin se përshtatja fonetike për emra të tillë është një proces kompleks, meqenëse bëhet fjalë për emra të përveçëm, të cilët shkruhen me shkronja latine, por edhe për faktin se ndër arbëreshët e Italisë identifikohet në këtë version.

Libri është i pasur me emra njerëzish e vendesh, të cilat nëse do të shkruheshin me përshtatje dhe më pas do të viheshin në kllapa në versionin origjinal, më tepër do ta mbingarkonin sesa do ta thjeshtësonin procesin e leximit të tekstit, andaj u pa e arsyeshme të mos i nënshtrohej izomorfizmit çdo emër i përveçëm. (Shën. Red.)

udhëhoqën luftimet e triumfuan kundër koalicionit të baronëve kalabrezë proanzhuinë.

1.4.1. *Misioni i Dhimitër Reresit*

Në vitin 1450 përfundoi misioni ushtarak i forcave shqiptare dhe një pjesë e kalorësve u transferuan në malet përtej lumit Belice, në bregun e Sicilisë Jugore, në pritje për t'u riatdhesuar, por edhe ata ndryshuan mendim e qëndruan në Sicili e disa të tjerë në Kalabrinë Jugore.

Në veprën e tij,²⁰ Bartolomeo Faço (Bartolomeo Facio) shkruan: “*Quo tempore Scanderbecus nobilis in Epiro Regulus ac magna et spectatae virtutis adversus Turcos, a quibus obsidebatur, ad Alphonsum legatos auxilium oratum misit...*” (Pra, për të shpërblyer ndihmën e ushtarëve të Skënderbeut, që luftuan dhe e thyen revoltën e baronëve, mbreti vendosi t'u dhurojë troje në Sicili dhe në Kalabri, ku shumica e tyre themeluan, ose ripopulluan *Piana degli Albanesi, Contessa Entellina* (Kundës – Kudhësi), *Santa Cristina Gela, Palazzo Adriano, Mezzojuso, Bronte, Biancavilla, San Giuseppe di Mastellaro, Sant'Angelo e San Michele, Taormina* (në Sicili); *Caraffa di Catanzaro, Carfizzi, Gizzeria, Pallagorio, San Nicola dell'Alto, Vena, Amato, Andali, Arietta, Belvedere, Marcedusa, Zagarise e Zangarona* (në krahinën e *Catanzaro*-s).

1.4.2. *Dyshime mbi figurën e Dhimitër Reres*

Popullimi i disa fshatrave arbëreshe para vdekjes së Skënderbeut, për shkak të ardhjes së stratiotëve të udhëhequr nga Dhimitër Reres, vihet në diskutim nga disa akademikë, të cilët mendojnë se ky variant është “absolutisht i rremë”.

Sipas tyre, kjo pjesë e historisë është skenar i përgatitur në vitin 1665 nga Gjergj Reres (*Giorgio Reres*), kryepriifti i *Mezzojuso*-s, dhe nga noteri Diego Baretta (*Diego Barretta*) i Palermos, bashkëpunëtori i tij, i cili pretendonte se ekzistonte një “diplomë” që kishte lëshuar

²⁰ Bartolomeo Facio, *De rebus gestis ab Alphonso I*, haer. Seb. Gryphii, 1562.

mbreti Alfonso I në favor të Dhimitër Reres. Bazuar në këtë pohim, studiues të shquar, si Pietro Pompilio Rodotà, në 1748-n konfirmuan ekzistencën e Demetrius Reres dhe të djemve të tij. Kjo ishte një teori që përcaktoi vitin e themelimit të të gjitha vendbanimeve arbëreshe të Kalabrisë Jugore (sot, krahinat e *Catanzaro-s* dhe *Crotone-s*) dhe të Sicilisë, që u bazua vetëm në atë që u hartua nga noteri Diego Barreta, ku, për më tepër, iu atribuua lindjes së familjeve fisnike Reres të *Mezzojuso-s* (shqiptarë që ishin pasuruar mjaft nga asgjëja, duke shpikur historinë e Demetrius Reres e të fëmijëve të tij).

Grupi akademik deklaroi se Domeniko Zangari (Domenico Zangari) vë në dyshim këto tri skuadra të Dhimitër Reresit dhe të fëmijëve të tij *Giorgio* dhe *Basilio*.²¹ Mitet e historiografisë arbëreshe rindërtojnë ngjarjet e viteve dyzet të shekullit XV, duke përdorur ngjarje të dokumenteve historike dhe duke arritur në përfundimin se Dhimitër Reres nuk kishte asnjë rol në revoltën kalabreze të vitit 1444. Për informacion të mëtejshëm mbi revoltën kalabreze, e cila nuk thotë asgjë rreth përfshirjes së Dhimitër Reres për të shuar revoltën e *Centelles*, flet edhe Ernesto Pontieri.²² Gjithashtu, Mateo Mandala (Matteo Mandalà)²³, në studimin e tij, “*Mundus vult decipi. I miti della storiografia arbëreshe*”, shprehet kështu: “Nëse sot studiuesit janë përpjekur të rindërtojnë historinë e mbërritjes së Shqiptarëve, le të mbështeten sa më shumë të jetë e mundur në burime të besueshme”.

1.4.3. Origjina e Dhimitër Reresit

Nuk ka të dhëna se nga cila trevë ishte Dhimitër Reresi dhe nga vinin kalorësit shqiptarë që e shoqëronin. Sipas dokumenteve veneciane, mbiemri ishte *Renes*, ose *Renessi*, dhe ishte kapedan i

²¹ Domenico Zangari, *Le colonie albanesi in Calabria: Storia e demografia nei secoli XV-XIX*, “Caselli”, Napoli, 1941, f. 20.

²² Ernesto Pontieri, *La Calabria a metà del secolo XV e le rivolte di Antonio Centelles*, F. Fiorentino, Napoli, 1963.

²³ Matteo Mandala, *Mundus vult decipi: Mitet e historiografisë arbëreshe*, Naimi, Tiranë, 2018.

ushtrisë shqiptare, shquar në rezistencën kundër sulmeve të ushtrisë turke.²⁴

Johan Xhorxh Han (Johann Georg Hahn, 1854), duke iu referuar historianit italian Bernardino Biondeli (Bernardino Biondelli)²⁵, shkruan se emri i tij ishte *Demetrius Reres Castriota*, kushëri i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, por ky mendim ka mbetur i pakonfirmuar.²⁶

Sipas historianit I. Mazziotti, shtrirja gjeografike e vendbanimeve shqiptare, nga *Carfizzi*, në *San Pellegrino* e *San Nicola Dell'Alto*, nga *Marcedusa*, *Andali* e *Zangarona* dhe zbritja në formë harku deri në *Gizzeria* pranë bregut të detit Tirren, të bëjnë të mendosh se këto qendra banimi u populluan nga shqiptarët, sipas një plani strategjik të Dhimitër Reresit, për ta vënë nën kontroll ushtarak terrenin, për të mbikëqyrur qëndrimin e baronëve e, kësisoj, të mund të shtypnin çdo formë revolte. Një grup tjetër studiuesish, mendon se origjina e Reresit mund të jetë nga fshati *Rrërës* në rrethin e Fierit në Shqipëri. Çdo hipotezë mbi këtë figurë mbetet ende për t'u vërtetuar.

²⁴ Domenico Zangari, *Le colonie albanesi in Calabria: Storia e demografia nei secoli XV-XIX*, "Caselli", Napoli, 1941.

²⁵ Bernardino Biondelli, "Prospetto topografico-statistico delle colonie straniere d'Italia", in: *Annuario geografico italiano pubblicato dall'ufficio di corrispondenza geografica in Bologna*, Bologna: Libreria Rusconi. 1845, f. 1-27.

²⁶ Johann Georg Hahn, *Geographisch-ethnographische Uebersicht. Sind die Albanesen Autochthonen Alphabet.Historisches.Verlag von Friedrich Mauke*, 1854.

Kapitulli II

2.1. DUKURIA E MERCENARIZMIT TË SHQIPTARËVE

Dukuria e mercenarizmit të shqiptarëve, të cilët, në shumicën e rasteve, zgjodhën të qëndronin në shërbim të fuqive të huaja, veçanërisht në Republikën e Venedikut, përgjatë shekujve XV-XVII, ngriti fuqinë detare në Adriatik dhe e gjeti veten përballë Perandorisë Osmane ushtarakisht për mbrojtjen e territoreve e të tregtisë së saj.^{27*}

Gjithmonë është imagjinuar se stratiotët ishin kryesisht me origjinë greke, por studimet bashkëkohore^{28*} kanë konstatuar se rreth 80% e emrave ishin me origjinë të qartë shqiptare dhe 20% të tjerame origjinë greke, valaca, si dhe sllavët e jugut. Është e vërtetë se shumë princa me njëfarë rëndësie ishin me origjinë bizantine greke (arbërore), si *Paleologhi*, *Spandounios*, *Comneni*, *Miniatis*,

^{27*} Shumë historianë, kanë trajtuar dukurinë e “*stradiotizmit*” (“*stratitizmit*”), duke e analizuar atë si nga pikëpamja antropologjike, ashtu edhe nga ajo historike (ndër ta, Marino Sanudo, Coriolano Cippico, Filippo de Commines dhe Constantinos Sathas, i cili, ndërmjet viteve 1888 e 1890, hartoi veprën monumentale, historinë e stratiotëve në nëntë vëllime: “*Documents Inédits Relatifs À l’Histoire De la Grèce Au Moyen Âge*” dhe koleksioni jo më pak i vlefshëm i dokumenteve nga arkivi venecian “*Acta Albaniae Veneta*” nga Giuseppe Valentini, botuar në vitin 1966, në 24 vëllime.

^{28*} Siç janë vizioni i listave të stratiotëve nga Sathas, në veprën e cituar më lart dhe indekset e ditarëve të Sanudos.

Kondomitis, Spyliotis etj. Por ata ishin një pakicë që kishin gjetur veten në komandën e trupave falë pozitës së tyre si zotër e feudalë të Argolit dhe Peloponezit, ku kishte vendosur sundimin Venecia. Të tjerë, siç janë *Soimiris, Vlastimiris dhe Voicha*, mund t'u përkasin familjeve sllave të jugut.

Nga viti 1475, ata zëvendësuan përfundimisht kalorësinë e lehtë të Venedikut, duke u vendosur për të ruajtur kufijtë e Furrëshës. Sidoqoftë, shumë të tjerë arritën në Europë duke u shërbyer oborreve franceze dhe spanjolle, në mënyrë të veçantë në Itali. Përveç *Serenissima*-ve të lartpërmendura, ata u rekrutuan nga aragonesë dhe Milano Sforza.^{29*}

Ndër stratiotët e famshëm përmenden shqiptarët, të tillë si: *Bua, Cladas, Bafi, Mathes, Blessi dhe Plessia, Basta, Renesi, Sarri, Candreva, Braila, Baccari, Stamati, Capuzzimadio, Masi, Reposio Busichio, Giorgio Gherbesi, Paulo Bua, Domenego Candreva, Francesco Manassi, Cesare Bua, Guma Bua, Todaro Bua, Andrea Bua, Nicola Suli, Todaro Criobardi, Gigni Zamanda, Chiurca Candreva, Micha Lusi, Giani Renessi, Zorzi Bus, Lecha Lusi, Andrea Bodea, Carlo Varibopi, Guma Bucura, Nicola Peta, Todaro Bacaro Recuni, Nicola Dorangriza, Zorzi Chiurchi, Gigni Laluca, Anargiro Gerbesi, Alessio Gambiera, Todaro Masi, Gigni Clossi, Nicolò Gambiera, Micha Gra Calenzi Clossi, Alessio Materanga, Dima Calenzi, Nica Lopesi, Stefano Busi, Thomaso Lusi, Zuan Plessa, Dima Golemi, Zorzi Lusi, Zorzi Sarachini, Guma Lusi, Nicolò Lusi, Nicola Bacari, Poaolo Caparelo* e të tjerë, të gjithë “Kapitanë të kuajve shqiptarë”. Shumë prej tyre, siç u përmendën më lart, e vunë veten në shërbim të të fuqishmëve perëndimorë, ndërsa të tjerët, si kapedanë e si ushtarë të thjeshtë, me të ardhurat e marra nga shërbimet e tyre të bëra në *Serenissima* (Republika e Venedikut), me familjet dhe priftërinjtë e tyre, vendosën të jetojnë në komunitetet paraekzistuese shqiptare të Italisë së Jugut, ku dhe sot ka një rrjet të dendur onomastik me origjinë stratiotike. Thuhet

^{29*} Poetët *Michele Marullo, Tracaniota* dhe *Manoli Blessi* shkruajtën në gjuhën veneciane të përzier me atë greke, duke lavdëruar me nota epike aventurat e stratiotëve.

se, më trima se të gjithë të tjerët janë ato të Napolit të Rumelisë, që është qyteti i Moreas në territorin e Argivit.

2.1.1. Pushtimi osman

Me shtrirjen e Perandorisë Osmane në Shqipëri në shekullin XIV, shumë prej shqiptarëve të krishterë u larguan në Dalmaci, në territoret e Greqisë Jugore dhe në Italinë e sotme. Me pushtimin e Kostandinopojës në vitin 1453, osmanët kishin marrë nën kontroll pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik.



Harta, Shqiptarët në Greqi në shekujt XV e XVI

Dokumentet e këtij tipi janë “xhevahir”. Dekada më parë, në shumicën e rasteve nuk ishin mëvetësuar, por ishin të shkrira në regjistra dhe shumë herë ndodhte fshehja e së vërtetës, apo ishin edhe pre e vjedhjes së historisë. Sot, këto arkiva janë një burim i pashtershëm i korrespondencës, ku studiuesi mund të nxjerrë

*materiale të reja dhe të pabotuara për studime mbi atë që ishte fuqia më e madhe e Botës së Vjetër.*³⁰

2.2. KULTURA ANZHUINE NË SHQIPËRI

Kultura e anzhuinëve në Shqipërinë e mesjetës së vonë është ende pak e njohur, sidomos për periudhën e viteve ‘70 të shekullit XIII, deri në dekadën e parë të shekullit XV. Kjo periudhë korrespondon me themelimin e *Regnum Albaniae* nga Karli I (Charles I) Anzhu dhe trashëgimisë së saj kulturore, e cila shoqëroi zhvillimin e një klase feudale shqiptare. Ajo kërkon ende studime nga pikëpamja historiko-artistike.

Ambiciet e pjesës lindore të anzhuinëve, krijimi i *Regnum Albanie*, ishin hapi i parë për kontaktet politike dhe ekonomike me Perëndimin, forcuan praninë fetare katolike, por pa ndikuar në kultin grek e të traditës artistike bizantine.

Nëse Karli I kishte meritat për të hedhur themelet e një monarkie të stilit perëndimor, është gjithashtu e vërtetë se ëndrrat e pushtimit në Ballkan nuk kishin të njëjtat përparësi të Karlit II Anzhu. Financat e fuqia tani drejtoheshin drejt Sicilisë për shkak të Vespërs (1282-1302), në përpjekje për t’i vendosur një pengesë fuqisë së re që ngrihet në Perëndim e që po kërkonte hapësira gjithnjë e më të spikatura në Mesdhe. Shiriti bregdetar është veçanërisht sa emblematic, aq edhe problematik për studimin e kulturës mesjetare shqiptare.

2.2.1. *Dukët e Durrësit dhe Princat e Tarantos*

Dukët e Durrësit e Princat e Tarantos (Tarentes) organizuan ekspedita të shumta jashtë shtetit në ato vite, për qëllime diplomatike dhe ushtarake. I pari i dha privilegje dhe autonomi familjes së fuqishme

³⁰ Vincenzino Ducas Angeli Vaccaro, “Albanesi in Grecia dal protomedievo agli inizi dell’Età moderna. Eseggesi storica attraverso fonti Veneziane e Catalane”, Fermo, Italy, 2020.

epirote të *Musachi*-ve, në këmbim të besnikërisë feudale, duke bërë të njëjtën gjë edhe me Topinë e fuqishëm. Në fakt, në vitin 1336, vizita e tyre në Durrës është e njohur, me qëllimin për të vendosur një gjykatë atje. Përkundrazi, Princat e Terenties, të përfaqësuar nga perandoresha Katerina (për shkak të vdekjes së Filipit), në udhëtimin e saj të njohur në Greqi në vitin 1338, patën mundësinë të pajtoheshin me Topiajt. Ndoshta termat e asaj marrëveshje tashmë duhej të përmbajnë themelet e një aleance martese të ardhshme që shënojnë legjitimimin e pretendimeve të sovranitetit të një pasardhësi të familjes shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit, histori nga e cila mund gjenden gjurmë në një kronikë të vonë të fillimit të shekullit XVI (dy martesat që kontrakttoi Filipi janë domethënëse, fillimisht me Tamarën, trashëgimtare të despotatit të Epirit në vitin 1294, që më pas u hodh poshtë, për të realizuar një martesë më të mirë në vitin 1313, me Katerinën e *Valois-Courtenay*, trashëgimtare e emëruar me titull *Perandore e Kostandinopojës*, që solli me vete ambiciet).

2.2.2. Vetëpromovimi politik i principatave shqiptare

Pika kulmore e vetëpromovimit politik të principatave shqiptare u arrit disa vjet më vonë nga Karl Topia, një feudal i fuqishëm, pasardhës i Tanushit, tashmë vasal i Anzhisë. Karli, emri i të cilit aludoi për sundimtarët napolitanë, përdori të gjitha elementet e legjitimitit e të sakralizimit të pushtetit nga të dyja traditat, ballkanike dhe franceze. Ai soditi vendlindjen e tij në Anzhu për të kërkuar një kurorë, kur në fund të shekullit XIV, pikërisht atëherë kur Mbretëria e Napolit ishte në kontrollin e betejave dinamike të njëpasnjëshme. I lehtësuar nga zhdukja e degës Anzhu-Taranto, u përkushtua me *Durazzeschi* për të synuar fronin e duke përfutur nga vakumi i energjisë së krijuar nga çifligjet jashtë shtetit, pikërisht në këtë kontekst u hoqën edhe principatat e tjera shqiptare, ku principata e Topisë, së bashku me atë të Balshajve, janë më të rëndësishmet.

2.2.3. *Shqipëria katolike me Italinë e Jugut në shek. XV*³¹

Në shekullin XV sundimi anzhuin ishte një kujtim i largët. Kontributi për formimin e fisnikërisë shqiptare kishte favorizuar latinizimin e zakoneve dhe konsolidimin e katolicizmit në *Arbanon*. Shitja e pronave dalmate në Venecia nga Ladislao di Duraxo (Ladislao di Durazzo), në vitin 1409, kur ai kishte qenë në fronin napolitan për disa vjet, zyrtarizoi një shkëputje nga politikat e Ballkanit, e cila ishte shumë më e vjetër, që nga koha kur princat vendas, si Karl Topia, pretenduan pavarësi dhe tituj sovranë. Por një kulturë e mbijetesës së anzhuinëve, e bërë nga modele feudale, duhej të vazhdonte të ekzistonte në aristokraci, e nxitur nga shkëmbimet e pandërprera me qytetet e portit apulian dhe nga marrëdhëniet fetare dhe vasale, që lidhnin Shqipërinë katolike me Italinë e Jugut edhe në shek. XV, shekull kur Gjergj Kastrioti Skënderbeu e bëri atë trashëgimi të tijën, duke njohur si zotërit e tij aragonesë, të cilët që nga 1441 kishin pasur shkëmbime me anzhuinët. Pas vdekjes së Skënderbeut, në 1468-n, Shqipëria u rikthye nën sundimin e një perandorie tjetër lindore.

2.3. EMIGRIMET E SHQIPTARËVE NË ITALI

2.3.1. *Fillimi i emigrimeve*

Për një kohë të gjatë besohej se shqiptarët e parë në Itali kishin mbërritur që nga shekulli XV, ndërkohë që sot mund të pohojmë se shkëmbimet ndërmjet Italisë dhe Arbërisë ishin edhe më të hershme se gjatë shekullit XIV.

Gjatë rrjedhës së shekullit XII, kur mbreti Karli I Anzhu, vëllai i mbretit të Francës, Luis IX, duke dashur të rivendoste Perandorinë

³¹ Gianvito Campobasso, "Da Occidente a Oriente. Alcuni casi di circolazione e ricezione di modelli nell'architettura e nella scultura dell'Albania fra XII e XIV secolo", Hortus Artium Mediaevalium, Université de Fribourg / Universität Freiburg, May, 2016.

Latine të Lindjes, më 1269 organizoi një ekspeditë në tokat shqiptare, ku pushton Durrësin e zonat përreth.

Më 21 shkurt 1272, mbreti Karl u zgjodh mbret i *Regnum Albanie* në Napoli. Gjatë sundimit pati trazira, por pasardhësit e Karlit ruajtën sundimin e tyre në Ballkan. Marrëdhëniet midis mbretit të Napolit dhe Shqipërisë datojnë në gjysmën e dytë të shekullit XII. Ka shumë të ngjarë që midis tyre të kenë ekzistuar marrëdhëniet tregtare, por pa qarkullim të qytetarëve shqiptarë në tokat italiane, duke konsideruar faktin se Shqipëria ishte toka e anzhuinëve.³² Prania e grupeve të vogla dhe sporadike shqiptare, kryesisht anëtarë, familje me origjinë nga zonat ngjitur me qendrat e mëdha portuale të Durrësit, të Ulqinit, të Barit, destinacione këto me karakter tregtar në drejtim të Lindjes, janë regjistruar midis fundit të shek. XIII dhe fundit të shekullit XIV në rajone bregdetare të Italisë Qendrore dhe Jugore, me degëzime në Sicilinë Perëndimore, ku kërkesa për krahë pune ishte veçanërisht e fortë dhe ku hapësirat e mëdha të tokës ishin të pakultivuara dhe të braktisura.³³

Pas betejës së 15 qershorit të vitit 1389, e cila u zhvillua në veri të Prishtinës, në Kosovë, me fitoren e Sulltan Muratit, Shqipëria u bë objekt i sulmeve të vazhdueshme osmane. Në mesin e pengjeve të transferuara në oborrin e sulltanëve ishte edhe Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), ende fëmijë.³⁴

Venecia ishte, gjithashtu, e interesuar për dominimin e brigjeve shqiptare. Në fakt, duke premtuar ndihmë dhe mbrojtje, ajo kishte arritur të shtinte në dorë qytetin e Durrësit dhe të Shkodrës.

2.3.2. *Emigrimi i parë i arbëreshëve*

Drejtimet e zhvendosjeve masive të shqiptarëve ishin tri. Njëri drejtim shkonte drejt Veriut në destinacion të brigjeve dalmate,

³² Zangari, *Le colonie albanesi di Calabria. Storia e demografia secoli XV-XIX*, f. 16-17.

³³ Henri Bresc, *Pour une histoire des Albanais en Sicile XIV-XV siècles*, in *Archivio Storico Siciliano*, LXVIII, 1972, f. 527 e në vazhdim.

³⁴ Innocenzo Mazziotti, *Immigrazione albanese in Calabria e la colonia di San Demetrio Corone (1471-1815)*, Coscile, Castrovillari 2004.

që të vijonte drejt Ballkanit e në Venedik. Drejtimi tjetër, në krah të kundërt, në atë të Greqisë, me destinacion Peleponezin, ose në qytetet bregdetare dhe Ishujt e Egjeut. Udha e tretë mbetej ajo e detit, që ishte më e shkurtër dhe shpinte në bregun tjetër të Adriatikut, pra, në trevat qendrore e jugore të Italisë.

Emigrantët shqiptarë që zbritën në territorin nga *Pescara* deri në *Porto San Giorgio* dhe nga Lindja në Perëndim (nga brigjet e Adriatikut deri në zonën e Apenineve *Umbria-Marche*), u asimiluan shpejt, duke lënë vetëm disa gjurmë të vetat dhe u morën me tregti e artizanat.³⁵

Kolonitë e shqiptarëve u vendosën në Venecia dhe në territoret e qeverisura nga *Serenissima*. Ata gjetën atje mikpritjen e një mjedis kulturor, që u lejonte atyre të shprehnin një kontribut të rëndësishëm e origjinal të punimeve dhe të ideve në fushën e Rilindjes Europiane.³⁶

Në vitin 1385, Balsha II me reparte kalorësish, i sulmuan turqit në Savër të Lushnjës, por u thyen dhe Balsha II mbeti i vvarë. Pas kësaj fitoreje, turqit morën Krujën e më pas pushtuan dhe treva të tjera në veri të trojeve shqiptare. Në këto vite, filloi emigrimi dhe nga trojet jugore arbërore. Francesco Tajani shkruan: "... Në vitet 1399-1410, grupe familjesh shqiptare të drejtuara nga fisniku Gjergj Matranga (Giorgio Matranga), zbarkuan në Sicili dhe u vunë në shërbim të mbretit aragonez Martino il Giovane (1399-1409)"... dhe kjo përbën periudhën e emigrimit të parë të shqiptarëve (1399-1409).³⁷

³⁵ Ducellier A., Doumerc B., Imhaus B., de Miceli J., *Les chemins de l'exile. Bouleversements de l'Est européen et migrations vers l'Ouest à la fin du Moyen Âge*, Armand Colin Éditeur, Paris, 1992, f. 225 e në vazhdim.

³⁶ Polpeo G. Molmenti, *La storia di Venezia nella vita privata, dalle origini alla caduta della Repubblica*, I. Bergamo, 1922; Molmenti P., *Vittore Carpaccio, gli Albanesi, la loro scuola in Venezia e i quadri di Carpaccio*, Milano, 1906.

³⁷ Francesco Tajani, *Albanesi in Italia*, Casa del Libro, Cosenza, 1909, fq.16.

2.3.3. *Migrimi i dytë (1416 dhe 1448)*

Migrimi i dytë daton ndërmjet viteve 1416 dhe 1448, por fluksin e vet e pati rreth vitit 1442, kur mbreti i Napolit, Alfonso I i Aragonës, pas pesë vjetësh luftime kundër anzhuinëve u detyrua të kërkonte mbështetje nga shqiptarët. Rreth 3000 shqiptarë fisnikë, nën drejtimin e kapiten Dhimitër Reresit e djemve të tij Gjergjin (*Giorgio*) dhe Vasil (Basilio), u dërguan në Kalabri për të shtypur revoltën e baronëve. Në 1448-n, Mbreti i Napolit e emëroi Dhimitër Reresin guvernator të provincës së Kalabrisë së Poshtme kundrejt ndihmës së ofruar. Dy djemtë e tij, Gjergji dhe Vasili, u ngritën në gradën e kapitenit. Nga një dokument i datës 1 shtator i vitit 1448 tregohet se Gjergji, si kryetar i Epirotisë, u transferua në Sicili me trupa ushtarake për të mbrojtur bregdetin perëndimor të ishullit nga dyndjet e anzhuinëve. Gjithashtu, mbreti u dha disa nga zonat e konfiskuara të *Centelles* në Kalabri, ku, për rrjedhojë, u themeluan fshatra shqiptarë, si dhe u ripopulluan fshatra. Ndër më kryesorët përmendim, në provincën e Katanzaros: *Caraffa*, *Gizzeria*, *Marcedusa dhe Zagarise*, në provincën e Krotones: *Carfizzi*, *Casabona*, *Pallagorio*, *San Nicola dell'Alto* e *Zinga* dhe në provincën e Kozencës, *Curinga*.

2.3.4. *Migrimi i tretë (1461-1468)*

Migrimi i tretë daton ndërmjet viteve 1461 dhe 1468, kur Ferdinandi I, mbreti i Napolit, në vitin 1459 i kërkoi Skënderbeut që ta mbështeste në luftën kundër revoltës së baronëve (1459-1462). Skënderbeu i vjen në ndihmë mbretit të Argonëve (në Mbretërinë e dy Sicilive).

Ekspedita ushtarake e Skënderbeut në Itali (1460-1462)

Në 1460-n mbreti Ferdinand pati probleme serioze me një rebel të Anzhusë dhe kërkoi përsëri ndihmë nga Skënderbeu. Kjo kërkesë shqetësoi kundërshtarët e mbretit Ferdinand, njëri prej të cilëve ishte edhe udhëheqësi i shquar, por jo i besueshëm, *Sigismondo Pandolfo*

Malatesta, që i thërrisnin “ujku i Rimitit”, i cili deklaroi se nëse Ferdinandi do të kishte marrë Skënderbeun për këtë ekspeditë, do të kishte mbingarkuar situatën me osmanët. Në fakt, Skënderbeun e prisnin betejat kundër osmanëve, prandaj, në shtator të vitit 1460 nuk shkoi vetë të ndihmonte mbretin Ferdinand të Aragonëve, por nisi në ekspeditë nipin e tij Gjokë Stres Balshën me 500 kalorës për të luftuar rebelin Giovanni Antonio Orsini³⁸ nga *Balzo*, princ i fundit i Tarantos, që më vonë luftoi edhe kundër francezëve që e kishin pushtuar.

Kur situata u bë kritike, Skënderbeu mbylli një armëpushim trevjeçar me osmanët, më 17 prill të vitit 1461 dhe arriti në Pulja më 25 gusht të vitit 1461, me 1000 kalorës dhe 2000 këmbësorë në ndihmë të mbretit Ferdinand.

Me mbërritjen e Skënderbeut, Ferdinandi ia besoi atij tërë frontin e Puljas dhe mbrojtjen e kalasë së Barletës, ndërsa vetë luftoi më tej në veri me Alessandro Sforza-n, Dukën e Milanos, kundër anzhuinëve francezë.

Skënderbeu kreu me ndërgjegjen më të madhe detyrën që i ishte caktuar. Nga Barleta dhe Trani ai sulmoi territoret e baronëve rebelë në Terra d’Otranto, në krahinën e Tarantos (zotërit feudalë të së cilës ishin aleatë me rebelin Giovanni Antonio Orsini) dhe u shkatërruan. Pas tre muajsh, rebelët e udhëhequr nga princi i Tarantos kërkuan paqe, për të cilën vetë Skënderbeu veproi si ndërmjetës.

Mbreti i dy Sicilive, Ferdinandi I shpërblen Skënderbeun me prona e tituj

Skënderbeu kishte arritur të mposhte trupat italiane dhe flotën e Orsinit të Tarantos, duke i siguruar kështu fronin mbretit Ferdinand, i cili e falënderoi Skënderbeun dhe “do t’i ishte mirënjohës për gjithë jetën”. Shumica e trupave mbeti në Pulja, në *Capitanata* dhe *d’Otranto*, duke themeluar kështu Shqipërinë Salentine (*Albania Salentina*). Skënderbeu u kthye me disa trupa për t’iu rikthyer misionit të tij kundër osmanëve.

³⁸ Kundërshtari i Ferdinandit, princi Giovanni Antonio Orsini i ofroi një aleancë Skënderbeut, i cili iu përgjigj se shqiptarët nuk do të tradhëtonin kurrë miqtë e tyre.

Në Shqipërinë Salentine bënin pjesë këto vende: *Sternatia* dhe *Zolino* në provincën e Leçes, *Belvedere*, *Carosino*, *Civitella* (*Carosino*), *Faggiano*, *Fragagnano*, *Monteiasi*, *Montemesola*, *Monteparano*, *Roccaforzata*, *San Crispieri*, *San Giorgio* etj. Sot vetëm *San Marzano di San Giuseppe* përfaqëson kujtesën historike të atyre kohërave, duke ruajtur gjuhën e ritin arbëresh.

Në krahinën e *Foggia-s* në *Capitanata* u themeluan *Casalnuovo di Monterotaro*, *Casalvecchio di Puglia*, *Castelluccio dei Sauri*, *Chieuti*, *Faeto*, *Monteleone di Puglia*, *Panni* dhe *San Paolo di Civilita*.

Skënderbeu në krahinat e Campania-s

Skënderbeu luftoi më vonë në betejën e krahinës së *Campania-s* (Napoli) dhe mposhti anzhuinët. Pas kësaj beteje, në kodër u vendos një garnizon ushtarësh shqiptarë për të mbrojtur territoret kryengritëse. Ata themeluan qytetin Greci (sot, provincë e *Avellino-s*). Në udhëtimin e Skënderbeut për në Napoli në vitin 1467, Ferdinandi I, në shenjë falënderimi për ndihmën e ofruar në Pulja, i siguroi një sërë avantazhesh simbolike dhe ekonomike. Skënderbeu mori çifligjet e *Monte Sant'Angelo-s* dhe të *San Giovanni Rotondo-s* në *Capitanata* për veten dhe trashëgimtarët e tij të tanishëm e të ardhshëm. Së fundi, mundësinë e shfrytëzimit të bregdetit të *Monte Sant'Angelo-s* dhe të portit të *Matinata-s* për të importuar dhe eksportuar në çfarëdo vlere pa detyrimin për të paguar taksat në portin e *Manfredonia-s*. Shumë shqiptarë që kishin shoqëruar princin e tyre në Itali u pyetën nëse do dëshironin të qëndronin dhe iu dha e drejta të qëndrojnë atje me familjet e tyre, ku u shpërndanë në fshatra të ndryshëm.

Vdekja e Skënderbeut

Skënderbeu vdiq më 17 janar 1468 në Lezhë. Donika Araniti, e shoqja e Skënderbeut, i shprehu mbretit Ferdinand I të Napolit dëshirën që, së bashku me djalin e saj Gjon Kastrioti II, pasardhësin e vetëm të Skënderbeut, të vendoseshin në çifligjet e Skënderbeut në Mbretërinë e Napolit (kjo ishte si kërkesë dhe dëshirë për të

shpëtuar nga hakmarrja e osmanëve). Mbreti e pranoi me kënaqësi këtë kërkesë në letrën e tij të datës 24 shkurt të vitit 1468.

Rrëfimi për udhëtimin e arbëreshëve drejt brigjeve të Italisë

Lidhur me emigracionin shqiptar në Itali, menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut (1468-1470) dhe me rënien e disa rajoneve të Greqisë në “*mano turcorum*” (*Eubea*, ose *Negroponte*, *Acaia*) në vitin 1473, ekzistonte edhe një dokument i shkruar nga Agostino Toçi (Agostino Tocci) në vitin 1650, gjetur në San Cosmo Albanese, në shtëpinë e Flaminio Tocci-t (botuar në Firence në vitin 1866 nga Jeronim de Rada dhe Niccolò Jenò de ‘Coronei si shtojcë e “Rapsodi të një poeme shqiptare”). Dorëshkrimi ofron një variant, i cili, tejkalon dogmat e vendosura nga historiografia. Prof. Domeniko Kasiano (Domenico Cassiano) jep një përmbledhje me titull “*Kujtimi i Agostino Tocci-t i 1650-s, gati dy shekuj pas vdekjes së Skënderbeut*”. Ky dokument historik është si një skicë e kujtesës popullore, dhënë gojarisht e transmetuar nga brezi në brez, për një udhëtim të trazuar nga Shqipëria në Itali, që përmban lajme të vërteta dhe dramatike.

Figurat më të shquara në histori shkruajnë për Skënderbeun:

Sir William Temple e cilëson Skënderbeun si një nga të shtatë krerët më të mëdhenj pa kurorë, së bashku me *Belisarius*-in, *Flavius Aetius*-in, Janosh (Gjon) Huniadin, *Gonzalo Fernández de Cordoba*-n, *Farnese Aleksandrin* dhe *William*-in e Heshtur.

Kompozitori italian *Antonio Vivaldi* kompozoi një opera me titull “Skënderbeu” (interpretuar për herë të parë në vitin 1718). Gjithashtu, në shekullin XVIII, kompozitori *François Francœur* kompozoi në frëngjisht një opera me titull “Skënderbeu” (e interpretuar për herë të parë në vitin 1763).

Skënderbeu është protagonist i tri tragjedi britanike të shekullit XVIII, përkatësisht:

Skënderbeu (*William Havard*, tragjedi e vitit 1733); *Hero i krishterë* (George Lillo’s, viti 1735); dhe *Skënderbeu - Dashuri dhe liri* (Thomas Whincop, viti 1747).

Poeti i shekullit XVI, *Ronsard* shkroi në frëngjisht një poemë rreth

tij, ndërsa poeti amerikan *Henry Wadsworth Longfelloë* e shkroi rreth shekullit XIX; Gibbon, “John Huniades dhe Skënderbeu”. Volteri (*Voltaire*) nis kapitullin e tij “Marrja e Kostandinopojës” me fjalinë: “Sikur perandorët bizantinë të kishin vepruar si Skënderbeu, Perandoria e Lindjes ende mund të ekzistonte.”

“E shtuna e Shalës” tek arbëreshët

Më 31 maj është Pentekosti. Në liturgjinë lindore, edhe e shtuna e mëparshme përkujton të vdekurit. Për arbëreshët është një ditë shumë e trishtuar. Një thënie e vjetër është “Ardhshin të gjitha festat, por e shtuna e *Scialla*-s nuk vjen kurrë”. Aluzioni është në të shtunën e ditës së pesëdhjetë të vitit 1413, sepse në atë ditë turqit, gjatë viteve të luftimeve, shkaktuan në Shalla një humbje të tmerrshme ndaj Gjon Kastriotit, duke shënuar kështu fundin e rezistencës të shqiptarëve dhe fillimin e sundimit otoman në Shqipëri. Përsëri, në prag të Pentekostit, më 29 maj të vitit 1453 Kostandinopoja, pas rezistencës së ashpër e heroike, u pushtua nga ushtria turke me në krye Mehmedin II. Kostandin Dragosez Paleologo, Basileos i fundit, pasi dëgjoi *Te Deum*, me një përulje të madhe, ngjeshi armët, luftoi heroikisht në muret e qytetit dhe vdiq heroikisht, duke luftuar midis ushtarëve, pa u njohur. Nga ajo ditë, Kostandinopoja, metropoli fetar i Lindjes së krishterë, u bë kryeqyteti i mbretërisë turke, në vend të Adrianopojës dhe Katedralja e Shën Sofisë u shndërrua në një xhami. Të shtunën Pentekoste, arbëreshët e *Mezsojuso*-s, pasi kujtojnë të vdekurit e tyre, në perëndimin e diellit, siç kanë bërë për mbi 500 vjet, shkojnë në *Brigna*, kodra me pamje nga qyteti dhe, me kokën e zbuluar, me fytyrën e kthyer në drejtim të lindjes, ata këndojnë “O Bùkura Morè”, kënga e trishtuar e mërgimit.

Familje shqiptare fisnike lidhur me botën arbëreshe

Emri i Gjergj Aranitit haset në kujtesën popullore dhe me emrin Gjorg Golemi. Sipas kujtesës popullore, Gjorg Golemi ishte i lavdishëm. Araniti, sipas Marin Barletit, ishte kryegjeneral i ushtrisë së Skënderbeut. Roli i vjehrrit të Skënderbeut, Gjergj Araniti, në ndeshjet kundër osmanëve, çmohet shumë në historia.

Historianët janë marrë pak me të, sepse fama e Skënderbeut e la në hije. Sipas historianëve, tri herë ka ardhur në Shqipëri Sulltan Mehmeti II: një herë kundër Krujës dhe herë të tjera kundër këtyre viseve dhe përballjen më të madhe e pati gjatë pushtimit të trojeve të arvanitasve. Gjergj Araniti ishte një nga krerët kryesorë, që mbështeti Skënderbeun në Kuvendin e Lezhës. Ai ishte përkrah tij edhe gjatë kryengritjes së përgjithshme kundërosmane, që ndërmorën shqiptarët nën udhëheqjen e tij.

Për historinë e familjes fisnike “Araniti” flet libri i prof. Dhimitër Shuteriqit, i cili pasqyron historinë e kësaj familjeje të fuqishme feudale, duke filluar që nga shekulli XI, kur shfaqet për herë të parë emri i kësaj familjeje në kronikat bizantine e gjer në vitin 1551, kur shuhet pinjulli i fundit i saj, Araniti, djalë i Konstandinit dhe nip i Gjergj Aranitit. Ky i fundit udhëhoqi shqiptarët në kryengritjet kundërosmane të viteve '30 të shekullit XV. Nga Aranitët vinte Donika, e shoqja e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Aranitët sunduan në viset kyçe të Shqipërisë, në rrugët e luginat kryesore të Shqipërisë së Mesme, në rrugën pranë Drinit, në hyrje të Shqipërisë nga ana e Ohrit dhe e Dibrës. Pas vdekjes së babait (Gjergj Aranitit), i biri 12-vjeçar, Kostandin Araniti, u shpërngul në Itali, ku pati një karrierë të ndritur.³⁹

Donika Kastrioti, e bija e Gjergj Aranitit, princit të Vlorës dhe Kaninës. Martesa me Gjergj Kastriotin solli edhe pajtimin e tij me Aranitasit, të cilët kishin marrë anën e Venedikut pas krizës së vitit 1450. Dy anëtarë të tjerë të familjes Araniti, Moisi Golemi dhe Muzaka Araniti ose Muzaka i Angjelinës, ishin bashkëluftëtarë të Skënderbeut. Donika Kastrioti, pas vdekjes së të shoqit emigroi në Napoli dhe prej andej në Spanjë, bashkë me të birin Gjon Kastriotin.

³⁹ Në pavijonin e mesjetës të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë gjendet epitafi i Gllavenicës, i cili daton në vitin 1373. Ky është i vetmi objekt i kulturës materiale që është ruajtur nga familja fisnike Araniti. Sipas kalendarit bizantin, korrespondon me 22 marsin e vitit 1373. Mbishkrimi i epitafit është qëndisur në dy shtylla, pranë kokës e këmbëve të Krishtit. Studiuesi Moikom Zeqo është shprehur se epitafi i Gllavenicës, daton në vitin 1373 dhe është zbuluar në qilarin e një shtëpie të rrënuar, në afërsi të Ballshit. Epitafi i përkiste kishës së Gllavenicës.

Theodor Koronë Muzaka (*Teodoro Corona Musachi*), i njohur edhe si *Theodore III Musachi*, ishte një udhëheqës dhe atdhetar shqiptar, që u angazhua në luftën kundër Perandorisë Osmane dhe drejtoi kryengritjen e parë kundër turqve, më 1437-1438. Pas kësaj lufte, ai u bashkua me Skënderbeun në Lidhjen e Lezhës (Alessios), më 1444-n.

Luka Bafa (Luca Baffa) lindi në Shqipëri, në gjysmën e parë të shekullit XV dhe, për shkak të ekspansionit turk, ai arriti në internim në Mbretërinë e Napolit, duke udhëhequr një grup mërgimtarësh që erdhën nga Epiri për të ripopulluar territoret e braktisura në Kalabri, pas vdekjes së heroit shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeut, më 1468-n.

Bernai Konti (*Branai Conte*), ose Brana (italianizuar në Bernardo) ishte djali i Vrana Kontit, bashkëpunëtor i ngushtë, këshilltar dhe një nga komandantët më të mirë të Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Kostandin Arianiti (Costantino Araniti), i quajtur edhe *Cominato* ose *Comneno* (Durrës, rreth vitit 1456-Montefiore Conca, 8 maj 1530), ishte një kapiten shqiptar dhe një kapiten sipërmarrës (stratiot) aktiv në Itali. I përkiste familjes Araniti dhe ishte djali i feudalit shqiptar Gjergj Aranitit, që luftoi në Shqipëri kundër turqve, dhe i *Pietrina Francone-s*, vajzës së baronit *Oliviero Francone*, toger aragonez në Leçe. Njëra nga motrat e tij, Donika, ishte gruaja e Skënderbeut.

Mërkur [Murrik] Bua Shpata (*Mercury Bua Spata*); Nauplia, 1478 – Treviso, 1542), ishte gjithashtu komandant me origjinë shqiptare.

Maurizio Bua (Nauplia 1478 – Treviso, 1542) ishte me etni shqiptare dhe ishte një pasardhës i familjes princërore me origjinë shqiptare të Bua Shpatës, e vendosur në Peloponez. Paraardhësit e tij kishin qenë princër të *Angelocastro-s* dhe Artës, si dhe baronë të despotatit të Moresë. Pas pushtimit osman të gadishullit helenik (1460), Pietro Bua, babai i *Maurizio-s*, ishte shpallur udhëheqës i shqiptarëve të Greqisë. Bua u transferua shumë i ri në Venecia – pas vdekjes së babait të tij (rreth vitit 1489) dhe këtu ai ndryshoi emrin e tij nga *Maurizio* në *Mercurio*.

Ai ishte konti i *Aquino*-s dhe *Roccasecca*-s, si një vasal i mbretit të Francës. *Maurizio*-ja njihet dhe Mërkur Bua Shpatën, apo “*Dominus Mercurio*”, siç e quanin venecianët. Është varrosur në kishën *Santa Maria Maggiore*-s, Treviso. Njihet për shërbimet e tij në mbështetje të mbretërve të Francës Karli VII dhe Ludoviku XII, e më vonë të perandorit gjerman Maksimalian. Në frëngjisht prej kohësh është regjistruar fjala “Albanueja”⁴⁰.

2.3.5. Migrimi i katërt (1468-1506)

Migrimi i katërt dhe më i gjerë daton ndërmjet viteve 1468 dhe 1506, kur venedikasit i kishin lënë shqiptarët në pushtetin e Mehmetit II. Gjithnjë e më shumë qytete dhe kështjella shqiptare binin nën sundimin osman. Popullsia po përndiqej e masakrohej. Shumë ndoqën shembullin e largimit, duke u vendosur më parë në Italinë e Jugut. Nga portet e Raguzës, të Shkodrës dhe të Lezhës filluan të largoheshin familje të tëra në anijet veneciane, napolitane dhe shqiptare.⁴¹

Pas pushtimit të Krujës (1478) dhe Shkodrës (1479)

Pas pushtimit të Krujës nga osmanët pati një emigrim tjetër të fisnikëve shqiptarë në Mbretërinë e Napolit për t’i shpëtuar hakmarrjes së osmanëve dhe islamizimit. Shumë familje katolike shqiptare të rritit bizantin ndoqën bashkatdhetarët e tyre dhe themeluan “*Casali*” në krahinat e Kozencës: *Acquaformosa*,

⁴⁰ “Albanueja” – kapelë shqiptare, që ka hyrë si fjalë e koncept nga trupat e Mërkur Buas. Kapela shqiptare ose “Albanueja” ishte kaq në modë në Francën e shekullit XVI (rezultat i kavalerisë së lehtë të Mërkur Buas), aq sa e futi në përdorim edhe vetë Mbreti i Francës.

⁴¹ Në këtë kuadër përmendim letrën që Papa Pali II i shkruante Dukës së Burgundit: “*Qytetet (e Shqipërisë), të cilat deri më tani i kishin rezistuar tërbimit turk, tani kanë rënë në fuqinë e tyre. Të gjithë popujt që jetojnë në brigjet e detit Adriatik dridhen para syve të një rreziku të afërt. Kudo shihet vetëm terror, dhimbje, burgosje dhe vdekje. Nuk mund të shikoni pa lot në sy ato anije që po iknin nga brigjet shqiptare në portet italiane, ato familje të zhveshura, të përzënë nga shtëpitë e tyre, ulen në brigjet e detit, duart e shtrira drejt qiellit dhe ajrit me vajtime në gjuhën e tyre*”.

Castroregio, Cavallerizzo (fraksioni i sotëm i *Cerzeto-s*), *Cervicati, Cerzeto, Civita, Frascineto, Marri* (sot pjesë e *San Benedetto Ullano-s*), *Mongrassano, Percile, Piataci, Rotagrega, San Basile, San Benedetto Ullano, San Giacomo di Cerzeto, Serra di Leo* (afër *Mongrassano-s*) dhe shumë vende të tjera, gjurmët e të cilave nuk gjenden sot.

Themelimi i ngulimeve arbëreshe në Sicili

Me një dekret mbretëror, një pjesë e arbëreshëve u vendosën në Sicili, duke u transferuar në vendbanimet e themeluara nga ushtarët e Reresit, më 1448-n. Veç tyre, u krijuan edhe vendbanime të reja, si: në provincën e Palermos 1481, *Palazzo Adriano*, në vitin 1488, *Piana dei Greci*, në vitin 1490, *Mezzojuso* dhe në vitin 1691, *Santa Cristina Gela*, në provincën e *Catania-s* dhe *Biancavilla* në vitin 1488. Për të siguruar jetesën, disa iu përkushtuan bujqësisë, ose bagëtive dhe të tjerë, u rekrutuan në ushtrinë e mbretit të Sicilisë, Ferdinandit III katolik. Midis atyre që u bënë pjesë e ushtrisë ishin: Pietro dhe *Mercurio Bua, Blaschi Bischettino, Giorgio dhe Demetrio Capusmede, Lazzaro Comilascari, Giorgio Matrancha (junior), Biaggio Musacchio* i familjes së famshme Muzaka (*Musacchi*, princat dhe despotët e Epirit), *Cesare Urana* (Vrana) dhe ushtarë dhe kapedanë të tjerë të famshëm që shërbyen me artet e tyre luftarake në luftërat në Itali dhe në rrethimin e Kastelnuovos (*Castelnuovo-s*) (1537-1540).⁴²

⁴² *Giovanni*, mbreti i Sicilisë nga viti 1458-1468, i rekomandoi nipit të tij “të famshëm” Ferdinandi I, mbretit të Napolit, në një letër kushtuar fisnikëve shqiptarë *Pietro Emmanuele de Pravata, Zaccaria Croppa, Petrus Cuccia* dhe *Paolo Manisi*, kundërshtarë të palodhshëm të turqve, që të lejonte shqiptarët të vendoseshin në Sicili. Ai i çliroi ata nga “çdo mbledhje”, taksim. Shqiptarët në krahinat e tjera të Mbretërisë së Napolit morën të njëjtat privilegje, si ato në Sicili.

2.3.6. *Migrimi i pestë (1532-1534)*

Migrimi i pestë masiv daton nga viti 1532-1534, kur osmanët pushtuan kështjellën e Koronit (Coronei) në More dhe popullsia greke e shqiptare që jetonte atje, u larguan nga Koroni, Methoni, Nauplia dhe Patras për në Mbretërinë e Napolit.

Koroni - pozita e saj strategjike

Në Koroni ekzistonin shqiptarë që nga shekujt XII-XIII. Në shekullin XV, një numër i madh i princave shqiptarë, të cilët kishin ikur nga atdheu i tyre para osmanëve, gjetën strehë atje. Koroni i vendosur në skajin perëndimor të gadishullit jugor të Peloponezit, së bashku me Methonin, u konsiderua një vend vëzhgimi i pakrahasueshëm, i cili me shekuj kontrollonte rrugët e galeve për në Kretë, Kostandinopojë dhe në Tokën e Shenjtë si “*venetiarum ocellae*” (sytë e Republikës të Venecias). Kësisoj, qyteti-port i Koronit ishte si pikë fillimi.

Andrea Doria dhe flota e tij në shërbim të Koronit

Kur osmanët nën Sulltan Sulejmanin ndërmorën një përpjekje të dytë për të pushtuar Vjenën në vitin 1532, admirali gjenovez Andrea Doria, i cili ishte në shërbimin e spanjollëve, i propozoi Charles V (si Charli IV, mbreti i Napolit) për ekspeditën në Lindje, të cilën perandori e pranoi.

Më 29 korrik, Andrea Doria mbërrin në Napoli me 25 galeone, dhe më 4 gusht, ai mbërriti në *Messina*, ku priti të bashkohej me disa anije për t'u larguar drejt Peloponezit. Më 18 gusht flota e Andrea Doria, me 48 galeone dhe 30 anije të mëdha, u largua nga porti i *Messina*-s për në Lindje.

Qyteti i Koronit, ose Korones (*Corone*-s), në vitin 1532, numëronte rreth 5 000 banorë. Me gjasë, në vitet 1500, osmanët kishin hequr kufizimet e vendosura nga venecianët lidhur me hyrjen e qëndrimin në qytet. Në fakt, shqiptarëve u ishte ndaluar të jetonin në qytet dhe madje të hynin në grupe me më shumë se dhjetë vetë.⁴³

Kur Doria arriti para Koronit, popullsia vendase i dërgoi

⁴³ Paolo Petta, “Eksodi i Coronei - Një faqe e historisë së italo-shqiptarëve”, në: Takimet Jugore 1/3, 1996.

fshehurazi mesazhe për ta mirëpritur, për ta informuar për gjendjen e brendshme të qytetit dhe për të rënë dakord për të bashkëpunuar nga brenda. Andrea Doria zbarkoi pjesën më të madhe të ekuipazhit spanjoll e italian për të rrethuar qytetin. Italianët komandoheshin nga *Girolamo* (ose *Geronimo*) *Tuttavilla* dhe Spanjollët nga *Girolamo Mendoza*. Pas një beteje të ashpër, që zgjati për tri ditë dhe pas vdekjes së 300 ushtarëve të krishterë, kryeqyteti i atëhershëm i Moresë ra në dorën e Dorias më 21 shtator të vitit 1532.⁴⁴

Lajmi për pushtimin e Koronit dhe masakrën e një numri të madh të ushtarëve osmanë i la mbresa të mëdha Sulejmanit të Madh, i cili u betua për hakmarrje të pamëshirshme si ndaj koroneive, ashtu dhe ndaj atyre që ishin bashkuar me kurorën spanjolle pas kësaj katastrofe.

Udhëtimi nga Morea ishte jo më shumë se 900 milje detare larg nga Mbretëria e Napolit, në brigjet e Kalabrisë dhe Lukanos, i cili realizohej në karvanë ose galeone, që udhëtonin me erëra të qeta, mesatarisht 100 milje në ditë, çka do të thotë se udhëtimi zgjaste 9-10 ditë, plus ndalesat. Nëse udhëtimi do të përfundonte në portin e Napolit, koha e udhëtimit do të dyfishohej. Uljet e para u bënë në Napoli dhe ende sot ekzistojnë, zona të rretheve të ndryshme të Napolit të quajtura lagje greke, ose *Decuman*.

Udhëtimi me anije kishte nevojë për furnizim me ujë, kështu që aty ku kushtet ishin të lejueshme, anijet me byk mjaft të sheshta mund të afroheshin në breg në vendet, ku të bënin “akuata”⁴⁵. Lëndët ushqimore që nuk prisheshin e që ishin ngarkuar në anije, i lejuan të arratisurit të ushqeheshin mjaftueshëm, duke marrë në

⁴⁴ Jakob von Sandrart (Peteers) në “Plani i qytetit dhe Kalaja e Korones”, shkruan: “Më 21.9.1532, admiralit gjenovez Andrea Doria, i punësuar nga perandori Charles V, me 10 000 ushtarë dhe me ndihmën e popullatës së krishterë të *Corone*-s, pushtuan kështjellën e *Corone*-s. Republika e Venedikut nuk reagoi dhe, brenda pak muajsh, osmanët rifituan kontrollin e situatës; të gjithë shqiptarët u kthyen kundër osmanëve dhe arritën të merrnin qytetin *Corone*. Fuqitë në konflikt filluan negociatat zyrtare të paqes, të cilat dështuan dhe gjithçka që mbetej ishte të pranohej vendimi i Karlit V, që të bëhej evakuimi i *Corone*-s.

⁴⁵ “Akuata” - quhej furnizimi me ujë (shënim i redaktorit)

konsideratë dhe kohën e shkurtër të udhëtimit. Bashkë me disa orendi të vlefshme dhe sende personale (rroba, stoli dhe sende të tjera), në anije u ngarkuan edhe kuaj, të cilët do t'u shërbenin për rindërtimin.

Më 8 nëntor të vitit 1532, Karli V e kishte tërhequr admiralin Doria nga Lindja. Mbreti dërgoi dyqind anije tregtare për të shpëtuar familjet fisnike. Këtu ishte dhe familja *Camidi*, ndër ta dhe *Camodeca*, i përmendur si "*ciertos caballeros que an venido de Coron*", të cilët kishin frikë nga hakmarrja e myslimanëve. Familjet më të rëndësishme fisnike shqiptare u ngjitën në anijet e Dorias dhe më 24 dhjetor të vitit 1532, erdhën me të në Napoli, ku Doria mori shumë lavdërime.

Mbreti Karli V, i mahnitur për vlerën e shqiptarëve për të mbrojtur qytetin e Koronës e për të "nderuar" këta refugjatë, nxori dekretin e *Regio Cavalierato-s (Regio Cavalierato Coroneo Diploma Imperiale Dhnje N On Morea*, më 22 nëntor të vitit 1533). Në formën e një letre të datës 8.4.1533, ai ia besoi markezit të *Villafranca-s* dhe mëkëmbësit të Napolit, *Pedro Alvarez de Toledo*, dhe u dha këtyre ushtarëve shqiptarë titullin "*Cavalier*", duke i përjashtuar nga çdo haraç, duke u hequr shumë taksa dhe duke u dhuruar 70 dukate çdo vit nga thesari i mbretërisë. Për koronasit në *Calabria Citra* mbreti urdhëroi t'u jepnin tokë në Pulja, në Kalabri ose në krahinat e tjera të mbretërisë. Disa u vendosën në Barile në Basilicata, në San Benedetto Ullano dhe në San Demetrio në provincën e Kozencës. Me një akt tjetër të datës 10.5.1533, Karli V i vlerësoi koronasit, duke i deklaruar ata si familje fisnike. Këtë e demonstrojnë mbiemrat, si: *Jeno, Rodota e Coronei, Camodeca*.

Flamuri spanjoll nuk zgjati shumë në kështjellën e Koronit, sepse, në vitin 1533, Sulejmani dërgoi një flotë detare nën komandën e ushtarakut osman Khizir, duke e pushtuar Koronën. Vetëm kur u vendos traktati i paqes të nënshkruar nga Kostandinopoja midis *Charles V* dhe Sulejmani I, qyteti i fortifikuar i Koronit iu la osmanëve. Kushtet në këtë traktat parashikonin që koronasi, i cili dëshironte të largohej nga qyteti, mund të hipte në një flotë të dërguar posaçërisht nga Karli V për të gjetur strehim në Itali.

200 anije tregtare, të drejuara nga qeveria napolitane përfunduan shpërndarjen e të gjitha familjeve greke dhe shqiptare të Koronit, që preferuan të gjenin një shtëpi të re në provincat jugore të Italisë.⁴⁶

Arbëreshët erdhën nga Korona (Corona)

Në vitin 2016, në Arkivin e Përgjithshëm të Simancas në Madrid është gjetur nga *Jose 'M. Floristan* dokumenti i pabotuar për koronasit shqiptarë. Ai ishte profesor i greqishtes klasike në departament dhe i gjuhësisë europiane. *Floristan*-i botoi disa dokumente të pabotuara për koronasit grekë dhe shqiptarë, në vitin 2016, në revistën “*Erytheia*”, ku shkruan: “Koronët shqiptarë të shpërndarë në Mbretërinë e Napolit protestojnë drejtuar mbretit për shkak të privilegjeve që nuk u jepen, kjo për shkak të gënjeshtreve të grekëve!”.

Dokumenti nr.8 i Arkivit thotë: Ekziston një dallim i qartë midis shqiptarëve dhe grekëve. Këta të fundit nuk silleshin në mënyrë transparente. Shqiptarët protestuan fuqishëm përmes memorialit drejtuar Karlit V. Gënjeshttrat e grekëve ishin të dukshme. Grekë kishte shumë pak (vetëm 3%) dhe ata ishin vendosur në zonat e jugut, por pjesa më e madhe e *Coronei*, ishte popullsia shqiptare dhe këtë e vërteton gjuha që flasin Arbëreshët. Kjo ide hedh poshtë ata që proklamojnë se *Coroneit* ishin grekë dhe kurrë nuk mbërritën në Mbretërinë e Napolit.

⁴⁶ *Bisignano*-ja shkruan: “Kishte pasur më parë emigrime të shqiptarëve grekë, por ajo e vitit 1535 ishte padyshim emigrimi më i qëndrueshëm i një populli, i cili kishte rezistuar për shumë dekada me shumë heroizëm ndaj pushtimit të turqve, dhe i cili u detyrua ta lërë tokën amtare me aq shumë hidhërim, përgjithmonë, duke privuar veten nga gjërat më të domosdoshme, duke u ulur në brigjet e popujve të huaj, me idioma, zakone të ndryshme nga të vetmet, të mbështetur vetëm nga besimi në Zot dhe me shpresën për të gjetur në të toka të reja dhe një gjendje më të mirë jetese. Në lidhje me këtë, Papa Pali II, në një letër drejtuar *Filipit, Duka i Burgundy-së*, përkshkroi, me theks dramatik, gjendjen e mjerueshme të refugjatëve të zbarkuar në Itali. Shumë prej këtyre shqiptarëve u ndalën në Napoli, të tjerët në ishullin Lipari, ndërsa, në pjesën më të madhe, ata preferuan të vendoseshin në vendet e ndryshme të Italisë Jugore dhe të izoluara, tashmë të populluar nga bashkatdhetarët e tyre në migrimet e mëparshme.

Braktisja e Koronës nga ushtria perandorake e udhëhequr nga Andrea Doria pas dy vitesh pushtimi (1532-1534) çoi në mbërritjen në Napoli të një kontingjenti të rëndësishëm të *Peloponnesiaci*-t, në veçanti nga qytetet e *Corone*, *Modone* dhe *Patras*. Disa llogaritje thonë se ishin rreth 8 000 “Coronei” që erdhën nën udhëheqjen e peshkopit të tyre *Benedetto*. Nga këta, 5 000 u vendosën në Napoli, ndërsa pjesa tjetër u vendosën në *Messina*, *Basilicata* dhe në Kalabri.

Nga cila pjesë e Greqisë erdhën arbëreshët e Italisë?

Nga dokumenti i gjetur në Arkivin e Përgjithshëm të *Simanca*-s, profesori *Gennaro Varriale* në universitetin e Xhenovas pohon me vendosmëri se: “Megjithëse në Napoli quheshin “koronei”, refugjatët shqiptaro-grekë vinin nga rajone të ndryshme të zonës helenike, të cilat në të kaluarën i përkisnin Perandorisë së Bizantit. Të mërguarit ishin me origjinë nga *Morea*, *Achaia*, *Euboea*, *Boeotia* dhe ishujt e Kikladave. Shumë njerëz, ende e konsiderojnë *Tommaso Assanis Paleologo* si një korone, por pak e dinë që ai arriti në Napoli nga Korinthi dhe që i shërbente mbretit Frederik në shërbime diplomatike. Të tjerë, ende e përfshijnë kapitenin e kuajve *Nicolò Masi* midis koroneive, duke harruar se ai ishte me origjinë nga Napflio ose Napoli i Rumelisë”.

Lazar Mathes

Rreth 2000 njerëz me kryepeshkopin e tyre të riteve greke, Benediktin e shumë ushtarë u larguan me shpenzimet e tyre në drejtim të Mbretërisë së Napolit. Ky grup udhëhiqej nga stratioti kapiten *Lazzaro Mattes* (ose *Lazar Mathes*). Disa u tërhoqën në ishullin Lipari, të tjerë preferuan të bashkohen me bashkatdhetarët e tyre në More në Sicili, të tjerë u përhapën në vende të tjera.

Karli V u dha *Lazaro Mathes*-it dhe trashëgimtarëve e pasardhësve të tij, lejen “*Casali*” në Mbretërinë e Napolit. Lazaro Mathes me të tjerë i hodhën bazat e tyre për ripopullimin e vendeve, si: *Barile*, *Brindisi Montagna*, *Ginestra*, *Maschito*, *Melfi*, *San Costantino Albanese*, *San Paolo Albanese* dhe *San Giorgio Lucano*, në krahinën e *Potenza*-s në *Basilicata*, ndërsa *Castroregio*

dhe *Farneta* në krahinën e Kozencës në Kalabri. Një grup tjetër themelo, ose ripopulloi “grekët” në krahinën e *Avellino*-s. Me koncesionin e Karlit V, *Mathes*-i ripopulloi zonat e Tarantos (*San Martino, Roccaforzata*).⁴⁷

2.3.7. Migrimi i gjashtë (1647 - 1680)

Migrimi i gjashtë daton nga viti 1647, kur popullsia greko-shqiptare e Manit në *Laconia* në gadishullin e Moresë u rebelua kundër sundimit osman. Revolta u shtyp me dhunë.

Me 16 qershor të vitit 1647, një numër i konsiderueshëm arritën në Otranto me familjet e tyre për të jetuar në këtë mbretëri. Maniotët jetuan atje dhe morën tokë, si dhe patën përjashtime nga taksat për dhjetë vjet. Shumica e maniotëve u vendosën në krahinën e *Potenza*-s “Barile” në *Basilicata*, ku ishin vendosur shqiptarët në vitin 1477 pas pushtimit të Krujës, në vitin 1534, “*Coronei*” dhe në 1597-n, rreth 30 familje “*Coronei*”, që u vendosën në Melfi. Të dhënat burojnë nga një dorëshkrim i *Don Giuseppe Caracciolo*-s, princi i parë i Torellës gjatë viteve 1639-1670.

Në vitin 1680, disa familje arvanitase u larguan nga Maina, të udhëhequr nga vëllezërit *Georg* dhe *Macario Sevastò*. I pari ishte një prift dhe tjetri murg bazilian. At *Ferdinando Apicella* e priti atë në *Chieuti*. Disa familje të fisnikërisë antike zbarkuan në Trani dhe Otranto. Meriton të përmendet familja Basta, e famshme dhe e fuqishme në Xhenova e Venecia. Gjergj Basta (*Giorgio Basta*) ishte kapiteni dhe baroni i *Civitella*-s, ndërsa Paskal Teodor Basta (*Pasquale Teodoro Basta*, 26.4.1711 – Monteparano, 27.12.1765) u zgjodh më 29 janar të vitit 1748 peshkopi i Melfit dhe *Rapolla*-s.

Shumë nga shqiptarët që ikën në Itali u vendosën në një pjesë

⁴⁷ Arbëreshët i këndonin deri vonë *Lazar Mathes*-it: “O Zoti, madhe Zoti/ Se ka deka Lazarini/E Zoti nenja gjender/Vemmi Eklishi/E shohu Lazarini/ E thirti Lazari ngridu/E Lazari ngridi uperbissi/neng pavi, neng favi/neng keshi. Transkriptimi në shqipen e sotme: O Zot, i madhi Zot/Ka vdekur Lazari/E ti Zot nuk u gjende/Ne shkojmë në Kishë/Të shohim Lazarin/E thërrasim Lazar ngrihu/Dhe Lazari u ngrit në gjunjë/ Nuk shihte, nuk fliste, nuk qeshte/ (*Roccaforzata*, 1866).

përgjatë bregdetit të Adriatikut midis *Abruzzo*-s dhe *Gargano*-s dhe më vonë, u transferuan në Molise dhe Shtetet Papale; disa u vendosën në *Genazzano*, të tjerët zbarkuan në *Marche*, ku qëndruan në Urbino dhe vende të tjera në Italinë qendrore.

Cilët njiheshin me emrin “grekë”?

Me fjalën “grekë”, gjatë shekujve të sundimit osman, kuptohej qoftë prejardhja nga “oekumeni bizantin” (ajo botë që *Obolensky* e quajti me një term shumë të goditur nga ana semantike dhe konceptuale *byzantine*, që përfshinte popuj etnikisht të ndryshëm, të lidhur nga ana politike, administrative dhe ekonomike) qoftë vetëm të krishterët ortodoksë të Ballkanit, pavarësisht përkatësisë së tyre etniko-kombëtare.⁴⁸

2.3.8. Migrimi i shtatë (1743)

Migrimi i shtatë daton nga viti 1743, kur Karli VII pranoi në mbretërinë e Napolit 73 familje greko-bizantine shqipfolëse nga qyteti bregdetar i Piqerasit, një qytet midis Borshit e Lukovës. Ky emigrim u parapri nga një inkursion i banorëve të Borshit, në dhjetor të vitit 1742, të cilët u detyruan të kthehen në islam, sidomos banorët në Kurvelesh. Në këto kushte, komuniteti vendosi të linte vendlindjen, të drejtuar nën kujdesin e *Macario Nikas* (Nica) dhe *Dacon Demetrio Atanasio*. Në rrugën e tyre përmes Lukovës, iu bashkuan vendas nga Shën Vasili, Likursi dhe Nivica-Bubari, që ndodhen në veri të Sarandës, Korfuzit dhe Othonit. Ndërkohë, 18 familje mbërritën me anije në qershor të vitit 1743 në Brindizi, nëish-mbretërinë e Napolit dhe Karli VII, në tetor 1743, i transportoi në rajonin e *Abruzzo*-s. Emigrantët prisnin të vendoseshin diku për qark në *Pianella*. Pas mosmarrëveshjeve të gjata me popullsinë vendase, që nuk pranonte emigrantët, Karli, më 4.3.1744, nënshkroi dekretin, nëpërmjet të cilit jepej tokë për shqiptarët në *Piano di*

⁴⁸ Dimitri Obolensky, *The Byzantine Commonwealth: Eastern Europe, 500-1453*, Praeger Publishers, Nju Jork, 1971.

Coccia dhe *Badessa* (tani *Villa Badessa*). Në vitin 1774, një grup i fundit emigrantësh u vendos në Brindizi di Montanja (*Potenza*).

2.3.9. *Migrimi i tetë*

Sipas *Tommaso Morelli*-t, migrimi i tetë daton në vitin 1774, kur spanjolli Ferdinandi IV, djali i Karlit VII, ishte mbreti i Napolit dhe kërkonte popullsi për të kultivuar e kolonizuar toka të mëdha të shkretëtirës pranë portit të Brindizit. Drejtues i grupit ishte *Panagiotti Caclamani*, i quajtur *Fantazia* (*Phantasia*) nga Lefkada, i cili ishte nën kontrollin e *Fiskalit, Marquis Nicola Vivenzio* (1742-1816).

Popullsia e re që erdhi, u tradhtua nga eprorët për pagat e tyre. Ata vrapuan drejt kryeqytetit (Napoli) për të kërkuar mbrojtje nga sovrani Ferdinandi IV, i cili urdhëroi që me këtë çështje të merrej *Arkimandriti Paisio Vretò*, kapelan i regjimentit II të “Real Macedonia”. Besnikëria e kapelanit ndaj mbretit dhe zelli i tij për qytetarët e tij ishin të njohura dhe u arrit që të merrej një pjesë e pagës. Sidoqoftë, zhvendosja në Napoli dhe vdekja e udhëheqësit të tyre ishin shkak i shpërndarjes së kësaj kolonie.

Arbëreshët ishin kundër burbonëve

Dekreti i Ferdinandit II të burbonëve për përjashtimin e arbëreshëve të Kalabrisë nga vëllazëria e kishave greke të Shën Pjetrit dhe të Shën Palit në Napoli, më 12 nëntor të vitit 1853, mund të jetë një formë ndëshkimi politik për pjesëmarrjen masive të arbëreshëve në kryengritjet antiburbone të atyre viteve, ose një nxitje nga mosmarrëveshjet e shumta, që karakterizonin jetën e brendshme të kishës greke të Napolit⁴⁹.

⁴⁹ Mbishkrimi zyrtar ruhet edhe sot në oborrin e kishës, ku, me fjalë të gdhendura në gur, mbreti i Napolit, Ferdinandi II, dekreton për të dytën herë përjashtimin e arbëreshëve të Kalabrisë nga vëllazëria.

Kapitulli III

3.1. ARBËRESHËT DHE TRASHËGIMIA E TYRE KULTURORE

Arbëreshët, më shumë se çdo gjë tjetër, vuajtën ashpërsitë e feudalizmit kishtar. Pasi kishin zbehur mundësinë e kthimit në vendin e tyre amë, filluan të hedhin themelet për një ekzistencë të qëndrueshme. Ata punuan tokat shterpë, pastruan kodra të egra për të përmirësuar bujqësinë dhe bagëtinë: mbollën fiq, vreshta, ullishte dhe jaseminë (mana⁵⁰), si dhe u morën me kultivimin e krimbit të mëndafshit.

Arbëreshët themeluan afro 100 koloni me ushtarë dhe civilë

Në vitin 1569 kishte 3944 “zjarre” shqiptare:

- *Abbruzzo citra* – 403;
- *Abruzzo Ultra* - 138;
- *Basilicata* - 787;
- *Calabria Ultra* - 153;
- *Capitanata* - 1169;
- *Molise* - 102;
- *Principato Ultra* - 56;

⁵⁰ Në tekst është ruajtur edhe varianti i disa emërtimeve sot, ose i atyre të njohura nga vetë arbëreshët, njëloj siç është paraqitur nga vetë autori. (Shën. red.)

- *Terra di Bari* - 1186;
- *Terra Hidrunti* - 803;

Për krahinat e tjera nuk ekziston një regjistrim për këtë vit, pasi shpesh ndodhte që shqiptarët largoheshin për të mos u llogaritur e, për këtë arsye, nuk u duhej të paguanin çdo vit njëmbëdhjetë Pugët.

Sot ekzistojnë 50 vende me origjinë dhe kulturë shqiptare, 41 bashki e nëntë fshatra me një popullsi të përgjithshme prej mbi 100 000 banorësh, të mbrojtur me ligjin nr.482, datë 15.12.1999, “Për mbrojtjen e pakicave historike gjuhësore” (për kolonizimin shqiptar të Italisë Jugore).⁵¹

Grupe të rralla shqiptarësh kanë marrë rrugën drejt Italisë qysh në vitin 1272, 1388 e 1393, por vetëm në mesin e shekullit XV ka ngulime të dukshme. Sot janë rreth pesëdhjetë qytete të shpërndara anembanë *Mezzogiorno*-s (Italinë e Jugut), ku ende dëgjohet të flitet shqip. Këto bashkësi gjenden në krahinat: Abruçe, Molize, Kampania, Pulje, Bazilikata, Kalabri (Kozencë dhe Katanxaros/Krotone) dhe Sicili. Ato janë, përkatësisht:

1. Krahina e Peskarës (*Pescara/Abruzzi*): Badhesa (*Villa Badessa*);
2. Krahina e Kampobasos (*Campobasso, Molise*): Këmarini (*Campomarino*), Munxhifuni (*Montecilfone*), Portkanuni (*Portocannone*) dhe Ruri (*Ururi*);
3. Krahina e Avelinos (*Avellino/Campania*): Greçi (*Greci*);
4. Krahina e Foxhas (*Foggia/Puglia*): Kazallveqi (*Casalvecchio di Puglia*) dhe Qeuti (*Chienti*);
5. Krahina e Tarantos (*Taranto/Puglia*): Shën Marxani (*San Marzano di San Giuseppe*);
6. Krahina e Potencës (*Potenza/Basilicata*): Barilli (*Barile*), Xhinestra (*Ginestra*), Mashqiti (*Maschito*), Shën Kostandini (*San Costantino Albanese*) dhe Shën Pali (*San Paolo Albanese*);
7. Krahina e Kozencës (Kozencë/*Calabria*): Firmoza

⁵¹ Bibliografia: Morelli 1842, Dorsa 1847, Scaglione 1921, Zangari 1940, Tajani 1969, Cassiano 1977, Bartla 1981, Rotelli 1988 dhe Dessart 1984. 29 kr. Camaj 1975.

- (*Acquaformosa*), Kastërnexhi (*Castroregio*), Kajverici (*Cavallerizzo*), Qana (*Cerzeto*), Çifti (*Civita*), Ejanina ose Purçilli (*Eianina ose Poicile*), Fallkunara (*Falconara Albanese*), Farneta (*Farneta*), Ferma (*Firmo*), Frasnita (*Frascineto*), Ungra (*Lungro*), Maqi (*Macchia Albanese*), Marri (*Marri*), Pllatani (*Plataci*), Shën Vasili (*San Basile*), Shën Benedhiti (*San Benedetto Ullano*), Strigari (*San Cosmo Albanese*), Shën Mitri (*San Demetrio Corone*), Shën Japku (*San Giacomo di Cerzeto*), Mbuzzati (*San Giorgio Albanese*), Shën Murtiri (*San Martino di Finita*), Picilia (*Santa Caterina Albanese*), Shën Sofia (*Santa Sofia d'Epiro*), Spixana (*Spezzano Albanese*) dhe Vakarici (*Vaccarizzo Albanese*);
8. Krahina e Katanzaros dhe Krotones (*Catanzaro, Crotone / Calabria*): Garafa (*Caraffa di Catanzaro*), Karfici (*Carfizzi*), Puhëriu (Pallagorio), Shën Kolli (San Nicola dell'Alto) dhe Vina (*Vena di Maida*);
9. Krahina e Palermos (*Palermo/Sicilia*): Kundisa (*Contessa Entellina*), Hora e Arbëreshëvet (*Piana degli Albanesi*) dhe Sëndhastini (*Santa Cristina Gela*).

Nuk ka të dhëna të besueshme për numrin aktual të italo-shqiptarëve. Të dhënat më të fundit statistikore vijnë nga regjistrimi i vitit 1921, kur janë regjistruar 80 228 shqiptarë dhe, nga një studim i Alfredo Fernandes në vitin 1997, që tregon për një popullsi prej rreth 197 000 banorësh. Në vitin 1998, Ministria e Brendshme e Italisë e vlerësoi pakicën shqiptare në Itali me rreth 98 000 banorë.

3.2. ARKITEKTURA DHE URBANISTIKA RRETHORE E KATUNDEVE ARBËRESHE

Të ashtuquajturat “arkitektura të vogla”, por sigurisht të një rëndësie të jashtëzakonshme, përfaqësojnë një trashëgimi të shkëlqyer të kulturës ndërtimore popullore të arbëreshëve. Gjithënjë është bërthama themeluese e fshatit shqiptar. Forma e saj buron nga

rregullimi i kasolleve që ndërtuan refugjatët shqiptarë në themel të fshatrave. Nga vendbanimi i pasigurt, me të cilin u organizua kampi modest i familjeve refugjate, ata kaluan në ndërtimet e përhershme e përfundimtare, që u bënë qelizat e para urbane të fshatit. Gjithonia, në format e saj më arkaike, ka një hapësirë të tillë qendrore (të quajtur shesh), drejt së cilës përballen dyert e katër ose pesë shtëpive, që, përmes një sistemi rrugor, lidhen me hapësirat e tjera. Në këtë mënyrë, ato formojnë strukturën e pëlhurës urbane, si një shenjë e barazisë shoqërore, si mërgimtarë që ishin, për të qenë të pandashëm në jetën sociale.

Shtëpitë e tyre ishin shumë të thjeshta, kishin një plan katërkëndor, pothuajse asimetric, me linjë jo të rregullt, me një ose dy kate me çati dhe nënçati, ose dykatëshe, të mbuluara me pllaka balte (si shtëpitë modeste rurale të kontekstit kalabrez, por është ruajtur origjinaliteti i tyre ballkanik).

Në gurët e disa portave të shtëpive ka stema në dyer të gdhendura, që janë emblema të legjioneve, një shenjë e një populli luftëtar, në të cilin edhe gratë shërbenin në ushtri. Perdet e dritareve janë element dallues për shtëpitë e arbëreshëve. Ato kanë motive shqiptare dhe janë në harmoni me kontekstin arkitekturor të banesës.

Në disa qendra me origjinë shqiptare ekzistojnë aktualisht artizanë (kryesisht gra), të cilët merren me përpunimin e gjineshrës, të cilën e bëjnë fije me tezgjah dhe me to krijojnë mbulesa dhe perde shumë të bukura origjinale, tipike arbëreshe.

Një element i kulturës lokale konsiston në futjen e furrës brenda shtëpisë. Kjo ndodh për dy arsye: së pari, sepse shqiptarët kishin mënyrën e tyre të gatimit të ushqimit, duke preferuar që të gatuanin tava në furrë, por edhe roli i saj si sistem ngrohjeje. Nëse do vizitoni qytezat arbëreshe, shpesh do të vëzhgoni nga pjesa e jashtme formën e “gungës” së furrës, një shtëpi të tillë do të gjeni në rrugën “*Ascensione*”, në pjesën “e sipërme” të fshatit (zona jugperëndimore) *Santa Sofia d’Epiri*, ose edhe në një qytezë tjetër arbëreshe si ajo e Çiftit (Civita).

Elemente të tjera të diversitetit janë disa “hapje” të vogla me

motive orientale. Një dallim tjetër janë edhe qoshet e disa ndërtesave, të cilat janë pjesërisht të rrumbullakosura, duke arritur kulmin në pjesën e sipërme me një hark të vogël, e cila bën daljen nga ana e jashtme.

3.3. TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE ARBËRESHE

3.3.1 *Arbëreshët trashëguan gjitoninë*

Nuk ka fjalë më të bukur se koncepti “*gjitoni*”. Gjitoni ka brenda rrënjën “*gji*”, nga i cili jemi ushqyer, apo kemi qenë të mbrojtur (në gjoksin e nënës).⁵²

Në fshatrat arbëreshe, ku shtëpitë prej guri ndjekin linja të lakuara dhe kanë karakteristikën e pragut të mbështjellë në sheshin e saj të vogël (e cila luante rolin e një salloni me qiell të hapur), gratë arbëreshe shpesh ndalonin në këto pragje, ku gurët shndërroheshin në kolltukë dhe shkallët e gjtonisë në divane. Në atë hapësirë të vogël të pragjeve, banorët e qytezës ndalonin e shkëmbenin përshëndetje. Gjytoria u bë si “një palestër e jetës”, ku gërshetoheshin ide dhe marrëdhënie, ku mësohej jeta reale. Gjytoria arbëreshe është ai unitet fizik, shoqëror e simbolik, është rezultat i asaj lidhjeje të rëndësishme dhe të qëndrueshme të solidaritetit.

Gjytoria ishte akt identiteti, ku gratë bashkoheshin e qëndisnin kostumin arbëror për ditët e festave; ishte ai vlerësim, sipas të cilit të vjetrit respektoheshin.

Falë gjtonisë u ruajt dhe gjuha. Nuk ekzistonin bibliotekat e komunitetit arbëresh, nuk kishte libra: veç gjuha e folur mbretëroi dhe arriti të përçojë në shekuj kulturën e lashtë shqiptare. Me gjtoninë koha qëndronte pezull në atë nostalgjinë e Moresë, për vendin që lanë, për tokën, për eshtrat e gjyshërve të tyre, për ndërgjegjen arbërore që transmetohej nga nëna tek e bija dhe kështu, breza e breza me radhë...

⁵² Arbëreshët, kur përshëndeteshin nëpër sokakë, i thërrisnin njëri-tjetrit “Gjiri”, në kuptimin “vëlla nga i njëjti gjoks/gji”.

Gjitonia ishte “nëna” e të gjithë atyre fëmijëve që luanin e kontrolloheshin në distancë, ku ndihej përgjegjësia kolektive për rritjen dhe edukimin e tyre. Gjitonia ishte edhe një “forum” a një “redaksi”, ku kishte kritika, apo bëheshin edhe thashetheme, por asnjëherë nuk të linte në baltë, sepse GJITONIA, mbi të gjitha, ishte ai akt i thjeshtë human, ku demonstrohej solidariteti dhe që të ndihmonte përherë kur kishte nevojë.

3.3.2. *Arbëreshët trashëguan ritin*

Nëse arbëreshët nuk janë asimiluar deri më sot, kjo është edhe falë ritit bizantin që ata ruajtën, sepse në ritin latin çdo funksion kishtar është në gjuhën italiane. Përpjekjet e bëra nga arbëreshët e Italisë për të mbajtur të pastër ritin e tyre (edhe nëpërmjet dioqezave bizantine) ishin të shumta dhe plot sakrifica. Ato u materializuan me kalimin e kohës e, në mënyrë të veçantë, me punën themelore të *Pompilio Rodota-s*, me origjinë arbëreshe.

Papa Klementi (1878-1903) me origjinë shqiptare, u njohu arbëreshëve identitetin dhe vlerat, si dhe urdhëroi eliminimin e çdo shtese liturgjike të papajtueshme me ritin bizantin. Më pas, në vitin 1919, me pontifikatën e Benediktit XV (1914-22), u krijua Eparkia (Dioqeza) e Lungros (Ungro), e cila përmblihte Kalabrinë dhe, në vitin 1937, nën drejtimin e Papa Pius XI (1922-39) u krijua në Sicili dioqeza e *Piana degli Albanesi* (Horës së Arbëreshëve). Në të njëjtën kohë, u deklarua “esarkik” edhe abati i *Santa Maria di Grottaferrata-s* (Romë).

I vetmi institucion publik, i cili deri vonë pati për qëllim ruajtjen, përdorimin e kultivimin e gjuhës arbëreshe ishte Kisha Bizantine (ose *Kisha Greko-Katolike Arbëreshe*). Riti, së bashku me veshjet, me gjuhën e me zakonet identifikojnë vetë arbëreshin. Kujdesi shpirtëror dhe identiteti iu besuan klerit. Arbëreshët, për arsye hapësire, krijuan dy eparki, njëra në Sicili dhe tjetra në Kalabri.⁵³

⁵³ Peshkopët e Eparkisë së Kalabrisë ishin: *G. Mele* (1919-1979), *G. Stamati* (1979-1987), *E. Lupinacci* (nga 1987-2010) dhe, së fundi, *D. Oliverio* (2010), ndërsa peshkopët e Eparkisë së Sicilisë ishin: *Giorgio Stassi*, *Giuseppe*

3.3.3. *Arbëreshët trashëguan besimin*

Në shekullin VI ekzistonte në Shkodër një kishë e njohur me emrin “Zonja e Këshillit të Mirë” (*Madonna del Buon Consiglio*), kushtuar Shën Marisë, e cila u rrafshua në vitin 1467, për shkak të hordhive turke kundër të krishterëve. Thuhet se kuadri shkëputet nga faqja e murit dhe shoqëron një grup shqiptarësh deri matanë Adriatikut dhe mbërrin deri në kishën e *Gennezano-s*, 48 km larg Romës.

Në vitin 1968, Papa Pali VI u shpreh për arbëreshët: “Nëse historia ju ka parë të shtypur dhe të shpërndarë, mirësia e Zotit ju ka bërë, me të gjithë anëtarët e “Gjaku i shprishur / Stirpe të shpërndarë” tuaj, me një veprimtari të zjarrtë të lindur dhe me mirëkuptim të fituar; bëjeni veten kudo nëpër aleanca dhe bashkëpunime, të cilat shpesh ju kanë bërë parashikues të ekumenizmit modern”⁵⁴.

3.3.4. *Arbëreshët trashëguan mitin e Skënderbeut*

Arbëreshët janë si një muze, ku lëviz shpirti i Skënderbeut. Ata kanë qenë një faktor i rëndësishëm për kthimin në mit të figurës së Skënderbeut.

Pothuajse në çdo fshat arbëresh nuk mungon busti i Skënderbeut, i cili është si një simbol për arbëreshët dhe ka mbajtur gjallë identitetin arbëror.⁵⁵

Guzzetta, Francesco Chiarchiaro, Giuseppe Crispi, Agostino Franco, Giuseppe Masi, Paolo Schirò. Peshkopët që ishin me origjinë nga arbëreshët e Sicilisë, por shërbenin në Kalabri apo në *Abruzzo, Basilicata, Puglia* ishin: *Agostino Franco, Giuseppe Schirò, Giovanni Barcia.* Kronotasët (*cronotasi*) e dioqezës ishin: *Luigi Lavitrano, Ernesto Ruffini, Giuseppe Perniciaro, Ercole Lupinacci, Sotir Ferrara, Paolo Romeo, Giorgio Demetrio Gallaro.*

⁵⁴ Fjalimi i Papa Palit të VI në festimet e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit -Skënderbeut, 1968, (<http://www.zemrashqiptare.net/news/38007/rp-0/act-print/rf-1/printo.html>)

⁵⁵ Historia e Skënderbeut u përfshi dhe në operën e Vivaldit me të njëjtin emër dhe u shfaq në teatrin “*Della Pergola*”, në Firenze, më 22 qershor të vitit 1718. Kjo vepër përuroi rihapjen për publikun të këtij teatri. Libreti u shkrua nga Antonio Salvi, libretisti i preferuar i dukës së Toskanës, *Ferdinando de’ Medici*, familje me influencë në Firenze.

3.3.5. Arbëreshët trashëguan rapsoditë dhe besën

Të martën fill pas Pashkëve, në shumë fshatra arbëreshe të Kalabrisë (në *Frascineto*, *Civita*, *Ejanina*) festohet ceremonia “Vallja”. Ata këndojnë nëpër rrugët e fshatit “Kostandinin e Doruntinën”⁵⁶ të kapur dorë për dore, duke çmuar besën, që bëri një të vdekur të ngrihet nga varri për të mbajtur fjalën e dhënë.

Me besën u trashëgua dhe mikpritja, të cilën arbëreshët e “shpalosën” për hebrenjtë⁵⁷. Këta u strehuan në vende, si në Tarsia, ose në Shën Sofia e Epirit.

3.3.6. Arbëreshët trashëguan kostumin e gruas arbëreshe

Veshjet arbëreshe ndryshojnë nga njëra krahinë në tjetrën, por veshja gala e gruas arbëreshe⁵⁸, karakterizohet nga ngjyrat e ndritshme dhe të arta, që korrespondojnë me atë që është thelbësore dhe themelore, me ikonografinë bizantine. Ngjyrat blu, e kuqe ose vjollcë, e verdhë ari, e bardhë e pastër dhe jeshile janë elegante dhe të ndritshme. Ngjyrat duket sikur “flasin” për paraqitjen e bukur të gruas arbëreshe. Një nga kostumet më të hershme është kostumi i arbëreshëve të *San Nicola dell’Alto-s*⁵⁹, gdhendur nga G. David, në vitin 1768. Një prej dokumenteve më të hershme, ku

⁵⁶ Kostandini, i ngritur nga varri, sjell motrën e tij Doruntinën në shtëpinë e nënës, sepse ai i kishte dhënë besën nënës së tij që, sa herë ta kërkonte ajo, ai do t’ia sillte.

⁵⁷ Kampi i internimit për hebrenjtë u krijua në vitin 1940, në Ferramonti, në komunën e Tarsias. Në kamp gjendeshin më shumë se 2000 të internuar (në vitin 1943). Pasi hebrenjtë u lanë të lirë, shumë prej tyre u larguan, ndërsa të tjerët, të tmerruar nga ideja se ndoshta do të burgoseshin përsëri, u fshehën në fshatrat përreth.

⁵⁸ Burrat arbëreshë nuk kanë kostum tradicional. Fustanellën e gjejmë tek arbëreshët e *Villa Badessa-s* në vitin 1743, me pjesëmarrjen e Regjiment “Real Macedonias”.

⁵⁹ Studiuesi Italo Elmo është shprehur: “Duken si veshje të figurave femërore hyjnore dhe të tilla modele janë kostumet më të vjetra të pikturuara deri tani në Arbëri, *San Nicola dell’Alto* dhe *San Michele dell’Alto*; *Carfizzi (Scarfizzi)* dhe *Pallagorio* në Arbërinë krotoneze.”

flitet për pjesët përbërëse të veshjes arbëreshe është një dorëshkrim në Kieuti (*Chieuti*) i vitit 1737. Në këtë dokument gjejmë një këngë martesore, ku nusja e re i përgjigjet pyetjes: “Çfarë gjërash të ka premtuar nëna?”. Nusja e jep përgjigjen në vargje⁶⁰:

Nende coghe e nende linije
(nove gonne e nove camicie)

nende breza te rregjende
(nove cinture di argento)

nende keze te vilushe
(nove diademi di velluto)

nende sqepes te ghole
(nove veli sottili).

Për veshjet arbëreshe kanë shkruar Girolamo Marafioti, Vincenzo Dorsa, Francesco Tajani e Antonio Scura. Ndërkohë, sipas Alessandro *Smillari*-t, “kurora diadema” (velloja me kurorë) e kostumit arbëresh i kushtohet Andromakës, gruas së Hektorit, për të cilën flet edhe Homeri.

Firma “Serpone” e Napolit ka shitur e shet edhe sot pëlhuara për kostumet arbëreshe, që nga viti 1820. Disa veshje gala të së kaluarës ishin njëngjyrëshe (bazuar në pëlhurat që janë gjetur në Napoli) dhe këtë e verifikon fabrika e pëlhurave⁶¹të çmuara të *San Leuccio* në *Caserta*.

Bazuar në pikturat antike dhe në disa dëshmi të shkruara, *Giuseppina D. Schirò* ka bërë hulumtim për këtë material, duke gjurmuar evolucionin e rrobave të grave shqiptare në Sicili.

⁶⁰ Në vargje bie në sy numri nëntë, pjesë përbërëse edhe e rapsodisë “Kostandini dhe Doruntina” (9 muaj, 9 male) etj.

⁶¹ Fabrika ndodhet në një fshat të vogël në provincën e *Caserta*-s (këtu prodhohen edhe pëlhurat e përdorura në pallatin mbretëror të *Caserta*-s, *Quirinale*, në Vatikan, si dhe në Shtëpinë e Bardhë e në Pallatin *Buckingham* (për flamujt).

3.3.7. Arbëreshët trashëguan gjuhën e kulturën

Bashkë me gjuhën,⁶² arbëreshët trashëguan edhe një nga këngët me të njohura sot, “Moj e bukura More”.⁶³ Moreja nuk është tjetër, veçse arbëreshi i personifikuar, polifonia e shpirtit arbëror, është kujtesa dhe malli i një populli të persekutuar për atdheun e humbur.⁶⁴

“Moj e bukura More” gjendet e dokumentuar për herë të parë në dorëshkrimin e Kieutit, botim i vitit 1708; më pas, materiali u ribotua nga filologu arbëresh Dhimitër Kamarda (1821-1882), në librin e tij, në vitin 1866. Teksti i publikuar i kësaj kënge nga Kamarda është shkruar në shqip, por me alfabet grek⁶⁵.

Kur arbëreshët u vendosën në territorin italian, ata filluan të transmetonin traditën gojore, e cila përfshin tri zhanre letrare: përralla, vjersha (improvizime poetike) dhe kalimera (këngë fetare). Përralla kishte një funksion mësimor-edukativ dhe përdorej për të transmetuar gjuhën nga babai tek fëmija. Vjershat ishin improvizime autentike poetike, ku shpirti popullor shprehu shqetësimet e tij e këndoi për ngjarjet e jetës së përditshme. Kalimerat ishin këngë fetare, të cilat shprehnin përkushtimin e besimit tek arbëreshët.

Poezia shqipe tek arbëreshët e Italisë i ka fillesat e saj te vargjet e Lekë Matrangës, të shkruara në vitin 1592. Që prej kësaj kohe, breza

⁶² Shoqëria Etnografike Italiane, në vitin 1969, në Lares, shkruan: “Shumica e perëndive pellazgjike kanë emra shqiptarë.” (botuar nga Johnson Reprint).

⁶³ Kjo këngë mërgimi (shumë e njohur jo vetëm për arbëreshët, por edhe për arvanitët e Greqisë dhe shqiptarët e të gjitha trevave) është çelësi për të kuptuar historinë e krijimit të fshatrave të arbëreshëve të Italisë. Morea, që personifikohet si një e dashur, është Peloponezi i sotëm i Greqisë. Moreja është pasthirmë, është vaj. Morea është riti i tyre, gjuha dhe vallja e tyre.

⁶⁴ Fshatrat arbëreshe janë ndërtuar në mënyrë të tillë me fytyrë nga lindja, vendi i të parëve të tyre. Ndërsa varrezat në *Villa Badessa* (fshat arbëresh, 1743) i kanë varrezat me kokë nga Shqipëria.

⁶⁵ Në atë kohë ishin në qarkullim më shumë se 40 alfabetet e ndryshme. Nuk ishte sanksionuar alfabeti shqip. Disa shkruan me alfabet grek, për shkak të rritit bizantin (ata që shkruanin përdornin grafema të ndryshme për të plotësuar tingujt e kështu përdorën alfabetin grek, latin, sllav e një variant turk, arab, siç ndodhi me shqiptarët e tjerë në emigrim në vende të tjera të botës).

të tërë poetësh kanë lëvruar stile dhe lloje të larmishme vjershërimi, duke ndikuar në zhvillimin e pasurimin e arealit gjuhësor e kulturor shqiptar.

Tradita e shkruar e arbëreshëve filloi në shekullin XVIII, në mesin e komuniteteve shqiptare të Italisë së Jugut, nga poetë dhe shkrimtarë, si: Jul (*Giulio*) Variboba, Jeronim (*Girolamo*) De Rada, Zef (*Giuseppe*) Serembe, *Domenico Mauro*, Zef Skiro (*Giuseppe Schirò*) e shumë të tjerë. “Milosao”, vepra e De Radës, ishte manifestimi i parë i letërsisë së shkruar shqipe. *Maria Antonia Braile* (1894 – 1917), e cilësuar nga kritika si poetja e parë shqiptare, lindi në *San Demetrio Corone*, në Kalabri. Vepra e saj “*Canti*” u botua nga vëllai i saj pas vdekjes. Vargjet e saj melankolike dhe me nota që karakterizojnë shpirtin e arbëreshit kanë vlera historike e letrare.

3.3.8. Arbëreshët trashëguan guximin

Arbëreshët e treguan guximin, kur iu bashkuan Garibaldit kundër burbonëve dhe një gjeneral arbëresh i quajtur Damis humbi syrin. Gjithashtu, gjatë betejës së Monrealit, kronikat shkruanin se një vajzë arbëreshe *Giovanna Petta*, nga Hora e Arbëreshëvet nxjerr nga gjoksi i saj flamurin italian të qëndisur me fijet e arit (me të cilin qëndiseshin kostumet) dhe e valëviste në qiellin e çliruar të Italisë. Ky ishte një akt i shpirtit bujar të arbëreshëve për këtë atdhe të dytë që kishin krijuar në këtë tokë.⁶⁶

3.4. KISHA ILIRE DHE KOSTANDINOPOJA

Kisha ilire ka luajtur një rol domethënës në unguillëzimin e pjesës tjetër të Evropës. Etërit e kishës vijnë nga ilirët: *San Gerolamo*, që përktheu Biblën në latinisht, Shën Gregori i Nisës dhe Shën Niceta nga Shkupi i Dardanisë (autori i himnit “Te Deum”). E gjithë historia e *Illiricum Sacrum* (Iliria e Shenjtë) është përshkruar

⁶⁶ Arbëreshët më vonë mbetën të zhgënjyer nga kjo luftë, sepse nuk morën atë që meritonin, por kjo i përket një historie tjetër.

në rreth 30 mijë faqe të shkruara nga një ekip në shërbim të Papës Klementi XI Albani (1700-1720).

Justiniani është një tjetër figurë e rëndësishme historike për Perandorinë dhe sidomos, për ilirët. Ai është i vetmi perandor që mendoi të shkëputeshin nga Roma dhe në Kostandinopojë krijoi një shtet të ri të ilirëve me një kishë më të bashkuar. Sistemi i tij i ri juridik e çoi përpara Ilirinë, duke caktuar si qendër të kishës qytetin e tij, Shkupin (dikur, Justiniana).⁶⁷

Helenizmi

Nëse thelbi i helenizmit është ideja e një mbretërie universale të *Zotit të Diellit Unik*, duhet theksuar se ky koncept vjen nga Iliria. Ishte Perëndia e Aleksandrit, duke qenë vetë i lindur si bir i Perëndisë së Diellit dhe i Princeshës Epirota Olimpia, priftëresha e Tempullit të Dodonës (lindur mistikisht nga një frymë e shenjtë) dhe edukuar, ndër të tjera, dhe në atë fe nga një prift i veçantë. Maqedonia kishte të njëjtën fe.

Bizanti dhe ilirët

Ilirët ishin gjithashtu themelues dhe ndërtues të Bizantit (12 Perandorët Kostandinianët, ata të Dinastisë së Engjëjve dhe të Komnenëve dhe shumë të tjerë, që ndajnë fuqinë me grekët dhe të tjerët në Isopoliteia). Përfundimisht, ilirët ndahen me dekretin e Theodosiusit në dy pjesë politike e kishtarë, e cila do të jetë fatale për historinë dhe identitetin e saj. Iliria Veriore, që i përkiste Romës, duke mos pasur më një mbrojtje, u pushtua nga sllavët. Në shekullin XI, kur Bizanti dobësohet, ilirët ngrihen përsëri dhe, duke iu referuar principatave të tyre në Jug: Despotati i Epirit (I Comneni), Principata e Albanoi (Principata e Arbërisë ose Arbëria e Kastriotëve), Dukati i Gjinit (Principata e Dukagjinit) në Dardani (Kosova e sotme), Principata e *Musachi* (Principata e Muzakajve)

⁶⁷ Mirie Rushani, “Gli Illiri, un fattore importante nella storia e la cultura Europea”, in *Miti e Cultura Arbëreshë a Cura Di Gianfranco Romagnoli*, Sicilia, 2007, f. 47. (<http://www.vatrarberesh.it/biblioteca/ebooks/albanesi.pdf>)

në Shqipërinë Qendrore e Jugore, Principata e Ballshoit (Principata e Balshajve), Golemi etj. Gjergj Kastrioti Skënderbeu i bashkoi këto principata në një mbretëri të vetme dhe zyrtarizoi “Ligjin e Lashtë”, që besohet se u huazua drejtpërdrejt nga ilirët. Ligji u reformua nga Aleksandri i Madh dhe ndryshe njihet edhe si “ligji antik” ose “ligji i Lekës” – emër ilir e shqiptar i Aleksandrit të Madh.

Mbërritja e pushtimit osman

Ardhja e osmanëve shkatërron atë që i kishte shpëtuar katastrofës sllave. Rënia e Kostandinopojës në vitin 1453, bëri që një numër i madh i familjeve me origjinë ilire të iknin nga Kostandinopoja në drejtim të Europës e më vonë, në vitin 1468, me rënien e Mbretërisë së Shqipërisë dhe të Epirit, edhe kjo popullsi u arratis. Shumë emra hynë në historinë e artit e të shkencës europiane, si: Tarkaniota, Besarioni, Artioti, Karpaçi, Albani, Tomeo, Barleti, Beçikemi, Albani i Bergamos. Drejtuesit e gjeneralët e Skënderbeut erdhën në Itali, në epokën ku fillon epopeja arbëreshe.⁶⁸

Shqiptarët që zbarkuan në tokat e Venedikut u vendosën në Istria në qendrat e Porecit, Paoles, Umagut dhe gjithashtu në vetë Venecian, ku, që nga viti 1443, ata kishin një “Shkollë të Devotshmërisë” në kishën e *San Severo-s* (Donika, e veja e Skënderbeut, dhe djali, Gjoni u çuan në Napoli nga *Gerolamo Carovigno*, me një anije të dërguar posaçërisht nga mbretëria e Ferdinandit).

Midis shekujve pesëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë kishte një rrjedhë migratore arbërore të Shqipërisë dhe Greqisë si ushtarë të fatit, refugjatë, fshatra të tëra që iknin nga sundimi osman. Pikat e mbërritjes ishin rajonet qendrore-jugore me pamje nga Adriatiku, deri në Pulje edhe në anën Joniane dhe, madje, në Sicili.

Këta banorë ishin katolikë të rritit lindor, një degë e të krishterëve ortodoksë që ishin afruar me të krishterët romakë, por që arritën

⁶⁸ Mirie Rushani, “Gli Illiri, un fattore importante nella storia e la cultura Europea”, in *Miti e Cultura Arbëreshë a Cura Di Gianfranco Romagnoli*, Sicilia, 2007, f. 49. (<http://www.vatrarberesh.it/biblioteca/ebooks/albanesi.pdf>)

të ruanin liturgjinë në greqishten e lashtë dhe të ruanin disa karakteristika të ritit origjinal. Mesha këndohet, këngët janë të gjitha me origjinë bizantine dhe kishat zbukurohen me ikona me kuptime të sakta. Në Italinë e Jugut kishte tashmë bashkësi katolike të riteve lindore, kështu që integrimi i popullsisë emigruese ishte më i thjeshtë, edhe pse me kalimin e viteve, ata shpesh ishin objekt i përpjekjeve për latinizimin e detyruar.

Në jug, arbëreshët u ndanë në tri kategori: Papat, të cilët dinin të lexonin dhe të shkruanin, nuk paguanin taksa dhe trashëgonin profesionin nga babai te djali; fshatarët, të lidhur me tokën nga “kapitullimet” e pamëshirshme dhe stratiotët (ushtarakë me profesion), të cilët me siguri nuk erdhën për të jetuar në fermat e mjerueshme, por ishin në shërbim të mbretërve të Napolit, Papës, Dukës së Milanos, Grand Dukës së Toskanës, dhe Karlit V.

Pas Luftës së Dytë Botërore pati një fluks të ri migracioni dhe shumë familje u zhvendosën në veri të Italisë, në veçanti në Lombardi dhe Piemonte. Torino, Crescentino, Poirino, Santena dhe shumë qytete të tjera në Piemonte kanë mirëpritur rreth dhjetë mijë arbëreshë të ritit bizantin. Emigrantët ishin të punësuar, kryesisht si punëtorë në fabrikat e industrisë mekanike dhe automobilistike, të cilat, në periudhën e pas luftës patën një zhvillim shumë të madh; pakkush arriti një nivel studimi që i lejonte ata të vetëpunësoheshin. Komuniteti arbëresh u strukturua si një bashkësi autonome, në kornizën administrative, juridike, ekonomike, kulturore dhe fetare në vendet ku u vendos.

Në shekujt XVIII, XIX e XX, arbëreshët arritën të bënin një përparim të jashtëzakonshëm në kulturë dhe letërsi. Të nxitur, mbi të gjitha, nga parimet romantike dhe të Rilindjes, një grup i madh intelektualësh u interesuan për historinë, gjuhën e traditat poetike popullore të arbëreshëve, duke filluar një proces vendimtar në historinë letrare shqiptare. Në këtë kontekst, arbëreshët ofruan figura me rëndësi të madhe dhe personalitete që, në mënyra të ndryshme dhe me mundësi të ndryshme, kontribuan në pasurimin e trashëgimisë së tyre të çmuar. Regjisori Pier Paolo Pasolini, mbijetesën shumëshekullore të komunitetit etniko-gjuhësor arbëresh,

fenomenin arbëresh, që ende sot ruan gjuhën, traditat e kujtesën historike, e përmbloodhi me fjalët: “Një mrekulli antropologjike!”.

3.5. ARBËRESHËT, IDENTITET QË NGJALL ADMIRIM

Në krahinën e Kozencës, shumica e vendbanimeve arbëreshe i kanë fillesat në gjysmën e dytë të shekullit XV. Vdekja e papritur e Skënderbeut (1468) çoi në fluksin e madh të shqiptarëve në Kalabri, ku ata u vendosën në disa vendbanime të braktisura për dekada, në të dyja anët e lumit Krati dhe rrëzë parkut natyror Sila.

Fluksi i emigrantëve vazhdoi gjatë dy shekujve në vijim, por ato më të rëndësishmet ishin në lidhje me kryengritjen e fundit shqiptare të Krujës e të Shkodrës (1478-1479) dhe të Korones.

Në rrugën drejt Kalabrisë ndeshen fshatra e qyteza të ndryshme, ku më pas shfaqet parku i malit të ngrohtë Polini (mal koral që nuk ka majë të mprehtë e që ndodhet në harmoni me brigjet dhe kodrat). Arbëreshët e krahasojnë atë me një trëndafil mes malesh, për shkak pozicionimit të tij gjeografik, pa ndërtesa rreth e rrotull. Polini dhe arbëreshi janë një simbiozë e mirëfilltë – vështrojnë Polinin e shikon edhe pemë me dy degë të përulura sikur luten – forca e Polinit është durimi dhe bujaria.

Kolegji italo-shqiptar i Shën Adrianos “Korsini”

Në jugperëndim të Gjirit të Sibarit, mbi lartësitë që ngrihen drejt malit të Silës, në drejtim të Shën Mitrit (*San Demetrio Corona*), jo larg nga qendra, gjendet selia e ish-kolegjit italo-shqiptar të Shën Adrianos (*Sant’Adriano*) - transferuar nga kolegji origjinal “Korsini” (“*Corsini*”) i *San Benedetto Ullano*-s.

Kolegji u krijua nga Papa Klementi XII, në vitin 1732, në një qytezë tjetër arbëreshe që quhet Shën Benedhiti (*San Benedetto Ullano*) dhe më vonë, në 1794-n, u transferua në Shën Mitri, pranë kishës së Shën Adrianos.

Arbëreshi *Stefano Rodotà de ‘Coronei* (prift i ritit bizantin në *San Benedetto Ullano*) në vitin 1715, në mungesë të figurës intelektuale

të klerit të ritit bizantin të popullsisë arbëreshe në Itali, me miratimin e Peshkopit, shprehu dëshirën që të edukojë me nocione thelbësore të kulturës e të liturgjisë greke priftin e ardhshëm. Kjo formë nuk pati shumë sukses, sepse nuk pati shumë ndjekës që të ndiqnin leksionet në shtëpinë e tij⁶⁹. Vetëm me ndryshimin e reformës (1722) u arrit të përurohej një shkollë falas e kulturës bizantine për të rinjtë arbëresh, si të Sicilisë, ashtu edhe të Kalabrisë.

Vëllai i Stefanos, *Felice Samuele Rodotà de 'Coronei*, qëndronte në Romë, ku, pavarësisht studimeve në kolegjin grek, preferoi të bëhej prift i ritit latin. Ai u mor me detyra të rëndësishme në Bibliotekën e Vatikanit. Gjatë viteve të studimit, kishte shok studentin Lorenzo Korsini (1652-1740), me origjinë shqiptare nga nëna, i cili më vonë u bë papë me emrin Klement XII (1730). *Felice Samuele* ia kishte paraqitur qëllimet e të vëllait Papa Klementit XII, i cili, në vitin e tij të tretë të Pontifikatit (më 11 tetor të vitit 1732, në Romë, në *Santa Maria Maggiore*), themeloi kolegjin "Korsini" në *San Benedetto Ullano* për shqiptarët e dy Sicilive. Inizio modulo Fine modulo

Më 26 shkurt të vitit 1733, seminari i rihapi dyert e tij për 17 nxënës dhe 3 profesorë, për të cilët Rodotà shpenzoi për dy vjet nga të ardhurat e tij. U mbajt një urdhër (*Inter multeplices*), ku shpreheshin qëllimet e themelimit të institutit, edukimin e mësimdhënien në gjuhën dhe letërsinë greke, në artet liberale, në shkencat natyrore e njerëzore dhe, mbi të gjitha, në shkencat teologjike, në elokuencën e në ritin grek të të rinjve arbëreshë. Në vitin e dytë (*Dum ea quae ad nobis*) vlerësohet angazhimi i bërë nga *Felice Samuele Rodotà*, i cili emërohet rektor i Kolegjit. Në vitin e tretë (*Ex inuncto*) përcaktohen rregullat e brendshme të institucionit e në të katërtin (Kushtetues i Lartë), Presidenca e Kolegjit iu besua një peshkopi të emërimit papal. Në vitin e pestë, në 1737-n, Papa dhuron shumë prej 12 000 dukate nga pasuritë e tij për ngritjen e mirëmbajtjen e seminarit. Në vitin e gjashtë (*Praeclara Romanorum*), rektorit të Kolegjit i njihet e

⁶⁹ Në një letër drejtuar peshkopit të tij, *Rodotà* shkroi: "Unë krijova një lloji seminari në *Ullano*, pasi, pas vdekjes sime, të mbetet si një shembull i asaj që mund të ishte bërë." Në këtë seminar në kulturën bizantine priftërinjtë e rinj do të kalonin provat e do të promovoheshin në urdhra të shenjtë".

drejta për t'u dhënë gradën atyre studentëve që kanë përfunduar me sukses studimet e tyre në Filozofi, Teologji dhe Shkrim të Shenjtë.

Më 16 shtator 1735, *Felice Samuele Rodotà* u emërua shugurues peshkop dhe kryetar i kolegjit të *Ullano*-s. Për më shumë se gjysmë shekulli, kolegji “*Corsini*” u bë një qendër e shkëlqyer edukimi për shumë priftërinj të rriteve greke, aq sa ata nuk kishin asgjë për t'u pasur zili në kolegjin grek të Romës. Në gjashtëdhjetë vitet e qëndrimit në *San Benedetto Ullano*, në kolegji u formuan peshkopë të ardhshëm, studiues grekë dhe të tjerë që u dalluan në kulturën greke në të gjithë territorin kombëtar.

Nën Karlin I dhe nën Ferdinandin I, mbret i Napolit, kolegji u bë një qendër e shkëlqyer e formimit kulturor, me fuqinë për të shuguruar priftërinjtë e ritit grek, u bë garantues i integritetit të ritit lindor. Në 1735-n, *Felice Samuele Rodotà* u lartësua në detyrën e kryepeshkopit të Bereas në *partibus infidelium* dhe kështu, të gjithë pasardhësit e tij u bënë peshkopë.

Kolegji, nën sundimin e themeluesit të tij, kishte vlerësimin e Papës e të sovranëve napolitanë; sidoqoftë, peshkopët latinë të dioqezave, ku jetonin arbëreshët nuk e kishin pritur mirë këtë. Ata e konsideruan Kolegjin si një prani, që mund të kishte zvogëluar autoritetin e tyre dhe një konkurrent në formimin e të rinjve të destinuar për priftërinj.

Pasardhësit e Rodotës, megjithëse ishin priftërinj të besimit të dëshmuar, nuk kishin prestigjin, pasurinë dhe kulturën për të vazhduar në mënyrë të duhur punën e për t'u mbrojtur nga ndërhyrja e peshkopëve latinë.

Në mars të vitit 1794, kolegji u zhvendos në Shën Mitër (*San Demetrio Corone*), pranë Kishës së Shën Adrianos, me pretekstin se kushtet klimatike në *San Benedetto* nuk ishin të favorshme për shëndetin e studentëve.

Zhvendosja e këtij kolegji u bë falë punës bindëse të peshkopit *Bugliari* dhe ndërmjetësit *Giuseppe Zurlo* (gjqytar e më vonë ministër i Financave). Transferimi dhe idetë revolucionare, për të

cilat priftërinjtë ishin bartës, nuk konsideroheshin aspak pozitive nga kryepeshkopi i Rossano-s, *Andrea Cardamone*, i cili nuk donte humbjen e asaj pasurie territoriale, të cilën e zotëronte kolegji dhe për këtë ai u bë një barrierë e fortë.

Pas transferimit, mësimi në kolegji u bë gjithnjë e më laik, edhe për zgjedhjen që drejtori bëri nga mësuesit e ideve të shkollës së hapur dhe klasike.

Imzot *Bellusci* (1807-1833) – atdhetar e liberal, dikur student në kolegji – u zgjodh drejtor dhe me mbarimin e periudhës franceze dhe të restaurimit të *Bourbon*-it, drejtimi i Kolegjit nuk pësoi ndryshime thelbësore. Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, kolegji “*Corsini*” kaloi peripeci të ndryshme. Në periudhën e rënies së Republikës Napolitane, në 1806-n, në kolegjin “*Corsini*”, në qendrën humaniste të njohur arsimore për arbëreshët e Italisë, thuhej që edhe Krishti ishte edhe Jakobin. Peshkopi arbëresh *Francesco Bugliari* u shkarkua dhe më vonë u vra.

Në vitet 1820-1821, aleanca ndërmjet profesorëve të Kolegjit dhe militantëve të Karbonerisë (rrymë kundër burbonëve dhe mbretërisë së dy Sicilive) të Shën Mitrit ishte forcuar në luftën kundër burbonëve. Karbonari i Italisë Jugore, pa dyshim, kishte një qelizë shumë të respektueshme në mesin e profesorëve të Shën Adrianos.

Puna e kësaj qelize ishte shumë efektive dhe depërtuese, sepse, përmes nxënësve, familjeve të tyre dhe klasave më të larta të borgjezisë italo-shqiptare, lindën heronjtë e mendimit të lirë dhe veprat e tyre të lavdishme.

Në vitin 1821, matematikani napolitan Gaetano Cerri hyn në Kolegji dhe u pranua si vëllazëror, por flitej që frekuentimi i tij në këtë institut dyshohej për lidhje me karbonarët. Pse dhe për cilat kanale profesor Cerri ishte i mirëpritur në Kolegjin italo-shqiptar do të mbetet një mister, por disa studiues mendojnë se rektori i Kolegjit kishte marrë pjesë në komplotet dhe revolta të shekullit XVIII dhe për këtë arsye, ishte mik i anëtarëve të shoqëritë sekrete. Në fakt, në vitet 1820-1821, me gjithë kontrollet e rrepta të kryera

nga autoritetet e policisë, aleanca midis profesorëve të Kolegjit dhe rrymës së karbonarës të pranishme në Shën Mitër vazhdoi. Mbikëqyrja e autoriteteve kundër këtij grupi profesorësh ishte shtuar, sepse ata dukeshin më të interesuar të motivonin të rinjtë në luftën kundër burbonëve, sesa t'i udhëzonin ata në studime.

Në atë kohë, jo vetëm lulëzuan studimet fetare, por edhe studimet matematikore dhe letrare; dashuria për lirinë, për atdheun dhe për artet e bukura, të cilat profesorët i injektuan me një ngrohtësi të madhe e doktrinë të bollshme, duke e ngritur institucionin në djepin e romantizmit kalabrez.

Me mbarimin e periudhës franceze, drejtimi i Kolegjit nuk pësoi ndryshime thelbësore, sepse *Domenico Bellusci* (pasues e Bugliarit), i emëruar nga burbonët, por me ide demokratike patriotike, kishte ditur të përfaqonte idetë kulturore të hedhura prej Ferdinandit dhe, në të njëjtën kohë, mbante një ekuilibër diplomatik në politikë.

Ky kolegji ishte edhe baza e kryengritjeve të vitit 1848. Në muret e këtij kolegji u organizuan shumë revolta, nga Mauro, Damis dhe rektori *Antonio Marchianò*, një prift i ritit bizantin, i cili ishte bashkuar me një numër të konsiderueshëm nxënësish të kolegjit. Rektori u burgos dy vjet në regjim burbon. Ferdinandi II nuk ngurroi ta përcaktojë Kolegjin me fjalët "*covo di vipere e fucina del diavolo*" (fole nëpërkash e farkëtim i djallit).

Nga bankat e këtij kolegji dolën figura të ndritshme të Rilindjes Italiane, shkrimtarë e juristë, si: *Cesare Marini* (1792-1865), *Domenico Mauro* (1812-1873), Jeronim De Rada (1814-1903), *Agesilao Milano* (1830-1856) dhe shumë e shumë arbëreshë të tjerë.

Në 1859-n fryma publike arbëreshe u ringjall. Ndihej ajri i një pranvere. Damis, Luci, Pace, Stratigò dhe të tjerët, bënë presione për veprim. Kryengritja ishte shpirti i të gjithë fshatrave. Sinjali pritej dhe erdhi pikërisht më 11 maj, me zbarkimin e Garibaldit në Marsala.

Më 1 shtator, heroi kombëtar u fut në Kalabri me një mikpritje entuziaste të papërshtueshme nga dy legjione të shqiptarëve, të udhëhequr nga Sarri e Pace në Kozenca, si dhe nga një turmë

shumëngjyrëshe prej të gjitha vendeve. Nga Kozenca, më 2 shtator, ai shkoi në *Castrovillari*, ku gjeti një mbështetje të fuqishme mes brohoritjesh. Këtu ai emëroi guvernatorin *Muzio Pace* dhe rekomandoi pajtim për të gjithë.

Ushtria e Garibaldit u bë shumë e madhe, duke kapërcyer këtë bandë të gjerë të fshatrave të vegjël. Kolonelët *Pace*, *Sarri*, *Stratigò* me ushtarët e tyre (ku 500 ishin vetëm nga Lungro) ndoqën Garibaldin e, më 13 shtator hynë në Napoli, nën një shi lulesh. I njëjti hero u shfaq nga pallati Angri për t'i përshëndetur ata. Më 1 e 2 tetor ata morën pjesë në betejën e Voltornos, të komanduar nga arbëreshi Damis. Ishte atëherë që Garibaldi, plot admirim, iu drejtua prijësit shqiptar dhe thirri me zë të lartë: “Damis, këta shqiptarët e tu janë luanë!”.

Një intelektual arbëresh nga Shën Mitri i quajtur *Demetrio de Grazia* (1850-1901), pak i njohur, apo dhe i harruar në botën arbëreshe, e përshkuan shumë bukur kur garibaldianët hynë në Shën Mitër: “E kujtoj si ato përrallat një mijë e një net atë natë të 8 shtatorit të paharruar. Isha vetëm 10 vjeç, por kujtoj entuziazmin e atyre burrave dhe grave, zotërinj dhe luftëtarë, të gjithë, të cilët ishin udhëhequr nga poeti *Costantino Bellusci*, ushtar i mbretit Murat, të cilët, nëpër rrugët dhe rrugicat e Shën Mitrit, recitonin poezi të improvizuara e himne dhe festonin sikur të ishte ndonjë fitore Skënderbegiane”.

Disa nga arbëreshët që u bënë figura të shquara të Rilindjes Italiane ishin: *Pasquale Scura*, *Luigi Giura*, *Domenico Mauro*, *Agésilao Milano*, *Attanasio Dramis*, *Francesco Crispi*, *Pasquale Baffi*, Jeronim de Rada, Françesk (*Francesco*) *Antonio Santori*, *Vincenzo Dorsa*, *Angelo Basile*, Zef (*Giuseppe*) *Serembe*, *Luigi Petrassi*, *Vincenzo Stratigò*, *Giuseppe Angelo Nociti*, *Antonio Argondizza*, *Bernardo Bilotta*, *Demetrio Chidichimo*, *Pietro Camodeca de Coronei*, *Giuseppe de Rada*, *Suso*, *Rosto Orazio Capparelli*, *Domenico Antonio Marchese*, *Michele Marchianò* (të gjithë të trajnuar në kolegjin e Shën Adrianos).

Pas vdekjes së Jeronim de Radës, i quajtur ndryshe dhe si homeri shqiptar me epopenë e tij “Këngët e Milosaos”, Kolegji i Shën

Adrianos u drejtua nga prifti *Gaspare Jakova Scutari*, dhe pasardhës të tij ishin profesorët nga Shqipëria, si Aleksandër Xhuvani nga Elbasani (1906-1909), Kol Martinaj nga Shkodra (1909-1914), Mehdi bej Frashëri (1915-1918) dhe më vonë, Hamdi Karasi (1919-1920) dhe Luigj Gurakuqi nga Shkodra (një personazh i rëndësishëm politik në dy dekadat e para të shekullit, shumë herë i zgjedhur si ministër e që studioi në këtë kolegji ndërkombëtar të gjuhës shqipe). Rreth viteve 1917, kolegji nuk u quajt më kolegji grek, për shkak të rritit bizantin, por u quajt kolegji italo-shqiptar.

Në vitin 1903, në kolegjin e Shën Adrianos studiuuan dhe shumë studentë të tjerë shqiptarë.

Themelimi i Bankës së Shenjtë në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe ligji i përmbysjes së feudalizmit të aprovuar nga mbreti Gioacchino Murat gjeneroi një mosmarrëveshje të pafund. Garibaldi premtoi drejtësi dhe shpërndarje të tokës. Fshatarët vrapuan masivisht, por mbi të gjitha borgjezia agrare e re dhe e egër që mori pushtetin. Nyja gordiane e pyetjes agrare u zgjidh në një mënyrë “*Solomonic*” në vitet 1865-1866: fshatarëve u shpërndaheshin disa shirita marginale tokë, ndërsa uzurpuesit iu njoh pronësia e plotë e “tokave” të tyre.

Më 17 mars të vitit 1861 u mblodh në Torino parlamenti italian dhe ratifikoi e proklamoi bashkimin e Italisë, nën spektrin e Viktor Emanuelit II. Në jug dhe në zonën ku ishin vendosur arbëreshët, shumë zona u shuan nga malaria. U bënë protesta të njerëzve të thjeshtë, që u braktisën e shumë prej tyre ishin arbëreshë. Edhe në zonën e Lungros dhe të Aquaformozës u krijuan vatra brigantizmi; njëri prej drejtuesve të tyre ishte Llaxarmani, që nuk pati një jetë të lehtë. Qeveria formoi 60 batalione, të cilat zhvilluan një luftë të vërtetë e brenda një viti vranë më shumë se 2500 veta dhe pushkatuan më tepër se 100 000. Kështu përfundoi epoka e *Risorgimento*-s, e cila në jug nuk ishte gjë tjetër, veçse një pushtim ushtarak. Ata u rebeluan masivisht dhe revolta e tyre u quajt si lëvizje banditësh. Një luftë e vërtetë civile e shtypur në gjak. Fshatarët gjithashtu humbën shpresën dhe u nisën jashtë shtetit në eksodin e parë të madh që ndodhi në dy dekadat e fundit të shekullit XIX.

Kisha e Shën Adrianos – arti, historia dhe besimi

Kisha e Shën Adrianos të Shën Mitrit (me komunitet arbëresh në krahinën e Kozencës) është një kryevepër e artit të shek. XI e XII. Për të kuptuar kishën e Shën Adrianos, është e rëndësishme të informohemi që këto toka, qysh në shek. VII, ishin të banuara nga bazilianët, të cilët, për t'i shpëtuar persekutimit, u detyruan të largoheshin e të fshiheshin në vende të vetmuara, si: shpella, guva, vende të papopulluara. Shumë u vendosën në Italinë jugore. Kjo kishë u themelua nga *San Nilo*, njëri prej murgjve bazilianë të ardhur nga Bizanti.

Shpella e Engjëllit

Zgavra që hapet në murin shkëmbor të Timpa Simaras në territorin e Orsomarsos është përmendur nga disa studiues si guva, ku jetonte i riu *San Nilo* kur shoqëronte mjeshttrin, abatin San Fantino, i cili banonte në një manastir aty pranë. *Hypogeu*, i mbrojtur pjesërisht nga një muraturë artificiale, ka një gur të madh brenda që ndoshta ka shërbyer si një tryezë ose shtrat. Në muret, e ngelura gjenden afreske, që përfaqësonin aktin e “Shpalljes” dhe “Kryqëzimit”.

Këtu lulëzoi një shkollë kaligrafie e transkriptimeve të teksteve të shenjta. Në 2015-n, me mbikëqyrjen e medievistit të mirënjohur prof. *Pietro de Leo*, dhe nën ekspertizën e njohur menaxheriale të dr. *Maria Francesca Solano*, sot mund të konsultoheni me shumë materiale të inventarit, letra nga Jeronim de Rada, katër pjata paleografike në greqisht, trashëgiminë arkivore të jetës brenda dhe jashtë kolegjit, si dhe pjesë të historisë së vendit.

Nga përmbajtja e diplomave të Frederikut II dhe nga njoftimet, edhe pse fragmentare, që gjenden në aktet e audiencës, është e qartë se manastiri kishte formuar pjesën më të madhe të trashëgimisë së tij feudale dhe kishte marrë privilegjet e përjashtimit e të imunitetit në epokën e normandëve. Vëllimet e mbledhura në bibliotekën e Kolegjit dhe të identifikueshme nga marka “*S. Adriano*”, përbëjnë, sipas prof. Cava, një dëshmi të padyshimtë dhe një tregues të interesave kulturore të vazhdueshme në bashkësinë e manastirit.

Nga kolegji i vjetër, janë regjistruar 4600 vëllime, të disponueshme midis *Fondit të Lashtë* dhe *Fondit Modern*, e, për çudi, midis tyre, një libër i gjeografisë astronomike të vitit 1400. Në vëllimet e mbijetuara ka vepra klasike latine greke, të filozofisë antike dhe të krishterë, për moralin dhe dogmat, të teologjisë dhe liturgjisë, përfshirë edhe disa botime me vlerë nga vitet 1500. Fatkeqësisht, biblioteka nuk ka kode të transmetuara nga murgjit kaligrafistë të *San Nilo-s*.

Jo larg nga kisha e Shën Adrianos, në Shën Mitër, në një pllajë ngjitur me Malin e Shenjtë (*Monte Santo*), ka një monolit me një kryq të ngjitur, fiksuar në një grumbull rrethor të disa gurëve, që i shërbenin të Shenjtit e dishepujve të tij për t'u ulur. Atje, çdo 26 gusht, përurohet festa e shenjtoreve Adrian e Natalia dhe mbahet një procesion.

Dera e djathtë e kishës së Shën Adrianos është e zbukuruar me dy maska, të cilat lëshojnë rrënjë bimësh nga goja e tyre. Zbukurimi me to përfaqëson themelet, stoicizmin, mbjelljen e diturisë nëpërmjet komunikimit. Stili duket arkaik, por relievi është i saktë dhe në thjeshtësinë e disenjimit.

Të futesh në këtë kishë, do të thotë të zhytesh në *esichia* (heshtja e shpirtit) të atyre që e vendosin veten në praninë hyjnore, përqendruar me besimin e ekzistencës dhe harmoninë e tyre midis *Immanent-es* dhe *Transcendent-es*, një hierofani e vërtetë...⁷⁰

Në kishin e Shën Adrianos ndodhen mozaikë të realizuar në shekullin XII. Ka kodifikim të mozaikëve, ku misticizmi dhe fantazia, monstruoza dhe bukuria krijojnë një art të mrekullueshëm. Përmendim mozaikun ku paraqitet një gjarpër në numrin 8,⁷¹ apo gjarpri me tri⁷² nyje.

Ndër relievet e çrregullta të ruajtura në kishë, interesante është

⁷⁰ (Shënim: *Ichthysi*, në formën e peshkut është simbol i Jezu Krishti) - *Hesychia* (lutja me zemër).

⁷¹ Në numerologji, numri 8 përfaqëson përjetësinë.

⁷² Numri 3 përfaqëson tri stilet e jetës e rregullat baziliane, për të arritur perfeksionin: puna me dorë/manuale (trupi), lutja (fryma) dhe studimi i Shkrimit të Shenjtë (mendja).

edhe skulptura që përshkruan një dorë që del nga goja e një gjarpri që mban një zinxhir unazash. Një dragua, një dorë që del nga goja dhe kap rrathët “*ichtys*”, dymbëdhjetë petale të lules së Jerikos.⁷³

Rrathët Trinitarë afër trëndafilut 12-petalësh,⁷⁴ *Ichtys* i doktrinës së *Gioacchino da Fiore*, formimi i gjashtë ditëve të Zanafillës, Lulja e Jetës. Në mesjetën e krishterë, rrethi quhej vendi i pajtimit midis parajsës dhe tokës, midis Zotit e njeriut dhe njeriut e Zotit, Frymës dhe Përjetësisë.

Në dy anët e altarit kryesor të kishës, i cili daton në vitin 1731, janë dy kamare, ku janë vendosur dy buste prej druri të viteve 1600, që përshkruajnë Shën Adrianon dhe Shën Natalinë. Në altarin në të majtë është përshkruar Shën Maria me *San Nilo*-n dhe *San Vito*-n, ndërsa në të djathtë është përshkruar Shën Vasili. Altari kryesor i atribuohet *Domenico Costa*-s, ndërsa piktura e martirit Shën Adriano ndoshta është punuar nga piktori *Francesco Saverio Ricci*. Muret e manastirit mbajnë psherëtimën arbëreshe edhe të piktorit *Franco Azzinari*, i cili e bëri “të dukshme” padukshmërinë e simboleve shpirtërore.

Libri antik i recetave (1788), i cili i përkiste kolegjit italo-grek “*Corsini*”, ka 22 faqe në formatin 19 x 26 cm, të dekoruara me filigram e që përmbajnë rreth 40 receta, të mbledhura në krahinën e *Calabria Citra*-s nga frati Reverend, At *Vincenzo Maria Gallucci* i rendit të predikuesve, lektor në seminarin “*Korsini*” në territorin e *San Benedetto Ullano* (1750). Vetëm disa hapa larg Shën Adrianos ndodhet parku antik i murgjve, ku dikur murgjit ndalonin me fretërit e tyre dhe bënin lutjen e mbrëmjes. Aty ndodhet një pemë bliri, të cilën legjenda popullore e njuh ndryshe si “elmi i Shën Nilit”. Pema e elmit⁷⁵ (*olmo*), “bukuroshja” e Shën Nilit, mishëron historinë dhe peripecitë, gëzimet, shpresat, ëndrrat e të gjithë atyre nxënësve, mësuesve, edukatorëve të formuar në kolegjin e Shën Adrianos, si

⁷³ Dragoi, në përgjithësi, është simbol i së keqes dhe i tundimit për të urreyer; dora përfaqëson njeriun, i cili e lë veten të udhëhiqet nga instinktet e ulëta dhe është gati të zhduket me bishën e çuditshme por, ndërkohë, ka unazat e lidhura të besimit që e mbështesin atë, përmes simbolit të Krishtit.

⁷⁴ Numri 12 në numerologji: 12 dishepuj, 12 muajt e vitit.

⁷⁵ Një erë e fuqishme e theu pemën, në shkurt të vitit 1961.

dhe një plejadë akademikësh e një armatë revolucionarësh në histori dhe ide, demokratike dhe liberale.

Ata që punuan dhe udhëhoqën Institutin kanë lënë gjurmë të pashlyeshme për historinë e vetë arbëreshëve, si:

- *Felice Samuele Rodota* (1735 – 1740), i cili ishte edhe i pari deputet për arbëreshët gjatë mbretërisë së dy Sicilive;
- *Nicola de Marchis* (7.12.1741 – 1756);
- *Giacinto Archiopoli* (1756 – 1789);
- *Francesco Bugliari* (26.3.1792 – 1806);
- *Domenico Bellusci* (1808 – 1883);
- *Gabriele de Marchis* (23.6.1834 – 18.4.1858);
- *Agostino Franco* (15.6.1858 – 1875);
- *Giuseppe Bugliari* (3.8.1882 – 1885);
- *Giuseppe Schirò* (Zef Skiroi) (30.7.1889 – 1896);
- *Guseppe Barcia* (24.4.1902 – 1912).

Kontribut të veçantë kanë dhënë edhe studentët e këtij koleji, të cilët punuan në dobi të identitetit arbëror e të gjuhës shqipe, për të cilat, edhe sot, vetë populli arbëror i mbron me këmbëngulje.

Këta njerëz janë të mëdhenj për misionin e tyre kaq fisnik, edukimin e identitetit, por janë harruar nga koha e janë braktisur nga politika. Vetëm kur ke një identitet, atëherë njihesh e ke një vend të duhur në hapësirën ku jeton.

Dëshmi e detajuar e kësaj përpjekjeje për ruajtjen e identitetit janë edhe vargjet e kantautorit arbëresh bashkëkohor *Pino Cacoza* (Zef Kakoca):

*“Ne jemi ata c’è fjasën me zemrën në dora,
Jemi dielli ndë verë, ndë dimër jemi bora,
Ne jemi 500 vjet storia e kallo ndër duar.
Merrini për dora se jemi vëllezëra e motra
Jemi kultura ç’e ngè mend vdes⁷⁶.”*

⁷⁶ Kuptimi “që nuk mund të vdesë”.

Gjithashtu, në Shën Mitër zhvillohet çdo vit në të shtunën e dytë të gushtit “Festivali i Këngës Arbëreshe”, i cili mbledh së bashku prurjet muzikore në zhvillim të italo-shqiptarëve.

Figura të shquara, studentë të kolegjit të Shën Adrianos

Giuseppe Pace lindi në *Castrovillari*, në vitin 1824, në një familje fisnike. Babai i tij ishte *Muzio Pace* dhe nëna e tij ishte dukeshë *Maria Baratta*. Në vitet e komplotit e të luftës dhe për shëlbimin e atdheut dhanë krahun, zgjuarsinë dhe pasuritë e saj. Kështu e ilustroi duka *Sigismondo* i *Castromediano*-s në kujtimet e tij “... me një fytyrë të këndshme, të sjelljeve të zgjedhura, të studimeve të gjera, ai kishte një zë të ëmbël e bindës, një natyrë të butë, një zemër bujare dhe të guximshme”.

Pace filloi studimet e tij klasike në kolegjin italo-shqiptar të Shën Adrianos, ku kishte shokë studentë, si: *Domenico Damis* e *Vincenzo Stratigò*. Ai asimiloi në kolegji të gjitha ato elemente kulturore të domosdoshme për një trajnim jetësor kushtuar moralit e dashurisë atdhetare. U transferua në Napoli në vitin 1844, ku u diplomua në drejtësi dhe letërsi. Bashkohet me rrymën *Mazzini*. Kur shpërtheu revolucioni, ai u emërua komisioner me kompetenca të plota në rrethin e tij, duke luftuar atë vit me Damisin, Plakon dhe Luçin në *Monte Sant’Angelo*. Pas revolucionit të dështuar, u arratis. I dorëzohet qeverisë, sepse i kishin arrestuar nënën e tij. *Giuseppe* qëndroi në burg për një kohë më të gjatë se shokët e tij *Settembrini*, *Poerio*, *Damis*, *Spaventa*, *Plaku Lamenza*. Pasi del nga burgu, më 1855-n, akuzohet përsëri se kishte letërkëmbim me Komitetin Revolucionar të Napolit.

Arrighi shkruan kështu për *Giuseppe Pace*-n: “Ai u dërgua në Napoli i lidhur këmbë e duar me zinxhirë dhe e bënë të shëtiste dy herë përgjatë Toledos, pastaj u torturua në birucat e *Santa Maria*-s, duke i dhënë vetëm ujë të zier dhe ushqime të prishura dhe duke e mbajtur në një vend të lagur e pa ajër”. Pasi u konsiderua nga policia “element shumë i rrezikshëm”, Ferdinandi II mori vendim të prerë, duke e konsideruar *Pace*-n si element “jashtëzakonisht të rrezikshëm”, përfshirë edhe shokun e tij të pandashëm *Domenico*

Damis. Ai dha urdhër për ta internuar në Argjentinë, por *Pace* u transferua fillimisht në Bristol e më pas në Londër, nga ku u kthye më pas në Itali (për disa kohë në Torino).

Më 1860-n zbriti në Sicili me *Damisin*, ku luftuan si trima e heronj në *Volturmo*. Pas unitetit të plotë, refuzoi çdo gradë ushtarake, duke pranuar vetëm mandatin politik në Parlament nga elektorati i *Cassano Jonico*-s në zgjedhjet që u zhvilluan në janar 1861.

Më 1866-n, si i dërguar e Ministrisë së Luftës, ai u vendos në Kalabri për të organizuar një organ të vullnetarëve që vrapuan për çlirimin e Venecias. Vdiq në moshën 42-vjeçare.

Raffaele De Cesare, shkruan: “*Giuseppe Pace* është një nga figurat më të shkëlqyera të periudhës së *Risorgimento*-s kombëtare dhe emri i tij do të jetojë, pavarësisht harresës së bashkëqytetarëve të tij”.

Xhuzepë Garibaldi (*Giuseppe Garibaldi*) ishte mysafir në shtëpinë e familjes *Pace*, e cila pagoi një çmim të lartë për epokën *Risorgimento*, duke marrë pjesë aktive në ngjarjet e kohës. *Muzio Pace*, babai i *Giuseppe Pace*-s, ishte anëtar i parlamentit të 1848-s dhe president i Komitetit të Parë të Shëndetit Publik të *Castrovillari*-t; ai u arrestua në Napoli, më 23.6.1848. U përpoq për komplot dhe u la i lirë në 7.10.1852, duke mbetur gjithnjë nën mbikëqyrjen e policisë. Ai kryesoi qeverinë kryengritëse të 1860-s dhe u emërua guvernator i rrethit të *Castrovillari*-t nga *Giuseppe Garibaldi*. Gruaja e tij *Maria Baratta* u dërgua në burg midis dy rreshtave të xhandarëve dhe u mbajt në paraburgim për katër muaj. Sipas *Arrighi*-t, vajza më e madhe *Antonietta*, shtatzënë, vdiq nga pasojat e një aborti të shkaktuar nga pamja e nënës së burgosur. Duka *Sigismondo* nga *Castromediano*, në “Memoirs” të tij, shkruan: “Me një fytyrë të këndshme, me sjellje të zgjedhura, me studime të bollshme, ai kishte një zë të ëmbël dhe bindës, natyrë e butë, zemërgjerë dhe e guximshme”.

Pas kthimit në Itali u regjistrua me Piemonte dhe me gradën toger u bashkua me ndarjen e gjeneralit *Cosenz*. Pas amnistisë së dhënë nga Francesco II, ai u kthye në *Castrovillari*. Pas lajmit se *Giuseppe Garibaldi* kishte zbritur në kontinent, *Castrovillari* u ngrit. Ndërsa

Muzio Pace e vendosi veten në krye të qeverisë kryengritëse, djali i tij, *Giuseppe Pace*, pasi çarmatosi xhandarmërinë, organizoi regjimentin që kishte nderin të luftonte me Garibaldin. Regjimenti përbëhej nga 1159 burra të ndarë në 12 skuadra, të mirëmbajtura me 11 530 dukatë të mbledhur në rreth. Në krye u emëruan *Giuseppe Pace* (me gradën kolonel) nga grupi i *Castrovillarese-s*, vëllai i tij *Eduardo* (me gradën kapiten), *Vincenzo Miglio* dhe togerët *Raffaele Bellizzi* etj. Bënin pjesë dhe kirurgët *Tommaso Cassanese* dhe *Salvatore Varcasia*. Regjimenti mori urdhrin të marshonte drejt Soverias, kundër gjeneralit *Ghio*, por, kur arriti në Kozencë, ai mësoi dorëzimin e tij, prandaj ata prisnin ardhjen e Garibaldit, që hyri në *Castrovillari* në mbrëmjen e 31 gushtit. Garibaldi ishte mysafir i shtëpisë *Pace*. Regjimenti *Pace* kontribuoi shumë në fitoren në *Volturno*, më 1 e 2 tetor 1860, duke merituar duartrokitjet e gjeneralit. Regjimenti i lavdishëm u dallua gjithashtu afër *Capua-s*. Pasi u arrit qëllimi, ushtria jugore u shpërbë, vetëm regjimenti i *Giuseppe-s*, me dekret të Viktor Emanuelit, kishte privilegjin të kthehej në shtëpi me armë dhe bagazhe. Në vitin 1861, ai ishte deputet në parlamentin e parë italian. Në maj 1867, duke u kthyer nga *Firence* (atëherë, kryeqytet në *Castrovillari*), ai vdiq afër *Ebolit* dhe eshtrat iu vendosën në kishën e *SS. Trinità*.

Kapitulli IV: Ngulimet Arbëreshe në Kalabri

4.1. NGULIMET NË RAJONIN E KOZENCËS

4.1.2. *San Demetrio Corone (Shën Mitri)*

Fshatrat arbëreshe karakterizohen nga shtëpizat e ulëta prej guri, rrugicat, gjitonia, ballkonet, shkallët dhe burimet-shatërvanë, që të kujtojnë krojet, ku derdhet uji i pastër si zemra bujare e arbëreshit.



Rruga për në Shën Mitër ka shumë kthesa dhe në hyrje të tij bien në sy shtëpitë me çatitë e kuqe në hapësirën qiellore. Qyteza është konsideruar si “kryeqyteti i kulturës arbëreshe”. Rrugicat me ullinj, mana dhe gështenja, prej së largu, duken si rrudha dhe të japin idenë e fustaneve me pala të kostumit arbëresh.

Territori i Shën Mitrit shtrihet përgjatë kodrave të *Sila Greca-s*, me një hapësirë rreth 7500 hektarë, dhe përshkohet nga përrrenjtë *Galatrella*, *Mizofato* dhe *Muzzolito*, ku degët e lumit Krat (*Crat*) krijojnë skenën e tyre si dy krahë.

Në një lartësi ku shikimi bie pingul me fshatin (me toka pjellore, ku jeta gjallonte nga dora e arbëreshit), bie në sy skenografia me ngjyra të gjelbra dhe blu në një relief të thyer, të rrahur nga emigracioni, malaria, latifondistët, hakmarrja, nga vuajtjet, por edhe të ekzaltuar nga puna dhe mendja e ndritur arbëreshe, njerëz të penës e të pushkës, të iluminizmit, të humanizmit, por edhe revolucionar të thjeshtë arbëreshë, të cilët, me ndërgjegjen e tyre arbërore, ndritën aureolën e identitetit e të krenarisë së shpirtit arbëror.

Historiku

Emërtimi i kësaj qyteze është i lashtë dhe mendohet të jetë themeluar nga murgjit orientalë gjatë rrjedhave migratore në shek. VII e deri në shek. XIV. Emri është vënë në kujtim të shenjtorit të Selanikut, Shën Mitri (*San Dimetrio*) në shekullin X nga *San Nilo di Rossano*.

Shën Mitri u popullua nga arbëreshët në vitin 1471. Arbëreshët e parë që u vendosën atje vinin nga Morea, Peleponezi, të cilët lanë qytetin e tyre, për shkak të pushtimit turk, duke e kthyer Shën Mitrin në një qendër të rëndësishme kulturore për të gjithë arbëreshët.

Dëshminë për faktin se vendi ekzistonte para ardhjes së arbëreshëve e marrim kur më 3 nëntor të vitit 1471, abati arkimandrit *Paolo Greco* shkoi te noteri *De Angelis* për të hartuar një akt, i cili regjistroi zotimin për të mirëpritur refugjatët shqiptarë në fshatin Shën Mitër, me të drejtën e kultivimit të tokës. Në vitin 1524, popullsia arbërore që erdhi ishte nga Korona dhe nga

Morea (Peleponezi) dhe fliste shqip e jo greqisht, prandaj dhe emri “*Corone*” iu shtua vetëm në vitin 1863.

Urbanistika

Qendrat më të hershme ishin *Murmurica* dhe *Marzile*. Në vitet në vazhdim u ngritën fshatra dhe rrethe të panumërta, ndër të cilat, përveç atyre të *Sofferetti-t*, *Curisa-s*, *Calamia-s*, *S. Agat-it*, *S. Nicola-s*, *Mezzofato-s*, *Corvino-s*, *Poggio-s*, *Piedigallo-s*, *Mattarise-s*, *Macchia Albanese-s*. Në qendrën historike u përqendrua jeta e komunitetit të mbyllur nga muret e fortifikimit të bëra me gurë, brenda së cilës ka rrugica që të çojnë në gjitoni, struktura arkitekturore tipike shqiptare, midis tyre dallohet lagjja “*Martial*”, sheshi “*Monumenti*”, Pallati i Drejtësisë, rruga “*Termopili*”, rruga “*Dante Aligeri*”, pallati “*Mauro*” dhe pallati “*Mazziotti*”.

Kisha e Shën Onufrit (Sant Onofrio)

Kisha e Shën Onufrit gjendet në rrugën “*V. Domenico Mauro*”, 99. Ajo u ndërtua në vitin 1737 nga *Reverend D. Francesco Antonio Lopes* (1686-1747), që i përkiste familjes më të pasur e të ndritur të vendit dhe ishte prifti i parë latin, që shërbente në kishë. Kisha u hap për besimtarët përgjatë shekullit të tetëmbëdhjetë dhe përbën një pikë nevralgjike adhurimi për banorët e komunitetit. Në qendrën e vogël arbëreshe, ku sot është zyrtarizuar riti grek, krijimi i kishës së Shën Onufrit lejoi integrimin midis dy popujve (ai që vjen nga jashtë me atë indigjen), duke siguruar komunitetin e ritit grek, mirëmbajtjen e praktikave të tyre fetare. Kisha, kushtuar Shën Onufrit, ruan ende pjesën më të madhe të tipareve të saj origjinale, shembull i shkëlqyer i artit barok në Kalabri. Në pamjen e jashtme kisha duket modeste, e vendosur në njërën nga anët e shkurtra nga aksesi i vetëm në tempull. Porta litike e realizuar me një mjeshtëri të shkëlqyer është e harkuar në qendër e ka një mbishkrim (sot, disi i venitur), i cili mban datën dhe emrin e themeluesit të “tempullit”. Kisha është ende në pronësi të familjes Mauro, e cila mban në njërën nga dhomat e pallatit portretin e shenjtit titullar, të vendosur dikur në altarin kryesor të vetë kishës. Kisha tani është e mbyllur

për publikun, pasi ajo ka nevojë për ndërhyrje serioze nga ana e autoriteteve kompetente.

Në sheshin kryesor të qytetës, në krah të majtë të kishës, është ngritur monumenti i të rënëve: një përmendore në gurë, ku është vendosur pllaka përkujtimore. Në krye të lapidarit është një skulpturë mermeri e vitit 1928, që përshkruan një ushtar të pajetë, të shtrirë mbi një shkëmb dhe të mbështetur nga alegoria e figurës së fitores me flatra, i cili përkulet për të puthur kokën. Rrëzë ushtarit ka një përkrenare, pushkë, degë dafine dhe lisi.

Kali i Shën Mitrit

Më 26 tetor është dita e shenjtorit të kësaj qyteze, Shën Mitrit. Gjatë kësaj feste ndërtohet edhe “Kali i Shën Mitrit”, me shkopinj kallamishte, mbuluar me letër me ngjyra, i cili shoqërohej prej dy burrave, duke e shëtitur nëpër rrugët e qytetit e duke vizituar shtëpi dhe dyqane.

Familja fisnike Lopes e Shën Mitrit

Familja Lopes është një familje fisnike arbëreshe, që u vendos në Shën Mitër në shekullin e XV, për shkak të pushtimit turk. Faktet përqafojnë pesë shekuj të historisë së kësaj familjeje e deri në vitet <70 të shekullit XX, kur vdiq pinjulli i saj i fundit. Pallati “Mauro” iu kalua trashëgimtarëve të familjes Lopes e tani është vendi i qendrës së studimit “*Risorgimentali Domenico Mauro*”.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu

Në rrugën drejt sheshit të kishës, brenda *Villa Marchianò*-s (pronë e komunës – sot, vendi i nismave kulturore) ndodhet monumenti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Ai është pjesë e harmonisë arkitekturore “unike agora”, me projektin e përgjithshëm për ringjalljen e zonës përreth kishës. Në shëtitorën “Gjergj Kastrioti” janë vendosur dy rrënjë peme me emrin *maclura pomifera*⁷⁷.

⁷⁷ Nuk është një bimë e zakonshme, sepse është e rrallë, nëse nuk zhduket plotësisht. Në Shën Mitër gjenden vetëm dy të tilla në bulevardin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”.

Riti i përjetësisë

Në vendet arbëreshe, të vdekurit nuk përkujtohen në fillim të nëntorit, siç ndodh në traditën katolike, por në fillim të pranverës, midis fundit të shkurtit e fillimit të marsit. Përkujtimi i të vdekurve nga arbëreshët paraqet karakteristikat e një feste popullore, gjatë së cilës të ndjerët futen mes të gjallëve: besohet se Jezu Krishti u jep leje shpirtave që të dalin nga nëntoka dhe të kthehen në tokë për të gjetur vendet e tyre.

Në procesionin që zhvillohet në *San Demetrio Corone* është jashtëzakonisht gjendje sugjestionuese: pas procesionit në varreza, të afërmit shkojnë në varrin e të dashurve të tyre për të konsumuar ushqim e pije dhe kushdo që kalon aty pranë është i ftuar të marrë pjesë në banket. Kjo traditë i ka rrënjët në përdorimet antike. Rolin simbolik të lehtësimit në festimet për nder të të ndjerit e luajnë edhe të ashtuquajturat *kolivi*, që janë feta buke me grurë të zier në krye. Në mbrëmje miqtë dhe të afërmit takohen dhe hanë darkë duke kujtuar, deri vonë natën, të dashurit e tyre dhe një nga vendet në tryezë lihet e lirë sepse “rezervohet” për të vdekurit. Në këtë mënyrë, rinovohet një traditë e lashtë, e cila lidhet me banketet e kishës primitive dhe me zakonet që me shekuj kanë nxjerrë në pah vlerat e solidaritetit dhe miqësisë brenda komunitetit arbëresh. E shtuna e ardhshme është një ditë e trishtimit të thellë, sepse sipas traditës të vdekurit detyrohen të kthehen në jetën e përtejme, duke u shkëputur nga të dashurit.

Karnavalet

Karnavalet e Shën Mitrit e të Sardenjës janë të njëjta dhe unike. Proto-Sardenja Ilire quhet arvareshu, prelatina sardaneze, ose shardana – gjuhë me origjinë pellazgjike (popujt e detit), që flitet në Sardenjë deri në periudhën perandorake bizantine, sipas asaj që dëshmohet nga historiani bizantin *Stefano di Bisanzio*.

Në zonën e qytezave shqiptare përreth Polinit, në Kalabri, ishte zakon takimi në mbrëmje në shoqëri dhe të gëzuar këndonin vjersha para derës së miqve:

“Oji ma sonde ç’ë ki karnivall,
 zgiomi ndrikull e kumbar!
 - Ngreu e çel atë hilnar;
 s’erdha të ha, erdha se jemi kumbar;
 s’erdha se dua të pi, erdha se jemi gjiri!”.

Shën Mitri ka disa degëzime, si: Scifo, Sofferetti, Sant’Agata e Poggio (Pozzo), për të cilat ka dëshmi të dokumentuara në vepra të caktuara, përkatësisht:

- *Scifo: Domenico Zangari* flet për këtë fraksion në librin e tij “Kolonitë italiano-shqiptare të Kalabrisë - Histori dhe demografi”, duke thënë se kishte 111 banorë shqiptarë në vitin 1543.
- *Sofferetti*: Ashtu si dhe Shën Mitri, *Sofferetti* u themelua në vitin 1471 nga pasuesit shqiptarë të dukës *Teodoro Lopes*. Në vitin 1534 mbërritën shqiptarët nga qyteti i Koronës (*Corone*). Vendasit ende flasin gjuhën e origjinës. Ai gjithashtu ruajti ritin bizantin e të gjitha traditat fetare të lidhura me të. Ndërtesa fetare, ku zhvillohet riti bizantin, është kisha famullitare e *San Michele Arcangelo-s*.
- *Sant’Agata* ka banorë pothuajse tërësisht nga familje nga *Macchia* dhe Shën Mitri, të cilët, në vitet ‘50 kishin tokat (një hektar tokë + shtëpia, stalla dhe kafshë) gjatë reformës agrare. Në disa dhoma, të përdorura tani si depo, ekziston ende pllaka me numrin e fermës. Sant’Agata kujtohet edhe për ngjarjen e gushtit 1806, kur brigandët proburbon u mblodhën në fshatin e afërt të për të marshuar kundër Shën Mitrit dhe Shën Sofies. Në këto kodra ata u mposhtën nga Ferriolo, i cili i mbajti të burgosur. Të çliruar nga një tradhtar, brigandët, vranë peshkopin *Bugliari*, pastaj në *Acri* ata vranë vëllain e peshkopit Ferriolo dhe shumë të tjerë vendës (në mesin e të cilëve ishin edhe shumë arbëreshë), në mënyrë mizore. Brigandët dogjën kufomat dhe ngjyen bukën në dhjamin që rridhte nga kufomat.
- *Poggio (Pozzo): Domenico Zangari* flet për këtë vend në librin

e tij “Kolonitë italiane shqiptare të Kalabrisë - Histori dhe demografi”, duke thënë se në vitin 1543 kishte 33 banorë arbëreshë.

Figura të shquara të Shën Mitrit

Domenico Mauro (1812-1873) është një nga figurat më të shquara në botën arbëreshe. G. Romeo Pavone⁷⁸ shprehet kështu për *Domenico Mauro*-n: “Një njeri me zgjuarsiri të thellë dhe doktrinë shumë të pasur, ai i përkiste familjes së lashtë dhe fisnike, i cili me pushkën dhe me penën e artë shkëlqeu dhe nderoi tokën e tij të dashur të Arbërisë”.

I ati i tij quhej *Angelo Maria* dhe nëna *Carolina Lopes*. Studimet e tij të para i bëri në kolegjin italo-grek të Shën Adrianos, ku studioi në vitet 1820-1831, duke demonstruar një aftësi të mirë për studime klasike, letërsi dhe filozofi. Në vitin 1832 shkoi në Napoli për të ndjekur kurset e jurisprudencës e të thellonte privatisht studimet letrare. Mauro ishte edhe deputet në asamblenë e parë konstituente të Napolit dhe në legjislaturën X të “*Italia Unita*”-s. Figura e tij ishte një pikë referimi politike dhe kulturore e arbëreshëve. Mauro shkroi poemthat: “*Errico*”, “*Concetto e forma nella Divina Comedia*”, “*Vittorio Emanuele e Mazzini*”.

Kontakti i tij i parë në debatin politik të fillimit të dyzetave kaloi përmes një njohjeje të plotë të veprës së Dantes, botuar në Napoli, në vitin 1840, një referat për Ferrin, i cili e radhiti atë “më interesantin dantist kalabrez të epokës romantike”.

Mauro u vlerësua nga bashkëkohësit, si *F. de Sanctis*, por edhe nga Viktor Hygoja. Kritika e tij u shtri në publik me titullin “Koncepte e forma të Komedisë Hyjnore” (Napoli, 1862). Është e vështirë të analizosh qëndrimin e Mauros, por *De Sanctis* i bëri një nderim kujtesës së tij: “Ai ishte një njeri i thjeshtë, i cili kurrë nuk foli për veten e tij. Ai vlerësoi të gjitha veprimet që bota i quan heroike, pothuajse sikur të mos dinte ose nuk mund të bënte

⁷⁸ G. Romeo Pavone, “*Gioacchino Gaudio dhe trazirat e fundit në Calabria Citra*”.

ndryshe. Ai kurrë nuk kishte besuar se kryerja e detyrës së tij ishte një shkallë shpërblimesh”.⁷⁹

Mauro mori pjesë aktive në lëvizjen revolucionare dhe ka luftuar shumë në betejën *Campotenesse*. Në atë kryengritje të shkurtër, vëllai i tij *Vincenzo* u gjymtua. Pas këtij dështimi u strehua në Greqi, pastaj u kthye në Itali. Më vonë u vendos në Xhenova dhe pastaj në Torino, duke jetuar në varfëri me dinjitet.

Në Torino, në vitin 1852, vepra “*Vittorio Emmanuele e Mazzini*”, përbën testamentin tij etiko-politik e shoqëror: një shumicë e intelektualëve borgjezë dhe një pakicë artizanësh. Viktor Hygoja i shkroi Domenico Mauros, më 15 qershor 1865: “Jam shumë i ndjeshëm, zotëri, për dërgimin e veprës suaj të shquar. Ju keni studiuar më shumë se sa kushdo këtë temë të shkëlqyer. Ju e keni thelluar atë. Është i lumtur Dante që të ketë një komentues si ju. Viktor Hygo”. Kujtojmë se Mauro ka pasur letërkëmbim jo vetëm me Hygonë, por me shumë përfaqësues të kulturës së kohës, siç tregohet nga letra e *Giuseppe Giacomelli*-t.⁸⁰ Mauro ishte gazetar i shkëlqyer. Më 1840-ën ai themeloi gazetën “*Il viaggiatore*”, organ kulturor e politik, për të pasur sa më shumë ndjekës në kauzën revolucionare. Mauro vdiq në Firenze, më 17 janar të vitit 1873.

Domenico Antonio Cassiano është eseist dhe studiues i historisë; ka kontribuar përmes eseve, hulumtimeve dhe konferencave në Itali, e jashtë saj, për njohjen e shumë aspekteve të fshehura, ose të fshira të Kalabrisë. *Cassiano*-ja është autor i librave që u përgjigjen motivimeve të forta shoqërore e morale. Ai botoi “Risorgimento në Kalabri – figurat e mendimet e protagonistëve italo-shqiptarë”, “Attanasio Dramis – Demokracia dhe socializmi në komunitetin Kalabri-Shqiptar”, “Cesare Marini (1792-1865) – Kultura dhe politika në jug”, “Intelektualë dhe politikanë nga Kalabria dhe Risorgimento”, “Domenico Mauro (1812-1873) – Letërsia dhe revolucioni”, “Fashizmi dhe antifashizmi në Calabria Albanese” etj.

⁷⁹ *De Sanctis*, 1953, f. 98.

⁸⁰ Burimet dhe bibliografia: G. Cingari, Romantizmi dhe demokracia në jug: D. M. (1812-1873), Napoli 1965 (botimi i ri, Lungro e Kozencës, 2001).

Demetrio De Grazia lindi më 28 shtator të vitit 1850 në Shën Mitër. Ai ndoqi liceun e Shën Mitrit e studioi Danten, Virgjilin, Homerin, Tasso-n, oratorinë greke dhe ishte i pasionuar për Demostenin. Ky intelektual duhet të kujtohet për botën arbëreshe, sepse njohu më së miri studimet e studiuesve më të mëdhenj, që u morën me prejardhjen e gjuhës shqipe. Demetrio u njoh me studimet e Gustav Majerit (Gustav Mayer), i cili deklaroi se gjuha shqipe e ka prejardhjen nga gjuha ilire. U njoh me studimet e *Matt-Brundhe Mezzafanti*-t, të cilët arritën në konkluzionin se gjuha shqipe është një gjuhë pellazgjike. Ai studioi Borè-në, Bopp-in dhe Armenin *Masdoty*. Ai lexoi “Dizionarin Epirota-latino”, të Frang Bardhit, lexoi “Gramatikën shqiptare” të De Radës, Varibobën e Seremben për thellësinë dhe kuptimin e vargjeve.

Demetrio De Grazia, në studimet e tij arriti në konkluzionin se gjuha shqipe është nëna e të gjitha gjuhëve indoeuropiane.

Arbëreshi intelektual *Demetrio De Grazia* studioi mbiemrat dhe arriti në konkluzion se nga cila pjesë e Arbërisë vinin ata. Ky arbëresh, në komunitetin Kaldei (*Caldei*) verifikoi që, në ditën e pestë të javës, ditën e premte, nuk martoheshin dhe në muajin e pestë të vitit, muaji maj, nuk lidheshin kontrata. Ky intelektual ka përshkruar gjithmonë që populli shqiptar është një popull i fortë, që respekton pleqtë, gratë dhe është krenar e hakmarrës.

Lidhur me “valljen” e arbëreshëve, të martën pas Pashkëve, Demetrio e përngjashmoi atë me rumeiken.⁸¹

De Grazia ishte 10 vjeç kur De Rada publikoi “Rapsodi të poemës shqiptare” dhe ai me siguri që është rritur me leximin e tij, sepse në vitin 1889 publikoi “*Canti popolari albanesi tradizionali nel mezzogiorno d’Italia, riordinati, tradotti, e illustrati*”, shtypur në rreth 500 kopje. Në këtë vepër, *Demetri de Grazia*, rrëfen historinë e Shqipërisë nga kohët me të lashta, duke nxjerrë në pah popullin arbëresh, zakonet, ritin, shpirtin, dinjitetin, krenarinë mikpritjen, sakrificën e deri dhe pranimin e vdekjes për të mos tradhtuar atdheun.

⁸¹ Valle e vashëzave të Peleponezit në Greqi, apo të rritit të “Vllamjes”, ku hidhej një pikë gjaku në gotë, pihej midis tyre dhe kështu transformohej miqësia në vëllazëri.

Një kopje të kësaj vepre ia dhuroi edhe Boselli-t, i cili mbështet idenë se populli shqiptar është një popull me virtyte dhe heroik.

Demetrio de Grazia i përgjigjet kështu kritikës: “Kam dashur t’i jap një imazh të qartë popullit shqiptar, këtij populli të harruar plotësisht nga literatura dhe diplomacia. Nuk di nëse ia kam dalë mbanë. Do vijë një ditë që fatkeqësisht gjuha shqipe nuk do studiohet në krahinat arbëreshe, sepse jemi të izoluar e kemi ngelur vetëm, por jam i kënaqur për punën që kam bërë, sepse të paktën tërhoqa vëmendjen e studiuesve dhe të kritikës për këtë popull të denjë”. *De Grazia* duket sikur e profetizoi situatën, në të cilën ndodhen arbëreshët sot.

Cesaro Marini (1792-1865) ishte një intelektual arbëresh nga Shën Mitri. Ai studioi jurisprudencë në Kozencë dhe ishte autor tekstesh mbi të drejtën romake, por ishte njëherësh edhe politikan (deputet në kuvend), i cili nuk ishte indiferent ndaj çështjes arbëreshe.

Salvadore Barile (1872-1960) ishte poet lirik e satirik. Ai ishte interpretues i poetikës popullore arbëreshe, por satira ishte zhanri që ai pëlqente më shumë dhe ishte i pari satirist arbëresh, që përdori këtë mjetet e satirës edhe në luftën e përditshme politike. Veprat e tij “*Fra un telegramma e l'altra*”, “*Versi Giovanili*”, “*Satire ed epigrammi*” dhe vjersha të tjera ishin në dialektin e kolonive shqiptare të Kalabrisë.

Ai lëvroi edhe poezinë erotike, siç është dhe kjo poezi e pabotuar e Salvatore Barile:

*U pamë,
u rujtim,
u puthëtim,
u shtrënguem,
u picpidhuam,
u lam!”.*

Alessandro Marini (1733-1796) ishte arbëreshi që iu kushtua studimeve kishtarë dhe ishte shumë i ri kur publikoi vëllimin “*Catechismo Isagogico*”. Për një kontrast që kishte me *Curian*, pas vdekjes së xhaxhait të tij *Luca Marini*, mohoi veshjen e veladonit fetar e iu dedikua botimeve të tilla, si: “*Il sistema teopolitico sopra l’economia della grazia con libero arbitrio*”. Ishte reformist dhe republikan.

Michele Marchianò (1860-1921) u diplomua në Universitetin e Napolit. Gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore u bë profesor në Universitetin Oriental të Napolit, ku jepte lëndën e gjuhës shqipe. Marchianò e zhvilloi aktivitetin e tij si mësues i letërsisë klasike në *Paola*, *Maddaloni*, e pastaj në *Foggia* deri në fund të jetës së tij. Ai shkroi veprën “*Albania e l’opera e De Rada*”.

Maria Antonia Barile (1894-1917) ishte poeteshë me vargje të brishta e të dhimbshme, për shkak të humbjes së të birit para kohe. Vepra e saj “U bjerr i biri i parë” u botua nga vëllai i saj Salvadori.

Në Shën Mitër ka edhe shumë arbëreshë të tjerë, të cilët kanë lënë gjurmë dhe vlen të përmenden e emra të tillë, si:

- *Achille Marchianò* (1923-1993), hetues.
- *Alighieri Mazziotti* (1949-2001), kirurg me famë ndërkombëtare.
- *Costantino Bellucci*, 1796-1886), poet popullor dhe autor i veprës “*La comediante*”.
- *Dimetrio Strigari* (1816-1896), jo vetëm një avokat i zoti, por edhe një patriot i flaktë.
- *Don Francesco Baffa* (1889-1956) prift arbëresh.
- *Fedele Marchianò*, filozofi i viteve ‘800.
- *Francesco Avati* (1717-1800), humanist dhe profesor i kulturës shqiptare të rrethit Macchia Albanese, mjek personal i mbretit të Napolit.
- *Giuseppe Cadicamo* (‘800) autor i “*Necropoli di Sibari*”.

- *Giuseppe Faraco*, papa i ritit grek, gazetar dhe publicist, themelues i revistës “Zjarri”.
- *Giuseppe Jenò de Coronei* (1783-1860), oficer mjekësor i Marinës *Royal Bourbon*.
- *Giuseppe Mazzioti*, (1831-1913), një përfaqësues i lavdishëm i shkollës laike liberale dhe demokratike, autor i një monografie del *Collegio italo-greco di San Adriano*, pra kolegjit të Shën Adrianos.
- *Giuseppe Salvatore Bellusci* (1886-1972), deputet i Asamblesë së Kushtetutës dhe nënsekretar në Ministrinë e P.I.
- *Nicola Maria Jenò de’ Cornei*, bijë e një familjeje të vjetër fisnike, gjatë mbretërisë së dy Sicilive të provincës së Materas, autor i teksteve: “*Cobden e la lega, ossia l’agitazione inglese per la liberta del comercio*”, “*Elementi della economia politca ad uso del popolo*”, e “*La situazione e lo stato della Russie*”.
- Prof. *Giuseppe Gradilone* (Kozencë, 1925) është personalitet i shkencave albanologjike; ka lindur më 1925, në Shën Demetrio Korone (Kozencë). Profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe dhe docent i parë i filologjisë shqipe në fakultetin e letërsisë në Universitetin e Romës “*La Sapienza*”. Punoi si redaktor i revistës “Shêjzat” dhe botoi artikuj dhe shumë analiza të krijimtarisë letrare të shumë autorëve.
- *Rafaele Lopez* nga Shën Mitri, i cili ka dhënë mësim së bashku me De Radën në kolegjin e Shën Adrianit, ku të dy u arrestuan në vitin 1851 për veprimtari revolucionare. Ai përgatiti një përmbledhje këngësh popullore arbëreshe të përkthyer prej tij në italisht.
- *Salvatore Marini* (vitet ‘700), i famshëm për ngritjen e pemës së lirisë, së bashku me disa studentë të tjerë në sheshin kryesor të Shën Mitri.
- *Vicenco Andropoli* (1823-1888) poet arbëresh.
- *Vicenco Mauro* dhe *Dimetrio Chiodi*, patriotë të dalluar, ku edhe dhanë jetën në fushën e betejës *Campotenese* kundër burbonëve.
- *Vicenzo Chiodi*, kapiten gjatë periudhës së mbretit *Giaochino Murat*.



4.1.2. *Macchia Albanese (Maqi)*

Macchia Albanese (Maqi) është një pjesë e komunës së San Demetrio Corone-s. Ai është një fshat i vogël në luginën e poshtme të Kratit (Crat-it), i shtrirë në një kodër në të majtë të përroit dhe rrethuar nga një panoramë piktoreske përballë detit Jon.

Maqi u themelua gjatë shekullit XV, por ishte Jeronim De Rada, arbëreshi i Maqit që i dha histori, i dha dinjitet, i dha emër këtij fshati të largët, gjeografikisht i humbur mes maleve.

Shtëpia e De Radës është zhveshur nga të gjitha kujtimet “materiale” (biblioteka e poetit është rrëmbyer, shitur, plaçkitur), asnjë institucion publik, bashkiak, krahinor dhe kushdo, këto njëqind vjet nga vdekja e poetit, asnjë nuk ka lëvizur gishtin për të kujtuar atë madhështi që një i ri i dha gjuhën një populli të tërë.

Te shtëpia “De Rada” nuk mund të lëmë pa përmendur edhe emblemën. Stema është e argjendtë me një rrip të ndarë më tresh, në të kuq-zi-kuq, në ballë dy yje të artë gjashtëcepash, poshtë një fletë dushku e blertë. Stema gjendet e gdhendur në gurë, në shtëpinë e poetit Jeronim De Rada në Makia të Kalabrisë, si dhe vjen e përshkruar, pjesërisht, e paplotë nga vetë poeti: me fushë të argjendtë, me dy yje vendosur sipër rripit të kuq (më pas ngjyra e rripit të mesit do të bëhej kuq-zi-kuq) dhe mbi majë dushku i Dodonës.

Sot, pjesa më e madhe e rrugëve dhe e rrugicave të kalldrërta mbajnë emrat që u pati vënë dikur De Rada kur ishte gjallë, udha “Morea”, “Marko Boçari”, “Shkodra”, “Domeniko Mauri” etj.

Kuriozitet: Në kujtim të këtij virtyti spartan për mbrojtjen e identitetit të vërtetë të vendit, kujtojmë vetëm disa nga anekdotat e jetës së përditshme të makjotëve, të pranishme deri në vitet e para të mesit të shekullit XX, riti latin bënte të pamundur për t’i kthyer arbëreshët e ritit bizantin.

Në Maki deri në vitet ’50, gratë arbëreshë ende donin të vishnin veshjen e tyre falë një prej rrobaqepësve të fundit të njohur, e cila quhej Mjësh Xheni. Dikur shkoi disa herë drejt një ngastre të vogël toke që zotëronte, në udhëkryqin Reka, duke kaluar nëpër fshat me kapelën në duar, e pyesni: Mjësh Xhe, ku i vete? Ajo u përgjigj në sensin satirik (me shaka): Jam e vete vràs një lëtir (kush kthehej në ritin latin dhe asimilohej në italian); Nga ana tjetër, latinët duke njohur rrezikun (duke njohur krenarinë e arbëreshit), përgjigjeshin: “*Se afronti një Ghjegghju dhe nu lupu (ujk), qelloni Ghjegghju dhe lere ujkun*”.^{82*}

Rrëfehej se arbëreshët që ktheheshin në latin dhe që kalonin në mes të fshatit duhet t’i zbrisnin gomarit deri sa të dilnin nga fshati. Ose, kishte raste drastike që kush kthehej në latin, duhej të kalonte nga rruga e dhive, sepse ishte e ndaluar të hynte në fshat.⁸³

Mbiemrat arbëreshë në fshatin Maqi

Më 1543, në Maki familjet arbëreshe më me shumë ndikim ishin: Argondizza, Belluscio, Caparella, Cochiloni, Flocca, Marchianò, Rado (Rada), Turchio. Ndërsa emrat dhe mbiemrat më të zakonshëm në Maki ishin: Alfano, Archiopolo, Belluscio, Brunetto, Cagnazzo, Chiurco, Clivezzo, , Di Pace, Drames, Ligori, Longo, Maimone, Manesi, Marchianò, Marino, Masi, Mastranga, Ponte, Rada, Rebecco dhe Zara.

^{82*} “Në qoftë se takon rrugës një arbëresh dhe një ujk, me pushkë godit arbëreshin dhe lëre ujkun”. (Shënim i redaktorit).

⁸³ Angelo Masci, “Discorso del Consigliere di Stato Angelo Masci sull’ origine, i costumi e lo stato attuale degli albanesi del regno di Napoli, Tipografia Nobili, 1847, Napoli, fq. 67.

Figura të shquara të Maqit

Jeronim De Rada (Girolamo De Rada)

De Rada i kishte përthithur dhe ishte i përmbushur me substancën humane arbëreshe, me trashëgiminë e kulturës arbërore, që kodifikoi dhe publikoi në veprën “Këngët e Milosaos” (e botuar në tri variante të ndryshme më 1836, 1847 dhe 1873). De Rada vazhdimisht e ndryshonte, e përmirësonte dhe e zgjeronte këtë përmbledhje baladash lirike me frymëzim të fuqishëm romantik, duke e kthyer nga “Milosao” me njëzetë këngë, në një variant përfundimtar shumë më të gjatë me tridhjetë e nëntë këngë.

Më 1848, nxori të parën gazetë shqiptare “L’Albanese d’Italia”, në të cilën shprehu pikëpamjet e tij për ngjarjet e kohës. Pas dështimit të revolucionit më 1848, e mbylli gazetën dhe u tërhoq në fshatin e tij.

De Rada bëhet një nga figurat më në zë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Pas traktatit “Parimet e estetikës” (Principi di Estetica, 1861) botoi veprat “Lashtësia e kombit shqiptar” (“Antichità della nazione albanese”, 1864) dhe “Rapsodi të një poeme arbëreshe” (“Rapsodie d’un poema albanese”, 1866), që luajtën një rol të rëndësishëm për ngritjen lart të çështjes kombëtare shqiptare.

Jeronim De Rada ishte vazhduesi i lëvizjes së ringjalljes shqiptare, i cili revokoi figurën e Skënderbeut. Këto ide i shpalosi veçanërisht në poemat “Milosao”, “Rapsodia e një poeme shqiptare”, “Skenderbeku i pa fanë”, “Serafina Topia” dhe shumë vepra të tjera të karakterit historik, politik, estetik, gjuhësor dhe gramatikor.

Ai pati një rol të rëndësishëm edhe në fushën e publicistikës. Pas gazetës “L’Albanese d’Italia”, më 1883 ai themeloi revistën mujore dygjuhëshe “Fiàmuri Arbërit – La bandiera dell’Albania”. Ky periodik, i botuar në fillim në Maqi, e më pas në Kozencë (nga një komitet fisnikësh nga Shqipëria dhe ngulimet e saj), zgjati deri në nëntor të vitit 1887 dhe me gjithë censurën turke e greke, lexohej gjerësisht edhe nga shqiptarët në Ballkan.

Më 1892, De Rada u riemërua mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër dhe më 1895,

organizoi të parin kongres gjuhësor arbëresh në Koriliano Kalabro. Gjithashtu, mori pjesë aktive në Kongresin e dytë gjuhësor arbëresh në Ungër (Lungro) dy vjet më vonë, në të cilin ai bëri thirrje për të ngritur një katedër të studimeve shqiptare në *Institutin Oriental në Napoli*. Në këto vite të fundit të jetës, ai botoi veprën “Caratteri e grammatica della lingua albanese” (“Shkronjat dhe gramatika e gjuhës shqipe”), Koriliano Kalabro, 1894. Për hartimin e kësaj vepre u bazua në leksionet e mbajtura në kolegjin e Shën Adrianit. Gjithashtu, botoi “Antologia albanese tradotta fedelmente in italiano” (“Antologji shqipe e përkthyer besnikërisht në gjuhën italiane”), Napoli, 1896, veprë ku përfshihen poezi të zgjedhura nga Jul Variboba, Anton Santori, etj. “Autobiologia” është vepra autobiografike në katër vëllime e botuar prej tij në Kozencë, në vitin 1898 dhe në Napoli, 1899. Pak para se të vdiste, botoi edhe veprën “Testamento politico”, një përmbledhje kjo e pikëpamjeve të tij politike e kulturore, e botuar në “La Nazione Albanese” më 30 shtator 1902. I vetmuar e i varfër, gjysmë i verbuar e në prag të urisë, Jeronim De Rada vdiq në vendlindje, në malësinë e Kalabrisë, më 28 shkurt 1903 - një fund tragjik ky për një figurë të madhe të kulturës shqiptare.⁸⁴

Dhimitër Leka (Demetrio Lecca)

Jeronim De Rada i kushtoi veprën e tij të parë letrare “Canti di Milosao” (“Këngët e Millosaut”) pikërisht Dhimitër Lekës.⁸⁵

⁸⁴ Literatura për Jeronim De Radën është relativisht e gjerë. Më kryesorët përmendim, shkurtimisht: Marchianò 1902, Douglas 1930, Gualtieri 1930, Gradilone 1960, f. 11-114, 1983, f. 13-38, Kastrati 1962c, Ruberto 1966, Valentini 1964, Koliqi 1972b, f. 81-116, dhe Qosja 1984, vëll. 2, f. 35-184. Për studime të veçanta mbi stilin poetik të De Radës, kr. Pipa 1969b, 1970, 1973, 1977, 1978b, 1982, Desnickaja 1985a, 1985b, K. Kodra 1988, Altimari 1991b, Hamiti 1993a, Kabashi 1994, dhe Pipa 1994.

⁸⁵ Në veprën “Milosao”, botimi i parë i vitit 1836, gjendet dedikimi i De Radës për Dhimitër Lekën, ku përkatësisht shkruhet: “A S.E. il Gen. Brigadiere Commendatore Signor Demetrio Lecca, questi canti che sien testimonianza dell’attaccamento agli antichi costumi della dispersa gente d’Epiro, Girolamo De Rada”. (Shënim i redaktorit)

Meqenëse me këtë vepër letrare e ka zanafillën letërsia moderne shqiptare, këto lidhje na shërbejnë për të kuptuar mjedisin kulturor të posaçëm që përgatiti dhe shpjegon këtë fazë të re të kulturës arbëreshe dhe shqiptare në diasporë.

Figura e Dhimitër Lekës ishte atëherë shumë ‘popullore’ mes arbëreshëve të Italisë. Para Jeronim De Radës, edhe Cesare Marini ia kishte kushtuar Lekës një vepër deri sot pak e njohur mbi kulturën arbëreshe, me titull: “*Memoria su’ riti delle nozze presso gli albanesi*” dedicata al sig. brigadiere D. Demetrio Lecca, commendatore del Real Ordine di S. Ferdinando, cav. dell’ordine di San Giorgio, ispettore della gendarmeria reale, dall’avvocato Cesare Marini, Dai Torchi di Settembre, Napoli 1831.

Dhimitër Leka ishte nxitësi kryesorë për krijimin e këtyre veprave nga De Rada dhe Cesare Marini, si dhe pati një veprimtari të gjerë patriotike. Mendohet se i përkiste një familjeje fisnike me prejardhje nga Chimera (Himara).

4.1.3. Frascineto (Frasnita)

Frashineto (Frascineto), ose Frasnita (siç e quajnë arbëreshët) është një fshat i ngritur rrëzë Polinit madhështor dhe Dolcedorme-s. Frasnita është një fshat i vogël, i cili më parë quhej “Casale Novo” ose “Casal San Pietro” dhe u ripopullua nga kolonitë e refugjatëve arbëreshë në shek. XV. Qyteza u popullua rreth vitit 1490. Aty lindën njerëz të shquar si: Don Domenico Bellusci (1734-1833), peshkop dhe rektor i kolegjit të Shën Adrianos në San Demetrio Corone; Vincenzo Dorsa (1823-1885) studiues dhe filozof, studiues i folklorit; Bernardo Bilotta (1843-1918), filozof dhe shkrimtar.

Sipas dokumenteve, emri “Frascineto” që nga viti 1264 nuk rezulton, por këtë emër e gjejmë pranë një territori rural, që sot gjendet “Capella Madonna della Pieta”. Etimologjia e emrit “Fraxinetum”, i atribuohet një pylli “frassini” që gjendej përfaqë. Popullsia u shtua më 1534 me emigracionin në vazhdim. Bashkëjetesa solli me popullsinë vendase kontraste. Arbëreshët i quanin (latin) për hir të



ritit dhe thoshin “Ka Lëtirët/Lëtinjtë”. Kjo lagje ishte më e rrafshët dhe arbëreshët e quanin lagjja “Ka Dërrasat”. Qyteza, kaloi dorë pas dore si pronë e feudalëve të ndryshëm dhe rreth viteve 1600, kaloi në zotërimin e San Severio Bazanjo (San Severio Bisignano).

Trashëgimia kulturore - Arkitektura

Kisha e Shën Mërisë Assunta

Kisha është e ritit bizantin. Ndodhet në qendër dhe mund të shijosh këtë arkitekturë antike të shpirtit arbëresh. Kjo kishë u restaurua më 1794, nga Bernardo Pallisciano. Holandezi Girolamo Leuzing e ndriçoi me elementë dhe imazhe sakre, ndërsa Rikardo Turra dhe shqiptari Josif Droboniku e pasuruan me piktura të stilit bizantin. Kjo kishë është madhështore dhe hijerëndë, por në të njëjtën kohë edhe e bukur, siç është edhe zemra e frasnjotëve.

Kisha e Shën Pjetrit

Ajo daton nga shekulli i 10-të dhe qeverisej nga murgjit bazilianë, deri në shekullin XVIII. Për stilin bizantin me tre anije (naveta),

me orientimin e veçantë në perëndim, sesa në lindje. Monumenti kombëtar e paraqet veten me abscesin, kube dhe parathënien tipike bizantine, ndërsa ndarja e naveve është e zakonshme për monumentet e tjera të perëndimit të krishterë. Ngjitur me varrezat e fshatit, Kisha e San Pietro, e mbyllur tani për adhurim, ka një kube të veçantë me kube koncentrike me një shtresë koncentrike, të shtruar dhe të mbuluar me pllaka.

Kapela e Shën Luçisë

Kjo kapelë ndodhet në qendrën historike të fshatit dhe daton nga shekulli XVI. Për shekuj u përdor si një vend i shenjtë dhe në vitin 1973 u rinovua, ridizenjua dhe u rihap për publikun nga peshkopi i Lungro-s, Giovanni Stamati. Punimet e zbukurimit u kryen në vitet '90, me vullnetin e Atë Francesco Solano, i cili konsistonte në ndërtimin e një ikonostasi mermeri me fise të sipërme dhe dyer prej druri. Imazhet e shenjta të ikonostasit dhe mozaikut që përshkruajnë Shën Lucinë në fasadën e jashtme të kapelës u krijuan nga ikonografi Josif Dubrovniku.

Ermo e Madonna di Lassù

Ndodhet në veri të Frascineto, të rrënjosura në shkëmbin e malit që qëndron në qytet. Ndërmjet mureve të tij, duke u mbështetur në shkëmb, dikur ndodheshin qelizat për murgjit Basilian të manastirit të San Pietro, të cilët iu përkushtuan jetës soditëse. “Madonna delle Armi” ose “Aramei”, njihet zakonisht nga komuniteti shqiptar si “Shën Mëria Këtje Lart” (Madonna e Lassù). Të dielën e dytë pas Pashkës, besimtarët e Frasnitës dhe të Ejaninës e kanë traditë të bëjnë një vizitë në këtë vend.

Urdhri i Dragoit në Kastrovillari (Simboli i dragoit)

Në Kastrovillari, rreth 3 km larg nga fshati arbëresh Frasnitë, gjatë rinovimit të një banese të lashtë, përkatësisht Palazzo Baratta, u gjend një gur gëlqeror i tipit lokal, në të cilin ishin gdhendur disa shenja të çuditshme. Pronari i banesës, N.H. Paolo Baratta, vuri re se ato shenja ishin në të vërtetë një vizatim i qartë, që riprodhonte një

lloj gjarpri me bishtin rreth qafës, simbol ky i mirënjohur, i përdorur nga Urdhri i Dragoit. Ky ishte një urdhër kalorësi ushtarak, që u themelua në shekullin XV dhe anëtarë të tij ishin paria e fisnikërisë europiane, përfshirë: Mbretin Alfonsi V i Aragonës dhe djali i tij, Ferdinand; Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Vlad II Basarab, si dhe Vlad III, i cili ka mbërritur tek ne me pseudonimin e Drakula⁸⁶, që do të thotë në rumanisht “djali i dragoit”. Simboli është i gdhendur në një pjesë të gurit që, në njëfarë mënyre, duket se është ruajtur, sepse mbrohet nga e njëjta muraturë, në të cilin ishte vendosur.

Objekte me vlerë historiko-artistike të Frasnitës:

- Ikonostasi i *N. Jannakakis* (Kisha e Shën Vasilit, Ejanina e Madhe);
- Mozaiku i jashtëm, që përfaqëson Shën Vasilin e Madh nga J. Droboniku;
- Ikonostasis nga *G. Leusing* dhe *R. Turra* (Kisha e *S. Maria Assunta*-s);
- Statuja prej druri me vlera të jashtëzakonshme të Konceptimit të Papërlyer (Kisha e *S. Maria Assunta*-s);
- Kanavacat e shekullit XVIII nga *Genesio Galtieri*, që përfaqësojnë Supozimin e Virgjëreshës dhe një Shën Mari (Madonna) me fëmijë e shenjtorët *Francesco di Paola* dhe *Trifone* (Kisha e *S. Maria Assunta*-s).
- Ikonostasi dhe mozaiku i jashtëm, që përfaqësojnë Shën Luçinë nga J. Droboniku në kishën me të njëjtin emër;
- Muzeu i Ikonave dhe i Traditës Bizantine;
- Muzeu i Kostumit Arbëresh në miniaturë;
- Muzeu i Biodiversitetit;
- Muzeu Etnografik Arbëresh (*Argalia / lo Telaio*);
- Ekspozitë e përhershme fotografike në shtëpinë kanonike.

⁸⁶ Vlad III ishte një sundimtar i Wallachia, një principatë e Europës lindore brenda Rumanisë moderne. Vlad u bë famëkeq për dënimet e tij brutale, por edhe për përpjekjen e tij për të luftuar osmanët muslimanë. Në epokën moderne u risoll sërish në vëmendje si figurë, në sajë të lidhjeve me romanin “Drakula”, të autorit Bram Stoker. (Shënim i redaktorit)

Struktura e shtëpive aristokrate

Në këtë fshat ka disa pallate të familjeve aristokrate si: Palazzo Caravona, Palazzo Pace (Eianina), Palazzo Bellusci, Palazzo Dorsa.

Pavarësisht se është e vështirë të identifikohet periudha historike e këtyre ndërtesave, struktura arkitekturore të Palazzo Pace dhe Palazzo Bellusci, na shtyn t'i vendosim ato në gjysmën e shekullit të 17-të dhe ajo e shekullit të 18-të. Me interes të veçantë është dera e madhe dhe shkallët e brendshme prej guri.

Trashëgimia shpirtërore

Kostumet arbëreshe

Kostumi i grave arbëreshe është identiteti i tyre që e ruajnë me krenari brez pas brezi, i cili vishet në çdo festë, në çdo manifestim, por në mënyrë të veçantë ato janë tek “Vallja”.

“Vallja” si ritual

Rituali i *Valles*, ose *Valljes*, bëhet të martën e parë pas ditës së Pashkëve. Është një ritual që nuk është modifikuar në kohë, por zhvillohet në mënyrën e saj më të hershme. Koreografia është në formën e harkut dhe duart me njëra-tjetrën janë të kapura me një shami trekëndëshe. Si në krye dhe në mbyllje të grupit të valles qëndron një burrë. Këndohen këngë folklorike, midis tyre edhe “Kënga e Kostandinit të vogël”. Rrethi i grave është i veshur me kostume arbëreshe, ndërsa burrat nuk paraqiten me kostume tradicionale. Këngët janë thirrje, janë klithma dhe rrjedhin herë lehtë, dhe herë si ujëvarë e furishme. Në këtë ritual kujtohet dita kur Skënderbeu humbi betejën në Shalë dhe që u vranë shumë shqiptarë. Në arbërisht, thuhet që: “*Të gjithë të shtunat ardhshin, e shtua e Shalës mos ardh të kurrë!*”.

Riti “Moterma” (Riti i Motrave)

Në disa prej fshatrave arbëreshe është praktikuar edhe riti “Moterma”, i cili është një rit i vajzave arbëreshe. Ashtu si edhe riti i “Vllamjes”, vajzat shponin gishtin dhe thithnin pikat e gjakut që dilnin nga gishti i njëra-tjetrës. Duke bërë këtë “shkëmbim gjaku” midis tyre, nga ai moment ato ishin motra për gjithë jetën. Për këtë rit flet edhe Vincenzo Dorsa në librin e tij.⁸⁷

Kulti i të vdekurit në botën arbëreshe

Të vdekurit përkujtohen dy herë në vit, sipas kalendarit liturgjik bizantin. Një herë në ditën e shtunë, para të dielës së parë të karnavaleve dhe herën tjetër, të shtunën para Pendekostes. Dita e të vdekurve quhet “E shtuna e Shpirtrave”, ose “Psikosabaton”. Sipas besimit, në këtë periudhë të vitit, të vdekurit kthehen në jetë dhe rrinë me të gjallët për tetë ditë, atëherë të afërmit u ofrojnë një sofër të pasur, duke sjellë mbi varrezat ushqime të ndryshme dhe shishe vere. Pas tetë ditëve përgatitet diçka tradicionale që quhet PANAGJIJA. Kulti i grurit është kulti i rilindjes dhe për këtë arsye, përgatitet dhe zihet gruri. Kjo është një traditë krejt e veçantë që arbëreshët në Itali e ruajnë ende me përkushtim.

Gjithashtu, tek arbëreshët kremtohet edhe dita e martës pas Pashkëve. Thuhet se në këtë ditë arbëreshët kujtojnë fitoren e Skënderbeut mbi turqit, që i bie përafërsisht në të njëjtën periudhë, më 27 prill të vitit 1467. Arbëreshët luajnë pjesë koreografike përmes valleve të ndryshme nëpër katundet e tyre.

“Biblioteka ndërkombëtare Antonio Bellusci”

Një nga bibliotekat më të pasura tek arbëreshët e Italisë, është “Biblioteka Ndërkombëtare Antonio Belushi”, e cila përmban mbi 10.000 botime që kanë të bëjnë me kulturën, artin, gjuhën e historinë arbërore-shqiptare. Kjo bibliotekë u themelua në vitin 1961 dhe gjendet në pikërisht në Frasnitë, ngulimin arbëresh në të cilin jeton studiuesi Belushi. Veç titujve të pasur të librave, në këtë

⁸⁷ Giuseppe Ferrari, *Rapsodie e scene di vita degli albanesi di Calabria*, Cosenza 1959, f.73.

bibliotekë gjenden edhe dorëshkrime, ditarë të ndryshëm, si dhe koleksione të plota gazetash e revistash të arbëreshëve të Italisë ndër dekada, si dhe të periodikëve të vatrave të tjera kulturore të diasporës shqiptare.

Disa prej thesareve të grumbulluara në “Bibliotekën Ndërkom-bëtare Antonio Bellusci” janë botuar në revistën e themeluar prej tij “Lidhja”, të tjera presin të botohen e të studiohen nga të interesuarit mbi këtë lëmi. Disa nga thesaret e kësaj biblioteke janë dorëshkrimet e para origjinale të disa veprave të autorëve arbëreshë, ku ndër më kryesorët përmendim:

Dorëshkrimi i parë arbërisht “Pa titull” paraderadian

Në këtë bibliotekë gjejmë dorëshkrimin e parë origjinal të disa këngëve arbëreshe, shkruar në arbërisht, të përmbledhur në 12 faqe, me kartën “Cartiera Bondon” e vitit 1817. Flitet për një dokument paraderadian dhe është gjendur tek shtëpia e Vincenzo Dorsës (Vincenzo Dorsa). Disa prej këtyre rapsodive gjenden tek libri i De Radës “Rapsodie Nazionali” po ashtu, edhe tek vepra “Ricerche sugli albanesi” e Dorsës.

Dorëshkrimi i hershëm “Rapsodi në gjuhën arbërisht”, 1822

Një tjetër dorëshkrim “Canti e rapsodie” shkruar në arbërisht në kartën “Bondon”, më 1822 u gjet në shtëpinë e Vincenzo Dorsës. Ky dokument u shqyrtua personalisht edhe nga prof. Jup Kastrati (më 1981, gjatë një vizite në bibliotekë, së bashku me prof. Dhimitër Shuteriqin dhe Ali Xhikun), ku shprehen se dorëshkrimi nuk mund të jetë as i Dorsës dhe as i De Radës, por duke ekzaminuar “alfabetin paterno” dolën në konkluzionin se i përket ndonjë autori tjetër.

Dorëshkrim panegjirik në arbërisht, 1847

Ky dorëshkrim prej 6 faqesh i përket autorit Vincenzo Dorsa (shkruar në arbërisht, më 1 janar 1847) për nder të festës së shenjtorit S. Basilio i Madh, mbrojtës i kishës në Ejaninë (Porcile). Është shumë interesant ky fjalim për mënyrën sesi ky prift i drejtohet popullit të tij me fjalët e zemrës, arbërisht, me gjuhën e vëllazërisë.

Dorëshkrimi i Mikele Belushit (Michele Bellusci) 1628-1633

Gjetja e një dorëshkrimi që përmbante një «Koleksion poezish shqiptare», në korrik 1957, dhe botimi drejt fundit të vitit 1963, ngjalli jo vetëm interes të madh, por kryesisht edhe mëdyshje të mëdha. Nuk do të ngjallte ndonjë çudi nëse zbuluesi i dorëshkrimit, nuk do t'ia atribuonte meritat e autorësisë, autorit Michele Bellusci, nga Frasnita, duke e vendosur koleksionin mes viteve 1628 dhe 1633.⁸⁸

Dorëshkrimi, për të cilin bëhet fjalë, përbëhet nga 58 fletë (116 faqe) në formatin 19.3 x 13.5 cm. Letra është e llojit “përdorim dore”, me brazdë lapsi; katërfaqëshe, dhe të tjerët; në filigrana, mban emrin e prodhuesit “Kamera Andrea”. Në fletët e tjera, në filigrana, dallohen inicialet “G.B.I.» Dhe emblema e fabrikës. ~ në kopertinën e dorëshkrimit është në karton të mbuluar me letër-muri.

Në fletën e dytë, bashkangjitur në kopertinë, lexohet shkrimi: “Dornenico - Kozencë- Këtu jam - Dornenico Marini - E dini - e mjerueshme». Ndjekin pesë fletë me të bardhë, me titullin e dorëshkrimit «Koleksione Poezive Shqiptare të mbartura me besnikëri në puosa Volgaue». Vazhdon menjëherë “Alfabeti”, i miratuar nga përpiluesi, me një shënim mbi vlerën e shkronjës “y” dhe një “Njoftim”. Në “Njoftimin” shkruhet : «B.M. nepos 1774» shkruar nga një tjetër dorë, shkruar me bojë të zezë të kohëve të fundit, pothuajse bashkëkohore; ndërsa teksti i dorëshkrimit ka gjurmë boje karakteristike të venitur të tipit “sepia”. Kjo gjithashtu shihet me sy të lirë, por nëse i nënshtrohet një analize kimike mund të tregohet qartësisht koha e dy bojërave. Ky dokument nuk ka akoma konfirmim të saktë, sepse autori që ka gjetur këtë mbishkrim, Giuseppe Ferrara nuk jep informacione të detajuara mbi autorin e këtij dorëshkrimi. Michele Bellusci mendohet të jetë edhe autori i përmbledhjes me dyzet e dy rapsodi të shkruara shqip.

⁸⁸ Giuseppe Ferrari, *Canti albanesi. Raccolta di Michele Bellusci del '600*, Adriatica Editrice, Bari 1963, f. 24.

Figura të shquara të Frasnitës

Mikele Belushi (Michele Bellusci)

Lindi më 1754-1806. Ishte një prej juristëve më të mëdhenj arbëreshë, mbrojtës i kombit dhe të ritit bizantin tek arbëreshët. Studioi pranë Kolegjit të Shën Benedikut të Ullanës. Shkroi dhe dokumentoi motivacionin ku theksoi se arbëreshët duhet të praktikonin ritin bizantin, që të mos asimilohen. Ai i këndoi lavdisë së popullit të vet arbëror, në një vepër të shkruar në italisht me titull: “*Risposta di Filaleta a Monsignor Cardamone*” (“Përgjigja e Filaletës për Imzot Kardamonen”), Napoli, 1796.

Mikele Belushi ishte i pari, i cili bëri diferencën midis ritit bizantin arbëresh dhe popullsisë greke. Më 1796, Peshkopit i Rossanos, po bënte të pamundurën me të gjitha mjetet dhe mënyrat për t’iu imponuar komuniteteve arbëreshe, që ishin nën mbikëqyrjen e kishës latine. Në këto kushte, arbëreshi Mikele Belushi mban qëndrim të rreptë dhe i drejtohet me këto fjalë: “*Zotëria juaj bën një gabim trashanik kur, përziën grekët me shqiptarët, duke i quajtur këta të fundit grekë kryelartë dhe gënjeshtarë. Shqiptarët, që përbëjnë popullsinë e Mbuzatit dhe të bashkësive të tjera të Kalabrisë, të cilët ruajnë ritin grek, nuk janë njësoj si grekët; kanë origjinën e ndryshme, sepse dallohen prej gjeneze, prej natyre e prej zakoni*”.

Domeniko Belushi (Domenico Bellusci)

Ky arbëresh arriti të rikthente lulëzimin e Kolegjit të Shën Adrianit. Ai e drejtoi kolegjin për një çerek shekulli, duke bërë që të rritej fama dhe autoriteti i këtij institucioni. Kolegji u kthye në një fidanishte dijesh, ku përgatiteshin dhe edukoheshin të rinj, të cilët do të bëheshin më vonë veprimtarë të shquar të Risorxhimitos Italiane.

Vinçens Dorsa (Vincenzo Dorsa, 1823-1885). Lindur në Frasnitë në rajonin e Kozencës, më 26 shkurt 1823. Dorsa ndoqi studimet në kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër e më pas, në Kolegjin e Propaganda Fides në Romë. Për shumë vjet që mësues i greqishtes

dhe i latinishtes në shkollën e mesme të Telesios në Kozencë. Vepra, me të cilën u shqua është “*Su gli Albanesi, ricerche e pensieri*”, Napoli, 1847 (“Mbi Shqiptarët, hulumtime e mendime”). Në hyrje të librit, ai shënon “*alla mia nazione divisa e dispersa ma una*” (“kushtuar kombit tim, të ndarë e të shprishur, por një i vetëm”), që synonte, siç e thotë vetë ai, “të tërheqë vëmendjen e opinionit publik ndaj të drejtave të një kombi të shquar, por të panjohur”. E ndarë në njëzet krerë, vepra përmban të dhëna të bollshme, të para në dritën e mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, për prejardhjen dhe historinë e shqiptarëve deri në kohën e Skënderbeut, për ngulimet shqiptare në Italinë e jugut dhe për poezinë popullore, zakonet dhe letërsinë.

Jeta e Dorsës ka qenë e vështirë. Vdekja e së ëmës, Vitoria dhe vizitat e shumta në burgjet e Kozencës dhe të Napolit ku ishte burgosur i ati, Frangjisko, lanë shenja të forta në jetën e Vinçencos.

Vepra e tij është si një manifest i fortë arbëresh i kohës, që i bën jehonë lëvizjes kombëtare të Shqipërisë. Në brendësi të 20 kapitujve, shtrihet gjithë ideologjia e Rilindjes Kombëtare: Historia e lavdishme e kombit, pellazgët, maqedonasit, ilirët, Skënderbeu, gjuha shqipe, folklori, traditat dhe zakonet popullore, letërsia e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja e kombit, (Shqipëria çka qenë, ç’është e ç’do të bëhet). Kush e ka lexuar, duket synimin i Dorsës që në rreshtat e parë, i cili kërkon t’i shpalosë opinionit publik të drejtat e kombit shqiptar dhe mbyllet me një projekt të plotë ideologjik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, për një kryengritje të armatosur kombëtare dhe për një shtet të pavarur.

Vinçens Dorsa ishte i pari arbëresh që pati një mendim të strukturuar mbi çështjen e kombit, duke hedhur kështu idenë e kombit. Ishte pro ritit bizantin dhe ashtu si daja e tij Mikele Belushi (Mikele Bellusci), duke sanksionuar ritin bizantin si forma më e lartë supreme për ruajtjen e gjuhës nëpërmjet ritit bizantin, kundërshtoi figura të ndryshme arbëreshe, mes tyre edhe poetin Jul Variboba. Dorsa ishte i pari që mbështeti institucionet e një eparkie autonome dhe të pavarur bizantine arbëreshe, nën juridiksionin e Papës në Romë, me një peshkop arbëresh me juridiksion të plotë mbi arbëreshët.

Kënga e parë arbëreshe mbi Skënderbeun është botuar nga Vinçens Dorsa, në vitin 1847, kur asnjë paraardhës i tij arbëresh nuk e përmend praninë e këngëve të tilla. Më vonë, ishte edhe Jeronim De Rada, në vitin 1866, i cili nën titullin “Rapsodi të një poeme arbëreshe” kodifikoi tetë këngë, përkatësisht: “Trimi dhe vasha”, “Motra e Skënderbeut”, “Skënderbeu dhe Miloshini”, “Martesa e Skënderbeut”, “Skënderbeu dhe Ballabani”, “Vjehrra e keqe”, “Skënderbeu dhe Vdekja”, “Vdekja e Skënderbeut”.

Vinçens Dorsa mbante korrespondencë edhe me princeshën Dora D’Istria. Shkrimet dhe veprat e tij janë dëshmi e sigurt e jetës dhe e gjuhës shqipe të ngulimeve arbëreshe.

Më pas, Dorsa botoi “Studi etimologici della lingua albanese”, (“Studime etimologjike për gjuhën shqipe”) Kozencë, 1862 dhe “La tradizione greco-latina nei dialetti della Calabria citeriore”, (“Tradita greko-latine në dialektet e Kalabrisë së Epërme”) Kozencë, 1876 dhe 1884. Të pabotuara kanë mbetur vepra e tij “Discorso in lingua albanese”, një traktat fetar i shkruar shqip gjatë studimeve në Romë më 1842, si dhe dorëshkrimi me afro gjashtëdhjetë e pesë këngë popullore arbëreshe nga Kozenca, me titullin “*Canti popolari albanesi*” (“Këngë popullore shqiptare”), të cilat i shërbyen Jeronim De Radës në përmbledhjen që ky hartoi me material folklorik arbëresh.⁸⁹

Bernando Bilota (Bernardo Bilotta, 1843-1918), ishte vjershëtar, filolog, mbledhës folklori. Lindi më 29 nëntor të vitit 1843, në Frasnitë në Kalabrinë e veriut. Ndoqi kolegjin e Shën Adrianit dhe shërbeu si klerik më 1866, dhe më vonë si mësues. Mik dhe pasues i Jeronim De Radës, nga i cili trashëgoi vrullin e zjarrtë për të rizbuluar kulturën shqiptare, Bilota ishte anëtar i ‘*Consiglio Albanese d’Italia*’ (Këshillit Shqiptar të Italisë) dhe nismëtar, bashkë me De Radën dhe Anselmo Lorekion, i Kongresit të parë gjuhësor arbëresh në Koriliano Kalabro, më 1895. Bilota ishte autor prodhimtar, ndonëse botoi pak. Përveç një numri veprash pak të njohura në italishte

⁸⁹ Dhimitër Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1976, f. 228.

për historinë biblike, arkeologjinë dhe origjinën ‘pellazgjike’ të shqiptarëve, ai ishte autori i një “*Dizionario filologico albanese*”, 1888 (“Fjalori filologjik të gjuhës shqipe”) prej 6000 fjalësh, i cili përmban dyqind faqe me material gjuhësor në dialektin e Frasnitës, si dhe disa sprova të habitshme etimologjike. Shkroi edhe “*Monografia di Frascineto*”, (“Monografia e Frasnitës”), 1891, kronikë poetike e papërfunduar në pesë pjesë për vendlindjen, që përfshin rreth 2000 vargje njëmbëdhjetërokëshe, dhe “*Zakonet e Frasnitës*”, 1894, ku përshkruan traditat e fshatit, ritualet dhe ceremonitë e përvitshme, në 1710 vargje njëmbëdhjetërokëshe. Deri tani, asnjë nga këto vepra nuk e ka gjetur dritën e botimit. Të pabotuara janë edhe një numër rrëfenjash në vargje, me tipare prozaike, fjala vjen “E bukura e Jetës”, 1895, sipas përrallës shqiptare të së Bukurës së Dheut; “E Bukura Harezë”, 1896, dhe “*Minosi*”, nga e cila gjenden tri variante, të viteve 1903, 1909 dhe 1918. Poema e tij satirike me 150 faqe, 8664 vargje, “*Minosi*” na jep një tablo fshatarake, e herë-herë therëse satirike të skëterrës, në flakët e së cilës Bilota ndien kënaqësinë danteske të ndëshkimit të kundërshtarëve dhe armiqtë të tij nga Frasnita.

Ndër veprat e tjera të pabotuara, mbi 20,000 vargje gjithsej, janë “*Jeta e Shën Mërisë*”, 1896, me 1720 vargje; “*Të vdekurit*”, 1896; “*Monografi i Shën Nilit*” dhe një komedi me 3500 vargje Don Kishoti, 1908. Në të gjallë, Bilota botoi vetëm dy përmbledhje modeste me poezi shqipe: “*Versi lugubri*” (“*Vargje të zymtë*”) Kastrovillari, 1894, që përmban rreth dyzet sonete elegjiake me përkthim në italisht, dhe “*Stima agli ottimi, biasimo ai tristi*” (“*Nder të mirëve dhe sharje të ligjve*”) Kastrovillari, 1898, një përmbledhje e vogël kushtuar Pjetër Buljarit (Pietro Bugliari), që përmban edhe disa përkthime në italishte.

Bilota lëvroi edhe temën shumë të dashur në letërsinë shqipe, atë të Skënderbeut, me poemën epike popullore me 10,000 vargje “*Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë*”, Tiranë, 1967. Kjo poemë historike në 13 këngë plot patos heroik, u nis më 1874 e përfundoi më 1890, dhe është me interes të veçantë për shqiptarët në kontekstin e zgjimit kombëtar në gjysmën e dytë të shekullit të

nëntëmbëdhjetë. Si në të tjerat, edhe në këtë vepër, Bilota shfaqet si shkrimtar që të habit me forcën e tij imagjinuese, të ndezur me vrull dhe entuziazëm patriotik, por pa ndonjë talent letrar e stil të spikatur. Skenave të zgjatura me përshkrime betejash në “Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë” u mungon dukshëm dramaticiteti, kurse vepra e tij në përgjithësi është pak e përpunuar. Ajo që duhet nënvizuar është merita që ka Bilota në përdorimin e gjuhës amtare, për herë të parë në një gamë aq të gjerë temash, duke i hapur kështu horizonte idiomës fshatare të arbëreshëve.⁹⁰

Bilota u diplomua si mësues i shkollës fillore dhe dha mësimë në shkollat e Frasnitës deri në 1873, kur zëvendësoi At Mikele Bellushin si pastor i Frasnitës. Mbështeti De Radën ekonomikisht për shpërndarjen e gazetës “Fjamuri i Arbërit”. Shkroi vjersha në gjuhën arbëreshe, ishte arsimdashës dhe atdhetar. Më 4 maj 1886 i shkruan De Radës se ka ardhur koha për të luftuar hapur kundër Turqisë dhe shtonte se: *“Për rilindjen e popujve të shtypur në luftën paqësore kundër tiranëve të tyre, duhet ringjallur ndjenja e atdhedashurisë nëpërmjet gjuhës dhe penës”*.

Botoi shumë libra, por në dialektin e tij. Më 1894 botoi librin “Vjersha të Përllipem”. Gjuhën shqipe e quante “Hyjnore”. Në italisht ai shkroi shumë vepra filologjike mbi gjuhën shqipe, dhe i botoi ato nga 1893 deri më 1915. Më 9 gusht 1898, Akademia Kombëtare Italiane e Shkencës, Letërsisë dhe Arteve, me qendër në Firence, e nderoi Bilotën me një diplomë të bashkëpunëtorit të përhershëm. Diploma të ngjashme iu dha nga Akademia “Leonardo Da Vinçi”, me qendër në Tortona, dhe nga Akademia Ndërkombëtare në Napoli.

Ai ishte gjithashtu anëtar i komitetit organizator të Kongresit Gjuhësor Shqiptar, në Koriliano, ku mori pjesë në tetor 1895, së bashku me patriotët De Rada, Argondizza, Camodeca, Ribeco, Lorecchio dhe të tjerët. Në atë takim të intelektualëve, Bilota prezantoi, me një fjalim në shqip, alfabetin e gjuhës shqipe, të cilën ai e përdori në shkrimet e tij: ishte alfabeti që Bilota përdori edhe

⁹⁰ Po aty, fq. 154.

në veprën “Shpata dhe Skënderbekut ndë Dibret Poshtë” (“Shpata e Skënderbeut në Dibrën e Ulët”). Në një poezi shqipe, të cilën e lexoi në atë Kongres, ai u bëri thirrje pjesëmarrësve: “Kini kujdes në studimin, të folurit dhe shkrimin mirë të kësaj gjuhe, ku ju e paraqisni në mesin e gjuhëve të botës, rekomandojani intelektualëve të huaj që ta vlerësojnë atë, sepse është unike “.

Vorea Ujko (1918–1989) është pseudonimi letrar i Domenico Bellizzit, poet arbëresh. Lindi në Frasnitë. Kreu studime teologjike dhe letrare. Shërbeu si klerik dhe mësues i letërsisë në Firmë të Kalabrisë. Poet lirik, ai krijoi një poezi që dallohet për pasuri e larmi tematike, për frymëzim të vetvetishëm dhe bukurinë e fjalës amtare; ajo u bë pasqyrë e jetës dhe e psikologjisë arbëreshe.

Vorea Ujko u dallua si mjeshtër i metaforës. Arbërishtja e tij u afrua në shkallë të lartë me gjuhën letrare. Poezia e tij e botuar në disa vëllime në vitet ‘70–‘80 shënon një stad të ri në letërsinë moderne arbëreshe (“Zgjimet e gjakut”, 1971; “Kosovë”, 1973; “Mote moderne”, 1976; “Ankth”, 1979; “Stinët e mia”, 1980; “Këngë arbëreshe”, 1983; “Burimi”, 1985; “Hapma derën, zonja mëmë”, 1990). Vorea Ujko ka qenë njëri nga drejtuesit e revistës “Zëri i Arbëreshëve” dhe bashkëpunëtor aktiv i shtypit arbëresh, ku botoi artikuj mbi folklorin, letërsinë, artin. Vizitat në Shqipëri e Kosovë i dhanë impuls të ri krijimtarisë së tij. I përkthyer në disa gjuhë, ai përfaqëson poezinë arbëreshe në botime dhe antologji të ndryshme. Humbi jetën aksidentalisht më 1989.

Françesko Solano (Francesco Solano)

Françesko Solano (1914–1999) është gjuhëtar e shkrimtar arbëresh, i njohur edhe me pseudonimin Dushko Vetmo. Lindi në Frasnitë (Frascineto) të Kalabrisë. Ndoqi studimet e larta për teologji në Itali dhe në Argjentinë. Shërbeu si famullitar për shumë vjet në Frasnitë dhe iu përkushtua njohjes dhe studimit të gjuhës, kulturës dhe letërsisë arbëreshe. Në vitin 1975 themeloi katedrën e gjuhës shqipe e më pas dhe atë të dialekteve arbëreshe në Universitetin e Kalabrisë (Rende) dhe drejtoi atje për disa vjet Departamentin e

Gjuhësisë. Lidhi marrëdhënie të ngushta shkencore e mësimore me universitetet e institucionet shkencore të Shqipërisë e Kosovës dhe me albanologë të vendeve të tjera. Solano botoi një varg studimesh rreth dialekteve dhe veprave të traditës letrare arbëreshe, si: “Belushi apo De Rada? - Vështrim mbi një dorëshkrim këngësh arbëreshe” (1966), “Vinçenc Dorsa dhe përkthimi i ungjillit të Vangjelit në të folmen arbëreshe të Frasnitës” (1975), “Il Catechismo Albanese di San Basile” 1983 (“Katekizmi arbëresh i Shën Vasilit”), botimi filologjik i tri veprave të F. A. Santorit: “Këngëtorja arbëreshe” (1974), “Alessio Dukagjino” (1983) dhe dramës “Emira” (1984). Botoi një numër studimesh dialektologjike me rëndësi, si: “I dialetti albanesi d’Italia meridionale. I. Appunti per una classificazione” (1979), “Le parlate albanesi di S. Basile e Plataci” (1979), “La parlata albanese di Firmo” (1983). Përkrahu mësimin e shqipes letrare në mjedisin arbëresh dhe lidhjet kulturore me mëmëdheun si i vetmi mjet për mbijetesën dhe zhvillimin e traditave kulturore arbëreshe. Botoi për këtë qëllim “Manuale di lingua albanese” (1972, rishtypur 1988) dhe “Guida alla conversazione albanese” (1975).

Si poet, prozator e dramaturg, i njohur me pseudonimet *Paullò Illyrico* e *Dushko Vetmo*, ka botuar një varg veprash letrare: përmbledhjet me vjersha “Bubuqe t’ egra” (1946) dhe “Te praku” (1977) dhe shkrimet në prozë: “Lalë Ndreu nuk thotë përralla”, (1957), “Tregimet e lëmit” (1975), “Vjeshtë e thatë”; novelat “Bijtë e Dodonës”, “Dhaskal Mitri”; romanin “Akullnajat” dhe dramat “E po hëna” (1963) dhe “Shkretëtira prej guri” (1974).

Antonio Belushi (Papa Antonio Bellusci)

Papa Antonio Bellusci (1934) është studiues arbëresh i kulturës popullore dhe klerik. Lindi në Frasnitë (Frascineto) të krahinës së Kozencës (Kalabri). Kreu studimet për filozofi dhe teologji në Universitetin Pontifik Gregorian të Romës (1962). Shërbeu si famullitar në fshatrat arbëreshe Shën Kostandin (1965–1973) e Fallkunarë (1973–1979) dhe në kishat arbëreshe në Kozencë (1979–2000) e në Kastrovilari (prej vitit 2000). Ka botuar: “Canti sacri

tradicionali albanesi”, 1971 (“Këngë fetare arbëreshe”); “Argalia ndër tekstet origjinale arbëreshe”, Kozencë, 1977; “Magia, miti e credenze popolari”, Kozencë, 1983 (“Magji, mite dhe besime popullore”); “Dizionario fraseologico degli Albanesi d’Italia e di Grecia”, 1989 (“Fjalor frazeologjik i Arbëreshëve të Italisë dhe të Greqisë”); “La pastorizia - Ricerca etnografia tra gli albanesi di Frascineto”, Kozencë, 1991 (“Blegtoria - hulumtim etnografik te Arbëreshët e Frasinës”); “Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Helladhës” (I, 1994, II, 2005), “Antologjia Arbëreshe” (Kozencë, 2003), si edhe një varg artikujsh studimorë. Themeloi dhe drejtoi revistën e parë arbëreshe në krahinën e Bazilikatës “Vatra jonë” (1966–1970). Në vitin 1980 themeloi revistën periodike “Lidhja”, organ i Shoqatës kulturore-shoqërore “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu”.

Arkimandri Emanuele Giordano

Emanuele Xhordano (Emanuele Giordano) lindi në Frascineto në vitin 1920, ku edhe ndoqi shkollën fillore. Më pas vijoi shkollën e mesme në Benedikti XV Grottaferrata (Romë) për filozofi dhe teologji. Giordano u kthye sërish në kishën e qytetit arbëresh në Lungro, ku kreu reforma të thella dhe ku në 1968 u vendos që mesha në kishë të mbahej në gjuhën shqipe.

Ai bashkëpunoi me revistën e Ernest Koliqit “Shejzat” dhe revistën “Zgjimi” e Albino Grecos. Në vitin 1963 publikoi “Fjalori i Arbëreshvet t’Italisë”, fjalor me 19 mijë fjalë e njësi leksikore. *Papa’Emanueli Giordano* thoshte: “t’ë shfletosh dhe t’ë studiosh këtë ‘Fjalor’, për çdo Arbëresh, do të jetë kënaqësi në rikthim të rrënjëve, sepse do t’i gjejë në fjalë dhe shprehje tipike të të folmeve të horëve të veta... Dua nanë të shpresoj se të gjithë Arbëreshët të Italisë – gjithasajtën të ndodhen – të ndiejnë ‘dëtyrën’ t’ë dashurojnë gluhën e tyre. E t’ë studiojnë, t’ë flasin e t’ia mësojnë bijvet të tyre. Përherë e gjithasajtën”.

Në vitin 1972, drejtoi revistën kulturore “Zëri i Arbëreshvet” (La voce degli Albanesi d’Italia) dhe në vitin 2000, botoi “Alfabetizzazione Arbëreshe” (“Shkrimi dhe leximi Arbëresh”), libër që u shpërnda falas për të gjithë fëmijët arbëreshë të Italisë.

Benjamin Frashini (Beniamin Frascini) ishte poet dhe prift nga Frasnita (*Frascineto*) në krahinën e Kozencës. Ishte autor i një poeme të gjatë, por që nuk ngjalli shumë interes. Poema trajton ngjarjet e vitit 1807, kur trupat frënge shkretuan krahinën. Kjo vepër me 168 strofa, me titullin italisht “*I Francesi in Frascineto-Porcile nel 1807. Triste conseguenze delle discordie degli abitanti, divisi in Giacobini, partigiani de’ Francesi, e Realisti, devoti al Re Ferdinando IV di Borbone*”. (“Francezët në Frasnitë-Purçill më 1807. Rrjedhojat trishtuese të mosmarrëveshjeve midis banorëve të ndarë në Jakobinë, partizanë të francezëve dhe ruajalistë, besnikë të mbretit burbon Ferdinand IV”), u kopjua më 1900 nga profesor Domeniko Manjeli (*Domenico Magnelli*) dhe u zbulua në një nga dorëshkrimet e tij më 1960. Një poemë e dytë historike në shqipe që flet për pushtimin francez në atë periudhë është shkruar nga Kostantino Askuri (Costantino Ascuro, 1810-1871) nga Ejanina (*Eianina*), student në Kolegjin e Shën Mitrit. Ajo ndodhet në një dorëshkrim të titulluar thjesht *Kënka* (Kënga), që mban datën 1834.

Akil Parapunja (Achille Parapugna, 1855-1883), të cilit De Rada i parashikoi një të ardhme të madhe si poet, vdiq para kohe më 16 mars 1883, duke mos lënë veçse disa këngë në dialektin e tij vendës të Ejaninës.

Papas Giuseppe Ferrari (1913-1990). Docent i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Barit. Autor i përmbledhjeve dhe këngëve arbëreshe dhe krijimit të një gramatike.

Papas Domenico Magnelli (1864-1931). Prifti dhe studiuesi, që mori pjesë aktive në Kongresin Gjuhësor Shqiptar, i cili u mbajt në “Corigliano Calabro” nga 1 deri më 3 tetor 1895 dhe në Kongresin e mëvonshëm shqiptar të Lungro, të mbajtur në 20-21 shkurt 1897.

Papas Vincenzo Selvaggi (1932-2006). Dijetari i liturgjisë bizantine dhe folklorist italo-shqiptar, me mbledhje të folklorit arbëresh – “Parambote mbrojtoqe”, vepër që përcjell një dëshmi të mrekullueshme të trashëgimisë gojore të arbëreshëve.

Andrea Kroçia (Andrea Croccia, 1899-1967)

Djali i Angelo dhe Domenica Durante, i lindur në Civita, më 2 maj të vitit 1899, banor i Frashinetos. Ishte një ish-luftëtar, anarkist-komunist dhe një nga njerëzit, që jetoi dhe punoi kundër regjimit fashist, jo vetëm në Frashineto, por edhe në nivel kombëtar. Në moshën 18-vjeçare ai u thirr në Monte Grappa dhe pas torturave, ngeli i gjymtuar me dy këmbët. Më 1921, themeloi seksionin komunist të Frasnitës. Vdiq në Frashineto në 1967.

4.1.4. Eianina (Purçilli)

E vendosur në shpatet e Timpone del Corvo, në 486 metra mbi nivelin e detit, ajo është një nga më të mirat bashkësi të rajonit, që ka trashëguar gjuhën, traditën dhe kulturën greko-shqiptare. Edhe sot, Eianina është e lidhur thellë me origjinën.

Emigrantët shqiptarë që themeluan Eianina-n (Ejaninën), ose siç e kanë emërtuar fillimisht arbëreshët *Purçilli*, mbërritën në Kalabri më 1470, dhe u vendosën në territorin aktual më 1491. Asnjë historian nuk raporton nëse Purçilli ishte i banuar para ardhjes së arbëreshëve.

Purçilli është një fshat i vogël “dy hapa larg” nga Frashineto, i quajtur fillimisht “Porticilli”, nga i cili rrjedh edhe emri “Porcile”. Emri u ndryshua në vitin 1938 në “Eianina”, sipas lumit të afërt



Eiano (Ejanë). Regjistri i të pagëzuarve fillon në vitin 1703. Mbiemrat më të zakonshëm me origjinë shqiptare janë: Barci, Bellusci, Bilota, Buscia, Ferraro, Gugliemo, Marino, Mastrotta, Pace, Zaccaro.

Besimi dhe riti

Arbëreshët e Purçillit i përkasin ritit bizantin. Kisha e vetme i kushtohet Shën Bazilit të Madh (Qisha e Shën Vasilit të Madhërimit), e ndërtuar në shek. XVIII, e stilit barok, me një fqinj të vetëm. Kisha e San Basilio Magno.

Në qendrën e vogël të Purçillit, kisha baroke është e orientuar drejt lindjes, sipas zakonit të ritit bizantin. Ajo daton nga shekulli XVIII dhe karakterizohet nga kubeja gjashtëkëndore, fasada trepalëshe dhe mozaiku që përshkruan S. Basili, në fasadën e portalit të krijuar nga Josif Dubrovniku. Ikonostasi dhe altari i stilit bizantin u ngritën në vitin 1947 dhe u zbukuruan më vonë me ikona të krijuara nga piktori i Kretës, Nikos Ianakakis, si dhe nga piktorët Rikardo Turra dhe Josif Dubrovniku.

Figura të shquara të Purçillit

Akile Parapunja (Achille Parapugna, 1855-1883)

Ai studioi në Kolegjin italo-shqiptar të Shën Mitrit të Koronës (San Demetrio Corone). I talentuar, me një inteligjencë të madhe dhe kulturë të gjerë letrare, ai u bë i njohur për kombin italian dhe për letërsinë italo-shqiptare. Jeronim De Rada ia vlerësoi vargjet. Papapugna vdiq shumë i ri, në moshën 28 vjeç, i prekur nga një sëmundje e pashërueshme.

Poetët

Lluka Perone (Luca Perrone, 1920-1984)

Lluka Perone ishte mësues i gjuhës dhe i letërsisë frënge. Ai lindi në katundin arbëresh Ejaninë, në krahinën e Kalabrisë, më 1920. Kreu studimet e larta për drejtësi dhe për gjuhë frënge. Punoi për një kohë si profesor i gjuhës dhe i letërsisë frënge. Deri në fund të jetës mbeti një nga intelektualët arbëreshë më aktivë. Ishte mbledhës,

studiues dhe botues i zellshëm i folklorit arbëresh, duke pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me Institutin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Universitetit të Romës, që drejtohej prej shumë vitesh nga Ernest Koliqi.

Botoi vëllimin me përralla të mbledhura arbëreshe “Novelstika italo-arbëreshe”. Nëpër vite të ndryshme, ka botuar disa libra me poezi si: “Lule Shkëmbi”, “Dërrudhëz”, “Vjershë lirie”, “Thierja e armit”, si dhe i një libri voluminoz dygjuhësh me titull “*Novellistica italo-albanese*”, Firenze, 1967. Malli për atdheun e humbur është temë qendrore e poezisë së tij.

Gjithashtu, studime e poezi botoi edhe në revistën e njohur letraro-kulturore Shêzjat, e cila botohej në Itali.

Lluka Miranda (Luca Miranda, 1852-1936). Ishte poet i njohur shumë popullor. Ende sot, shumë vargje të tij recitohen dhe këndohen nga njerëzit.

Agostino Xhordano (Agostino Giordano), nipi dhe trashëgimtari shpirtëror i arkimandritit Emanuele Giordano. Është drejtor i



revistës “Jeta Arbëreshe”, e cila mban gjallë gjuhën arbëreshe. Ai është studiues i pasionuar i letërsisë dhe i gjuhës arbëreshe, si dhe poet i talentuar. Shumë poezi të tij janë botuar me pseudonimin “Buzëdhelpr”.

Vincenzo Pace, protagonist i luftës për bashkimin e Italisë.

4.1.5. *Civita (Çifti)*

Civita (Çivita), ose arbërisht Çifti, është një qytezë e bukur malore, e cila shtrihet në rrëzë të masivit Pollino. Arkitektura është tipike arbëreshe. Në krah të majtë të saj ngrihen madhështorë, si një fortesë, shkëmbinjtë. Kjo është një nga pjesët më të virgjëra dhe më të egra të relievit të Parkut Kombëtar Pollino. Sapo futesh në qytezë, në krahë të majtë, është busti i Skënderbeut.

Të hënave, në sheshin kryesor, bëhet pazari javor, ku gjen tregtarët me prodhimet e tyre. Në shesh ndodhet një shatërvan që arbëreshët e quajnë “Kroi”.

“Ura e Djallit”, me një hark të vetëm, në një lartësi 260 metra mbi Raganello, është një punë inxhinierike e guximshme dhe një pikë strategjike vëzhgimi. Krijimi daton në vitin 1500 dhe lidhet me një legjendë. Ndërtimi i saj hyn në një nga ato veprat inxhinierike nga më të vështirat, të ashtuquajtura “vepra të pamundura”.

Pamja është mbresëlënëse dhe me reliev të thyer. Në lindje shtrihet Pllaja e Sibarit, prej nga ku zbarkuan arbëreshët. Nga lart duket sikur çdo gjë e shikon në pëllëmbë të dorës. E veçanta e urbanistikës së kësaj qyteze është se nuk ka rrugë tjetër. Kjo është rruga e vetme lidhëse. Në një kënd të këtij ballkoni “Belvedere”, ngrihet busti i Pal Engjëllit (këshilltari i Gjergj Kastriotit, 1417-1470), dhuratë e shoqatës shqiptare me të njëjtin emër për arbëreshët e Çiftit, nën drejtimin e zotit Ilirjan Celibashi.

San Procopio

Ky lokacion nuk ekziston më, por Domenico Zangari flet për të, në librin e tij “Kolonitë shqiptare italiane të Kalabrisë - Histori dhe demografi”⁹¹, ku thuhej se ishte rreth 27 km larg Çiftit dhe, në vitin 1543, kishte 89 banorë shqiptarë.

4 Maji

Në Mbretërinë e Dy Sicilive ishin caktuar tri ditë gjatë vitit për të paguar pagën e punëtorëve. Ato ishin 4 shtatori, 4 janari dhe 4 maji, kjo e fundit ishte edhe dita për të paguar taksat e qirave të shtëpisë. Shumë arbëreshë nuk kishin mundësi të paguanin taksën e kasolleve që kishin ndërtuar gjatë dimrit. Kështu, në maj, duke qenë pranverë, u vinin flakën kasolleve (banesave) për të rezultuar pa shtëpi dhe në këtë mënyrë, shmangnin edhe pagesën. Në Çivita, në datën 4 maj festohet Dita e Zjarrit.

Riti i zjarreve

Tri ditët e para të majit, sapo të ketë rënë muzgu i mbrëmjes dhe deri në agim, nga të gjitha lagjet e Çiftit pranë luginës së qetë të Raganello-s, ngrihen këto zjarre dhe ndihet krisja e lehtë e drurëve të dushkut, që rritet me shumicë në Pollino. Është një traditë me rrënjë të thella, e trashëguar brez pas brezi, për më shumë se 500 vjet. Ky rit arbëror bëhet vetëm në Çifti.

Tradita gojore popullore shprehet se ndriçimi i zjarreve është i lidhur me ngjarje të ndryshme, të tilla si:

- 1) për të nderuar pranverën që vjen;
- 2) Skënderbeu përdori zjarret, si sinjale tymi kur luftoi kundër turqve;
- 3) si simbol ngrohje, por edhe për të plehëruar fushat.

Urbanistika e Çiftit

Zona e banuar e Çiftit përbëhet nga tre rrethe kryesore: Sant’Antonio, Piazza, Magazzeno. Ka një bashkim kompakt, por

⁹¹ Shih për më gjerë: Domenico Zangari, *Le colonie italo-albanezi di Calabria, Storia e Demografia sec XV-XIX*, Napoli: Casella, 1941.

të parregullt. Arkitektura urbanistike e Çiftit pasqyron së pari, zakonet e jetës që vijnë nga emigracioni dhe, më pas, kolonizimi, si dhe shprehen në forma solidariteti, që i kanë lejuar këtij populli, në më shumë se pesë shekuj, të ruajë identitetin, gjuhën, zakonet, traditat, por mbi të gjitha mjedisin.

Shtëpitë në qendrën historike të Çiftit janë të gjitha të ndërtuara me gurë nga shqiptarët e parë. Burimet historike tregojnë se shtëpitë e para ishin prej kashte dhe digjeshin në pranverë, në mënyrë që të mos paguanin taksa. Në të njëjtën kohë ishin të ndaluar të ndërtonin muraturë, kështu që shtëpitë prej qerpiçi me degë të thata dhe baltë, që quheshin “*kallazine*”, ishin vetëm stinore. Më vonë, me kapitullimet (marrëveshjet) u ndërtuan shtëpitë e para me gurë. Që të gjitha kishin vatër dhe oxhak, ballkon “lloxhe” dhe furriqet në katin e parë të shtëpisë, ku mbanin kafshët, derrat dhe pulat. Më shumë sesa ripopullim, flitet për një rindërtim të vërtetë të strukturës paraekzistuese, ku është futur koncepti shoqëror i hapësirës, territorit dhe shtëpisë, i cili në kulturën shqiptare është përmbledhur me termin *gjitonia*.

Shtëpitë “Kodra”

Të ashtuquajtura shtëpitë “Kodra” janë në kujtim të artistit shqiptar, Ibrahim Kodra, i cili duke vizituar Çiftin, i portretizoi ato, duke i bërë elemente të pikturës së tij. Shtatë shtëpitë dallohen prej të tjerave nga morfologjia interesante, që propozon tiparet e një fytyre njerëzore. Këto shtëpi, që flasin me linjat e tyre, tregojnë epokën dhe i bëjnë ato mure autentike. Mjafton të zberthesh heshtjen e tyre, që të përcjellin në një vend sa luftëtar, aq edhe paqësor.

Arkitektura dhe antropologjia takohen për të lartësuar veten

Duke vizituar qytetin e Çiftit dhe duke hedhur shikimin lart, në çatitë e shtëpive të qendrës historike, do të shihni se oxhaqet kanë diçka që shkon përtej funksionalitetit të thjeshtë praktik. Këto “mushkëri” të shtëpive janë kthyer në një objekt arti, të cilat admirohen nga historianët e kulturës arbëreshe.

Oxhaqet e Çiftit janë krijesa prej guri, të lindura kryesisht midis

shkujve XVIII dhe XIX nga popullsia arbëreshe. Arkitektura e tyre u trashëguar nga emigrantët shqiptarë, të cilët mbërritën në Venecia dhe dinin të dekoronin dhe personalizonin oxhaqet. Këto oxhaqe janë edhe një shenjë se si qyteti arbëresh dëshironte të shquhej përmes formës së tij të brendshme dhe origjinale të inxhinierisë dhe artit. Furrat e përbashkëta, krijojnë ndjesinë e gjitonisë.

Krojet e Çiftit

Karakteristike janë burimet e ndërtuara në gur vendas, ngjyrë gri. Të gjitha datojnë që nga vitet 1800. Burimet e qytetit kanë pasur rëndësi të madhe në të kaluarën, si një vend socializimi, ato përbënin shtrirjen e gjitonisë. Ndërsa “*lavanderia*” ishte vendi ku gratë mbushnin ujë, bisedonin dhe lanin teshat.

“*Castello di San Mauro*” është një kompleks arkitektonik rural në zonën e Cantinella-s, në fshatin Koriliano, në komunën e Corigliano-Rossano. Pavarësisht se nuk është i mirëmbajtur, pothuajse i rrënuar, këto mure lidhen edhe me historikun e Irina Kastriotit, që gjatë viteve 1539 ishte pronë e bashkëshortit të saj, Pietro Antonio.

Më 1535, Pietro Antonio priti perandorin Charles V në kthimin e tij nga Tunizi. Ai vetë u mahnit nga pritja e madhe dhe me shaka tha frazën e famshme: “Vos es el Rey, apo el Prence de Bisignano?” (A jeni ju mbreti, apo princi i Bisignano?). Princi në atë kohë ishte i martuar me Xhulia Orsinin (Giulia Orsini-n), një grua e bukur, e dhënë pas kënaqësive dhe jetës së shfrenuar. Giulia u largua nga skena, thuhet se ajo u helmua apo e burgosën në manastir dhe vendin e saj në talamusin bashkëshortor e zuri më 1539, Irina Kastrioti (Irene Castriota Scanderberg).

Më 1650, kompleksi *Castello di San Mauro* u ble nga duka Saluzzo. Sot, kështjella e San Mauro-s është pronë private.

Riprodhimi i kalasë së Krujës

Me shumë rëndësi është riprodhimi i kalasë së Krujës në Shqipëri, e ndërtuar në vitin 2000. Sot është një qendër kongresesh, me një pamje të mrekullueshme të Raganello-s. Brenda mund të vizitoni

galerinë e artit, në të cilën gjenden piktura që përfaqësojnë Çiftin dhe grupin etnik arbëresh. Gjithashtu, në këtë qytezë të bukur, të pret dhe të përcjellë busti i Skënderbeut.

Arsenali i Venecias (Arsenale di Venezia)

Venecia është një bibliotekë, tashmë e njohur për shqiptarët, për ruajtjen e tekstit të çmuar të “*Statuteve të Shkodrës*”. Sidoqoftë, midis këtyre kartave, ekziston një listë që lidhet me armët dhe armaturën e figurave të ndritura, të lidhura me historinë e Republikës së Serenissima-s, që me kalimin e shekujve ishte ruajtur në Arsenalin e Venecias.

Irina Kastrioti Skënderbeg

Irina, ose Irene Castriota Scanderbeg (Irena), ishte mbesa e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, dukeshë e San Pietro-s në Galatina, konteshë e Soletto-s dhe princeshë e Bisignano-s.

Irina Kastrioti u martua në vitin 1539 me Pietrantonio Sanverino, Princi i 4-t i Bisignano-s, i cili vdiq në Paris më 1559. Nga martesat e tyre lindën dy fëmijë: Niccolò Bernardino Sanseverino, Princi i Bisignano, nga 1541-1606, dhe Vittoria Sanseverino. Irina Kastrioti vdiq më 15 shtator 1565. Testamenti i vdekjes së Donna Erina Scanderbeg “*Testamentu nuncupatium Ill.ma Donne Herina Scanderbech Castriota principissa Bisiniani*”, u gjet nga autori i këtij libri (Antonio Bellushi) në Arkivin e Shtetit të Kozencës, Seksioni i Castrovillari-t, më 1996. Vepra në fjalë është marrë nga protokollet e “Noter Virginio Carpino di Taverna” dhe i referohet vitit 1565, 15 gusht (k. 210r-213r).

Me vdekjen e princit, meqë djali i saj ishte në moshë të vogël, Irina qeverisi pronat, pasurinë e Sanseverino di Bisignano-s, trashëgoi titujt dhe çifligjet e kastriotëve, veprimi si një princeshë e Bisignano-s dhe si ndërmjetëse e rëndësishme midis kulturës arbërore dhe asaj të vendit pritës.

Irina, pasardhëse e trungut të Skënderbeut, është një figurë madhështore dhe e virtytshme, princeshë fisnike, në modelin e saj, e pakrahasueshme, e cila i shtoi karakterit të saj edhe një shkallë

sipërore të devotshmërisë. Një pjesë të jetës, princesha ia kushtoi të varfërve, me humanizmin magjepsës dhe mbi të gjitha, me zotësinë e saj dhe me instinktin e një gruaje, por edhe të ndërgjegjes arbërore.

Stema e Irina Kastriotit

Në sallat e Pallatit Dukal të Tricarico është një stemë e gdhendur në gur, stema e Erina (ose Irina) Castriota Scanderbeg. Në këto qendra, në fakt, prania e shqiptarëve, e dokumentuar që nga gjysma e dytë e shekullit XV, ishte rritur për shkak të politikës së mirëpritjes së valëve migratore të kërkuara nga Karli V dhe tendencës së këtyre emigrantëve për të ardhur në këto zona.

Kuriozitet - Rrënojat e Manastirit të Colloredo-s (1546)

Jo shumë larg nga Frashineto, midis Moranos, ndodhen rrënojat e Manastirit *Colloredo*. Është një vend shumë i bukur, pavarësisht se çdo gjë është tashmë është kthyer në rrënojë. Me gjithë dy shekuj neglizhence, është ende atje i zhytur në natyrë, lehtësisht i arritshëm...

Thuhej se Irina kërkonte të bënte një fëmijë dhe lutej këtu te ky manastir. Shumë shpejt mbeti shtatzënë dhe lindi Nikola Bernardinon (1551-1606), trashëgimtari i fundit i Sanseverino-s. Që nga ajo kohë, ajo u bë bamirëse e këtij manastiri.

Giorgio Paleologo Assan

Giorgio Paleologo ishte një gjeneral bizantin, i cili i përkiste familjes fisnike bizantine të Paleologëve, që mbajti fronin e Perandorisë Bizantine nga viti 1259 deri më 1453. Ishte një nga gjeneralët dhe përkrahësit më të rëndësishëm të Alessio I Comneno. Luajti rol shumë të rëndësishëm në fushatat e Alessio-s, veçanërisht në betejën e Durrësit (1081) kundër normanëve dhe në betejën e Levounion, kundër Peceneghi (1091).

Në një dokument të vitit 1487 thuhet që Giorgio Paleologo Assan-it, iu dha titulli “Signore”, me merita të mëdha “për ruajtjen e qetësisë së mbretërisë” për këtë arsye, mbreti Ferdinand i dha si koncesion fshatin Çifti.

Margherita Paleologa

Në veprën themelore për studimin e mesjetës arbërore, “Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi të Gjon Muzakës”, të shkruar në vitin 1510 dhe të botuar nga historiani Karl Hopf në “Chroniques gréco-romaines” (Paris 1873, fq. 270–340), lexojmë se: Angjelina Araniti, vajza e Gjergj Arianitit, e martuar me despotin serb, Stefan Brankoviç, pati një vajzë me emrin Maria, e cila u martua me Boniface Paleologu III, Markez i Montferrat. Nga kjo martesë patën së bashku dy fëmijë, William IX (1486-1518), markez i Montferrat, midis viteve 1494 dhe 1518, dhe John George (1488-1533). Markezi i fundit i Montferratit, midis viteve 1530 dhe 1533. William IX u martua me Anne of Alencon, fisnike franceze dhe patën së bashku tre fëmijë, një prej të cilave ishte Margherita Paleologa në dhomën e së cilës ndodhej vepra e Leonardo Da Vinçit. Margherita Paleologa (11 gusht 1510 në Casale Monferrato - 28 dhjetor 1566 në Mantua) ishte stërmbesa e Gjergj Arianitit dhe Maria Muzakës, një nga zonjat fisnike më të rëndësishme të Italisë. Vepra e Madonës me flokët e shpupuritura u porosit tek Leonardo Da Vinçi^{92*}, në vitin 1501, nga markezja Margherita Paleologa, e cila ishte martuar me Federico II Gonzaga, kryezotin e Mantovës.

Figurat e shquara

Kontandino Belushi (Costantino Bellusci) lindi në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Ai studioi në Kolegjin Grek të Romës dhe ishte kryepriфт në Lungro.

Daniel Mortati (Daniele Mortati) lindi në Çifti, në mesin e shekullit XVII. Edhe ai përfundoi studimet në Kolegjin Grek në Romë, ku u bë priфт, dhe kreu funksionin e kryepriфт në Çifti. Më 1650, ai ndërtoi Kishën e Frymës së Shenjtë, e cila ishte famullia e vetme e gjysmës së parë të 700. Vdiq në Çifti.

^{92*} Në një letër të vitit 1501, markezja Margherita Paleologa i drejtohej Pietro Novallara-s nëse Leonardo Da Vinçi mund të pikturonte një Madonë për studion e saj private.

Karlo Basta (*Carlo Basta*) lindi në vitin 1585 nga familja e shquar, Basta e Spezzano-s dhe emigroi në Çifti. Studioi në Kolegjin Grek të Romës. Jetoi në vendin e lindjes deri në ditët e fundit të jetës. Prej tij ka tri libra të shkruar në latinisht, të cilët ruhen në Bibliotekën Kombëtare të Napolit.

Kozmo Basta (*Cosmo Basta*) ishte djali i dytë i Karlo Bastës. Lindi në Spezzano. Mbaroi studimet në Salerno, ku u diplomua në fizikë në vitin 1644. Ai vdiq shumë i ri në Çifti, në vitin 1649. Shkroi në latinisht, librat e tij mbahen në Bibliotekën Kombëtare të Napolit.

Serafino Basta, letrar dhe historian. Autor i një përshkrimi të çmuar dhe të plotë të përdorimeve, zakoneve, demografisë dhe historisë së Çiftit, Lorenzo Giustiniane, i “Mbretëria e dy Sicilive e përshkruar dhe ilustruar”, lë një dëshmi mbi zakonet, demografinë, historinë e Çiftit që përfaqëson burimin më të plotë për komunitetin.

Xherardo Dorsa (*Gerardo Dorsa*) lindi në vitin 1872. Ishte autori i veprës me titull “Martirizmi dhe Besimi”, në të cilën ai flet në një mënyrë romantike për ngjarjet e vitit 1836.

Shkrimtari dhe poeti me kulturë klasike, shkroi dramën “*Agesilao Milano*”, në katër akte, 1916, dhe poezitë “*Raggi e Ombre*”, 1918.

Kostandino Mortati (*Costantino Mortati*), jurist. Lindi në Corigliano Calabro, 1891, nga Tommaso Civiltese dhe Maria Tamburi. Karriera e të atit si jurist, e zhvendosi familjen në qendra të mëdha. Kostantino kur ishte 7 vjeç ndodhej në Mesina, ku përjetoi një përvojë shumë të dhimbshme. Një tërmet i fortë goditi Mesina-n, ku humbi të motrën, plagosi babanë dhe preku thellësisht nënën e tij. Familja Mortati mbeti pa shtëpi. Babai u transferua në Gjykatën e Apelit të Catania-s dhe i riu Kostantino u dërgua për të përfunduar studimet e shkollës së mesme në Kolegjin Italo-Shqiptar të Shën Mitrit të Koronës (San Demetrio Corona).

Lufta e Parë Botërore e thirri edhe Konstantinon e ri për të dhënë shërbimin e tij. U regjistrua në ushtri, ku shërbeu si një toger i dytë

në zonën e Padovas. Pas kthimit në jetën civile u ngarkua me shumë detyra. Në vitin 1921 u martua me Ester Valentini-n, gjithashtu një vajzë kalabreze e një magjistrati.

Në vitin 1939 u transferua në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Macerata-s, pasi kishte kryer detyrat e drejtorit. U emërua rektor në periudhën dyvjeçare 1940-‘42. Më vonë, Mortati u transferua në selinë e institucionit të së drejtës publike në *Institutin Detar të Universitetit të Napolit*. Ndërsa po jepte mësimë në Napoli, Italia hyri në luftë. Pa mundur të arrinte në Napoli, ai mbeti në Romë dhe shërbeu për rezistencën në radhët e demokracisë. Pas çlirimit të Romës u zgjodh në qershor 1946 si deputet dhe ishte anëtar i komisionit kushtetues. U emërua gjyqtar kushtetues në 20 korrik 1960. Më 1972 u emërua nënkryetar i Gjykatës Kushtetuese, nga e cila ai pushoi së qeni anëtar, për shkak të skadimit të mandatit në dhjetor 1972. Megjithëse ai kishte kaluar prapun e tetëdhjetë viteve, nuk pushoi kurrë për të dhënë kontributin e tij.

Vdiq në 25 tetor 1985, në moshën 94 vjeç. Ishte një njeri i mirë dhe bujar, njohës i thellë i ligjit, mjeshtër i studentëve të mirë, një gjykatës i vëmendshëm, i cili i dha shumë Italisë, por nuk mori njohje të plotë.

Dhimitër Emanuele (Demetrio Emanuele). Punoi mësues i shkollës fillore në Çifti. Shkroi disa artikuj në revistën “Zgjimi” e më vonë vendosi të krijojë një revistë, “Katundi ynë”, organ i shoqatës kulturore “Gennaro Placco”. “Katundi ynë” filloi të publikojë tematika të ndryshme e përfshinte shumë të rinj, e në vijim filloi të zgjerohej dhe të botohej katër herë në vit.

Demetrio Emanuele krijoi edhe një muze interesant etnografik, që është aktiv dhe vizitohet nga mijëra arbëreshë dhe të huaj. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe të bijën, Stefania, e cila e mbështet nismën, edhe pse me shumë vështirësi vazhdon ta çojë më tej këtë mision, nëpërmjet revistës “Katundi ynë”, që shpërndahet në çdo skaj ku ka arbëreshë.

Xhenaro Plako (Gennaro Placco)

Në këtë fshat lindi një figurë e madhe, Xhenaro Plako (Gennaro Placco), i quajtur edhe “Luan i Arbërisë”. Është një figurë e ndritur e periudhës së Risorxhimentos, i cili së bashku me arbëreshët Ambrogio Albamonte, Domenico Albamonte, Giuseppe Alessandria, Francesco Baffi, Francesco Basti, Francesco e Nicola Cortese, Vincenzo Cozza, Giovanni Di Benedetto, Michelangelo Ferrari, Mercurio Mortati, Nicola Mortati, Nicola Pisano, Domenico Stamati, Domenico Zaccaro lanë shenjë të forta tek arbëreshët.

Në Muzeun e Çiftit, ku ndodhet edhe një foto, mësojmë shumë për historikun e kësaj figure.

Xhenaro Plako lindi në Çifti, në fshatin arbëresh, më 21 maj 1825. Babai i tij, Ludovico, ishte bujk, kurse nënën e tij, Marta, e humbi në moshën 16 vjeç. Luigi Settembrini shkruan mbi kujtimet e Gennaro-s për nënën e tij të sëmurë: “Nëna e varfër, sa shumë më donte dhe çfarë sëmundje mizore kaloi. E veshja, e merrja në krahë, e ktheja nga njëra anë në tjetrën në shtrat dhe vdiq në krahët e mi, duke më thirrur me emër dhe duke më bekuar”⁹³.

Shumë i ri, ai u dërgua për të studiuar në Kolegjin Italo-Shqiptar të “Sant’Adriano”, ku të rinjtë u edukuan nga mësues të shquar, të cilët iu referuan traditës kulturore të iluministëve napolitanë, reformistë dhe përparimtarë. Klima kulturore dhe politike e Kolegjit Italo-Shqiptar, pa dyshim, ushtroi një ndikim të madh në formimin e personalitetit të Placco-s, i cili pasi mbaroi studimet e shkollës së mesme u transferua në Castrovillari, për të ndërmarrë studimet juridike dhe noteriale, duke kundërshtuar edhe dëshirën e familjes, të cilët dëshironin të bëhej prift i ritit grek.

Xhenaro Plako iu bashkua më 1848 kauzës së Revolucionit Kalabrez kundër tiranisë burbone dhe në qershor të po këtij viti, me 17 bashkëqytetarë, luftoi me batalionin e komanduar nga arbëreshët Domenico Damis të Lungro, në Monte Sant’Angelo. Qëllimi ishte të parandalonin bashkimin e trupave të burbonëve me gjeneral Busacca me ato të Lanzës. Më 27 qershor gjatë asaj beteje,

⁹³ Luigi Settembrini, *Ricordanze della mia vita, Volume 1*, Morano, Torino 1944, f.157.

i plagosur, humb gishtin e dorës së djathtë dhe u mor i burgosur. Lidhur me atë ngjarje të trishtueshme, Settembrini shkruan: “Ai luftoi si trim, si një luan... hidhet i pari në sulm, përparon i vetëm, ai nuk dëgjon askënd që i bën thirrje për t’u tërhequr, lufton mes topave që fishkëllenin rreth tij ... Tani e shikon të shtrirë në tokë, pastaj pas një peme, i vetëm po përballet me pesëdhjetë armiq të zemëruar dhe të befasuar prej guximit të tij. Dy ushtarë nuk i shikon që e sulmojnë nga anash, një gisht i pritët dhe i fluturon në ajër, por ai nuk ndalet, arrin të kapë të dy bajonetat, edhe pse i çarmatosur dhe vendos të dy ushtarët pranë vetes që të mos vritet. Fërshëllejnë një mori armësh”.⁹⁴

Nga dënimi me vdekje, në burg të përjetshëm

Xhenaro Plako u arrestua në Castrovillari dhe më pas, u transferua në burgun famëkeq të Cosenza-s. Gjykata e Lartë Penale e Kalabrisë Citra, më 14 shtator 1849, i dha të riut Plako dënimin me vdekje. “Me sëpatën në qafë - shkruan Settembrini - në mes të vrasësve më mizorë dhe në burgun më të lig, nuk e dha veten dhe i qeshte kësaj vdekje”. Më 22 shkurt 1850, dënimi me vdekje u ndryshua në dënim me burgim të përjetshëm.

Në vitin 1852, familja Plako u përpoq ta nxirrte nga burgu Gennaro-n. Xhaxhai i tij, z. Domenico, i paraqiti Ferdinandi II, një kërkesë, të cilën mbreti nuk e mori në konsideratë. Xhenaroja i shkruan nga burgu xhaxhait: “I miri im dhe i nderuar xhaxha. Je një prind i dashur dhe i moshuar, u kujdese shumë për mua dhe më dhe jetën materiale, jetën morale dhe intelektuale. Ju ishit si një prind i dytë i dashur. Edhe pse ende i vogël, më çuat në Kolegjin e Shën Adrianos të Shën Mitrit, ku më mbyllët për 13 vjet. Mësova të shkruaj, jo me dorën e majtë, si po ju shkruaj tani, por me të djathtën time, sepse e kam dorën të gjymtuar. Por, edhe sikur të më duhej të lija kockat e mia këtu, nuk do të nënshkruaja një lutje kurrë atyre që shkaktuan këtë gjymtim. Unë shoh që është një veprim jobindës ky i imi, por unë jam ky! Ky është nderi im dhe, mbi këtë ideal, ka vetëm Zot dhe atdhe...”.

⁹⁴ Po aty, f. 221.

Khaxhai i tij, Domenico, nuk ndalet, por kërkon me çdo kusht të nxjerrë nipin nga burgu dhe merr një avokat, Cesare Mazzei, i cili përgatiti një kërkesë të re, e cila u refuzua nga Ferdinandi II, sepse Gennaro Placco nuk dëshironte ta nënshkruante atë, por megjithatë arriti ta ndryshonte dënimin e tij nga i burgosur politik, në internim të përjetshëm në Argjentinë.

Gjashtëdhjetë e gjashtë të dënuar politikë u zgjodhën për mërgim dhe në mesin e tyre Damis, Mauro, Bellantonio, Lamenza, Spaventa dhe Settembrini.

Më 2 korrik, Mbretëria e Napolit u shkatërrua. Xhenaro Plako u amnistua nga Francesco II. Ai u tërhoq në Çifti, ku nuk e gjeti më vëllain e ri, Graziano, të vranë, dhe veproi si një baba për dy nipërit e tij. Sapo mësoi se arbëreshi tjetër, Domenico Damis, një oficer në Shtabin e Përgjithshëm të Garibaldit, kishte mbërritur në Kalabri, ai dhe italianin Vincenzo Luci u bashkuan dhe shkuan për ta takuar. Më 2 tetor 1860, në Ponte della Valle në Caserta, si oficer i Batalionit të shqiptarëve luftoi me aq shumë vlerë, sa që vetë Damisi, në shkrimet e dërguara për Camillo Vaccaro, e konsideroi atë më shqiptarin nga të gjithë shqiptarët. Me Unitetin e Italisë, ai nuk kërkoi shpërblime dhe nderime, por u zhgënjye si shumë atdhetarë të tjerë të revolucionit “të padobishëm” të mbretit Savoyard, i cili kishte mbizotëruar mbi atë të popullit. Emigroi i trishtuar në Argjentinë, ku jepte mësim të pedagogjisë dhe gjuhës italiane. Pas kthimit në Çifti, në vitet e fundit të jetës mbajti detyrën e kryetarit të fshatit të tij të dashur. “Luani i Arbërisë” vdiq në Çifti, më 27 shkurt 1896.

Ja çfarë shkroi shoku i tij i qelisë në *Banjën Penale të San Stefanos*, Luigi Settembrini, në lidhje me figurën e Gennaro Placco-s në “Kujtimet e jetës sime”:

“Një djalë i ri i pashëm, një fytyrë greke, me sy shkëndijë, fliste me një theks të caktuar shqiptar, me atë shkronjën ‘RR’ siç e shqiptonte Alcibiade. Me një shpirt të freskët si një puhizë, me, dritën e zemrës, dhuratë e një të riu që lulëzon. I gjallë dhe poetike, një zemër shumë e ngrohtë dhe e palëkundur, ai e donte lirinë dhe ndjeu atë fuqi të panjohur që të bën të ngrohë zemrën peshë dhe mendjes i jep forcë

dhe ide. Ishte i thjeshtë në veprime, ndonjëherë i egër, si shqiptar dhe alpinist; por mua më pëlqente ajo ngurtësia, një shenjë e shpirtit të qëndrueshëm dhe mashkull. Ajo vendosmëria e tij kur ishte ‘Po’ dhe kur ishte ‘Jo’, pa ato arabeska hipokrizie që i quajmë buzëqeshje, pa ato fjalë të sjellshme që janë suvatuar mbi një mur të ngrirë; nën atë shpërthim të fortë, rrihte një zemër fisnike dhe bujare”.

4.1.6. San Cosmo Albanese (Strigari)

Fshati San Kozmo Albanese (San Cosmo Albanese) ose *Shën Kozmai*, të cilit sot arbëreshët i thonë *Strigari* shtrihet në drejtim të pllajës Sibati. Rruga është gjarpërushe, sa më shumë të zbresësh, i afrohesh një lumi me shtrat të gjerë, Raganelli. Ky lumë është i lidhur me festat e martesave të arbëreshëve. Shpesh nëpër dolli thohim: “Sa gurë ka Rrakanjelli, aq butë Muskatjelli (fuçitë me verë Moscato)”.

Arbëreshët këtu, jo vetëm u trajtuan si njerëz të dorës së dytë, por i bënë dhe të ndihen të tillë, sepse shteti mëmë kurrë nuk i ndihmoi. Arbëreshët dhanë më të mirën në ato vende ku u vendosën. Ata edhe pse u pranuan, në mbretërinë e Napolit falë madhësisë aragoneze



të Karlit V, i cili u erdhi në ndihmë, (për shkak të ndihmës që i kish dhënë dikur Skënderbeu) u përplasën me feudalët vendas, dhe më shumë se kushdo tjetër iu nënshtruan ashpërsive të feudalizmit, imponimit feudal dhe kishtar. Edhe pse të lodhur, të braktisur, të bindur që për ata s'kishte kthim prapa, arbëreshët filluan të hedhin themelet, për një ekzistencë, për një identitet, për t'u ndier të gjallë, si gjaku që iu vlonte në deje.

Përveshën mëngët, pastruan tokat shterpë, pastruan kodra të egra për të përmirësuar bujqësinë dhe bagëtinë; mbollën fiq, vreshta, ullishte dhe zhvilluan fillin e mëndafshit. E nisën me shtëpi prej qerpiçi dhe dalëngadalë filluan të ndërtonin shtëpi me gurë. Filluan të hedhin rrënjë dhe gradualisht u integruan në strukturën shoqërore, por sistemi feudal, duke parë ecurinë e tyre, u bë edhe më despotik dhe acarues.

Vendi “pritës” i përçmonte arbëreshët duke i thirrur “gjegje”. Por abëreshët, me shpirtin fisnik dhe mendjen e ndritur, ditën të integroheshin dhe në të njëjtën kohë, të ruanin identitetin e tyre.

Dokumenti më i vjetër (Bolla di Papa Urbano këtu) dëshmon për ekzistencën *Strigarit* që nga viti i largët 1089. Rreth shekullit XV, territori u popullua nga një koloni e mërgimtarëve shqiptarë, të udhëhequr nga një shqiptar që i thoshin *Strigari*. Vendbanimi monastik, i shenjtëruar te Shenjtorët Kozma dhe Damian, ishte nën varësinë e kishës së Shën Adrianos. Ky territor ishte pronë e principatës së Bisignano-s, që më pas, iu caktua Kastriotëve.

Në hyrje të fshatit ngrihet një kishë madhështore, e heshtur, me një shesh të gjerë përpara.

Sapo hyn brenda, përballë është altari dhe një mozaik i mrekullueshëm i qëndronte si kurorë. Në krah të majtë, statujat e dy mjekëve, Shën Kozmai dhe Shën Damiani, shkëlqejnë me ngjyrat e artit. Pas kishës vjen qendra e fshatit. Nëpër rrugica, “kalldrëmi” post-modern nuk e zbeh aspak lashtësinë e antikitetin e urbanistikës së “gjitonisë”, karakteristike për shtëpitë arbëreshe.

Arbëreshët e parë hodhën themelet në këtë atdhe të vogël që nuk ishte i tyre. Në një pllakë lexohet vargjet në shqip dhe italisht, të cilat kishin poshtë nënshkrimin e poetit të madh, Zef Serembe. Pllaka tregonte edhe se kjo ishte shtëpia, ku kish lindur Zef Serembe.

Pothuaj në të gjithë rrugicën ishin vendosur vargjet e Serembes. Ndihej shpirti i tij, që kalonte nga brishtësia, me të cilën i këndonte natyrës, te tërbimi dhe melankolia e një vetmitari.

Serembe i këndoi natyrës, njerëzve që emigruan, jetës që shuhej, por edhe vetes, dhe këtë e shfaqti në poezinë “Il mio ritrat” kur thotë: “Digjen nga melankolia sytë e mi, nëse do të dish t’i vështrosh”.

Në një cep, ku hapësira dhe horizonti është i dukshëm, prej këtej Serembe shikonte anijet që emigronin për në Brazil, ku shkroi edhe poezinë “Më e bukura e Strigarit”, të cilën ia dedikoi një vashëze me të cilin u dashurua, por vdiq pak ditë më vonë nga mbërritja e saj në Brazil. Serembe emigroi edhe vetë në Brazil, u end si një nomad, ndoshta donte të shkonte për tek varri i vazhëzës, me të cilën u dashurua.

Lidhja me Elena Gjickën (Dora D’Istria) bëri që t’i ofrohej një shërbim në pallatin mbretëror të Pedro II, por shpirti i Serembes nuk kërkonte mure oborrtare, shpirti i tij ishte i lirë, kështu kthehet në Marsiglia, ku për fat të keq e vjedhin dhe humb dorëshkrimet. Në “Sheshin e Lirisë” (“Piazza della Liberta”) është gdhendur busti i Serembes nga skulptori Odise Paskali.

Ky ishte Serembe, rebel dhe i ndjeshëm, që kishte dy stinë në shpirtin e tij, dimrin e egër dhe pranverën, por ishte edhe analist i ndërjegjes së tij, kur i shkruan zotit Kamarada:

“...Jam i zbardhur dhe i uritur. Më bënë të skuqem, për aventurat e mia që nuk kanë të sosur. Do të zhdukem si një meteor duke marrë hakun e të gjithë atyre që ishin shkatërrimtarë të jetës sime”.

Poezitë e tij kishin një larmi tematike. Ai shkroi vargje patriotike, si ajo për “Elena Gjickën”, apo për “Ali Pashë Tepelenën”. Mendimet e tij i hodhi edhe në sferën religjioze, si ajo e dy Shenjtorëve “Shën Kozmai e Shën Damiani”, apo poezia “E papërlyeme” (Immacolata).

Melankolia, optimizmi, romanticizmi, vetmia, rebelizmi dhe egërsia ndaj kësaj bote plot padrejtësi bëheshin si një buqetë që ajo rrugicë dhuronte me aromën ngjyer në shpirtin sa patriotik, aq

edhe vëzhgues i natyrës. Ky arbëresh ishte sa i perëndisë, aq edhe i universit.

Zef Serembe e Dora D'Istria

I obsesionuar nga kjo humbje dhe mendimi për gjetjen e varrit të së dashurës, Serembe u nis për në Brazil, në vitin 1874. Me ndihmën e një letre rekomandimi nga Dora D'Istria, ai u prit në oborrin e perandorit Pedro II, por, përkundër këtyre referencave të rëndësishme, ai u kthye në Europë i zhgënjyer. Në zbarkimin e tij në kontinentin e vjetër, në shtator 1875, ai u grabit dhe humbi të gjitha paratë, siç duket në portin e Marsejës dhe u detyrua të kthehej në Itali, në këmbë. Gjatë këtij udhëtimi, thuhet se humbi shumë dorëshkrime. Në Livorno, Demetrio Kamarda i bleu biletën e trenit për në Kozencë. I dëshpëruar dhe i rënduar nga ana psikologjike, ai u bë gjithnjë e më i pasigurt dhe i vetmuar. Mendja e tij gjeti strehë në ëndrrën për tokën e të parëve të tij, në vizionin e Shqipërisë në kohën e pushtimit osman dhe në indiferentizmin e fuqive perëndimore ndaj vuajtjeve të tij. Në këtë gjendje izolimi emocional, Italia iu duk gjithnjë e më shumë “dheu i huaj”, toka e huaj. Në vitin 1886, Serembe vizitoi komunitetet arbëreshe në Sicili dhe në 1893, udhëtoi për në Shtetet e Bashkuara, ku jetoi për dy vjet. Një vëllim i vargjeve të tij në italisht u botua gjithashtu në Nju Jork në 1895. Në 1897, emigroi përfundimisht nga Kalabria në Amerikën e Jugut, ku u përpoq të rindërtojë jetën në Buenos Aires. Një vit më pas, ai u sëmur dhe vdiq në 1901, në San Paolo.

Shumë prej veprave të Serembes (poemat dhe dramat), të cilat autori i rishikonte vazhdimisht, kanë humbur. Ndërsa ishte gjallë, botoi vetëm: “Poema italiane dhe këngë origjinale të përkthyer nga shqipja”, Kozencë, 1883 në italisht dhe arbërisht; “Ushtari veteran, balada lirike”, Nju Jork, 1895, (vetëm në italisht), si dhe “Sonete të ndryshme”, një koleksion i rrallë me 42 sonete në italisht, me një hyrje, të shtypur në vetëm katër faqe, me karaktere të vockla. Një prej poezive u shfaq edhe në revistën e Zef Skiroi, “Arbri i Rii”, 31 mars 1887. 39 poezitë e tij u botuan pas vdekjes në vëllimin “Vjersha”, Milano 1926, nga nipii i tij, Cosmo Serembe.

Punime të tjera janë gjetur në disa arkiva dhe dorëshkrime në vitet më të fundit dhe disa nga këto poema, janë dhënë me gojë midis banorëve të San Kozmos. Kjo konfirmon popullaritetin e arritur midis fshatarëve, përkundër faktit se ai jetoi larg vendit të lindjes. Vargjet e Serembes, melankolike në karakter, patriotike dhe idealiste në frymëzim, vlerësohen nga shumë njerëz si tekstet më të mira të shkruara ndonjëherë në shqip, të paktën para kohërave moderne.

Terenc Toçi (Terenzio Tocci)

Në një distancë jo të largët është pllaka kushtuar Terenc Toçit. Terenc Toçi lindi në një shtëpi të thjeshtë, në zemrën e Strigarit. Askush nuk duhet të harrojë ditën e 26 prillit 1911, kur ai organizoi një kuvend dhe një ditë më vonë, më 27 prill, pas kuvendit të mbajtur në Fan të Mirditës, nënshkruan me krerët shqiptarë në Kimzë, dokumentin me të cilin shpallnin krijimin e një qeverie të përkohshme, të kryesuar prej Terenc Toçit.

Në kuvendin e Fanit u deklarua për një Shqipëri të lirë dhe e pavarur, e cila do të vinte vetëm nëpërmjet luftës me armë në dorë kundër pushtuesve. Deklarata u përpilua nga Terenc Toçi dhe është një dokument i rëndësishëm ku theksohet themelimi i një shteti të lirë e të pavarur. Kuvendi pati rëndësi historike sepse që i pari kuvend arbëresh, pas atij të Lezhës, ku bëhet betimi për të luftuar për Shqipërinë deri sa ushtari i fundit i pushtuesit të largohet nga Shqipëria. Terenc Toçi i mori detyrën e kryetarit të qeverisë, kurse në postin e sekretarit u caktua Zef Shantoja.

Më 27 prill të vitit 1911, gazetari dhe juristi arbëresh Terenc Toçi, iu bashkua kryengritjes së armatosur të Malësisë së Madhe. Kryengritja dhe jetëgjatësia e kësaj qeverie ishte e shkurtër, por ishte qeveria e parë e pavarësisë.

Terenc Toçi ishte i pari i cili përpiloi statusin e një qeverie të re për Pavarësinë e Shqipërisë, gati 1 vit e gjysmë edhe më herët se Ismail Qemali, kur ngriti flamurin në Vlorë. Ky ishte dhe themelues i lindjes së Shqipërisë, si një shtet i pavarur. Misioni i Terenc Toçit, në shoqatën “Pro Albania” ndonëse nuk përfundoi me suksesin e dëshiruar, nuk dështoi. Veprimtaria e tij dhe arbëreshëve u vlerësua

si një hallkë e rëndësishme në luftën për çlirim kombëtar. Arbëreshët dhe shoqëritë atdhetare në kolonitë shqiptarë në Amerikë, Rumani, Bullgari, kontribuan me të gjitha format për të siguruar pavarësinë e Shqipërisë. Përpyekja e tyre u vlerësua nga personalitete të shumta shqiptare.

Eqrem bej Vlora shkruante: “Në kohën e kryengritjes malësore katolike në vitin 1911, u bashkuan me to vullnetarët arbëreshë, me në krye Terenc Toçi. Ai çau në Mirditë ku dhe shpalli një republikë shqiptare, ku dhe ngriti një flamur shqiptar dhe, për disa ditë, ngriti fuqishëm moralin e popullit. Arbëreshët dëshmuuan, me qëndrimin e tyre, besnikërinë ndaj etnitetit shqiptar. Ata luftuan me trimëri të rrallë pa asnjë mëdyshje, rrezikuan jetën e tyre duke u dhënë zemër edhe vëllezërve në atdheun e lashtë të braktisur para shumë kohësh. Toçi bashkëpunoi edhe me qeverinë e Fan Nolit, dhe krijoi aneksimin e Shqipërisë me Italinë, jo si varës i Shqipërisë nga Italia, por si formë për ta mbrojtur. Regjimi komunist e dënoi me vdekje.”

Historianët duhet të shfletojnë arkivin për t’i dhënë dinjitet kësaj figure arbërore. I pari që u bë shtetas shqiptar, por i kushtoi shumë, sepse u pushkatua prej diktaturës së E. Hoxhës. Sipas së bijës së Toçit, i ati ishte viktimë e ideologjisë. Kjo figurë kaq poliedrike, kur sot kanë rënë barrierat, duhet të rishikohet, sepse puna e tij ishte në dobi të çështjes kombëtare. Qeveria e sotme shqiptare e ka harruar kontributin e këtij arbëreshi hero. Ai dha jetën për këtë Shqipëri sot, për këta vëllezër shqiptarë që rrojnë të lirë sot.⁹⁵

Kuriozitet: Stema e familjes Toçi është ende e dukshme brenda kishës kushtuar Shenjtorëve Pietro dhe Paolo, në Strigari.

⁹⁵ Shënim: Dokument historik i rëndësishëm është ai i Agostino Toçit, që daton nga viti 1650, i gjetur në *San Cosmo Albanese*, në shtëpinë e Flaminio Toçit dhe botuar në Firence, më 1866 nga Jeronim de Rada dhe Niccolò Jenò de Coronei si shtojcë e «Rapsodies të një Poeme Shqiptare». Prof. Domenico Cassiano ka dalë në përfundim se përmbledhja “Kujtimi” i Agostino Tocci më 1650, gati dy shekuj pas vdekjes së Skënderbeut, përbën një dokument historik me një vlerë të konsiderueshme, që përmban lajme të vërteta dhe dramatike.

Stema të tilla tregojnë se familjet arbëreshe, në shumicën e tyre, ishin familje fisnike, që kishin lënë trojet për shkak të luftërave. Lidhje të tilla në Santa Sofje d'Epiro gjatë periudhës nga shek. XVIII deri në shek. XIX, ishin Baffa me Samengo të Lungro, Lopez me Pascuzzi të Macchia Albanese, Masci me Marini e San Demetrio Corone.⁹⁶

Ndër personazhet e lindur në Strigari, kujtojmë gjithashtu: **Francesco Saverio Tocci**, viktimë në Campotenese, në kryengritjen anti-Burbon; **Guglielmo Tocci**, anëtar i Parlamentit Kombëtar; **Terenzio Tocci** dhe **Cosmo Serembe**, nipi i poetit Zef Serembe.

4.1.7. Vaccarizzo Albanese (Vakarici)

Qyteti ndodhet në shpatin verior të Sila Greca, në shpatet e Serra Crista d'Acri (1125 m). Ngrihet në një zonë të banuar që nga kohërat e lashta (Baccharizzo në Acri) dhe rreth vitit 1471 u popullua nga një koloni etnike e emigrantëve shqiptarë. Përfshirë dhe fshatin Corigliano, qyteti i takonte së pari Saracene-s dhe pastaj Saluzzo-s.

Historiku

Vaccarizzo Albanese (Vakarici) u themelua rreth vitit 1470, pas vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1468) dhe përparimit osman në Gadishullin Ballkanik, nga grupe emigrantësh që u vendosën në kodrat e Pre-Sila grek, duke themeluar ndër të tjera edhe fshatrat *San Demetrio Corone*, *Macchia*, *San Giorgio Albanese*, *San Cosmo Albanese*, *Santa Sofia d'Epiro* dhe *Spezzano Albanese*.

Ardhja e popullsisë arbëreshe rezulton në vitin 1470, ndërsa themelimi i tij daton më 1509. Sipas të dhënave historike, në vitin 1545 numëroheshin 480 njerëz (96 zjarre); më 1564 numëroheshin 605 njerëz (121 zjarre); më 1595 numëroheshin 660 njerëz (132

⁹⁶ Rodota Pietro Pompilio, *Dell'origine progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi libri tre*, Vol III, rist. Brenner, Kozencë 1986, f. 67.



zjarre); më 1648 numëroheshin 530 njerëz (107 zjarre). Më 1669 numëroheshin 755 njerëz, (155 familje). Popullsia arbëreshe në këto zona u mor me blegtori. Ka shumë mendime mbi origjinën e emrit, ku thuhet se këto toka ishin kasollet e feudalëve, ku mbanin lopët (vacca) dhe e quajtën Vaccarizzo. Banimet e para u ngritën në afërsi të kroit të vjetër, ku ekziston rrënoja e Kapelës së San Nicola-s (Shën Nikollës), që daton nga shekulli XIII.

Arbëreshët e ndërtuan fshatin e tyre rreth Kishës së Santa Maria di Costantinopoli (Shën Mëria e Kostantinopojës), e cila daton më 1669. Pasi kishin jetuar për një kohë të gjatë në kasolle degësh, të cilat shpesh ishin djegur, në mënyrë që të mos regjistroheshin nga numëruesit e taksave, ata zgjodhën të vendosen këtu përgjithmonë.

U vendosën, pra, në Vakarici nga tre zotëri të ndryshëm: zotëria e Sanseverino Princave të Bisignano, Lord i Badia di S. Adriano di San Demetrio, dhe së fundi, Lordët i Saluzzo-Doria i Corigliano Calabro, nën juridiksionin i të cilit Vaccarizzo qëndroi deri me përmbysjen e feudalizmit midis fundit të XVIII dhe fillimit të shekullit XIX. Në 1863, emrit *Vaccarizzo* iu shtua edhe ajo *Albanese*.

Në shekullin XVI, vendi ku ndodhet qyteti sot, u bë objekt i konflikteve të princave të Sanseverino-s. Në shekullin XVII, ai kaloi

në duart e Dukës së Corigliano dhe shtrihej nga Cino në Crat, nga kodrat sipër Vaccarizzo dhe San Giorgio në Detin Jon.

Urbanistika e këtij fshati ishte disi më e veçantë, vinte në formën e një qarku, herë duket rreth dhe herë-herë ngjan me formën e një ylli. Tabelat janë jo vetëm në italisht, por edhe në gjuhën shqipe. Edhe pse me shumë vështirësi kanë arritur të mbajnë gjallë identitetin. Mjedisi i këtij fshati është disi më modern.

Në sheshin *Montessori* ndodhet edhe *kisha Santa Maria di Costandinopoli* (Shën Mëria e Kostandinopojës) dhe kisha pranë saj, *Madonna del Rosario* (Zonja e Rozarit). Njëra me ritin bizantin dhe tjetra me ritin latin.

Muzeu etnografik

Në muzeun etnografik ekspozohen kostume arbëreshe, të gjitha për rastet e ceremonive, nga ajo martesore e deri te kostumi për rast zije.

Rrugës për në muze do t'ju tërheqë vëmendjen, një pemë me rrënjë të forta, por me degë të thara, që u rezistonte kohërave. Duket si simboli përfaqësues i këtyre arbëreshëve, për të cilët jeta nuk kishte qenë kaq bujare, por nuk u përkulën kurrë. Gjithashtu në rrugët e Vaccarizzo-s do të shihni një lapidar në kujtim të të rënëve. Mbi një shtyllë është vendosur shqip emri "*Sheshi*".

Pallati Cumano

Pallati Cumano u ndërtua në 1764, nga Salvatore Cumano si vendbanimi i tij. Iu vu zjarri nga një luzmë e kardinalit Ruffo në vitin 1799. Pallati u rindërtua në 1855 nga nipërit e tij, Alessandro dhe Domenico Cumano, dhe këtë e vërteton edhe pllaka e mermerit, e vendosur në hyrje. Në vitin 1908, një pjesë e Pallatit Cumano u ble nga administrata e kohës dhe ishte selia e komunës deri në vitin 1985. Në fasadën kryesore të ndërtesës ndodhet pllaka përkujtimore e Pasquale Scura-s, e vendosur në vitin 1911, me rastin e 50-vjetorit të bashkimit të Mbretërisë së Italisë.

Figura të shquara

Paskal Skura (Pasquale Scura) lindi më 24 prill 1791 në Vakarici dhe ishte i pari i shtatë fëmijëve, tre djem dhe katër vajza. U martua në vitin 1829. Vitet e para të shkollës i ndoqi në Vakarici dhe pastaj tre vjet në Kolegjin e Shën Adrianos në San Demetrio Corone (Shën Mitër Korone).

Miku i tij, Salvatore Marini, kryetar i Gykatës Penale të Monteleone-s (tani Vibo Valentia), e emëroi atë nënkancelar të gjykatës, një funksion që nuk kërkonte trajnim juridik. Pas disa muajsh, Scura u konfirmua kancelari titullar.

U transferua në Potenza me gradën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe u befasua në këtë qytet, të cilin e quajti “Siberia e Mbretërisë” për shkak të klimës dhe mungesave të shkollës. Këtu qëndroi tetë vjet. Pasquale, Scura, si Prokurori i Përgjithshëm në Potenza, u persekutua nga burbonët, për shkak të përpjekjes për të zbuluar të vërtetën në lidhje me vdekjen e Costabile Carducci, një anëtar i Parlamentit Napolitan të 1848. Me urdhrin e të arrestuarit, në mesin e tetorit 1849, Skura arratiset nga Potenza dhe në Napoli, bashkë me djalin e tij Angelo, hipën në varkën franceze *Ariel*, e cila i çoi në 21 tetor në Civita Vecchia dhe, prej andej, në Genova.

Në vitin 1851, u dërgua përsëri në gjykim, në një nga proceset e shumta politike të reagimit, i cili në këtë rast përfshinte më shumë se 30 të pandehur, disa prej të cilëve u akuzuan gjithashtu për pjesëmarrje në sektin e Bashkimit të Italisë.

I detyruar të largohet në Mbretërinë e Sardenjës, u lirua në mungesë, por me kusht të kthehet në vendlindje. Ishin momente të vështira, që po kalonte Skura, por jeta i merr një drejtim tjetër kur mori lajmin për ekspeditën e Garibaldit. U bashkua me Garibaldin dhe kontributi e tij qe i madh.

Dekreti: A dëshironi një Itali të pandarë?

Pasquale Scura kujtohet edhe për detyrën e tij me rigozitet dhe ndershmëri intelektuale në hartimin e thirrjes për votim: “A dëshiron një Itali të pandarë? Dekreti i thirrjes së zgjedhjeve mban

firmën e tre arbëreshëve, që ishin ministra: Pasquale Scura, Luigi Giura dhe Francesco Crispi-t, të Horës së Arbëreshëvet.

Votimi u zhvillua dhe vetë formulimi i pyetjeve ishte i pakuptueshëm për shumicën e votuesve, pothuajse të gjithë ishin analfabetë. Më 8 nëntor 1860, me dorëheqjen Garibaldit, edhe ministrat dhanë dorëheqjen.

Pasquale Scura rinis aktivitetin profesional, emërohet gjyqtar i Gjykatës Supreme, me dekret të 14 nëntorit 1860 dhe, me një dekret tjetër të 6 prillit 1862, konfirmohet Këshilltar i Kasacionit të Napolit. I zhgënjyer nga sistemi i ri shtetëror, kthehet në detyrën si magjistrat, nën qeverinë e mbretit, sepse shikon që nuk plotësonte idealet e tij.

Boton dy libra, njërin prej tyre më 1865, një ese mbi shqiptarët në Itali, ku përshkruhen zakonet, ritet, kultura e tyre në shekuj. Vdiq në Napoli, më 13 janar 1868, në moshën 77 vjeç. Në fasadën kryesore të Pallatit Cumano, atëherë selia e Bashkisë, vendasit i vunë një pllakë përkujtimore. Për ta përkujtuar atë, qyteti i Napolit i vuri emrin një rruge. Po te kjo rrugë është edhe shkolla “Pasquale Scura”.

Stema e Skurajve gjendet edhe në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. Familja Skura ishte një prej familjeve më të shquara feudale të Arbrit në shekujt XII-XIV. Stema paraqet një ujk/luan të ngritur në dy këmbët e pasme me një brazdë të tërthortë. Koka dhe trupi duken të ujkut, ndërsa bishti duket sikur është i luanit.

Luigi Giura lindi në Maschito, në rajonin e Potenca-s në 1795. Ai ishte një inxhinier, inspektor i Korpusit të *Rruga e Urës të Mbretërisë së Dy Sicilive*, i njohur për projektimin dhe ndërtimin si menaxher ndërtimi në vitin 1832.

Dramis Antonio lindi në San Giorgio më 1828, emigroi në Vaccarizzo Albanese, ku vdiq në vitin 1905. Iu dha një “Medalje ari” për vlera ushtarake të larta në luftën me “Të njëmijtët” deri në Volturmo.

Braiotta Nicolino lindi në Vaccarizzo, 19 shkurt 1839 - vdiq më 7 nëntor 1875. Ishte student në “Collegio S. Adriano” të San

Demetrio Corone. U regjistrua në ekspeditën e “Të njëmijhtëve” (Spedizione dei Mille) dhe ishte toger i dytë i një kompanie me 51 (vendas), i cili luftoi deri në Volturno.

Aloisio Elmo themeloi “Pio Monte Laicale” në Vakarici, një lloj instituti femëror. Pjesën më të madhe të trashëgimisë i shpenzoi si fonde për pajën e vajzave të varfra të Vakaricit në moshën e tyre për martesë.

Elmo Vittorio lindi në Vakarici në 1924 dhe vdiq në Romë, në vitin 1999. Historian dhe studiues i çështjeve që lidhen me historinë dhe të drejtat e pakicës arbëreshe. Botoi: “Statusi i arkipelagut të pakicave” më 1990; “Idetë e Iluminizmit në mendimin e italo-shqiptar në fund të shekullit XVIII”, (Le idee dell’illuminismo nel pensiero degli italo-albanesi alla fine del XVIII secolo) më 1992; “Paskuale Skura, ministër arbëresh” (Pascuale Scura, Ministro arbresh) - 1994; “Pronësi dhe zotërim në shoqërinë fshatare arbëreshe. Zanafilla dhe shndërrimi strukturor i pasurive kolektive të Vaccarizzo Albanese” (Proprietà e possesso nella società contadina arbreshe) – 1997; «Shpirtrat e mëdhenj të atdheut të vogël arbëror» (Le grandi anime della piccola patria arbreshe) 2003. (Macchia, S. Cosmo, S. Demetrio, S. Giorgio, S. Sofia e Epirus, Spezzano, Vaccarizzo “- 2003”).

Librandi Vincenzo lindi në Vakarici, më 7 mars 1867. Dijetar i gjuhës amtare dhe i traditave, ai botoi në Milano: “Gramatika shqipe me poezi të rralla të Varibobës” në gjuhën e folur të Vaccarizzo-s (1897) dhe “Shqipja e Italisë”, në vitin 1927.

Antonio Scura lindi në Vakarici, më 24 shtator 1872 dhe vdiq më 24 tetor 1928. Ai ishte mësues dhe prorektor i Kolegjit të “S. Adriano” e San Demetrio Corone. Ai botoi në Nju Jork: “Shqiptarët e Italisë dhe këngët e tyre tradicionale”, në vitin 1912.

Giorgio Marano lindi në Vakarici me 20 shtator 1927. Pas diplomës së shkollës së mesme klasike në Liceo di San Demetrio Corone,

ndoqi Seminarin e Grottaferrata, por shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore e detyroi të braktisë Seminarin. Pas kthimit në fshat, mori gradën e masterit në Kozencë, duke dhënë mësim në shkollat fillore të Vaccarizzo-s. Për 42 vjet, ai mban rolin si mjeshtër me përkushtim dhe kompetencë, duke kontribuar në formimin kulturor dhe njerëzor të brezave të tërë. Kryetar i komunës, nga viti 1955 deri në 1970, ai kontribuoi në përmirësimin socio-ekonomik të vendit. Në të njëjtat vite, iu përkushtua me pasion mësimdhënies dhe si studiues i gjuhës, historisë dhe traditave të vendit të tij, shpresonte ndërhyrjen e autoritetit në përfshirjen e mësimin të gjuhës amtare në shkolla.

Ai pati bashkëpunime me revistat “Zjarri”, “Zgjimi”, “Vatra”, “Katundi Ynë”, “Jeta Arbëreshe”, etj. Vepra e tij e fundit, “Vaccarizzo Albanese comunità albanofona della provoncia di Cosenza (dalle origini ai nostri giorni (dalle origini ai nostri giorni)” u botua disa muaj pas vdekjes, më 9 janar 2008.

Giuseppe Faraco lindi në Vakarici në 1938. Ndoqi studimet teologjike në kolegjin italo-grek në Romë. I emëruar famullitar i San Demetrio Corone në vitin 1964, ai u dallua për përkushtimin e veçantë në ushtrimin baritor, si dhe si gazetar dhe promovues i kulturës arbëreshe.

Në të vërtetë, ishte themeluesi i revistës prestigjioze kulturore “Zjarri” (Il Fuoco), nëpërmjet së cilës e bëri të njohur kulturën e dashur arbëreshe kudo. Revista, e cila për këtë arsye gëzoi popullaritet të madh jo vetëm në atë lokalitet, më vonë u bashkua me botimin e “Fletoreve Zjarri” (Radhonjtë dhe Zjarrit), duke u bërë shpejt një nga mjetet më të rëndësishme për përhapjen e historisë, letërsisë dhe kulturës arbëreshe. Përveç revistës, ai themeloi edhe një nga bibliotekat më të rëndësishme private në botën arbëreshe, “Filomena Faraco”, kushtuar motrës së vdekur para kohe. Ai vdiq papritur më 2 nëntor 1998.

Qyteza është e heshtur. Plaga e rëndë e migracionit në Jug të Italisë lëndon pa masë shumë familje që, ashtu si dje, shkuan drejt Amerikës dhe Argjentinës, edhe sot po emigrojnë nëpër rrugët e Londrës, Gjermanisë etj.

4.1.8. San Benedetto Ullano (Shën Benedhiti)

Shën Benedhiti është fshati që ndodhet në rrëzë të kodrës S.Elia, në një lartësi që varion nga 209 në 1400 metra mbi nivelin e detit. Përballë luginës pjellore të Crat-it, në një lartësi 450-500 metra, shtrihet qyteza me një popullsi rreth 700 frymë.

Karakteristike janë pyjet me gështenja dhe zonat “Piano di Cerri”, “Graudo e Acquafredda”, të pasura me burime si kristali në mes të një gjelbërimit të harlisur. Në lartësinë 1135 metra mbi nivelin e detit ndodhet lugina Laghiccello.

Historianët rrëfejnë se Shën Benedhiti ka origjinë shumë të lashtë. Informacioni i parë historik daton në shek. XII, kur ishte pronë e dukëve normanë të Montaltos, i cili në ato vite themeloi një manastir benediktin, nga i cili mori emrin edhe fshati. Por toponimi i tij i ka rrënjët më të hershme. Hulumtimet e studiuesit Italo Elmo dalin në konkluzionin që toponimi “Ullano” lidhet me një antroponim Ollius, apo Ullius. Flitet për një ushtar romak me emrin Ullius, të cilit sipas “ligjeve të shpërblimeve në shumë parash, ose në materiale“ i ishte dhënë si shpërblim kjo pjesë toke. Kjo ide përforcohet edhe me “urnën romake” me një mermer të çmuar, e punuar bukur artistikisht, e cila ndodhet në “kishën Nënë”.



Gjithashtu, studiuesi Lorenzo Giustiniani flet për një prani të popullsisë arbëreshe qysh në vitin 1300: “San Benedetto Ullano, në Kalabri, në tokat e Bisagnaneve, rreth 13 mile larg Kozencës, është E banuar prej shqiptarëve rreth viteve 1300”.⁹⁷

Demografia

Në vitin 1488 numëroheshin 20 zjarre. Këto të dhëna jepen nga dokumenti i Relevio Feudale, 375, ku “Subventiones generales angioine” kanë regjistruar banorë që nga viti 1276. Ky dokument është një census deri në ditët tona.

Fshati lulëzoi në gjysmën e dytë të shek. XV, kur u ripopullua nga arbëreshët. Territori i Shën Benedhitit ndahet në pesë fraksione. Në veri gjendet lokaliteti San Giovanni (San Xhuanit, platea San Joani) me popullsi 90 frymë. Në jug, fraksioni Marri (Allimarri) me popullsi 160 frymë; fraksioni Maglionzi, (Majonxet) me popullsi 80 frymë; fraksioni Piano dei Rossi Nord (Qane Ili Rusi) dhe fraksioni i Piano dei Rossi Sud, me popullsi rreth 340 frymë.

Gjatë rrugës do të ndesheni me lagjet rurale si “Lla Kroçe” (la Croce), “Prato Calavario”, “Koc i Ullinjve”, “Serracò” (Serako), “Marinelli” (Marinulet).

Qyteza është e një stili mesjetar, gjë që tregon për origjinën e hershme. Bërthama urbane është në pjesën e majtë të luginës së Crat-it. Arbëreshët e ardhur ruajtën gjuhën dhe këtë e shohim në shumë emërtime: Fundi i katundit, Qisha e Madhe, Qisha e Bo Konxijit. Në shumë zona rurale, emërtimi arbëresh është edhe sot: Kuponja e Priftit, Lluka e Muzaqit, shpellat, sheshet, shkurdheshi, Vër e Ujikut, Trembat e Pinulles. Një sërë urash mbajnë toponimin arbëresh: Urëza e Pashkavalit, Ura e Marinelvet, Urëza e Allimarit, Urëza e San Xhuanit.

Mbërritja e arbëreshëve në Shën Benedhiti

Me mbërritjen e arbëreshëve u dyfishua popullsia. Gjatë kësaj periudhe gjenden shumë akte noteriale mbi marrëveshje shitje dhe

⁹⁷ *Dizionario geografico-ragionato del regno di Napoli*, Manfredi, Volume 8, fq.131.

blerje. Një avantazh jep edhe zona hidrike e Shën Benedhitit, por edhe pyjet të pasura me gështenja.

Popullimi më i madh nga arbëreshët ndodhi më 1472 kur mbreti i Napolit, Ferdinandi, i dha lejen një grupi emigrantësh shqiptarë të qëndronin në Shën Benedhit. Këtu fillon edhe riorganizimi i territorit, i cili u shpyllëzua, për të kultivuar dhe për t'u rindërtuar. Tipologjia e ndërtimit ishte ajo e stilit të “gjitonisë”.

Urbanistika dhe arkitektura

Qendra e Shën Benedhitit

Rrugët e fshatit nuk janë të zhurmshme. Në qendër është sheshi i vogël “Corsini”. Ky është një shesh i rëndësishëm, ku në fillim të vitit 1500 u ngritën pallate të familjeve të pasura. Banesat e tyre janë elegante, mbi të gjitha stemat dhe me porta harkore. Mes tyre u ndërtua edhe pallati “Rodotà”, me një arkitekturë të thjeshtë. Në krahë të majtë gjendet kapela e “Zonja e Këshillit të Mirë”, e ndërtuar prej familjes Rodotà. Në të djathtë të saj, ndodhet Kolegji Korsini (Corsini). Karakteristikë është se të gjitha portat janë me shikim nga sheshi.

Zona “Insorte”

Zona historike “Insorte” e Shën Benedhiti është qendra e saj më antike, ku u grumbulluan dhe nisën të ndërtonin arbëreshët. Kjo zonë ndahet në pjesën e sipërme dhe të poshtme. Arbëreshët, sapa u vendosën, i dhanë emër burimit “Kaçube”. Në rrugën “Insorte”, në pjesën e poshtme të saj, ndodhet Kisha Mëmë, Kolegji Corsini, shtëpia e Agesilao Milan.

Në këtë zonë, gjendet historia dhe arkitektura. Këto sheshe dhe rrugica mbajnë peshën e vuajtjeve, por edhe të rebelimit. Rruga midis Pallatit Milan dhe Pallatit Confort rrëfen edhe sot, përleshjet dhe frymën antiburbone. Zonë tjetër historike është edhe rruga “Epiroti”.

Urbanistika e viteve 1600 dhe familjet feudale

Urbanistika gjatë këtyre viteve pëson ndryshime me rritjen e familjeve fisnike. Dallohen në këtë periudhë shtimi i familjeve feudale si Tavolareve, Muzakëve, Calimà, Mosciaret. Në këtë periudhë ndërtohen banesa feudalësh në stilin e Rilindjes, midis tyre pallati Miliano, De Seta, e Rodotà. Shumë familje pasurohen, kjo jo vetëm prej të mirave materiale të Shën Benedhitit, por edhe të shfrytëzimit masiv që bëhej nga familjet feudale e barone. Në rrugicën “Insorti” dallojmë shumë dyer të ndërtuara me gurë të cilat mbajnë stemën e tyre. Mjeshtrit më të mirë vinin nga Rogliano e Fuscaldo, të cilat ngelën vërtet një pasuri lokale.⁹⁸

Pallati De Angelis (Palazzo de Angelis)

Më sipër, nëpërmjet disa shkallëve shkohet tek rruga “Epiroti”. Kompleksi i përket epokës mesjetare, ose më mirë të themi, mesjetës së vonshme. Duke përshkuar një rrugicë të ngushtë, mbërrihet në rrugicën “Tavolari” ku ndodhet Pallati De Angelis (Palazzo de Angelis). Ky pallat i përket ndërtimit të vitit 1700, familjes Spinelli nga qyteza Tarsia dhe Marsico të Altilisë. Banorët e fundit ishte Baroni i Shën Benedhitit. Në qendër të harkut të portës është një stemë, me pesë gjethe të gdhendura. Gjendet një kopsht dhe disa shkallë, të cilat shërbejnë për t’u ngjitur në katin e sipërm.

Pallati Mosciaro

Një nga pallatet më të vjetër është edhe pallati “Mosciaro”. Stema prej guri është e gërryer, për shkak të kushteve atmosferike. Në stemë dallohet qartë dragoi, që simbolizon forcën dhe sundimin e kësaj familje fisnike. Nuk dihet shumë për këtë familje nëse janë me origjinë arbëreshe apo jo.

Pallati Konforti

Pallati i familjes fisnike Konforti, ku lindi Eugenio Konforti, komplotist arbëresh, dëshmor i çështjes së Rilindjes Italiane. Një

⁹⁸ Italo Elmo, *La storia di San Benedetto Ullano e Marri*, San Demetrio Corone: Arbutalia Editrice, 2011.

nga ndërtesat më të bukura dhe të veçanta gjendet në afërsi të Kishës Nënë. Ka formë asimetrike. Është më i hershëm se pallati tjetër i familjes Konforti dhe Pallati Mosciaro. Porta është shumë interesante me dy faqe fasha zbukurimi në stilin barok dhe në stilin manierist. Pallati Konforti e pati lulëzimin në shekullin XVII-XVIII.

Bukuria e stemës, eleganca e këtij pallati, na bëjnë të depërtojmë dhe informohemi se familja Konforti ishte familje me ndikim ekonomik. Në madhësinë e saj, kjo familje ka edhe karakteristika kontradiktore. Rrëfëhet që gjatë periudhës së burbonëve, njëri prej familjes së konfortëve hyn në kishë me kalë, përdor dhunë kundër priftit bizantin, i cili po u bënte thirrje qytetarëve që të mos shkonin në betejën Campotenesese, sepse do të vdisnin. Në fakt, ashtu ndodhi. Shumë gjak u derdh dhe shumë prej tyre vdiqën në atë betejë kundër burbonëve.

Në njërën fasadë të Pallatit Konforti vihet re se në muret e saj, edhe sot, ndodhen shenjat kur nga qendra e Marrit goditën me top burbonët në fasadat e kësaj shtëpie.

Pallati i Setës

Pallati ndodhet në bulevardin *Cassano*. Paraqitet në formë drejtkëndore dhe në katin e parë ndodhet një portë e Periudhës së Rilindjes (XV-XIV), harkore me tetë kolona (tufi) mbështetur në dy blloqe. Në qendër është montuar një stemë me lule (lulëzore) e gdhendur në gurë, e mbështjellë me detaje në formën e shkronjës “S” të përmbysur. Familja “Seta” ishin “gdhendës të gurit” nga më të famshmit në atë kohë.

Pallati Masci

Pallati Masci është i vetmi pallat, që i përket një familje arbëreshe. Arkitektura i përket periudhës së shekullit XII-XIII. Pallati ndodhet në pjesën e poshtme të qendrës historike. Jo shumë larg nga sheshi *Korsini* dhe prapa Kishës Nënë. Në hyrje të tërheq porta harkore, me 24 bugne (në formë piramide), 12 për çdo anë dhe të ndarë tre plus tre. Nëse do të hyjmë në simbologji, do të shohim numrin 3 (numrin e ritit), numrin 12 (12 muajt e vitit, ose 12 dishepujt) dhe

numri 24, që është numri i “udhërrëfyesve engjëllorë”. Në pjesën e sipërme është gdhendur një zog që i ngjan Feniksit (simbol i rilindjes, ripërtëritjes, përjetësisë). Është i vetmi pallat me këtë stemë. Mbiemri “Masci” e gjejmë për herë të parë në një akt noterial, më 10 dhjetor 1598.

Pallati Bisceglia

Pallati Bisceglia ku ndodhet biblioteka e bashkisë, zona kushtuar kulturës arbëreshe me shfaqjen e kostumeve tradicionale, mjeteve të punës, si dhe ekspozita fotografike mbi veshjet tradicionale, nën kujdesin e Luigi Imbrogno; ekspozita e fotografive historike të fshatit, që ilustron zona të ndryshme sociale (arkiva e Gino Tavolaro); ekspozita mbi poetin Costabile kushtuar emigrimit, nën kujdesin e Luigi Imbrogno.

Palati Cipriano i përkiste familjes Dora dhe Milani. Ky pallat ishte selia e lashtë e *Kolegjit Corsini*. Struktura është e thjeshtë. Sipër shohim stemën. Gdhendjet janë bërë nga artistët më të mirë nga Fuscaldo, edhe pse ka një arkitekturë të thjeshtë.

Kisha Nënë

Kisha e Famullisë u bashkua me manastirin antik të themeluar më 1099, rrënojat e të cilit, më 1862, iu shitën nga bashkia Camillo Milano-s. Pas tërmeteve më 1854, 1887 dhe 8 shtatorit 1905, kisha pësoi dëme të njëpasnjëshme dhe shumë herë u mbyll për adhuruesit. Më 1932, falë një kontributi të madh nga shteti i Pius XI, nga fondi për kultet, nga Komuna e Montalto Uffugo dhe nga e gjithë popullata, u rindërtua. Ndërtuesi ishte Silvio Lodi nga Pistoia, inxhinier Antonio Amoroso, i cili ofroi të bënte punën falas. Në dhjetor 1933, kisha mbaroi dhe altari u shenjtërua në datën 17 dhjetor nga S.E.D. Giovanni Mele, Peshkopi i Lungro-s.

Kisha Nënë e Shën Benedhitit nuk ka dimensione fizike, por ka gjeometrinë e shpirtit. Kur hyn brenda ndien solemnitetin, por edhe ngrohtësinë. Është e mbledhur dhe gjigante në të njëjtën kohë. Aty ndien se gjaku i shprishur është kodi më sublim. Pranë derës

anësore të hyrjes ndodhet busti në mermer i Papës Klement XII (a. 1736), themelues, më 1732, i Peshkopatës Greke dhe i Seminarit në Badia të Shën Benedhitit për arbëreshët. Papa Klementi nuk e harroi kurrë origjinën e tij.

Papa Klementi dhe gjuha shqipe

Më 1702, Klementi XI urdhëroi peshkopin kroat Viskë (Vincent) Zmajeviqi (Vincentius Zmajevich, 1670-1742) të Tivarit (Antivari) për të raportuar mbi gjendjen e Kishës Katolike në Shqipërinë e Veriut. Kryepeshkopi e vizitoi Shqipërinë për tre muaj si “Vizitor apostolik i Serbisë, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë” dhe përgatiti një raport të titulluar “*Notitie universali dello stato di Albania*” (“Shënime të përgjithshme mbi gjendjen e Shqipërisë”), i cili ka shërbyer si burim parësor të dhënash për Shqipërinë e Veriut të fillimit të shekullit XVIII.

Me rastin e vizitës së Kryepeshkopit, u mbajt një Kuvend, i quajtur *Kuvendi i Arbërit* në Mërqi, afër Lezhës, në dhjetor të vitit 1703. Si fjala e hapjes së Zmajeviqit, ashtu edhe vendimet e Kuvendit, u hartuan në gjuhën shqipe. Këto dokumente me rëndësi historike, gjuhësore dhe kishtarë u dërguan në Romë, të cilat u botuan në shqip dhe latinisht nga Propaganda Fide më 1706, me ndihmën e Francesco Maria da Lecce dhe janë burim me vlerë mbi gjuhën e Shqipërisë së Veriut, në fillimin e shekullit XVII.

Fakte historike, artistike mbi këtë kishë

Interesante, nga ana artistike, është një fron me një ciborium prej druri nga vitet ‘700. Në kishën e famullisë është kapela e familjes Rodotà de ‘Coronei, ku është vendosur busti i mermertë i vitit 1740, i Felice Samuele Rodotà, peshkopi i parë i ritit grek për shugurimet e italo-grekëve dhe shqiptarëve të Kalabrisë.

Gjurmë romake në Kishën Nënë

Brenda Kishës Nënë, gjendet edhe një aneks i bukur artistikisht, por edhe i shenjtë (urna ku mbahet hiri) i epokës romake i Lucio Aurelio Stefano, ndoshta i konsullit romak. Urna, ky artefakt

historik, është i rëndësishëm për vetë faktin që San Benedetto Ullano rezulton një qendër e rëndësishme në periudhën më të hershme. Hulumtuesi Italo Elmo, na thotë se kjo relike është objekt “jo i importuar”, duke marrë në konsideratë faktin e kolonializimit romak në këtë zonë dhe që etimologjia e San Benedetto Ullanos merr emrin e një kolonizatori, e një familje romake të quajtur “Ollanius”, me një prapashtesë latine - “anum”, e cila tregon përkatësinë. Urna e hirit, e dekoruar me Perëndinë “Amonne” me “Kokën e dhisë”, mban mbishkrimin: *D.M.L. Aurelio Stephano Proc. Averedis Ang.* Studiuesi Elmo deklaroi se e njëjta vazo ndodhej edhe në Piemonte, e cila përforcon idenë e kolonializimit romak.⁹⁹

“Kapiteli dhe kolona”

Një tjetër element që tregon për lashtësinë dhe rëndësinë e Shën Benedhimit është edhe “Kapiteli dhe kolona”. Të dyja pjesët janë analizuar. Artefaktet arkeologjike flasin për një periudhë të vonshme perandorake pak më përpara periudhës së Kostantinut. Elementet i përkasin ndonjë tempulli pagan.¹⁰⁰

Kisha San Rocco

Duke u ngjitur në rrugën “Squillo” arrin në Kishën e San Rocco-s. Kisha u ndërtua në shekullin XVII, me një portal të bukur dhe dritare të skalitura. Ishte vërtet një vepër arti në lulëzimin e saj. Nga shekulli XVIII deri në vitet ‘40 të shekullit XIX, ka ngelur vetëm një kabanë e thyer, e ruajtur, por që u shkri më 1881 në fonderi.

E ndërtuar në vitin 1656, kisha në fillim nuk ishte e zyrtarizuar. Zyrtarizimi i saj u bë nga Ferdinandi IV. Kisha i kushtohet San Rokut. Ishte vepër e Vincenzo dhe Mauro Rodotà, ku konfirmohet nëpërmjet një pllake më 26 prill 1779, të nënshkruar nga Mbreti Ferdinand IV. Me kalimin e kohës, pas vitit 1860 edhe priftërinjtë e braktisën atë. Në vitin 1943, fshati u godit nga një rrëshqitje e madhe e dheut dhe kisha e San Rocco-s ishte një nga ndërtesat që

⁹⁹ Italo Elmo, *La storia di San Benedetto Ullano e Marri*, San Demetrio Corone: Arbutalia Editrice, 2011.

¹⁰⁰ Italo Elmo, *La storia di San Benedetto Ullano e Marri*, San Demetrio Corone: Arbutalia Editrice, 2011.

u dëmtua më rëndë, deri sa u shpall e pasigurt për përdorim. Ka qenë e pamundur të hyje në të. Kisha ka një portë dhe një dritare të punuar bukur artistikisht.

Kroi i Kaçubes

Ndodhet në pjesën qendrore të fshatit, në zonën “Insorti”. Përballë është Kisha Nënë. Një monument sa i thjeshtë, edhe elegant. Janë dy derdhje. Burimi mban mbishkrimin e gdhendur me vitin 1601. Kroi i parë u ndërtua nga arbëreshët.

Kroi Bitrit

Bitri ishte një burim uji dhe shëndeti për vendin. Është diuretik, i bën mirë trupit. Pleqtë e parë thoshin se ishte brisk i ftohtë dhe e quanin atë “Siberia”, për të ftohtin e zonës. Por gjatë verës, gjithçka bëhet më e bukur. Vendi ku ngrihet *Kroi Bitrit* është një nga më të freskët në zonë dhe jo më kot e kanë pagëzuar “konditioner natyral”. Në të dy krahët, Bitri ka bijtë e tij që e ndërtuan dhe e pagëzuan. Nga njëra anë, është Marri dhe në tjetrën, Shën Benedhiti. Duket sikur këta dy krahë mbledhin dhe mbajnë të përfaquar këto dy fshatra. Kur del dielli, çerkat e ujit të tij shndërrohen në një ylber që lidh Marrin dhe Shën Benedhitin.

Rodotà dhe Kolegji Korsini

Shën Benedhiti është dhe krenaria e arbëreshëve. Më 1723, Papa Klementi XII (familja Corsini), e ëma e të cilit ishte me origjinë shqiptare, gjatë studimeve në Romë kishte një shok, Pietro Pompilio Rodotà, me të cilin flinte në një dhomë. Ky i fundit, shumë herë i kishte bërë kërkesë që të hapnin një kolegji në ritin bizantin në gjuhën shqipe, në fshatin Shën Benedhiti.

Në vitin e tij të tretë të papnimit, Papa Klementi XII, më 11 tetor 1732, me kërkesën e vazhdueshme të arbëreshit Felice Samuele Rodotà të Koronës, themeloi Kolegjin për shqiptarët në San Benedetto Ullano, i cili, për nder të themeluesit të shquar (Papa Corsini) u quajt: “Collegio Italo-Albanese Corsini”. Kolegji ishte një strukturë e vërtetë universitare për formimin e klerit italo-shqiptar.

Stema e Familja Rodotà de' Coronei

Merita për të përhapur kulturën arbëreshe, gjuhën dhe ritin i shkon familjes së shquar dhe të denjë “Rodotà de ‘Coronei e San Benedetto Ullano”, sepse falë këmbënguljes u hap Kolegji Korsini.

Stefano Rodotà u vu në krye të Kolegjit Korsini

D. Stefano Rodotà ishte vëllai i priftit, Pietro Pompilio Rodotà, i cili e kishte kuptuar se mënyra më e mirë për të edukuar bashkatdhetarët ishte krijimi i një kolegji në Kalabri, i kryesuar nga një peshkop arbëresh i ritit bizantin grek.

Stefano Rodotà-s, në cilësinë e Arqipeshkvit, iu dha e drejta për të qenë në krye të këtij kolegji, në rolin e rektorit në degën e *Filozofisë Teologjike*. Në vitin 1736, për herë të parë, filloi të shkruhej gjuha shqipe, kështu që, për arbëreshët nisi një epokë e re e arsimit kombëtar. Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, u ngritën dy institucione arsimore, Kolegji Corsini (Shën Benedhiti) në Kalabri, si dhe Seminari Arbëresh i Palermos në Sicili, të cilët mbushën zbrazëtinë e jetës shpirtërore të Arbëreshëve.

Për më shumë se gjysmë shekulli, Kolegji Korsini mori një famë të madhe dhe konkurronte me Kolegjin Grek të Romës. Ai u bë qendra arsimore më e njohur në rajonin e Kalabrisë.

Figura të shquara që nxori Kolegji Korsini

Në ‘60 vitet e tij të stabilitetit në Shën Benedhiti, Kolegji, nxori një plejadë eruditësh e peshkopë përkrahës të Iluminizmit si: Francesco Bugliari dhe Domenico Bellusci; studiues të njohur të greqishtes si Guglielmo Tocci nga San Cosmo Albanese; Vincenzo Gangale nga Firmo; Domenico Damis, xhaxhai i gjeneralit, nga Lungro; Francesco Avato nga Macchia Abanese, profesor i greqishtes në Universitetin e Barit; Vincenzo Canadè dhe Vincenzo Archiropoli nga San Demetrio Corone, përkatësisht mësues në shkollat e mesme të Barit dhe Capua-s; Pasquale Baffi, ministër i Republikës Napolitane, i konsideruar si studiuesi më i shquar grek, me Nicola Ignarra, të Mbretërisë së Napolit. Nga ky kolegji dolën figura si: Jul Varibova, autor i “Himnet” dhe “*Gjella e Shën Mërisë së Virgjër*”; Françesk Anton Santori; Zef Serebme. Por poeti më i madh ishte Jeronim de

Rada, i cili bëri çmos për të përhapur kujtimet e gjakut të humbur shqiptar.

Këta ndriçues të letërsisë shqipe dhe të kulturës arbëreshe vijnë ende. Në këtë kuadër, vlen të përmendim: D.Vincent Stratigò da Lungro; Pasquale Baffi nga S. Sofia d'Epiro, dëshmor i Republikës së Napolit, filozof i shquar; Domenico Mauro nga S.Demetrio Corone, komplotist dhe studiues i shquar, atdhetar dhe kreu i Lëvizjes Kryengritëse Kalabreze, deputet në Parlamentin Italian; Pasquale Scura nga Vaccarizzo Albanese, një atdhetar i flaktë, ishte ministër i Drejtësisë me Garibaldin më 1860; Francesco Crispi, një avokat i njohur dhe burrë shteti, ishte dy herë president i Këshillit të Ministrave. Nga ky kolegji dolën figura të Rilindjes: Domenico Dramis, Giovanni Mosciaro një karbunar i zjarrtë, Agesilao Milan, i cili u përpoq të vriste mbretin Ferdinandi II, në një paradë ushtarake, më 1856. Pavarësisht viteve të diskriminimit kulturor, komunitetet arbëreshe kanë arritur të mbijetojnë, duke ruajtur shumë prej traditave dhe ritualeve.

Kontesha Rocca (1051-1099)

Normana Rocca, e bija e Dragonit të Altavilla dhe mbesa e Tancredit, është zonja e kështjellës së Ullano. Vetëm 8 vjeç, Normana Rocca, ishte konteshë e Shën Benedhitit. Kjo ndodhi për faktin, sepse i ati u gjet i vrarë nga një person i padëshirueshëm dhe për normat ligjore, Normana Rocca është princesha e Kështjellës Ullano. Këto të dhëna rrjedhin nga një dokument i marrë nga regjistri i Petri Diaconi dell' abbazia Montecassino.

Teodor Muzaka

Teodor Muzaka është i pari kapiten stratiot me origjinë shqiptare, i cili u vendos në Shën Benedhiti, më 1446, me funksion në shërbim të feudalëve të Badia San Benedetto Ullano. Midis dokumenteve është një dekret i 22 gushtit 1523, nga ku rezulton se Teodor Muzaka ishte guvernatori i Oborrit të Badias Ullano, mbërritur në fshat në kohën e Abbatit Paolo të Terranova, ushtarët e parë të Demetrio Reres nga Jazzeria.

Vitet 1700 sjellin ndryshime kolosale në Shën Benedhiti

Gjatë këtyre viteve nuk kemi vetëm një rritje të numrit të feudalëve, por viti 1732 shënon një kthesë radikale në ndërthurjen urbane, si për zhvillimin social, ekonomik, por edhe kulturor. Është viti kur u hap Kolegji Korsini. Falë këtij kolegji, Shën Benedhiti shndërrohet në një qendër lulëzimi dhe shkëmbimesh tregtare.

Kisha e Zonjës së Këshillit të Mirë (Chiesa della Madonna del Buon Consiglio)

Në vitin 1719, me përkushtim të Zojës së Bekuar, prifti Michelangelo Rodotà, me shpenzimet e tij, ndërtoi kishën kushtuar Zonjës së Këshillit të Mirë, “Madonna del Buon Consiglio”. Punimet filluan më 7 nëntor 1720, nën drejtimin e arkitektëve Stefano Vangelio, Nicola Ricciullo dhe Giovanni Calieri. Ndër reliktet e shumta, nga të cilat i pati dikur me shumicë, por që më vonë u vodhën, ishin ato të Shenjtorëve që përfshinin Kalendarin Liturgjik për të gjithë vitin.

Kisha e Zonjës së Këshillit të Mirë “Madonna e Buon Consiglio” është cilësuar nga më të bukurat.

Në këtë kishë, përveç relikeve, ekziston një statujë e Zonjës së Këshillit të Mirë “Madonna del Buon Consiglio”, e gdhendur në dru, nga një autor i panjohur.

Është interesant historiku i saj. Rodotà, i cili në atë kohë studionte në Romë, shkante shpesh në Genzzano. Atje shikon këtë statujë, ku rrëfëhet që shqiptarët e sollën nga Shkodra, gjatë emigrimit të tyre dhe kjo Shën Mëri i udhëhoqi gjatë rrugës deri kur mbërritën në Itali, në Genzanno. Statuja u punua nga artistë në Napoli dhe duke qenë shumë e rëndë, sillet me traget nga Napoli në Paola dhe prej andej, arbëreshët e sollën mbi shpatullat e tyre, duke bërë turne dhe shkëmbim me njëri-tjetrin. Ishte prifti Stefano Andrea Rodotà, ai që solli statujën e Madonna-s në Shën Benedhiti. Ajo konsiderohet dhe katalogohet ndër më të bukurat nga artistët ekzistues në Itali. U ekspozua në Kozencë, me rastin e Ekspozitës së Artit të Shenjtë që u zhvillua gjatë Kongresit Rajonal Eukaristik, më 16-21 shtator 1947, San Benedetto Ullano, Zonja e Këshillit të Mirë. (Madonna e

Buon Consiglio). Në vitin 1919, gjatë ekspozitës në Cozenca-s, kjo statujë e Shën Mërisë u cilësua nga më të bukurat në të gjithë Italinë.

Kisha ka një balustradë të altarit latin, në kontrast me altarin katror të mbërthyer nga katër kolona tipike bizantine. Ajo ruan një ikonë prej druri barok, të pikturuar dhe të praruar, që përshkruan zonjën e kishës të mbështetur nga një engjëll dhe dy kutitë e shekullit XVIII. Tema bazohet në traditë sipas një portreti të Madonna-s, mbrojtëse e shqiptarëve, që u soll nga Shkodra në Itali. Sipas legjendës, Madonna tregoi rrugën dhe udhëhoqi mërgimtarët që u larguan nga atdheu i tyre nën presionin e turqve. Grupi skulpturor u soll në vitin 1737, nga Gennazzaro në Shën Benedhiti.

Kapela e San Giovanni Battista

Ideja për të ndërtuar një kishë në pronën e tij, duke ia kushtuar Shën Gjon Pagëzorit, ishte nga Joram Dores. Kisha u ndërtua më 1899 në rrethin Sgarbole, afër rrugës që të çon në Lattarico. Në të njëjtin vit, u bënë praktikrat për vendosjen e një panairi. Sot, ndërtesa e vogël e kultit është nën kujdesin e familjes Milano.

Në vitet 1800

Gjatë këtyre viteve lindin banesa feudale si ajo e Pallatit Muzaka, si edhe qendrat e banimit në rrugën “Corsini”. Jemi në shekujt kur ranë shumë tërmete në Kalabri dhe rrënuan fizikisht pjesën më të dobët të manastirit. Humbi kështu pjesa më e çmueshme e “trashëgimisë artistike kulturore” dhe më kuptimplotë e Shën Benedhitit, e cila mund të vlerësohet vetëm prej “gërmimeve”. Është për t’u cilësuar që struktura e urbanistikës së Shën Benedhitit ka “stilin e gjitonisë”.

Në vitet 1900

Në fillim të viteve 1900, një tërmet i fuqishëm rrëzoi pjesën e poshtme të kishës dhe kampanën, të cilat u restauruan rreth viteve ‘30 në formën klasike. Urbanistika e Shën Benedhitit ngelet një rrjet i “karakterit të gjitonisë”, besnike e stilit, zakoneve dhe kostumeve. Këngët liturgjike, tezgjahu, vatra, furra e bukës, oxhaku, festat,

kostumet, martesat, dhe gjuha, të gjitha këto elemente, ishin pjesë e kulturës etnike arbërore të San Benedetto Ullano.

Figura të shquara

Agésilao Milan lindi në një shtëpi arbëreshe të Shën Benedhitit, në një familje pronarë tokash nga nëna e tyre. Kur Milan ishte ende shumë i ri, babai i tij u burgos për një kohë të gjatë në Kastelvetere, Kaulonia e sotme.

Ai hyri në Kolegjin Shqiptaro-Grek të San Adriano, si një i ri ku formoi një miqësi të ngushtë me Attanasio Dramis nga San Giorgio Albanese, si dhe Antonio Nocito nga Spezzano Albanese. Ishte i rreptë, por edhe romantik. Ishte simpatizant i Marko Boçarit (Marco Botzaris), ku në moshë të hershme shkroi edhe një odë kushtuar këtij atdhetari. Poezia u botua pas vdekjes së tij nga F. Lattari. Disa vjet më vonë, u përjashtua nga kolegji për sjellje të pahijshme. Së bashku me studentë të tjerë të kolegjit, përfshirë Domenico Mauro, më 1848 Milan mori pjesë si kryengritës në luftën e zhvilluar në Spezzano Albanese dhe Campotenese. Revoltat dështojnë dhe Milan u fut në burg, për rreth dy vjet, por del nga burgju në sajë të amnistisë.

Milan nuk e harroi kurrë atë moment kur i arrestuan të atit, i cili lëngonte në shtrat. Kishte parë me sytë e tij kur e ëma u lutej policëve të mos e arrestonin atë natë, sepse ishte me temperaturë, por polici e kishte ngritur nga shtrati. Këto momente, Milanit iu ngulitën në mendje. Urrente mbretin dhe burbonët. Rasti i erdhi më 8 dhjetor 1856, kur batalioni në të cilin bënte pjesë do të parakalonte dhe nderonte në Capodichino para mbretit me kalë. Në mes të paradës, Milani doli nga radhët dhe kërcëu mbi sovranin, por u detyrua të përdorë armën e ftohtë, pasi ai nuk kishte arritur të rimarrë fishekun e fshehur nga bateristi për rastin. Shpata i hyri pak në kofshë mbretit, por nuk i shkaktoi ndonjë plagë të rëndë. Mbreti Ferdinand II shpëtoi shëndoshë e mirë. Milan ishte gati të godiste sërish, kur nga turma e heshtur, mbërriti një oficer i rojës mbretërore mbi kalë, gjenerali F. de La Tour, i cili e hodhi në tokë.

Të gjithë kishin frikë se Milan kishte helmuar majën e bajonetës, por ai vetë u përgjigj se, për fat të keq, nuk e kishte menduar atë. Pavarësisht plagosjes, parada vazhdoi, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Milani u arrestua dhe menjëherë u burgos në Castel Capuano, ku e vizitoi gjeneral D. Lecce, i cili i tha se do t'i shpëtonte jetën nëse do të zbulonte emrat e bashkëpunëtorëve. Milani ngulte këmbë se kjo ishte nismë e marrë nga vetë ai.

Gjyqi u mbajt tri ditë pas sulmit dhe Milani, krenar dhe dinjitoz, mohoi linjën e mbrojtjes si i sëmurë mendor dhe në mënyrë dinjitoze, u kërkoi gjyqtarëve që t'i dërgonin mbretit ftesën për të vizituar Kalabrinë, për të parë me sytë e tij kushtet, në të cilat jetonin bashkatdhetarët e tij.

Milani u dënua me varje

Në orën 6:00 të mëngjesit të 13 dhjetorit 1856, Milani u ngjit në vendin e ekzekutimit, me fytyrën të mbuluar nga një vello e zezë, i shoqëruar nga 50 burra, duke mbajtur në gjoks një shenjë me fjalët “njeri i pabesë”. Ai donte të fliste, por një daulle e ndaloi. Sapo u konstatua vdekja e tij, ranë kambanat e shumë kishave.

Një natë para ekzekutimit, ai shkroi një kujtim, ku midis të tjerave nënvizonte: “Isha i vetëdijshëm se nuk do ta vrisja tiraninë, por vetëm një tiran, por ishte e vetmja mënyrë proteste...”.

Milani ishte një vizitor i shpeshtë i bibliotekës burbone dhe shkroi disa poema në vargje. Profesori C. Avena kujton ato momente pak kohë para sulmit: “Ai ishte një i ri, i hollë ishte shumë fisnik, me një vështrim depërtues dhe mustaqe shumë të vogla, ai u ul dy herë pranë meje në dhomën e leximit [...] ai lexoi një vëllim latin dhe veshi uniformën e tij”). Kujtesa e tij mbrojtëse zbulon gjithashtu një kulturë jospërfaqësore në të.

Më 1860, Garibaldi, e quajti atë një hero dhe dëshmor dhe i dha pension nënës dhe vëllezërve të tij që ishin persekutuar rëndë pas sulmit. Sidoqoftë, qeveria e Mbretërisë së Italisë nuk e respektoi këtë dispozitë.

Cilat ishin motivet që e bënë Milanin të kryente këtë veprim?

Me arrestimin e Agésilao Milan, të gjithë arbëreshët u arrestuan në Napoli, për çfarëdo arsye, ata e gjetën veten në atë qytet. Sa u përket shqiptarëve të regjistruar në ushtri, ata u urdhëruan që të gjithë të dërgohen në Sicili, duke u vendosur një në secilën kompani dhe kurrë dy bashkë. Përndjekjet shumëfishoheshin çdo ditë. Qeveria u përball me “çështjen e arbëreshëve” në disa seanca dhe, për disa ditë, mbizotëroi mendimi për të detyruar të gjithë fshatarët të kalojnë Adriatikun. Por hipoteza së shpejti duhej të hidhej poshtë, jo vetëm sepse ishte shumë qesharake, por sepse gjykata e Napolit ishte e prirur ta linte Europën të dinte se, në sferën e vet, gjithçka zhvillohej po aq e qetë sa vaji. Atëherë u mendua për disa dispozita kundër Kolegjit Korsini, i konsideruar, tani më shumë se kurrë, “falsifikimi i djallit” dhe “farë e rebelëve”, siç quhej zakonisht. Dhe, u vendos mbyllja. Por Selia e Shenjtë bëri një kundërshtim të fortë ndaj këtij vendimi.

Raffaele De Cesare e përshkruan Milanin, me vullnet të hekurt, me karakter të mbyllur dhe shton se Agésilao Milano, ishte pasardhës, shqiptar, por askush nuk e konsideroi që ai ishte stërvitur në një vend si San Adriano, ku së pari u pranuan idealet e Jakobinizmit dhe prejardhjes anarkiste. Si përfundim, fjalët e Michelangelo Mandella përfaqësojnë sintezën e gjykimit historik: “Sulmi i Agésilao Milano nuk ishte gjesti i një të çmenduri, i cili vepron papritmas, por ishte një akt që pritej, ishte një akt i vërtetë politik kundër shtetit të burbonëve: një akt i pjekur në kohë, për vetë gjendjen që po përjetonte jugu i Italisë midis 1850 dhe 1860”. Ashtu siç konsiderohen po aq të dobishme fjalët e cituara nga De Cesare kur konfirmon se “dëshironte të shkruante një faqe të kësaj historie mbi sulmin e Agésilao Milano, e cila u bë jehonë në të gjithë botën, sepse ishte një nga ngjarjet kryesore të viteve të fundit të mbretërisë”. Atentati i Agésilao-s pati një jehonë ndërkombëtare. Për këtë ngjarje shkroi i gjithë shtypi i asaj kohe.¹⁰¹

¹⁰¹ Raffaele De Cesare, *La fine di un Regno, Napoli*:1894; Città di Castello: S. Lapi, 1900; Città di Castello: Lapi, 1908-1909, f. 178.

Në vitet 1950

Në vitet 1950, popullsia arbëreshe e Shën Benedhitin braktis stilin e gjitonisë dhe ndërton vija lineare pranë rrugës që përshkon San Benedetto Ullano. Ky rrjet e lidh më tepër me fshatrat përfaqark dhe e bën të humbasë dalëngadalë, edhe identitetin e gjitonisë si bërthamë.

Vitet 2000

Shën Benedhiti është komunë italiane, dygjuhëshe. Gjuha shqipe në Itali mbrohet nga shteti, sipas ligjit Nr. 482, të 15 dhjetorit 1999. “Në zbatim të nenit 6, të Kushtetutës dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të krijuara nga organet europiane dhe ndërkombëtare, Republika e Italisë mbron gjuhën dhe kulturën e popullsisë shqiptare”. Ligji i mësipërm ka ngelur thjesht si dokument. Mungesa e shkollave shqipe, globalizimi, migracioni dhe emigracioni janë plagë shumë të rënda për komunitetin arbëresh në këto zona të Kalabrisë. Shpopullimi është i jashtëzakonshëm. Shumë shtëpi janë boshatisur dhe braktisur, megjithatë “gjaku i Arbrit rron”.

Legjenda e Pilingrato-s (prifti nuk ishte arbëresh)

Pilingrato është një lumë që ndan Shën Benedhitin me Bashkinë e Lattarico-s, vetëm një kilometër larg nga qendra historike, në rrugën rajonale në veri drejt Fuscaldo-s. Ky vend ka ujë veçanërisht të lehtë dhe të mirë për shëndetin. Për udhëtarët përfaqësonte një vend për të shuar etjen. Ende sot, është një vend i rëndësishëm, në mes të bimësisë së dendur, i frekuentuar mbi të gjitha nga të rinjtë. Thuhet se ky ishte një vend dashurie midis një prifti dhe një gruaje të martuar. Në një natë veçanërisht të errët, burri i tradhtuar, i paralajmëruar për këtë gjë, i kapi mat dy të dashuruarit. Burri, prej zemërimit, i përzier me zhgënjimin, nuk e përballoi dot tradhtinë e gruas. Ai ngriti dorën kundër të dyve, duke vlarë priftin i cili, në fund të jetës kërkoi falje dhe ia ktheu kokën Parajsës. Para se të vdiste, ai shqiptoi fjalinë: “*Për një qime, mosmirënjohës*” (pilingratu). Shprehja nuk është arbëreshe, sigurisht që prifti nuk ishte nga këtu.

Figura të shquara të Shën Benedhitit

Aristidh Manes (Aristide Manes, 1897-1974) nga Shën Benedhiti. Manes u prek thellë nga kasaphana e luftimeve në frontin austriak gjatë Luftës së Parë Botërore. Mërgoi në Amerikën e Jugut dhe jetoi për vite me radhë në Brazil, Argjentinë dhe Kili. Përsiatjet e tij plot mall janë botuar në organe të ndryshme. Në një të ardhme të afërt, mund të botohet një përmbledhje me vjershat e tij.

Personazhe të tjerë të rëndësishëm të Shën Benedhitit:

Andrea Gargano (shek. XIX), një atdhetar, i cili flijoi jetën për kauzën e përbashkët.

Giovanni Mòsciaro, politikan, i zgjedhur deputet në Parlamentin e Parë Italian.

Abramo Mòsciaro (1901-1979), stenograf dhe krijues i sistemit “Stenital Mosciaro”.

Stefano Rodotà (1933), jurist dhe politikan, disa herë deputet italian dhe parlamentar europian, ish-nënkryetar i Dhomës së Deputetëve (1992-1994) dhe ish-president i Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (1997-2005).

Antonio Rodotà (Cosenza, 24 dhjetor 1935 - Romë, 23 shkurt 2006), inxhinier italian dhe menaxher biznesi i angazhuar në sektorin e hapësirës italiane dhe europiane; Drejtori i ESA-s.

Alfio Antonio Moccia (1943), historian, shkrimtar dhe tekstshkrues. Në tekstat e tij shpreh ndjenjën ndaj vendit të origjinës dhe botës arbëreshe.

Italo Elmo (1951), pedagog, kontribuon në realizimin e veprimtarive kulturore për forcimin e traditave popullore të botës arbëreshe. Organizoi dhe drejtoi në Çifti “Qendrën për studime të traditave popullore shqiptare” të San Demetrio Corone-s, edicionin e parë të “Festivalit Euromediterran të Muzikës dhe Valle Etnike”.

Është autori i dy vëllimeve “La Storia di San Benedetto Ullano e Marri”, që paraqesin një punë kolosale, plot me informacione, risi, hulumtime historike, politike, sociale, dhe mbi të gjitha, pasion të madh për “të dashurën Arbëri”.

4.1.9. Marri (Llimarri)

Rreth një kilometër pas fshatit S. Benedetto Ullano ndodhet Marri. Ky fshat u popullua nga shqiptarë në gjysmën e dytë të shekullit XV, të cilët kaluan lumin Argentino (lumi i Llimarrit). Fshati Marri ka pothuajse të njëjtat karakteristika si të gjithë fshatrat arbëreshë.

Arkitektura

Kisha e Shën Jozefit

Kisha e Shën Jozefit, që gjendet në këtë fshat, fillimisht u ndërtua si vend lutjeje për të kremtuar meshën. Prifti Don Giovanni Battista Rodotà kërkoi nga Peshkopi i Bisignano, Monsignor Berlinmgieri që t'u jepte mundësinë atyre banorëve të kishin një vend adhurimi. Më 1708, ipeshkvi dha leje dhe ia besoi kujdesin vetë priftit Rodotà. Vendi i lutjes u ndërtua në territorin e Ëngjell Muzakës, i cili bëri një dhurim.

Ajo u hap për adhurim në 25 maj dhe varej nga famullia e qendrës San Benedetto Abate të S.Benedetto. Famullia u krijua në 8 shtator të vitit 1947. Aty gjendeshin statuja të Zemrës së Shenjtë të Jezusit dhe Shën Jozefit, i cili në vitin 1997 u zëvendësua, me rastin e festës, nga një ikonë e pikturuar prej piktorit shqiptar Josif Droboniku. Një ikonostas prej druri në kishën e Shën Jozefit ishte i pari, që u ngrit në të gjithë qytetin (rreth 1939). Ikonat ishin pikturuar nga piktori Felice Fiore di S.Benedetto Ullano. Në vitin 1957, famullitari i asaj kishe, Demetrio Dolzani i kërkoi Ipeshkvisë së Lungros autorizimin për prishjen e ikonostasit ekzistues, pasi hapësira ishte shumë e kufizuar dhe ikonostasi i vogël nuk ishte artistik. Peshkopi dha autorizimin që u zbatua disa vite më vonë. Në vitin 1987, famullitari Papàs Donato Oliverio, rivendosi ikonostasin, duke e rindërtuar në muraturë dhe ikonat e vjetra u vendosën përsëri në vendin e tyre.

Kapela Gliosci

Kapela Gliosci është e vendosur në qendër të fshatit Marri. Aty gjenden dy statuja të Shën Jozefit dhe e Zonjës së Vuajtjeve, ndaj të

cilave ka një nderim të veçantë. Sot kjo kishë në aspektin e saj fizik ekziston, por është e shkishëruar.

Figura të shquara të Marrit

Albino Greco ka lindur këtu në këtë fshat. I frymëzuar prej Ernest Koliqit, që krijoi një revistë, e cila do të shërbente për të grumbulluar emigrantët shqiptarë, të cilët në atë kohë ishin emigrantë politikë për shkak të regjimit komunist, por edhe për të bashkuar italo-shqiptarët intelektualë si në fushën e poezisë, letërsisë, studimeve kërkimore, e për t'i shtyrë në aktivitetin kulturor, që të dilnin nga bota e tyre pasive, Albino Greko, me profesion avokat, më 1962 me kurajë, duke përballuar sakrificat të shumta themeloi revistën e parë “Zgjimi” apo “Risveglio”. Më vonë, më 1965, tre vjet më pas, themeloi “Vatra Jonë”.

Albino Greco, është i pari që besoi në këtë ringjallje të ndërgjegjes arbëreshe, duke ftuar të gjithë arbëreshët të shpërndarë në Itali, të shkruanin rreth kulturës arbëreshe. Kjo revistë, për afro 30 vjet u bë “palestra shqiptaro-arbërore”, për gjuhën dhe identitetin kulturor.

Revista “Zgjimi”, zgjoi nga një letargji shekullore shpirtin arbëror, sepse në atë periudhë lulëzimi, krijoi gonxhe të reja e vitale si; Gazeta “Zëri i Arbëreshëve” në Ejaninë nga Papas Emanuele Xhordano, revista “Zjarri” në Shën Mitri të Koronës nga papas Giuseppe Faraco, revista “Dita Jotë” e Shën Sofia e Epirit nga Papas Jani Capparelli, revista “Lajme” në Ungër, themeluar nga peshkopi Ercole Lupinacci, revista “Basilicata Arbëreshe”, në Rionere (Pz) nga Donato Mazzeo, si edhe revista “Lidhja” e themeluar nga unë (Antonio Belushi) në Kozenca. Sot, “Jeta Arbëreshe” e themeluar nga Agostino Giordano nga Ejanina, është i vetmi organ online që lidh shumë studiues, pasi ai është natyrë tepër aktive.


Këto zëra në hapësira të ndryshme demografike në Arbërinë e jugut, u bënë instrumente që krijuan një filarmoni, gojore, poetike, botime, studime, kuvende, udhëtime, e sensibilizime si për të mbajtur gjallë gjuhën, identitetin, por edhe për të bërë sensibilizimin mbi të drejtën e gjuhës shqipe, në organet kompetente rajonale

dhe qendrore. Për këtë motiv, ne arbëreshët i jemi mirënjohës këtij arbëreshi (Albino Greco-s), por njëkohësisht edhe gjithë atyre nismëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë, që dhanë kontributin dhe japin akoma për të mbajtur gjallë frymën e Arbrit.

4.1.10. *Santa Sofia D' Epiro (Shën Sofia E Epirit)*

Shën Sofia d'Epiri shtrihet në të djathtë të shpatit të luginës së ulët të Cratit. Shën Sofia e Epirit është një qendër me një ekonomi kryesisht bujqësore, për këtë arsye, pasuria e territorit të saj përbëhet nga rrethe të shumta, më shumë se 40, ku banon një pjesë e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohet i gjithë prodhimi bujqësor. Territori i Shën Sofisë ka një shtrirje totale prej rreth 39 km², me një morfologji tipike kodrinore dhe me një lartësi mesatare midis 550-750 metra mbi nivelin e detit. Rrjeti i saj hidrografik përbëhet nga përrenj të shumtë dhe dy rrjedhat më të rëndësishme janë, lumi Crati dhe përroi i Galatrellës. Ajo kufizohet me komunat e Bisignano-s në jugperëndim, Shën Dhimitri i Koronës në Lindje, Tarsia në Veri dhe Veriperëndim. Rrethet më të rëndësishme dhe të populluara janë: Cavallodoro, Acci, Grottile, Scesci, Gaudio, Mustia, Fravitta, Zarella, Pagliaspito, Zamadà, Gallice, Cacciugliera dhe Serra di Zotto.

Qendra historike e Shën Sofisë së Epirit ndodhet përgjatë një



linje të kërrusur, që shtrihet nga verilindja në një nivel më të lartë drejt jugperëndimit. Nga burimet filologjike, dimë se në zonën veriperëndimore, (një zonë ngjitur me kishën aktuale të Shën Sofisë së Epirit) në shekullin IX u krijua një fshat i vogël i themeluar nga ushtarë grekë. Në shekullin XV, kur refugjatët arbëreshë mbërritën për të ripopulluar pesë rrethet e shfarosur nga murtaja e zezë, ata u vendosën në mënyrë strategjike pranë kishës së vjetër (Santa Sofia - Terra), ndërsa, me shumë mundësi, një grup i dytë ngriti kampin në krahun lindor. Në fakt, në këto zona ekzistojnë gjurmët e para të mikrostrukturave urbane me një matricë të qartë nomade.

Urbanistika

Hapësira urbane që lindi bërthamën e parë të vendbanimit, e cila sipas të gjitha gjasave ricikloi mënyrën e rregullimit të çadrave ose kasolleve u organizua në *gjitonie*. Gjitionia (term me origjinë greke, që do të thotë lagje) përbëhet nga një grup shtëpish të rregulluara në mënyrë radiale në një zonë të përbashkët të quajtur *sheshi*, mbi të cilën janë vendosur hyrjet e këtyre banesave, hyrja e të cilave është e mundur, për dalje direkt përmes një shkalle që jep mundësinë e lidhjes për të komunikuar.

Shtëpitë me hapësirë të hapur përbëjnë një “unicum”, pra fushën e tij, ose më saktë, një strukturë të vetme. Grupe gjitonie, edhe pse në formë asimetrike krijojnë një urbanistikë origjinale, që përshtatet në mënyrë harmonike në territor. Mikrostrukturat përsëriten në orografinë e tokës, duke ndjekur linjat e konturit, duke ndryshuar zonën e përbashkët (sheshi) në një plan të tillë, që të bëhet e mundur rrjedha e ujit. Ky “plan urbanistik” është tërësisht i huaj për kulturën italiane.

Qendra historike e Shën Sofisë së Epirit, si ajo e të gjitha vendeve arbërore, është e organizuar në zona të vogla banimi të quajtur *gjitonie* (*Rioni*). Ajo ndahet gjithashtu në dy pjesë: e sipërmja, Drelarti, dhe ajo e poshtme, Drehjimi, të cilat e gjejnë pikën e tyre ideale të takimit në sheshin kryesor të fshatit, ku qëndron kisha katolike e ritit greko-bizantin kushtuar Shën Athanasit.

Në skajin lindor të qytetit qëndron kisha e lashtë e Shën Sofisë

së Epirit, e quajtur *Qisha Vjetër*, e rindërtuar në vitet gjashtëdhjetë dhe gjithashtu, në anën perëndimore është kisha e Shën Venerandës. Kapela e Shenjtit, e restauruar dhe e zgjeruar kohët e fundit, është e vendosur përballë qytetit në kodrën Monogò. Pas Pallatit të Peshkopatës së lashtë, në Largo Trapeza, ndodhet ndërtesa e Bashkisë, Biblioteka Qytetare “Angelo Masci”, si dhe Muzeu i Territorit dhe Kostumit Arbëresh.

Arkitektura

Kisha e Shën Athanasit të Madh

Kisha e Shën Athanasit të Madh është themeluar më 1742 nga arbëreshët, e ngritur në një ndërtesë të lashtë të shekullit X. Ky shenjtor është shenjtori mbrojtës i qytetit. Në vitet shtatëdhjetë u ndërtua ikonostasi dhe u shtuan ikonat e shkruara nga artisti Partenio Paulik. Brenda në kishë ruhen tablotë që dikur zbukuronin altarët anësorë të kishës. Kjo kishë është e stilit neoklasik dhe ka një navatë të vetme. Afresket e kësaj kisha i dekoroi piktori i Kretës, Nikos Jannikakis.

Kisha e Shën Venerandës

Një tjetër kishë është kisha e Shën Venerandës, e cila u themelua nga një familje fisnike shqiptare në shekullin XVII. Kjo kishë është më e vjetra dhe ende ruan stilin origjinal.

Kisha e Shën Sofisë Martire

Kjo kishë daton nga shekulli X dhe është kisha më e vjetër e fshatit. Ajo është ndërtuar në periudhën bizantine dhe ruan ende disa karakteristika të stilit origjinal. Brenda ka piktura të vjetra e me vlerë, si dhe ikona të pikturuara nga Jeromonaku e abatit basilian të Grottaferratas.

Pallatet e fisnikëve arbëreshë

Në fund të shekullit XVII, me rënien e principatës së fisnikëve Sanseverino, u krijua një klasë e re shoqërore, e përbërë nga ata që ishin në shërbim të princit dhe vendasve të Shën Sofias, të cilët

u bënë pronarë tokash. Kështu u ngritën në fund të shekullit 17-të disa pallate aristokrate: Palazzo Becci, Palazzo Bugliari, si dhe Palazzo dei Vescovi i Bisignano (shek.XVI), Palazzo Fazio (shek. XVIII), Palazzo Rizzuti (shek. XVIII) e Palazzo Toscano (shek. XIX).

Pallati i Peshkopëve

Është ndërtimi civil më imponues në Santa Sofia, vendi i lashtë i peshkopit Baron të Bisignanos, i cili dikur ishte zotëria feudal i qytetit.

Palazzo Bugliari

Në të djathtë të komunës ndodhet një ndërtesë elegante neoklasike, stili dykatësh, shekulli XVIII, e transformuar në bibliotekë. Shtëpia e Muzeut Shqiptar të Kostumeve mbledh një gamë të gjerë të veshjeve të përditshme, festive, gjysmë festive dhe gala për gratë shqiptare, të cilat, pjesërisht janë dhuruar nga familje lokale. Në katin e tretë është herbariumi i rezervuarit natyror të liqenit Tarsia dhe të grykës së lumit Crat.

Toponimet

Në toponiminë e qendrës urbane, shumë rrugë ende mbajnë gjallë kujtimin e vendeve nga të cilat erdhën mërgimtarët e parë greko-shqiptarë në shekullin XV. Sidoqoftë, disa mbartnin emrat e qytetarëve sofiotë, të cilët në të kaluarën janë dalluar në kulturë dhe angazhim politik dhe atdhetar.

Muzeu i veshjeve

Pranë Palazzo Bugliari, me fasadën nga sheshi “Largo Trapezën” është themeluar Muzeu i Kostumeve. Koleksioni përfshin veshje të përditshme, festive e ceremoniale. Shën Sofia e Epirit është një nga qendrat e pakta, ku gratë e moshuara ende i përdorin për t’u veshur rrobat tradicionale. Raste të tjera për të admiruar këto veshje janë ngjarjet e shumta tradicionale, ndër të cilat më e famshme ajo e pranverës italo-shqiptare që zhvillohet çdo vit, të dielën e dytë të majit. Kostumet janë zemra e arbëreshëve, të cilat edhe sot i veshin me krenari.

TRADITA E ZAKONE

Dasmat arbëreshe

Kur arrin dita e dasmës, një mjeshtre e ceremonive shkon te nusja e re për ta veshur, e shoqëruar nga pesë, ose gjashtë këngëtarë nga qyteti. Para martesës, të rejat shqiptare veshin një fustan leshi të kuq dhe në bel vënë një brez atllasi, rreth një pëllëmbë të gjerë.

“Shtunia e Shalës” në Shën Sofian e Epirit

Tetë ditë para fillimit të Kreshmës, sipas kalendarit liturgjik bizantin, njerëzit shkojnë në varreza për t’u lutur mbi varret e të dashurve. Ata mblidhen në formën e një rrethi dhe duke qëndruar në këmbë me bërrylat e tyre duke pushuar në varr. Ata konsumojnë diçka dhe pinë një gotë verë, për nder të të ndjerit të tyre, për shpirtin e të vdekurit, duke ofruar edhe diçka për kalimtarët. Po ashtu në Greqi, tri ditë pas vdekjes së të dashurit, anëtarët e familjes, të afërmit dhe miqtë e të ndjerit mblidhen mbi varr dhe konsumojnë “To sperna”, e cila është një ëmbëlsirë e bërë me kokrra gruri dhe përfaqëson të ndjerin. Në këtë mënyrë, besohet se fryma e të ndjerit vazhdon të jetojë tek ata që kanë konsumuar “To sperna”. Siç e kemi theksuar, në bashkësitë tona arbëreshe ekziston edhe thënia e vjetër “Gjith t’Shtunat ardhshin”, por dhe “Shtunia Shales maj mos ardhit”, (çdo e shtunë të vijë, por e shtuna e “Sciaglia” nuk vjen kurrë). Gjithashtu ekziston besimi se këtë të shtunë të gjithë të larguarit, duke dalë nga varret e tyre, mblidhen bashkë, mbajnë gishtin sikur të ishte një qiri dhe heshtin në procesion në rrugët e vendit. Besohet se secili i ndjerë shkon të vizitojë të dashurit e tyre të gjallë, çdo vit, pa i trembur dhe, për këtë arsye, ata mbajnë tryezën në shtëpi për t’i pëlqyer të ndjerit dhe për ta nderuar. E njëjta gjë bëhet në natën e Krishtlindjes.

Pedilati

Pedilati është i vendosur në territorin e Shën Sofisë së Epirit. Domenico Zangari flet për të në librin “Kolonitë italiane shqiptare të Kalabrisë - Histori dhe Demografi”: Më 27 nëntor 1542, Dhoma Mbretërore e Përmbledhjes urdhëroi numrin e zjarreve, ose familjeve të Mbretërisë. Një episod domethënës i varfërisë së arbëreshëve

është i lidhur me këtë histori. Lajmi për mbërritjen e oficerëve të regjistrimit shtoi panik tek arbëreshët, aq shumë sa shumë prej tyre dogjën kasollet ku jetuan dhe u strehuan në pyll. Edhe i gjithë fshati i Pedelatit u dogj plotësisht. Banorët iu bashkuan komunitetit të Shën Sofia e Epirit, duke shkuar për të jetuar atje ku sot, në kujtesën e tyre, gjendet “Via Pedilati”.

Figurat e shquara të Shën Sofisë së Epirit

Francesco Bugliari (1742-1806), lindi më 14 tetor; mbaroi studimet në Kolegjin italo-grek të San Benedetto Ullano dhe më vonë u bë kryepriфт i vendit të tij të lindjes. Më 1792 u diplomua për teologji në Universitetin e Napolit dhe pasi fitoi konkursin për kryesinë e Kolegjit italo-grek të San Benedetto, u emërua peshkop i Tagastes në *partibus infidelium* dhe u zgjodh si peshkop i shqiptarëve të rritit grek të Kalabrisë (26 mars). Filloi periudha e një aktiviteti më intensiv për peshkopin e Santa Sofie Sofiota, i cili, për të rigjetur një ndërgjegje fetare më autentike tek besimtarët e tij, u shqetësua mbi të gjitha për përmirësimin e shërbimeve, pasi konstatoi se shëndeti i konviktorëve ishte prekur nga klima e pashëndetshme e Shën Benediktit dhe së dyti, për rritjen e cilësisë së përgatitjes së klerit me pajisjen me një bibliotekë të pasur. Ai punoi për të marrë transferimin në manastirin basilian të Shën Adrianit në Shën Dhimitër. Me mbështetjen e bashkatdhetarit të tij, Giovanni Miracco, një murg i manastirit dhe mbi të gjitha, falë ndërhyrjes së mikut të tij Angelo Masci, peshkopi Bugliari i pa të plotësuara kërkesat e tij me një dekret mbretëror të 1 shkurtit 1794. Pas transferimit të tij në banesën e lashtë të Niliana, kolegji lulëzoi përsëri dhe u bë një qendër me shumë rëndësi për studimet humaniste dhe për përhapjen e ideve të reja përparimtare. Të gjitha këto transformime të kolegjit nuk u mirëpritën nga Kryepeshkopi i Rossanos, Andrea Cardamone.

Në nëntor të vitit 1794 u botua një pamflet, me të cilin bashkëngjitnin ritin grek dhe klerikët e tij. Domenico Bellusci iu përgjigj kësaj broshure, i frymëzuar nga peshkopi Bugliari, duke hedhur poshtë akuzat. Më 1799, lëvizja revolucionare u përhap edhe në

Shën Dhimitri dhe kishte midis mbështetësve të saj edhe peshkopin e bashkëpunëtorin i tij Bellusci. Kështu që, kur në mars të po këtij viti, u përhap në vend reagimi i Sanfedistas kolegji u shkatërrua. Bugliardi, në vitin 1806 kërkoi të rihapte kolegjin, por kjo nuk u realizua. Bugliardi i dobësuar u tërhoq në Santa Sofie, po edhe këtu situata nuk ishte paqësore.

Më 17 gusht ndodhi një akt i shëmtuar në Santa Sofia, ku Antonio Santoro di Longobucco, i njohur si *Mbreti Coremme*; arritën të infiltroheshin të mblidhnin burra në Aciri, dhe transferuan për t'u hakmarrë kundër sofiotëve.

Bugliardi kishte refuzuar të bashkohej me bashkëfshatarët e tij dhe të arratisesh, por gjeti strehë në një hambar. Kapet nga këta grabitës më 19 gusht 1806, zihet rob dhe merr 22 goditje me thika. Vdiq, ndërsa i lutej Zotit që të falte sulmuesit e tij. Dy ditë pas vdekjes së tij, kryepriifti i San Giorgio Albanese-s, Domenico Lopez, mori trupin e peshkopit dhe e varrosi në Kishën Nënë të Sant Athanasius të Madh. Disa ditë më vonë, u vra edhe vëllai i tij Domenico Antonio. Nga Bugliardi mbeti vetëm një disertacion historiko-teologjik me titull "*Arianizmi i shtypur në Napoli*" më 1791.

Pasquale Baffi lindi në 11 korrik 1749, në Shën Sofie të Epirit. Origjina shqiptare e familjes së tij duket se dëshmohet edhe nga forma origjinale e mbiemrit të tij *Baffi*. Kreu studimet e para në Kolegjin italo-grek të San Benedetto Ullanos. Flitet se është larguar nga shkolla para se ta përfundonte, duke u rebeluar kundër abuzimit të një prej mësuesve të tij. Pas dëbimit të jezuitëve nga Mbretëria e Napolit, ai u caktua si pedagog i greqishtes dhe të latinishtes në Universitetin e Salernos, kur sapo kishte mbushur njëzet vjeç; më 1773 u emërua mësues i gjuhës latine dhe greke në kolegjin ushtarak të Nunziatella-s në Napoli. Baffi, së bashku me Antonio Jerocades da Parghelia, bashkohen në shtëpizën masonike në Portici.

Më 1776, ai u arrestua dhe pas një viti u la i lirë nga burgu, vit ky (1777), ku u mbyll edhe kolegji i Nunziatella. Edhe pse ende nuk kishte botuar asgjë, fama e kulturës së tij në fushën e

filologjisë dhe paleografisë ishte bërë aq e përhapur, sa që më 1779 u zgjodh partner rezident i Akademisë së Shkencave dhe Letërsisë së Napolit. Frymëzuar nga mësimi dhe studimi i gramatikës helene, Baffi kompozoi një gramatikë të re të gjuhës greke, që nuk u botua kurrë. Merita e tij më e madhe intelektuale, sidoqoftë, ishte zbulimi në vitin 1779 i tekstit të atëhershëm të pabotuar të komentit të Hermias tek “Fedro” i Platonit. Baffi përgatiti botimin kritik dhe përkthimin në gjuhën latine, por edhe kjo punë nuk e pa dritën. Më 1781, ai gjeti në manastirin e “Trinisë së Shenjtë të Caves” shumë rrotulla në greqisht, që i transkripto i dhe i përktheu në latinisht. Fatkeqësisht, edhe këto hulumtime mbetën të pabotuara dhe u botuan një pjesë pas vdekjes së tij, në vitin 1865.

Më 1786 u martua me Teresa Caldora, nga një familje fisnike napolitane. Në këto vite ai vazhdoi aktivitetin e tij si anëtar i lozhës masonike dhe në periudhën midis 1785 dhe 1787 pati kontakte të shumta me teologun danez luteran Friederich Münter, i cili kishte shkuar në Napoli për të rindërtuar rrjetin masonik, për të promovuar shfaqjen e regjimeve demokratike dhe republikane. Në të njëjtën kohë, për shkak të gjendjes ekonomike, kishte nisur veprimtarinë e avokatit. Përvoja juridike kombinohej me njohuritë e mëdha të filologjisë, e bënte figurën e tij më komplekse. Më 1787, ai u dërgua në Katanzaro për të interpretuar dhe përmbledhur dokumentacionin e vendeve të shenjta, me qëllim që të formonte statistikat patrimoniale të *Bankës së Shenjtë*, për të cilën ai shkroi regjistrin dhe inventarin. Për këto merita, ai u emërua bibliotekari i parë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bukura dhe më pas, Bibliotekar i Bibliotekës Mbretërore të Napolit. Shkroi më 1796 listën e dorëshkrimeve greke të Bibliotekës Mbretërore. Bashkëpunoi edhe në transkriptimin dhe botimin e vëllimit të parë të papirusit *Herkulanensian* (1793). Në janar 1799, Baffi iu bashkua lëvizjes revolucionare dhe qeverisë së përkohshme, në të cilën ai mbante detyrën e kryetarit të komitetit të administratës së brendshme. Me rivendosjen e burbonëve arrestohet dhe dënohet me vdekje, më 7 nëntor 1799. U ekzekutua me varje, më 11 nëntor të po atij viti.

Alessandro Becci ishte me profesion mjek, por edhe shumë i interesuar për albanologjinë. Becci ishte pjesë e atij grupi intelektualësh që kontribuan për furnizimin me material të Jeronim De Radës për realizimin e veprës së tij “Rapsoditë e një poezie shqipe ...”.¹⁰²

Becci ishte aq shumë i dashuruar pas gjuhës shqipe sa që fëmijën e pestë, e cila ishte vajzë, e quajti *Harea*, gjë që për epokën e atëhershme ishte një risi, sepse bëhet fjalë për vitin 1860.

Angelo Masci lindi në Santa Sofia, më 7 dhjetor 1758 dhe u nda nga jeta më 1821. Ai ishte jurist dhe studiues arbëresh. Mësimet fillore i kreu në kolegjin e Shën Adrianit. Studimet për drejtësi i përfundoi në Napoli. Mashi është autor i një vepre në italisht me titull “Discorso sull’origine, costumi e stato attuale della nazione albanese”, Napoli 1807 (Fjalë për prejardhjen, zakonet dhe gjendjen e tanishme të kombit shqiptar), që u botua menjëherë pas daljes në frëngjisht të studimit të Konrad Malt-Brën (Conrad Malte-Brun, 1775-1826) “Essai sur l’origine, les moeurs et l’état actuel de la nation albanais” (“Ese për prejardhjen, zakonet dhe gjendjen e tanishme të Kombit Shqiptar”). Në veprën e tij vë në dukje autoktoninë e shqiptarëve dhe prejardhjen e tyre nga pellazgët, si dhe kërkon që arbëreshët e Italisë të njihen nga shteti si një kombësi e veçantë. Vepra pati ndikim pozitiv tek arbëreshët e Italisë dhe rilindësit shqiptarë. Botimi i parë i saj u përkthye në frëngjisht nga gjeografi i njohur Maltebrun, duke i bërë të njohur shqiptarët në botë.

Si jurist, ai mbajti disa pozicione të rëndësishme prestigjioze gjatë jetës së tij. Ai ishte prokurori i parë i Gjykatës së Katanzaros, prokuror i Përgjithshëm në Gjykatën e Apelit të Napolit dhe Këshilltar i Shtetit më 1820. Ai ishte autori i shkrimeve të ndryshme, për të cilat disa ende nuk dihet. Vepra e tij më e famshme mbetet “Fjalë mbi zanafillën, doket dhe gjendjen aktuale të Kombit Shqiptar”, të ribotuar pas vdekjes në një monografi me këtë titull në Napoli, më 1847, nga nipë i tij Francesco Masci, megjithëse shkrimi doli në dritë për herë të parë më 1807, duke u botuar nga autori

¹⁰² Elena Gjika, *Shkrimtarët shqiptarë të Italisë Jugore*, në A. Di Cristina, Palermo, 1867, fq. 18.

i tij në revistën enciklopedike të Napolit të atij viti, në dy episode, në numrat 6 dhe 7 të qershorit dhe të korrikut.

Veprimtaria e tij letrare njihet mirë (falë famës së arritur nga disa prej veprave të tij; Diskursit të lartpërmendur ose “Ekzaminimi politik dhe juridik i të drejtave dhe prerogativave të barones në Mbretërinë e Napolit”) 1792, por pak është studiuar dhe pak është shkruar për këtë figurë në lidhje me veprimtarinë e tij si avokat. Interesante për studimin e komunitetit të Spezzano Albanese-s, është mbrojtja e tij “Për Universitetin dhe qytetarët e Spezzanos kundër Arqipeshkvit të Cosenza-s”.

Stefan Bafa (Stefano Baffa) nga Shën Sofia (d’Epiro). Prej tij ka mbetur një poemë me 320 vargje në gjuhën shqipe mbi shkatërrimin e kolegjit të Shën Adrianit në Shën Mitër më 1799, ngjarje që e pa me sytë e vet gjatë kohës së turbullt të Napoleonit.

Ferdinandi IV i Napolit kishte dekretuar mbylljen e seminarit Korsini në Shën Benedhit dhe transferimin e tij në manastirin e Shën Adrianit në Shën Mitër, në anën tjetër të luginës së Kratit. Kjo poemë me tetëdhjetë strofa katërshe me rimë AABB, që mendohej se kishte humbur prej kohësh, u botua në Grottaferrata, më 1971.

4.1.11. *San Basile (Shën Vasili)*

Pasi largohesh nga Kastrovilari (Castrovillari), në drejtim të kodrave gjendet San Basile, ose Shën Vasili, siç i thonë arbëreshët. Fshati shtrihet në një lartësi 500 metra mbi nivelin e detit. Nga lartësia duket si në pëllëmbë të dorës fusha e Sibarit dhe deti Jon.

Deri në vitin 1930 në këto fshatra martoheshin arbëreshë me arbëreshe dhe vetëm në vitin 1930, fillojnë martesat e para me italianë, ku arbëreshi e jepte vajzën, sepse kërkonte që e bija të kishte një të ardhme ekonomike dinjitoze. Djemtë arbëreshë e zgjidhnin gjithmonë nusen arbëreshe. Si të gjithë fshatrat arbëreshë përreth, edhe në Shën Vasil flitej arbërisht toskërisht dhe ishin të rritit greko-bizantin. Festat e tyre fetare i përkasin të gjitha të këtij riti.

Arbëreshët e gjetën këtë vend të pagëzuar me emrin *Shën Vasili*, pra nuk ishte fryt i arbëreshëve. Manastiri i Shën Vasilit zotëronte toka, por vetëm pas kapitullimit, në vitin 1510, u sanksionuan një numër rregullash ku iu dha mundësia edhe arbëreshëve për shfrytëzimin e tokave, shitblerjeve të tyre, si edhe marrjes së taksave.

Rrugica “PACE”

Kisha antike “Matrice” u ndërtua me duart e emigrantëve arbëreshë me vullnetin e peshkopit Tomacelli, më 1500. Sipas dokumenteve më të hershme, rezulton që kjo iu dedikua *Shën Xhenaros*, sepse peshkopi ishte napolitan dhe ky shenjtor është shenjti mbrojtës i napolitanëve. Transformimi i kësaj kishe në bashki u bë më 18 gusht 1838, por vetëm më 1887, kjo strukturë kaloi në autonominë e plotë si pallat komune. Kjo u arrit në sajë të Giovanni Damis, i cili ishte i ngarkuar në detyrën si kryetar i Komunës së Shën Vasilit. Shumë interesante është edhe sahati, si pjesë e kësaj arkitekture.

Figura të shquara të Shën Vasilit

Michele Bellizzi lindi në Shën Vasili dhe ishte një prift dhe edukator. Kreu detyrën e tij si edukator pranë Kolegjit San Adriano, (San Demetrio Korona), më vonë në Seminarin Diocesani të Cassano e Morano Calabro, Maratea, dhe më tej, në Kastrovillari. Ishte bashkëpunëtor në periodikun “Il Calabrese” themeluar më 1842, ku shkruanin studiuesit më të mirë të asaj kohe.

Michele Bellizzi ishte mësues në Kastrovillari për seksioni e “Giovanni Italia” që ishte themeluar në mars 1848, i cili predikonte kundër tiranisë, duke nxjerrë në pah vlerat e dashurisë për atdheun, dhe të lirisë. Ishte shumë i rëndësishëm fjalimi i tij kundër burbonëve, mbajtur në kishën e Madona del Castello. U arrestua në 1850, ku bëri dënimin dy vjet heqje lirie. Pasi del nga burgu, punon si mësues privat deri më 1860. Ishte i pari drejtor i gjimnazit të Kastrovillarit. Vdiq në vitin 1886. Për nder të tij, u vu edhe një pllakë përkujtimore në fasadën e godinës së gjimnazit.

Angelo Bellizzi ishte rift i ritit grek. Lindi në Shën Vasili, në tetor të 1754. Kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Napoli, ku më 1754 ishte Rektor i Kavaliereve të Napolit dhe nga viti 1789, u bë kapelan pranë Kortës së Ferdinandit IV. Më 1829 u transferua në Shën Vasil, në vendin ku u lind dhe kaloi pjesën tjetër të jetës me të afërmit dhe të dashurit të tij. Bënte pjesë në kategorinë e atyre njerëzve, të cilët mendonin që edukimi dhe mësuesia përfshijnë të gjitha sferat. Njihte shumë mirë latinishten, greqishten dhe ishte një shkrimtar shumë i mirë, ku ka lënë shumë vepra akoma të pabotuara me një shenjtëri elokuece, në histori, filozofi, mjekësi. Thuhet se veprat e tij ruhen në shtëpinë e një stërnipit të vet. Vdiq në Shën Vasili, më 20 shtator 1836.

Paolo Bellizzi lindi në Shën Vasil, më 4 prill 1890. U diplomua në shkencat ekonomike dhe tregtare. Ai kultivonte një dëshirë të madhe edhe për shkencat politike. Kur shpërtheu lufta, mori pjesë vullnetarisht, por dallohej për trimërinë, guximin e inteligjencën e tij dhe mori titullin “Kapiten”. Qëndroi për dy vjet, ku iu dorëzua një medalje e artë dhe dy bronzë. Është shumë interesante letra e kavalierit madhor Giuseppe Moscone, komandant i batalionit, që shprehet me aq krenari dhe me aq dashamirësi, por edhe i prekur për humbjen e këtij njeriu kaq të madh sa Paolo Bellizzi. Më 30 shtator 1917 u vu në Shën Vasili një pllakë përkujtimore për nder të dhuntive morale dhe intelektuale të Paolo Bellizzit, i quajtur ndryshe edhe “Maestro”.

4.1.12. Firmo (Ferma)

Firmo (Ferma) ndodhet në majë të një kodre me një pozicion panoramik në rrafshinën Sibari, në zinxhirin Pollino pas saj, në të djathtë të luginës së mesme të përroit të Tiros. Fshati ndodhet afër krahinave Aquaformosa, Ungra, dhe San Basile. Përballë saj është Spezzano Albanese.

Firmo, ndonëse një fshat i vogël ndahet në dy pjesë: Firmo i



poshtëm (Sotano) dhe Firmo e sipërme (Soprano). Gjurmët më të hershme i kemi në Firmon e poshtme dhe mbajnë datën 1486, ku u vendosën 10 familje arbëreshe. Në vitin 1497 kemi ngulimet arbëreshe në pjesën e sipërme dhe atje ishin 10 familje. Në vitin 1502, numëroheshin 10 familje, midis tyre: Alessio Comite, Gangale, Bellizzi. Këto të tria janë edhe familjet e para të Firmos.

Në vitin 1503 në Firmo e poshtme rezultonin 23 familje, me mbiemrin Prevatà. Ky mbiemër vjen nga fjala shqipe “Preva” (thuhet se kjo familje kishte origjine luftarake, prandaj mbante edhe këtë mbiemër. Kishin një mentalitet agresiv dhe të dhunshëm). Nga viti 1502-1809, Firmo e sipërme kishte arritur numrin 30 familje. Ndërsa në periudhën 1486-1809 Firmo Sotano numëronte 30 familje. Vetëm në vitin 1812 ndodh bashkimi i dy pjesëve që formon Firmon në një pjesë të vetme, me një popullsi prej 1000 banorë.

Në 11 janar 1503, u krye pakti agrar midis popullsisë arbëreshe të Firmos dhe princit të San Severino. Me 6 gusht 1502, Alessio Comita merr koncesionin të hyjë në pallatin e ndërtuar në 1274 nga Barone Erardo.

Para se arbëreshët të strehoheshin këtu, nga viti 553 deri në 1486, kur erdhën arbëreshet kjo tokë kaloi në shumë duar. Nga 553-1000 ishte koloni e Mavri (Afrika e Veriut). Më vonë ishin kolonitë ballkanike e nga viti 1274 ishin normanët- svevët- anxhuinët. Në 1453, Firmo për shkak të luftërave dhe tërmeteve u braktis. Në vitin 1486 përqark kishës greke, të quajtur “*Kalogero*” u vendosën familjet e para arbëreshe. Nga viti 1809, katundi ishte një çiflig nën juridiksionin e Don Bernardino San Severino, princit të Bisignano-s dhe etërve dominikanë të Altomontes.

Ka Kalogero

Në këtë strukturë dallohen gjurmët e murit të kishës së vjetër, ku mbi rrënojat e saj u ndërtua kisha tjetër. Është shumë interesante sesi bashkimi i dy besimeve ka ardhur kaq natyrshëm.

Pallati Dominikan përfaqëson kujtesën historike të këtij vendi. Ndërtesa, e cila ekziston tashmë, në shekullin XV u shkatërrua nga tërmeti i 1456 dhe pronarët e atëhershëm, etërit dominikanë të Altomontes, ua dhanë refugjatëve shqiptarë, duke i autorizuar ata të rindërtonin *Firmon*.

Punimet përfshinë ndërtimin e një kisha të stilit grek, rreth së cilës u zhvillua një ndërtesë banimi, dhomat e shumta të së cilës u përdorën pjesërisht për mbledhjen e mallrave bujqësorë. Prej kishës kanë ngelur vetëm porta qendrore dhe dy dritaret e njëres fasadë të pallatit. Në vitin 1809, ndërtesa kaloi në duart e borgjezit Sensi Bisantis dhe më 1860 i kaloi familjes Frascino. Sot është pronë e bashkisë, e cila e bleu atë në vitin 1993, duke e kthyer në një qendër kulturore. Aty gjendet *Biblioteka Komunale, Muzeu i Artit Fshatar* dhe *Sportelli linguistik*.

Në këtë strukturë ndërtesë antike gjendet edhe *Muzeu i Arteve dhe i Traditave* me kostumet e tij. Ato objekte ishte pasqyrimi i jetës arbërore dhe veshjet e ekspozuara si protagoniste të gëzimeve dhe të hidhërimeve të grave arbëreshe. Në brendësi, gjendet dhe Biblioteka, ku ruhet dhe një akt juridik i vitit 1500. Ajo që bën përshtypje është edhe një hartë antike e shekullit XVI, e cila ruhet në këtë muze. Aty paraqiten ngulimet e arbëreshëve.

Seminari i parë shqiptaro- grek shqiptar

Seminari i parë shqiptaro- grek shqiptar u krijua në Firmo më 4 dhjetor 1663 nga Propaganda Fide Congregation Side, me bashkëpunimin e emigrantëve nga Maina (Napoli i Rumanisë dhe Malvasia), me qëllim të formonin të rinj eruditë nga të gjitha trevat e Greqisë dhe Epirit, të aftë për priftërinj. Rektori i parë ishte Fr. Eustachio Sevastò dhe pas tij, Daniele Cortese Brana, epirot, nipi i famullitarit të famshëm Cortese Brana të Kishës Greke të Napolit. Seminari u mbyll në 1746, ku në të njëjtën kohë kishte famë ai i San Benedetto Ullano më 1732 nga familja Rodota.¹⁰³

Një ndër figurat e shquara të Firmos ishte **Alessio Comite**. Ai ka qenë një fisnik shqiptar i Moresë në Greqi, për të cilin dihet pak ose asgjë. Alessio Comite qe në krye të refugjatëve shqiptarë pas mbërritjes së tyre në Firmo, rreth vitit 1540. Ai gëzonte privilegjet e aragonëve dhe veçanërisht nga princi i Sanseverino di Bisignano Berardino dhe gruaja e tij Eleonora Piccolomini (mbesë i Papës Pius II). Në vitin 1502, princi i Bisignano i dha atij çifligjet e Firmos tashmë të populluar nga arbëreshët, që prej vitit 1486. Alessio në këmbim i dha atij reliktet e lipsanave (të tibias) të San Giovanni Crisostomo, e cila ruhet ende në Kishën e Santa Maria della Consolazione, në Altomonte.

4.1.13. *Lungro (Ungra)*

Qyteza e Ungrës ndodhet në një zonë malore dhe kufizohet në lindje me territorin e komunës Saracena, në jug dhe jugperëndim me ato të Firmos dhe Altomontes, në veriperëndim me territorin e Acquaformosa-s dhe në zonat malore brenda Parkut Kombëtar Pollino.

Etimologjia e fjalës *Ungra* do të thotë “i lagësht” (i Unjtë, i ujtë, i lagësht, Ungra). Fshati ndodhet rrëzë malit Petrosa, rreth 600 metra mbi nivelin e detit dhe kufizohet nga dy lumenj: Galatro (ose Fiumicello) dhe Goma. Deti Jon ndodhet rreth 40 km larg.

¹⁰³ Robert Appleton, Catholic Encyclopedia. New York 1913. Vol. III, f. 626.



Ekzistojnë dokumente, të cilat hedhin disa hipoteza mbi zhvillimin urban të qytetit të Ungros. Sipas tyre, ka ekzistuar një moment vendimtar i transformimit të këtij qyteti, nga një strukturë mesjetare e një grumbulli banesash (casale) drejt një kompleksi më të gjerë në trajtën e fshatit (borgo), ku me ardhjen e refugjatëve shqiptarë u mbivendos sistemi policentrik i gjitonisë.¹⁰⁴ Banorët e rinj, në fakt, gjetën një aspekt të qytetit që tashmë ishte përcaktuar mirë në fshatin mesjetar. Shqiptarët mbërritën në Ungro në një periudhë relativisht qetësie, pas betejave të përgjakshme midis baronit të Peskarës, zotit feudal të Saraçenës (Saracena) dhe Sanseverinos, princave të Bizinjanos (Bisignano) dhe feudalëve të Altomontes. Territori i Ungros kishte pasur përplasje të vazhdueshme midis dy zotërve feudalë, gjë që kishte shkaktuar shpëpullim të zonës.

Shqiptarët, nga ana e tyre, e rikonceptuan urbanizimin e vendit sipas modelit të gjitonisë, në një amfiteatër natyror të pranishëm në rrjedhën e sipërme të qytetit mesjetar të dikurshëm. Gjitonitë u transformuan dhe favorizuan krijimin e pallateve fisnike. Më vonë, u shtuan lagjet në formën e gjitonisë, të cilat i ngjanin kullave të

¹⁰⁴ Inxhinieri dhe arkitekti i Ungros, Vincenzo Maria Mattanò, jo vetëm që na furnizoi me materialin e duhur, por edhe na ndihmoi të kuptonim më së miri urbanistikën e ngulimeve të para të arbëreshëve të Ungros nëpërmjet skemave të planimetrisë dhe të urbanistikës së qytetit.

kështjellave, në të cilat rrugicat ishin të lidhura me çdo dalje ku gjendej një shesh pothuajse i rrumbullakët. Ky sistem ishte jo vetëm socializues, por edhe vrojtues, i sigurt e mbrojtës. Gjithonia është një sistem që nuk e lejonte izolimin.

Në rrugët “San Leonardo” dhe “Sant’ Elia” (e cila është pjesa historike e fshatit), duket qartë arkitektura tipike e gjitonisë, që ka përfaqësuar dhe ende përfaqëson, etninë arbëreshe. Sot kjo karakteristikë konstatohet në një mënyrë më të kufizuar, pasi qendra historike është zbrazur dhe banorët janë zhvendosur drejt zonave të reja duke ndërtuar shtëpi të stilit modern.

Në Lungro gjendet disa ndërtesa, të cilat bartin vlera historike, të tilla si: pallati i Kuriës Peshkopale, pallati De Marchis, pallati Stratigò, pallati Kabregu, pallati Damis, pallati Belluscio, pallati Cucci, dhe pallati Vaccaro. Sipas gojëdhënave, thuhet se nëntokë, në lagjen “Konxa”, ekziston një galeri nëntokësore e përdorur në mesjetë nga murgjit e Lungrës. Kjo galeri lidhte pallatet fisnike: pallatin Damis, pallatin Stratigò, etj.

Gjithonia

Si në të gjitha katundet arbëreshe mbizotëron stili i gjitonisë. Gjithonia shpjegon konceptin themelor të kulturës arbëreshe: ndarja e përbashkët e gjithçkaje. Për shembull, ishte e zakonshme mbajtja e derës së përparme të hapur, sepse asnjë i huaj nuk mund të hynte brenda, duke qenë se kontrollohej nga fqinjët, por po ajo derë e hapur përdorej edhe për të shkëmbyer majanë e birrës për të bërë bukë, për të ndarë një ëmbëlsirë, por edhe për të ndihmuar në raste nevojë. Zakonisht dyert e përparme të shtëpive (në toskërisht, *shpitë* ose *shtupit*), të ndërtuara tradicionalisht me gurë dhe gëlqere (ose baltë për kasollet), përfundojnë të gjitha me një shesh të përbashkët. Të tilla kanë qenë deri në vitet ’60,’70. Lagja ishte një mekanizëm për strukturimin e marrëdhënieve ndërvepruese, veçanërisht përmes shkëmbimit të solidaritetit shoqëror.

Brenda ngulimeve arbëreshe, dallohen lagjet, të cilat janë pjesë e qendrës së banuar, të përcaktuara nga kryqëzimi i teksturës urbane me një, ose me më shumë rrugë kryesore. Çdo lagje (rione) ka

kishën e vet, dyqanin e vet ushqimor, furrën e vet dhe më parë kanë pasur dhe bodrumin e vet. Gjytoria është pjesa më e vogël e lagjes, ku rrugicat e ngushta që çojnë në gjytonitë e tjera. Më pas me evolucionin socio-ekonomik të vendeve arbëreshe, fundi i shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII, gjytoria shndërrohet në një bërthamë prodhuese parakapitaliste dhe humbet pak nga natyrën e saj të hershme. Por në çdo rast gjytoria arbëreshe është uniteti fizik, shoqëror dhe simbolik i bashkësive arbëreshe, një vend i transmetimit të njohurive të traditës, i takimeve dhe i shkëmbimeve të mallrave dhe shërbimeve.

Ungra ruajti ritin greko-bizantin

Nga viti 1768 shqiptarët e Ungrës ndërmorën me këmbëngulje mbrojtjen e ritit të tyre liturgjik greko-bizantin, pasi duke ardhur nga Shqipëria e Jugut, nga Epiri dhe nga Greqia, ata ishin nën juridiksionin e Patriarkut të Kostandinopojës. Për shekuj, falë edhe punës së kishës bizantine, arbëreshët e Ungrës vijojnë të ruajnë ritin bizantin, si një aspekt të identitetit të tyre.

Katedralja “San Nicola di Mira”

Qendra më e madhe e besimit dhe e ritit bizantin për Kalabrinë dhe për fshatrat arbëreshe të Potencës dhe Molises është Katedralja *San Nicola di Mira*. Katedralja është ndërtuar në shekullin XVII dhe është kisha kryesore e Eparkisë së Ungrës. Ndërtimi i kishës së tanishme daton që nga viti 1721, pasi tërmeti i fundit të shekullit XVII e shkatërroi plotësisht kishën ekzistuese.

Kisha “Santa Maria dell’Icona”

Kisha “Santa Maria dell’Icona” është e njohur pasi brenda saj ruhet dëshmia e parë e ikonografisë bizantine të shqiptarëve në gur, e cila përshkruan Shën Mërinë dhe Fëmijën.

Kisha e Sant’Elia dhe vargjet revolucionare të Viçenzo Stratigò

Kisha e Sant’Elia (Qisha e Shën Llirit, fundi i shekullit XVII), qëndron në një pikë, e cila ka shërbyer si pikë vëzhgimi për banorët

e fshatit të vogël. Gjatë periudhës së Rilindjes, kulti i shenjtorit u praktikua gjerësisht dhe u konsiderua si çlirimtarja e popullit shqiptar të Ungras nga shtypjet e burbonëve. Disa vargje në gjuhën shqipe, ato të pakta që kanë mbërritur deri më sot dhe që këndohen ende nga besimtarët në procesionin e shenjtorit, janë shkruar nga poeti Vincenzo Stratigò në vitin 1852. Që atëherë, qeveria burbone e ndaloi procesionin, sepse e kishte ndjerë kuptimin revolucionar të atyre vargjeve që njerëzit e Ungrës kënduan për të lavdëruar shenjtorin luftarak, duke proklamuar rënien e regjimit dhe lirinë.

Kisha e “Santa Maria del Carmelo”

Kisha e Santa Maria del Carmelo është ngritur në vitin 1608 si manastir dhe pati veprimtari të gjerë kulturore, e cila lulëzoi deri në vitin 1808. Ajo u mbyll gjatë periudhës së Napoleonit dhe u përdor si varrezë. Kisha i është kushtuar Virgjëreshës së Bekuar të Malit Karmel dhe ruan statujën prej druri të Virgjëreshës dhe Fëmijëve. Në dy të diela rreth datës 16 korrik zhvillohen dhe sot dy procesione në të.

Krojet

Krojet në jetën e arbëreshit ishin një fenomen “organik”. Kroji ishte vendi ku bashkoheshin, ku këndonin e socializoheshin. Në fshat gjenden disa kroje, si: kroji i Pirkus, i Hundës, i Batit, i Gjinit, i Ciambis, i Gjitonisë, i Rejkanit etj.

Tradita të Ungrës në fushën e kulinarisë e më gjerë

Thjeshtësia e jetës arbëreshe kishte kuptimin e saj të vërtetë dhe pranë oxhakut ishte gjuha e djersës së lodhjes. Nga nëntori deri në maj, poçja nuk mungonte kurrë nga vatër. Kishte madhësi të ndryshme: të mëdha, të mesme të vogla, shumë të vogla, për t’u përdorur sipas nevojës. Më të mëdhatë përdoreshin në raste të veçanta, për të gatuar mishin për supë (ato mbanin një pulë të tërë), ose thjesht për të pasur gjithmonë ujë të nxehtë gati. Ato përdoreshin për gatimin e fasuleve, qiqrave, thjerrëzave; poçet e vogla përdoreshin për të përgatitur çaj kamomili (*peçorriqe hamumilit*).

Veshjet e fshatit

Veshja tradicionale e grave arbëreshe vijon të përdoret edhe sot në festa të ndryshme familjare. Veshja dhe stolitë, për shkak të veçantive dhe elegancës që mbartin, kanë tërhequr vëmendjen e udhëtarëve të huaj. Studiues të shumtë, etnografë apo ekspertë të modës, vazhdojnë t'i shikojnë si burim frymëzimi këto elemente arbëreshe.

Karnavalet në Ungra

Mënyrën me të cilën arbëreshi i Ungrës është përballur dhe ka jetuar ndër vite e pasqyron në karnavale, ku tregohet vullneti i jashtëzakonshëm i popullsisë arbëreshe. Në vitet '60 u hapën festimet e karnavaleve me paradën historike që prezantonin veprën heroike të Gjergj Kastriot Skënderbeut, që konsiderohej babai i të gjithë arbëreshëve.

Folklori

Gajre dhe fizarmonika. Vitet e fundit zakoni i dajres (zampone) ka humbur disi, pasi në ditët e sotme është shumë e vështirë të mësosh këtë art fisnik, i cili kërkon jo vetëm mjeshtëri, por edhe aftësi. Një tjetër instrument i përdorur gjerësisht është fizarmonika.

“Java e Shenjtë” (Java e Madhe) fillon në prag të së Dielës së Palmës (Rromollidhet) deri të Dielën e Pashkëve. Me ceremoninë dhe ritualet e pasura shpirtërore renditet ndër festat më të rëndësishme dhe domethënëse të kalendarit liturgjik bizantin. Në Ungra, Java e Shenjtë merr një kuptim edhe më të gjerë dhe më solemn, gjë që e imponon dhe katedralja madhështore.

“E Shtuna e Shenjtë”

“E Shtuna e Shenjtë” në Ungra shoqërohet me dy rituale: Së pari, rrihen baulet, sepetet prej druri duke thënë shprehjen “Ikni morra dhe Ikni pieshta, ecni gjithë ket vreshta” (shkoni përmes morrave dhe pleshtave, shkoni në vreshtat). Së dyti, kukulla e Kreshmës digjet me pendën e saj të fundit (kreshëmësja) duke thënë lutjet.

Risorgjimento dhe figurat e shquara

Arbëreshët që janë bërë protagonistë të ngjarjeve të vogla apo të mëdha të periudhës së Risorgimento-s italiane. Në mendjen dhe në zemrat e arbëreshëve ngelën ata që dhanë edhe jetën, të tillë si: Ungresi Nicola Cortese, Vincenzo Mazzei, Raffaele Santoianni, Angelo Stratigò, Raffaele Tocci, Camillo Vaccaro, Antonio Martino, Giosafatte Laurito, Ferdinando Manes Nicola Bellizzi, PS Samengo, Diodato Trifilio, Alfonso Martino, Nicola and Giuseppe Cucci, Salvatore Irianni, Francesco Pisarro, Ambrogio Cortese, Domenico and Giuseppe Santoianni, Domenico Todaro, Salvatore Cortese, Saverio Bruno, Vincenzo Di Turi, Salvatore Franco. Gjithashtu dhe gratë arbëreshe kanë luajtur një rol të rëndësishëm. Gratë arbëreshe të Ungras qëndisën flamurin trengjyrësh për Garibaldin.

Figura të rëndësishme arbëreshe në Ungër

Daniel Korteze (Daniel Cortese) lindi në Ungra në vitin 1617. Vazhdoi studimet në Kolegjin Grek të Shën Athanasit në Romë nga viti 1631 deri më 1639. Është autor i disa vjershave në shqip. Vjersha e tij me gjashtë vargje “Carmen albaniense sev epiroticvm” (“Këngë shqiptare apo epirote”) përbën një dëshmi me interes për përdorimin e dialektit të toskërishtes.

Domenico Damis ishte atdhetari më fisnik dhe një nga ato figura që rrezatojnë dritën e virtytit dhe të sakrificës. Damis lindi në Ungra më 24 shkurt të vitit 1824. Ai studioi në Kolegjin e San Adrianos dhe më pas, vazhdoi studimet në Napoli, ku u diplomua për jurisprudencë. Ai ishte patriot dhe një gjeneral i shquar.

Në vitin 1844, ai ishte pjesë e “Italisë së Re” dhe së bashku me vëllain e tij Angelo kishin marrë pjesë në lëvizjen kryengritëse Cosentino.

Në 1848, ai urdhëroi 200 kryengritësit arbëreshë të Lungro-s të largoheshin nëpërmjet kalimit Campotenese; pastaj luftoi në Monte Sant ‘Angelo. Më 1851, ai u arrestua në Lungro në shtëpinë e ushtarit Raffaele Molfa. Gjykata e Lartë Kriminale e dënoi atë me 25 vjet të shkallës së 4-të për vrasjen dhe komplotin kundër shtetit.

Francesco Santojanni lindi në Ungra në vitin 1860. Emigroi në Argentinë, ku u martua me një trashëgimtare të pasur me origjinë skoceze, Urbana Sañez. Në vitin 1935 Francesko, duke mos pasur trashëgimtarë e shpërndau për bamirësi pasurinë e tij, duke ia dhuruar Komunës së Ungras, me qëllim që të shfrytëzoheshin një pjesë për mbajtjen gjallë të identitetit arbëresh dhe pjesa tjetër, të përdorej për ndërtimin e një azili komunal.

Vinçenc Stratigo (Vincenzo Stratigò, 1822-1885). Lindi më 16 dhjetor 1822 dhe studioi në Shën Mitër, në Kolegjin e Shën Adrianit. Mori pjesë në ngjarjet e vitit 1848, ku për pak kohë ishte kapiten ushtrie. Me t'u kthyer në qytetin e lindjes, ku edhe kaloi pjesën tjetër të jetës, iu përkushtua me gjithë shpirt mbrojtjes së të drejtave sociale e politike të fshatarësisë së varfër të Kalabrisë dhe luftës së saj për një jetë më të mirë. Pikërisht tek sheshi “17 korriku” Stratigo bëri agjitacion kundër burbonëve. Qeveria e asaj koke shpërblen me 2000 dukat për kokën e Stratigòs dhe u bënë një sërë persekutimesh dhe burgosjesh në Ungra dhe Aquaformosa. Nuk ishte hera e parë që Stratigò shfaqej si rebel. Edhe në vitin 1852 kishte përçuar ide revolucionare midis popullit, përmes vargjeve për lavdi që këndoheshin gjatë procesionit.¹⁰⁵

Salvatore Cortese ishte një arbëresh antifashist të Ungra, mësues dhe studiues i çështjeve arbëreshe, i cili jo vetëm ka shkruar një histori të mbushur me ngjarje njerëzore dhe politike, por ka rindërtuar tiparet biografike të figurave të shquar të antifashizmit në Kalabri. Ngelet një nga eksponentët më të mëdhenj të Lëvizjes Kombëtare Antifashiste.

Camillo Vaccaro ishte arsimtar dhe filozof. Për mbi gjysmë shekulli ishte protagonist i dhe dëshmitari më autoritar, së bashku me Filippo Turati, Cesare Lombroso dhe Roberto Ardigò, të pozitivizmit italian. Ndër veprat e tij më të rëndësishme kujtojmë: “Lateneide, ose zëra

¹⁰⁵ Alberto Straticò, *Manuale di letteratura albanese*, Manuale Hoepli, Milano, 1896, f. 263-270.

në shkretëtirë” për rinovimin e shkollave klasike, Parma 1891; “Arsimi fillor në Itali”, Milano 1902; “Pedagogjia midis moralit”, Mantova 1905; “Kurthet e logjikës”, Torino 1907; “Energjia e sinqeritetit të guximshëm në vlerësimin e forcave që veprojnë mbi njeriun dhe universin”, Romë 1952. Ai vdiq në moshën 92-vjeçare në Romë, më 14 dhjetor 1955.

Alberto Straticò (1863-1926), profesor i letërsisë italiane në shkollat e mesme, i lindur në Ungra (Cosenza), me origjinë arbëreshe. Ai njihet si hartuesi i parë i historisë së letërsisë shqipe dhe si një nga studiuesit më të rëndësishëm të letërsisë arbëreshe.

Më 1896, botoi në Milano librin “Manuale di letteratura albanese” (“Manual i letërsisë shqipe”), vepër e parë e këtij lloji në historinë e studimeve për letërsinë tonë. Libri sjell gjykime të vyera për një varg shkrimtarësh arbëreshë.

Alberto Stratiko e njihte pak letërsinë e Shqipërisë, prandaj edhe informacioni e vlerësimet e tij për shkrimtarët e saj janë më të kufizuara. Ai i kushton vëmendje të veçantë edhe folklorit arbëresh.

Francesco Trifilio, i njohur gjerësisht me nofkën “kapiteni” është një figurë e harruar, që ai i dedikoi lirinë e vet atdheut të dytë të tij Ungras. Ai u dënua me burgim me 25 vjet heqje liri të plotë, për shkak të angazhimit politik.

4.1.14. *Acquaformosa* (Firmoza)

Pesë kilometra larg Ungrës, ndodhet fshati *Acquaformosa*. Sipas një legjende mbi origjinën e emrit *Acquaformosa*, thuhet se zuri fill nga një episod me princeshën Irena Kastrioti, e bija e Gjergj Kastriotit, e cila duke pirë ujin e Abatit të Santa Maria di San Leucio, tha me zë të lartë: “A çfarë uji!”. Që nga ajo kohë, emri i qendrës ndryshoi nga *Ariosa* në *Acquaformosa*. Arbëreshët vetë, e quajnë *Firmoza*. Ky vend ndodhet në një pozicion të mrekullueshëm panoramik, midis luginave të Fiumicello-s dhe Grondo-s. Qyteti e kishte origjinën



në shek. XV dhe u themelua nga një grup refugjatësh shqiptarë. Vendbanimi, i karakterizuar fort nga ndërtesat popullore, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përfshirë njësitë e banesave dhe kapelat e vogla, akoma ruan tipare arkitekturore fetare dhe civile, si dhe disa struktura të tjera, siç janë mullinjtë e vajit, që tashmë mbeten si një relike e kohës së shkuar.

Gjithashtu, në Firmoza gjendet edhe kisha e San Giovanni Battista është themeluar në fillim të viteve 1500 dhe e rindërtuar midis viteve 1936–1938. Brendësia, e përbërë nga tre murriza, është e mbuluar plotësisht me një mozaik të artë. “*E jëm’e ujit*” është emri i burimit, i cili ka qenë gjithmonë pjesa qendrore e arbëreshëve.

Figura të shquara të Firmozës

Enzo Vincenzo Capparelli lindi në Acquafurta më 26 nëntor 1878, ai përfundoi studimet e mesme në Katanzaro, pastaj në Romë mori një diplomë në mjekësi dhe kirurgji. Ai mori pjesë në luftën libiane dhe Luftën e Parë Botërore, si oficer mjekësor, duke arritur

gradën e nënkolonelit dhe mori dy medalje për trimëri. Pas luftës, ai u specializua në stomatologji dhe u transferua në *Vittorio Veneto*. Këtu ai u dallua si njeri, si mjek dhe mbi të gjitha si studiues.

I pajisur me një njohuri enciklopedike nga një epokë e re, ai u tërhoq nga Pitagora, i cili shumë shekuj më parë kishte rrezatuar mençuri nga Kalabria e tij në tërë botën. Puna e tij e parë ishte “Urdhri i kohërave dhe formave në natyrë” i cili u botua në 1928-29 për botimet Cappelli. Më 1940 “La sapienza di Pitagora” ishte vepër e pjekurisë së plotë të Capparelli. Në këtë libër, Pitagora dhe Pitagorianizmi janë përballur me një dokumentacion kaq të gjerë kritik dhe një aparat aq të gjerë filologjik, sa që mund të konsiderohet traktat i mirëfilltë dhe si puna më e plotë e shkruar ndonjëherë mbi këtë temë.

“Kontributi i Pitagorës në shkencë” i vitit 1955 dhe “Tenori i Pitagorës i jetës dhe i Omoiosis” të vitit 1958 ishin dy veprat e fundit të Vincenzo Capparelli. Dy sinteza interpretuese shumë të larta mbi *Pitagoreanizmin*.

Capparelli ishte mjek dhe filozof, ai ishte një nga studiuesit më të mëdhenj të mendimit pitagorik, studimet e tij akoma edhe sot botohen për vlerën e madhe që kanë.

Leonio Caparelli lindi në Aquaformosa dhe vdiq në Napoli. Ishte një mjek kirurg shumë i zoti i “*Spedale della SS trinita de’ Pellegrini e Convalescenti*” në Napoli. Shkroi shumë vepra shkencore, ku u çmua dhe u nderua nga shumë ekipe shkencore. Në veprën “*Il dottore Pietro*”, kujtimet e tij përcjellin në motet e hershme kur ai ishte një fëmijë në Aquaformosa.

Annunziato Capparelli lindi në Acquaformosa me 19 mars të vitit 1811 dhe vdiq po në Acquaformosa, me 25 gusht të vitit 1892. Figura e këtij arbëreshi ia vlen të përmendet, sepse ai ishte një mjek i ndershëm dhe një patriot i madh.

Giosafat Frascino ishte një tjetër figurë arbëreshe e Acquaformosa, që u shqua si poet. Lindi me 30 tetor të vitit 1907 dhe vdiq me 24 korrik të vitit 1895.

Malescio Giovanni u dallua si një komandant partizan i guximshëm. Lindi me 12 shkurt të vitit 1922 në Acquaformosa dhe vdiq ne 05 janar të vitit 2004.

Simone Orazio Caparelli lindi me 30.05.1850. Ky arbëresh vinte nga një familje e pasur, dhe jetoi midis Acquaformosa ku u lind dhe Ungra ku i ati ishte zotërues i shumë terreneve.

Giovanni Mele ishte peshkopi i parë i Eparkisë së Ungras. Ai lindi në Acquaformosa më 19 tetor 1885. Mele u emërua I peshkvi i parë në 1919, kur ishte vetëm 33 vjeç. Vdiq në 10 shkurt 1979 pasi drejtoi Eparkinë e Ungra për pesëdhjetë vjet. Giovanni Mele ishte asistent në Fronin Papal. Pasardhësi i tij, Imzot Giovanni Stamati, u shpreh në këtë mënyrë mbi këtë personalitet: “Ai ishte një pastor me një zemër të drejtë, një besim të thellë, bamirësi ungjillore dhe një zell të padepërtueshëm”.

Vincenzo Matrangola lindi në Aquaformosa me 6 dhjetor 1913. Matrangola ishte profesor teologjie dhe figura shpirtërore e arbëresheve të Aquaformozës deri në vitin 2004, kur ai ndërroi jetë. Ai shkroi librin “La venerazione alla madre di dio” (“Nderimi i nënës së Zotit”).

4.1.15. *San Giorgio Albanese (Mbuzati)*

Katundi *San Giorgio*, ose *Shën Gjergji*, është pozicionuar në mënyrë të tillë që është gjysmë ore larg nga deti dhe po aq larg është edhe nga mali i Polinit. Ky fshat quhet dhe “*Mbuzat*”, sepse arbëreshi që i drejtoi quhej *Buza*.

Qytet i vogël me 1553 banorë, siç thotë vetë fjala, (*Albanese*) u ndikua nga ardhja e shqiptarëve në Itali, rreth mesit të shekullit të pesëmbëdhjetë. E vendosur në kodrat e rrafshnaltës së Silës, fshati ngrihet rreth ndërtesës së Komunës dhe “*Sheshit*”. Fshati ruan ende gjuhën arbëreshe dhe është pjesë e bashkimit Arbëria, i përbërë



nga bashkitë e *S. Demetrio Corone*, *S. Sofia D'Epiro*, *S. Giorgio Albanese*, *Vaccarizzo*, e cila vulos lidhjen kulturore italo-shqiptare.

San Giorgio nuk u themelua nga shqiptarët. Vendbanimi ekzistonte dhe kjo daton që nga epoka normanëve, me emrin *Sancto Jorio*. Këtë e dëshmon një dokument i vitit 1104, raportuar nga Abati Vincenzo d'Avino, në vëllimin i tij "Shënime historike mbi kishat arkiepiskopale, peshkopale dhe prelate të Mbretërisë së Dy Sicilive".

Arbëreshet erdhën në këto troje nga ana tjetër e Adriatikut për t'i shpëtuar pushtimit turk. Me pëlqimin e Arkimandritit të Patirionit dhe me miratimin e Contes së Coriglianos, Geronimo Sanseverino, shqiptarët ripopulluan fshatin e San Giorgio-s rreth vitit 1469-1470, duke mos pagur taksa fetare dhe feudale për dhjetëvjetëshin e parë.

Arbëreshët e San Giorgio-s, ose të Mbuzaatit iu përveshën punës, duke i bërë prodhuese këto toka, të cilat kishin qenë të shkreta prej të paktën 150 vjetësh.

Bërthama e parë e banorëve të fshatit Mbuzat ishte mjaft e vogël, por në hapësirën e disa dekadave popullsia u rrit. Kjo rritje e popullsisë ishte favorizuar ndoshta nga martesat midis Princit Sanseverino të Bisignano dhe Dukeshës Irene (1539), stërmbesës të Skënderbeut. Për këtë arsye, kur në shekullin e 16-të refugjatët shqiptarë zbarkuan në Itali, ata patën mundësi të vendosen më lehtë në territoret të tilla si San Giorgio, sepse gjetën një mikpritje jo vetëm për shkak të lidhjeve të gjakut me Princeshën Irina Kastrioti, por edhe për murgjit e Manastirit të Patire e Rossano, që i përkasin të njëjtit rit, pikërisht atij bizantin. Nga ky moment, filloi një fazë e zgjerimit demografik dhe ekonomik të qendrës së vogël shqiptare.

Kisha “San Giorgio Megalomartire”

E veçantë në Mbuzat është Kisha e San Giorgio Megalomartire-s, e ndërtuar në vitin 1700. Kisha është shembulli i integritetit të liturgjisë bizantine në një strukturë të ndërtuar sipas traditës romake. Ajo ka si elemente identifikuese tre murriza me dy kapela në stilin greko-bizantin dhe një kambanarë imponuese në stilin bizantin. Si të gjitha kishat arbëreshe në brendësi të saj gjenden shenjtorë me historitë e Jezusit të vogël, deri tek Shën Maria.

Banorët këtu flasin arbërisht. Kisha bizantine është aktive dhe është pjesë e Eparkisë së Lungrës. Është interesante se pothuajse të gjitha kishat bizantine arbëreshe nuk kanë shtëpi ngjitur. Është gjithmonë një shesh, në të cilin kisha ngrihet si një yll që ndriçon shtëpitë për qark.

Figura të shquara të Mbuzatit

Jul Variboba (Giulio Variboba, 1724-1788), është autor i këngëve të shenjta, që realizohen akoma tek Java e Madhe (Java e Shenjtë). Ai hyri në historinë e letërsisë shqipe me poemën fetare “*Gjella e Shën Mërisë së Virgjër*”, botuar në vitin 1762.

Variboba lindi në Shën Gjergjin Arbëresh, fshat me origjinë arbëreshe, në krahinën e Kosentinës, më 1724 (ose 1725). Babai i tij, Gjovani (Giovanni), ishte prift i ritit greko-bizantin në Famullinë e Shën Gjergjit Arbëresh.

Jul Variboba studimet kishtare i mori në kolegjin Korsini në Shën Benedeto Ullano; ai kishte hyrë në këtë kolegji në moshën 12 vjeç për të mbetur deri në përfundim të studimeve të mesme (të ulëta e të larta), sikundër edhe të atyre universitare, duke pranuar shugurimin priftëror më 1749 dhe duke mos e preferuar martesën, që megjithatë është e lejueshme te priftërinjtë e ritit grek. Variboba, i pajisur me “kujtesë të mrekullueshme, talent të madh dhe me shpirtmadhësi”, në studimet e tij arriti një kulturë solide, të cilën do ta zbatojë në aktivitetin e vet të ardhshëm.

Jul Variboba u bë rektor i Seminarit arbëresh të Shën Benediktit në Ullano. Në maj të vitit 1751, pas pak muajve si rektor, Jul Variboba hoqi dorë nga kjo detyrë, se babai i tij, Gjovani, famullitar në Shën Gjergj, ishte i plakur dhe i sëmurë. U kthye në vendin e vet për t’u zgjedhur në funksionin e ekonomit, si ndihmës i babait dhe në përkujdesje të famullisë.

Këngët e Jul Varibobës

Me datën 25 të çdo muaji, në kujtim të lindjes së Jezusit, këta njerëz të devotshëm mblidheshin për një meditacion të përmuajshëm, kurse pasdreke këndonin këngë në gjuhën arbëreshe, të mbledhura nga vetë Variboba. Kështu, ai gjeti në këtë lloj të kongregatës edhe këngë të gjuhës arbëreshe – në gjuhën e folur nga njerëzit e komunitetit të vet, që ishte mjeti më i përshtatshëm për të arritur në popull një formë të thjeshtë e të kuptueshme. Në ato momente duket ta ketë nxjerrë gjenezën e veprës së vet, “Gjella e Shën Mërisë Virgjër”, të kompletuar në formën përfundimtare në Romë, në të cilën paraqet në brendinë e vet ndërshtënie (interpolacione) të ndryshme në këngët e kushtuara Marisë, Jezusit dhe shenjtorëve, por edhe elemente kryesore të doktrinës së krishterë.

“Gjella e Shën Mërisë Virgjër”

Në vitin 1762, botoi veprën “Gjella e Shën Mërisë Virgjër”- një vepër që nga studiuesit është vlerësuar si kalimi nga poezia e llojeve të shkurta në poemën e gjatë, gjë që s’ishte parë deri në atë kohë ndër shkrimtarët shqiptarë. Në dy prozat hyrëse të veprës: “Oj e ndërurja

Rrexhin (Oj Mbretëresha e nderuar)” dhe “Oj ti çë dhjexasën (Ori ti që mëson)”, gjejmë shumë elemente që e kthjellojnë zanafillën, zhvillimin dhe qëllimin e poemës, si dhe veprimtari që pasqyrojnë momentet e spikatura festuese të ciklit vjetor liturgjik. Jul Variboba shfrytëzoi të folurën e vendit të vet, sepse donte të kuptohej prej njerëzve, por megjithatë nuk u tregua fort i kujdesshëm për purizmin e gjuhës, sepse tejkaloj në italianizma për nevojat e terminologjisë teologjike dhe gjithashtu për nevojat metrike.

Në vitet në vazhdim, Jul Variboba mërgoi në Napoli dhe nga viti 1761 thirret nga Papa në Romë, ku qëndroi deri në fund të jetës, më 1788.

Jul Variboba u padit në Vatikan se kishte rënë në mëkat me një vajzë të fshatit, mëkat të cilin e pohon edhe vetë në kreun e dytë të veprës së tij. Prindërit kishin dashur ta martonin përpara se të dorëzohej prift. Jul Variboba nuk kish pranuar, sepse e urrente martesën, por pas shumë lutjesh nga familja e farefisi, pranoi të shkonte në Napoli për të gjetur nuse. Pasi qëndroi disa kohë në qytetin e madh, u kthye më në fund në fshat, ku hapi fjalën se nusja do të mbërrinte së shpejti. Nuk mbeti njeri pa dalë të shohë e të përshëndesë nusen e Varibobës, por u çuditën së tepërmi kur panë në vend të nuses një shtatore të Zonjës Shën Mëri. Djaloshi s’përmbahej dot nga gazi, hoqi unazën e tij dhe ia shkoi në gisht Zonjës së Bekuar, duke thënë se ajo ishte nusja e tij.

Në “Qytetin e Përjetshëm” ku shkroi veprën e tij të pavdekshme “Gjella e Shën Mërisë Virgjër”, e cila u botua në Romë më 1762, pati fatin të njihej me shumë dijetarë e filozofë të kishës. Thuhet se ai vdiq duke thënë meshën dhe menjëherë u hap fjala se trupi i tij nuk ra përdhe, por qëndroi një pëllëmbë mbi tokë, derisa e morën për ta përcjellë në banesën e fundit.

Figura të tjera të shquara të Mbuzatit:

Anton Argondica (ital. Antonio Argondizza, 1839-1918) ishte folklorist, poet dhe

botues nga Mbuzati (ital. *San Giorgio Albanese*) në krahinën e

Kozencës. Studimet i përfundoi në kolegjin e Shën Adrianit, ku edhe qe mësues më vonë. Argondica bashkëpunoi me një varg periodikësh me artikuj mbi folklorin dhe gjuhën shqipe. Më 1890 vizitoi Spanjën, Francën dhe Shtetet e Bashkuara, ku themeloi gazetën “*L’Emigrato italiano*”. Më pas vizitoi Shqipërinë. Argondica është i njohur kryesisht si botues i “Ili i Arbreshvet” (Ylli i Arbëreshëve), revistë e themeluar më 1896 me porosi të kongresit të parë albanologjik në Koriliano Kalabro të kryesuar nga Jeronim De Rada, më 1895. Kjo ishte një revistë me peshë në botën letrare arbëreshe, por, ashtu si shumë organe shqiptare shtypi të shekullit të nëntëmbëdhjetë, nuk e pati jetën të gjatë dhe u zëvendësua një vit më pas nga “La Nazione albanese” e Anselm Lorekios. Përveç shkrimeve në italishte për folklorin dhe gjuhën, dhe përveç një vepre mbi kolegjin italo-grek S. Adriano, Koriliano Kalabro 1884 (Kolegji italo-grek i Shën Adrianit), Argondica ishte edhe autori i disa vjershave shqip. Ato nuk kanë ndonjë nivel të dukshëm, vetëm mund të përmenden për interesa gjuhësore.

Atanazio Dramis (Attanasio Dramis) lindi në San Giorgio Albanese me 1 maj të vitit 1829. Në vitin 1842 kur ishte në moshën 13-vjeçare, ai hyri në kolegjin italo-shqiptar të San Adriano-s. Në këtë shkollë konsolidoi miqësinë e tij me të rinjtë e tjerë italo-shqiptarë, si: Agesilao Milano, Angelo Nociti dhe Nicodemo Baffa.

Në vitin 1851, ai u burgos në burgjet e Kalasë së Kosenzës. Më vonë u burgos në burgjet e Santa Maria Apparente-s, ku, pa gjyq, u la i lirë më 6 qershor 1860. Për të pasur lidhjet me Garibaldin, u nis për në Kosenzë, ku pati kontakt me Komitetin Revolucionar. Ai organizoi një batalion shqiptarësh në Mbuzat dhe luftuan kundër burbonëve.

Në qershor të vitit 1862 u gjend përsëri me Garibaldi në Palermo. Mori pjesë në shtypjen e brigandazhit, duke pasur sukses me shqiptarët e tij në kapjen e brigandës Serravalle. Më 1864 u transferua në Napoli, ku vëllai i tij po studionte inxhinierinë civile, duke u bashkuar me redaksinë e “Popolo d’Italia”. Këtu ai u takua me figura të shquara të politikës dhe të kulturës, përfshirë Giorgio

Mileti dhe Giuseppe Fanelli, por ngeli i zhgënjyer nga politika pas bashkimit të Italisë.¹⁰⁶

Vincenzo Canadè (shek. XVIII), i cili që nga viti 1767 punoi si mësues i gjuhës greke në shkollën e mesme të Barit.

Atanasio Dramis (1829-1911), patriotët, i cili dha një kontribut të madh Risorgimento-n Italiane.

Ercole Lupinacci (1933), peshkop i Eparkisë së “Horës së Arbëreshëvet” dhe më vonë, Peshkop i Eparkisë së Ungrës.

4.1.16. Santa Caterina Albanese (Picilia)

Destinacioni tjetër është *San Caterina Albanese (Picilia)*. Në hyrje të Picilias gjendet një fotografi gruaje arbëreshe, veshur me kostumin tradicional, me vështrimin e ngrohtë, e cila duket sikur të thotë: “*Mirë se erdhët vëllezër shqiptarë!*”.

Si të gjithë arbëreshët e tjerë në Itali, edhe arbëreshët e Picilias u vendosën mbi këtë kodër 472 metra mbi nivelin e detit, që shtrihet midis pllajës së Esari-t e përroit të Ricorsoli-t, që nga fundi i shekullit XIV, kur Ballkani u pushtua nga osmanët. Tabelat janë dygjuhëshe.

Qyteti u themelua në shekullin XV nga emigrantët shqiptarë, të mirëpritur nga princi i Bisignano-s në fushat e tij. Më 1578 u nda nga shteti i Bisignano-s dhe iu dha familjes Bruno, e cila e mbajti atë deri në vitin 1583. Më vonë, Picilia i përkiste Murtado-s (1583-1638), Dattilo-s (1638-1704) i cili kishte titullin e markezit, Sambiase-s (1704-1784) dhe së fundi, Sanseverino-s së Saponara-s, i cili e mbajti atë deri më 1806. Nga viti 1928 deri më 1934 qyteti ishte pjesë e Komunës së Fagnano Castello, për t’u rikthyer më pas në autonominë e vet administrative, pikërisht në vitin 1976.

Shtëpitë janë karakteristike të një qyteze malore, të larta dy-tre

¹⁰⁶ N. Cortese, “Kalabria në Risorgimento Italiane”, në “Punimer e Kongresit të 2-të Historik të Kalabresit”, Napoli 1961, fq. 13.



kate. Ato janë fare pranë njëra-tjetrës, me shkallë të jashtme që të çojnë nga njëri kat në tjetrin. Shtëpitë janë të gjitha prej guri e në të njëjtën ngjyrë gri. Teksa i shikon, zhytesh në atmosferën e një “gjitionie” që arbëreshët e mbajtën gjallë deri 40 vite më parë. Nuk sheh të rinj, por vetëm pleq.

Pranë bashkisë së qytetit, ngrihet pallati i lashtë i familjes Chiurco. Rrugicat e shtruara ende me kalldrëm dhe harqet e vjetra të kujtojnë hijeshinë dhe lashtësinë e tij.

Kur shfaqen muralet, zemra rreh fort. Duket se Arbëria këtu nuk po vdes, por po ringjallet. Atmosfera e këtyre muraleve është aq e bukur, saqë çdo vizitor e të pamundur të mos përfshihet emocionalisht me to.

Pak më tutje është shtëpia e lindjes së At Francesco Antonio Santorit. Rrugës për te shtëpia ku lindi, shfaqet pas disa minutash tabela “Udha e Frangjiskos”. Figura e tij njihet dhe nderohet në të gjitha katundet arbëreshe të zonës. Ai është një shkrimtar dhe artist poliedrik i rëndësishëm në kulturën arbëreshe të ‘800-tës. Intelektuali i rafinuar kontribuoi në historinë e letërsisë arbëreshe. Santori ka lënë trashëgimi një sërë dorëshkrimesh, që nuk janë botuar. Disa prej tyre e kanë njohur botimin kohët e fundit.

Në veri të Picilias ndodhet Kisha Nënë, kushtuar Shën Nikollës së Madhe në stilin barok. Rruga “Pantaleone” fillon nga qendra e vogël e banuar, nga e cila sheh kishën “Santo MM Nikomedia”, e ndërtuar më 1600, dhe më tutje gjendet kisha e Shën Pantalliut. Në këto kisha, arbëreshi krijoi një atdhe, në një tokë që nuk ishte e tij, lutet në gjuhën e tij në një copë tokë që askush nuk ua dhuroi, por e fituan.

“*Udha e Bukura Pamje*” është rrugica, ku në fund të saj, shfaqet një panoramë piktoreske e qytezave përreth, të rrethuara nga gjelbërimi e atmosfera mistike e natyrës, panoramë që e justifikon denjësisht emrin e rrugës.

Kostumet arbëreshe këtu vishen vetëm në ditët e festave. Më të vjetrit mundohen t’ua trashëgojnë ato brezave më të rinj, që të jenë krenarë për rrënjët e veta.

Figurat e shquara të Picilias

Francesco Antonio Santori (arbërisht: Françesk Anton Santori, ose Ndon Sartori; 16 shtator 1819 - 7 shtator 1894). Ishte shkrimtar, poet dhe dramaturg nga Picilia.

Drama e tij “Emira” konsiderohet si drama e parë shqiptare e shkruar ndonjëherë. Me një angazhim social e edukativ, At Santori u frymëzua nga komuniteti arbëresh dhe provoi të shkruajë në të gjitha gjinitë letrare, vargje, novela, romane, melodrama etj. “Emira” rrëfen aventurat e Emira, Kalina, Albenci dhe Mirjani gjatë një revolte sociale në Kalabri, dhe jetën në komunitetet arbëreshe. Disa pjesë të dramës u botuan fillimisht në revistën “Fiamuri Arbërit” të De Radës dhe më vonë, në “Antologjinë Shqiptare” të Jeronim De Radës. Ai është autor i një sërë këngësh arbëreshe, përrallash, rapsodish popullore, këngësh fetare, të cilat interpretoheshin në ditë festash. Pati meritë në krijimin e fjalëve të reja, madje në një ese të tij, shkruan mbi krijimin e një alfabeti të ri në gjuhën shqipe. Risia e penës dhe kontributit të tij në letërsinë arbëreshe është se në ndryshim nga romantikët e epokës së vet, ai i këndoi popullsisë arbëreshe jo sesi ishin e çfarë ishin dikur, por ashtu siç i shihte. Kjo është dhe merita absolute e artit të Ndon Santorit.

Ai, gjithashtu, përshtati 112 të fabula të Ezopit dhe shkroi një libër mbi gramatikën e shqipes. Santori e shkroi poezinë e tij të parë, të titulluar “Canzoniere Albanese” në vitet 1830 dhe e botoi më 1846. Libri i këngëve shqipe është një poemë e gjatë lirike, kushtuar dashurisë dhe natyrës. Poema u ndikua nga “Këngët e Milosaos” e Jeronim De Radës. Në vitin 1848, kompozoi një himn në shqip me titull “Valle e haresë madhe”, botuar më 23 shkurt 1848 në revistën e De Radës “L’Albanese d’Italia”.

Më 1848 shkroi poemën “I burgosuri politik”, e shkruar në shqip dhe italisht, e cila u botua në Napoli. Poema rrëfen ndryshimet në jetën e një familje të persekutuar gjatë revolucioneve të vitit 1848 në shtetet italiane. Gjatë viteve në manastir, Santori shkroi dy vepra fetare. Vepra e parë është një varg fetar me titull “Rozhari i S. Meris së Virgjër”, shkruar në shqip dhe botuar më 1849 në Kozencë. E dyta është një koleksion prej 230 faqesh me lutje, tekste fetare dhe përkthime, botuar më 1855, në Napoli.

Santori shkroi shumë pjesë dramatike, përfshirë komeditë melodramatike dhe tragjeditë, disa prej të cilave mbetën të paplota. Në dramat e tij përfshihet “Jeroboam”, një tragjedi me përmbajtje biblike dhe “Alessio Dukagino”, një melodramë e shkruar midis viteve 1855 dhe 1860, duke rrëfyer jetën e Lekë Dukagjinit, princi shqiptar, i cili luftoi kundër Perandorisë Osmane.

Në vitet e fundit, janë gjetur 1845 vargje satirike të shkruara nga Santori. Shumica e romaneve dhe tregimeve të shkurtra të Santorit u botuan pas vdekjes, më 1894. Në romanet e tij përfshihet “Sofia Kominiate”, një roman i papërfunduar, i shkruar në dy versione. Versioni i parë përmban 282 faqe dhe është shkruar në shqip, ndërsa versioni i dytë, i shkruar në italisht, përmban 714 faqe. Asnjë kopje nuk ka mbijetuar nga romani i tij “Bija e mallkuar”, e shkruar në shqip. Ai gjithashtu shkroi romanin “Ushtari shqiptar” në italisht. Santori shkroi shumë tregime të shkurtra të njohura me emrat e figurave të tyre qendrore. Tregimet e tij të shkurtra të shkruara në shqip përfshijnë: “Brisandi Lletixja dhe Ulladheni”, “Emilja”, “Fëmija Pushtjerote”, “Filaredo”, “Gnidhja dhe Kusari”, “Kolluqi dhe Sorofina”, “Miloshini”, “Neomenia”, “Panaini dhe

Dellja”, “Rosarja dhe Virginia”.

Veprat e Santorit janë shkruar në një formë arkaike të shqipes toskërishte. Në veprat e tij, Santori përdor sistemin e vet drejtshkrimor, pa ndonjë saktësi fonetike. Temat e zakonshme në veprat e Santorit përfshijnë jetën rurale, periudhën e *Lidhjes së Lezhës* dhe zakonet e komuniteteve arbëreshe. Poemat politike përmbajnë motive morale, që përshkruajnë idetë dhe ndjenjat qendrore të personazheve të secilës poezi. Në disa nga poemat si “Vallëzimi i gëzimit të madh”, Santori përshkruan elemente folklorike të kulturës shqiptare, si këngët dhe vallet popullore. Santori vdiq më 7 shtator 1894.

4.1.17. *Falconara Albanese (Fallkunara)*

Falconara Albanese, ose *Fallkunara*, është i vetmi fshat arbëresh i vendosur mbi detin Tirren. Aty ruhet riti bizantin dhe si i tillë, është pjesë e Eparkisë së Ungrës. Struktura e brendshme e *Fallkunarës* ndjek një model rrethor, që formon gjashtë nyje rrethore.



Për shkak të mungesës së dokumenteve të shkruara, nuk ka datë të saktë për ardhjen e shqiptarëve në këtë fshat, por në “Rivista Calabrese” të vitit 1800, thuhet se Falkonara u themelua nga shtatë familje shqiptare që mbërritën në Calabria në 1487, të cilët u ndalën së pari në San Pietro, midis San Lucido dhe Fiumefreddo Bruzio, duke mbetur atje për tridhjetë vjet. Realisht supozohet se kolonët, në Falconara, duhet të kenë qenë vendosur, në fillim të shekullit të pesëmbëdhjetë, në zotërimin e *Commenda Badiale di Fontelaurato*. Bazuar në informacionet e deritanishme, Falconara u themelua në vitin 1517, kur filloi ndërtimi i Manesato, rrethi Curtina dhe kisha e parë kushtuar San Atanasio. Të përfshira në Baronin e Fiumefreddo, ajo i përkiste së pari Sanseverinos dhe më pas, Marquises di Rende, i cili e mbajti atë deri në vitin 1806. Falconara mori emrin e saj të tanishëm (*Falkonara Albanese*) në vitin 1803. Interesante është fakti se ky fshat iu rikthye përsëri ritit bizatin. Kjo dëshmon edhe tolerancën e kishës latine.

Arbëreshët para se të hidhnin themelet, siguronin burimet hidrike. Edhe në Falkonara shfrytëzuan dy rrjedhje uji: Fabiano, që ndan Falconarën nga Fiumefredda Bruzio dhe rrjedhën Cavoni, që ndan Falconarën nga San Lucido. Këtu u ndërtuan shumë burime. Duke qenë një fshat me burime hidrike, arbëreshët e Falkonarës ndërtuan shumë kroje. Disa prej tyre janë: “Kroji i vjetër”, i cili është në qendrën e katundit, që shërbente si një lavanteri, ku lanin rrobat dhe i thanin ato; Kroji i bardhë, jo shumë larg nga qendra. E quanin të tillë për shkak të presionit të ujit; “Kroji i kollaringut” (*Kroji i Nikolla Ringut*), ku rrëfëhet që qëndronin refugjatët shqiptar, por që ishte pronë e Nikolla Ringut dhe ndodhet rreth 5 km nga qendra e fshatit në lokalitetin San Pietro; “Kroi i Priftit”, që buron 100 metra larg nën fshat dhe përdorej për të rrjepur derrin, si dhe për lavanteri; “Kroji i mollëve”, i cili është quajtur i tillë, sepse ndodhet mes mollëve dhe kur është koha e mollëve mban aromën e tyre; “Kroji i Sholes” ose kroji (*Fontana del Dirupo*) quhet e tillë, sepse prapa saj gjendej një gur i madh që i thonë “Sholla”; “Kroji i Sikurit” (*Fontana di Sikuri*), i cili ndodhej në tokat e Skurave, mbiemër ky që tani në Falkonara është zhdukur.

Torremozzo (Fraksion i Falconara Albanese)

Torremozzo u themelua në vitin 1467 nga disa familje shqiptare, që vinin nga Kruja, në Shqipërinë veriore qendrore, dhe nga Shkodra. Vendasit ende flasin gjuhën e origjinës. Ai gjithashtu, ruajti ritin bizantin dhe të gjitha traditat fetare të lidhura me të. Ndërtesa fetare ku është zyrtarizuar riti bizantin është Kisha e Shpëtimtarit më të Shenjtë.

Vigilja e Fatit

Në Falkonara thuhet se, në ditën e tretë pas lindjes së një fëmije, fati shkon në shtëpinë e tij për të “shkruar” të ardhmen. Për këtë arsye, prindërit vendosin tryezën duke rregulluar tre vende dhe duke heshtur, në mënyrë që mos t’i shqetësojnë ata. Ata shpresojnë se në këtë formë ata do të jenë madhështorë me fëmijën e tyre.

Figura të shquara

Felice Stafa (Felice Staffa)

Felice Antonio Tommaso Dionisio Staffa lindi në Falkonara Albanese me 5 mars të vitit 1801. Nëna e tij, Donna Giustina Angeli ishte një fisnike me origjinë nga San Lucido dhe babai, baroni Samuele Staffa, një fisnik i cili mbajti detyrën e kryetarit arbëresh për tre herë dhe për shtatëmbëdhjetë vjet në total (1812-1821; 1826-1829; 1832-1837).¹⁰⁷

Mësimet e para i mori pranë familjes dhe studioi italishten,

¹⁰⁷ F. A. Staffa, *Opera Omnia*, Vëllimi 1, Opere Edite, redaktuar nga A. Matrangolo, A. Stracan, *Administrata Komunale e Falconara Albanese*, 2009, f. 17-22.

Tre gjysmë vëllezërit e Felice Staffa ishin Felice Maria Staffa, e lindur në 1784, Fedele Maria Staffa, i lindur në 1788 dhe Nicolina Staffa e lindur më 1789, e cila u martua në 1810 me Luigi Pasquale-n, fisnik i Tessano-s. Shih gjithashtu, Mateo Mandala, “Poezia Popullore dhe Poezia e Artit në Rilindja: Kërkime dhe studime të italo-shqiptarëve”, në: “Punimet e Kongresit XIV Ndërkombëtar të Studimeve Shqiptare”, Palermo, 25-28 nëntor 1988, f. 53. Po aty, shih edhe: G. Ferrari, “Kontributi i shqiptarëve në Risorgimento Italiane”, në: “Punimet e Konferencës së Parë të Studimeve Shqiptare”, Bari, 9-10 Prill 1960, Tipografia F. Bianchini, Romë, 1960, f. 14-38.

latinishten dhe greqishten. Në moshën tetëvjeçare, ai u dërgua për të studiuar në “Real Collegio di Cosenza”, ku ai ishte në gjendje të demonstronte inteligjencën e tij shumë të shpejtë dhe kujtesën e tij të fortë. Më 1817 u transferua në Napoli, ku u diplomua në shkencat juridike nga Universiteti Mbretëror i Napolit. Në vitin 1837 nga dhimbja e humbjes së nënës së tij dhe dy fëmijëve, Staffa nisi të merret me letërsi. Në 1841 u shfaqën dy vepra të tij në Napoli. E para titullohej “Il sole del 12 Gennaio”, kushtuar princit të S. Antimo, që u recitua në Accademia Cosentina dhe e dyta titullohej “Il Mattino del Maggio 30” dhe u recitua në Shoqërinë Provinciale Agronomike të Kalabria Citra. Në vitin 1843, Staffa botoi himnin “Il Vaticinio” dhe dy vjet më vonë, në vitin 1845 nxori në dritë veprën e tij më të madhe “Këngët Shqiptare”, më saktë - siç thotë nëntitulli - *Parafrazimi në italisht i teksteve shqipe të disa prej baladave më të rëndësishme legjendare arbëreshe*, të cilat autori dëshironte t’ia kushtonte Sarah Louisa Strachan (1818-1881) princeshës së Sant’Antimo.

Vitet në vijim, shënuan angazhimin politik vendimtar dhe të zjarrtë të Felice Stafës. U arrestua dhe u burgos për tre vjet në Kalanë e Kosenzës. “Vena e tij poetike”, e cila u rishfaq fuqishëm gjatë tre viteve të vështira të burgosjes, u materializua në shkrimin e kompozimeve të ndryshme, të njëjtat që autori vendosi të mos i besonte për nderin e shtypit, ndryshe nga ato që datojnë në vitet që i paraprinë burgosjes. Në vitin 1894 botoi “Kompozime politike të pabotuara, të shkruara në burgun e Kalasë së Kosencës në vitin 1850, ‘51, ‘52 nga i ndjeri Baron Felice Staffa Accademia Academico”. Këto janë tekste poetike, të cilat duke u bazuar në poezinë atdhetare të Romantizmit të dytë dhe duke përdorur stile ekspresive tipike të letërsisë italiane të Risorgimento-s, përbëjnë një dëshmi të çmuar të betejave të kryera në Kalabri nga grupe intelektualësh, kushtuar çështjes së bashkimit kombëtar të gadishullit. Staffa ndoqi këto kompozime me të tjerët që, që nga viti 1857, botuan në gazetën kulturore “La Musica”, fletën periodike për rritjen e shkencës dhe artin e tingullit, të themeluar në Napoli dhe të drejtuar nga muzikanti, kushëriri i tij Giuseppe Staffa.

Në vitin 1867, Staffa botoi esenë shkencore “Shpjegimi që mund t’i jepet Fenomenit të regjistruar deri më tani nga Sizmologët” (vëll. X - Viti 1866-67), në të cilin u trajtuan ngjarjet sizmike të kohës. Në të njëjtin vit botimi, në Napoli botoi disa poezi me frymë atdhetare. Vdiq në San Lucido, me 6 mars të vitit 1870.¹⁰⁸

Xhuzepe Stafa (Giuseppe Staffa) lindi në Falconara Albanese në vitin 1807, nga Baron Luigi Staffa dhe Maria Giuseppa Caracciolo dhe vdiq në Napoli me 16 maj të vitit 1877. Ai studioi në Napoli me mjeshtrat Ruggi dhe Tritto. Ai iu përkushtua studimit të muzikës dhe mësimit të kompozicionit, harmonisë dhe kundërvënies me një metodë të re. Në vitin 1857, ai themeloi gazetën “La Musica”, nga e cila ishte drejtor dhe pronar. Ai ishte gjithashtu edhe Presidenti i parë i seksionit muzikor të “Shoqatës Mbretërore të Shkencëtarëve, Letërsisë dhe Artistëve”, themeluar në vitin 1860. Pati një korrespondencë të gjerë me Giulio Ricordi-n, atëherë pronar i “Gazzetta Musicale di Milano”. Ishte drejtor i *Teatro del Fondo* dhe *Teatro Nuovo*.

Giuseppe Staffa kompozoi katër opera për teatrin San Carlo në Napoli: “Priamo alla tenda di Achille”, dramë nga Raffaele Valentini (1828); “Francesca da Rimini”, melodramë nga F. Romani (1831); “Beteja e Navarrinos”, dramë nga Emanuele Bidera (1837); “L’Alceste”, një tragjedi nga Sesto Giannini (1851). Pastaj kompozoi për Teatrin e Ri, më 1845, pjesën “Zingara, ose Merciaiuolo ambulante”, një shfaqje nga Quattromani; kompozoi një meshë në festën solemne të San Giacomo della Marca; një vals dhe një simfoni, si dhe një traktat për harmoninë dhe për metodën e shkollës së muzikës napolitane.

¹⁰⁸ Një kopje e një përmbledhjeje 32-faqesh me këngë popullore shqiptare, *Canti albanesi*, Napoli 1845 (Këngë shqiptare) ruhet në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë.

4.1.18. Plataci (Pllatani)

Bukuria dhe madhështia e natyrës në fshatin *Plataci (Pllatan)*, me pishat e bukura dhe të izoluara, ka mbledhur në gjirin e vet me qindra e mijëra arbëreshë.

Origjinën e emrit mund ta ketë marrë në Itali para se të shndërrohej në ngulim shqiptar, duke qenë se Platachi (Plataci) ishte një shtëpi që gjendej në fermën *Cerchiara*. Emërtimi origjinal u shndërrua nga *Plataci* në *Pllatani* nga vetë shqiptarët, ose nga disa arvanitas (greko-shqiptarë), të cilët gjithashtu u vendosën në këtë vend, kryesisht nga *Corone* dhe *Modone* (Peloponezi), ose nga një prej fshatrave të tyre të të njëjtit grup etnik: Plātani në Euboea; Plātana në Peloponez (Morea e lashtë), Plātanos në Gjirin e Korintit, Plātia në Attica, në kujtim të tokës së tyre.

Nga pikëpamja etimologjike, ajo gjithashtu mund të burojë nga fjala greke *Platania*, “pyll pemësh aeroplan” (pemë autoktone të familjes Maple orientale), ose mbase nga termi latinisht *Plateacium*, që buron nga Platea klasike, që do të thotë “fshat i pakulturuar,



vend bosh”, për shkak të faktit se territori i saj ishte disi i zymtë dhe i braktisur.¹⁰⁹

Vitet 1468-1480

Në këtë periudhë kohore territori i Pllatanit rezulton që të jetë populluar nga arbëreshë të tjerë, që erdhën në një numër më të madh nga jugu i Shqipërisë dhe në një numër më të kufizuar nga ai i zonës së veriut të Shqipërisë.

Viti 1510

Në Pllatani, famullia e San Giovanni Battista tashmë ekzistonte, në varësi të Dioqezës së Cassano Jonio.

Viti 1861

Në këtë vit, në Pllatani, ishin 1525 folës arbëreshë prej një popullsie me 1613 banorësh (94.5%).

13 tetor 1968

Ipushkvi i ri i Lungro-s, Mons G. G. Stamati (i Pllatanit) shpall një dekret shumë të rëndësishëm për përfshirjen e gjuhës shqipe në Liturgjinë Hyjnore të Shën Gjon Chrysostom-it.

9 maj 1996

Në vitin 1992, arbëreshi Mario Brunetti i Plataci-t zgjidhet deputet i Republikës së Italisë. Në maj të vitit 1996, ai riparaqet në Dhomën e Deputetëve propozimin e Ligjit nr. 396, të “Mbrotjtjes së minoriteteve gjuhësore”, duke përfshirë arbërishten. Ligji përbëhet nga 20 nene të rregulluara dhe të përcaktuara mirë, në mënyrë që të shndërrohet në një dekret ekzekutiv për të mbrojtur të gjitha ato bashkësi etnike, që ende prisnin njohje ligjore.

15 dhjetor 1999

Më në fund, miratohet ligji kombëtar nr. 482, “Mbrotjtja e minoriteteve gjuhësore”. Ky ligj solli mbështetjen institucionale në drejtim të promovimit, nxitjes dhe forcimit të gjuhëve dhe kulturave minoritare, përfshirë ato arbëreshe. Me këtë ligj, komuniteti arbëresh në Itali e përfshiu brenda suazave ligjore trashëgiminë e vet shpirtërore e kulturore.

¹⁰⁹ Costantino Bellusci, *PLATACI Pllatni Cronistoria generale dal Medioevo ad oggi*, Collana culture Popolari Vol. 3 (1998), fq.17.

Ligji 482/1999 “Norma për tutelën e minorancave gjuhësore historike” ka njohur veçantinë e gjuhës që ata flasin, arbërishtjes, si dhe të drejtën e mbrojtjes së saj dhe të kulturës arbëreshe: të letërsisë që lindi shekuj më parë, këngëve dhe rrëfimeve të përcjella gojarisht brez pas brezi, të kostumeve dhe valleve, të artit të krijimit të stolive, të kuzhinës dhe të shumë e shumë të tjerave. Me pak fjalë, mbrojtjen e të gjithë përbërësve të identitetit arbëresh.

Kontributi i Platanit për Risorxhimento-n

Edhe Pllatani i dha një haraç gjaku dhe bujarie Rilindjes (Risorxhimentos), si dhe përpjekjeve për bashkimin e Italisë, duke filluar që nga viti 1848, kur në Alto Jonio Cosentino, revolucionarë e liberalë shpërthyen për të dëbuar sundimin burbon. Në këtë revoltë, mori pjesë një grup ushtarësh vullnetarë, të tillë si: Nicolantonio Marchese, Salvatore Ferdinando Trojano, Francesco Busicchio, Giacinto Bellusci, Giovanni Trojano Costa, Pietro Brunetti, Rocco Cartolano, Giovanni D’Agostino, Giovanni Dramissino, Pietro Anno Dramissino, Giovanni Costa, Francesco D’Agostino, Nicola D’Agostino, Pietro D’Agostino, Giovanni Crisostomo Trojano dhe prifti famullitar, Don Francesco i Farnetës.

Garda kombëtare italiane, seksioni i Pllatanit

Më 26 gusht 1860, Mbreti i Italisë, Viktor Emanueli II (Vittorio Emanuele II), me dekretin e 14 dhjetorit 1860, themeloi Gardën Kombëtare, e cila mbështeti ekspeditën e Garibaldit. Garda Kombëtare e Pllatanit, e cila luftoi burbonët dhe brigandët, përbëhej nga 12 seksione me 77 ushtarë, 6 robëresha, 12 korporata, 1 toger (D. Angelo Basile), 2 togerë të dytë (D. Vincenzo Bellusci dhe D. Cratisto Trojano), 1 rreshter Veronero, 1 mbikëqyrës dhe 1 kapiten (Ferdinando Troiano), i cili formoi Këshillin e Disiplinës.

Muralet, imazhe që të përfshijnë në botën e tyre

Për të mbrojtur specifikën etnike arbëreshe (ligji 482/99 dhe LR 15/2003), Pllatani mori nismën e muraleve, në sipërfaqet e mureve të shtëpive në qendrën historike. Qëllimi kryesor i nismës

është dhënia e një protagonizmi më të madh kulturës arbëreshe dhe figurave historike shqiptare si: Skënderbeu, Nënë Tereza etj.

Liqeni i Forano-s

Liqeni i Forano-s është piktoresk dhe rrethohet me pyje të dendura dhe shumë burime natyrore. Ndodhet 15-16 kilometra larg Pllatanit.

Në këtë vend ndodhet edhe “Burimi i Lartazit”, i cili është një krua, ku në të tria derdhjet, çezmat kishin një kokë luani. Për këtë arsye, i thoshin ndryshe edhe “Kroi i tre luanëve”.

Pylli i Montagnola-s “Bosco della Montagnola”

Ndodhet në kurorën e fshatit, në pozicionin më të lartë, ku janë krijuar edhe disa zona lojërash, si dhe janë ndërtuar shtëpiza druri.

Arkitektura

Kisha e Shën Mërisë së Kostandinopojës, e ndërtuar në fillim të shekullit XVII nga Martino Troiano, ruan një statujë antike të qytetit. I vetmi informacion për Kishën e Shën Mërisë së Kostandinopojës ndodhet në epigrafin latin, në një nga muret e brendshme që përmbajnë historinë e Shenjtores, ku thuhet: “*Troiano Martino e rindërtoi këtë kishë nga themelet për përkushtimin dhe bujarinë personale, në qytetin e Pllatanit, i cili fillimisht quhej S. Maria e Kostandinopojës. Më 1706 u mor në patronazh, nga vëllezërit Andrea dhe Agostino Troiano, pasardhës në linjë të drejtpërdrejtë nga themeluesi, Troiano Martino. Ata e rindërtuan dhe e pasuruan dhe kështu vazhdoi me pasardhësit e së njëjtës familje Martino që gjithashtu e morën këtë të drejtë deri më 1791. Pietro Trojano, në vitin 1795, e ktheu kishën në një gjendje më të mirë. Ser Nicola La Padula e suvatoi në vitin 1795*”.

Stema e Pllatanit në kishën Madonna e Kostandinopojës

Një “fushë qielli”, pemë e gjelbër (simbol i jetës dhe shpëtimit nga armiku), shpresa dhe munda i natyrshëm, ku mbështetet në të majtë luani i artë, me të dyja këmbët e përparme në trungun e asaj peme, e cila në të djathtë shoqërohet nga tre yje me tetë rreze të arta.

Kapela e Madonna del Monte, e ndërtuar në vitin 1954, u restaurua në verën e vitit 2010. Festa zhvillohet më 21 gusht, me procesionin e mëngjesit dhe të pasdites. Gratë e devotshme mbajnë shporta me qirinj të zbukuruar me lule dhe kërcëjnë rreth Madonna-s. Pasdite, besimtarët pasi marrin pjesë në procesionin e shenjtë nëpër qytet, fillojnë një pelegrinazh përgjatë rrugëve të pyllëzuara në malin Barone, ku ndodhet kapela.

Kisha e San Rocco-s (Roko)

Kisha e S. Rocco-s është ndërtuar në fund të shekullit XIX. Ajo qëndron në pjesën më të lartë të qendrës historike të Pllatanit. Fasada e përparme ka një stil të kthjellët klasik, pa dekorime. Ka një hark të rrumbullakët, të kapërcyer nga një dritare katrore. Në secilin mur anësor ka një dritare të vogël në pjesën më të brendshme të kishës. Sot ka vetëm një kambanë. Çatia është e pjerrët dhe përbëhet nga një dërrasë, e mbështetur nga tufa prej druri, tani të degraduara, të mbuluara me një mantel prej pllakash antike të çatisë. Brenda është altari kryesor që mbështetet në murin e përparmë, përballë veriperëndimit, duke mbajtur afreske me një motiv fetar jo plotësisht të dukshëm, sepse ato janë të dëmtuara dhe pesë altarë të tjerë: tre mbështetur në murin anësor në të djathtë dhe dy në murin e majtë. Ndërtesa e shenjtë, si të gjitha kishat e lashta të bashkësive italo-shqiptare të ritit bizantin, nuk u ndërtua sipas kanoneve arkitekturore të kishave bizantine. Në fakt ajo u ndërtua me një mjedis arkitektonik latin, pasi Famullia e komunitetit të Pllatanit i përkiste Dioqezës së Cassano-s. Ishte tek kjo kishë e vogël që, para mbylljes së saj kremtohej mesha për nder të San Rocco-s, më 20 gusht të çdo viti. Sot, e gjithë festa dhe shërbimi fetar drejtuar Shenjtit, kryhen pranë vetë kishës së San Rocco-s.

Kisha “San Giovanni Battista”

Kisha “San Giovanni Battista”, ose e Shën Janit, është e ndërtuar me gurë dhe e mirëmbajtur me sakrifica. Si në shumë fshatra të tjerë arbëreshë, edhe këtu nuk ka një datë të saktë se kur mbërritën në këtë troje arbëreshët. Një datë e shënuar është data 24 qershor, që

është festa e Shën Janit Pagëzor, shenjtori me ritin bizantin, të cilin e sollën me vete që nga koha e Skënderbeut. Kisha është një ndërtesë e shekullit XV, me një kullë katrore, e cila mbizotërohet nga një fanar tetëkëndësh. Pjesa e brendshme u rindërtua në periudhën baroke dhe ruan statuja druri.

Sipas historianit Francesco Russo,¹¹⁰ komuniteti i Pllatanit më 1535 kishte famullinë e vet, e cila i përkiste Dioqezës së Cassano-s, por ne nuk e dimë nëse kisha famulli ekzistonte. Të dhënat e para historike të pranisë së saj datojnë, megjithatë, në vitin 1600. Në shekullin XVIII, gjithnjë sipas Russos dhe nëpërmjet një studimi të tij historiko-arkitekturial, ai u zëvendësua nga një i ri me tri naveta, pasi nuk kishte mbivendosje. Ndërtesa e shenjtë, si të gjitha kishat e para të bashkësive italo-shqiptare të ritit bizantin, nuk u ndërtua sipas kanoneve arkitektonike të kishave bizantine, për shkak të situatave të veçanta, në shekujt e kaluar, në kontakt me ritin dhe autoritetet kishtare latine.

Në dallim nga e kaluara, kur kisha nënë e Pllatanit u ndërtua me një qasje arkitektonike latine (siç thamë, ajo varej nga Dioqeza e Cassano-s), sot brenda saj paraqet disa pajisje karakteristike për ritin, si p.sh. prania mbizotëruese e ikonave në vend të statujave dhe një altar i vendosur në qendër të apseit. Brenda ka pasur (dhe ka ende) një restaurim të fortë të formave, që karakterizojnë një kishë të ritit bizantin.

Ndodhet në zemër të qendrës historike të Pllatanit, drejt së cilës mblidhen të gjitha rrugët kryesore të qytetit. Kompleksi i ndërtesave që përfshin kishën në anën verilindore, zhvillohet në një plan shumë të parregullt dhe është shkatërruar pjesërisht. Për të krijuar një hapësirë para saj, që përbën oborrin e kishës, është ndërtuar një argjinaturë e mbështetur nga një mur guri, me parapetin e tij, pjesërisht katror. Në rinovimin e parafundit të përgjithshëm, që daton nga viti 1955, parapeti i gurit u rinovua me një seri pllakash, të bëra me tulla terakotë dhe të lidhura në krye nga një frenë betoni

¹¹⁰ Francesco Russo, "Storia della Chiesa in Calabria: dalle origini al Concilio di Trento", *Volume 5 of Collana "Quaderni di scienze umane"*, Rubbettino, 1982.

e përforcuar dobët. Gjithashtu, në atë kohë, hambari përballë kishës në anën jugore u rrënuar, gjë që i lejoi asaj të rimarrë më shumë dritë dhe dekor. Në vitin 1993, kisha u rregullua plotësisht dhe me atë rast, hapësirat përpara u shtruan me pllaka guri vendase, muri rrethues me tulla terakotë u rinovua dhe u vendos ndriçimi i jashtëm me shufra stilesh dhe fenerë të lashtë. Suvaja e jashtme, e bërë me veprat e vitit 1955, më pas u hoq dhe muratura prej guri, që doli në dritë mbaroi me spërkatje llaç çimentoje, duke krijuar pamjen e fytyrës që mund të admirohet.

Pallate me vlera historike

Pallati Brunetti, shekulli XVIII

Pallati Adduci, shekulli XVIII

Pallati Bellusci, shekulli XVIII

Pallati De Paola, shekulli XVII

Figurat e shquara të Pllatanit

Arqipeshkvi Angelo Basile lindi në Pllatani, më 31 mars 1813, nga Antonio dhe Lucia Basile. Studioi në Seminarin italo-shqiptar të Shën Adrianos, në Shën Mitër Korone (nga viti 1829 deri më 17 shtator 1841), ku ishte miku i përhershëm shoqëruar (në 1833) i poetit Jeronim de Rada. Pasi u shugurua meshtar, më 17 korrik 1841, filloi shërbimi baritor në vendin e tij. Ai mbeti në Parinë, deri më 31 tetor 1847 dhe më pas, shkoi në Napoli, ku ai kreu shërbimin si mësues për djemtë e Markezit Lignola. Në këtë kohë takohej me shokun vëllazëror De Rada, i cili i kishte sjellë disa këngë arbëreshe, të mbledhura nga banorët e Pllatanit dhe vendeve të tjera shqiptare. De Rada i përktheu më pas edhe në italisht këto këngë.

Nga data 27 deri më 29 janar 1848, Basile (Vasili), në qytetin napolitan, mori pjesë në kryengritjet liberale kundër burbonëve. Duke udhëhequr një rresht të dyfishtë studentësh e duke festuar shpalljen e Kushtetutës të dhënë nga Mbreti Ferdinand II, endej nëpër rrugët e qytetit dhe betohet për besnikëri ndaj *Statutit të ri*. Vdiq në moshë të re, në korrik të vitit 1848.

Demetrio Chidichimo lindi në Pllatani, më 12 korrik 1846. Ishte djali i Pietro dhe Serafina Camodeca da Castroregio. Në moshën 6-vjeçare, hyri në Kolegjin e Shën Adrianos në San Demetrio Corone, ku mbaroi studimet dhe u shugurua prift në vitet 1864-1866.

Ishte poet dhe shkrimtar, njohës i thellë i latinishtes dhe i greqishtes, nga e cila përktheu “Psalterin e Davidit” në tercetat e Dantes, disa prej të cilave janë ende të pabotuara. Botoi shumë poema të bukura në arbërisht dhe në italisht, si dhe mori pjesë me entuziazëm, me shkrimtarë të tjerë në lëvizjen për pavarësinë e Shqipërisë dhe atë letrare italo-shqiptare (Rilindja). I gjithë talenti letrar fitoi lëvdatat e Paskolit, të At Ciuti, të prelatëve të shquar dhe të humanistit të madh F.S. Alessio, me të cilin Chidichimo kishte letërkëmbim të vazhdueshëm.

Më 2 tetor të vitit 1895, Papa Chidichimo ishte i pranishëm në Kongresin Gjuhësor Shqiptar, në Corigliano, për të përpiluar një fjalor shqip-arbëresh. Më 22 prill të vitit 1900, ai mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Kombëtar Shqiptar “Pro Patria” në Romë, i cili mbërriti në të njëjtën kohë si një pelegrinazh katolik dhe dërgoi një përhëndetje të dashur për vëllezërit nga përtej Adriatikut, që ishte një inkurajim për të vazhduar në rrugën e harmonisë dhe se synimet e institucionit të tij ishin konkretizuar rreth gjuhës kombëtare.

Më 2 dhjetor të vitit 1921, si testament, duke pritur fundin e vet (ai vdiq rreth një vit më vonë, më 26 tetor 1922), shkroi sonetin “*Pendimi*”, në të cilin paraqet përmes vargjeve biografine e tij.

Salvadore Gramshi (Salvatore Gramsci) lindi në Pllatani, në vitin 1881. Që në moshë të re, ishte një tip shumë i çuditshëm. Pavarësisht se ndoqi vetëm klasën e tretë, ai u bë një shpikës i shkëlqyer. Arrin të ndërtojë një harpë me 49 tela, 25 për dorën e djathtë dhe 24 për të majtën, madje duke mësuar që të luajë me të. Shpiku dhe ndërtoi orën e kabanave të Kishës Nënë të Pllatanit, “*Patentuar Gramisci System*” dhe të vendeve të tjera, duke i bërë ato të funksionojnë vetëm me dy rrota e gjysmë dhe me vetëm një peshë motori. Me shpikjen e tij, fitoi “*Patentën Gramisci*”, të drejtën e pronësisë industriale.

Në ekspozitën ndërkombëtare në Paris, atij iu dha “Medalja e artë”, me diplomën relative dhe u emërua anëtar i Jurisë së Nderit. Në vitin 1946, gjithashtu shpiku një organ muzikor të vogël, pa pasur ndonjë njohuri shkencore në muzikë, fizikë, akustikë dhe krijoi një fuqi punëtore të specializuar për ndërtimin e kallamave dhe të xhamave.

Konceptoi ndërtimin e ndërtesës së tij eklektike në Trebisacce. Më 1915 deri në vitin 1918, gjatë Luftës së Parë Botërore, Gramshi u pranua në një fabrikë ndihmëse të shtetit që prodhonte plumba. Atje, shpiku një sistem që rriti prodhimin me rreth shtatë herë, duke fituar drejtimin e punimeve të departamentit ku shërbeu. Vdiq më 26 maj 1966.

Antonio Gramshi (Antonio Gramsci). Pllatani është i njohur si fshati i origjinës së familjes së Antonio Gramshit. Këtu organizohet çdo vit përkujtimi i kësaj figure, sepse paraardhësit atërorë të Antonio Gramshit ishin me origjinë nga qyteti i Gramshit në Shqipëri, por mund të kenë ardhur në Itali që në shekullin XVI, gjatë emigrimit të diasporës shqiptare, të shkaktuar nga pushtimi turk. Gramshi lindi në Ales të Sardenjës, më 22 janar në vitin 1891. Babai i tij, Francesco, ishte transferuar në Sardenjë që nga viti 1881, për t’u punësuar në *Zyrën e Regjistrimit Ghilarza*, dhe këtu u martua me Giuseppina Marcias. Më vonë, zyra u transferua në Ales dhe, bashkë me të, edhe familja Gramshi.

Nuk mund të injorohet fakti se në dokumentet arkivore të shekullit XVII dëshmohet se stërgjyshi, Gennaro Gramsci, jetonte në Pllatani, në Kalabri, në rrethin e Castrovillari-t, dhe se familja vazhdoi të banonte në atë zonë, deri në transferimin në Sardenjë.

Antonio Gramshi konsiderohet një nga mendimtarët më të rëndësishëm të shekullit XX. Ka shkruar 54 vëllime me shkrime filozofike, sociale, estetike etj. Ndër to shquhen “Rilindja”, “Shkrimet politike”, Materializmi historik”, “Intelektualët”, “Elementet e politikës”. Personaliteti i Gramshit ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve. Ai ka dhënë kontribut me vlerë edhe në trajtimin e një varg çështjesh teorike të letërsisë dhe të artit

në përgjithësi. Gramshi analizoi strukturën kulturore dhe politike të shoqërisë. Ai përpunoi në veçanti konceptin e hegjemonisë, sipas të cilit, klasat në pushtet imponojnë vlerat e tyre politike, intelektuale dhe morale në të gjithë shoqërinë, me qëllim bashkimin dhe administrimin e pushtetit rreth një kuptimi të përbashkët, të ndarë nga të gjitha klasat shoqërore, përfshirë ato vartëse.

Si aktivist dhe për idetë e tij politike, Antonio Gramshi u dënua. Pas periudhës së lirisë së kushtëzuar dhe lirisë së plotë, më 25 prill 1937, ai pëson një hemorragji cerebrale. Dy ditë më vonë, më 27 prill, vdiq. Hiri i tij u depozitua në varrezat e Veranos dhe, më vonë, u zhvendos në varrezat jokatolike në Romë.

Giovanni Stamati lindi në Pllatani, nga Angelo dhe Antonietta Stamati, më 9 qershor 1912. Pas shugurimit priftëror, u emërua fillimisht prift famullitar i Firmos, deri më 1942 dhe më pas famullitar i Lungros, nga 1943 deri më 1967. Më 25 mars 1967 u zgjodh nga Papa Pali VI, peshkop i Stefaniakos dhe Administrator Apostolik, selia e plotë e Eparkisë së Lungro-s. Më 29 qershor të vitit 1967 u shenjtërua peshkop i asaj Eparkie, të cilën e mbajti deri më 7 qershor 1987, ditën kur u nda nga jeta. Gjatë 20 viteve të jetës episkopale, ishte një pastor i përlulur dhe i dobishëm i popullit të Zotit.

Zelli dhe virtytet e tij të krishtera mbetën të rrënjosura në zemrat dhe mendjet e të gjithë ndjekësve të tij. Në secilin prej tyre la imazhin e pashlyeshëm të një shpirti të ëmbël dhe atëror, i cili gjithmonë manifestohej me një ndjenjë të dashur të krishterë dhe me një dëshmi ungjillore të palodhur, me besnikëri të plotë ndaj Zotit dhe në udhëzuesin shembullor shpirtëror të kishës së tij lokale.

Francesco Chidichimo lindi në Pllatani më 20 mars 1915, nga Serafino dhe Caterina De Paola. Pasi mbaroi studimet në Seminarin e Grottaferrata-s, hyri në Kolegjin Grek të Romës. Aty mbaroi studimet për filozofi dhe teologji, në universitetin pontifik të “*Angelicum*”. Më 21 prill 1940, u shugurua meshtar nga Xhovani Mele në Kishën e Shën Atanasio-s.

Gjatë qëndrimit në kolegji spikati për inteligjencën dhe kulturën e

fortë. Që atëherë, Chidichimo kishte një “forma mentis” largpamëse, e cila e bënte gjithmonë të mençur dhe i jepte një pamje të gjerë të gjërave. Si përfaqësues i Kolegjit Grek, si dhjaku më i madh, ai mori pjesë në kurorëzimin papal të Pius XII, në Bazilikën e Vatikanit, San Pietro, në Romë. Disa herë e manifestoi intuitën e tij të spikatur, veçanërisht kur pranoi dispozitat e peshkopit Giovanni Stamati. Ai gjithashtu luftoi për përfshirjen e gjuhës arbëreshe në liturgjinë e bashkësive shqiptare të Eparkisë së Lungro-s.

Martin Basilio Bellusci lindi në Pllatani, më 1 janar të vitit 1921. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u plagos në frontin e luftës afrikane. I punësuar në Komunën e Pllatanit deri në vitin 1962, ai u transferua në Kozencë. Belushi ishte themeluesi i Seksionit të parë të Partisë Komuniste Italiane të Pllatanit, në të cilin shërbeu deri në vitin 1956. U shkëput pas ndërhyrjes ushtarake sovjetike në Hungari, e cila shkatërroi kursin e ri të demokracisë nga qeveria komuniste e *Imre Nagy*-t. Ai ishte udhëheqësi i grupeve fshatare dhe mori pjesë aktive në luftën e fshatarëve të detit Jon të epërm për çlirimin e tokave, të cilat patën rezultatin më domethënës në Reformën Agrare.

Pas vitit 1956, u anëtarësua në Partinë Socialiste italiane dhe mbeti anëtar deri në vitin 1988. Nga viti 1964 deri më 1988 ishte kryetar i Komunës së Pllatanit, i zgjedhur, në kandidaturën e tij të parë, në listën qytetare “*Dega e Ullirit*”.

Në vitet ‘60, Pllatani ishte një qytet i vogël i disa shtëpive të ndërtuara dobët, pa kujtime për të treguar, sikur, këtu, koha me rrënojat e saj kishte mbuluar çdo gjë. Gjithçka ishte e përkohshme, gjithçka u vendos atje, në mënyrën e mirë, për njerëzit në nevojë, të përulur që kënaqen me pak. Pllatani ishte një vend i izoluar, pa një rrjet rrugor të përshtatshëm, që e lidhte atë me *Scalo di Torre Cerchiara*. Gjatë qëndrimit të gjatë në krye të bashkisë, Martin Basilio Bellusci, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, kryen punime të rëndësishme, duke e rindërtuar vendin, duke e detyruar atë të rritet dhe të fitojë solidaritet dhe ndjeshmëri civile. Rruga rajonale që lidh Pllatanin me Villapiana-n u asfaltua. U ndërtua

ujësjellësi “Frida”, rrjetet e ujit dhe kanalizimeve, u zgjerua ish-”Piazza Marconi”, u zgjerua “Piazza del Popolo”, u ndërtua sheshi i qytetit të ri, u ndërtuan shkollat fillore dhe thertoret, u themelua shkolla e mesme, u ngrit një konsultore pediatrike dhe, më 1983, u ngrit edhe Garda Mjekësore. Më 1969 u miratua hartimi i perimetrit të qendrës së banuar. Përveç kësaj, u ndërtuan rrugë të shumta ndërkrainore dhe u krijua një shkollë fillore në rrethin “San Giovanni”. Ai ishte anëtar i Qarkut të Komunitetit Malor, duke ndihmuar në zhvillimin e detit të epërm Jon. Bellushi ishte gjithnjë në anën e shtresës punëtore dhe të të gjithë popullatës, pa ndonjë paragjykim ideologjik ose shoqëror. Vdiq më 24 shtator 1997.

Luigi De Paola lindi më 20 maj 1942 në Pllatani, djali i një sindikalisti komunist, Mimì, i cili vdiq tragjikisht në një aksident rrugor, duke u kthyer nga një takim i sindikatës në fillim të viteve 1960. Luigi, i cili dëshiron të jetë për të gjithë dhe në çdo fushë, Gigino, është një komunist i ri, i cili dëgjon arsyet e më të dobëtëve dhe menjëherë dëshira për të vazhduar punën e të atit ishte e fortë tek ai. Brenda Partisë, ai mori poste ekzekutive në nivele të ndryshme, derisa u bë një komponent në rang krahine në periudhën e fundit të jetës së Partisë Komuniste italiane.

Seksioni mitik “Gramsci” i Piazza Duomo në Cosenza është një vend i gjallë në politikën sociale, ku Gigino De Paola karakterizohet nga harmonia e tij e jetës, ekuilibri dhe aftësia për të krijuar konsensus dhe unitet. Ai respekton dhe respektohet. U martua në vitin 1968 me Francesca Garofalo-n, me të cilën pati tre fëmijë; Mimì, Carola dhe Massimiliano. Ai u diplomua në Shkencat Ekonomike dhe Sociale në Universitetin e Kalabrisë. Mes interesave të tij, i kushton vëmendje të veçantë problemeve të lidhura me shëndetin. Në vitet ‘60-’70, ishte një militant dhe udhëheqës brenda CGIL. Në vitin 1989, Luigi De Paola ishte një nga më të vendosurit për të mos varrosur mitet, simbolet, traditat dhe idetë. Ai do të jetë një nga themeluesit dhe koordinatori krahinor i *Lëvizjes së Referencës Komuniste* që nga lindja e saj, në shkurt 1991. Ai u zgjodh sekretar

krahinor i PRC dhe anëtar i Komitetit Kombëtar Politik. Më 23 prill 1995, u zgjodh Këshilltar Rajonal në legjislaturën e gjashtë. Është i pari i zgjedhur me 3,218 vota.

Në vitin 1999, ishte zëri i ligjit ARPACAL për zhvillimin e qëndrueshëm të një Kalabrie europiane dhe mesdhetare. Zhvilloi beteja të rëndësishme, duke u përfshirë mbi të gjitha në aktivitetet legjislative në lidhje me çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe pakicat gjuhësore. 27 propozime legjislative (ndër të cilat, ai ishte kundër barrierave arkitektonike dhe kundër azbestit), 179 pyetje, 30 interpelanca janë trashëgimia e tij si këshilltar para *Rifondazione*-s. Vdiq në Rende, më 25 dhjetor 2003.

4.1.19. Castroregio (Kastëjnexhi)

Pllatani nga *Castroregio* (*Katrorexho*) nuk janë larg në vijë ajrore dhe janë tri rrugë që lidhen me njëra-tjetrën. Castroregio dallohet që nga larg, sepse është në majën e një kodre dhe i ngjan një qiriu, ku rreth e qark qëndrojnë shtëpi, të cilat duken si bletëza rreth një koshereje. Ndodhet 819 metra mbi nivelin e detit.



Kastëjnexhi u themelua midis fundit të shekullit XV dhe fillimit të shekullit XVI, nga mërgimtarët shqiptarë, të cilët u vendosën në Kalabri për të shpëtuar nga pushtimi osman i territoreve të Shqipërisë dhe Greqisë, rreth vitit 1476. Flitet se ka ndodhur edhe një valë tjetër rreth vitit 1515. Themeluesve iu bashkuan në vitin 1534 edhe migrantë të tjerë nga qyteti Corone-s.

Hipoteza e disa historianëve është se familjet e para u vendosën në “Casaletto”. Migrantët shqiptarë u vendosën në *Cerviola* dhe më vonë, u zhvendosën në majë të malit. Fshati ishte pronë e princit të Bisignano-s dhe Pignone del Carretto-s.

Megjithatë ky territor do të shfaqej një “tokë e premtuar” për shqiptarët që e populluan. Nga marina, të paraprirë nga Papët dhe ikonat e shenjta, ata shpejt përqaftuan majën e malit dhe e kultivuan me forcë e mundime.

Heshtja, që kish mbuluar pyjet dhe luginat u thye shpejt nga tingujt e një jete që rifilloi. Ishin vetëm arbëreshët, por nuk ndiheshin vetëm, kishin qenë gjithmonë pranë njëri-tjetrit dhe përreth ndërtuan tempullin e tyre, “Kishën”, e cila me madhështinë nga lart mbronte ato shtëpi “guaska”, duke mbajtur sytë nga miku i tyre Jon-Adriatik. Arbëreshi ndërtoi shtëpi pa muratorë, nga shtëpitë prej guri e oxhaqet me shtëllunga tymi në peizazhet e borës së dimrit, buronte një ndjenjë e thellë për gjërat e thjeshta dhe një shije e rrallë ndjesie njerëzish të civilizuar.

Gjurmë historike

Për shumë vite, Kastëjnexhi që i lidhur me Oriolo-n, ku ajo ishte një pjesë integrale e këtij çifligu. Më 1820 u përfshi në territorin e Farnetës edhe ky një fshat arbëresh. Pas shumë peripecive, këta migrantë u vendosën në këtë territor. Më në fund ndaluan aty, duke ndërtuar shtëpitë e tyre.

Ata përveshën llërët dhe shtëpitë e mjerueshme të kashtës u zëvendësuan me shtëpi prej guri të thatë, që ripropozuan organizimin urban të atdheut të origjinës: gjitonìa, lagjja.

Në fakt, gjithçka rrotullohej rreth një ndihme të ndërsjellë midis fqinjëve, mes të cilëve u krijuan lidhje shumë të forta. Vendi u rrit

si një komunitet burrash, krenarë për identitetin e tyre fetar dhe kulturor. Ata shpesh duhej të mbroheshin kundër ndërhyrjes së peshkopëve latinë, që kundërshtonin gjuhën, ritet dhe zakonet orientale në territoret e tyre. Identiteti nuk i pengoi të rinjtë e Kastëjnexhit të jepnin jetën gjatë kryengritjeve të Rilindjes.

Gjithashtu, në fillim të viteve 1900, disa produkte bujqësore, të prodhuara prej tyre, si vaji dhe vera, morën çmime të rëndësishme në ekspozitat ndërkombëtare.

Në këtë periudhë kur shpërtheu lufta midis Spanjës dhe Francës, të gjitha vendet fqinje, përveç Oriolo-s, kaluan në kampin e kundërshtarit. Kur ushtria spanjolle filloi të tërhiqej në jug drejt Castrovillari-t, spanjollët e vendosën kampin e tyre pranë Castroregio-s dhe vendi ende mban emrin e “Timpone dello Spagnolo”. Me mbarimin e luftës me fitoren e spanjollëve, i gjithë territori kaloi si një feud i familjes Sanseverino i Salerno-s.

Gjuha shqipe

Gjuha e Kastëjnexhit, ajo e Platacit dhe e Farnetas, përbënte një grup konservator të dialekteve shqipe. Kjo “falë” izolimit të këtyre tre lokaliteteve, më pak të ekspozuara ndaj ndikimeve të gjuhës italiane. Gazetat e kohës raportojnë se në Castroregio, për nder të vdekjes së mbretit Umberto I, kryebashkiaku Crispino Camodeca (familjar i Pietro Camodeca) në ceremoninë e funeralit organizoi dhe bëri të mundur fjalimet në gjuhën amtare.

Kastëjnexhi sot

Nëpër rrugicat e kësaj qyteze ndihet atmosfera arbëreshe: arkitektura e gjitonisë, harqet, shkallët, guri, sokakët. Shumë shtëpi janë mbyllur dhe jeta arbëreshe ka nevojë të rigjallërohet. Të krijohet përshtypja se e ka pllakosur “një dimër i vogël”.

Tek-tuk sheh ndonjë të vjetër në moshë. Flasin shqip. Ndiheh krenarë për këta arbëreshë që në muralet e bukura, në rrugët e qytezës e kudo, shtëpia e arbëreshit karakterizohet nga flamuri shqiptar, kostumi arbëror, si dhe nga gjitonia. Rrugët, rrugicat apo tabelat mbajnë emrat shqip. Miti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut

është ende i gjallë.

Ky fshat arbëresh po shpopullohet. Shumë prej brezave janë shpërngulur drejt veriut, por këtu, në këto mure, kanë ngelur shpirti arbëresh, sakrificat, jeta e thjeshtë e zemra bujare.

Riti i dasmës

Në Castroregio, riti i dasmës (martesa) është karakteristike. Gjatë procesionit të dasmës, bëhet kalimi nëpër rrugët e qytetit nga “Flamurtari”.

Arkitektura

Kisha Nënë është ndër më të vjetrat në Eparkinë e Lungro-s, e ndërtuar në shekullin XV me forma eklektike dhe stil bizantin. Ajo ka një fasadë të veçantë, të bërë me gur të ekspozuar, në të cilën dera hyrëse çelet në pjesën e poshtme të kambanores.

Brenda është e zbukuruar me ikonat bizantine dhe e mirëmbajtur. Ajo ruan një ikonostas venecian-kretan. Mesha festohet edhe sot sipas ritit bizantin. E veçantë dhe interesante është ceremonia e dasmës skenografike. Dy bashkëshortët e ardhshëm prezantohen me priftin përpara derës së kishës, burri në të djathtë, gruaja në të majtë. Unazat janë vendosur në altar. Prifti i pyet ata nëse duan të bashkohen me vullnetin e tyre. Duke marrë një përgjigje pozitive, ai bën tri shenja kryqi në kokë dhe u jep atyre dy qirinj të ndezur. Pastaj i bën të hyjnë në tempull, në formën e një kryqi. Shenjtërimi i çiftit vijon, me bekimin e Shpirtit të Shenjtë. Dy kurora dafine vendosen më pas në kokën e të dyve, duke përfaqësuar përsosmërinë dhe lavdinë e ndërsjellë. Pas kurorëzimit, prifti u ofron bukë dhe verë të porsamartuarve, të përfshira në një gotë të vetme, e cila më pas thyhet për të simbolizuar pandashmërinë e dasmës.

Kisha kushtuar “Madonna della Neve” (“Zojës së Borës”)

Kisha katolike greko-bizantine *Santa Maria ad Nives* (Madonna della Neve ose Nostra Signora delle Nevi) u ndërtua në vitet 1600 dhe është një nga kishat më të vjetra në Eparkinë e Lungros. Sipas

arkitekturës bizantine, kisha është e orientuar sipas pikave kardinale nga lindja-perëndimi, me altarin në lindje dhe hyrjen në perëndim.

Kapela ndodhet e zhytur plotësisht në një pyll me pemë antike, ku ka edhe një zonë piknikësh. Në këtë zonë, më 18 gusht, zhvillohet edhe një panair i gjedhëve në zonën përpara kishës.

Aristokracia e Kastëjnexhit

Në Kastëjnexh gjenden edhe disa pallate të aristokracisë arbëreshe, të tillë si: Palazzo Camodeca Coroneij, Palazzo de Lazzaro Camodeca, Palazzo D' Agostino dhe Palazzo Parisi.

Pallati Camodeca de Corone, i ndërtuar në vitet 1600, u rikonstruktua në fillim të shekullit XX nga Pietro Camodeca. Interesante është hyrja me harkun prej guri, e cila sot është në pronësi të familjes Roma.

Pallati Agostino

I ndërtuar në fillim të vitit 1700. Ka një portal me gur të harkuar.

Pallati Lazzaro-Camodeca

Në këtë pallat ekziston një portal guri i harkuar dhe me dy litarë kryesorë.

Pallati Parisi

Paraqet një portë me hark, i bërë me gur vendas.

Figura të shquara të Kastëjnexhit

Pietro Camodeca, i quajtur Don Pietro, lindi më 1847.¹¹¹ Mori pjesë në Kolegjin Italo-Grek të San Demetrio (Shën Mitrit). Mbaroi studimet në Seminarin e Tursi dhe më 25 mars 1871, ishte mësues i latinishtes dhe greqishtes në Institutin Cirino në Napoli dhe një vit më vonë, në atë të Institutit Silvio Pellico në Viggiano. U emërua zv.rektor dhe Drejtor Spiritual i Shkollës së Konviktit Komunal.

¹¹¹ Shënim: Shumë prej akademikëve vënë në diskutim prejardhjen “fisnike” të Camodeca-s.

Pietro Camodeca u emërua Kryepriifti i *Santa Maria ad Nives* në Kastëjnexh. Në atë kohë, bashkësitë shqiptare të ritit grek ishin të shqetësuara, pasi duhej të braktisnin ritualin e tyre tradicional dhe ta ndryshonin në atë latin. Camodeca i paraqiti një kërkesë Papës Leone XIII për Jubileun Priftëror të Lartë. Së bashku me disa mijëra nënshkrime të italo-shqiptarëve, ai pretendoi autonominë kishtarë, krijimin e dioqezës së tij dhe caktimin e një peshkopi të ritit grek. Vetëm më vonë, më 1919, Papa Benedikt XVI e themeloi atë në Lungro.

Më 1898, u emërua Vikar i Përgjithshëm i italo-grekëve të Kalabrisë dhe të Bazilikatës. Ndërsa në vitin 1899 u emërua “Cavaliere della Corona d’Italia”.

Figura që kanë mbetur në zemrën e arbëreshëve të Kastëjnexhit

Dy figura që kanë hyrë në historinë e Kastëjnexhit në periudhën që jetuan ishin, Mosè Troiano dhe Battista Mollo.

Mosè Troiano ishte një nga figurat intelektuale, por edhe një arbëresh zemërgjerë e bujar. Ishte nëndrejtor shkollë, në fillim në Bari dhe më vonë në shkollën e mesme të Amendolarës. Ai i përgatiti falas në të gjitha lëndët vajzat, familjet e të cilave nuk mund të përballonin shpenzimet ekonomike. Shumë nga këto vajza, tani gra, janë diplomuar dhe kjo u arrit falë tij. **Don Battista Mollo**, figurë religjioze, por edhe njeri shumë human, i kulturuar, i përvulur dhe i mençur, të cilit të gjithë i kërkuan një mendim (një këshillim jete).

4.1.20. Farneta (Farneta)

Më në veri të Kastëjnexhit, në një distancë rreth 20 kilometra ndodhet Farneta, fraksion i Kastëjnexhit (Castroregio-s). Rruga është gjithë dredha dhe e pyllëzuar me *farne* (një tip peme që i ngjan lisit), nga ku thuhet se ka marrë emrin fshati.

Fshati është ngritur në malin e Rotondos, nga ku peizazhi është magjepsës dhe mund të sodisni luginat e gjera të lumit Ferro, detin

Jon deri në Taranto, malet e Bazilikatës dhe Monte Sparviere. Arbëreshët e populluan fshatin e vogël në të njëjtën periudhë kur u vendosën në Kastëjnexh. Historikisht, ky fshat ka qenë një pingpong në duart e feudalëve. Në vitin 1811, Farneta ishte fraksion i Oriolo-s, ndërsa më 1820 iu bashkua komunës së Kastëjnexhit.

Familjet e para të Farnetës ishin: Licursi, Camodeca, Trupo, Petta dhe Pappadas, të cilat më vonë ikën dhe u vendosën në zonën e Oriolit. Familjet e para u vendosën në fund të luginës “Katundisht” (fshati), por e braktisën, për shkak se kishte shumë gjarpërinj. Ato u vendosën në kryqëzimin aktual të Oriolo-s, “Katund i vjetër” i cili mban emrin edhe sot, ku pranë tij ishte një kishë kushtuar *San Giorgio Martire*, statuja e të cilit ndodhet në kishën e Oriolo-s, siç tregojnë pleqtë. Edhe ky vendbanim u braktis rreth vitit 1560, për shkak të murtajës.

Farneta ishte e populluar me njerëz të pasur që zotëronin, bagëti dhe industri, por fati i kohërave ndryshon drejtim. Rrëshqitja e tokës ishte një rrezik dhe me burime të pakta.

Në regjistrimin e parë të vitit 1542, nuk ekzistonte as Farneta e as Castroregio, por një qytet i zhdukur, *San Procopio*. Më 1551 kishte rreth 400 njerëz; më 1669, 250 njerëz; më 1750, 100 vetë; më 1841, 100 njerëz; më 1806, 250 njerëz; më 1816, 484 njerëz; më 1857, rreth 450; më 1901, 489; më 1921, rreth 500; më 1950, 508; më 1985, 250; sot, 65 njerëz. Më 1590 kishte një regjistër të



pagëzimeve. Priftërinjtë Camodeca zotëronin një bibliotekë të pasur, por që fatkeqësisht tashmë ka humbur.

Urbanistika

Lagjet e arbëreshëve janë aty, të heshtura, por gjurmët, të gjalla. Lagjja e Llazët, Fikarroni, Grizat, Cirazi, Llumbardi, Lugadhi, Pëtroza, Kroj Posht, Llazi Minkut, Katundisht, Pishkunjeti, Rrupaqjea, Kalbazaqi, Dhjeci, Krojzërvet, Rrutunda, Udha dhe Horës, të gjitha për pesë shekuj kanë punuar e kanë ushqyer breza të tërë.

Farneta ndahet në dy rrethe, që të dyja quhen “Ka Mbatana”, të lidhura me një rrugë “Nzillikata”.

Riti dhe besimi

Në Farneta kishte tri kisha: kisha famullitare kushtuar *San Nicola di Mira*, që u shkatërrua në vitet 1950; *Kisha San Rocco*, e zgjeruar në vitin 1900 dhe e rindërtuar në vitin 1968, sot një vend i famullisë dhe *Kisha S. Antonio di Padova*, me një shesh të vogël, i cili festohet me 13 maj dhe me 13 qershor. Në këtë kishë ndodhet një statujë e vitit 1708 e *Madonna della Catena*, e cila festohet më 10 maj nga familja Trupo.

Në fshat ekziston një kapelë, kushtuar *Madonna del Ceraso*, e cila mban emrin e asaj lagjeje, në të cilën qëndron. Pak më sipër ndodhet kisha bizantine arbëreshe *San Donato*, mbrojtësi i tyre. Kisha u ndërtua me sakrificat e arbëreshëve. Fasada ku ndodhej kambana ka edhe një orë. Koha duket sikur ka ndalur këtu.

Krojet e Farnetës

Farneta është edhe fshat i burimeve. Emrat e këtyre burimeve janë të pagëzuara me gjuhën shqipe: Kroj Marsit, Kroj Priftit, Kroj Tufit dhe Kroj Posht.

“Vij nga Alpet e Trentinos, nuk jam shqiptar, por do ta mësoj shqipen”

7 marsi i vitit 1945 ishte një ditë e jashtëzakonshme. Dy priftërinj, me një tub në kokë dhe rrobat e zeza të bollshme, hyjnë në Farneta, në tingujt e kambanave festive, të mirëpritura nga At Giovanni Battista Mollo. Ishte një ditë e ftohtë. Njëri prej tyre ishte prifti i ri i famullisë, i ri, me flokë të gjatë, me mjekër të plotë, i cili e prezantoi veten: “Unë jam At Alfredo, prifti i ri i famullisë. Vij nga Alpet e Trentino-s, nuk jam shqiptar, por do ta mësoj”. Tjetri ishte zoti Vincenzo Matrangolo nga Firmoza, i cili ditën tjetër, nga frika se mos bllokohej nga dëbora, e la vetëm priftin, duke e pagëzuar idiomën “i huaj”. Duke pasur parasysh pritjen festive dhe gëzimin e madh të arbëreshëve të Farnetës, ai u ndal. Njerëzit menduan me vete: “do rrijë dhe për sa kohë do të qëndrojë. Apo do të bëjë edhe ai si të tjerët?”. Ai mbeti për tridhjetë vjet aty. Ishte gjatë kohës së luftës. Ishte varfëri e madhe nëpër këmbë, por ai vetë thotë: “Më munguan shumë gjëra, por asnjëherë një copë bukë, kurrë nuk kam parë një bujari të tillë”. Në broshurën e tij “Ricordi di Farneta”, ai shkroi: “Për Pashkë dhe pushime të tjera, San Donato, San Rocco, Madonna del Ceraso dhe në rrethana të tjera, të rinjtë dhe vajzat organizoheshin për ‘Vallje’, ku ata merrnin duart e njëri-tjetrit, këndonin dhe vallëzonin si njëherë e një kohë shqiptarët e lashtë. I pari dhe i fundit i zinxhirit shfaqnin një shall me ngjyrë të bukur (flamuri), lëviznin nga njëra anë në tjetrën, në mënyrë që të mund të rrethonin dikë për t’i ofruar një pije. Viktima që kërkohej të futej në qark ishte famullitari dhe për mua kjo gjë ishte kënaqësi”.

Populli është thesar i historisë gojore. Thuhet se në gjysmën e sipërme të kodrës qëndronte një *olmo* (dru elme) gjigant dhe madhështor, i cili ishte krenaria e fshatit. Olmo ishte monument, gjigant, me një perimetër 4 metra, i mbjellë më 1779, me rastin e Republikës Partenopiane, si një pemë e lirisë, falë edhe studentëve të Kolegjit Korsini, për idetë e tyre të ndryshimit. Në mënyrë metaforike, banorët përdornin profecinë e olmos që po thahej, për ta krahasuar me Farnetën, e cila po asimilohej e shuhej.

Sot, kohët kanë ndryshuar. Farneta ka ndalur, mbizotëron varfëria, njerëzit janë larguar në qytete të mëdha. Gjithçka po shuhet.

Enza Scutari lindi në Farneta. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në San Costantino Albanese, si mësuese. Veç mësuesisë, ajo njihet dhe çmohet se ishte hulumtuese dhe studiuese e traditave dhe kulturës arbëreshe. Scutari është nderuar me disa çmime për poezitë e saj lirike, e frymëzuar nga realiteti arbëresh.

Domenico Licursi lindi në Farneta dhe jeton po aty. Ai publikon gazetën “Rinascita del Sud”. Domenico Licursi është gazetar autodidakt, por përmendet dhe vlerësohet për misionin si arbëresh për të mbajtur gjallë identitetin arbëror. Shumica e lajmeve janë marrë nga vizitat apostolike, nga Antonio Scura, Domenico Zangari, Patrizia Resta, Rodota, Mussabini dhe nga Korolevski, nga At Moratti, si dhe nga të dhënat e shkrimet e Domenico Licursi-poet, gazetar, themelues i “Rinascita Sud”, bashkëpunëtor i disa gazetave lokale, i pasionuar në çështjet politike dhe sociale, si dhe botës arbëreshe dhe historike.

4.1.21. Cervicati (Çervikati)

Origjina e Çervikatit mund të gjurmohet qysh në vitin 969 dhe emri rrjedh nga “numri i madh i drerëve në zonë”. Vendi ndodhet në luginën e mesme të Cratit dhe është pjesë e shpatit të brendshëm të zinxhirit Paulinë. Aktualisht ka pak informacione historike. Duket se në një kodër, të quajtur “Castrocucco”, qyteti ishte ndërtuar rreth vitit 969 dhe e kishte emrin “Cervicati” nga numri i madh i drerëve në atë zonë (“Cervicati” nga “Cervi capti”).

Ai shtrihet në njëren nga tre kodrat (të cilat paraqiten së bashku me një dre, pjesë e stemës së bashkisë). Si të gjitha fshatrat arbëreshë edhe Cervikati ka fizionominë e gjitonisë. Në vitin 1050, Roberto il Guiscardo do të fillonte ndërtimin e *Abacisë Cistercian të S. Maria ad Nives* (Shën Mërisë së Borës) në rrethin Conicella, kisha e së cilës do të shenjtërohej në prill të vitit 1066. Nga “regjistrat e Angevin dhe popullsia kalabreze” e vitit 1276, shkruhet se Cervicatum ishte përfshirë në listën e të gjitha qyteteve. Ai kishte paguar një taksë



prej 14 ounces, 2 tarì dhe 8 grana, sipas sistemit monetar të kohës dhe numëronte rreth 704 banorë. Edhe për vitet 1300, 1440, 1500 ka dokumente që dëshmojnë ekzistencën e Çervikatit.

Midis viteve 1468 dhe 1506, pas vdekjes së Skënderbeut, edhe në Çervikati mbërritën koloni shqiptarësh. Zotërinj feudalë që sunduan vendin ishin Sanseverino i Bisignano-s, Spinelli i Fuscaldo-s, Caschi, Sersole e Cerisano, Maiorana dhe së fundi Guzolini, i cili më 1651 mori titullin e “Baron”. Në vitin 1929, Çervikati u konsiderua një pjesë e Shën Mark Argentano, por në vitin 1937, për shkak të interesit të peshkopit vendas të Çervikatit, Domenico Petroni, ai rimori autonominë.

Qendra historike përbëhet nga shtëpi të thjeshta, që mbështesin njëra-tjetrën, të pasuruara nga rrugicat dhe sheshet karakteristike. Në një pozicion strategjik është “Palazzo del Barone”, një ndërtesë e shekullit XVIII, me arkitekturë rigoroze. Ai përmban dokumente të çmuara nga epokat e shkuara (kode, armë, etj.) dhe ruan dhomën (me tavolinë, kolltuk) ku qëndronte Francesco De Sanctis. Kisha e lashtë, me kamberë dhe orë, daton në vitin 1600. Në të ruhen disa

vepra arti, duke përfshirë edhe disa piktura bashkëkohore.

Midis shekujve XVII dhe XVIII

Kalimi nga riti bizantin në ritin latin

Në vitin 1607 u shpall një dekret nën pontifikatin e Palit V, për arsye që lidhen me kalimin nga riti bizantin grek në ritin latin, ku përmendet emri i qytetit (*Cervicata*). Informacione të tjera gjenden në dokumente të ndryshme nga viti 1630 (akti i shitjes), viti 1650 (falja për Flavio Cozzolino). Në këtë akt, qyteti përmendet për herë të parë në latinisht si *Cervicarius*, dhe më vonë, u italianizua si *Cervicaro*. Në një dokument tjetër, të datës 10 maj 1649 (Arkivi Shtetëror i Kozencës - mandati i dhënë nga qytetarët e Çervikatit, Santo dhe Domenico Barci në polemikën feudale me D. Giuseppe Guzolini), përdoret për herë të parë, emri aktual "*Cervicati*". Ndërsa kalimin nga riti bizantin në atë latin, arbëreshët e Çervikatit e bënë në vitin 1607.

Nga regjistrat e kadastrës *Onciario* (Arkivi Shtetëror i Napolit) mësohet se më 1753, ishin rreth 500 banorë dhe shumica e tyre u shfaqën me kualifikimin "bujq", domethënë një punëtor krahu i ndjekur nga ai i "massaro di campo" dhe nga ata të "rojtarit të qeve". Kualifikime të tjera përmendim: "master murator", "hekurkthyes", "këpucar", "rrobaqepës" etj.

Shekulli XIX karakterizohet, në fazën fillestare, nga një seri ligjesh, të kërkuara nga francezët, të cilat zbulojnë një përmbajtje thjesht shoqërore, në përputhje me parimet e Revolucionit (fundi i besnikërisë - ndarja e pronës komunale).

Lajmi i parë, i cili mund të shihet nga një tekst i vitit 1857, i referohet një urdhri të Komisarit të Mbretit, të lëshuar në mosmarrëveshjen midis Bashkisë së S. Marco, tani Cervicati, dhe ish-zotit feudal Nicola Campagna.

Dokumente të tjera datojnë nga viti 1812, 1813, 1814. Në vitin 1809, Baroni Angelo Guzolini da Cervicati paraqitet si president në Këshillin e Qarkut të Kozencës. Në vitin 1929, Çervikati u konsiderua si pjesë e San Marco-s, por në vitin 1937, falë interesimit të peshkopit Domenico Petroni, me origjinë nga Çervikatit, ai rifitoi autonominë.

Pallatet aristokrate janë përfshirë në trashëgiminë kulturore. Ndër vilat dhe pallatet, që duhet të përmendim, janë: Palazzo Cipolla dhe Palazzo Guzolini, ndërsa midis kishave dhe ndërtesave të tjera fetare të Çervikatit përmendim Kishën e San Nicola-s dhe Kishën e San Francesco-s (në rrethin Marinello). Në qendrën historike bien në sy portat dhe harqet, shtëpitë fisnike të feudalëve të Çervikatit.

Një nga figurat më të shquara në Çervikati është Pasquale Rebecchi, një figurë e rëndësishme e mjekësisë në shekullin XIX.

4.1.22. Mongrassano (Mungrasana)

Vendi ndodhet në majë të një kodre dhe përshkohet nga rruga rajonale Torano-S.Marco. Nuk ka asnjë informacion të saktë historik. Sipas disa historianëve, *Mongrassano* njihej në shekullin XII, nën emrin e *Magrosani*.

Fillimisht u nda në dy lagje: *Serra di Leo* dhe *Mongrassano*. Popullohej nga një grup familjesh, që migruan nga Shqipëria rreth vitit 1478, ose në fillim të vitit 1500. Më 20 korrik 1459, Princi i



Bisignanos ia dha juridiksionin civil peshkopit të San Markos. Në vitin 1642, atë e bleu familja Gaetani, e cila në vitin 1688 ia shiti Markezit të Fuscaldos, që e mbajti deri në heqjen e feudalizmit (1806).

Në vitin 1811 u bë një pjesë e *Serra di Leo*. Më 1816, u ngrit në një bashki me Serra di Leo e fraksionin e saj. Komuna e Mongrasanos (*Mongrassano-s*) ndodhet 545 metra mbi nivelin e detit dhe përfshihet në komunitetin malor “*Unione delle Valli*” (“*Bashkimi i Luginave*”).

Urbanistika

Sot banorët e Mungrasanës e ndajnë qendrën e banuar në pesë zona, të quajtura: Li Romani, La Costa, Lo Piano, La Sciuria (Shurja) dhe Serra di Leo (Sardalia).

Piazza “Sheshi”

Piazza “Sheshi” është një shesh i thjeshtë. Kjo është zona më e hershme arbëreshe. Gjithonia është zemra e çdo komuniteti shqiptar, vendi më i rëndësishëm i shoqërisë, nëpërmjet të cilit lindin lidhje më të ngushta se lidhjet familjare, mbështetur në ndihmën e ndërsjellë dhe në identifikimin e përbashkët. Me pak fjalë, nëse kaloni nga Piazza “Sheshi” në Mungrasanë, mos e shikoni në mënyrë sipërfaqësore, pasi do ta gjeni veten në mes të një gjtonie të shekullit XVI, një nga qendrat e para të mbrojtjes dhe të përhapjes së kulturës arbëreshe në këtë zonë të Kalabrisë.

Praktika të ndryshme tradicionale janë ende të gjalla dhe funksionale në Mungrasanë, të cilat janë të lidhura me ciklin e vitit dhe atë të njeriut. Traditat më të rëndësishme për komunitetin janë: Krishtlindjet, Karnavalet, Java e Shenjtë, Pashkët, etj. Këngët shqiptare dhe “vallja”, karnavalet, si dhe veshjet e nuseve, janë padyshim unike.

Qendra Ikonografike Arbëreshe

Qendra Ikonografike Arbëreshe u themelua në vitin 1992. Ajo

mbledh një galeri të madhe fotografish të kulturës italo-shqiptare, si dhe shfaq në një ekspozitë me veshje tradicionale arbëreshe dhe objekte karakteristike për qytetërimin e lashtë fshatar.

Ish-manastiri i Karmelitës, sot Bashkia e Mungrasanës

Bashkia e Mungrasanës është e vendosur në ish-manastirin brazilian, në sheshin “Piazza Tavolaro”. Duke qenë një ndërtesë publike, nuk paraqet ndonjë vështirësi të veçantë për ta vizituar. Ndërtesa ka ruajtur strukturën e manastirit antik pranë kishës së njohur “*Della Congrega*”. Gjurmët e ndërtimit të gjithë kompleksit arkitektonik, shkojnë rreth shekullit XIII.

Në shekullin XV u kthye në ritin latin dhe priti murgjit karmelitë. Këtë e shpjegon mbishkrimi në *Santa Maria del Monte Carmelo*, ku lexohet një mbishkrim në fasadën e ndërtesës. Brenda mund të vizitoni edhe kopshtin e mbyllur antik të rrethuar, si dhe shkallët. Gjëja më interesante nga pikëpamja artistike është “*Peizazhi Ideal*”, i pikturuar nga artisti i Mungrasanës, Rubens Santoro, në shekullin e kaluar, i njohur mirë në Itali dhe jashtë saj.

Sipas disa historianëve, çdo zonë e vendit paraqet një fazë të zhvillimit të qytetit. Këto do të ishin bërthama urbane, që u shtuan njëra pas tjetrës ndër shekuj.

Kisha e Congrega e Mongrassano është pjesë e konventës antike të sheshit qendror “*Tavolaro*”. Fillimisht ishte *basiliane* dhe më pas u kthye në *carmelitane*, ku sot bashkia e qytetit ka selinë e saj. E ndërtuar në shekullin XII së bashku me tërë kompleksin, *Chiesa della Congrega (Kisha e Kongregës)* paraqitet sot si një ndërtesë e bukur, me një fasadë lineare dhe me ngjyra të buta, që duket se dëshiron të nxjerrë në pah portalin e saj të gdhendur.

Portali është vepër e murgjve carmelitë që u vendosën atje duke e shndërruar kishën në ritin latin. Portali është një strukturë me tone të kuqërremta, i punuar imët me pilastikë dorikë, të zbukuruar me një motiv thurje. Dyert karakterizohen nga disa gdhendje jashtëzakonisht të holla, në të cilat bashkohen forma gjeometrike dhe modele lulesh.

Në brendësi do të gjeni kolona të zbukuruara në stilin korintas, me skanaliturë blu dhe të artë. Në kornizën e arkitekturës mbizotëron *Kurora Hyjnore*, ndërsa në të dy anët mund të admirosh dy statuja të engjëjve, sipas një teknike tipike të arkitekturës dorike, të quajtur *metope*. Pas altarit të lartë ndodhet një pikturë e çmuar, që përfaqëson *Shpalljen* që i atribuohet Carlo Santoro-s, babai i Rubens-it, artistit më të famshëm që lindi këtu. Edhe statuja prej druri aty pranë është nga i njëjti autor.

Figura të shquara

Anxhelo Sarri (Angelo Sarri). Në rrugëtimin për t'u bërë prift, ai zëvendësoi veshjen e priftit me togën e gjykatësit. Në vitin 1823 u emërua Kryetar i Gjykatës Civile të Kozencës dhe më pas, Kryetar i Gjykatës së Madhe Penale të Bazilikatës në Potenza. Ai vdiq në vitin 1848. Elegjia e funeralit u mbajt nga poeti Vinçens Padula (Vincenzo Padula).

Domeniko Sarri (Domenico Sarri) lindi në vitin 1810 në një familje të pasur. Studioi në kolegjin e *San Marco Argentano* dhe ishte shok i Vincenzo Padula-s. Në vitin 1848, ishte një nga promovuesit kryesorë kalabrezë të revoltave popullore antiburbone. Mori përsipër komandën e Batalionit të Parë Shqiptar dhe, bashkë me njerëzit e tij, u bë pjesë e trazirave të Paolës, duke parandaluar zbarkimin e trupave të burbonëve në brigjet e Tirrenit. Më pas u transferua në kampet ushtarake të Spezzano Albanese dhe Cassano-s. Pjesëmarrja në trazirat e '48-tës bëri që të dënohej me vdekje më 1850 nga Gjykata Speciale e Kozencës. Sidoqoftë, ai i shpëtoi dënimit. Sipas një versioni, thuhet se Carlo Santoro kishte shkuar në Napoli dhe i kishte ofruar skulpturën e tij mbretëreshës, e cila, e pushtuar nga hiri i artit, e zbuti dënimin e Sarrit.

Më 1860, ai ishte ndër protagonistët më të mëdhenj të ekspeditës "Të Njëmjtëve" në Kalabri, të cilin e mbështeti vetë financiarisht. I emëruar shef legjioni i kryengritjes popullore, mori pjesë me trupat e tij në betejën e Soveria Mannelli-t, me detyrën për të ndaluar

kalimin e Crocetta-s. Ai fitoi titullin e majorit. Pas bashkimit të Italisë, u kthye në Mongrasano me plot nderime dhe lavdi dhe vdiq atje, më 1876.

Karlo Santoro (Carlo Santoro). Jetoj në shek. XIX. Babai i të famshmit Rubens Santoro. Ai ishte ndër piktorët më të rëndësishëm të Kalabrisë. Santoros i atribuohen shumë vepra, veçanërisht afresket, por ai ishte padyshim autori i një busti prej druri kushtuar *San Francesco da Paola*, statujave të *Santa Caterina d'Alessandria*, *Santa Filomena*, *Madonna del Carmine* dhe *Concept Immaculate*, që ruhen ende sot në Mongrasano në kishën famullitare. Karlo Santoro realizoi punime edhe jashtë fshatit. Ai skaliti statujën e *Madonna del Rosarios*, e cila ruhet në Katedralen e S. Marco Argentano dhe një kanavacë në *Kishën e Frymës së Shenjtë* të Kozenzës. Punime të tjera gjenden në kishat e Çervikatit dhe një pikturë e mrekullueshme në vaj i *Madonna del Carmine*, në Kishën e Cavallerizzo.

Rubens Santoro. Emri i plotë është Gustavo Adolfo Rubens. Ai lindi në Mongrasano, më 26 tetor 1859 (sipas dëshmisë së lindjes së kësaj komune), nga Giovannina Belmonte dhe Carlo Santoro, piktor dhe skulptor, i cili i dha mësimet e para. Veçanërisht i talentuar për artet grafike, ai vajti në Napoli, derisa arriti të përsoste dhuntitë e tij natyrale. Në kryeqytetin napolitan, Santoro ndoqi Institutin e Arteve të Bukura për vetëm një vit, nën drejtimin e piktorit të famshëm Domenico Morelli. Arti i tij njihej në Napoli, Verona dhe Venecia, dhe më pas u bë i njohur dhe u vlerësua edhe në Paris dhe Londër.

Admiruesi i tij më i madh ishte Margherita e Savojes, e cila e bëri atë të njohur për carin e Rusisë, Nikolla II. Punimet e tij më të rëndësishme janë: “La bottega dell’antiquario”, “Hapi i fundit” dhe “II Rifugio”. Ai vdiq më 30 dhjetor 1941, duke lënë një kujtim të pashlyeshëm jo vetëm tek admiruesit e tij, por edhe te njerëzit të Mongrasano. Punimet e tij gjenden në shumë koleksione private dhe publike dhe mund të admirohen në muzetë e Capodimonte në Napoli dhe qytetin e Torinos. Vepra “Peizazh ideal” ruhet në Bashkinë e Mongrassano-s.

Filinto Santoro. Emri i plotë është Benvenuto Filinto Enrico Francesco, lindi më 9 shkurt 1863 (sipas dëshmisë së lindjes së kësaj komune) nga Giovannina Belmonte dhe Carlo Santoro. Ishte piktor dhe skulptor. U diplomua në Napoli në inxhinierinë civile. Emigroi në Brazil, ku drejtoi ndërtimin e pallateve të shumta dhe monumentale, ndërtesën e qeverisë dhe Kursaal në shtetin e Bahisë; ndërtesën e qeverisë dhe katedralen në Manoes. Ishte përpiluesi i ligjit për ndërtimin dhe drejtori i përgjithshëm i punëve publike në shtetin e Espirito Santo, si dhe inspektori i shkollave italiane në Rio de Zhaneiro. Mendohet të ketë vdekur rreth vitit 1934.

Silvio Tavolaro u diplomua në Napoli në jurisprudencë. U kthye në qytetin e lindjes, ku filloi veprimtarinë si avokat në *Procura di San Marco Argentano* dhe *Gjykatën e Kozencës*. Thuhet se pasi mbrojti me sukses një hajdut, iu neverit sistemi i ligjit dhe e la profesionin. Megjithatë, vazhdoi studimet duke përqafuar gjyqësorin në karrierën e tij. Ai ka mbuluar pozicionet më të rëndësishme, si atë të presidentit të Gjykatës së Kasacionit. Vdiq në Romë, në mesin e viteve 1960.

Nicola Vetere ishte ndër shpikësit më të famshëm të shekullit XIX. Ai udhëtoi si në Europë, edhe në Amerikën e Jugut. Pasi u vendos në Argjentinë, shpiku një lloj të ri të kasafortave me 570 kombinime, që patën sukses në të gjithë botën. Mori shumë nderime dhe ishte furnizuesi i Bankave Kombëtare të Spanjës dhe Argjentinës.

SERRA DI LEO

Ky lokalitet është sot një rreth i komunës së Mongrassano-s dhe gjendet rreth 9 km larg *San Giacomo di Cerzeto-s*. Më 1543, kishte 53 banorë arbëreshë. *Cassale di Serra di Leo*, i populluar në fillim të shekullit XV, në gjysmën e dytë të këtij shekulli i përkiste së pari feudalit Cavalcanti dhe më pas, nga fundi i shekullit XV deri në fund të shekullit XVI, Sersale të Cosenza.

Në janar 1750, Tommaso Miceli, i cili kishte blerë territorin nga



dukët katalanas të Gonzaga të Majera u bë baroni i saj. Baronët Miceli dhe pasardhësit e tij, ushtruan të drejta feudale mbi Serradileo deri më 1806.

4.1.23. Cerzetto (Qana)

Arbëreshët i thërrasin ndryshe *Qana* dhe komuna e saj përfshin fshatrat: San Giacomo, Cavallerizzo dhe Colombrà. Territori u përfshi së pari në Baroninë e San Marco-s dhe më pas kaloi në Cavalvanti.

Pozicioni gjeografik

Qana ndodhet 500 metra mbi nivelin e detit në luginën e Kratit të Mesëm. Territori i Qanës shtrihet përgjatë shpatit të brendshëm të Apennines Paolano, në një sipërfaqe 22 kilometra katrorë. Kufizohet me komunat e Bisignano, Mongrassano, Cervicati, Torano Castello, San Martino di Finita, Rota Greca dhe Fuscaldo. Maja më e lartë është Serra Petrulla, 1309 metra, në Apennines Paolano. Kryqëzohet



nga përrrenjtë Finita, Turbolo, San Nicola, Cocchiato. Territori i Qanës është i mbuluar me gështenja shekullore, lisi dhe ahu dhe në pjesën e poshtme, nga ullishtat.

Historiku

Cerzetto (Qana) u themelua nga një grup i kolonëve arbëreshë që lëvizën nga *Rrahji i Mushkavet (Passo delle Mule)* në luginë, të cilët i dhanë jetë fshatit të *Sant Japoco* (shekulli XV). Qendrat historike të *San Giacomo*, *Cerzeto* dhe *Cavallerizzo* mbajnë të paprekura sharmin jetësor të fshatrave antikë - shtëpi historike, kisha, pallate, portale, ballkone prej hekuri të punuar, rrugë dhe rrugica të gjata dhe të ngushta, në të cilat identiteti arbëresh është ende i fortë tek banorët.

Kulti i diellit tek arbëreshët e Qanës

Për të shpjeguar perëndimin e diellit në Qana tregohet një histori interesante. Thuhet se dikur ishte një vajzë e bukur, me të cilën ishin të dashuruar të gjithë të rinjtë. Ata i kënduan serenata dhe i

dhanë fjalën e dashurisë. Sidoqoftë, një ditë, vajza u rrëmbye nga magjistaret (shtrigat), të cilat e çuan në male dhe me magji e bënë të shëmtuar dhe të gjymtuar. Megjithatë, kur vajza u zhvesh, edhe magjistaret u mahnitën nga bukuria e saj dhe qëndruan duke e parë atë tërë natën. Në mëngjes ato ikën, duke vjedhur rrobat e gruas së re, e cila, e vetme, filloi të qante. Dielli, atëherë, u zhvendos me keqardhje nga lotët dhe i magjepsur nga bukuria e saj, shtoi rrezet dhe bëri të lulëzojnë gjineshtrat. I gjithë mali u mbulua me të verdhë, kështu që vajza mund të fshihte bukurinë e saj diellore. Në fund të ditës, dielli u kthye te vajza, e përqafoi, duke e marrë atë me vete pas maleve. Thuhet se, që prej asaj kohe, çdo mbrëmje, dielli kthehet në “djepin” e tij për të përqaftuar vajzën e dashur.

Shprehje popullore:

“Copën e madhe haje, e fjalën e madhe mbaje”

(Il pezzo grosso mangialo e la parola grossa mantienila)

“E di luga çë ka poçja”

(Lo sa il mestolo quel che c'è nella pignatta)

“Mos thuaj se nga ki krua nëng do ujë”

(Non dire che da questa fontana non vuoi acqua)

“Rrih me dru e pajtò me fjalë.”

(Picchia con il bastone e discuti con le parole)

Arkitektura

Madonna del Buon Consiglio (San Giacomo)

Ndodhet në fshatin *San Giacomo*, me siguri është me origjinë në shekullin XVI. Struktura ka ndryshuar nga ndërhyrjet me kalimin e kohës, që u bënë në varësi të pallatit fisnik të familjes Tocci. Fasada ka një hyrje, e cila arrihet përmes një shkalle. Në të majtë të derës qëndron kulla e kambanës. Brenda ruhen statuja të vlefshme.

Chiesa dei SS.Pietro e Paolo

Kisha me tre navete u ndërtua në shekullin XVII. Ajo ka tipare të Rilindjes, me prani të dukshme të stilit barok, dhe brenda bart

dekorime, të cilat dhurojnë një atmosferë të kthjellët dhe elegante. Portali i imponuar, i gdhendur në gur, është i jashtëzakonshëm në fasadën kryesore. Brenda navetës qendrore mund të admirosim piktura të mëdha të shekullit XVII. Në zonën e presbiterit¹¹² ngrihet altari i çmuar i shekullit XVII në mermer polikrom. Altarët e San Francesco di Paola dhe Madonna del Rosario në kapelat përkatëse të rreshtave anësore janë gjithashtu shumë të rëndësishëm.

Chiesa di San Nicola

Kisha e San Nicola-s (Cerzeto) është shumë e vjetër dhe për fat të keq, sot vetëm rrënojat dëshmojnë për të. Ishte e hapur deri në fillim të shekullit XIX, kur u dëmtua rëndë nga tërmeti i vitit 1908. Nuk ka informacion për themelimin e saj. Në dokumentet kishtarë të shekullit XVIII bëhet fjalë për një kishë kushtuar San Nicola-s, e cila ekzistonte para ardhjes së shqiptarëve.

Pallati Fazio

Në Qana u përrua Muzeu Etnografik Arbëresh (Museo Etnografico Arbëresh) në pallatin Fazio. Gjetjet janë grumbulluar, kataloguar dhe dhuruar nga prof. Carmine Stamile. Muzeu mbledh mjete që kanë të bëjnë kryesisht me mjedisin fshatar dhe artizan. Këto janë objekte të varfra, por të pasura me histori dhe kulturë popullore.

Pallati Tocci (San Giacomo)

Është një pallat fisnik, ngjitur me kishën e Madonna del Buon Consiglio (Kishën e Këshillit të Mirë), e cila dominon qendrën historike të fshatit San Giacomo. Ishte vendbanimi i familjes Tocci me të njëjtin emër dhe daton nga shekulli XVII. Ndërtimi i gjerë dhe imponues paraqet karakteristika të një vendbanimi historik të rafinuar dhe të vlefshëm.

Pallati Andreotti Loria

Pallati i madh i shekullit XVI, shtëpia e markezëve Andreotti

¹¹² *Presbiterianizmi*, pjesë e traditës së reformuar brenda Protestantizmit (Shën. red).

përbën një dëshmi të vlefshme për trashëgiminë historike dhe artistike të zonës. Fasada kryesore ka një stil arkitektonik klasik dekorativ, ndërsa në fasadën lindore ka një lozhë të madhe me harqe të stilit të shekullit XVI. Brenda, sallat dhe kapela fisnike janë të jashtëzakonshme.

Pallati Mayera (Cerzeto)

Së bashku me pallatin Andreotti ngjitur, ai daton në shekullin XVI. Deri në vitin 1970, ishte shtëpia hijerëndë e Mayaras. Sallat, gjithë shkëlqim, frekuentoheshin nga fisnikëria e Kozencës, ku në fillim të shekullit XIX, ata pritën, midis artistëve të shquar të kohës, aktoren e famshme Emma Grammatica.

Mali i Çerzetos (Cerzeto)

Mali i Çerzetos përfaqëson një trashëgimi të paçmuar ekonomike për vendasit, falë drurit që mund të shitet, gështenjave të shijshme dhe kërpudhave që mund të gjenden. Një mal i pandotur, i rrethuar nga dhjetëra livadhe që të çojnë në vende legjendare dhe misterioze, të cilat u bënë pjesë e jetës së arbëreshëve. Jo shumë larg kroit “Shtikan” është gështenja monumentale e quajtur “Patriarku i Kroj Shtikan”. Moshja e pemës gjigante, mblidhet në më shumë se 11 metra në perimetër. Thuhet se arbëreshët e gjetën atje kur erdhën.

Lumi Finita

Emri mund të rrjedhë nga fjala shqipe *fignë*, që do të thotë *lavanderi*. Një kazan, ku uji i kulluar dhe hiri përziheshin me rrobat brenda, të cilat më pas duheshin shpërlarë në lumë. Shpesh bëhej duke i zierë në breg të lumit, pastaj i nxirrnin dhe i lanin rrobat në lumë. Si pasojë përdorej shpesh shprehja “*unë shkoj te (fignatë) Finita*”.

Një nga figurat e shquara të Qanës ishte **Luigi Petrasi** (Luigi Petrassi). Ai lindi në Qana (*Cerzeto*). Mblodhi këngë popullore kalabreze. Petrasi përktheu këngën e parë të *Çajld Haroldit* të Lord Bajronit dhe poemën *Dei Sepolcri* të Ugo Foskolos, që janë përkthimet e para në shqipe të njohura deri më tani të poezisë romantike europiane.

4.1.24. San Giacomo Di Cerzeto (Shën Japku)

Në jug të Qanës, rreth 1 km larg rrzës së Qafës së *Serra dei Muli* (*Rakji mushkave*), e mbuluar nga pemë me gështenjë shekullore, shtrihet fshati i *San Giacomo di Cerzeto* (*Shën Japku*). Fshati e mori emrin nga *Kapela e San Giacomo-s*, e cila me ardhjen e shqiptarëve më 1534, ekzistonte rrzë malit *Sant 'Elia*.

Muzeu Etnografik në fshatin e Shën Japkut është ngritur së fundmi dhe ekspozon mjete, që kanë të bëjnë me mjedisin fshatar dhe artizan. Këto janë objekte të varfra, por të pasura me histori dhe kulturë popullore. Gjatë shekujve, zejtaria e tekstitit ka pasur një rëndësi të veçantë. Fijet vegjetale të marra nga liri, kërpi, fshesa dhe fijet e kafshëve u përpunuan, në veçanti mëndafshi. Këto procese, edhe pse në një mënyrë të zvogëluar, janë aktive me prodhimin e qilimave, tapeteve dhe batanijeve të mjeshtërisë së mirë sipas traditës.



Figura të shquara të Shën Japkut:

Silvio Mesineti (Silvio Messinetti) ishte mjek dhe politikan i fundshekullit XX. Lindi në Qana, në vitin 1902. Jetoj në Corso Vittorio Emanuele. E quanin doktori i të varfërve. Për njëzet vjet, ai jetoj në provincën e Krotones, ku u zgjodh kryebashkiak. Ai njihet si kryebashkiak i thjeshtë e i lidhur me popullin, të cilit i shërbeu nga viti 1946 deri më 1957. Vdiq në vitin 1996, në vendin ku punoi si kryebashkiak, Krotona. Administrata komunale për nder të punës së këtij arbëreshi, i vendosi një pllakë përkujtimore, më 13 shkurt 2007.

Karmell Kandreva (Carmelo Candreva, 1931-1982), lindi në Shën Japk (*San Giacomo di Cerzeto*) më 4 prill 1931. Kaloj një fëmijëri të varfër, ku deri në moshën 17 vjeç ishte bari. Studioj në formë autodidakte, por në malet e Kalabrisë, fitoj lidhjen e ngushtë me tokën dhe me traditat e popullit të tij, tmerrësisht të varfër e analfabet në fshatrat e thella. Njëkohësisht, dhe kjo është gjëja më kryesore, fitoj vetëdijen se nuk mjaftonte lidhja me tokën. Bashkë me Karmine Stamilen (Carmine Stamille) botoj edhe një studim të gjerë me titull: “*Sprovë didaktike në një mjedis dygjuhësh arbëresh*” (1979).

Poezia e Kandrevës, e botuar së pari në tre vëllimet: *Shpirti i arbërit rron*, Kozenca 1976, *Arbëreshi tregon, II*, Kozencë 1977, dhe *Shpirti i arbërit rron. Vuan dega e hershme, III*, Koriljano Stazione 1979, është ribotuar në Prishtinë dhe në Tiranë. Kandreva ishte poet i krenarisë etnike, po edhe i angazhimit social, i cili ngriti zërin për të luftuar për të drejtat e pakicave e për drejtësi shoqërore. Personazhi idilik i vendlindjes ishte për të edhe vend i mjerimit dhe i mundimeve.

4.1.25. Cavallerizzo (Kajverici)

Cavallerizzo quhet edhe “*S. Giorgio në S. Marco*”. *Cavallerizzo* (*Kajverici* në arbërisht) është pjesë e komunës së Cerzeto-s me 841 banorë, në provincën e Cosenza-s në Kalabri. Rreth tre kilometra në veri të Qanës, është ky komunitet arbëresh në Italisë, ky shembull i rrallë i një fshati nën administrimin e një komune me të njëjtën origjinë dhe identitet etnik.

Origjina e Kajvericit daton rreth vitit 1478, kur pas vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe rënies së Krujës, shumë shqiptarë që iknin nga shtypja e egër osmane u strehuan në Mbretërinë e Napolit. Një pjesë e madhe u mirëprit në pronat e Girolamo Sanseverino di Bisignano.

Emrin e fshatit Kajverici, disa e argumentojnë se quhet kështu, sepse zona u shit nga princi i Bisignano-s të një kalorës. Të tjerë mendojnë se në të kaluarën ajo strehonte kuaj në fermë. Kajverici u themelua nga një grup arbëreshësh në fillim të viteve 1500. Në pronësi në fillim nga Sanseverinos, më 1606, i kaloi Dukës Orsini



Gravina e San Marco Argentano. Atëherë ishte radha e dominimit të Princit Spinelli të Fuscaldo (1629) dhe të Markezit Dattilo të Cosenza (1774) deri në përmbysjen e feudalizmit (1809).

Ishte viti 1758

Pas shirave të rrëmbyeshëm dhe reshjeve të borës të muajve janar dhe shkurt, në muajin maj, një rrëshqitje toke preku qendrën arbëreshe në Kajveric, duke shkaktuar shembjen e disa shtëpive dhe duke i bërë të tjerat të pabanueshme, pikërisht në mes të qytetit, në rrethin e quajtur *De Li Ricioppo*, nën kishë.

Kryetari i bashkisë i kërkoi Baronit Dattilo të rindërtonte shtëpitë e rrënuara në zonën e quajtur *Motticella*, përpara kishës. Por, baroni propozoi rindërtimin në lokalitetin e quajtur *La Croce*, drejt Mungrasanës.

Pas dhjetë vjetësh, më 1768, kryetari i bashkisë themeloi Kajvericin pikërisht në festën e *Shën Gjergjit (San Giorgio)*, sepse sipas besimit, ishte ai që i shpëtoi nga vdekja. Në mesin e viteve 1800, famullitarit Gaetano Melicchio iu dorëzua një statujë e shenjtorit, si një dhuratë nga “Piana degli Albanesi” (*Hora e Arbëreshëvet*).

Arkitektura

Kisha famullitare Cavallerizzo-s. Ndërtimi daton në shekullin XVII, por me kalimin e kohës, ndërtesa ka pësuar ndryshime të shumta. Brenda ka vetëm një navatë. Në një kamare anësore, me një kornizë prej druri, ruhet statuja e bukur e Shën Gjergjit. Kisha u rindërtua më 1860 nga prifti i famullisë Gaetano Melicchio, por u dëmtua nga tërmeti i vitit 1905. U hap për adhurim më 16 prill 1927, me një ceremoni solemne. Më 1992 u restaurua përsëri.

Pallati Posteraro

Ngjitur me Kishën e San Giorgio-s, në sheshin kryesor të fshatit Kajverici, është ky pallat i ndërtuar në fund të shekullit XVII. Ai karakterizohet nga pesë harqe të mëdha në katin e parë, të rregulluar në dy fasada të ndryshme. Vlen të theksohen edhe dyert, mbi të cilat

është vendosur stema, sallat e mëdha në katin kryesor dhe tarraca e madhe panoramike, nga e cila shihet pjesa më e madhe e luginës së Kratit. Në shekullin XIX, pronarët, liberalët dhe republikanët financuan ekspeditën e vëllezërve Bandiera që morën pjesë në ekspeditën e “Të njëmijëve”.

Kajverici njihej për kostumet, të cilat konsideroheshin si nga më të bukurat e Mbretërisë së Dy Sicilive të asaj kohe. Për më tepër, një pjatë e vogël prej porcelani që daton midis viteve 1785-1787, e prodhuar nga “*Real Fabbrica Ferdinanda*”, e krijuar për të dokumentuar kostumet më të bukura të Mbretërisë, ngjall një çudi: është një grua e Kajvericit, pikërisht nga ky fshat i vogël dhe i panjohur, por me këtë famë. Bujaria nuk ishte aq e madhe me këtë zonë, duke marrë parasysh që nga gjysma e dytë e shekullit XV, murtaja, tërmetet dhe krizat ekonomike kishin shpopulluar vendet e jugut dhe ato të Kalabrisë në veçanti, të cilat ishin braktisur plotësisht.

Kajverici sot është një fshat fantazmë

Më 7 mars 2005, një rrëshqitje e madhe toke bëri që i gjithë fshati të evakuohej dhe që nga ai moment, qyteza u bë e pabanueshme. Gjurmët arbëreshe gjenden ende aty: si Fontana Noce - *Kroi Arra*, Fontana Lacerata - *Kroi Laçeratë*, Fontana Tarabanë - *Kroi Tarabanë*.

Popullisa e Kajvericit u zhvendos në një tjetër zonë dhe ndërtuan aty pallate me stile bashkëkohore, që nuk kanë asgjë të përbashkët me stilin arbëresh.

4.1.26. San Martino Di Finita (Shën Mërtiri)

Pozicioni fizik e gjeografik i Shën Mitrit

Është një qendër e vogël në anën lindore të *Catena Costiera*, në luginën e mesme të Kratit (Crati-t). *San Martino di Finita*, ose *Shën Mitri*, së bashku me *Rota Greca*, *San Benedetto Ullano*, *Marri*, *San Giacomo*, *Cerzeto*, *Cavallerizzo*, *Mongrassano* dhe *Cervicati* janë pjesë e komunitetit arbëresh. Në të hyrë të qytezës, me vështrim nga lindja qëndron si simbol, shqiponja dykrenore, që është edhe simbol i flamurit shqiptar.



Historiku

Pas vdekjes së Skënderbeut, shumë arbëreshë u vendosën në këtë vend. Ata vinin nga territoret e Shqipërisë dhe nga Morea, pas vitit 1468. Territori i San Martino-s fillimisht, paraqitej si një fermë në territorin e San Marco-s dhe ishte pjesë e shtetit feudal të Sanseverino-s dhe të Princit të Bisignanos. Më pas, u vendos nën juridiksionin e kështjellës së Reginës. San Martino i përkiste Dioqezës së Bisignano-s. Arbëreshët që erdhën u mbështetën nga feudali i Bisignano-s dhe kështu filluan të ndërtonin kasollet dhe të mbanin ritin bizantin. Me kalimin e shekujve, Shën Mërtiri kaloi nëpër duart e shumë baronëve. Në vitin 1690, pronat e San

Martino-s kaluan përfundimisht nën familjen Alimena, e cila mori edhe titullin e *Markezit* dhe e zotëroi këtë territor deri në përmbyshjen e feudalizmit (1806).

Toponimi San Martino

Toponimi *San Martino* vjen si homonimi e shenjtit me të njëjtin emër, me të cilin arbëreshët kishin emërtuar edhe kishën “San Martino”, pikërisht në regjistrin e tokës komunale më 1825 (San Martino Vecchio). Ndërsa kishën, e quanin “*Qisheza e vjetër*”, ku edhe sot ndodhen rrënojat e saj. Ndërsa toponimi “*Finita*” vjen për shkak të një përroi që ndan dy zona, *finita* (*kufij*).

Ky toponim mban datën 22 janar të vitit 1863. Pra, etimologjia e emrit San Martino di Finita, i referohet shenjtorit mbrojtës “*Shën Martin*”, duke shtuar “*Finitë*” për shkak të, siç e thamë më lart, përroit homonim që rrjedh pranë saj.

Regjistrimet e popullsisë

Dokumenti i parë historik daton në vitin 1503, gjatë kryerjes së një regjistrimi, për qëllime tatimore, të fshatrave shqiptare të Kalabrisë ku rezultoi 22 zjarre për një total prej rreth 80 banorësh. Një regjistrim i mëpashtëm i taksave për të cilin ne dimë, gjithashtu i kufizuar në komunitetet arbëreshe të *Calabria Citeiore*, u krye nga oficerët mbretër më 1543. Popullsia e “Sancto Martino” përbëhej atëherë nga 241 banorë dhe ndahej në 71 “zjarre”.

Mbiemrat arbëreshë

Mbiemrat më të zakonshëm arbëreshë ishin: Basti, Bua, Cali, Camideca, Cartofloca, Clavaro, Coppola (Kopullë), Dardes, Licursi, Drames, Ferraro, Gliossia, Golè, Greco, Malicchia, Migliano, Mosacchio, Namila, Pillora, Radi, Rotundo, Silves, Spata, Sulla dhe Tozio. (Mbizotërues janë mbiemrat: Drames, Tozio ose Toccio).

Urbanistika arbëreshe

Arbëreshët që mbërritën në San Martino iu përveshën punës dhe me shumë mundime e sakrificë filluan të ngrinin qytezën e tyre. Pjesa

më antike është ajo në zonën e “Kishës së Vjetër” (që arbëreshët e kishin emërtuar “Qisha e vjetër”), e qendrës urbane, së cilës i dhanë toponime shqipe: Rahj (Poggio), Nën Rahj (Sotto il Poggio), Kroi Naskut, ose Kroi Muzakut (Burimi: Carlo Musacchio), Qaca (Piazza), Kongat (Conche), Malikat ose Malicchia, etj., Kumba (tharëse), Vurgu (Borgo), Krie Vurgut (Mbi Borgo), Barrakët (Barakat, i njohur edhe si Sheshëz, pra Pianori), domethënë *familje*.

Stili i gjitonisë

Nga një analizë demografike historike, në lidhje me përbërjen dhe vendndodhjen hapësinore të familjeve, si dhe me mbështetjen e toponimisë, theksohet se të paktën deri në gjysmën e parë të shekullit XVIII, familjet që i përkisnin të njëjtit trung, pushtuan lagje të tëra. Në regjistrin e zyrës në shekullin XVIII ka një numër të konsiderueshëm martesash midis njerëzve me të njëjtin mbiemër. Kështu ishin rrethet Tocci (e quajtur *Rahji*), Pinnola, Malicchia (në shekullin XVII). Muzakët, lagjet në të cilat jetuan Drammis, Perrotta dhe të tjerët.

Gjitionia humb stilin e saj vertikal

Lagjet me kalimin e viteve kanë humbur strukturën urbane dhe sociale të gjitonisë. Shpopullimi i vendit, çuan drejt tipit horizontal. Prandaj, gjitioni nuk është domosdoshmërisht një i afërm. Megjithëse gjitionia evoluoi nga një strukturë shoqërore tipike vertikale në një strukturë të tipit horizontal, marrëdhëniet midis anëtarëve të saj ishin shumë të ngushta, si ato me të afërmit.

Ushqyerja e fëmijëve me gji

Një fenomen i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve ishte ushqyerja me gji. Jo vetëm që nënat me më shumë qumësht ushqenin fëmijët e atyre që kishin më pak, por kur nënat e reja largoheshin për punë në komunitet, njëra prej tyre qëndronte në shtëpi duke ushqyer me radhë foshnjat e të tjerave. Gratë, nga të cilat fëmija kishte marrë qumësht, quheshin “mamau”, një variant i termit mëma (nënë).

Riti i vëllazërisë dhe i motrave

Po ashtu, riti i vëllazërimit dhe i motërzimit, variante të termave *vulla* dhe *motër* (përkatësisht vëlla dhe motër), që konsistonte në një dashuri vëllazërore jashtë qendrës së banuar, përmes së cilës përforcoheshin lidhjet midis pjesëmarrësve. Dikur organizohej midis gjitonive të ndryshme.

Brenda kësaj strukture zhvilloheshin punë të përbashkëta të komunitetit dhe bashkëpunonin duke i ardhur në ndihmë njëri-tjetrit. Ky rol u besohej veçanërisht grave dhe adoleshentëve që nuk refuzonin t'i bënin shoqëri gjatë natës të moshuarave të vetmuara, të shkonin dhe të merrnin ujë nga burimi; t'i ndihmonin të merrni ngarkesën e druve para se të hynin në qytet, për t'u kursyer atyre lodhjen. Të moshuarat e shpërblenin ndihmesën, duke u dhënë njohuritë e tyre, të cilat trashëgoheshin nga një brez në tjetrin.

Komuniteti nuk ishte tërësisht i izoluar

Një komunitet i tillë, i strukturuar në mënyrë të ngurtë, mund të duket nga dikush se kemi të bëjmë me një shoqëri të mbyllur. Kjo është pjesërisht është e vërtetë. Nga ana tjetër, një hulumtim i shkurtër arkivor, tregon se tashmë në shekullin XVII, disa samartinezë po martoheshin me njerëz nga komunitete të tjera fqinje, si: Rota, Mongrassano dhe Serra di Leo, dhe nga zona të ndryshme gjeografike, por me të njëjtën origjinë etnike, si Santa Caterina, Spezzano Albanese dhe Falconara Albanese. Sidoqoftë, ka martesë, edhe pse numerikisht të vogla në numër, me njerëz nga vende si Torano dhe Guardia.

Shkëmbimet tregtare

Marrëdhëniet me komunitetet e tjera, për arsye tregtare, siç është blerja e kripës në Lungro, meli në Sartano dhe Spezzano, si dhe pjesëmarrja në panairë si ai i Solferano-s në Bisignano, pelegrinazhe në shenjtëroren e “Madonna del Pettoruto” në San Sosti dhe në atë të “San Francesco di Paola” në qytetin me të njëjtin emër, “ndotën” kulturën etnike të saj. Kjo është qartësisht e dukshme edhe në repertorin e gjerë të melodive, disa prej të cilave janë të

pranishme në komunitete të tjera, si dhe të këngëve në Kalabri. Megjithatë, gjuha kryesore e folur është arbërishtja. Një variant i lashtë i dialektit toskërisht të Shqipërisë së Jugut, të ruajtur nga paraardhësit në tokën italiane.

Veshja e grave arbëreshe

Shumë interesante është veshja tradicionale e grave të Shën Mërtitit, e cila merr një rol kryesor në historiografinë e veshjeve të shqiptarëve të Italisë. Kjo pasi përveç pasurisë së elementeve përbërëse, vlerës së pëlhurave dhe ornamenteve të çmuara, ajo paraqet modele të ndryshme nga njëra-tjetra, bazuar në epokën në të cilën ato u krijuan dhe u veshën. Në fakt, ruajtja në San Martino e modeleve nga epoka të ndryshme dhe një studim i kujdesshëm, si dhe metodologjikisht i saktë, na ka lejuar të kuptojmë evolucionin brenda një konteksti dinamik, në të cilin është zhvilluar kultura arbëreshe.

Deri në mesin e shekullit XVIII, veshja përbëhej ekskluzivisht nga këmisha (linja) me mëngë të gjera, pëlhurë ose mantel saten, zakonisht në ngjyrë të gjelbër, por edhe blu, i mbështetur nga rripa të gjërë të shpatullave dhe kufizohet në fund nga tre shirita mëndafshi ari, ose dantella napolitane. Veli (skjepi) prej mëndafshi ose bambuje, nganjëherë deri në dymbëdhjetë pëllëmbë gjatësi (rreth tre metra), një brez dhe kapela me dantella (keza),^{113*} me platformë dykrenore. Siç përshkruhet, veshja është shumë e ngjashme me atë që ruhet ende në *Caraffa di Catanzaro*.

Një krahasim midis modeleve që ekzistojnë ende në San Martino dhe i njëjtë me modelet nga komunitetet e tjera arbëreshe, me ato të raportuara nga ikonografia e shekullit XVIII dhe XIX, gjetjet fotografike, të ruajtura në San Martino, si dhe krahasimi me format e grupeve të tjera etnike, jepnin një pamje pak a shumë të detajuar të evolucionit të këtij stili. Është interesante të theksohet se sa detaje të vogla, më shumë se gjithçka tjetër në prerjen e veshjeve, e afrojnë

^{113*} **Keza** (kësula), element i veshjes së gruas së martuar arbëreshe, është disi e zgjatur dhe riprodhon një shqiponjë të bukur me dy koka, një simbol i linjës shqiptare.

atë më pranë modës europiane të veshjeve urbane të epokave të ndryshme.

Modeli më i vjetër, i ruajtur në San Martino mund të jetë midis shekujve XVIII dhe XIX. Një model tjetër, në gjysmën e parë të shekullit XIX. Modele të tjera mund t'i përkasin fundit të shekullit XIX dhe disa të tjerë, fillimit të shekullit XX, deri në vitet '50.

Nga fundi i shekullit të kaluar e deri në fund të viteve 1920, modele të ndryshme bashkëjetuan në San Martino. Ato ndryshonin nga njëri-tjetri, sipas brezave të ndryshëm që i vishnin, po ashtu edhe nga shijet personale, si dhe nga rrobaqepësit që i qepnin. Por vitet '30 të shekullit XX i dhanë formën përfundimtare, si prerjes, ashtu edhe larmisë së pëlhurave të ndryshme, si në llojin e pëlhurës, edhe në ngjyrën e saj. Tashmë në vitet '50, gratë e reja filluan të veshin jo më kostumin arbëresh, për këtë arsye, veshja arbëreshe ndali evolucionin e saj.

Artizanati

Sipas traditës antike, në disa familje ende prodhohen tapiceri dhe batanije të punuara me dorë, që karakterizohen nga dizenjime dhe tema të frymëzuara nga historia shqiptare.

Nga riti bizantin në ritin latin

Arbëreshët e Shën Mërtirit kaluan në vitin 1643 në ritin latin, për shkak të presionit të asaj kohe mbi ritin bizantin.

Ekziston edhe një variant tjetër, ku flitet për një “bola papal” të lëshuar më 21 shtator të vitit 1089 nga Papa Urban II, i cili konfirmoi posedimin e tokës së San Martino-s nga Abati San Trinità di Cava.

Arkitektura

Banesat e para të arbëreshëve, si kudo, ishin kasolle me degë dhe me baltë, por kishat që ata ndërtuan, i konsideruan “tempuj” dhe ndërtoheshin me stilin e tyre të kultit. Kisha Nënë, nuk e pati fatin t'u rezistonte kohërave, sepse nga njëra anë, erozioni dhe nga ana

tjetër, tërmeti i vitit 1900, i dëmtuan shumë muret e saj. Arbëreshët edhe sot i thërrasin “Qisha e vjetër”. Data e fundit për rindërtimin e saj daton në vitet ‘30. Restaurimet në kohët e fundit e kanë bërë ndërtesën e shenjtë një nga më të rëndësishmet. Brenda ka dy statuja që përshkruajnë Shën Martinin, një kryqëz të vlefshëm dhe një ekspozim që përfaqëson “Grotta di Lourdes” (Shpellën e Lurdit).

Kulla katërkëndëshe brenda me sahatin ka një formë hapje si akrepi. Në brendësi të kishës ndodhen statuja e Madonna-s (në bronz dhe dru, relike të viteve ‘700), busti i San Michele-s; busti i drurit të San Francesco di Paola (shekulli XVIII), Madonna del Carmine (në dru, shekulli XVIII), San Giuseppe (në dru, shekulli XVIII), Peshkopi San Martino (në shekullin XIX), San Martino mbi kalë (në dru, shekulli XIX), Santa Rita (në dru, shekulli XVIII).

Kisha e Borgos në Bartolomeo

Në zonën e Bartolomeo-s ndodhet kisha e Bartolomeo-s. “Chiesa del Borgo”. Jashtë gjendet portali prej guri, ndërsa brenda ka altarin, me motive baroku dhe një organo të shekullit XVI, me dru kane spanjoll.

“Santuario i Misericordia”

Santuari i vendosur në rrethin e San Bartolomeo-s është ndërtuar në vitin 1600 dhe është vendi i konfidencialitetit të S.S. *Maria e Mëshirës*. Ka një plan drejtkëndësh me një mur të vetëm dhe dy kapela anësore. Viti 1828 tregohet në fasadën sipër portalit prej guri. Brenda ka statujat prej druri nga shekulli XIX, që përshkruajnë Shën Pjetrin dhe Shën Gjon Pagëzorin, një altar mermeri dhe një statujë me gjatësi të plotë, që përfaqëson Madonën, një vepër prej druri nga F. Gullo e shekullit XIX. Mbi fasadën kryesore është vendosur mbishkrimi me vitin 1828.

Festa e qytezës së Shën Mërtirit festohet më 11 nëntor dhe shtëpitë feudale të kësaj krahine janë: Pallati Scavello, Pallati Musacchio, Pallati Garrafa (Tocci shek. XVII), Pallati Carci etj. Interesante dhe me rëndësi historike është pallati i Giacinto Alimena, sepse është edhe një qendër aktive e prodhimit artizanal të produkteve të tekstilit.

Burimet e San Martino-s:

Kroi Bagnoce (burimi i banjës). Para dasmës, nusja shkon për t’u larë. Atë e ndihmonin vetëm shoqe virgjëresha.

Kroi Giuàn (burimi Giovanni) e merr emrin nga murgu, i cili gjatë periudhës së Kreshmës ngacmoi një vajzë nga San Martino, e cila u vra nga vëllezërit në këtë shatërvan.

4.1.27. Spezzano Albanese (Spixana)

Spezzano Albanese, ose siç i thonë arbëreshët *Spixana* ndodhet në një zonë kodrinore midis *Piana di Sibari-t* dhe luginës së *Esaro-s*, rreth 300 metra mbi nivelin e detit. Kjo komunë përfshin fshatrat e *Spezzano Scalo-s* dhe *Spezzano Terme-s*, ku rrjedhin ujërat e dobishëm të pranverës, *Fonte Thurio* dhe *Acqua delle Grazie*.

Nëse udhëton në rrugën shtetërore “sp 241”, nëpërmjet Tarsias, lë në krah të djathtë liqenin artificial të Tarsës dhe pllajën e Sibarit. Në horizont duket deti. Kjo rrugë ishte i vetmi komunikim, që lidhte Kalabrinë më Napolin (është rruga që kanë bërë mërgimtarët arbëreshë, të lodhur e të drobitur, kur kanë ardhur nga Greqia dhe Shqipëria në shekullin XV).



Lashtësia

Arbëreshët, kur u vendosën në këto troje të lashta, nuk e dinin se kishin ardhur në një territor epik, ku lulëzonte periudha helenistike e ku mbretëronte bukuria natyrore e Polinit. Arbëreshët nuk e njihnin kullën stoike “Mordilo”, e cila ngjan me historinë e arbëreshit, krenare prej mijëra shekujsh. Ky vend ishte pikë kyçe për kontrollin e territorit të rrafshit Sibari deri në detin Tirren.

Kulla Mordilo (*Torre Mordillo*)

Kulla Mordilo i jep emrin një parku të madh arkeologjik, i cili fillimisht u zbulua nga profesor Luigi Viola (Luigi Viola) (asokohe, drejtor i Muzeut Arkeologjik të Tarantos) midis fundit të 1887-s dhe fillimit të 1888-s.

Dokumentet arkeologjike, të zbuluara gradualisht, dëshmojnë praninë e cikleve të ndryshme të vendbanimeve në një periudhë të gjatë kohore, nga fillimi i Epokës së Bronzit (shekulli XVII para Krishtit) e deri në periudhën helenistike.

Kulla në formë rrethore është i vetmi objekt i dukshëm dominues nga një distancë e madhe në rrafshinën *Esaro*. Artifaktet e gjetura në këtë vend janë të shpërndara në muze të ndryshme, si: në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të Sibarit dhe në muzeun “Pigorinia”, Romë etj. Me kalimin e kohës nuk është bërë asnjë përpjekje serioze për të përmirësuar zonën, e cila aktualisht është lënë pas dore.¹¹⁴

Torre Scribla

Rruga që të çon në Castrovollari është një rrugë antike, e cila lidh Spixanën me Napolin. Në krah të djathë, në një kodër, ndodhen mbetjet e vendbanimit ushtarak norman, një fortesë që duhet të lejonte hyrjen në luginë. Shihet vetëm njëra pjesë, *Torre Scribla*, ndërkohë që pjesa tjetër ndodhet më poshtë, ku mendohet të kenë qenë dy kulla, ndoshta binjake. Ky territor ishte nën zotërim nga

¹¹⁴ F. Mollo - R. Smurra, s.v. *Torre del Mordillo*, BTCGI XXI, *Pisa-Roma-Napoli*, 2012, faqet 66-80; faqet 70-73, 74-80 (Fabrizio Mollo; *Istituto per gli Studi Micenei ed Egeo-Anatolici*, Roma 10/2001, faqet 12, 13, 16 e 19).

Sanseverino di Bisignano dhe më pas, nga Spinelli ndërsa para shkatërrimit të tij, ishte vendi i kalorësve të Maltës.

Prejardhja e emrit *Spezzano Albanese*

Origjina e emrit të Spezzano Albanese-s nuk është shumë e qartë. Ka shumë të ngjarë që rrjedh nga latinishtja, siç mendojnë disa studiues, pasi, siç tregohet nga dokumentet historike, thuhet së Spezzano-ja e sotme dikur quhej “*Spetianum*”. Disa studiues të tjerë mendojnë së origjina e emrit që arbëreshët i dhanë vendit buron nga “*Spiza*”, pozicionuar në gjirin e Tivarit, në Mal të Zi, ku gjenden shumë fshatra shqiptare. Studiues të tjerë ia atribuojnë origjinën nga ishujt jonianë të arkipelagut grek “*Spezia*”, ku banonin shqiptarë. Këtë e shpjegonin më faktin e ardhjes në Itali të shqiptarëve, të cilët, për të kujtuar atdheun e tyre të braktisur, i dhanë emrin e vendit të origjinës atje ku u vendosën.

Historiku, vitet 1467-1543

Sipas profesor Francesco Marchianò,¹¹⁵ popullsia e ardhur në Spixanë ishte e varfër dhe merrej kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Si e tillë, u vendos atje ku ishin toka të përshtatshme për të rritur kafshët e për të kultivuar tokat. Thuhet së arbëreshët u vendosën në ato vende ku kishte ujë e ku gjendeshin manastiret, dy elemente që u nevojiteshin për të ushqyer trupin e shpirtin.

Njëri prej krojeve ishte ai më emrin “**Fundanelet**” (*Le Fontanelle*), rreth një milje larg nga qyteza në drejtim të Austros, pranë një muri të ndërtuar rreth vitit 1850, ku rridhte burimi, i cili u shoi etjen shumë arbëreshëve dhe popullsisë vendase. Kroj, së bashku me platformën e *lavanderisë* (vendi ku lanin rrobat), gjenden rreth 100 m larg, në udhëkryqin e San Salvadores-s, duke ndjekur rrugën “SP 241 (ex SS 19)” në të djathtë. Ky burim është tharë sot, por luajti

¹¹⁵ *Francesco Marchianò*, profesor i historisë, studiues, hulumtues, i cili ka publikuar për periudhën e *Risogimento*-s së Spixanos, për jetën arbëreshe, historikun e saj e shumë materiale të “*Katundi ynë*”. *Marchianò* është anëtar e bashkëpunëtor i shquar i shoqatës “*Bashkimi*” dhe njohës i mirë i gjuhës shqipe.

një rol shumë të rëndësishëm në jetën e arbëreshëve që u vendosën në këto shtigje e brigje.

Kroi “Pozzo”(Pusi) ndodhet në këmbët e kodrës, ku është vendosur *Madonna delle Grazie*. Ai ka pak ujë dhe, rreth 25 vjet më parë, burimet e “Columbro-s”(Kullumbri) dhe të “Pozzo-s” (*Pusi*) u bashkuan, duke formuar një krua të vetëm, i cili mban emrin “*Pusi i vjetër*”.

Zona “Prato” është zona ku u vendosën arbëreshët e Spixanës për herë të parë. Aty nuk ka asnjë gjurmë, përveç tokave të punuara. Arbëreshët ndërjuan kasolle kashte, të cilat i digjnin shpeshherë në pranverë për të mos paguar taksat.

Përrenjtë janë dëshmi që arbëreshët nuk janë vetëm ata që shikojmë sot, më kostume të ndritshme, por një popull me shumë sakrifica, të cilët punuan, derdhën gjak e arritën të krijonin një harmoni me popullsinë vendase që vuante po aq sa ajo arbëreshe.

Kroi i Pratit (pozicionuar në lindje dhe në veri të qytezës), të cilit, në 1858-n, iu shtuan çatia dhe lavaxantaria ishte vendi ku socializoheshin gratë, duke larë rrobat, duke mbushur uji për vete dhe për kafshët. Ky burim, edhe pse me pak derdhje, vazhdon të rrjedhë në jetën e Spixanës, duke mbartur historinë. Kroi sot është i harruar e i braktisur; në të nuk ka as edhe një pllakë përkujtimore.

Pranë kësaj zone ndodhet edhe një zonë tjetër, që i thonë *Valco Fimena* (*Valico/Varco delle femmine*), e cila duket gjatë rrugës që përshkohet me makinë. Në dokumentet antike të fundit të shekullit XVI e gjejmë edhe me emrin *Varco de La Jencha* ose *la Varca di Spezzano*. Uji zbret nga një gëmushë plot gjelbërim e vendi është i mbushur me të mbjella. Edhe ky vend u bë një nga strehët e arbëreshëve.

Nga rruga, disi në distancë, shihen gjurmët e një strukture, e cila ka qenë fabrikë e barutit. Kjo ka pësuar transformime, duke u kthyer në një fabrikë buke e së fundi në fabrikë vaji.

Rruga e Horës, e cila i përket shek. XV, ka pasur të njëjtin emër që ka dhe sot. Në mes të rrugës ndodhet një pjesë rruge më çakëll, ku duken gurët e shtruar e që i përket një epoke shumë të hershme, pothuajse romane. Arbëreshët shkelën në atë rrugë me kalldrëm, i prekën ato gurë, atë vend, që do ta pagëzonin si atdheu i dytë.

Gjatë rrugës në vazhdim shfaqet në horizont një copë tokë, që arbëreshët e quanin “*Copa e madhe*”, për shkak të shtrirjes së saj të gjerë dhe të një relievi të rregullt. Anës rrugës ndeshet një bimë, të cilën arbëreshët e quanin “*muqja*” – bimë që u shërbente për t’i dhënë aromë bukës kur piqej në furrë. Kokrrat e kësaj bime shërbenin për prodhim vaji.

Tokat përqark janë plot më ullishte dhe e gjithë natyra e qetë bie në kontrast me praninë e shtyllave të larta të energjisë eolike.

Militino (Terranova di Sibari) është një zonë e pasur me florën e faunën, të cilën arbëreshët e vendasit e kanë frekuentuar edhe nga prania e kroit të quajtur *Shën Mëria e Dushkut* (Santa Maria di Loreto) e vitit 1492. Disa metra në afërsi të saj, nga ana tjetër e rrugës, dikur kishte qenë një manastir antik i San Francesco di Assisi-t (në fund të shek. XV).

Si e zgjodhën këtë vend arbëreshët?

Spixana u përket pesë komuniteteve arbëreshe, të cilat, për nga distanca, janë sa larg, aq edhe afër me njëri-tjetrin. Ato janë vendosur midis bregut të Corigliano-s dhe Sibari-t antik e, në brendësi, ndahen, përkatësisht: tre, mes pyjeve të *Pre Sila Cosentina*, duke formuar San Giorgio, San Cosmo, San Demetrio (duke formuar kështu fshatin e tyre më emrin e protektorit të tyre) dhe fshatrat e tjerë, që janë Vakarici (që sheh në lindje ultësirën e Sibarit e Jonin; në jug, San Giorgio-n, dhe në perëndim, dritat e San Kozmos, të Shën Mitrit dhe në veri gjendet Spixana.

Të gjithë këto fshatra ishin sistemuar, përveç njërit, Spixanës. Ata ishin në kërkim të yllit të tyre. Ky grup nuk u ngjit në drejtim të Silës, por vazhdoi të ecte në drejtim të rrafshnaltës e u vendos në lagjen që sot quhet “*Cantinella*”. Në horizont duket kurora e malit Polin dhe lugina Esaro dhe fusha e Sibarit.

Grupit që arriti në këto troje nuk i mungonte mbrojtësi i tyre dhe ai ishte shenjtori *San Francesco di Paola*, i cili vdiq 1507. Pas vdekjes së tij, komuniteti i shqiptarëve ishte i dëshpëruar dhe ata kërkonin Madonën, mbrojtësen e tyre që i kishte shoqëruar nga vendi i tyre i lindjes Arbëria deri atje. Në këtë gjendje, ata ecnin si të humbur në pyjet e gëmushat e Vignale-s e të Martalo-s, duke shkuar deri në brigjet Esaro e del Coscile, duke u ndalur për të gjetur ngushëllim. Kjo zonë u shndërrua në atë që sot njihet si V. San Maria.

Legjenda “Madonna delle Grazie”

Rrëfëhet se në muajin prill (nuk dihet viti më saktësi, por rreth viteve 1510 e 1520, në një kalive (kasolle, ose shtëpi modeste e hershme arbëreshe) jetonte një grua arbëreshe rreth 30 vjeç (ishte e ve që prej 13 vjetëve), së cilës iu shfaq në ëndërr një dritë shumë e fuqishme, aq sa nuk shikonte më. E shqetësuar se ndoshta ishte vonë, zgjoi herët të dy fëmijët e saj ende të vegjël e i nisi për të kullotur kafshët dhe nuk arriti të kuptonte se përjashta ishte ende errësirë e ra për të fjetur. Fëmijët që dolën herët po shihnin një agim shumë të çuditshëm; dielli ishte ndryshe, dallëndyshet në qiell krijonin arabeska që të tërhiqnin me lëvizjet e tyre akrobatike, zogjtë cicëronin e dukeshin si më të gëzuar se zakonisht e nga ky qiell i pastër blu u shfaq një dritë dhe, prej andej, dalëngadalë, një fytyrë e ëmbël me flokë të verdha dhe me një vështrim sa rrëmbyes, aq hipnotizues.

Të vendosur mbi qerpikët e gëmushës, ata ndalen duke admiruar këtë krijesë, që u buzëqeshte dhe u pushtoi zemrën. Qëndronte mbi një fron dhe kishte një fustan blu të qëndisur më ar dhe në kokë mbante një kurorë (turrta) të fisme. Të dy fëmijët harruan për një çast kafshët. Vrapuan në shtëpi dhe rrëfyen për çfarë u kishte ndodhur. Shumë erdhën në atë vend dhe panë e pastaj ulën kokën, u përulën në shenjë nderimi dhe çdo gjë heshti. Kjo heshtje zgjati shumë, sa dukej sikur edhe frymë nuk merrnin. Lot gëzimi dolën nga sytë e shumë prej tyre, ngjanin si vesa e mëngjesit përkëdhelur nga dielli. Momente solemne, himn e besë, përulje dhe falënderime Shën

Mërisë, që e kërkonin prej kohësh dhe ajo tashmë kishte mbërritur në Spixanë. Shën Mëria që u quajt “*Madonna delle Grazie*”. Edhe qielli dukej si i qëndisur me yjëza.

Kapela e vogël e “*Madonna delle Grazie*” është zmadhuar ndër shekuj për të arritur formën madhështore që ka sot. Në fillim të shekullit XVIII, gjatë administrimit të kishës nga mjeku Nicola Guaglianone dhe Francesco Bellezzi, u shtuan dy murriza anësore. Në hyrje, dy kolona të bukura në gur, të cilat mbështesin portën madhështore të hyrjes me hekur të punuar. Bellezzi bëri gjithashtu altarin kryesor të bërë nga mermeri dhe dekorimet e bukura të gdhendura prej druri, që zbukurojnë kamaren e madhe, ku ekspozohet statuja antike e Virgjëreshës Mari. Asaj iu shtuan dy kamare anësore, kambanat dhe salla hyrëse, e cila kufizohej nga tri porta madhështore prej hekuri të punuar. Brenda ka tre murriza të mbuluar me mermer polikrom.

Më 5 gusht 1951, me nismën e imzot Don Francesco Gullo, me një festë solemne fetare, kisha u ngrit si vend i shenjtë dhe “*Madonna delle Grazie*” u kurorëzua dhe u shpall “Mbretëresha e Spezzanesi-t”.

Ku u pozicionuan arbëreshët e Spixanës?

Vendi i ri ku u vendosën arbëreshët ishte në një kodër nga e cila dukej deti Jon, që i ndante nga toka amë dhe që e kujtonin me nostalgji të madhe. Sipas burimeve historike, në periudhën 1467-1543, kur arritën refugjatët e parë shqiptarë të ardhur nga Shqipëria e nga Greqia, ata u vendosën në zonën *Prati*, pranë burimeve aktuale “Pusi” dhe “Kulumbri”, dhe në Casale di San Lorenzo. Ata ndërtuan kasolle të mjerueshme me degë dhe baltë, duke ia kushtuar jetën jetën blegtorisë dhe bujqësisë.

Në Spixanë, në një territor të quajtur “San Lorenzo”, pronë e feudalëve të Peskarës, dukës së Saracenvë, u vendosën një grup tjetër arbëreshësh. Këta të fundit kishin mosmarrëveshje dhe përleshje me ata që gjetën aty dhe, për rrjedhojë, bashkëjetesa midis tyre u bë e pamundur. Situata u përkeqësua më tej kur një grup i ri shqiptarësh mbërritën nga qyteti Corone (1533). Arsyet e përplasjeve shpjegohen

me faktin se kolonët e mbërritur punuan tokat e “zotërve” vendas dhe papunësia e popullsisë vendase u rrit e bashkë me të u rrit edhe kriminaliteti e ilegaliteti. Shumë prej familjeve arbëreshe, të shtrënguar nga uria, kryenin vjedhje të vogla për të mbijetuar. Pas këtyre ngjarjeve të pakëndshme, markezi Marcello Pescara, duke përfituar nga një ligj i miratuar kundër epirotëve, mbollën urrejtje dhe terror e kështu, shkaktuan kontraste të pashmangshme midis dy grupeve etnike, derisa shumë familje u shpërngulën nga “Casale San Lorenzo”. Rreth vitit 1543, kjo popullsi arbëreshe, falë autorizimit të marrë direkt nga mbreti i Napolit, u zhvendosën në fermën “Casale delle Grazie”.

Dokumentet e para të popullsisë arbëreshe në Spixanë

Në vitin 1500 zona e banuar shpërngulet në zonën më të lartë që i afrohet kishës së San Pietro-s e Paolo-s. Prifti i parë i famullisë bizantine greke, për të cilin gjenden dokumente, ishte Don Martino Barbato. Ai në vitin 1598 filloi librin e parë të pagëzimeve. Po në këtë vëllim të çmuar, të shkruar me vëmendje të madhe shfaqen emrat e mbiemrat e zonave të banuara të Spezzano Albanese-s.

Informacioni më i lashtë nga arkivat e famullisë vjen nga vetë kjo famulli, e cila i përket vitit 1598 me Don Martino Barbaton, kapelani i *Casale delle Grazie*, i cili filloi librin e tij të pagëzimeve më 10 gusht 1598. 76 faqet e para të këtij libri tregojnë pagëzimet e para dhe pikërisht ato të bëra në “Capela della Grazia”, i cili ishte edhe i pari ndërtim që arbëreshët bënë dalëngadalë me sakrificat e tyre.

Çështja arbëreshe është disi e komplikuar për arsye se jo gjithmonë ka, apo gjenden dokumente arkivore.¹¹⁶

¹¹⁶ *Giuseppe Acquafredda* është hulumtuesi, studiuesi i shumë veprave dhe themeluesi i shoqatës “Bashkimi” në vitin 1984. Ai është një ndër studiuesit më të mëdhenj të botës arbëreshe sot. Falë tij, ne i kemi këto të dhëna, të cilat ruheshin në shoqatën “Bashkimi”.

Jeta e arbëreshëve të Spixanës në Casale

Sistemi feudal ishte i egër si për popullsinë vendase, ashtu edhe për popullsinë arbëreshe. Kjo e fundit, që u vendos në këto shtigje, u mor me blegtori dhe bujqësi. Popullsitë arbëreshe dhe vendase nuk kishin të drejtë që kafshët e tyre të kullosnin lirshëm nëpër lëndina, nuk kishin të drejtë që të shfrytëzonin të njëjtat hapësira, ku qëndronin zotërinjtë feudalë (përcaktuar me kufij). Kishte dhe një ligj për kullotat: nëse gjedhi do të kalonte territorin, koka e kafshës i shkonte priftit, trupi i shkonte feudalit dhe, në të njëjtën kohë, fshatari do paguante dhe taksën e dëmshpërblimit. Kjo do të thotë se popullsia në sistemin feudal kalabrez nën regjimin e Spinelli-t ishte në kushte tepër të vështira.

Vetëm në vitin 1581 nis një kapitull i ri, sepse realizohet marrëveshja e parë me princin e Bisagnano-s, me të cilin ishte martuar mbesa e Gjergj Kastriotit, gjë që ndikoi pozitivisht për popullsinë arbëreshe. Taksat paguheshin në bazë të “zjarreve” (familjeve feudale, ose priftërinjve), të cilëve u paguhej pesë dynym grurë në vit.

Kisha e Shën Janit

Popullsia arbëreshe ishte rritur dhe banesat po shtoheshin në lagjen e Kostandinopojës. Në vitin 1607, kisha e Shën Mërisë ishte shumë larg qendrës që popullohej; ndodhej në pjesën e lagjes “Prato”. Lagja e Kostandinopojës midis luginave, e cila në atë kohë fillonte përtej ish-rrugës “*Nazionale*” dhe që përfshinte lagjen “Cella” dhe “Xhullumeta”, e bënte të vështirë frekuentimin e kishës “Madonna della Grazia”, për shkak të distancës e të kushteve atmosferike në dimër; kështu që lindi nevoja të ndërtohej një tjetër tempull.

Martino Barbato, kapelan i kishës së *Santa Maria di Spixano* (delle Grazie), e konsideronte të dobishëm ndërtimin ose rinovimin e kishës “San Giovanni” me shpenzimet e veta, sepse gjatë dimrit, meqenëse kisha “Santa Maria delle Grazie” ishte larg bëhej problem për frekuentimin e saj prej të moshuarve (por edhe për të rinjtë apo për të vegjlit, për shkak të mungesës së shkollave dhe ishte e nevojshme për të ndjekur ritin fetar për edukimin e tyre). Problem

tjetër ishte shkak i klimës së dimrit, e cila nga ana e detit Jon është e ekspozuar ndaj rrymave arktike të ngrirjes dhe është shumë më e ngurtë së ajo e detit Tirren.

Kisha e Shën Janit (Giovani Battista) kryente ritet e pagëzimit dhe ato të varrimit. Këtu ndodhen edhe eshtrat e tij e të familjes së tij dhe të shumë e shumë njerëzve të popullsisë së Spixanës. Aktualisht, në të gjendet vetëm një tabelë treguese e shkruar në gjuhën shqipe “Shën Jani”.

Kisha “S.S. Pietro e Paolo”

Kur Spixana po rritej e shtohet në vitin 1607, Don Martino Barbato përgëzoi, uroi dhe hapi kishën “S.S Pietro e Paolo”. Në këtë kishë u ndryshua me dhunë riti grek në atë latin, me urdhër të princit Spinelli të Tarsisë dhe Don Nicola Basta. Kjo ngjarje mbahet mend për egërsinë e këtij argjipeshkvi dhe për tiraninë e familjes Spineli, duke detyruar banorët e Spixanës të braktisnin ritin greko-bizantin. E gjithë kjo ndodhi edhe për shkak të presionit të fortë të ushtruar nga kryepeshkopi i Rossano-s, që i përkiste familjes Spineli.

Më 9 mars të vitit 1668, Don Vincenzo Magnacavallo festoi pagëzimin e parë. Në arkivat e famullive nuk ka më shumë lajme lidhur me shekullin XVII. Në vitin 1668, kisha “San Pietro” e Spixanës kaloi nga riti bizantin në ritin latin.

Kisha e tretë në Spixana është ajo e Shën Pietrit e Paolos. Përpara kishës “San Pietro” ndodhej edhe një burg, që ekzistonte që nga viti 1849. Burgu u shkatërrua përpara Luftës së Dytë Botërore.

Spixana midis viteve 1595-1648

Mendohet se në vitin 1607 fshati ishte zhvilluar në lagjen “Santa Maria”, ku rezulton me plot 47 zjarre ose familje, por ndodhte që bashkoheshin dy familje për të shmangur taksën e pagesës për dy zjarre. Familjet aktuale mund të kishin qenë midis 47 dhe 94 zjarre dhe qendra e banuar mund të shtrihej në shtëpitë prapa pjesës fundore që tani quhet rruga “Roma”, sepse kjo shtrirje, për shkak të linearitetit të saj, presupozon një organizim urban. Flasim për një

periudhë ku ekzistonin të dy kishat, gjë që do të thotë se popullsia ishte rritur, se për ndryshe kisha e “Santa Maria delle Grazie” do të kishte qenë e mjaftueshme për këtë popullatë.

Popullsia e Spixanës vinte nga gadishulli Ballkanik, kryesisht nga Arbëria dhe përdornin ritin bizantin lindor. Priftërinjtë e tyre i thërrisnin “Papas” dhe ishin të urdhëruar nga peshkopi i Ohrit në Maqedoni. Papa i parë i ritit bizantin, për të cilin ka dokumente, ishte Martino Barbato. Ai ndërtoi për veten e vet dhe familjen e tij kishën “San Giovanni Batista” (1649). Priftërinjtë gjatë kësaj epoke mund të martoheshin një herë. Duke qenë të varfër, ndihmonin në fushë dhe mësonin edhe të varfrit të lexonin.

Viti 1572, fillimi i kapitujve (marrëveshjeve)

Më 31 tetor të vitit 1572 Spixana ishte pronë e Niccolò Sanseverino-s, birit të Pietro Antonio-s dhe Irina Kastriotit. Marrëveshjet e shumëpritura realizuan shfrytëzimin e tokave, si dhe të drejtën e përdorimit të ujit.

Në vitin 1647, revolta e Masaniello-s në Kalabri dhe arbëreshët

Në vitin 1647, në Napoli shpërtheu një trazirë në sheshe, e cila u shndërrua shpejt në revoltë ndaj pushtetit të spanjollëve në Italinë e Jugut. Në Kalabri u shpall republika. Franca aleate me piratët turq nxitën revoltën dhe dërguan këshilltarët e vet ushtarakë, mes tyre Pietro Santo Becci i fermës arbëreshe të S. Sofjes. Të parët që u shfaqën ishin minatorët e kripës së Lungro-s, të udhëhequr nga Tosardo, i cili punonte si llogaritar. Filloi një luftë e përgjakshme civile, me grushte shteti, tradhti dhe mizori. Sipas raporteve spanjolle, shqiptarët “të këqij nga natyra dhe nga besimi”, u dalluan në betejat që u zhvilluan midis Cosenza-s, Luzzi-t, Corigliano-s, Rossano-s, San Donato-s (të Ninea-s). Revolta në Napoli dështoi, në Kalabri zjarri u ndez aq shumë, sa që qeveria spanjolle dërgoi Capecelatro-n për të shtypur lëvizjen. Ishte një përleshje dhe një masakër mes kalabrezëve dhe arbëreshëve. Shtëpive të fshatrave iu vu zjarri. Kjo vazhdoi edhe pas vitit 1650. Sipas dokumenteve të

konsultuara, arbëreshët ishin të parët që u rebeluan dhe të fundit, të cilët u dorëzuan.¹¹⁷

Folklori dhe riti

Edhe sot në Spixanë festohen *Krëshmëza*, kukulla e veshur me rroba që përgatisin nënat arbëreshe. Te këmbët i vihej një portokall me shtatë pendë pule. Pendët i hiqeshin nga një çdo ditë deri sa arrinte Pashka, pendët digjeshin në zjarr, sepse era e pendës largonte shpirtrat e këqij nga shtëpia. Ajo kukull e vogël ishte një “*sahat*” në kohët e mëparshme për nënat arbëreshe.

Rruga “Costandinopoli”

Rruga “Costandinopoli”, ndodhet pranë kishës së Kostandinopojës. E veçantë në stilin e saj neoklasik, ajo ishte fillimisht një kishëz e vogël, ku, siç tregohet nga regjistrat e famullive të asaj kohe, të vdekurit u varrosën atje në vitin 1655. Kisha është shumë e lashtë, ndoshta e ndërtuar në një periudhë edhe më të largët sesa data në të cilën përmendet.

Kisha qëndron në rrethin e quajtur “*qelizë*”, me siguri sepse në atë vend, në lashtësi, kishte qeliza “Antoniane”, siç shkruhet në pllakën sipër derës kryesore. Kapela e vogël e Santa Maria e Kostandinopojës u ripërshtat më 1742 dhe më 1826, kisha u zgjerua nga prokura “Don Dongo Salimena” me faljet e besimtarëve.

Në vitin 1836, në këtë kishë u krijua *Kongregacioni Laik i Shenjtorëve të Kostandinopojës*, me miratimin e mbretit Ferdinand. Vëllezërit e kongregacionit mbanin një thes të bardhë dhe një pelerinë blu në demonstrata fetare dhe procesione varrimesh. Kongreset e xhematit, në vitin 1850, me ndihmën e besimtarëve të tjerë, zmadhuan murrizin qendror, ndërtuan rrugicat anësore e kullën e kambanës dhe rindërtuan dyshe-menë. Në atë kohë, festa e Medresesë së Kostandinopojës festohej në një mënyrë solemne, aq sa për të rivalizuar atë që u festua në shenjtororen e Madonna delle Grazie, mbrojtësen e vendit. Brenda saj ka një trashëgimi të pasur fetaro-artistike.

¹¹⁷ Informacionet mbi revoltën e Masaniello-s janë përgatitur nga prof. Francesco Marchianò.

“Cimtori”

Në vitin 1848, në zonën ngjitur me kishën e Kostandinopojës u ndërtuan varrezat e para, duke qenë një nga vendet e para me një varrezë të vërtetë. Deri në atë kohë, njerëzit ishin varrosur në varret poshtë kateve të kishave. Ndërsa kroi i Kishës Nënë, pranë dhomave të fundit të Pallatit Rinaldi, nga ana e pasme e derës së vogël të kishës, quhej “*Cimtori*”.

Kisha San Maria del Carmelo

Alessandro Cucci e Don Dragonetto Cucci nga viti 1735 deri në vitin 1744, ndërtuan kishën Del Carmine përbri shkollës “Ritiro del Carmine”. Kisha që u ndërtua mban emrin “San Maria del Carmelo”. Në arkivin e Parisio Ribecco-s, thuhet se në vitin 1735 u ngrit kisha *Del Carmine* dhe pranë saj, ndërtuan një manastir, me emrin “*Rrethimi i Karminit*”. Këtu, shumë priftërinj të shquar formuan klerin.

Gjatë periudhës së burbonëve, një pjesë e ndërtesës shërbeu si institucioni i Gjykatës Ushtarake. Në mars të vitit 1806, trupat franceze, pas një përleshjeje të përgjakshme, u strehuan në Kishën Nënë. Ata shkatërruan mermerin e altarët dhe ndezën zjarrin në qendër të kishës. Kisha e Spixanës drejtohej në atë kohë nga Don Vincenzo Maria Cucci, i cili u emërua në vitin 1803 kryepriift, deri në vitin 1842. Thuhet se ata humbën çdo të drejtë mbi këtë kishë me pushtimin francez, në vitin 1806. Më vonë, kisha “Del Carmine” u restaurua nga mjeshtërit arbëreshë Antonio dhe djali i tij, Salvatore, që ishin gjenerata më antike e muratorëve. Kjo kishë është e pasur edhe me një pasuri elementesh artistike. Sheshi përballë saj quhet “Garibaldi”.

Madonna delle Grazie dhe procesioni më 15 gusht

Në vitin 1799, nisën kryengritjet e Republikës Napolitane në Italinë e Jugut. Spixana e kishte pranuar frymën e lirisë së revolucionit francez. Ky qëndrim nuk u pa me sy të mirë prej shumë fshatrave fqinjë, të cilët në gusht 1799 organizuan një ekspeditë me qëllim plaçkitjen. Sulmi u zbulua nga banorët Spixanës, të cilët pasi

siguruan gratë dhe fëmijët në pyllin afër, pritën bandën në zonat *Vignale* dhe *San Domenico*. Në pritën e bërë, mbeti i vrarë një prej plaçkitësve dhe të tjerët ia mbathën vrapit. Kisha e Spixanës drejtohej në ato vite nga arkipeshkvi Don Antonio Fronzino.

Procesioni i Madonna della Grazia bëhet çdo 15 gusht

Me këtë shenjtore lidhet edhe një ngjarje me ditën kur ra tërmeti i vitit 1821. Popullsia zhvilloi një procesion nëpër rrugët e qytetit, duke mbajtur mbi shpinë simbolin e *Madonna delle Grazie*, *Madonna del Carmine*, *Madonna di Costantinopoli*, *Madona Adolorata*, ku për 15 ditë qëndruan në kishën famullitare, në shenjë falënderimi dhe solemne, pasi nuk pësuan dëme. Kalabria u godit nga dy tërmete shumë të fortë, njëri më 24 prill 1836 dhe tjetri, më 8 mars 1837.

Shkolla e parë në Spixana

Më 21 tetor 1848 u hap shkolla pranë “Ritiro del Carmine”, për edukimin dhe aftësimin e priftërinjve të varfër dhe studiuesve të rinj. Mësuesit e parë, të cilëve iu ishte besuar arsimi i të rinjve, ishin: Don Ferdinando Diodati, Don Giovanni Cucci, Don Michelangelo, Don Giuseppe Squillaci. Arbëreshët e Spixanës pohojnë se administratorët e asaj periudhe e drejtuan me ndershmëri dhe përgjegjësi të madhe.

Rruga “Roma”

Në këtë rrugë, tek ish-pallati i baronit Longa ndodhej e ashtuquajtura “*Magazine delle Corte*”, ku popullsia e Spixanës i paguante taksat princit Spinelli. Në këtë vend, në vitin 1700 u krijua instituti “Monte Frumentario”, njëfarë depozite e grurit për t’u përdorur në raste emergjence dhe fatkeqësie natyrore.

Fundi i shekullit XVIII

Në janar të vitit 1789, trupat e gjeneralit Championnet pushtuan Mbretërinë e Dy Sicilive, të mbretit Ferdinandi IV të Burbonëve. Si rezultat, u krijuan dy grupe: Jakobinët, që ishin filo-francezët dhe Sanfedisti, që ishin filo-burbonët. Në Spixana ekzistonin të dyja këto grupe.

Nga Spixano në “*Spezzano Albanese*”

Gjatë kohës së pushtimit të Mbretërisë së Dy Sicilive vdiq arkipeshkvi Don Antonio Fronzini. Vendin e tij e zuri Don Vincenzo Maria Cucci, i cili drejtonte këtë periudhë të vështirë. Në mars të vitit 1806, trupat franceze hynë në kishë. Dy vjet më vonë, pikërisht në vitin 1808, Giaochino Murat, mbret i Napolit, piketon rrugën shtetërore “S 19”, e cila përshkon Napolin me Kalabrinë dhe kështu, Spixanës i jepet status civil. Ajo shndërrohet në komunë dhe noteri A. Nociti, në vitin 1811, propozon emrin aktual: Spixano Albanese.

Vitet 1807-1810, infrastruktura rrugore

Në lidhje me Spixanën, shekulli XVIII shënoi hapjen nga qeveria e Gioacchino Murat-it, të arterieve të mëdha në Kozenzë, duke kaluar nëpër Spixana e më tej, në Napoli. Mendohet se në vitin 1807, ose në vitin 1810, Gioacchino Murati, mbreti i Napolit, shtroi këtë rrugë (ish-“SS 19”, ose “rruga nazionale” aktuale) që lidh Napolin me Reggio Calabria. Qyteti ishte i shtrirë dhe kjo rrugë favorizonte lidhjet me tregtinë kombëtare. Para se të hapej kjo rrugë, kalohej nga *Largo Garibaldi*.

Shekulli XVIII solli ndryshim radikal politik dhe social në të gjithë Italinë. Pas humbjes së Napoleonit në Vaterlo, sovranët e Europës u kthyen në shtetet e tyre. Burbonët u kthyen në Napoli dhe filluan të ndëshkojnë ata që kishin pasur aleancë me francezët. Priftërinjtë që u arrestuan në Spixana në atë kohë ishin: Don Fedele Marchianó, Don Francesco Tocci, Don Andrea Nemoianni, Don Giovanni Cucci.

Viti 1830, zbulimi i ujërave termale

Në pjesën më në veri ndodhet *Spezzano Terme*. Spixana njihet edhe për ujërat termale. Në vitin 1830 u zbulua një burim uji mineral, pranë brigjeve të Esaro-s, afër Spixanës, i cili prej asaj kohe e deri më sot është quajtur “ujë squfuri” për shkak të aromës së tij. Për këtë ujë, më 1851 u interesua një nga studiuesit dhe autoritetet komunale të Spixanës, në veçanti dr. Alessio Rovitti, profesor i kimisë në Universitetin e Napolit. Ai ekzaminoi ujin për

herë të parë dhe publikoi një raport të thelluar mbi rezultatet, të cilat konfirmonin praninë e squfurit në ujë.

Kryengritjet e karbonerisë

Më 1820-1821 filluan kryengritjet e karbonerisë, të cilat shkaktuan edhe shumë trazira në Spixana. Shumë anëtarë të atij sektit u arrestuan, ose u vunë nën mbikëqyrje të veçantë. Karbonarët më të njohur të vendit ishin: Don Luigi Nociti dhe Don Ferdinando Marini.

Viti 1848, viti i revolucionit

Ky shekull mbahet mend edhe për rëndësinë historike që pati “Revolucioni i ‘48-tës”, kur edhe qyteti i Spixanës ishte skenë e ngjarjeve të rëndësishme. Në Spixana, në urën “Intavolato”, rreth 4 mijë burra u përleshën, kalabrezë dhe sicilianë, të udhëhequr nga Ribotti kundër trupave të Busacca-s. Në fund të këtyre përplasjeve, gjeneral Ribotti, me fjalë të ngrohta dhe nderime, lavdëroi komunitetin e Spixanës.

Arbëreshët e Spixanës dhe Garibaldi

Fundi i regjimit të burbonëve erdhi falë ndërhyrjes së Xhuzepe Garibaldit (Giuseppe Garibaldi), një nga figurat më të rëndësishme të Risorxhimentos. Më 1860, Giuseppe Garibaldi, nën komandën e “Të Njëmijtëve”, mbërriti në Sicili në maj dhe u përplas me trupat burbone, duke sjellë përsëri një fitore vendimtare.

Garibaldi vazhdon për në Kalabri dhe kalon pranë Spixanës, më 1 shtator 1860, i shoqëruar me garibaldianët e tij. Lajmi u përhap nga Giuseppe Angelo Nociti, një oficer i rojës kombëtare. Populli arbëresh i Spixanës e priti me entuziazëm e me flamur trengjyrësh që valëvitej nga dritaret dhe ballkonet.

Gratë arbëreshe e pritën Garibaldin me “Vallen”, ku ai e vlerësoi me lavdi popullin arbëresh. Arkipeshku Don Paolo Nociti dhe të gjithë klerikët i dhanë haraç për të mbërritur në destinacion. Giuseppe Garibaldi, sapo mbërriti, u ftua të hipë në një kalë që ishte gati dhe eci në rrugën konsullore deri në dalje të vendit, i shoqëruar

nga turma që e përmyti, duke hedhur bajame me sheqer. Te dera e Pallatit të Chefalo-s, Galibardi zbriti nga kali dhe shkoi për të pushuar në një nga dhomat e tij për disa orë. Më pas, vazhdoi udhëtimin drejt Capua në Campania.

Kisha San Salvatore dhe garibaldinët

Kisha ngrihet në majë të kodrës me të njëjtin emër. Historianët vendas na japin pak të dhëna, për shkak të pozicionit strategjik. Më 1806 ishte skena e përplasjeve midis trupave franceze me ato proburbone dhe më 1860, u pushtua nga garibaldianët. Sot është një pikë trigonometrike ushtarake, stacioni sizmografik i Universitetit të Kalabrisë, pikë e antenave për telekomunikacionin dhe në pronësi të individëve privatë. Prifti i famullisë, Don Luigi Talarico, në përkushtim ndaj Spixanës dhe besimtarëve të tij vendosi një kryq të ndritshëm në kodrën e San Salvatore-s, për të sinjalizuar praninë e Spixanës dhe për t'u parë nga e gjithë krahina.

Urbanistika, pallatet dhe arkitektura e Spixanës

Pallatet në Spixanës mendohet të jenë ndërtuar rreth viteve 1600. Ndoshta për shkak të tërmeteve, nuk ekzistojnë pallate të viteve 1500.

Më 1821 ra një tërmet i fuqishëm. Shumë vende fqinje u dëmtuan, vetëm Spixana nuk pësoi dëme dhe këto pallate rezistuan.

Pallati Serpe, pikë tranziti për ndërrimin e kuajve

Nga viti 1860 deri më 1878, Spixana pati një periudhë lulëzimi. Meqenëse linja hekurudhore nuk ishte hapur, rruga që përshkonte qytetin ishte një pikë tranziti për ndërrimin e kuajve për të gjithë ata që shkonin nga Cosenza në Castrovillari. Kjo nxiti lindjen e hoteleve, restoranteve dhe kafeneve të mira, që ofronin pije freskuese për udhëtarët.

Viti 1928 shënon hapjen e ujërave termale

E gjitha filloi pas Luftës së Parë Botërore, kur “uji” tërhoqi njerëzit me probleme shëndetësore në vetvete. Në mesin e tyre ishte Vincenzo

Piro nga Aprigliano. Ky ujë e shëroi atë dhe e lidhi aq shumë me këtë vend, sa që vendosi të gjente një banjë, duke blerë tokën përpara dhe ku ndërtoi strukturën falë disa muratorësh të mirë.

Nga një kontroll i kryer, u gjetën katër lloje ujërash: Uji i *Grazie*-s; uji i *Sant'Antonio*-s; uji i Princit; uji i Kantinës. Secili prej këtyre ujërave kishte karakteristikat e veta terapeutike.

Në vitin 1930 në Spixana ndërtohet ujësjellësi. Edhe regjimi fashist e mori këtë problem seriozisht dhe siguroi fondet për të përfunduar punimet. Në vitin 1932, uji rridhte në të gjitha burimet e shesheve. Pas instalimit të energjisë elektrike më 1916, kjo ishte ngjarja e dytë me rëndësi për komunitetin.

Viti 1900 në Spixana

Shekulli filloi me një nga tragjeditë më të mëdha, që shënoi fatin e një brezi të tërë. Në Luftën e Parë Botërore, Spixana, si shumë vende të tjera italiane, në atë kohë vuante nga varfëria dhe paguante një tarifë shumë të lartë për sa u përket vdekjeve dhe dëmtimeve.

Në vitin 1916, në mes të luftës, Spixana u lidh me rrjetin e energjisë elektrike. Në vitin 1919 u shënuar një fazë tjetër e rëndësishme, hapja e Cassa Rurale-s, e themeluar në përpjekje për të ndihmuar familjet në gjendje më të vështirë ekonomike si pasojë e luftës. Midis themeluesve përmendim: Don Francesco Gullo, Francesco Gullo, Giuseppe Curti, Nicola De Rosis, Angelo Maria Chiurco, Antonio Pesce, Francesco Serra dhe Giuseppe Pesca.

Në këtë periudhë të rimëkëmbjes u hap edhe kinemaja (1919), e cila u quajt “Kinemasë Irene” dhe u themelua nga Gaetano Barbati dhe Angelo Maria Montone. Më 1927, Klubi Katolik e rihap atë duke i dhënë të njëjtin emër dhe duke përdorur të njëjtin projektor, por duke ndryshuar vendndodhjen, nga pallati Longo në Pallatin Nociti. Ky ishte një vit i rëndësishëm dhe me nisma të reja. Në fakt është edhe viti i hapjes së “*Rrethit të Filarmonisë dhe Kulturës*”.

Viti 1921

Vitet pas Luftës së Parë Botërore u karakterizuan jo vetëm nga përpjekja për rimëkëmbje ekonomike, por edhe nga ngjarje të reja

dhe të rëndësishme politike. Skenarë të rinj po propozoheshin në horizont dhe në veçanti, lindja e Partisë Fashiste Kombëtare. Në Spixana u krijua partia e parë fashiste më 1922 nga avokati Alessandro Marini, i cili u bë edhe sekretari politik i kësaj partie. Ndërsa avokati Angelo Forte, ish-marshall në kohën e luftës dhe Don Vincenzo, i quajtur si vëllai i “Medaljes së artë” u bënë udhëheqësit e fanellave të zeza famëkeqe. Njerëz të tjerë të rëndësishëm ishin Luca Marini, Alfonso Cucci dhe Agostino Ribecchi (asokohe student i veterinarisë).

Lufta e Dytë Botërore

Shekulli XX, për shkak të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, pati një sërë ngjarjesh të tmerrshme e të përgjakshme. Më 28 tetor të vitit 1940, në vitin e shpalljes së luftës me Greqinë, një grup ushtarësh të divizionit 226 të këmbëtorisë së Arezzo-s, ishte në Spixana për të luftuar dhe për të dhënë jetën për atdheun. Lajmi për zbarkimin e aleatëve dhe për nënshkrimin e armëpushimit erdhi si një rrufe në qiell të hapur dhe një psherëtimë lehtësimi dukej se vinte nga zemrat e pikëlluara të popullsisë. Kur lajmi u bë zyrtar, gjermanët ngritën kampin në tokat e *Fortit të Madh*, ku shumë shpejt u organizuan për t’u larguar nga veriu. Më 14 shtator të vitit 1943, tre makina të blinduara aleate mbërritën në Spixana, ndërsa banorët dolën në ballkonet e zbukuruar me batanije të kuqe, si një shenjë mirëseardhjeje. Vendi mbeti pa udhëheqës për disa ditë, derisa avokati Giovanni Rinaldi, i cili po hidhte themelet e Partisë Komuniste në Spixana, u emërua *Komisioner Prefekt*.

Tri rryma politike ishin në kontrast me atë të Rinaldit: Partia Fashiste, një nga familjet afër regjimit, Partia Socialiste dhe rryma e Demokratëve të Krishterë. Kjo e fundit nuk kishte karakter të spikatur, pasi seksioni krahinor i Kozencës mund të mburrej me avokatin nga Spixana. Ishte pikërisht Gennaro Cassiani, i cili mori detyrën e rëndë të organizimit të lëvizjes Demokracia e Krishterë më 1943.

Monumenti i të Rënëve

Është një bllok mermeri, në krye të të cilit është një luftëtar në bronz, i cili shpalos flamurin dhe në një plan më të ulët gjendet simboli i një gruaje. Mban mbishkrimin me vitin “1931” dhe i dedikohet Luftës së Parë Botërore, ku shumë arbëreshë ranë në luftë për të mbrojtur atdheun e dytë.

Territori i banuar me shqiptarë

Rruga “Albania”, në rrjedhën e sipërme të lagjes së Kostandinopojës, nuk mund të krahasohet me asnjë rrugë tjetër për vjetërsinë e saj në Spixana. Është më e vjetra, veçanërisht për rrugicat e ngushta, të cilat duket sikur thonë: “*Ne jemi këtu më të hershëm. Krijua dhe lamë gjurmë në këtë tokë që nuk ishte atdheu ynë, por u bë atdheu ynë i dytë*”. Në këto rrugica ndodhet edhe Pallati Cassiani. Këtu do të ndieni freskinë e verës, sepse ato janë të paarritshme nga rrezet e diellit, si dhe ngrohtësinë e dimrit, që depërton nga një shtëpi në tjetrën.

Dhe, nuk është rastësi që pikërisht këtu, rruga mbart emrin “Albania”. Këtu gjeni edhe emrin e rrugës “Ellena”, sot “Via Don Nicola Basta” dhe pastaj në të njëjtën zonë, rruga “Plebiscito”, ish-rruga “Pireo”, e ndryshuar me emrin “Vincenzo Luci”. Jo shumë larg është rruga “Dei Coronei”, e ndryshuar në rruga “Antonio Lupinaro”. Emrat e vendeve të arbëreshëve, të ardhur nga Morea, si dhe nga pjesë të tjera të Greqisë, i gjeni vetëm në këtë zonë “Santa Maria delle Grazie”.

Kostumi tradicional arbëresh

“Llambadhör” - Komuniteti arbëresh ngjall interes e admirim për kureshtarët dhe për turistët në lidhje me kostumin e tyre “gala”. Falë bukurisë, elegancës, pompozitetit e vështirësisë që kanë për t’u përgatitur secili prej elementeve të tij, kostumi merr vlera të çmuara në shumë aspekte. Ky interes për kostumin gala (që në shqip njihet me emrin “llambadhör”, rrjedh nga fakti se është një nga simbolet më përfaqësues të identitetit etnik e kulturor të arbëreshëve. Secili

prej elementeve përbërëse ka simbolikë të ndryshme, në varësi të komunitetit italo-shqiptar.

Poeti Xhuzepe Anxhelo Noçiti (Giuseppe Angelo Nociti) e përshkroi poetikisht në vargje bukurinë e Llambadhòrit e që atëherë, Lorenzo Bergamin-i, pasi e lexoi, hodhi idenë e paradës së veshjes arbëreshe “Llambadhori”. Kostumi arbëresh duhet të karakterizohet nga një kriter që, siç thonë arbëreshët, “*xhipuni ka t’jet i shkurtur ç’ka të buftonj mushqit prapa*”. Kostumi arbëresh i Spixanës ndodhet edhe në muzeun “Rende” të Spixanës. “Llambadhori” i Spixanës është i përbërë nga dy funde me pala të trasha: “*kamizolla*” dhe “*coha*”. “*Ljinja*” është këmishë e gjatë pambuku e bardhë me qafë “V”, e zbukuruar në anë me dantella të pasura, të bëra me fije mëndafshi të bardhë. Në supe mbahet xhipuni = (bodi), lamé shumë e shkurtër, i artë dhe i ngjashëm me ngjyrën e cohës, me copëza prej ari të copëtuara dhe me shirita të mëdhenj me gallona ari në pjesën e pasme të shpatullave. Mëngëzat kanë qëndisje të artë shumë të imët, që kujtojnë motive me lule, ose motive astrale. *Tuqilji* është pëlhurë e bardhë pambuku që ka funksionin e mbulimit të vijës së gjerë të qafës së linjës.

Veshja tjetër karakteristike është ajo e quajtur “*bajrak*”, e cila nuk e ka pasurinë e detajeve dhe aksesoreve të “*llambadhorit*”.

Veshja tradicionale, e ashtuquajtur “*pacchiana*”, është vazhdim i kostumit gala dhe është i përbërë nga një këmishë e gjatë pambuku e bardhë dhe një korse. Për më tepër, në skaj karakterizohet nga palosje të trasha dhe ka një platformë me motive lulesh, që bien në kontrast me ngjyrën e vetë skajit.

Kostumi i burrave

Veshja mashkullore është më pak e njohura, pasi ka humbur përdorimin e veshjes me shekuj. Sidoqoftë, shpesh proklamohet kostumi shqiptar, që mbetet shumë i rëndësishëm, nëse jo për pasurinë, të paktën për vlerën e tij historike e tradicionale.

Figura e Gjergj Kastrioti Skënderbeut në Spixana

Në sheshin “Republika”, si në çdo qytezë apo katund arbëresh, është busti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Arbëreshët janë të lidhur

edhe me një figurë tjetër të Kastriotëve, Irina Kastrioti, e cila u dha një ndihmë shumë të madhe arbëreshëve të krahinës së Kozencës.

Figura të shquara në Spixana:

Xhuzepe Anxhelo Noçiti (Giuseppe Angelo Nociti, 1832-1899). Ai lindi në Spixana më 1832. Studioi juridik në Napoli. Pas sulmit ndaj mbretit Ferdinand, Nociti ishte një person i përndjekur nga qeveria e burbonëve, kështu që iu desh të strehohej në Maltë. Pas kthimit në Itali gjatë ekspeditës së “të Njëmijtëve”, ai u regjistrua në mesin e vullnetarëve të Garibaldit. U emërua kapiten dhe gjatë betejës së Bezzeca-s u dallua për guximin e tij. U vlerësua me “Medaljen e artë” për merita në luftë.

Zotëronte një kulturë të gjerë. Ishte studiues i latinishtes dhe albanolog. Përfundoi studimet filologjike dhe ishte një shkrimtar me vlera për Spixanën. Krijoi shumë vepra, kryesisht me dorëshkrime. Shumë prej tyre humbën, ato që shpëtuan u ruajtën nga disa familje në Spixana. Më të njohurat prej veprave janë: “Ditari”, 1898 (në pronësi të *Bashkimit Kulturor Arbëresh*); “Përshkrimi historik i Spezzano Albanese”, në 1852, i pabotuar, (në pronësi të *Bashkimit Kulturor Arbëresh*); “Buletini nga Spezzanese”, i pabotuar, (në pronësi të *Bashkimit Kulturor Arbëresh*); “Arti Poetik i Horacit”, përkthim, Cosenza, 1878; “Orari i plotë i Komedisë Hyjnore”, Cosenza, 1894.

Më 1871, në muajin mars, Nociti i kushton një odë Don Paolo, nën gjurmët e rreshtave të “5 majit” të Manzoni. Me interes të veçantë është vëllimi i dorëshkrimit, i cili mban titullin “La Crusca Brezia”, ose “Fjalori i Dialektit Kalabrez” me etimologji të ndryshme të përpiluara nga Nociti - filluar më 1868. Është një studim krahasues i idiomës kalabreze, që integron dhe shpjegon termat e injoruar, ose të keqinterpretuar nga studiuesit e tjerë. Noçiti pati njohuri të frëngjishtes dhe të gjermanishtes, si dhe të gjuhëve klasike dhe të shqipës.

Në njëzet vitet e fundit të jetës, Noçiti iu përkushtua mbledhjes së tërë krijimtarisë poetike në vëllime dorëshkrimesh. Përmbledhja prej 27 vjershash lirike me titull “*Rëmenxa t’arbresha*” (“Rima

Shqiptare”), u hartua midis viteve 1858-1876. Qindra sonete, ode, satira, përktihme nga latinishtja, arie, vargje dhe kompozime. Më 1887 ai krijoi “Zibaldone poetike” e cila përbëhet nga koleksioni i poezive, që variojnë afërsisht nga 1848 deri më 1880.

Në një sonet “Kapitulli në vdekje të Ferdinand II të Burbon”, i vitit 1859, ai përshkruan atdhetarin Agesilao Milano. “Vall’e Bakut” (“Inno a Bacco”) është përmbledhja e katërt në shqip. Për më tepër, vëllimi përmban disa përktihme të këngëve të Montesquieu, një ode ndaj mikut dhe atdhetarit nga Sandemetrese Domenico Mauro, me të cilin ai ndau studimet e Dantes, dhe parimin e një tragjedie të frymëzuar nga Manzoni “Gertrude dhe Egidio”.

Në një vëllim tjetër të dorëshkrimit, nga 1893, janë mbledhur kompozime poetike të llojeve të ndryshme, nga vitet 1885 deri më 1897. Pjesa e parë mban titullin “Vargje të ndryshme”, ai gjithashtu përmban sonete dhe vargje të konceptuara dekada më herët si “Ditirambo mbi sëmundjen e rrushit”, nga viti 1854. Pjesa e dytë ndahet në tre libra, që mbajnë titullin “Rime nuove di G. A. Nociti”. Ekzistojnë kompozime patriotike që lartësojnë sovranët, ministrin Krispi, një “Ode të Italisë” dhe një tjetër me titullin “Himni në Romë”.

Ndjenjat e tij nacionaliste u shfaqën në sonetin “Për të vdekurit e Dogaliut në Afrikë”, nga prilli i vitit 1887. Ekziston edhe një poemë me titull, “Moj ti zëmër dhe moj ti mall”, që nxjerr në pah dhimbjet dhe dashuritë e tij. Me përjashtim të poemës “Orari e komedisë hyjnore”, botimet e tjera të tij kanë rënë në harresë.

Vinçens Luçi (Vincenzo Luci, 1826-1898). Luci lindi në Spixana dhe ishte një atdhetar i flaktë gjatë revolucionit të ‘48. Revolucioni i vitit 1848 pati jehonë të gjerë në Kalabri e në Spixana, ku burbonët shtypnin me dhunë. Spixanezët u drejtuan nga Vincenzo Luci dhe morën pjesë në trazirat e qershorit 1848. Më 22 qershor 1848, Spixana priti vullnetarët sicilianë që, së bashku, mposhtën xhandarët burbonë. Pas trazirave të vitit 1848, burbonët u rebeluan dhe ndodhën shumë reprezalje.

Më 1848, kriza ekonomike dhe përhapja në rritje e idealeve të

lirisë dhe pavarësisë, ishin shkak i trazirave që shpërthyen në shumë vende të Europës dhe gjithashtu në Itali. Vullnetarë kalabrezë, të bashkuar me një grup të madh në Spixana, zhvillojnë një përlëshje në urën “Intavolto”, të udhëhequr nga Vincenzo Luci, ku dalin fitimtarë mbi trupat burbone, që u detyruan të tërhiqeshin. Spixana ishte selia e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Kalabri-Sicili dhe një numër i madh i trupave banonin atje.

Kryetari, dr. Francesco Candreva, kërkoi një patrullë të armatosur të sigurt në këtë qytet, për të siguruar paqen publike. Në atë kohë u krijuan shoqatat sekrete të Italisë së re dhe u ngrit një seksion, në të cilin bënte pjesë edhe Vincenzo Luci. Aktiviteti i tij ishte i jashtëzakonshëm, kështu që Luci iu nënshtrua një persekutimi nga policia. Më 1850, ai u arrestua dhe u dënua me 25 vjet punë të detyruar, për të shërbyer në burgjet e quajtura “banjot Procida”. Më tetor 1852, mbreti Ferdinand erdhi në Kalabri dhe kaloi nëpër Spixana në një karrocë të hapur, i shoqëruar nga 10 mijë burra. Në ato ditë, një vëlla i Vincenzo Luci-t kishte vdekur dhe familja ishte në zi. Por nëna, D. Rakele Paqja Rakela, gjeti forcën të shkonte personalisht duke i rënë në këmbë mbretit e duke i kërkuar “hir” (falje) për djalin e mbyllur në burg.

Mbreti burbon, në njëfarë mënyre u prek dhe e uli dënimin në 12 vjet burg dhe i burgosuri u transportua në ishullin e Ventotene-s. Ai u lirua më 1859, pas vdekjes së mbretit burbon dhe luftës fitimtare kundër Austrisë. Vincenzo Luci u kthye dhe rifilloi veprimtarinë atdhetare. Në verën e vitit 1860, kur e gjithë Kalabria ishte çliruar nga Garibaldi, Vincenzo Luci, në krye të një batalioni të përbërë nga vullnetarë spixanezë mori pjesë në kompaninë e Garibaldit. Batalioni Luci u dallua në luftën që u zhvillua në Capua, më 1 tetor 1860. Luci u emërua kryetar i Gardës Kombëtare. Vetëm kur Garibaldi arriti në Kalabri, Luci mori pjesë me guxim në marshimin e “Të Njëmijtëve” dhe në Volturmo fitoi medaljen për trimëri ushtarake. Vdiq në Spixana, më 1898.

Ferdinand Gualione (Ferdinando Guaglianone, 1843-1927). Ai lindi më 1843 dhe vdiq në vitin 1927. Ishte prift, aktivist shoqëror

dhe poet. Shkroi disa vepra të rëndësishme: “Kujtime të një Konti Kalabrez Tommaso d’Aquino” (1872); “Poezi” (1874); “Rosalia” (1878), “Ligjërata në Muajin e Marisë”, 2 vëllime (1885), “Cari Dipter Memories” (1890), etj.

Ferdinand Kasiani (Ferdinando Cassiani, 1878-1935) ishte jurist dhe shkrimtar. Lindi në Spixana, më 1878 dhe vdiq në vitin 1935. Si i ri, ai bashkëpunoi me revista të shumta. Më 1897 themeloi “*L’Albania Letteraria*”. Shkroi një elegji në kujtim të vdekjes së Vincenzo Luci-t dhe një tjetër, në kujtim të Jeronim de Radës. Gjtashtu, shkroi një poezi të titulluar “Brezia” (1899) dhe dy vepra, që mbanin titullin “Spezzano Albanese, në traditat dhe historia e saj” (1929) dhe “Banorët e Spexanos në revolucionin italian” (1927) në bashkëpunim me Luigi Cucci-n.

Françesko Gulo (Don Francesco Gullo, 1886-1926). Lindi në vitin 1886 dhe vdiq në vitin 1926. Nga viti 1926 ishte kryepriфт i Spixanës. Ishte poet dhe prozator i një kulture të thellë, themelues i bankës së parë të vendit “*Cassa Rurale e Artigiana*”, më 1919. Falë tij, kisha e Madonna delle Grazie u shndërrua, më 1951, në një Shenjtërore.

Xhenaro Kasiani (Gennaro Cassiani, 1903-1978) lindi në Spixana, në vitin 1903. Ishte avokati kryesor i krimeve në Kozencë dhe, në të njëjtën kohë, u dallua si një ndër organizatorët më aktivë të Lëvizjes Kalabreze Katolike. Ishte i “përndjekur” dhe shpesh ishte paralajmëruar prej policisë për aktivitetin politik. Më 1942, organizoi grupimet e para klandestine të Demokracisë Kristiane në Cosentino. Një vit më pas, duke njohur aftësitë e tij politike dhe organizative, Alcide De Gasperi i besoi detyrën e krijimit të strukturës së Demokracisë së Re Kristiane të Kalabrisë. Pas tre muajve të rënies së regjimit fashist, DC-ja u organizua edhe në Kosenza. Në korrik të vitit 1944, Cassiani doli si një nga përfaqësuesit më të rinj të DC (Demokracisë Kristiane) në jug.

Zgjedhur në Asamblenë Kushtetuese më 1946, Cassiani ishte

nëndrejtor i Departamentit të Punës. Më 1948 u zgjodh deputet për rrethin Catanzaro-Cosenza-Reggio Calabria dhe u rizgjodh edhe në vitin 1953. U emërua ministër i Postave dhe i Telekomunikacionit në qeverinë e parë Fanfani, nga 1954 deri më 1959. Në vitin 1968, ai u zgjodh në Kolegjin Senatorial të Castrovillari-Paola dhe më 1972, ishte ministër i Marinës së Tregtisë në qeverinë e parë të kryesuar nga Giulio Andreotti.

Ai dha leksione të shumta dhe drejtoi revistën “Tribunali Calabresi” për 12 vjet. Ishte nënsekretar i Shtetit për Punë Publike më 1944, deputet dhe senator, Nënsekretari i Thesarit, ministri i Postave dhe Telekomunikacionit, ministri i Marinës Detare. Tridhjetë e tre ligje mbajnë emrin e tij. Ai ishte autor i studimeve monografike mbi problemet ekonomike dhe sociale të Jugut.

Shkrimet mbi Skënderbeun (përkujtimet në veçanti), shkrimet homazh mbi një mjeshtër të letërsisë shqiptare si Ernest Koliqi, paraqesin hapa themelore në atë përballje të vazhdueshme me kujtesën e rrënjëve, ose me kohën e historisë dhe të traditës të një populli, të cilit i është referuar gjithmonë. Duke iu përmbajtur pikërisht Koliqit, në një artikull të titulluar: “Portreti i shkrimtarit më të madh katolik të Lindjes”, u shfaq në numrin special të muajit qershor të revistës “Shejzat” (“Le Pleiadi”) kushtuar vdekjes së Koliqit, më 1975, Cassiani deklaroi: *“Ai më zbuloi misteret magjepsëse të botës Lindore, më shoqëroi me dorë përgjatë shpatit të malit shqiptar dhe më tregoi për ligjet e mbledhura nga Kodi i Malit, të veçantë dhe misterioz, duke më bërë të depërtoja aq thellë në një botë që për mua kishte ca përrallë. Dhe ndërkohë, ai më ekspozoi në shpirtin e tij, i cili nuk lejonte hollësi të holla, ose frikacakë të fshehur. Kështu që mbase mund të kuptojmë se si grimca e shpirtit tim përfundoi me të”*.

Francesko Kandrea (Francesco Candrea, 1813-1872), një personalitet deri më tani pak i njohur, i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në kulturën arbëreshe dhe periudhën e Risorxhimentos. Francesco Candrea lindi më 1813 nga Giovanni Andrea dhe Caterina Mortati. Prindërit u përkisnin familjeve të rangut të lartë

dhe të pasur. Nëna e tij ishte e bija e “mjekut ligjor”, Dr. Angelo Mortati (1771-1817).

Francesco Candreva, pasi mbaroi studimet fillore, vazhdoi studimet në Kolegjin Italo-Grek të “S. Adriano” në “S. Demetrio Corone” ku lidhi miqësi me Jeronim de Radën. Që të dy i vazhduan studimet në Napoli, kryeqyteti i Mbretërisë, në të cilin dy miqtë e rinj, Francesco dhe De Rada do të formohen politikisht dhe do të diplomohen përkatësisht për mjekësi dhe letërsi. Francesco, i cili u kthye në Spixana, në shkurt të vitit 1844 u martua me një vajzë të pasur, D. Rachele Tarsia. Nga kjo martesë lindën vajzat Letterina Saurella Amalia (1853) dhe Letizia Rosina Lucrezia (1856). Kandreva iu përkushtua profesionit të mjekut dhe veprimtarisë politike, duke marrë edhe funksionin e kryetarit të komunës. Në vitin 1847, kryetari Kandreva përmirësoi infrastrukturën e komunikacionit lokal të Spixanës.

Kandreva ishte edhe një letrar i zoti. Prof. Ahmet Kondo, në arkivat shtetërore të Tiranës, gjeti edhe letër-shkëmbimet me De Radën, ku thuhet se, Kandreva ishte përkthyesi i parë i “Milosaos”. Fatkeqësisht, për mungesë dokumentesh dhe për vdekjen e tij të parakohshme më 1872, nuk mund të themi asgjë tjetër për këtë figurë intelektuale të Spexanos, i cili diti të bashkojë profesionin e mjekut, administratorit të aftë, politikanit, luftëtarit, poetit dhe kritikut në një trajtë koherente.

Aleksandër Serra (Alessandro Serra, 1912 – 2000) lindi në Spixana, më 1912 dhe vdiq në Romë në vitin 2000. Ai ishte profesor dhe drejtor shkolle i lëndës së historisë, por dhe studiues i saj. Punoi në mbledhjen dhe ruajtjen e dokumenteve që lidhen me historinë dhe kulturën e italo-shqiptarëve. Bashkëpunoi me revistat “Shêjzat” dhe “Katundi Ynë”, si dhe me gazeta të shumta kombëtare si “L'Osservatore Romano”, “Il Tempo”, “Storia Illustrata”, “Calabria Letteraria”. Punimet më të famshme janë: Spezzano Albanese në ngjarjet historike të saj dhe të Italisë (1470-1945); Shqipëria 8 shtator '43 - 9 mars 1944; Refugjatët nga Shqipëria drejt Italisë mikpritëse; Shqipëria dhe Selia e Shenjtë në kohën e Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

Arkanxhelo Barbati (Arcangelo Barbati, 1925-1999) lindi në vitin 1886 dhe vdiq në vitin 1983. Barbati ishte poet dhe mbrojtës i një kulture të thellë, themelues i bankës së parë në vend “*Cassa Rurale e Artigiana*” në vitin 1919. Falë tij dhe Don Francesco Gullo-s, Kisha e Madonna delle Grazie u bë një shenjtërore më 1951.

Agostino Ribeko (ital. Agostino Ribeco, 1867-1928) lindi në Spixana më 1867 dhe vdiq më 1928. Ishte me profesion mjek, avokat dhe poet. Ai është pak i njohur, edhe pse ka pasur një veprimtari të dendur në fushën e kulturës dhe si një nga miqtë më të afërt të Jeronim De Radës, ai ishte anëtar i kongreseve gjuhësore të ndryshme shqiptare.

Ribeko ishte bashkëpunëtor i rregullt në një numër organesh shtypi të kohës dhe ka botuar një përmbledhje me vjersha të titulluar “Vjersha malli”, Sofje 1902, libër me poezi dashurie që, sipas traditës së romantizmit kombëtar të kohës, nuk përjashton vjersha dashurie për atdheun.

Një variant i kësaj përmbledhjeje i zgjeruar me disa vjersha fetare u shtyp në Kastrovilari, më 1917.

Ribeku është edhe autor i një vepre filologjike “*Vestutà della lingua albanese e sua importanza nella spiegazione del mondo anticho*”, Valle di Pompei. 1922 (Lashtësia e gjuhës shqipe dhe rëndësia e saj për shpjegimin e botës së lashtë), si dhe i një përkthimi italisht të pjesës melodramatike të Sami Frashërit “Besa”.

Xhovani Rinaldi (Giovanni Rinaldi, 1883–1960) lindi më 1883 në Napoli. Ishte një nga themeluesit e Partisë Komuniste të Italisë. U edukua me frymën atdhetare, shtëpia e tij priti vëllezërit Cairoli gjatë ekspeditës së “Të Njëmijtëve” në Spixana.

Në Romë, kur shkoi për të ndjekur universitetin në vitin 1903, në kohën e “L’Avanti” me regji nga Enrico Ferri, ai ndoqi seksionin socialist të Marmorelle dhe tavernën e “Karafili i Kuq”, një vend takimesh për studentë dhe punëtorë. Pas diplomimit, ai u kthye në Spixana ku themeloi “Klubin Popullor Arsimor”, i cili frekuentohej kryesisht nga zejtarë të etur për të shkolluar veten. Pastaj erdhën

luftat dhe krizat pas luftës. Giovanni Rinaldi themeloi seksionin socialist të Spixana në këtë periudhë.

Delegat në Kongresin e Milanos në vitin 1920, ai mori pjesë dhe dha dëshmitë e veta me kurajë. Me ardhjen e fashizmit ai u përgjigj me demonstrime të fuqishme proteste, me procesione masive. Në vitin 1943, selia e parë komuniste vendoset në shtëpinë e Rinaldit dhe një vit më vonë emërohet Komisioner në Komunë nga C.L.N. Rinaldi themelon kooperativën “La proletaria Libera”. Në zgjedhjet e vitit 1948, Fronti Popullor në Spixana pati një fitore dërrmuese. Në zgjedhjet e vitit 1952, Rinaldi u zgjodh kryetar i Spixanës.

Arbëreshët e Spixanës e nderojnë dhe lartësojnë figurën e Giovanni Rinaldi-t, udhëheqës dhe militant revolucionar i klasës punëtore, kundërshtar i pandreqshëm i privilegjeve dhe padrejtësive, kalorës i një ideali të madh të moralit të pastër. Vdiq në Spixana, më 1960.

Mario Karuzo (Mario Caruso), aktor. Ai ka spikatur në rolet e tij të pafundme, me personazhe herë të trishtuar, herë të gëzuar, herë me fytyrat e grave, e herë me fytyrat e burrave të shkatërruara nga lodhja dhe veset.

Luigji Amato (Luigi Amato, 1898-1961). Autor i portreteve për fëmijë, por edhe të portreteve të figurave historike, si ajo e mbretit Vittorio Emanuele III dhe gruas së tij Elena. Ai ekspozoi punimet e tij në pikturë nëpër sallonet e Parisit dhe në Galerinë Arlington në Londër, duke marrë vlerësim dhe sukses të jashtëzakonshëm.

Gracia Markiano (Grazia Marchianò) është profesoreshë e njohur ndërkombëtarisht për lëndën e *Estetikës*. Punoi në Universitetin e Siena-Arezzo. U shpall “Qytetare Nderi e Spixana-s” në dhjetor të vitit 2001. Ajo ishte gruaja e filozofit ezoterik Elemire Zolla, i cili vdiq më 29 maj 2002.

Të tjera figura të shquara të Spixanës:

- *Agostino Gualianone* (*Agostino Guaglianone*, 1825-1881), avokat, poet dhe autor i poezisë “*I briganti*”, ku rrëfohen ngjarjet e luftës së Kalabrisë në kohën e pushtimit francez.
- *Paskal D’Errico* (*Pasquale D’Errico*), prof. dr. i botanikës së pyjeve, inspektori i përgjithshëm i Korpusit Pyjor Shtetëror dhe shef i divizionit në Drejtorinë e Përgjithshme për Ekonominë e Maleve dhe Pyjeve.
- *Ambroxho Arabia* (*Ambrogio Arabia*, 1858-1934), avokat, i cili mbante detyrën e presidentit të Avokatisë dhe, nga viti 1913 deri në vitin 1917, ishte kryetar i komunës së Kozencës, president i *Curia of Cosenza*, magjistrat i parë dhe krijues i planit të parë rregullues të atij qyteti.
- *Antonio Lupinaro* (1873-1956), mjeshtër i artit, piktor e skulptor, autor i elementeve të shumta dekorative dhe veprave të vlefshme, duke përfshirë tri relievet në fasadën e kishave “*Madonna delle Grazie*”, “*San Pietro*”, “*Madonna del Buon Consiglio*” dhe “*San Paolo*”.
- *Cesare Annibale Musacchio* (1880-1967), portretist e karikaturist.
- *Cosma Damiano Signorelli* (1935-2007), neurokirurg, profesor i neurokirurgjisë në Universitetin e *Reggio Calabria*-s dhe në Fakultetin e Mjekësisë në Katanaxarë; drejtor i Shkollës së Specializimit në Neurokirurgji dhe ish-anëtar i Senatit Akademik të Universitetit të Katanaxarës.
- *Kozmo Basta* (*Cosmo Basta*, 1617-1649), fizikan, i cili shkroi “*Pyetjet e fizikës aristoteliane*”, për logjikën aristoteliane, metafizikën aristoteliane.
- *Cosmo Damiano Oriolo* (1881-1965), poet popullor.
- *Domenico Grisolia* (1906-1984), partizan e avokat, oficer artilerie dhe luftëtar në luftën çlirimtare. Ai ishte senator i Republikës Italiane dhe nënkryetar i komunës së Romës.
- *Don Carmine Tarsia*, Mjeshtër i Madh i shitjes së karbonit.
- *Don Ferdinando Guaglianone* (1799-1852), baron.
- *Don Ferdinando Guaglianone junior* (1843-1927), prift e

shkrimtar, redaktor i “*Civiltà Cattolica*” dhe autor i shumë lutjeve dhe meditimeve fetare. Më 1887-n u emërua rektor i Seminarit të *Rossano*-s dhe në vitin 1901, kryepriift i vendlindjes së tij, deri në fund të jetës së tij.

- **Don Nicolò Basta** (1610-1668), bir i priiftit Carlo Basta. Don Nicolò ishte priifti i fundit i famullisë greko-bizantine të Spixanës. Ai ra në duart e feudalëve Spinelli. U arrestua dhe u la në burg derisa vdiq. Basta tregon gjithashtu se me dhunë e mashtrim besimtarët e ritit grek detyroheshin të kalonin në atë latin.
- **Don Paolo Nociti** (1799-1871), kryepriift i Spixanës dhe shkrimtar. Ai ishte i apasionuar pas së drejtës kishtarë dhe civile. Gjithashtu, shkroi disa poema të bukura shqiptare me karakter didaktik dhe moralizues.
- **Don Raffaele Costantini** (1829-1901), i cili, pas një ndërhyrjeje të shkurtër në kishën e Santa Maria del Carmine, ku përfundoi punimet e restaurimit, shkoi në një mision në Amerikë.
- **Giovanni Laviola** (1915-2008), ish-dekan i shkollës së mesme të klasës së parë të Trebisacce-s dhe studiues i vlerësuar i Kalabrisë, në mënyrë të veçantë, për kulturën arbëreshe dhe pakicat gjuhësore. Aktiviteti i tij si shkrimtar e si historian për veprimtarinë e fugurave të tilla, si: *Pietro Camodeca dei Coronei* (1969), *Ferdinando Cassiani* (1971) dhe *Gennaro Placco* (1985) ishte mbi të gjitha, intensiv dhe i frytshëm. Ndër veprat e tij më të njohura përmendim: “Trebisacce”, “Histori - Kronikë – Kulturë”, si dhe “Dizionario biobibliografico degli italo-albanesi” (“Fjalor i madh biobibliografik i italo-shqiptarëve”).
- **Giovanni Manes** (1928-1994), mjek e poet.
- **Giuseppe Chimenti** (1952), artist, profesor i historisë së artit e piktor i njohur ndërkombëtarisht. I vetmi ekspozues i Kalabrisë, deri në vitin 2011, që nga themelimi i Bialës së Venecias. Në vitin 2003 ai ekspozoi në Nju Jork, në galerinë e famshme *Mikrocosm Hermetic* dhe në 2013-n në Berlin, në *Imagin Action, Galeria Vierraumladen*.
- **Giuseppe Marchianò** (1830-1902), i burgosur nga burbonët pas sulmit nga Agesilao Milano. Marchianò, më 1860-n; gëzoi

amnistinë dhe më pas punoi në departamentin e Drejtësisë në Settembrini. Ai frekuentoi qarqet liberalo-socialiste pranë pozicioneve të Bakuninit dhe ishte autor i një poezie të gjatë në gjuhën spixaneze “Kangjeli i zogut”.

- **Giuseppe Marchianò** (i riu) (1911-1988), piktor e shkrimtar.
- **Giuseppe Maria Nociti** (1792-1842), profesor i shkencave humane dhe i Retorikës. Fillimisht punoi në Monteleone (sot, Vibo Valentia) e më pas, në liceun e Salernos. Ai themeloi një shkollë private të letërsisë dhe të filozofisë në Napoli dhe ishte gjithashtu anëtar i shoqatës “Sebazia”, i principatës së shoqërisë ekonomike “Citra”, si dhe i akademive “Pontaniana” e “Cosentina”.
- **Giuseppe Montone** (1941) poet e shkrimtar.
- **Luca Paolo Marini** (1832-1906), atdhetar, artist.
- **Luigi Amato** (1898-1961), i dalluar si piktor i gjysmës së parë të viteve 1900, ka treguar talentin e tij artistik që në moshë shumë të re, ndërsa më pas, rreth viteve 1920, ai imponoi veten si një piktor portreti me brohoritje dhe njohje të madhe. Ai u transferua në Angli në moshën 40-vjeçare, ku u vlerësua shumë nga kritikët vendas, për shkak të vajrave të tij të rafinuar në kanavacë, që përshkruanin subjekte të shoqërisë së lartë britanike.
- **Maria Nociti**, punimet e të cilës shijohen ngadalë, kanë aromën e një freskie të paimitueshme; ato riprodhojnë skica të asaj jete arbëreshe dhe kjo na bën të mendojmë se gjaku i arbëreshit edhe këtu rron.
- **Orazio Rinaldi** (1830-1911), atdhetar, nënkryetar i Napolit, magjistrat e garibaldin.
- **Papa Nicola Nemojanni**, një nga priftërinjtë e parë të riteve greko-bizantine, që vinte nga njëra prej familjeve të lashta shqiptare, që mbërritën në Spixanë në fund të shekullit XVI.
- **Pino Chimenti** është një artist arbëresh me stil abstrakt. Në pikturën e tij, çdo pjesëz është një peizazh me pyje orendish, që marrin drejtimin për në ishujt e tij të harlisur si fluturza, por që ngjajnë më tepër me enigmat e një *puzzle*-i në formën e sferave që rrotullohen si një glob në hapësirë e në kohë. Veprat e piktorit

të mirënjohur të artit modern janë të ekspozuara në galeritë kryesore të artit, siç është ajo në Nju Jork.

- **Vincenzo Forte** (1886-1939), atdhetar, që luftoi në dy luftërat botërore dhe mori medaljen e artë për vlera ushtarake. Gjatë betejës së shtatë të *Isonzo-s*, vdes në frontin e *Carso-s* në 1916-n.
- **Vincenzo Grisolia** (1909-1975), poet, pedagog e autor i shumë eseve letrare;
- **Vincenzo Maria Cucci** (1778-1842), kryepriфт, i cili shkroi “*Le Cronache*”, ngjarje historike që ndodhën në Spixanë nga viti 1805 deri në vitin 1821.

Në fushën kulturore dhe artistike përmendim *Francesco Fusca*, *Giuseppe Montone*, *Annamaria Basile*, *Vincenzo Rimola* dhe të tjerë.

Mbiemrat me origjinë arbëreshe

Mbiemrat më të zakonshëm me origjinë shqiptare janë: *Barbati*, *Bellusci*, *Bomentre*, *Bruno*, *Camodeca*, *Candreva*, *Cucci*, *Diodati*, *Dorsa*, *Galicia*, *Gullo*, *Iannuzzi*, *Luci*, *Montone*, *Mortati*, *Nociti*, *Pesce*, *Pugliese*, *Vattimo*.

4.2. NGULIMET NË RAJONIN E KATANXAROS

Pas vdekjes së Skënderbeut (1468) dhe rënies së Krujës (1478), ndodhi rrjedha migratore më e rëndësishme nga Shqipëria për në Itali, duke bërë të lindin pothuajse të gjitha vendbanimet arbëreshe të Provincës së Katanaxaros (Catanzaro-s). Në disa prej tyre, ndër shekuj, identiteti shqiptar ka ardhur duke u zbehur, por në pjesën më të madhe gjuha shqipe, kultura, zakonet dhe traditat janë ruajtur deri në ditët e sotme, ndërsa riti bizantin është zhdukur.

Vendbanimet në provincën e Catanzaro-s janë si më poshtë: Amato (në gjuhën arbëreshe, *Amatu*); Andali (në gjuhën arbëreshe, *Andalli*); Arietta (në gjuhën arbëreshe, *Arjèta*); fraksioni i Petrona,

Carafe di Catanzaro (në gjuhën arbëreshe, *Garrafë*) dhe fshatrat e tij të Arenoso, Casalnuovo, Scaricatore dhe Usito; Curinga, Gizzeria (në gjuhën arbëreshe, *Jacarise*) dhe fraksionet e saj të Gizzeria Lido (në gjuhën arbëreshe, *Zolli*) dhe Mortilla (në gjuhën arbëreshe, *Mortilë*); Marcedusa (në gjuhën arbëreshe, *Marcedhuza*); Vena di Maida (në gjuhën arbëreshe, *Vena*) fraksioni i Maida, Zagarisë dhe Zangarona në gjuhën arbëreshe, *Xingarona*); fraksioni i Lamezia Terme.

4.2.1. Andali (Andalli)

Thuhet se *Andali* u themelua nga ushtarët e Demetrio Reres. Rrëfëhet se ishin pesë familje shqiptare, mysafirë të aragonezëve, dhe për nder të tyre, ato e quajtën *andali*. Më vonë emri i këtij katundi u transformua në Andalli. Fshati arbëresh ndodhet në pyllin më të madh në Itali, ku dallohet një plantacion plot me vreshta dhe ullishte. Fatkeqësisht, nuk ka ngelur asgjë nga jeta dhe kultura arbëreshe në këtë vend.



4.2.2. Marcedusa (Marcedhuza)



4.2.3. Zangarona (Xingarona)

Nuk ka të dhëna të sakta mbi krijimin e këtij fshati. Disa historianë shkruajnë se fshati u krijua nga komandanti Reres, i dërguar prej Gjergj Kastriotit Skënderbeut për t'i ardhur në ndihmë mbretit Alfons të Aragonës kundër rebelimit të baronëve, të cilët luftonin për fronin e Napolit. Kapedani Reres arriti të zbusë trazirat e feudalëve, mes të cilëve u dalluan Luigi Caracciolo, Conteni Nicastro dhe Baroni i Maides. Fitorja dekretoi sundimin e shqiptarëve mbi Xingarona.

Në më pak se një dekadë, arbëreshët krijuan një komunitet të ri, të përbërë nga zakonet dhe nga kultura etnike magjepsëse, për shkak të veshjeve të tyre plot jetë. Më vonë, pas vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe me pushtimin osman, erdhën emigrantë të tjerë nga territori i Shqipërisë e i Moresë dhe u vendosën në Zangarona, rreth 4 km larg Nicastro-s. Me rritjen e tyre në numër, vendasit i quajtën “ciganë”, sepse mënyra e të veshurit dhe të folurit ngjasonte me ciganët nga Ballkani. Në ditët e para, shqiptarët nuk u panë me sy të mirë nga popullsia vendase dhe termi i tyre “ciganë” bart konotacion poshtërues. Me kalimin e kohës, ky paragjykim u tejkalua dhe arbëreshët u integruan plotësisht në Xingarona.

Gjurmët arbëreshe

Qendra historike karakterizohet nga shtëpi që kanë ruajtur originalitetin, por nuk janë mirëmbajtur. Përgjatë rrugëve të ngushta, shihen ballkone të vogla. Normalisht shtëpitë kanë nga një, ose dy dhoma dhe pothuajse gjithmonë janë në dy nivele. Lloji i konstruksionit është një muraturë prej guri dhe llaçi. Në shtëpitë e fisnikëve shihen rifinitura dhe punime elegante të suvasë.

Gjuha arbëreshe në Zangarona

“Katundi arbëresh” i Zangaronës bën pjesë në krahinën e Catanzaro-s. Rrugët janë shkruar në dy gjuhë. Ata ruajnë kostumet tradicionale dhe këngët arbëreshe. Në vitet '70, në Zangarona flitej shqip. Arbëreshja e fundit, e cila fliste arbërisht, jetoi deri në vitin 1998. Është një komunitet shqiptar në të gjitha aspektet, pavarësisht faktit se gjuha e folur thuhet ka humbur.



Legjenda e zanave

Sipas legjendës, shpellat me mermer të zi ishin shtëpitë e zanave. Çdo ditë, kur dielli arrinte pikën më të lartë në qiell, krijesat mitologjike dilnin për të kërcyer dhe për të kënduar. Njerëzit kishin marrëdhënie të mira me to dhe për çdo festë, u rezervohej një vend nderi. Njëra prej tyre, një ditë humbi një unazë, që u gjet nga një fermer. Në vend që ta kthente, ky i fundit ia dha atë të dashurës së vet. Zanat nuk u ftuan në dasmë dhe si hakmarrje, parashikuan një katastrofë kundër fermerit. Të këqijat nuk do të marrin fund, derisa unaza t'i kthehet në gisht pronares së vërtetë.

Judeka e Zangaronës

Për shkak të një dekreti të vitit 1510, shumë familje hebreje u dëbuan nga Nicastro e duhej të shkonin diku tjetër. Një pjesë u zhvendosën djathtas në Zangarona. Ata i ndërtuan shtëpitë në rrjedhën e sipërme të Kishës së San Nicola-s, në zonën, që më vonë u quajt *Giudecca e Zangaronës*, e cila ende sot mban këtë emër.

Humbja e ritit bizantin në Zangarona

Në epokën e parë, shqiptarët ngritën kishën e tyre nën emrin “*Shën Nikolla*”, në ritin ortodoks grek, i cili zgjati deri në shekullin XVI. Në vitin 1601, banorët kaluan në ritin latin.

Kisha e San Nicola-s dhe riti ortodoks grek

Në pak më shumë se dhjetë vjet nga themelimi i qytetit, u ndërtua *Kisha e San Nicola di Bari*, me ritin ortodoks grek. Kisha e San Nicola-s ishte e zbukuruar me ikona të bukura dhe të çmuara. Në bodrumet e saj ishte një varrezë e gjerë nëntokësore, ku ishin varrosur të gjithë njerëzit e fshatit. Me ndihmën e popullatës, u ndërtua një manastir, pranë kishës dhe një bujtinë, ku strehoheshin lypësit dhe udhëtarët. Shatërvani i San Nicola-s në atë kohë, është ende sot i rrjedhshëm, por ka ujë jo të pijshëm. Poshtë kishës është sheshi i rrethuar nga ndërtesa të vogla, ku zhvillohej një panair çdo 15 ditë, që tërhiqte njerëz nga fshatrat përreth.

Mermeri i zi dhe Kisha e Shën Mërisë (Maria delle Grazie)

Për rindërtimin e saj filluan të mbledhin fonde, “derë më derë”. Ndërtimi zgjati më shumë se gjysmë shekulli dhe përfundoi në vitin 1616. Më 27 mars të vitit 1638 ndodhi një tërmet i fuqishëm, që shkaktoi më shumë se 500 të vdekur, dëmtoi disa shtëpi dhe në veçanti, Kishën antike të San Nicola-s. Pas një kohe të shkurtër, banorët e mbijetuar, rindërtuan dhe riparuan shtëpitë e shembura. Nën presionin e peshkopit të Nikastros, Zangaronesit adoptuan ritin latin në kishën e re kushtuar *Madonna delle Grazie*. Riti ortodoks grek u braktis. Librat e famullive nisin në vitin 1682. Mermeri, simboli i figurës së Shën Mërisë mban vitin 1614. Altari kryesor dhe kamarja janë bërë me mermer të zi, të gjetur në një gurore afër Zangaronës. Kisha kishte katër kambana në vitin 1833. E para ishte për njerëzit që e blenë atë në funksion të orës. Tre të tjerat i përkisnin kishës që u bekua nga Mons. Francesco Mandarani, më 20 shtator të vitit 1779. Kambana më e madhe u quajt S. Maria delle Grazia, ajo e mesme S. Barbara, e treta S. Nicola. Kisha e re, kushtuar *Madonna delle Grazie*, shtrihet në një hapësirë të gjelbër me dardha dhe fiq deti.

Zangarona sot

Sot, fshati mund të numërohet në mesin e atyre fshatrave “gjysmë fantazmë” me rreth 300 banorë. Popullohet nga një komunitet i moshuar, i cili thuhet tërësisht i ka braktisur rrënjët shqiptare. Lagjja nuk e ka humbur hijeshinë. Nëse bëni një shëtitje në rrugët e saj të ngushta me guralecë, me siguri, do të takoni buzëqeshjen e ëmbël dhe melankolike të ndonjë prej banorëve të moshuar.

Ndërsa shëtisni në rrugët e qytezës do të dëgjoni heshtjen që zotëron në të. Aroma e bukës së pjekur ndërthuret me aromën e luleve të freskëta.

Nëse sodisni perëndimin e diellit, do të kuptoni se Zangarona është një dritare mbi detin Tirren. Dardhat, fiqtë e detit apo limonët i paraprijnë një sfondi të mrekullueshëm.

4.2.4. Vena Di Maida (Vina)

Dikur quhej “Vinagreci”. Qyteti u themelua gjatë një vale migratore rreth vitit 1448, nga ushtarët shqiptarë që ndoqën Dhimitër Reresin (Demetrius Reres) në ndihmë të mbretit të Napolit, Alfonso I të Aragonës. Dhimitër Reres u emërua guvernator i *Kalabria Ulterior* për shërbimet që i bëri mbretit.

Më 4 maj 1831, me dekretin për krijimin e bashkive dhe zonave përreth, u formua komuna e Venës. Në datën 14 tetor 1839, Vena u caktua si pjesë në Komunën e Maidës. Sot ajo ka 1300 banorë. Emri i tanishëm i qytetit Vena, ndoshta buron nga karakteristikat gjeomorfologjike dhe kushtet strukturore të territorit, i cili është shumë poroz dhe i pasur me damarë.

Mbiemrat e Venës

Duke shfrytëzuar arkivin e famullisë së Vena-s, përkatësisht regjistrin e të vdekurve (libër mortuorum) 1758-1762, vëmë re se disa nga mbiemrat kryesorë në Vena janë: Brescia, Falvo, Bubba, Argirò, Comità, Barberio, Santo, Rania, Brailla, Petruzza, Dattilo, Bardascino, Fiocca, Brundo, Sword, Scalise, Pallaria, Scamardi, Daughter, Boca, Guzzo, Miceli, Colistra, Reto, Pallone Sciumbata, Grande, Carafe, Pascuzzo, Rizzuto, Pisano, Sergi, Torchia, Vivacqua, Angotti dhe Pititto. Ndërsa mbiemrat e familjeve, të marra nga regjistri i noterit Gaetano Petruzza di Vena



(1790-1795) janë: Barberio, Boca, Braila, Bubba, Hat, Comità, Conestabile, Del Giudice, Daughter, Fiocca, Grande, Guzzo, Lo Schiavo, Miceli, Olivadoti, Pallaria, Pallone, Peta, Petruzza, Pileggi, Reto, Santo, Saraceno, Scalise, Sciumbata, Shpata, Suppa, Torchia dhe Varano.

Mbiemrat më të zakonshëm me origjinë shqiptare janë: Boca, Bubba, Cristofaro, Derro, Figlia, Forte, Giglio, Graziano, Santo dhe Stranieri.

Kostumi i Venës

Veshjet paraqesin elemente dalluese të identitetit të një vendi. Veshja tradicionale që mbajnë gratë e Venës kishte elemente arkaike të veshjes së ilirëve, një popullsi autoktone e rajonit të Ballkanit.

Vena mbeti i vetmi komunitet arbëresh në provincën e Catanzaro-s, që zotëronte një zbulim të plotë të veshjes tradicionale gala të grave. Ajo u përdor nga gratë e vendit deri në fillim të viteve 1900.

Vena di Maida banohet ende sot nga arbëreshë. Riti bizantin ka humbur, por gjuha arbëreshe, një tipar thelbësor i pakicës etnike, është ruajtur deri diku. Zakonet tradicionale arbëreshe dhe kostumet e tyre të ngjashme me ato të Garrafës ruhen nga disa familje, edhe pse tani përdoren pak, janë ende të gjalla.

Kostumet, riti, traditat

Personalitete të ndryshme kulturore që përshkuan Venën midis viteve 1700 dhe 1800 u mahnitën nga gjuha, por mbi të gjitha nga zakonet, aq sa shkruan për to në udhëpërshkrimet e tyre. Në vijim, po paraqesim disa prej tyre.

Henry Swinburne, më 1777, flet për bukurinë e grave të Venës dhe shkëlqimin e veshjeve të tyre. “Kjo është pjesa më e ngushtë e Italisë (i referohet lumit Amato) dhe këtu rruga, nga Napoli përmes Puglia-s dhe Catanzaro-s, kalon nga deti Jon në detin Tirren. Ndërsa po përshkonim lumin Amato, takuam një grup arbëreshësh (grekë)

nga një fshat aty pranë. Veshjet e tyre ishin dukshëm të ndezura. Mbizotëronte ngjyra e verdhë dhe e kuqe. Gratë ishin shumë më tërheqëse, më shumë sesa shumica e grave të Kalabrisë”.¹¹⁹

E pasur me detaje është edhe historia e udhëpërshkrimeve të skocezit, *Craufurd Tait Ramage*, i cili në librin “*Calabria pittoresca e romantica*” i dedikon një kapitull më vete Venës, pikërisht në kapitullin nëntë, ai tregon për udhëtimin e vitit 1800 në këtë vend.

Ai përshkruan veshjet dhe vallet e Venës, por edhe dukuri të tjera që kishte vënë re: “Pas drekës propozova të largohem, por miku im mori ftesë për të vizituar fshatin Vena, vetëm disa kilometra nga Maida, e cila, më thanë, ishte një koloni shqiptare; [...]. Ne zbritëm përsëri në shtratin e lumit Lamato, pastaj u ngjitëm lart në kodër, në bregun e kundërt, ku ndodhej fshati Vena. Me t’u afruar në Venë nuk takuam një shpirt të gjallë. Banorët ishin të gjithë në kishë për të marrë pjesë në meshën e mbrëmjes. Aty pata një mundësi të mirë për të parë zakonet karakteristike të vendit dhe banorët. Kapela ishte e vogël dhe e mbushur me njerëz. Numri i grave ishte shumë më i madh se ai i burrave. Ato ishin aq të përkushtuara ndaj lutjeve, sa madje as prania e një të huaji nuk ua tërhiqte vëmendjen. Fytyrat e tyre kishin një formë më ovale sesa ato të grave italiane dhe me mollëza të zgjatura; për këtë tipar më kujtuan bashkatdhetaret e mia. Kishin bukuri të veçantë. Sjellja e tyre e thjeshtë dhe modeste ishte veçanërisht e këndshme. Veshjet e qëndisura ishin kryesisht në ngjyrë blu dhe vjollcë të ndritshme. Këta njerëz e dinin italishten në mënyrë të përkryer, por mes tyre flisnin shqip. Kam pasur vështirësi të mëdha të zbuloj nëse ato kanë përdorime dhe zakone të veçanta, sepse ata rrallë e kuptojnë se janë të ndryshëm nga të tjerët; Por pasi pyeta nëse ceremonitë që shoqëronin ritin e martesës ishin të ndryshme nga ato të zakonshmet, një prej të pranishmëve më tregoi zakonet e mëposhtëm: një koreografi që quhej “valle” duhet t’i paraprijë ceremonisë së dasmës. Gratë organizohen në një rreth, duke mbajtur duart dhe të paraprirë nga një flamur, vallëzojnë e

¹¹⁹ HENRY SWINBURNE, *Travels in the two Sicilies, in the years 1777, 1778, 1779, and 1780*, 2 voll., P. Elmsly, London 1783-1785.

këndojnë këngët luftarake të vendit të tyre, kur luftonin kundër osmanëve. Vallja vazhdonte kur nusja e re shoqërohet në shtëpi nga burri i saj. Dasma këtu festohej ende sipas ritit grek. Përgatiteshin dy kurora, njëra për dhëndrin dhe tjetra për nusen, dhe pasi bekoheshin ato vendoseshin në kokë dhe më pas, në jastëkët e shtratit martesor. Vallja e luftëtarit njihet ende si vallja shqiptare, ose “Lamico”.¹²⁰

Horace de Rilliet, në tetor të vitit 1852, përshkruan me përpikëri veshjen e grave në Vena, si dhe karakteristikat e veshjes së burrave: “Pas disa milje ecjeje, ne kalojmë lumin Lamato në një urë prej druri, Ura Calderaio. Në fund të saj është vendosur popullsia e qytetit të Venës, e grupuar në kodra dhe në shkëmbinj. Na mirëpresin me klithmat entuziaste të “Viv” mbreti ose “Viv’u re” ashtu siç e shqiptojnë në dialektin e tyre kalabrez. Kostumi i grave është shumë piktoresk. Ato vendosin mbi kokat e tyre një kapele të qëndisur me ar, forma e së cilës të kujton atë të rendit të ushtarëve tanë, që fiksohen nën mjekër me një vello të gjatë të bardhë, të hedhur mbi supë. Ari nuk është kursyer në qëndisje. Ndonjëherë, ato kanë këpucë, por janë të kënaqura t’i bartin në dorë ose t’i bashkëngjisin në rrip. Burrat kanë një kapelë me majë, që bie në njërën anë. Një xhakëtë të zezë të rrumbullakët prej kadifeje e një rrip të zi të gjerë prej lëkure, të zbukuruar me gozhda bronzi, kokat e të cilit formojnë vizatime. Rripi shtrëngohet në belin e pantallonave të shkurtra; çorape të bardha dhe sandale, ose këpucë të endura të lidhura në këmbë me rripa, ose litarë plotësojnë këtë kostum shumë piktoresk.”¹²¹

Kisha e Sant’Andrea

Në sheshin kryesor të fshatit është kisha e S. Andrea Apostolo, burimet historike të së cilës datojnë nga mesi i shekullit XVIII.

¹²⁰ Craufurd Tait Ramage, *Calabria pittoresca e romantica, Rubbettino*, 2014.

¹²¹ *Tournée in Calabria, Colonna mobile in Calabria nell’anno 1852, chirurgo aggregato al 13° Battaglione Cacciatori*, prefazione e traduzione italiana di Agostino Formica, Collana “Traduzioni di testi stranieri”, 2, Jason Editrice srl, Reggio Calabria 1991 (con la riproduzione di 203 illustrazioni originali a penna dello stesso De Rilliet)

Lajmet historike u ndalën në episodin e vizitës së Vikarit Apostolik të dioqezës së Nicastro, Paolino Pace, që daton nga viti 1769.

Kisha Bellacava

Në distancë rreth 2 kilometra nga qyteti, qëndron *Sanctuary of Madonna di Bellacava*, në mes të ullishtave. Kisha është përdorur për festat e Shën Mërisë dhe kryesisht për festën në nder të saj. Brenda saj është një kamare në pjesën e poshtme të absidës, ku gjendet një kopje e statujës së Shën Mërisë.

4.2.5. Gizzeria (Jazeria)

Në rrafshinën Lametina, 630 metra mbi nivelin e detit, në anët e pjerrëta të një kodre përgjatë rrjedhave *Casale* dhe *Mezza Serra*, ndodhet një fshat me origjinë arbëreshe, *Jazeria* (Gizzeria). Kjo përfshin një zonë të bregdetit, që shtrihet përreth 10 kilometra, ku ndodhet edhe fshati i Gizzeria Lido (në gjuhën arbëreshe: *Zalli*



dhe *Jacarisë*). Fraksione të tjera të Gizzeria-s janë: Bastioni di Malta, Campoienzo, Destra, Lenzi, Maiolino, Mortilla (në gjuhën arbëreshe: *Mortilë*), Prisa, Scaramella.

Sipas disa studiuesve, rrënjët e Gizzeria-s datojnë nga një koloni e lashtë greke, e quajtur “Izzario” ose “Izzaria”, ku edhe vetë arbëreshët e quajnë *Jacaria*, e cila gjendet në provincën e Catanzaro-s. Rreth viteve 1000, në këtë territor mendohet të ketë qenë një manastir bizantin kushtuar San Nicola-s, i cili mbijetoi derisa u pushtua nga Roberto il Guiscardo dhe normanët e tij. Pushtimi u dha fund bizantinëve të San Nicola-s dhe shënoi fillimin e latinizimit.

Një dokument tregon se banorët “shqiptarë” kanë jetuar në fermën e “Jzaria”, që nga viti 1491 dhe nga ai moment kanë rimarrë emrin *Jezeria*. Rreth vitit 1504, Gizzeria u ripopullua nga 65 familje shqiptare. Më 1521 “Jzaria” numëronte 72 zjarre, ndërsa më 1544, 64 zjarre. Më 1595 ishin 124 zjarre; më 1669 ishin 113 zjarre dhe më 1732, 120 zjarre. Në vitin 1802 numëroheshin 800 zjarre. Giuseppe Maria Alfano, më 1823, shkruan për Gizzeria se banohej nga shqiptarë të rritit latin dhe kishte një popullsi prej 846 banorësh.

Më 1510, ata u detyruan të braktisin ritin bizantin. Ardhja e disa familjeve nga zona të Kalabrisë, të shkatërruara nga tërmetet e vitit 1638 dhe 1783, përveç shkëmbimeve tregtare, marrëdhënieve dhe martesave me njerëzit e vendeve fqinje, ndryshoi dukshëm stilin e jetës së popullatës shqiptare, e cila çoi në zhdukjen progresive të gjuhës origjinale.

Kryetari i parë i bashkisë së “Jzaria” quhej Luca Greco, ndërsa riti fetar u festua nga prifti Domenico Crapuczano dhe nga meshtari Nicola Pacera.

Ndër mbiemrat e familjeve gjejmë Crapuczano, Pacera dhe Caraze, që nuk hasen në komunitetet e tjera arbëreshe. Disa vjet më vonë, disa familje shqiptare mbërritën në *Gizzeria*, gjithsej 53 persona. Shtëpitë e fermës shënuan një rritje të lehtë të popullsisë në një kohë të shkurtër, duke arritur në rreth 245 banorë më 1561. Popullsia u shtua gjithnjë e më shumë pas mbërritjes së shqiptarëve të tjerë në vitet në vijim.¹²²

¹²² Sipas të dhënave të përcjella nga Alfonsio Trapuzzano, *Storia di Gizzeria*, ed. Junior, Napoli, 1977, f. 201.

Muzeu i famullisë

Ndër pasuritë e shenjta të artit, të ruajtura në muzeun e famullisë, përmendim një fustan antik, i qëndisur me ar, në fund të shekullit XIX dhe një jelek të kuq, me qëndisje ari, nga shekulli XIX. Ka edhe dëshmi interesante nga bota fshatare. Në muze ruhen edhe disa gjetje nga manastiri bizantin i San Nicola-s. Dashurinë dhe interesimin për rrënjët e ndeshim edhe në veprën e Camillo Trapuzzano-s, “Veshja femërore në Gizzeria”,¹²³ e cila ofron një analizë historike mbi evolucionin e kostumit të Gizzeria-s me kalimin e kohës, duke iu referuar traditës shqiptare, kryesisht të humbur.

4.2.6. Caraffa (Garrafa)

Carrafa, ose *Garrafë* në gjuhën arbëreshe është një qytet i vogël dhe i veçantë, i banuar sot nga rreth 2 mijë banorë. Ndodhet në shtrirjen më të ngushtë dhe veçanërisht të bukur të Kalabrisë, midis Catanzaro-s dhe Lamezia Terme-s. Në ditë të kthjellëta mund të shihen të dy detet, Joni dhe Tirreni.

Historiku

Quhej “*Arenos*”, fshati mesjetar, i cili u themelua nga familja *Caraffa*, nga feudalët të cilët rridhnin prej një dege të familjes *Caracciolo* që e mbajtën atë deri në shekullin XVI. Thuhet se ky katund u popullua si fillim nga stradiotë shqiptarë, rreth vitit 1448. Popullsia e Garrafës u shtua më tepër kur mbërritën nga Shqipëria, si dhe nga Morea, shqiptarët gjatë pushtimit osman. Në një kohë të shkurtër, të gjithë banorët u përqendruan në kreshtën e rrafshët, e cila ende përfaqëson qendrën historike të vendit, e shkatërruar në një pjesë të madhe nga tërmeti i tmerrshëm i vitit 1783. Vetëm më 1807, me rënien e regjimit feudal dhe nën sundimin francez, fshati i vogël arriti të sigurojë autonomi, duke u bërë komunë më vete e zonës së Tiriolo. Me bashkimin e Italisë, Garrafa u kthye në rrethin e Catanzaro-s dhe më 1867, mori emrin që mban sot.

¹²³ Camillo Trapuzzano, *Il costume femminile di Gizzeria*, Stampa Sud, *Lamezia Terme*, 2005, f. 68.



Gjtonia e Garrafës

Në Garrafë, lidhja midis strukturës sociale dhe urbane është shumë afër, rruga dhe gjtonia, lagjja, përbëjnë vazhdimin natyror të shtëpisë dhe familjes jashtë. Në veçanti, gjtonia, karakterizohet nga një shesh, ku secila shtëpi ka hyrjen e vet ose të paktën një dritare, në mënyrë që të lejojë zërin apo shikimin me fqinjët. Gratë, për shembull, mbledheshin bashkë për të kryer disa punë të përditshme: qepnin, qëndisnin, por edhe shkëmbenin mendime me njëra-tjetrën. Gjtonët (fqinjët) ndihmonin njëri-tjetrin si në kryerjen e veprimtarive prodhuese, edhe në rast nevojash, duke shkëmbyer edhe produkte ushqimore, siç ishte huazimi i bukës. Gjtonia arbëreshe e Garrafës është një vend veçanërisht i rëndësishëm për komunitetin. Në gjtoni ruhej kultura gojore, muzika, përrallat, vjershat etj. Këtu ekziston ende një thënie e lashtë popullore: *“Gjtoni është më shumë se një i afërm”*.

Urbanistika arbëreshe

Qendra historike e Garrafës ruan ende një strukturë urbane, tipike për një qytet rural, me rrugë të ngushta dhe të paarritshme. Në rrugica do të gjeni struktura të thjeshta që ruajnë tipologjinë origjinale, shtëpi shumë të ulëta nën nivelin e rrugës, apartamente me një ose dy dhoma, në gur të mbështetur nga një përzierje rërash dhe kashte (bresda), pa suva, me taban në tokë të rrahur dhe çati terakote, e mbështetur nga trarët prej druri.

Shatërvani Kostandini

Kostandini, me siguri e merr emrin nga kënga e lashtë shqiptare “*Kostandini dhe Doruntina*” (“Besa e Kostandinit”). Shatërvani është shumë i vjetër dhe ndodhet në një luginë të vogël. U shërbente banorëve në jug të vendit dhe gjithë atyre që shkonin për të punuar në zonën e Garrafës.

Kroi i madh – Shatërvani i madh ishte në fillim të “*Fosso Foto*” (mjaft afër qendrës së banuar). Nuk kishte strukturë murature, por vetëm një mur mbajtës me dy dalje uji. Pozicioni i tij ishte veçanërisht i përshtatshëm për të gjithë njerëzit që duhej të shkonin në fshat. Fatkeqësisht, ai u shkatërrua nga përmbytjet e viteve ‘70.

Kroareli – Burim i vogël. Është shatërvani i vjetër i kujtimeve, jo vetëm sepse përfaqëson një nga burimet më të lashta dhe më të rëndësishme, por edhe për implikimet e historike dhe shoqërore që lidhen me të. Përbëhet nga dy struktura betoni. Struktura e parë përfshin një korpus të vogël me ujë të pijshëm me dy burime. Ajo u rinovua dhe u përmirësua në vitet 1930. Struktura e dytë përfshin një shtëpi të mbuluar me lantaneri, e ndërtuar në vitin 1920.

Biveri – Ky është shatërvani më përfaqësues nga pikëpamja artistike. U ndërtua midis viteve 1909 dhe 1911. Ndodhet në një pikë strategjike, në kalimin e një rruge që lejonte popullsinë të shkonte në fshat. Megjithëse jo shumë i pasur me ujë, kryente funksionin e rëndësishëm rural të pirjes falë dy rezervave të mëdha.

Ngjela – “Vendi i pritjes / pushimit”, ai është e një burim për përdorim kryesisht rural. Ndodhet në malin Arenoso, përgjatë rrugës rajonale Caraffa-Corace.

Nxhika – Kuptimi i mundshëm është “*Unë e ngop veten me lakmi për ujë*” nga “*ngihem*”. Është një burim shumë i pasur me ujë, ku gratë shkonin për të larë lirin në gur. Më pas, gjatë punimeve të rindërtimit të vitit 1929, u bë një shatërvan i bukur dhe i madh me gjashtë priza uji, një tendë të gjatë betoni të përforcuar dhe gjashtë vaska të mëdha shpëlarjeje. Aktualisht, për shkak të përmytjes në vitin 1970, është zhytur plotësisht në rërë.

Pallatet feudale

Pallati Comi, ndodhet në sheshin “Skënderbej”. Ndërtimi nisi në fillim të viteve 1800 dhe përfundoi pas rreth 50 vjetësh. Tridhjetë vjet nga fillimi, prona ishte ende pa suva. Në dy nivele, ndërtesa ka një portal kryesor prej guri, me një hark të rrumbullakët dhe ballkone prej hekuri të punuar. Ndërtesa në formë katrore është madhëshore. Dyert prej druri mbizotërojnë ende nga trarët e harkuar. Rrjetat prej hekuri të farkëtuar, me përpunim dhe hedhje ndërlihdhëse krijojnë një harmoni vizuale për çdo dritare të vetme dhe një ekuilibër të këndshëm, për të gjithë strukturën. Karakteristikat e atriumit të hapur dhe shkallët prej guri e bëjnë tërheqëse brendësinë e ndërtesës.

Pallati Peta, i atribuohet shekullit XIX. Ndërtesa ka një plan drejtkëndësh dhe është rregulluar në dy nivele. E ndërtuar me vullnetin e mjekut Antonio Peta, ajo u përdor jo vetëm si shtëpi, por edhe si klinikë mjekësore. Doktorit e kreu profesionin për mbi 50 vjet. Djali i tij ndoqi gjurmët e të atit, prandaj një pjesë e ndërtesës u përdor për më shumë se një shekull si klinikë mjekësore. Kati i sipërm arrihet përmes një shkalle të madhe të dyfishtë L, me kangjella prej hekuri të punuar, pas kalimit nëpër një derë druri imponuese dhe një atriumi në formë katrore, dysHEMEJA e të cilit është e mbuluar me gurë të gjallë. Prona ka edhe një dhomë tjetër, që

përdorej si një mulli vaji dhe me praninë e një sterne për mbledhjen e ujërave të shiut. Menjëherë pas luftës, një zejtar zbukuroi pjesën e brendshme të ndërtesës. Fasada e jashtme nuk u suvatua kurrë dhe përbërja e saj është ende e dukshme (janë të pranishëm kryesisht gurë të vegjël, të prerë me një formë të rrumbullakosur dhe gurë ranorë). Ky material guri, pas renditjes së kujdesshme, u përdor si një element dekorativ.

Pallati Miceli, ndodhet në një shesh të vogël, ngjitur me sheshin kryesor të qytetit. Gennaro Miceli e ndërtoi këtë ndërtesë rreth vitit 1930. Ajo është e strukturuar në dy nivele. Një pjesë e katit përdhes është përdorur gjithnjë si depo, një pjesë si vend i partisë politike, ndërsa kati i sipërm ishte për banim. Fasadat e ndërtesës janë suvatuar, ndërsa në pjesën e përparme është e lexueshme qartë një strukturë e mjeshtërisë antike, ku ekziston prania e një harku me tulla.

Figura të shquara

Girolamo Comi, hero i lindur në Garrafë më 1856. Vdiq më 1887 gjatë betejës së Dogali në Afrikë.

Luigi Comi, lindi në Garrafë më 1838 dhe vdiq më 1916.

Dr. Antonio Peta, lindi më 1864 dhe vdiq në vitin 1951. Ai ishte mjek për shumë vite.

Don Michele Pucci, lindi në Garrafë më 1814 dhe vdiq më 1898. U shgurua prift.

Don Lorenzo Monteleone, lindi në Garrafë më 1826 dhe vdiq më 1890. Është autori i 60 poezive dhe një vëllimi mbi edukimin e të rinjve.

Don Gennaro Sciumbata, lindi në Garrafë më 1753 dhe vdiq më 1849. Ai rindërtoi kishën e re pas tërmetit të vitit 1783. La një ditar dorëshkrimesh me rreth 250 faqe.

4.3. NGULIMET ARBËRESHE NË RAJONIN E KROTONES

Në provincën e Crotone-s janë këto vendbanime: Belvedere di Spinello dhe fshatrat e tij Malpezza dhe Monte Spinello; Carfizzi (në gjuhën arbëreshe: *Karfici*); Casabona dhe fshati i saj Zinga; Pallagorio (në gjuhën arbëreshe: *Puhëriu*), San Nicola dell'Alto (në gjuhën arbëreshe: *Shën Kolli*).

4.3.1. Carfizzi (Karfici)

Ndodhet në një kodër të bukur, 450 metra mbi nivelin e detit dhe ka një pamje piktoreske. Është qytezë arbëreshe, e cila ruan shumë mirë gjuhën dhe traditat. Popullsia përbëhet prej rreth 1500 banorësh. Kjo popullsi, si në të gjitha qytetet e jugut të Italisë, po shpopullohet.

Historia e Karficit

Pronat e Karficit në shekullin XV u takonin çifligjeve Gioannotto dhe më pas, Enrico Morano. Në fund të këtij shekulli, territori u popullua nga arbëreshët e sotëm. Në fillim të shekullit XVI, përkatësisht më 1507, feudi i Santa Venere konfirmohet nga mbreti katolik *Luca Antonio Morano i Catanzaro-s*, i cili e zotëronte atë së bashku me territoret e Trivio, Carfide (Salface) dhe Crisma. Carfide, njihej edhe si Crisma Scalfizzi ose Scalfize. Në këtë territor, numri i banorëve kishte arritur 80 shqiptarë, dy herë më shumë se në gjysmën e dytë të shekullit, kur jetonin në kasolle. Shumë familje shqiptare i ndërtonin një pjesë të shtëpive të varfra me kashtë, për



t'i shpëtuar taksës mbretërore. Ata fillonin e ndërtonin, pasi bëhej numërimi i ndërtesave.

Karfici është quajtur kështu nga *Carfidi*, i cili përthithi dy fshatrat e tjerë. Deri në vitin 1563 mbeti çiflig i familjes Morano, tashmë pronar i pronës së Santa Venera. Më 1630, iu shit familjes Sersale dhe i kaloi De Filippis (1648), pastaj Pisciotta (1687) dhe më vonë, familjes Moccia, e cila më 1698 fitoi titullin e Dukës. Më 1767, ata ia shitën familjes Malena, e cila fitoi kështu titullin e *Markezit* dhe mbeti deri në heqjen e feudalizmit (1806).

Në vitin 1807 iu nënshtrua Qeverisë së Strongoli-t dhe më 1811, u bë pjesë e fraksionit të San Nicola dell'Alto. Më 1816, ajo kaloi nga krahina e Cosenza-s në atë të Catanzaro-s, me dëshirën e burbonëve. Nga 1904, qendra u shkëput nga S. Nicola dell'Alto dhe u formua një komunë autonome.

Riti bizantin

Gjatë peshkopatës së Antonio Ricciulli (1632 - 1638) riti grek ishte ende i gjallë. Ndryshimi i ritualit dhe përpjekja për të latinizuar emrin e famullisë do të ndodhë gjatë peshkopatës së Vitaliano Marescano (1661-1667).

Karfici sot

Në qendër ndodhet sheshi qendror, të cilin arbëreshët e Karficit e quajnë “Rahji”, një pikë takimi ku ata mblidheshin që nga koha e Skënderbeut dhe ishte salloni i jetës së tyre sociale. Edhe këtu ndihet arkitektura e gjitonisë, kostumet e bukura, apo kultura e miteve dhe tregimet që u referohen së kaluarës paraosmane shqiptare. Ato vërtiten rreth historisë legjendare të Skënderbeut, fatit të shqiptarëve, ku rapsoditë e trashëguara brez pas brezi, të recituara në përrallat stërgjyshore të të moshuarve, janë ende të gjalla. Karakteristikë janë rrugicat e vogla të shtruara me gurë, por edhe shtëpitë e stilit rural, jashtë borgut, të cilat ruajnë siluetat e mullinjve të vjetër.

Si të gjithë fshatrat arbëreshë që u ngjajnë folezave të shqiponjës, edhe Karfici shtrihet në kodër dhe ka një panoramë që të lë pa frymë. Traditë e popullsisë vendase është tezgjahu i batanijeve

shumëngjyrëshe dhe modeleve orientale. E rëndësishme është edhe argjendaria tradicionale. Gjithashtu, festa patronale për nder të Santa Veneranda zhvillohet më 27 korrik.

Figura të shquara rilindëse të Karficit

- **Karmine Abate (Carmine Abbate)**- Lindi në katundin arbëresh Karfici me 24 tetor të vitit 1954. E nisi krijimtarinë me përmbledhje vjershash e tregimesh, por u njoh si romancier me romanet: “Il ballo tondo”, 1991 (“Vallja rrethore”), “Il muro dei muri”, 1993 (“Muri i mureve”), “Tra due mari” 2002 (“Midis dy deteve”) dhe “La festa del ritorno”, 2004 (“Festa e kthimit”). Është i njohur në Itali dhe i vlerësuar nga kritika me çmime letrare. Romanet e tij dallohen për stilin e veçantë, për karaktere të spikatura, për rrëfimin realist, me nota gazmore, dhe sidomos për paraqitjen e mendësisë dhe të jetës arbëreshe (romanet “La moto di Scanderbeg” – “Motoçikleta e Skënderbeut”, 1999, dhe “Il mosaico del tempo grande” – “Mozaiku i motit të madh”, 2006). Disa nga veprat e tij janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera.
- **Francesco e Martino Fazio**, të cilët kontribuan në lëvizjen e Risorxhimentos në Itali.

4.3.2. San Nicola Dell’alto (Shën Kolli)

Fshati ndodhet rreth 4 km larg Karficit. *San Nicola dell’Alto* u themelua në shekullin XV nga shqiptarët që migruan dhe u vendosën midis malit San Michele dhe malit Pizzuto, një zonë e pabanuar, por duke iu përshtatur relievit malor, i ngjashëm me atë të “vendit amë”. Arbëreshët u vendosën në këto zona për dy arsye. E para, të ishin sa më larg armikut dhe e dyta, sa më larg sëmundjes së malaries, që kishte pushtuar në ato vite Italinë e Jugut.

E quajten *Shën Nikolla*, për devotshmërinë e treguar ndaj peshkopit *Mira*, ku rrëfëhet që më ‘807 pas erës së re, anija me



trupin e shenjtorit Nikolla, nga Lycia e Barit ndaloi për një kohë të gjatë në brigjet e Shqipërisë.

Familjet e para të vendosura në Shën Koll janë: Basta, Bisulca, Canossa, Camisecra, Carida, Carvisci, Clamaro.

Fshati e ka humbur ritin bizantin, por Pashkët i feston njëlloj si në fshatrat arbëreshë ku vazhdon ky rit, gjë që tregon se gjurmët ende ekzistojnë.

Është si traditë që kostumin, të cilin e përdorin në martesë e ruajnë për ta veshur edhe kur të vdesin. Kjo gjë ka bërë që kostumet arbëreshe të zhduken, sepse të rinjtë kanë pak interes në punimin dhe qëndisjen e tyre.

Gjuha shqipe flitet ende në pjesën më të madhe të këtij katundi arbëresh. Ajo është futur kohët e fundit edhe në shkolla. Një nga fjalët popullore që kanë trashëguar këta arbëreshë dhe që vijon të përdoret, është: “*Tundet muri dhe jo burri*”.

4.3.3. Pallagorio (Puhëriu)

Territori i *Pallagorio-s*, ose siç i thonë arbëreshët *Puhëriu*, kufizohet me *komunat Carfizzi, Casabona, San Nicola dell'Alto, Umbriatico* dhe *Verzino* dhe me komunën *Campana*. Ndodhet në zonën kodrinore të Presilanit në veri të Markezatës së Crotone-s. Qyteti gjarpëron përgjatë dy rrjedhave që derdhen në lumin Vitravo.

Puhëriu shtrihet në një pllajë të zhytur në gjelbërimin e kodrave të Crotone-s, të kultivuara me perime dhe vreshta. Puhëriu është një qytet i njohur për pozicionin gjeografik. Ngrihet në zonën kodrinore të Presilanit, në veri të Marchesato-s dhe është një vendbanim arbëresh, i cili ruan gjuhën, zakonet dhe traditat e veta, por jo më ritin bizantin-grek. Kishat e tij janë të pasura me orendi të shenjta. Në kishën e Karminës, e ndërtuar në shekullin XVII, ka një statujë prej druri të Madonës, e realizuar me një mjeshtëri të përkryer, që daton nga shekulli XVIII. Në anën veriore të kishës qëndron një kullë zile shumë e bukur, e ndërtuar rreth vitit 1900, e pajisur me dy kambana të madhësive të ndryshme. Jo shumë larg saj janë disa zona arkeologjike, përkatësisht në fraksionet: Cona, Rosicelle, Coracciti, S. Antonio dhe Furci.

Lashtësia e Pallagorio-s (Puhëriut)

Arbëreshët u vendosën në këto zona, me qytetërim helen, të quajtura *Magna Greci*, ku duket qartë prejardhja helenike (Palaios - Chorion: fshat i vjetër); toponimia helene e së gjithë zonës përreth (Patamò, Coracciti, Gardea, Cona etj.) dhe mbetjet përkatëse arkeologjike (amfora, orendi, varre) të gjetura në rrethet e Gardea, Coracciti, Prastinella, Suvero, S. Antonio, Monte Giudicissi, Cona. Në pjesën juglindore të qendrës së banuar ekziston një zonë, e cila mban emrin e lashtë të “Scea”, ose “Porta Scea”.

Mbërritja e arbëreshëve në Puhëri

Arbëreshët emigruan në Puhëri në shekullin XV. Në kohërat mesjetare, fshati i përqendruar në rrethet e “Valle” dhe “Cucinaro” merr emrin e “San Giovanni në Palagorio”.

Që nga mesi i shekullit XVI, fshati ka qenë subjekt i një migrimi intensiv dhe të vazhdueshëm të njerëzve nga vendet e rrafshnaltës Silano, të cilët janë tërhequr nga pjelloria e tokës dhe klima e butë. Qyteti atëherë ishte pronë e familjes Spinelli deri në fund të shekullit XVII, pastaj kaloi te fisnikët Rovegno, të cilët e mbajtën atë deri në fund të shekullit XVIII.

Taksat e peshkopëve mbi popullsinë arbëreshe

Peshkopi i Umbriatico, Pietro Bastone (1611-1621), në raportin e tij më 2 dhjetor 1618, shkruan për herë të parë mbi formimin e një ferme të re në San Giovanni de Palagorio. Në territorin e këtij qyteti të Umbriatico, në vendin e quajtur *San Giovanne de Palagorio* midis banorëve të vendit, shqiptarët kanë ndërtuar njëzet kasolle dhe jetojnë atje me tërë familjet e tyre. Të vendosur në dioqezën e Umbriatico-s, subjekti “në spiritualibus” do të duhet të paguajë pesëmbëdhjetë dynymë grurë për të katërtat kishës. Fshatarët e vendosur në këto territore gjithsesi mund të mbanin një farë autonomie fetare, derisa peshkopi i Umbriatico-s të vendoste për kandidatin, i cili do të mbahej me shpenzimet e fshatarëve.

Popullsia arbëreshe e Puhëriut

Vitet 1662

Në fakt, popullsia arbëreshe u zvogëlua prej murtajës nga 700, në vetëm 600 banorë, më 1666. Më 1682, Carlo Antonio Spinelli i shiti pronat e S. Giovanni di Pallagorio, Giovanni Giuseppe Rovgnos, i



cili më 1696 mori titullin e princit të Puhëriut. Dy vjet më vonë, më 1684, popullsia u rrit në rreth 1000 banorë (me gjashtë priftërinj dhe katër klerikë). Më 1688, u zvogëlua sërish në 700 banorë dhe do të numërojë rreth 800 banorë në fund të shekullit XVII.

Jeta e mjeruar e arbëreshëve të Puhëriut, në shekullin XVII

Popullsia përbëhej kryesisht nga punëtorë dhe kolonizues të varfër, pronarë në rastet më fatlume të një vreshti, të cilët merrnin me qira tokën dhe huazonin grurin për t'i rritur ato, duke hyrë në borxh të pronarët e tokave. Në fund të shekullit XVII, Puhëriu si tokë në dioqezën e Umbriatico, kishte rreth 500 banorë.

Gjendet midis fshatit Zinga, 6 milje larg, dhe Umbriatico, i cili ka rënë në mjerim të madh. Banorët e tij, shqiptarët, ende ruajnë gjuhën dhe zakonet. Ata ruajnë me fanatizëm të drejtat dhe traditat. Përpjekjet e peshkopëve të Umbriatico për të imponuar priftërinj jolokalë pa lidhje me kulturën e tyre janë ende të kota.

Më 26 korrik 1882, Puhëriu dhe fshatra të tjerë të Crotone-s, banoreshin nga shqiptarë

Në mesin e shekullit XVIII, Puhëriu kishte 1000 banorë dhe ruajti kishën e S. Giovanni Battista, atë të Karminës dhe një të re, të thjeshtë, kushtuar S. Filomena. Kisha e S. Filomena është e vetmja që ka një datë të saktë. Një pllakë brenda dëshmon se punimet përfunduan në vitin 1859. Kisha ka edhe legjendën e saj. Ajo u ngrit me vullnetin e bashkëshortëve Vitetta të cilët, duke mos pasur fëmijë dhe trashëgimtarë, ia dhanë të gjitha pronat kishës së S. Filomenës. Në pallatin e tyre thuhej se kishte ndodhur një mrekulli. Statuja e S. Filomena, në mungesë të të zotërve Vitetta, i është përgjigjur një gruaje që kërkonte të zonjën e shtëpisë duke thënë: “*Mami nuk është këtu*”. Pas ngjarjes së çuditshme u ngrit kisha e San Filomena, dhe të gjitha pronat e Vitetta (përfshirë pallatin e tyre, ku tashmë është vendosur komuna) ia dhanë Kishës.

Peshkopi i Crotone-s, Luigi Maria Lembo (1860–1883) më 26 korrik 1882 zbuloi shqiptarë të shumtë nga vendet fqinje, burra dhe gra që shëtisnin në qytetin e Crotone-s. Arbëreshët vinin nga San

Nicola di Alto, Carfizzi, Pallagorio, Santa Sofia, Marcedusa, Andali etj., për të festuar në kishën e ritit bizantin, festën e tyre. Ata kishin rënë dakord për të përmbushur premtimet dhe për të shenjtëruar ditën e 26 Korrikut, kushtuar nënës së Zotit.

Riti bizantin

Arbëreshët që u vendosën në këtë territor ishin në lëvizje të vazhdueshme, nga një vend në tjetrin, ku përveç disa gjërave të përditshme që mund të zotëronin, duke punuar në tokat e të tjerëve, nuk kishin asgjë tjetër. Shtëpitë e para ishin prej kashte dhe vështirësive për të mbijetuar iu shtua edhe ajo riti, sepse iu imponohej riti latin. Popullsia arbëreshe u rebelua kundër imponimit të ritit latin dhe kërkuan një prift grek.

Megjithatë, kalimit nga riti grek në atë latin do të ndodhte. Madje, gjatë peshkopatës së Bartolomeo Criono (1639 - 1647), menjëherë pas emërimit, ai dëshmonte se, kishte tre shtëpi në fermat shqiptare në dioqezën e tij, të cilat jetonin sipas ritit grek, megjithatë priftërinjtë e tyre, sipas tij, ishin aq injorantë sa nuk dinin as ritet e as funksionet e tyre në administrimin e sakramenteve dhe shqiptarët ndiqnin ritin latin.

Santa Maria de Monte Carmelo

Madonna del Carmine kishte mbërritur në Puhëri e tërhequr me një qerre direkt nga Shqipëria dhe ishte ndalur pikërisht në sheshin ku qëndron kisha aktuale. Kisha ka një murriz. Një hark i madh me majë akute, i mbështetur nga dy kolona të barabarta me ato të altarit, përcakton zonën e presbiterisë. Mbi muret anësore në të djathtë, altari kushtuar Santa Ritës. Në të majtë, altari kushtuar San Anna.

Në altarin qendror ndodhet një statujë druri e Madonna del Carmine, shekulli XIX, e cila simbolizon Shën Mërinë. Altari u ndërtua nga familja Lorecchio me mbishkrimin: “Me përkushtim të Bernardo Lorecchio 1858”. Statuja përfaqëson Madonna del Monte Carmelo, e quajtur ndryshe “del Carmine”.

Legjenda e Statujës së Santa Maria de Monte Carmelo

Një legjendë e lashtë tregon se si ka zbritur statuja. Banorët e një qyteti aty pranë kishin porositur një statujë të Madonna del Carmine. Disa burra e transportuan atë në një karrocë të tërhequr nga dy qe. Karroca u ndal papritmas. Qetë sikur ishin gozhduar me thonjtë e tyre në tokë, duke u ngjitur dhe duke mos lëvizur. Burrat që shoqëronin statujën filluan t'u binin kafshëve, qeve, por ato nuk lëviznin. U parashtrua hipoteza se, mbase, Madonna del Carmine dëshironte të qëndronte pikërisht atje, në atë vend ku ishte ndalur. Statuja e bukur ishte vendosur përkohësisht në një kamare e ndërtuar vetëm për të.

Kisha ndodhet në një drejtim “strategjik”, me vështrim nga deti, kështu që Shën Mëria mund t'i mbrojë bijtë shqiptarë, të shpërndarë kudo nëpër botë, si dhe vendin amë “Shqipërinë e dashur”.

Kambana

Kambana meriton vëmendje të veçantë, duke u ngritur me madhështi në anën veriore të kishës. Të kujton në strukturë kullën e *Palazzo Vecchio* në Firenze. Është ndërtuar me tulla, rreth vitit 1900, me dëshirën e Lorecchio me bashkëpunimin e njerëzve të Puhëriut.

Arbëreshët në formë klandestine mbanin ritin bizantin

Gjatë peshkopatës së Agostino De Angelis (1667–1681) edhe pse në pamje të parë riti grek nuk praktikohet më, në realitet mbijetoi në shprehjet e shumta të jetës së përditshme, aq shumë sa peshkopi, shpesh, duhet të ndërhynte duke vendosur dënime shumë të rënda.

Kisha e S. Antonio në Gradea

Ka shumë të ngjarë që Kisha e S. Antonio në Gradea të jetë mbetje e një manastiri bizantin, ose, më saktë, abacia e kishës antike. Ruan një afresk që shfaq një Madonna dhe fëmijë, të shekullit XVII. Të martën pas Pashkëve, festohet Shën Antoni me bekimin e fshatit. Në këtë ditë, shumë banorë bëjnë piknik në fshat. Ky është kthyer në një rit.

Kisha e San Cristoforo

Kisha e San Cristoforo, rrëzë malit Pomello, ndodhet jashtë qytetit, në një rrugë që ngjitet lart në mal. Kisha ka madhësi modeste dhe fasadë të thjeshtë. Kjo karakteristikë e ndërthurur me mikpritjen e banorëve, e bëjnë vërtet të bukur qëndrimin në këtë tokë. Komuna ka origjinë shqiptare, megjithëse pak gjurmë kanë mbetur, përveç asaj të gjuhës së folur pjesën e parë të Umbriatico, më 1834 ajo fitoi autonomi administrative. Si një fshat i Umbriatico, ajo iu nënshtrua sundimit të Spinellis, Princit të Cariati, i cili më 1682 e shiti atë në Rovegna.

Më 1799, nën emrin e San Giovanni di Palagorio, ajo u njoh si autonome dhe u përfshi në Kantonin e Corigliano-s. Më pas, borbonët, më 1816, e kalojnë atë në provincën e Catanzaro-s.

Kisha Madonna del Carmine

Imazhi i shenjtë i fatoes së lashtë të Puhëriut u shkatërrua, por raportohet se ajo u gjet në vendin ku ndodhet tani kisha rurale e Sant'Anna del Bosco. Në të vërtetë, ata që nuk mund të shkojnë, ngjiten në kodrat nga të cilat mund të shihet kisha e vetmuar e Sant'Anna. Këto janë kodrat e Presilana në veri të Marchesate, në provincën e Crotone-s. Sot, Puhëriu ruan gjuhën, zakonet dhe traditat e veta, por jo më ritin greko-bizantin.

Figura të shquara të Puhëriut

Anselmo Lorekio (Anselmo Lorecchio, 1843-1924) ka qenë botues dhe figurë e shquar publike arbëreshe. Lindi në Puhëri (*Pallagorio*), në krahinën kalabreze të Crotone-s, më 3 nëntor të vitit 1843 dhe studioi për drejtësi në Universitetin e Napolit. Pak kohë më pas, iu kushtua studimit të kulturës shqiptare dhe mori pjesë aktive në lëvizjet politike e kulturore të kohës. Drejtoi punimet e Kongresit të Dytë Albanologjik në Ungër (*Lungro*) më 1897 dhe u zgjodh president i “Societa Nazionale Albanese” (Shoqata Kombëtare Shqiptare).

Tre vjet më vonë, “Societa Nazionale Albanese” u transferua me seli në Romë. Anselmio Lorekio më 1899, ftoi në Romë dy prej personaliteteve të njohura të Rilindjes Kombëtare, Mehmet Frashërin dhe Dervish Himën, të cilëve u besoi gazetën dygjuhëshe, shqip e frëngjisht “Zen’i Shqipënisë” (Echo d’Albania).

Botoi me shpenzimet e veta vepra të shumë shkrimtarëve arbëreshë. Edhe vetë ishte shkrimtar e poet. Përmendet si autor i “*La questione albanese*”, Katanaxaro, 1898; (“Çështja shqiptare”), “*Il pensiero politico albanese in rapporto agli interessi italiani*”, Romë, 1904 (“Mendimi politik shqiptar në lidhje me interesat italiane”), si dhe artikuj të shumtë. Megjithatë, u bë i njohur për botimin e periodikut të shquar arbëresh “*La Nazione albanese*” (“Kombi shqiptar”), revistë e përdyjavshme politike e kulturore, e cila zgjati nga 1897 e derisa vdiq më 22 mars 1924. Ndër veprat që publiku arbëresh zbuloi nëpërmjet “*La Nazione albanese*” përmendim “Histori e Skënderbeut” e Marin Barletit, manifestin politik “*Shqipëria - ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë*”, e Sami Frashërit, dhe poemën osianike “*Kënga e sprasme e Balës*” e Gavril Darës etj.

Ofelia Xhudiçisi (Ofelia Giudicissi), lindi në Puhëri, më 11 maj 1934. Rridhte nga një familje modeste dhe ishte e shtata prej dhjetë fëmijëve (babai i saj, Carmine, ishte një mësues në shkollë fillore dhe nëna, Domenica, shtëpiake). U martua në prill 1959, pas një fejeje të shkurtër me Antonio Curci, nga i cili mori edhe mbiemrin e dytë. Lindën dy fëmijë, Francesco, më 1960 dhe Pietro, më 1965. Në vitin 1964, botoi veprën e parë letrare, “Pallagorio”, një libër me poezi, i frymëzuar plotësisht nga bashkëqytetarët e saj, me të cilët u lidh fort. Ajo ishte gjithashtu shumë aktive në fushën e arkeologjisë, veçanërisht në hapësirën e vendit ku lindi, ku kreu edhe shumë kërkime për etimologjinë e saktë të emrit të qytetit. Në periudhën kur po shkruante librin e fundit, me titull “Momentet e një Profili Jugor”, një sëmundje e rëndë e goditi dhe vdiq më 13 shtator 1981 në moshën 47 vjeçe. Vepra u botua pas vdekjes, nga i shoqi dhe dy fëmijët, në vitin 1996.

Kapitulli V: Ngulimet arbëreshe në bazilikatë

Në Basilikata janë 5 fshatra arbëreshe: *San Costantino*, *San Paolo*, *Barile*, *Ginestra*, *Mascito*. Prej tyre, vetëm *San Kostantino* e *San Paolo* e ruajtën ritin bizantin, ndërsa të tjerët u kthyen në ritin latin. Riti bizantin u praktikua në Mascito deri në vitin 1628. Më pas, dominikani Diodato Scaglia i Melfi-t, përmes urdhrit episkopal e ndaloi këtë rit në bashkësitë arbëreshe shqipfolëse të Mascito-s dhe Ginestra-s dhe shumë më vonë, edhe në Barile.

5.1. San Costantino Albanese (Shën Kostandini)

Qyteti i vogël futet në Parkun Kombëtar Pollino dhe gjendet në luginën “Vale Sarmiento”.

Historia e *San Costantino Albanese*, ose siçi thonë vetë arbëreshët *Shën Kostandini* është e lidhur me emigrimet e popujve arbëreshë, në veçanti të refugjatëve koronei, nga Morea (Greqi), rreth vitit 1534. Numëroheshin rreth 1040 shqiptarë të ritit bizantin. Taksa më e vjetër është ajo e vitit 1595, e cila ishte për 58 zjarre. Në vitin 1648 u tatua për 109 zjarre dhe më 1669 për 55 zjarre.

Karakteristikat e urbanistikës i percepton sapo futesh në qendrën e fshatit, ku përballësh me gjurmët arbëreshe, dje edhe sot. Rrugicat

mbajnë emrat shqip. Stili i gjtonisë edhe këtu është mbizotërues. Sot kryesisht kanë mbetur arbëreshë të moshës së tretë, sepse të rinjtë, për arsye studimi ose pune janë detyruar të largohen. Kjo është një specifikë e dhimbshme në pikëpamje të traditës e të identitetit, por ajo pakicë që ka mbetur përpiqen ta ruajtë me të gjitha format identitetin e vet kombëtar.

Urbanistika

Qendra e banuar, në një pjerrësi jo shumë të theksuar, është e mbyllur nga dy rrjedhje të vogla në pjesën që shkon drejt Sarmentos. Pjesa më e vjetër, është e ndarë në pjesën e lartë (katundi alartaz), banoret e së cilës quhen “lastu lasht” dhe pjesën e poshtme (katundi ahimaz), që shtrihet në gjatësi nga veriperëndimi në juglindje. Dy pikat ekstreme kufizohen nga dy kisha të vogla: ajo e pjesës së sipërme, kushtuar “Madonna delle Grazie”, e cila ekziston edhe sot dhe “Madonna della Katistea”, e cila u shkatërrua tridhjetë vjet më parë për t’u bërë një rrugë.

Rruga kushtuar Gjergj Katriotit Skënderbeut (nxellikata) fillon nga kisha e vogël e Madonna delle Grazie, përshkon tërë fshatin e gdhendur me portale të bukura, zbukurohet me murale dhe pastaj zgjerohet në sheshin kryesor, i cili mbikëqyr kishën nënë kushtuar shenjtoreve Konstandinit dhe Elenës. Duke shkuar më tej në perëndim, gjendet, gjysmë e fshehur midis lisave dhe ullinjve, Santuari Madonna della Stella, mbrojtëse e qytetit; ky shenjtëror përbën zemrën fetare të komunitetit të San Costantino-s.

Shën Mëria e Yllit (ilit) (Santa Maria della Stella)

Jo larg nga zona e banuar, mund të vizitoni shenjtëroren e *Santa Maria della Stella*, e ndërtuar në shekullin XVII në një ndërtesë paraekzistuese bizantine të shekullit X-XI. Ajo përbëhet nga kube tipike me një çati të shkallëzuar, që mbështetet në një cilindër katror. Ajo zhytet plotësisht në mes të qiellit blu dhe ullishtës jeshile. Kisha është e zbukuruar me afreske të shekullit të shtatëmbëdhjetë, që i atribuohen Belisario Correnzio.

Gjuha shqipe ende gjallon

Arbëreshët janë akoma shumë të lidhur me gjuhën shqipe, ritin, traditat bizantin, zakonet dhe traditat (sidomos në ritualin e martesës dhe në atë të varrimit). Edhe pas pesë shekujsh, këtu mund të dëgjoni sërish gjuhën arbëreshe.

Pashka

Ndër ritet më të rëndësishme fetare është Pashka. *Të Shtunën e Shenjtë*, perdet e zeza janë hequr nga dritaret e kishës dhe kambanat janë ngritur për të shpallur Ringjalljen. Pas mesnatës, në shumë vende, gratë shkojnë në një shatërvan jashtë vendit për ritualin e “vjedhjes së ujit”. Të folurit ndalohej gjatë rrugës. Ky rit kujton skenën e grave të devotshme, të përshkruara nga Ungjilli që ecin në heshtje, në mënyrë që të mos zbulohen nga ushtarët romakë. Simbolikisht, ekziston një marrëdhënie midis fajit, i cili u përket të gjithë njerëzve që kryqëzuan Krishtin dhe heshtjen. Uji do të ndikojë në katarsin çlirues dhe kthimi është i lidhur me ringjalljen e Krishtit. Funkcioni i agimit zhvillohet të dielën në mëngjes: sakristani, brenda kishës, interpreton djallin dhe përpiqet të parandalojë hyrjen në tempullin e priftit, i cili pasi troket vazhdimisht futet me ëmbëlsi duke kënduar këngë.

Karnavale 2020

Fjala “ Karnavale vjen nga fjala latine *carne* - mish dhe *vale*, që ka kuptimin të hamë mish në këtë ditë, se pastaj do agjërohet për 40 ditë. Kisha latine ka dy dite karnavale, ndërsa kisha bizantine vetëm një ditë.

Riti “Kùkù kùkù” në San Costantino Albanese

Në San Costantino Albanese kur liturgjia parashikon lindjen e Jezusit, në ditën e 25 dhjetorit, nga ana e burrave fillonte klithma e “*kukù kukù*”, e shoqëruar nga tingulli i karramunxas (zamponja), “fishketi dhe rrishinjoli” (bilbilat kalamore).

Çfarë kuptimi kanë pasthirmat “*Kùkù kuku*”? Ky rit quhet ndryshe “epifenomen e zgavrave të shpirtit” dhe janë emocione të

qytetërimeve e të popujve të hershëm, siç është edhe populli arbëror, ku përmes kësaj pasthirrme shprehnin gëzimin, apo hidhërimin si në rastin e lindjes së Jezusit (ky rit është i zakonshëm në komunitetin arbëresh San Kostandino Albanese dhe San Paolo Albanese.

Himunea (hime)

Në këtë fshat, *Himunea* simbolizon kulturën dhe teknikën që lidhet me kultivimin e grurit dhe është objekt i një kulti, i cili përveçse përfaqëson fundin e një cikli sezonal, përfaqëson edhe mbijetesën e vetë komunitetit dhe vazhdimësinë e jetës. Shoqërohet me një rit të posaçëm, ku vjelësit imitojnë korrjen në një valle, në të cilën u paraprihet forcave të mbinatyrshme të natyrës, që në të njëjtën kohë, është përfaqësim didaktik i lëvizjes efektive për të korrur frutat.

Një manifestim karakteristik, me rastin e festës së San Rokos, është edhe ai i transportit të “grenjës” (tufë veshësh të grurit), të bartur mbi supe gjatë procesionit, në fund të së cilës grupe të rinjsh dhe të moshuarish, të veshur me kostume tradicionale performojnë në vallëzimin tipik të quajtur “*falcetto*”.

Natyra dhe parqet

Fshati karakteristik i San Costantino Albaneses është pjesë e Parkut Kombëtar Pollino, në territorin e Bazilikatës dhe të Kalabrise. Ky park ka 192,000 hektarë pyje dhe është më i madhi në Itali.

I konsideruar si një nga masivët më të bukur dhe karakteristikë të Apenineve Lucane, Akeasit e quajten Apollineum, duke e identifikuar atë me Olimpën, për shkak të madhësisë së tij gati sa prek qiellin.

Muzeu i kulturës arbëreshe

Kultura arbëreshe ndodhet e ekspozuar në qendrën historike të qytetit, brenda një ndërtese elegante të shekullit XIX. Sallat e ekspozitës janë të vendosura në dy nivele, kati përdhes dhe kati i parë. Etnomuzeu përmban rrobat e lashta, mjetet e punës së fshatarëve, një zbukurim antik, me të cilin bëheshin pëlhura, si dhe

objekte të tjera karakteristike të etnisë arbëreshe. Është një vend ku mund të prekni traditat, zakonet e një populli antik si ai arbëresh, i cili pavarësisht kalimit të kohës, ka ruajtur të gjitha veçantitë e tokës së origjinës, të pandryshuara ndër shekuj.

Arbëreshët e Shën Kostandinit, ndeshen çdo ditë me vështirësinë e shpopullimit dhe të zhdukjes së gjuhës arbërishte. Shën Kostandini është një fshat i bazuar në një ekonomi mjaft të dobët, e përqendruar në kultivimin e gështenjës dhe të ullinjve, si dhe prej lirit, fshesave dhe pambukut.

Figura të shquara të Shën Kostandinit

Mikele Skutari (Michele Scutari) lindi me 7 tetor të vitit 1762. Për tridhjetë e gjashtë vjet ai ishte kryepriфт, pikërisht nga 16 tetori 1793 deri në 1830. Në vitin 1825 ai dha një kontribut të rëndësishëm edhe në fushën historike, pasi botoi materialin e detajuar “Informacione historike mbi origjinën dhe vendosjen e shqiptarëve në Mbretërinë e Dy Siçilive- Mbi natyrën, gjuhën dhe ritualin e tyre”. Vdiq në San Costantino më 11 gusht 1830.

5.2. San Paolo Albanese (Shën Pali)

San Paolo Albanese (ose Shën Pali Arbëresh), u quajt edhe *Casalnuovo Lucano*, përkatësisht nga viti 1936 deri në vitin 1962. San Paola, është një qytet arbëresh, në Italinë e Jugut, me 280 banorë dhe e vendosur pikërisht në krahinën e Potenza-s, në Basilicata.

San Paolo shtrihet në një lartësi prej 843 metrash dhe ndodhet në shpatin e malit *Carnara*, 1.284 metra mbi nivelin e detit dhe është komuna më e vogël në Basilikatë, me një sipërfaqe prej 29.9 km². Themelimi i *San Paolo Albanese*-s daton rreth vitit 1534 dhe u krijua nga refugjatët arbëreshë prej Shqipërisë dhe Moresë. Edhe këtu miti i Gjergj Kastriotit nuk mungon, pasi në sheshin kryesor është vendosur shtatorja e tij.

Ky fshat ende mbron trashëgiminë gjuhësore të përkatësisë etnike dhe të trashëgimisë fetare, ritit bizantin të të parëve. Vendbanimi



fillestar urban përfundoi në shekullin XVIII, duke shtuar shtëpitë tipike me tarraca, arkitektura që ndoshta i referoheshin qendrave antike të Moresë shqiptare. Gjatë shekujve, kjo etni ka mbetur fort kohezive dhe nuk është bashkuar me popullsinë vendase. Kjo qëndresë është deri në atë pikë, saqë ende njihet si ngulim shqiptar. Flasin dialekt të përzier të italishtes e të shqipes dhe ndjekin ritin bizantin të fesë katolike.

Në rrugën “Regina Margherita” është vendosur edhe muzeu, i cili mbledh prova të kulturës arbëreshe. Muzeu, në tërësi, kombinon disa realitete: është një vend me vlera tradicionale dhe një kornizë e jetës së brezave të mëparshëm, që promovon identitetin kulturor. Muzeu u inagurua në vitin 1993 dhe sot është një qendër historike e rëndësishme. Në të janë ekspozuar objekte të përditshme, kostume tradicionale, produkte dhe mjete të jetës shtëpiake dhe të punës, të cilat ilustrjnë fazat e përpunimit të fshesës; nga mbledhja, transformimi, deri tek prodhimi i pëlhurave etj.

Kisha e San Rokut

Kisha nënë e “Ekzaltimit të Kryqit”, u ndërtua në shekullin XVIII mbi rrënojat e një ndërtese fetare paraekzistuese. Këtë kishë, arbëreshët e ndërtuan me duart e tyre dhe aty ruhen disa afreske

nga autorë të panjohur, si dhe ikona të vlefshme bizantine. Data 16 gusht është festa e San Rokut. Mbahet procesioni për nder të San Rokos dhe transporti karakteristik i “grenjës” (tufave me grurë), që kryhet në shpatullat e vendasve dhe zhvillohet vallja tipike “*falcetto*”.

Trashëgimia kulturore

Për ata që e vizitojnë për herë të parë, *San Paolo Albanese* paraqitet si një vend zanash, me fshatin karakteristik dhe antik, në të cilin zhvillohen shtëpitë, në një mënyrë mjaft të pazakontë, rreth një gjiri të vogël, mbi të cilin dalin shkallët hyrëse të vetë shtëpive. Kjo skemë origjinale dhe tërheqëse përfshin gjithashtu disa pallate, që datojnë nga shekulli i 18-të.

Natyra dhe parqet

San Paolo ngrihet mbi luginën e lumit Sarmiento, duke i dhënë qytetit një pamje shumë romantike. Nga ajo lartësi ofron pamje vërtet unike me pamje të gjerë, të pasura nga zona të dendura jeshile, me drurë dhe lisa.

Në territorin e San Paolo Albanese-s, shkurre të trasha dhe shumëgjyreshe shoqërojnë shëtitoren. Aty gjendet edhe një nga burimet më të freskëta të zonës, pikërisht ai i *Caprio*-s, dhe më tej, shtrihet një hapësirë jeshile e panoramike, midis kullotave, livadheve, orkideve dhe bimëve të egra.

5.3. Barile (Barilli)

Zona e *Bariles*, ose *Barillit* ishte e populluar në kohërat e lashta nga një koloni grekësh, të cilët më vonë e braktisën këtë vend. Pas rënies së Shkodrës, në vitin 1478 dhe, pas rënies së kalasë së Corone-s në vitin 1532, rajoni i Vulture-s u popullua nga valët e grupeve shqiptare që largoheshin nga pushtimet turke. Kjo mbahet mend në historinë e kolonive shqiptare si migrimi i pestë dhe daton në vitet 1533-1534. Kolonia greko-shqiptare, me emrin “Arbëreshë”,



mbërriti në këtë zonë në vitin 1478. Kolonia tjetër shqiptare, e quajtur “Coronei” meqënëse vinte nga Corone, mbërriti rreth vitit 1534. Kjo valë refugjatësh u vendos në të njëjtën kodër të zgjedhur nga Arbëreshët e mëparshme. Kolonia e tretë mbërriti në vitin 1597 dhe ishte e përbërë nga afërsisht tridhjetë familje Coronei nga Melfi, të cilët u vendosën në Barile pas armiqësive të shumta me banorët e Melfit. Ndërsa kolonia e katërt arriti afërsisht në vitin 1675, quhej “Mainotti”, sepse vinte nga Laconia dhe Maina, pra, nga Leuctra antike. Ata u quajtën edhe “Camiciotti”, për shkak të bluzës së zezë që vishnin. Në vitin 1664, pati edhe një valë tjetër migrimi shqiptarësh në Barile, të cilët konsiderohen si migrimi i gjashtë.

Qyteza Barile

Në qendër të Bariles, në Largo Garibaldi, jo larg Piazza del Municipio, qëndron monumenti “Fontana dello Steccato”, i cila është bërë simbol i një qyteti që krenohet me një histori mijëvjeçare, me origjinë arbëreshe. Etnia arbëreshe e këtij fshati shpërfaqet në forma të ndryshme. Ndryshe Barile quhet edhe “qyteti i verës”, sepse aty prodhohet edhe vera më e famshme në Europë, Aglianico.

Peizazhi është përrallor. Vetëm pak metra larg qendrës historike është kodra me shpellat antike të kantinës tipike, të gdhendura në shkëmb. Këtu mund të shihni shumë dyer të bodrumeve të Bariles, të vendosura në një rresht pranë njëra-tjetrës. Edhe stema që identifikon fshatin Barile, ilustron një fuçi midis dy bredhave dhe një bistak rrushi.

Figura të shquara

Një nga personalitetet më të rëndësishme të kësaj zone ishte **Vincenzo Torelli**. Ai lindi në Barile, në vitin 1807 nga një familje arbëreshe, pastaj u transferua në Napoli, ku edhe vdiq në 1882. Gjatë jetës së tij spikati si gazetar, libretist, shkrimtar dhe si botues.

Vincenzo Torelli është konsideruar si dekani i gazetarisë napolitane të shekullit XIX dhe emri i tij është i lidhur në veçanti me themelimin e revistës “Omnibus”, të cilën ai e drejtoi për pesëdhjetë vjet, ku u lidh me artistë të shumtë, veçanërisht aktorë e kompozitorë dhe luajti një rol kryesor në menaxhimin e teatrove napolitane dhe pati ndikim në skenën kulturore të kohës. Gjithashtu, edhe i biri i tij, **Achille Torelli** pati një karrierë të ndritur si dramaturg në Itali.

5.4. Ginestra (Zhura)

Ginestra, është një fshat i vogël, i vendosur në një kodër me një shpat të butë, ku zërat e banorëve të saj ligjërojnë me fjalë shqipe dhe ku ndihen besnikë të rrënjëve të tyre. Janë në kufi me vëllezërit e tyre arbëreshë të dy fshatra të tjerë, Barile dhe Maschito. Në ato rrugica të ngushta, mbi ato shkallë është gdhendur historia e qytetit, në të cilin nuk mungojnë emrat e shesheve dhe të rrugëve, të shkruara në shqip: *Alessio, Skënderbeu, Schipetari, Jura* etj.

Fshati i bukur *Ginestra*, ose *Zhura* sipas arbëreshëve vendas, u ndërtua në rrënojat e qyteti lombard, që u shkatërrua nga normanët. Qyteti u themelua nga një komunitet i mërgimtarëve shqiptarë, të udhëhequr nga Francesco Zhura, i cili në vitin 1478 përfitoi nga

territori i fshatit të vogël, duke ndërtuar shtëpi dhe duke përhapur kulturën dhe rrënjët e tij, falë lëshimit të tokës nga aragonezët.

Origjina shqiptare vazhdon të jetojë në përdorimet dhe traditat e popullit të Ginestra-s, e cila si referencë mban emrin e bimës shumëgjyreshe, të pranishme përgjatë shpateve të të gjithë territorit të saj.

Artin dhe kulturën e gjurmëve arbëreshe i gjejmë tek “Via Garibaldi” me trotuarin e saj unik, “Palazzo Allamprese” të shekullit të 16-të. Ende në qendër të qytetit, tek sheshi “Raffaele Ciriello”, gjendet harku karakteristik i furrës.

Midis shumë bukurive qëndron e madhërishme kisha nënë e shekullit të pesëmbëdhjetë kushtuar Shën Nikollës, e cila ka artin e vet, stolitë, mozaikun, afresket dhe historinë e saj.

Elementet shqiptare të Ginestra-s vazhdojnë të jetojnë edhe në disa rite fetare. E tillë është festa për nder të “*Madonna e Kostandinopojës*”, mbrojtëse e Ginestrës.

Ginestra ngrihet në zemrën e Vultures dhe rrethohet nga peizazhet spektakolare. Njëra anë të çon drejt në shpatin e *Monte Vultures*, ku mund të kundrosh një peizazh të mbizotëruar nga rreshtat me vreshta dhe me ullinj. Nga ana tjetër, mund të shihni një pamje piktoreske, në të cilën hapësirat e mëdha duken si valë të arta të një dimensionit surreal.



5.5. Mascito (Mashqiti)

Maschito, (ose në arbërisht, *Mashqiti*) është një fshat arbëresh që u ngrit rreth vitit 1467. Pas rënies së Krujës, midis viteve 1478 dhe 1479, pati një emigrim të parë të shqiptarëve në Bazilikata. Më vonë, në vitin 1533, koloni shqiptare nga Korone iu shtuan shqiptarëve të mëparshëm.

Me traktatin e paqes midis Karlit V dhe Sulltan Sulejmanit I, nënshkruar në Kostandinopojë në 1533, fortesa e Koronit u dorëzua te turqit me kushtin që banorët, të gatshëm të linin qytetin, të hipnin në një flotë dhe të strehoheshin në Itali. Në këtë mënyrë, koroneit u shpërndanë në vende të ndryshme në jug të Italisë. Gjatë dy shekujve të parë, riti greko-ortodoks u ruajt në Maschito, por më vonë riti latin u pranua, për shkak të presionit nga peshkopi Deodato Skalia (Deodato Scaglia).

E vendosur në zonën e *Vulture Alto Bradano*, e karakterizuar nga peizazhe të paprekura, në të cilat mbizotërojnë kultura dhe historia, Maschito ngrihet në një zonë kodrinore. Kryesisht shquhet për kultivimin e hardhive, ullinjve dhe grurit. Megjithëse disi në



rënie, përdorimi i gjuhës arbëreshe ekziston ende në komunikimet e përditshme, thëniet, fjalët e urta dhe vjershat, të cilat kryesisht rrjedhin nga tradita rurale, me të cilën ishte lidhur vendi.

Qyteti ka tri pjesë kryesore: pjesa qendrore, pjesa e vjetër (qendra historike, që daton nga fundi i shekullit XVI) dhe pjesa e periferisë, që u zhvillua në periudhën e dytë të pas luftës. Ndër rrugicat e ngushta dhe tërheqëse do të zbuloni qoshet më sugjестive të fshatit arbëresh, tre kishat me vlerë (fillimisht ishin rreth pesëmbëdhjetë kisha gjithashtu të ritit bizantin dhe me liturgji të thënë në greqisht deri në shekullin XVII), pallatet fisnike dhe shatërvani Skënderbe.

Kisha e Caroseno-s u ndërtua nga arbëreshët e Corones dhe është e njohur për një afresk shumë të çmuar të Madonës së vitit 1558, zbuluar në vitin 1930 gjatë restaurimit të kishës, dhe dy piktura të mëdha që lidhen me Rrëshajën dhe prezantimin e Jezusit në tempullin që daton nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë. *Kisha e Purgatorit*, ose *Madona e Rruzares*, ruan një pamje artistike të Medresesë së Kostandinopojës, marrë nga kapela me të njëjtin emër, e rrënuar. Për kishën e sotme kushtuar *Virgjëreshës së Rruzares së Pompeit*, nuk dihet data e saktë e ndërtimit, kjo daton që në vitet e para të themelimit të Maschitos dhe zotëron reliktet e Rozario Aduka (Rosario Adduca), një shërbëtor i Zotit me origjinë nga Maschito.

Kisha Nënë e Sant'Elia, ka një altar të vetëm, të zbukuruar me allçi. Ai përmban dy piktura vaji të shekullit të gjashtëmbëdhjetë dhe pikturën e Madonës me shtatë vello. Është ndërtuar në vitin 1698 nga banorët shqiptarë.

Burimet

Në këtë fshat vlen të vizitohen burimet e shumta hidrike, të cilat konsiderohen edhe si vende shoqërore për të zhvilluar biseda të këndshme.

Shtëpitë, në të vërtetë, nuk kishin ujë të pijshëm. Për kuzhinë dhe

nevoja familjare, gratë shkonin për të marrë ujë te burimet, duke përdorur kasa. Një shatërvan publik ishte një vend i rëndësishëm për plotësimin e nevojave të familjeve. Në 1879 - siç dëshmohet nga pllaka e rikonstruktuar nga Bashkia: “Shatërvani Skënderbej u ngrit nga qytetarët dhe me ndihmën e Bashkisë”.

Burimet e tjera në zonë janë: Fontana Carrozz, e vendosur në Via Venosa; Fontana Boico, e vendosur në Via Venosa; Fontana della Noce, e vendosur në Contrada della Noce; Fontana Cangad, e vendosur në Via Venosa.

“Retnes”

Nga viti 2010 në Maschito zhvillohet veprimtaria e quajtur “*Retnes*”, e cila synon të forcojë lidhjet midis popullatës lokale dhe rrënjëve të saj shqiptare, të rikuperojë historinë e origjinës së komunitetit dhe të rimarrë ndjenjën e përkatësisë dhe identitetin.

Rreth tetëdhjetë figura, të veshura me rroba dhe armë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, të rindërtuara nga artizanë vendas, përbëjnë të dy fraksionet e ushtarëve mercenarë, të cilët ishin pjesë e kompanisë së armëve të Lazzaro Mathes-it dhe kapitenit shqiptar, Skënderbeut. Para se të sfidojnë njëri-tjetrin, të dy grupet ecin nëpër rrugët e qytetit. Ndërsa, pas betejës, e gjithë ndërmarrja, e udhëhequr nga kapiteni Lazzaro Mathes, shkon drejt burimit të Skënderbeut, ku janë betuar trupat.

Kapitulli VI: Ngulimet arbëreshe në Kampanjë

Në kohën kur u bë eksodi i madh i arbëreshëve në Itali, Napoli ishte kryeqyteti i Mbretërisë së Ferdinandit I të Aragonës. Në të kaluarën, Skënderbeu dhe Ferdinandi kishin qenë aleatë të afërt ushtarakë, por edhe miq, duke mbështetur njëri-tjetrin në momentet më të vështira të historisë së tyre dhe me interesa të ndërsjella kudo. Skënderbeu u prit në Napoli me nderime të mëdha, duke pasur parasysh që ai kishte mbështetur luftërat për fronin e Mbretërisë së Napolit, si për mbretin Alfonso V, ashtu edhe për djalin e tij Mbretin Ferdinand I.

Kjo ishte arsyeja pse Mbretëria e Napolit ishte vendi i vetëm që në vitin 1468, pas vdekjes së Skënderbeut, mikpritën bashkëshorten e tij, Donika Kastriotin bashkë me djalin dhe me qindra oborrtarë dhe luftëtarë të Krujës. Napoli u bë gjithashtu destinacioni i shumë prej mijëra emigrantëve shqiptarë, të cilët mbërritën në Itali për t'i shpëtuar pushtimit osman të vendit.¹²⁴

¹²⁴ Nuk është e rastit që, në këtë qytet janë botuar disa nga veprat më të rëndësishme për letërsinë dhe kulturën arbëreshe të asaj kohe. Këtu Jeronim De Rada shtypi të gjitha veprat e fazës së parë të krijimtarisë së tij letrare, përmendim “Këngët e Millosaut” (1836, 1847), “Këngët e Serafinës Topia” (1839, 1843), “I Numidi” (1846), “Storie d’Albania dopo il 1460” (“Rrëfimet e Arbërit”) etj.

Në këtë qytet janë botuar vepra të tjera të rëndësishme nga pikëpamja letrare, si: tragjedia “Ines de Castro” e Ëngjëll Basile-s (1847) dhe “Su gli

Nga Napoli, për të shmangur grumbullimin e shqiptarëve në bashkësi të mëdha, këto u shpërndanë në krahinat e ndryshme të Mbretërisë, kryesisht në Kalabri dhe Sicili. Disa familje mbetën në Napoli, e të tjerë u vendosën në krahinën e Avelinos (Avellino), në Kazale (Casale) (pjesë e Ariano Irpino), në Ginestra degli Schiavoni (në Grottaminarda) në Villanova del Battista, në Greci e në krahinën e Beneventos u formua vendbanimi i Sant'Arcangelo Trimonte.

Kisha e Apostujve Shën Pjetri dhe Shën Pali është kisha më e vjetër e diasporës shqiptaro-greke. Në krahinën e Kampanies me qendrën e saj në Napoli, flitet për një komunitet arbëresh, të cilët frekuentonin kishën e Shën Pjetrit e Paolos të ritit bizantin në rrugën “San Tommaso d’Aquino”, nr. 51. Kjo kishë i përket fundit të shekullit XVI dhe gjysmës së parë të shekullit XVII. Tommaso Assan Paleologo ndërtoi më 1518 kapelën e Apostujve të Shën Pjetrit dhe Shën Palit. Ai vendosi emblemën e tij fisnike, dy luanë të lyer me ar të shfrenuar, të cilët mbanin një shpatë argjendi në një sfond të kuq. Mbreti Charli V i caktoi shumën 5,000 dukatë” për mirëmbajtjen e kishës bizantine”. Edhe sot kisha quhet Kisha e Shenjtorëve Pjetri dhe Pali.

Në brendësi të kishës së dy Apostujve të Shën Pjetrit dhe të Shën Palit, e njohur gjithashtu si “Il Greco”, për shkak të origjinës shqiptare-greke (arbëreshe) ndodhet edhe një pikturë e Belisario Corenzio-s. Belisario Corenzio, piktor me origjinë shqiptare, pikturoi një numër të madh afreskesh, në pallatin mbretëror, në Certosa di San Martino, në kishën e Santa Maria la Nova, në San Domenico Maggiore, në Gesù Nuovo dhe në shumë kisha të tjera napolitane.

Ndër priftërinjtë arbëreshë që vepruan në këtë kishë gjatë kësaj kohe, përmendim: Papas Giuseppe Bugliari (Josif Buljari) nga Shën Sofia, papas Andrea Figlia (Ndre Filja) nga Munxifsi, papas Antonio Pace (Anton Paçe) nga Shën Kostandini, papas Nicola Chetta

Albanesi, ricerche e pensieri” (“Mbi shqiptarët, kërkime dhe mendime”) e Vinçens Dorsës (1848). Po ashtu këtu u botua, me iniciativë të vetë De Radës, më 1848, gazeta e parë shqiptare “Arbëreshi i Italisë” (“L’Albanese d’Italia”).

(Nikollë Keta), papas Francesco Antonio Tamburi (Frangjisk Anton Tamburi) nga Shën Vasili, papas Demetrio Camarda (Dhimitër Kamarda) nga Hora e Arbëreshëve, papas Costantino Tamburi (Kostandin Tamburi) nga Shën Vasili, papas Giuseppe Martino (Josif Martino) nga Ungra etj.

Krahina e Avellino-s

Nga pesë vendbanimet e identifikuara si arbëreshe në krahinën e Avellinos, më e rëndësishmja u themelua afër Orsara-Terrastrutta, në gusht të vitit 1461, në kohën kur u zhvillua beteja midis Skënderbeut dhe ushtrisë së Piccininos, gjeneralit të princit të Taranto Giovanni Antonio del Balzo Orsini, ku Skënderbeu triumfoi, duke shkatërruar plotësisht ushtrinë e baronit që ishte rebeluar kundër Mbretit të Napolit. Ky vendbanim ishte pikërisht Greci.

6.1. GRECI (KATUNDI)

Greci, ose siç i thonë arbëreshët *Katundi*, është vendi i vetëm në Campania (krahinë e Italisë së Jugut, me qendër Napolin) i cili qysh prej shekullit XV ruan me xhelozi gjuhën, kulturën dhe traditat e saj. Midis vitit 1461 dhe 1464, gjeneral Skënderbeu ishte në Itali me një numër të madh arbëreshësh trima për të ndihmuar mbretin Ferdinand kundër Giovanni d'Angiò-s. Skënderbeu më 14 gusht 1461, në betejën e Orsaras mposhti përfundimisht Anzhuinët. Pas betejës, një garnizon ushtarësh shqiptarë mbeti në këtë kodër në mbrojtje të çdo sulmi rebelësh. Ushtarët, të bashkuar nga familjet e tyre, filluan ndërtimin e shtëpive të tyre në lokalitetin e quajtur Breggo (Bregu), duke ndërtuar shtëpitë *kalive*, (shtëpi prej guri me çati prej druri dhe pllaka), të formuara nga një mjedis i vetëm, që do të shërbente si shtëpi dhe strehë për kafshët. Shqiptarët e rritit bizantin u konvertuan në atë latin rreth vitit 1690, për shkak të represionit të kryepeshkopit Orsini që vepronte në këtë zonë.



Qendra historike

Hulumtimet historike na kanë lejuar të japin më shumë informacion mbi kishën e parë, kushtuar mbrojtësit të fshatit “Shën Bartholomeu”, e cila është ngritur në qendrën “Largo S.Bartolomeu”. Arkitektura e saj e thjeshtë orientale u shtrembërua në shekullin XVII, kur ajo u rregullua sipas ritit latin dhe jo më bizantin. Rindërtuar në fund të shekullit XVII në stilin romanesk, kisha u shenjtërua nga Kardinal Vincenzo Maria Orsini, në kohën kur ishte arqipeshkv i Beneventos. Në brendësi të kishës gjenden statujat e Maria Santissima del Caroseno dhe shenjtorit mbrojtës Bartolomeo, si dhe piktura të shekullit XVII, ndërsa burimorja e pagëzimit daton nga viti 1706. Në altarin e sipërm vihet re statuja e bukur e Maria SS ma del Caroseno, e nderuar nga komuniteti shqiptar dhe e pasuruar me një mantel të çmuar në pëlhurë damask, dhuruar nga Mbretëresha Maria Cristina e Savoja. Piktura e vajit që i atribuohet shkollës “Guido Reni”, dhuruar nga Duka Guevara e Bovino është një kanavacë e shekullit XVII që përshkruan Shën Luçinë. Të denja për

t'u përmendur janë disa statuja të shekullit XVIII-XIX, të punuara në letër e të modeluara nga mjeshtrit vendas. Çdo vit, në dhjetë ditët e para të qershorit zhvillohet festa e Madonna del Caroseno (që konsiderohet si mbrojtësja e këtij fshati). Në këtë festë fetare zhvillohet procesioni, ku statuja, e ruajtur në kishën Nënë, e veshur me kostumin e ditës së rëndësishme (e dhuruar nga Mbretëresha Maria Kristina e Savojës) marshon nëpër rrugët e qytetit. Gjatë festës, ballkonet e shtëpive zbukurohen me pëlhura mëndafshi dhe me mbulesa të qëndisur me dorë. Në disa hapësira të caktuara përgatiten altarë të zbukuruar me bimë, lule dhe me objekte të shenjta. Në të kaluarën, njerëzit paganin për të pasur nderin që të mbanin mbi supet e tyre statujën e Marisë. Pranë saj, gjendeshin edhe statuja të Shën Vincencos dhe e Shën Nikollës (S.Vincenzo e S.Nicola). Besimtarët arbëreshë të Grecit në këtë ditë pëshpëritin, ose luten duke iu drejtuar Maria del Caroseno-s me himnin “Ghiir imath ibecuare, Ajo Marii dhe Zinnit».

Shtëpitë “halive”

Në Greci gjejmë shtëpi të lashta e të thjeshta vetëm me një ambient, të cilat janë të realizuara në gur, karakteristikë kjo e stilit të shtëpive arbëreshe.

Një nga llojet e shtëpive ishte “haliva” e ndërtuar me gurë e me një çati prej druri dhe me pllaka. Në përgjithësi ishte i përbërë nga një dhomë e vetme që do të shërbente si shtëpi dhe strehë për kafshët. Halivet ishin shumë të ulëta dhe në të banonin kryesisht familjet shumë të varfra. Ato që janë akoma të paprekura janë afër Breggo-s.

Përveç shtëpive të të varfërve, ishin dhe shtëpitë e artizanëve dhe mbarështuesve, të cilat kishin përgjithësisht dy kate dhe ishin të shpërndara në të gjithë vendin.

Në qendër qëndronin ndërtesat hijerënda me disa kate dhe një oborr të brendshëm. Dyshemeja e “halive” ishte prej toke të rrahur, ndërsa ato të shtëpive të tjera ishin ose prej guri ose me pllaka terakotë. Për të dekoruar fasadat e ndërtesave më të bukura, u

punësuan gurskalitës të aftë të punonin gurin në një mënyrë artistike, të krijonin portale, kolona, qoshe dhe dritare. Pothuajse çdo shtëpi, për t'u mbrojtur nga keqdashësit kishte një trung prej druri që e quanin "varra" dhe ishte e fiksuar në dy muret anësore, i cili mbante fort derën me një aks tjetër (trung), vertikalisht. Shtëpitë, zakonisht, bëheshin me gurë të mbledhur në fshat (të cilët shërbenin për muret kryesore) dhe me tulla, të cilat përdorehin për ndarje të brendshme.

Disa nga ndërtesat me arkitekturë karakteristike në Greci ishin:

Pallati Lauda (shek. XVIII), pallati i përkiste familjes Lauda, e cila mbërriti në fshatin Greci me migrimet arbëreshe.

Pallati De Maio (shek. XVIII), pallat që u përkiste pasardhësve të Michele De Maio, guvernatorit të vendeve fqinje në kohën e sundimit spanjoll.

Pallati Caccese (shek. XIX), pallati i shekullit XIX, i përkiste familjes Caccese. Ata kishin disa prona midis arbëreshëve, Montecalvo dhe Gesualdo. Palazzo Caccese, një ndërtesë e shekullit XIX, me një portal të shquar, i cili përmban edhe një muze me emrin e patriotit shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

Pallati Lusi (shek. XVI), pallati i shekullit XVI, me oborr të brendshëm, të rimodeluar në shekullin XVII, i shitur në shekullin XX nga trashëgimtarët e familjes në komunën Greci dhe që prej asaj kohe, është bërë selia komunale. Familja Lusi ishte ndër familjet më të rëndësishme, e pranishme që në shekullin XIV në Ariano Irpino. Familja Lusi është me origjinë arbëreshe (Louzis / Λούτζης), me origjinë nga ishulli i Korfuzit.

Në fshatin Greci gjen emërtime shqiptare, të tilla si: Sheshi Kikutë, Pili, Fisa, Ghama Shpotit, Mali, Vreshtë, Bregu, Shkëmbi, Rëshkalatat, Shelqi, Proigas etj.

Tre Burimet (Le Tre Fontane)

Në fraksionin "Le Tre Fontane" ndodhet "Maseria", e cila u ngrit në kryqëzimin e tre rrugëve të lashta të trafikut "Via Appia Traiana", ndërtuar në shekullin II pas Krishtit. E ndërtuar në shekujt XVII dhe XVIII, funksioni i saj ishte ajo e një zyre postare në "Tratturello Regio Camporeale - Foggia", e cila ishte një degë e

rajonit më të rëndësishëm të “Pescasseroli - Candela”. E ndërtuar në kryqëzimin kryesor midis Campania dhe Puglia, vendbanimi në fillim ishte shumë i zhvilluar falë lëvizjeve të mëdha të barinjve, udhëtarëve, tregtarëve etj.

Ceremonia e varrimit

Gjatë ceremonisë së varrimit, të afërmit vajtojnë të ndjerin, me zë të lartë në gjuhën shqipe me vargjet i shoqërojnë me fjalë që nxjerrin në pah meritat dhe virtytet e të vdekurit.

Dasma

Dasma ishte një rast i volitshëm për të festuar me të afërmit dhe miqtë. Martesat midis klasave të ndryshme shoqërore nuk shiheshin si të favorshme, në këtë rast çiftet e fejuara shpesh zgjidhnin të bënin “fuitina”, ose “arratisjen e dy të dashuruarve”. Arratisja u zgjodh edhe në rastet kur dy të rinjtë vinin nga familje të varfra, ose kur vajza nuk miratonte atë që i thoshin prindërit.

Kur fejesa ishte në zhvillim e sipër, të dy të rinjtë nuk mund të ishin kurrë vetëm. Gjëja më romantike ishte serenata nën ballkonin e saj, tingulli i fizarmonikës, violinës apo kitarës. Dhëndri duhej t’i jepte gruas së ardhshme shtëpinë, në të cilën do të jetonin (në pronësi, ose me qira), ndërsa nusja mendonte për mobilet dhe pajën.

Figura të shquara në Greci

Leonardo De Martino

Komunitetet italo-shqiptare tregojnë një vetëdije të lartë për identitetin e tyre gjuhësor dhe kulturor, i cili gjen shprehje në zellin dhe veprimtarinë e shumë intelektualëve që nga shekulli XVI. Një prej tyre është edhe shkrimtar **Leonardo De Martino** (ose Leonardo de Martino), i cili lindi në Greci, në krahinën e Avellinos, më 1830 dhe ndërroi jetë në Manastirin e Sarno (SA) më 1923. Ai kaloi dyzet vjet të jetës së tij (1865-1903) në Shkodër dhe në Malësi.

Emri i Leonardo de Martino është i lidhur me veprën “L’Arpa d’un Italo-Albanese” (1881), një përmbledhje poezish të shkruara

pjesërisht në italisht, pjesërisht në shqip, frymëzuar nga Manzoni. Vëllimi përfshin himne me frymë fetare dhe një dramë fetare, e para në llojin e saj e shkruar në gjuhën shqipe. Ai ishte mësues i Ndre Mjedës (1866-1937) dhe i Gjergj Fishtës (1871-1940).

Do të ishte mirë të rivlerësohet krijimtaria e këtij autori, i cili e gjeti motivin frymëzues në besimin e krishterë dhe në dashurinë për vendin e tij të origjinës, Shqipërinë.

Është e vështirë të gjesh librat e shkruar nga Leonardo de Martino. Katalogu unik i bibliotekave italiane përmban 17 nga veprat e tij dhe pjesa më e madhe ruhen në bibliotekën “Casa Carducci” në Bolonjë. Tetë libra të këtij autori janë botuar në Avelino nga Tipografia Pergola. Dy vepra të tjera janë shtypur në Ariano Irpino (AV), ose siç njihet asokohe me emrin Appulo-Irpino.

AULETA SALERNO

Në shekullin XII qyteti i Auletës ishte i rrethuar me mure dhe në pjesën më të lartë të zonës urbane ngriheshin vendet simbolike të jetës së asaj kohe, kisha famullitare dhe kalaja imponuese. Në kohërat normane, kalaja i përkiste Kontit Guglielmo di Principato (të familjes Altavilla) dhe djalit të tij Nicola. Më pas ajo ishte në pronësi të Gesualdo, Vitilio dhe Di Gennaro, pasardhësit e San Gennaro-s. Me martesën midis Beatrice di Gennaro dhe Antonio Kastrioti Skënderbeu (Antonio Castriota Scanderbech), pasardhës i drejtpërdrejtë i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, kalaja iu dhurua në formë paje familjes fisnike shqiptare, për t’u trashëguar më pas te familja Maioli Castriota Skënderbeu, që është edhe pronari i tanishëm. Më 31 maj të vitit 1941, kalaja u shpall një objekt me interes historik dhe kulturor (ish-ligji 1089/1939). Brenda në këtë kala gjendet “Salla e Armëve”, në qendër të së cilës është një model i madh majolica me stemën fisnike të familjes Kastrioti (shqiptonjat me dy koka, simbol i flamurit shqiptar); salla e “kapelës”, me një altar të praruar, ku ruhen disa relike, si dhe dhoma e “oxhakut” me vatrën e saj prej guri.

6.2. ABRUZZO

Abruzzo ka qenë një vend zbarkimi që nga shekulli XIV nëpërmjet detit Adriatik. Në rajonin e Abruzzo-s kishte disa vendbanime arbëreshe, veçanërisht pas vdekjes së Skënderbeut. Vendbanimet arbëreshe në Povincia di Pescara, Cappelle sul Tavo, Caprara d'Abruzzo (fraksioni i Spoltore-s), Cipressi (fraksion i Citta Sant'Angelo); në krahinën e Teramo-s të Komunës së Silvi-t dhe Villa Prepositi (fraksioni i Atri); në krahinën e Chieti të Komunës së Cupello-s; në krahinën e L'Aquila të komunës Sulmona.

Prania e arbëreshëve në rajonin e Abruzzo-s sot identifikohet me vendbanimet e tyre në Villa Badessa (në gjuhën arbëreshe: Badhesa) dhe vendbanimet në një pjesë të bashkisë së Rosciano-s, përkatësisht në provincën e Pescara-s, e cila mendohet se është themeluar nga një grup familjesh të shpërngulura nga Piqerasi, në jug të Shqipërisë.



6.3. VILLA BADESSA (BADHESA)

Kolonia shqiptare e Badhesës është populluar nga të shpërngulurit e fundit në Itali, duke marrë parasysh që komunitetet e tjera u vendosën në Kalabri, Sicili, Molise, Pulia, që nga shekulli XV.

Ka informacione të gabuara në lidhje me themeluesit e Badhesës, të cilat ia vlen të qartësohen duke iu referuar fakteve historike. Tre qytetet e fundit të pushtuara nga osmanët ishin Kruja më 1478, Shkodra më 1479 dhe Durrësi, më 1501 (më shumë se 10 vjet pas vdekjes së Skënderbeut). Të tre qytetet ndodhen në veri të Shqipërisë. Shqipëria e Jugut, ku ndodhet Piqerasi, atdheu i banorëve të Badhesës, ishte nën zgjedhën e osmanëve shumë kohë para qyteteve të lartpërmendura. Në kohën kur vendosën të emigronin, ata kishin bashkëjetuar rreth 200 vjet me osmanët. Shumica e banorëve të Piqerasit i përkisnin besimit ortodoks dhe kishin mosmarrëveshje me banorët e fshatrave fqinje, që ishin islamizuar.

Në dhjetor të vitit 1742, banorët e Piqerasit u sulmua nga këta myslimanë, që ishin bashkëkombësit e tyre shqiptarë dhe fqinjët e tyre. Për shkak të këtij konflikti, ata u shpërngulën nga vendi i vet dhe u vendosën në një rajon historik në jug të Shqipërisë. Veç tyre, pati edhe banorë nga fshatrat Lukovë e Nivicë, të cilët për t'i shpëtuar hegjemonisë shtypëse dhe persekutimit fetar të turqve u vendosën po në Abruzzo. Kjo shpërngulje shiptarësh i përket vitit 1743.

Komuniteti arbëresh i Badhesës gjeti ngrohtësi dhe mikpritje në Mbretërinë e Napolit, nën udhëheqjen e mbretit Karli III të Burbonëve, i cili i vendosi në territorin e Panielës (Pianella-s). Sovrani u caktoi atyre tokat e trashëguara nga nëna e tij, Elisabetta Farnese, në zonën e Piano di Coccia. Nga veprat noteriale të kohës, konstatohet me saktësi se familjet shqiptare të mbërritura në territorin e Panielës ishin 23 (18 më 1743, dhe 5 më 1748), nga të cilat dihen mbiemrat e kryefamiljarëve, tokat e caktuara, furnizimet, si dhe kushtet dhe garancitë që duheshin respektuar kundrejt Shtëpisë Mbretërore. Përveç “ndarjes” falas të një totali prej 793 tomoli (320 hektarësh tokë), mbreti u siguroi familjeve edhe gjithçka që u duhej për të jetuar:

para, veshje dhe mjete për t'u mirëmbajtur. Gjithashtu i përjashtoi për 20 vjet nga të gjitha taksat vendore. Një tjetër dëshmi mbi kohën e mbërritjes së komunitetit arbëresh në Abruzzo gjendet edhe në një regjistër të vjetër të të pagëzuarve në kishë. Ky regjistër ndodhet në shtëpinë kanonike dhe në të del qartë se shënimi i bekimeve të para mbart datën e 18 nëntorit të vitit 1743.

Demografia e Badhesës

Siç vërtetohet nga letra e Marchese di Salas, i cili ishte Sekretar i Shtetit në kohën e sundimit të mbretit Karli III i Napolit në Badhesa numëroheshin 18 familje me 73 persona, në vitin 1743 dhe pesë vjet më vonë, në vitin 1748 u shtuan edhe 5 familje me 23 persona. Këto të dhëna i gjejmë edhe në Fjalorin Gjeografik Rajonal, si dhe nga historiani Giustiniani. Në vitin 1945, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, largohen nga Badhesa më tepër se 350 persona.

Më 1957, misioni apostolik i kishave, konfirmon se numri i popullsisë arbëreshe në Badhesa ishte 615 banorë. Ndërsa në vitin 1983 kishte sërish një tkurrje të madhe të popullsisë, ku sipas të dhënave ishin 101 familje me 292 banorë, prej të cilëve 154 ishin emigrantë. Sot numërohen vetëm dhjetëra shtëpi dhe gjurmët arbëreshe po zvetënohen.

Shtëpitë e arbëreshëve në Badhesa

Shtëpia karakteristike në Badhesa përbëhet nga një kulm me dy shpate pak të pjerrëta, të mbuluara me një përzierje argjile të kashtës dhe bykut, të depozituara në copa lisi, kallamishte dhe kashte, mbi të cilat rreshtoheshin pllakat (qjaramidet). Në kohët e kaluara, gurët e lumit "Nora" dhe tullat përdoreshin për të ngritur muret rrethuese të shtëpisë së arbëreshëve.

Në volumnin "XVII, Abruzzo inferiore I, fasc. 5 pp 132-133 Pansini" (Napoli, 1853) qendrat e banimit të arbëreshëve në Badhesa përshkruhen, si vijon: "Dy rreshta me shtëpi paralele janë shtëpitë e këtyre njerëzve që i quajnë grek, të ndërtuara me baltë, por shumë të pastra. Dy herë në vit shtëpitë e tyre lyhen me gëlqere me dorë nga gratë".

Santa Maria Assunta, Badhesa

Në Badhesa gjuha arbëreshe flitet pak, por identiteti ruhet në ritualin liturgjik. Sot ekziston një kishë e ritit greko-bizantin, e cila i përket Eparkisë së Lungro-s, në Kalabri. Është ndërtuar rreth gjysmës së dytë të shekullit XVII dhe përfaqëson simbolin e komunitetit arbëresh. Kisha e Badhesës ruan një koleksion të pasur me ikona bizantine dhe pasbizantine, aq sa mund të konsiderohet koleksioni kryesor i ikonave në Europën Perëndimore.

Për ndërtimin e kishës, Karli III kishte ndarë 40 dukatë, por familjet shqiptare që kishin ardhur në mërgim iu lutën dhe i kërkuan edhe 60 dukatë të tjerë, në shkurt të vitit 1745. Karlo Mauri, përgjegjës për menaxhimin ekonomik të 8 familjeve shqiptare, e mori përsipër se do ta çonte deri në fund këtë kërkesë.

Gjithashtu, familjet që u shpërngulën nga Piqerasi udhëhiqeshin nga vëllezërit De Martino. Sipas dëshmimeve të banorëve, vëllezërit De Martino, përpara nisjes me një varkë, do të ktheheshin natën në Piqeras për të marrë ikonën Odigitria nga kisha e manastirit të Himarës. Sipas mendësisë së tyre, ajo do t'u tregonte rrugën e duhur. Ikona, e restauruar disa herë, tani ruhet në kishën e Santa Maria Assunta në Badhesa.

Kostumi arbëresh në Badhesa

Dy kostume arbëreshe i janë dhuruar kishës së Badhesës. Ato i përkisnin familjes D'Andrea Giovanni, pikërisht gruas së tij, Laura Trabucco, më 28 tetor 1971. Kostumi mendohet se është i viteve 1770-1780. Në Badhesa është edhe kostumi arbëresh i prejardhur nga Epiri më 1743 dhe ngjan me kostumin epirot.

Tiparet antropologjike

Vendasit u çuditën nga pamja e greko-shqiptarëve, të cilët mbërritën në territoret italiane. Ata ishin shumë të gjatë dhe me mjekër. Gërmimet e vitit 1968, nxorën në dritë një kamare mortore me një skelet të paprekur, 2 metra i gjatë. Për më tepër, greko-shqiptarët e Badhesës u përshkruan si zemërgjerë, të durueshëm dhe besnikë.

Pallati Felice

Struktura më e lashtë e ndërtesës përbëhet nga kulla katërkëndore, rreth së cilës fshati u zhvillua me një prirje unazore. Kulla, që supozohet se daton nga shekulli XIII, mendohet të jetë përdorur për vrojtim dhe mbrojtje. Në shekujt pasardhës, kulla iu nënshtrua rikonstruktimeve dhe modifikimeve, veçanërisht kur u aneksua në pallatin Di Felice në Casale.

Aktualisht kulla dhe pallati janë në pronësi të Bashkisë së Rosciano-s dhe në të planifikohet të ngrihet një muze i traditës arbëreshe.

Figura të shquara në Badhesa

Kostandin Vlasi (Costantino Vlasi) ishte nënkolonel i regjimentit të këmbësorisë “Maqedonia Reale”. Ende sot kujtohet kontributi i çmuar i shërbimit të tij pranë mbretit Karli III në betejën Velletri, më 10 gusht të vitit 1744, ku komandanti Kostandin Vlasi drejtoi brigadën shqiptare prej 25 personash të rekrutuar.¹²⁵

Shqiptarët figurojnë me dy regjimente dhe me një batalion, i cili quhej “Corpo Franco Albanese”. Karakteristika e veshjes së tyre ishte e njëjtë me atë të zonës Mardi në Kaukaz dhe të zonës së Mirditës në Shqipëri. Për shkak të mënyrës sesi visheshin, ata quheshin ndryshe edhe “Kamçoti” (“Camiciotti”). Ata demonstuan se ishin luftëtarë të mrekullueshëm dhe dalloheshin për guximin dhe besnikërinë në fjalën e dhënë si askush tjetër.

Maximilian Lambertz dhe Badhesa

Në prag të Luftës së Parë Botërore, Maximilian Lambertz u transferua në Itali për të studiuar dialektet shqipe në atë zonë. Gjatë udhëtimit në Italinë e Jugut, Lambertz bëri të pavdekshme një seri

^{125*} Më 10 gusht 1744, ushtria e Karlit III, e përbërë kryesisht nga regjimente mercenarësh të huaj, në betejën e Velletrit, korri fitore kundër ushtrisë perandorake. Suksesin e kësaj beteje, mbreti Karli III ia dedikoi shqiptarëve të fanterisë Maqedono – Ilire, e përbërë nga arbëreshë, malazezë dhe maqedonë. (Shënim i redaktorit)

imazhesh të Badhesës, fshatit të lashtë, me personazhe tipike të asaj periudhe. Pllakat prej qelqi origjinale të këtyre fotografive janë mbajtur në Arkivin Fotografik të Bibliotekës Kombëtare Austriake të Vjenës (Bildarchiv der Österreichischen Nationalbibliothek, Wien). Imazhet dhe vendet janë dëshmi e jashtëzakonshme për komunitetin vendas, në vitet në të cilat Lambertz kreu kërkimin e tij gjuhësor në Italinë e Jugut, përkatësisht më 1912 dhe 1913.

KAPITULLI VII: NGULIMET ARBËRESHE NË MOLISE

Në këtë rajon kanë ekzistuar 27 vendbanime arbëreshe. Sot, pothuajse të gjitha janë zhdukur. Ato kanë lindur në periudha të ndryshme përgjatë pesë shekujve të kaluar dhe, në veçanti, më 1463 – 1466, deri në shekullin XVI.

Shumica e arbëreshëve u vendosën në krahinën e Campobasso-s. Përkatësisht, shpërndarja e arbëreshëve në këtë krahinë ishte si vijon: në **Campomarino** (në arbërisht: Këmarini), në Casacalenda dhe në San Barbato, Casale Sant'Elena, Ceppito, Civitacampomarano; në Guglionesi, Larino dhe fshatrat e saj në Colle di Lauro; **Montecilfone** (në gjuhën arbëreshe: Munxhufuni) me rrethin e saj të Torre Francara, Palata dhe fshatrat e saj të San Leucio, Pettaccia; **Portocannone** (në gjuhën arbëreshe: Portkanuni), Rotello, etj.; San Biase, San Felice del Molise, San Giacomo degli Schiavoni, San Martino in Pensilis dhe pjesa e tij; San Leo, San Paolo Matese, Santa Croce di Magliano, Tavenna; **Ururi** (në gjuhën arbëreshe: Rur). Ndërsa në provincën e **Isernia**, arbëreshët u vendosën në Macchia d'Isernia dhe Sant'Elena Sannita.

Sot në Molise, komunitetet e vetme etno-gjuhësore të arbëreshëve, që ende ruajnë gjurmë historiko-kulturore janë të gjitha në Provincën e Campobasso-s dhe përkatësisht në Campomarino (në arbërisht: Këmarini), Portocannone (në gjuhën arbëreshe: Portkanuni), Ururi (në gjuhë arbëreshe: Rur) dhe Montecilfone (në gjuhën arbëreshe:

Munxhufuni) me rrethin e saj të Torre Francara. Të gjitha këto fshatra arbëreshe shikojnë drejt lindjes, pra në drejtim të vendit amë.

Monumenti më i hershëm i gjurmëve arbëreshe është pallati Baronial, ndërsa manifestimi më domethënës quhet “Carrese”. Kjo është një garë që bëhet midis dy karrocave, për nder të shenjtit mbrojtës të vendit, Virgjëreshës së Bekuar të Kostandinopojës. Manifestime të tjera janë festa e Shën Antonit, që zhvillohet natën e 16 janarit dhe karnavalet tradicionale.

7.1. CAMPOBASSO (PORTKANUNI)

Portkanuni u popullua më 1460 nga grupe shqiptarësh, që u larguan për shkak të pushtimit osman. Menjëherë pas vdekjes së princit Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ata u vendosën edhe në Portkanuni. Ky vend ekzistonte që në periudhën mesjetare, shumë kohë para se të mbërrinin kolonët e rinj shqiptarë. Portkanuni u themelua nga popujt latinë më 1046, në zonën e quajtur “Castelli”, afër varrezave aktuale. Më 1137, u quajt “Portocandesium” dhe më pas, siç duket nga regjistrat e Angioini të vitit 1320, emri u ndryshua në “Portocanduni”.

Sheshi kryesor mban emrin e Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Në këtë shesh ndodhet sahati, pallati baronal dhe shatërvani. Gjithashtu,



pranë Bashkisë së Portkanunit është murali që i kushtohet heroit tonë Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Figura e tij, me shpatën në dorë, mburojën dykrerëshe dhe kalin e bardhë si një Pegasus fluturon në hapësirën qiellore. Në qendër është shkruar në shqip “Bashkia”. Emocioni dhe krenaria ndërthuren bashkë.

Harku i rrumbullakët i gurëve duket sikur mbështetet mbi kullën me sahat. Këtu fillon edhe zona më e vjetër, e quajtur “*Madonna di Costantinopoli*”. Kjo është një lagje karakteristike arbëreshe, ku ruhen ende sot stili, traditat dhe gjitonia. Në brendësi të saj u ndërtua edhe një kapelë për nder të Madonës së Kostandinopojës (Madonna di Costantinopoli). Thuhet se Madona e Kostandinopojës drejtonte këta dy buaj që nuk i drejtonte askush. Aty ku ndali qerrja (karroca), aty u vendosën shqiptarët. Edhe sot, legjenda kujtohet me një garë karrosh, për nder të festës “Madonna di Costantinopoli”.

Stema në kishën San Giorgio Martire, Molise

Një stemë elegante, e pikturuar me ngjyra të buta dhe harmonike. Ajo përfaqëson një kafshë imagjinare, grifën, me trup luani dhe me kokë e krahë shqiponje. Këmbët e pasme mbështeten në dy nga tre majat e pikturuara në emblemë: Montecilfone, Corundoli dhe Casavecchio. Shqiponja kthen kokën drejt lindjes, duke parë një yll me gjashtë cepa, që simbolizon Shqipërinë, të cilën të parët e tyre e lanë me dhimbje. Ajo tregohet nga shigjetat që shpojnë fytyrën e shqiponjës. Fisnikëria e linjës shqiptare tregohet nga kurora sipër kokës së shpendëve.

Kisha “Santi Pietro e Paolo”

Qyteza e Portkanunit (Portocannone Angeli) u rrafshua nga tërmeti i vitit 1456. Dhjetë vjet më vonë, më 1466, në vendin që ndodhet pranë qytetit të banuar nga latinët (afër varrezave të tanishme) u ndërtua nga emigrantët arbëreshë Kisha e Shenjtorëve Pietro e Paolo.

Kisha u kushtohet shenjtorëve mbrojtës të qytetit. Ajo ka një strukturë të thjeshtë, me një portal të vetëm hyrjeje. Fasada tregon një vend të vogël ku ndodhet statuja e Madonës së adhuruar.

Banorët arbëreshë të Portkanunit ishin katolikë të riteve lindore, një degë e të krishterëve ortodoksë që ishin afruar me të krishterët romakë, por që mundën të ruanin liturgjinë në greqishten e lashtë, si dhe disa karakteristika të ritit origjinal. Këngët janë të gjitha me origjinë bizantine. Në Italinë e Jugut kishte tashmë bashkësi katolike të ritit lindor, kështu që integrimi i popullsisë emigruese ishte më i thjeshtë, edhe pse me kalimin e viteve, ata shpesh u bënë objekt i përpjekjeve për latinizimin e detyruar. Grupet e emigrantëve përfshinin thujtë gjithnjë një prift dhe për këtë arsye, besimi fetar ishte një zë i rëndësishëm. Për një kohë të gjatë, madje martesat bëheshin gjithmonë vetëm midis anëtarëve të të njëjtit grup etnik, gjë që ndikonte në ruajtjen e shqipes arkaike. Ajo aktualisht flitet ende si dialekt, në disa zona të Abruzos, Pulias dhe të Kalabrisë.

Figura të shquara të Portkanunit:

Enrico Murichio

Portkanuni i kushtoi një pllakë në sheshin “Skënderbej” Enriko Murikios (Enrico Murichio), i cili u shqua për veprat e tij heroike. Ai u diplomua në degën e mjekësisë në vitin 1933 dhe u kualifikua për të ushtruar profesionin e mjekut. Më pas, u dërgua për të marrë pjesë në shkollën e aplikimit të shërbimit shëndetësor ushtarak në Firence, ku mori gradën e mjekut toger të dytë. Ai u caktua në Regjimentin e 23-të të Artilerisë, të vendosur në Trieste. Murikio luftoi me vetëmohim, derisa ra si hero e fushën e betejës.

Vincenzo Muricchio

Një tjetër personazh i spikatur i familjes së njohur shqiptare Murikio të Portkanunit është edhe Vinçenzo Murikio (Vincenzo Muricchio). Gjeneral dhe shpikës italian, ai bën pjesë në mesin e atyre studiuesve të ushtrisë, që mori pjesë në krijimin e pushkës së famshme “Carcano Mod 91”, armë simbol i ushtarit italian që nga Lufta e Madhe. Në vitet 1873-1878, Muricchio mori pjesë në “Kolegjin Ushtarak të Napolit” të atëhershëm, “La Nunziatella”, në të cilin tashmë veçohej si njohës ekspert i çdo arme, nga revolveri

deri te topat e fortesës së madhe. Sidoqoftë, pajisjet e atëhershme të armëve, të lindura nga ushtarët, ishin shumë të mëdha dhe pak funksionale për ta. Kalibri në përdorim (10.35 mm i pushkës Vetterli-Vitali 1870/87) kërkonte që ushtria të zotëronte të paktën 40-60 fishekë. Kjo ishte një ngarkesë me të vërtetë e tepërt për ushtrinë, e cila rezultoi fatale në betejën e Dogalit.

Nevoja për një kalibër më të vogël ndihej në të gjitha ushtritë e fuqive europiane dhe botërore, që dëshironin të rinovonin arsenalin e armëve, të paktën dy dekada të vjetra.

Muricchio, në kohën që ndodhej në Forli, u përkushtua me vull për zgjidhjen e këtij problemi dhe nisi studimin e thelluar.

Si pjesë e të njëjtit hulumtim që synonte municion më të lehtë, gjenerali me origjinë arbëreshe, në atë kohë vetëm 30 vjeç, u kujdes për përsosjen e sistemeve të kontrollit të fishekëve të prodhuar, nëpërmjet përdorimit të reflektuesve parabolikë, të cilët lejonin të shiheshin edhe papërsosmëritë më të vogla. Ai ishte, gjithashtu, përgjegjës për studimin e karabinëve të vjetra.

Don Nicola Campofreda

Don Nicola Campofreda lindi në Portocannone (CB) më 14 dhjetor 1794 (1) nga Nazario dhe Maddalena Musacchio, që i përkiste një familje të lashtë shqiptare. Ende shumë i ri, u bashkua me ushtrinë dhe bëri një karrierë të shpejtë atje. Në moshën 18-vjeçare Campofreda ishte një rreshter në legjionin krahinor, i pranuar më 1 shkurt 1812, për një periudhë 3-vjeçare, 2 muaj e 18 ditë.

Në moshën 21-vjeçare, u emërua nënkolonel i dytë në të njëjtin legjion krahinor, më 3 prill 1815, për 2 vjet 9 muaj e 19 ditë. Në moshën 24-vjeçare, ai u bë toger në regjimentin e ushtrisë, më 29 janar 1818, për 1 vit, 4 muaj e 25 ditë. Në vitin 1819, në moshën 25-vjeçare u emërua kapiten në regjimentin e Molises. Më 1813, fisniku Nicola shpëtoi mrekullisht nga një pritë e ngritur nga hajdutët.

Vardarellisët ishin një nga bandat më të njohura, veçanërisht në Molise, Capitanata dhe në Kalabri. Qeveria nuk ishte në gjendje t'i eliminonte këta kriminelë, të cilët vendosnin gjoba ndaj pronarëve

dhe nëse nuk ishin të kënaqur, ata hakmerreshin duke djegur të lashtat dhe duke vrarë bagëtinë. Duke mos i mundur ata, qeveria vendosi, me këta banditë, të formonte një skuadër mbi kuaj në shërbim të shtetit. Ky vendim i kushtoi thesarit 1900 dukatë në muaj. Pavarësisht pozicionit të tyre të ri, Vardarellisët vazhduan me abuzimet e tyre.

Don Nicola i kushtoi të gjitha energjitë kërkimit dhe kapjes së Vardelli-t, siç tregohet nga disa letra të ruajtura në arkivin e shtëpisë Campofreda. Kjo nuk ishte e lehtë, sepse Vardelli, duke ditur mirë territoret dhe vendet e fshehta midis maleve dhe pyjeve, lëvizte shpejt nga një krahinë në tjetrën. Nënkoloneli Don Nicola Campofreda, në nëntor 1816, për shkak të një sëmundjeje të papritur iu desh të kthehej në qytetin e lindjes, Portkanun. Në mesin e bashkëfshatarëve dhe ajrit të shëndetshëm të vendit, ai u shërua shpejt, i gatshëm për të rifilluar luftën për të siguruar qetësinë dhe paqen për banorët. Princi i Leporano, Marshalli i Campo-s dhe Komandanti i Provincës së Barit, e paralajmëroi Campofreda-n se Vardelli ishte parë më 3 janar 1817 në Guaraglione dhe e urdhëroi atë të lëvizte, me kolonën shqiptare, në Porcelino dhe Gravina (BA). Princi i Leporano-s i dërgoi dy letra të tjera nga Altamura më 4 janar 1817 dhe nga Gravina di Puglia (BA) më 6 janar të këtij viti.

Nazario Campofreda

Nazario Campofreda lindi më 1773 në Portkanun, një qytet me origjinë shqiptare, nga Niccolò dhe Cristina Carriero, me origjinë nga Campomarino. Ai u edukua sipas kanuneve të traditës shqiptare, ndjenja e nderit, lidhja e ngushtë me familjen, detyra e mikpritjes në shtëpi, edhe nëse ai kishte qenë armiku i tij, sepse shqiptari falte ofendimet ndaj familjes, por jo ato që i bëheshin mysafirrit në shtëpi. Dhe kur ishte e nevojshme, rrokte edhe armët.

Nazario Campofreda, kishte si detyrë të shkatërronte banditët në Contado të Molises, në Capitanata dhe në zonat fqinje. Ai gjithmonë vlerësohej nga qeveria për punën e tij. Campofreda kishte gradën Kapiten i Gardës Qytetare Provinciale dhe mori përsipër komandën e Legjionarëve të S. Paolo, Larino, Montecilfone dhe Serracapriola. U vra pabesisht.

Ndërtesat historike të Portkanunit

Pallati Muricchio

Të ruash një shtëpi historike, do të thotë ta mbrosh atë nga degradimi dhe kalimi i kohës. Të ruash jo vetëm strukturën arkitektonike, por edhe përmbajtjen e paçmuar, dëshminë e botës së brendshme dhe ekspresive artistike, si dhe momentin historik, politik e social të krijimit të tyre. Një nga ndërtesat më të vjetra dhe më luksoze është Pallati Muricchio, të cilin familja vendosi të ndërtojë në fund të shekullit XVIII. Sot ai është nën Mbrojtjen e Mbikëqyrjen e Trashëgimisë Kulturore.

Në këtë shtëpi banon ende një nga pasardhësit e fundit të familjes fisnike me origjinë shqiptare, Giovanni Battista Muricchio. Brenda mund të ndihet aroma e lashtë që vjen nga historia dhe që reziston me kalimin e kohës, duke u trashëguar brez pas brezi, për të mos u harruar. Ora e gjyshit, që qëndron me madhësi në sallë, menjëherë pas hyrjes, me lëvizjen e akrepave dëshmon ikjen e viteve të jetës fisnike arbëreshe. Kati përdhes përbëhet nga një derë e madhe, e cila dikur shërbente që të futeshin karrocet me kuaj.

Një atrium i madh shtrihet në mënyrë madhështore pasi kalon pragun, i cili të çon në mjediset që dikur përdorehin si depo dhe si stalla. Një shkallë imponuese të drejton në katin e parë. Dhoma të mëdha, me tavane të pikturuara me afreske, që ruhen ende të paprekura sot, falë përkujdesjes së pronarëve, si dhe biblioteka e madhe, qilimat, tapetet dhe perdet e trasha karakterizojnë orënditë e brendshme. Ashtu si në të kaluarën, portretet e paraardhësve qëndrojnë të varura në mure.

Pallati Cini-Tanasso

Pallati u ndërtua me urdhër të baronit Diego Cini në shekullin XVIII. Ai u restaurua nga familja Tanasso më 1915, e cila e zotëron atë edhe momentalisht.

E vendosur në qendër të bërthamës urbane, ndërtesa ka një mur, i cili e bën atë të duket si një kala. Plani i ndërtesës është katërkëndor dhe qëndron në tre nivele: kati përdhes, përfshin hapësirën përreth

oborrit qendror dhe përdoret si depo; kati i parë, i quajtur “kati fisnik”, është i ndarë në shumë dhoma, të pasura me afreske dhe me mobilje; kati i dytë, ka një hyrje të madhe, që mbikëqyr kopshtin nga pjesa lindore.

Hyrja në ndërtesë ka një afresk mitologjik, të cilin e pikturoi në vitet '30 Ugo Sforza, nga Terame. Në dhomën e ndenjes gjendet gjithashtu një afresk me temë mitologjike, ndërsa në studio paraqitet figura nudo e një mashkulli, e cila i atribuohet Ippolito della Fedra nga D'Annunzio.

Pas derës së studios, përveç stemës së familjes Cini është edhe një portret i Matteo Tanasso-s fëmijë, pranë së ëmës, Rosa Bucco do Larino.

Pallati Tanasso mbrohet në përputhje me ligjin e ri nr. 1089, “si shprehje e një bukurie dhe me vlera artistike të arkitekturës së Molises së shekullit XVII. Kjo shtëpi përbën një shembull të rrallë të një shtëpie arbëreshe aristokratësh, të ruajtur në mënyrë të përsosur”.

7.2. CAMPOMARINO (KËMARINI)

Mbi detin blu të Adriatikut, jo shumë larg tij, shtrihet një tjetër qytezë e bukur arbëreshe, e quajtur Këmarini (Campomarino). Kjo është një qytezë me rreth 7800 banorë, e zhytur midis blusë së qiellit dhe detit, në një lartësi 52 metra, në shpatin ku rrjedh lumi Biferno. Për arbëreshët e Këmarinit, pasi u vendosën këtu në këto troje, rrëfëhet prejardhja e tyre nga një legjendë e lashtë. Ajo thotë se qyteti u themelua nga Diomede, heroi mitik homerik, i cili pas kthimit nga lufta e Trojës do të martohej me vajzën e mbretit Dauno. Varri në ishujt Tremiti, i quajtur Diomede, ruhet nga zogjtë detarë me të njëjtin emër.

Sipas fakteve historike, pas tërmetit të vitit 1456, i cili shkatërroi këto zona, Këmarini u popullua nga emigrantë shqiptarë të udhëhequr nga Dimetrio Mega. Shqiptarë të tjerë erdhën më vonë, të ftuar nga duka Andera di Capua, feudal i cili u vendos në Këmarini.



Liliana Corfiati, artistja e shumë muraleve

Liliana Korfiati (Liliana Corfiati) është një personalitet i këtij vendbanimi, e cila nëpërmjet muraleve të saj në këtë qytezë, tregon skena nga jeta arbëreshe dhe një pjesë të Arbërisë në këtë zonë që gjendet në brendësi të çizmes italiane. Në murale shfaqen me ngjyra të ndritshme, elegante dhe fisnike kostumet arbëreshe të këtij populli, që emigroi në Këmarini, duke lënë shtëpitë e tyre në fund të shekullit XV për të shpëtuar nga tmerri i pushtimit osman në Ballkan.

7.3. URURI (RÛRI)

Ururi (ose siç thuhet në arbërisht, Rùri) është një qytezë arbëreshe me rreth 3000 banorë, që ndodhet në një rrafshnaltë të ulët në Molise, në një kodër në të djathtë të rrjedhës të përroit Cigno. Përroi i Çinjos (Cigno-s) konsiderohet si një rrjedhë ujore e bekuar, pasi shpëtoi të gjithë popullsinë në periudhat e thatësirës. Në vitin 1456 pati dy tërmete të forta, i pari më 5 dhjetor, tjetri më 30 dhjetor.



Tërmetet shkaktuan vdekjen e disa njerëzve dhe shkatërruan shumë shtëpi, duke e bërë Rurin një qytetë fantazmë. Në gjithë këtë mjerim, Ipeshkvi Lord dhe Baroni i Rurit u përpoqën të ndihmonin ata që mbetën gjallë. Ata u përpoqën të shërojnë sadopak të mbijetuarit, duke i afruar ata pranë besimit, si shpresa e vetme pas kaq shumë fatkeqësish.

Fshati i Rurit u popullua gjatë valës së dytë të emigracionit të arbëreshëve. Ururi, ose Ruri, rrjedh nga etimologjia e fjalës “aureolë”. Në marrëveshjen papnore të Lucius III të vitit 1181, quhet “Aurora”, e cila ndër shekuj ka pësuar ndryshime morfologjike, deri në formën aktuale, që u përdor për herë të parë në shekullin XVIII. Shumë studime janë përpjekur të hedhin dritë mbi kuptimin origjinal të emrit të kolonisë shqiptare, të vendosur më 1456, nën kujdesin e ipeshkvit Monsignor De Miseriis, të dioqezës së Larinos. Këto territore kaluan në pronë shtetërore, rreth vitit 1785, si pasojë e shfuqizimit të ligjit feudal.

Kisha e Trinisë së Shenjtë, fillimisht brenda qytetit, qëndroi në të njëjtin vend me kishën aktuale, të ndërtuar rreth shekullit XVIII me titullin e Santa Maria delle Grazie. Gjatë kësaj periudhe ndodh edhe emigrimi i arbëreshëve në Ruri.

Familja Giammiro u vendos në Aurora (emri i lashtë i Ururi-t). Dokumentet raportojnë vitin 1461 kur familja fisnike, së bashku me një grup të madh shqiptarësh, qëndruan pikërisht në Ruri. Nga ky moment, Aurora pati ndryshimet e para thelbësore. Shtëpitë e

ndërtuara rreth manastirit Benedikti filluan të krijojnë një fshat të vërtetë. Pallati Giammiro u ndërtua në qendër të fshatit, në sheshin e vetëm, ku u ndërtua edhe kisha. Duhet kujtuar se rreth gjysmës së dytë të viteve 1300, Ururi u godit nga fatkeqësi të shumta, murtaja, luftërat dhe tërmetet, të cilat e shfarosën popullsinë aq shumë sa Mbretëresha e Napolit, Giovanna II, u detyrua të lehtësojë taksat për t'i ndihmuar banorët.

Në vitin 1686-1703, popullsia e Rurit humbi ritin bizantin

Në vitet 1686-1703, popullsia e Rurit humbi ritin bizantin. Sot, situata është ndryshe, sepse ndihet rigjallërimi i gjuhës dhe i gjakut të shprishur. Ata kanë ruajtur gjuhën e të parëve, padyshim të përzier në leksik dhe gramatikë me dialektet vendase dhe gjuhën italiane. Si të gjitha fshatrat e asaj periudhe, edhe popullsia shqiptare që erdhi ishte nën sundimin e feudalëve. Me mund e sakrifica, brez pas brezi, arbëreshët e vendosur në këto troje e kanë ruajtur gjuhën.

Gara e buajve, një nga festat kryesore

Më 3 maj në Ruri zhvillohet gara tradicionale e karrocave që tërhiqen nga qetë. Thuhet se e ka origjinën nga ana tjetër e Adriatikut, nga Shqipëria, nga ku arbëreshët e Rurit e morën me vete.

“Cursa dei Carri” është një garë e karrove, të cilat tërhiqen nga dy buaj dhe quhet gara e qerreve. Gara zhvillohet nga dy ose më shumë grupe, që përfaqësojnë lagjet e qytezës, të cilat përshkojnë rreth 3.5 km me qerre. Në mbyllje, qetë dhe kalorësit bekohen para kishës së S. Maria delle Grazie. Ai që fiton garën mbart në procesion beliken prej druri të Kryqit të Shenjtë.

Kodi i gjakmarrjes

Historia e Rurit lidhet ngushtë me masakrën e Vardarellit. Të udhëhequr nga një ish-mbrojtës i ushtrisë mbretërore, Gaetano Meomartino, Vardarelli kishte formuar një bandë hajdutësh që terrorizuan Daunian dhe vendet fqinje me vrasje, vjedhje dhe plaçkitje. I amnistuar nga ushtria mbretërore, së cilës ai ishte

përpyetur vazhdimisht t'i zhdukej, banda Vardarelli u bë një organ i veçantë. Banda u shtyp më 19 prill të vitit 1818, në sheshin e qytetit, nga një breshëri zjarri e anëtarëve të një familje, të cilët donin, veç të tjerave, të merrnin hak në përputhje me rregullat e kodit zakonor të nderit të Lekë Dukagjinit. Masakra e Vardarelli-t shfaqet në imagjinatën kolektive me skicë legjendare.

Ndërtesat historike të Rurit

Pallati Giammiro

Pallati Giammiro ka një strukturë shumë të thjeshtë, me lartësi të kufizuar, në krahasim me pallatet dukale të vendeve të tjera të Molises. Plani mjaft i rregullt katërkëndësh theksohet nga veshja e betonit të armuar, e cila nuk është shumë e bukur për t'u parë. Fasada kryesore përbëhet nga një derë qendrore hyrëse, e përkufizuar nga një kornizë prej guri, që i jep një pamje të caktuar vetë derës. Në të djathtë të hyrjes kryesore ka një derë tjetër tre hapa larg. Në të majtë të derës ndodhet "pundi Giamirs", ura e vjetër që lejonte hyrjen antike në shtëpinë e fermës. Pallati i familjes Giammiro, që nga fillimi i saj, ishte ndër ndërtesat më elegante në Ruri. Brenda, pallati Giammiro ndahet në katin përdhes, katin e parë dhe një papafingo. Kati përdhes përbëhet nga një dhomë e madhe, e cila përmes një shkalle, të çon në katin e parë. Kati i parë përbëhet nga katër dhoma, njëra prej të cilave ka një ballkon të madh, i cili mbikëqyr sheshin direkt. Fatkeqësisht, sot ndërtesa duke qenë e pabanuar, nuk është ruajtur mirë.

Kisha Santa Maria di Grazia

Kisha Santa Maria di Grazia u ndërtua në vitin 1700 prej arbëreshëve. Në vitin 1962 ra një tërmet i fortë në Ruri, që i shkaktoi dëmtime shumë të mëdha kishës. Me vullnet dhe, mbi të gjitha, me besim, arbëreshët e Rurit e restauruan kishën pas 39 vjetësh dhe kisha u hap në vitin 1999.

7.4. MONTECILFONE (MUNXHUFUNI)

Montecilfone është pjesë e krahinës së Molise-s, ku u vendosën emigrantët e parë shqiptarë gjatë shekullit XV. Popullsia ishte me origjinë fshatare, që merrej me bujqësi dhe blegtori. Shumë shpejt, arbëreshët bonifikuan tokat, ndërtuan shtëpi, ndërtuan kishën që e quajtën “San Pietro” dhe më vonë, “San Giorgio”, ku u praktikua riti bizantin deri në vitin 1696. Qyteza shtrihet në një lartësi 405 metra mbi nivelin e detit. Arbëreshët e rinisën jetën me mund dhe djersë në këtë qytezë midis mushkërive të pyllit Courundoli. Dokumentet tregojnë se Montecilfone quhej më parë “Mons Gillani”, i themeluar në vitet 1102.

Me interes për nga pikëpamja artistike dhe arkitektonike është kisha e vetme në vend, pikërisht kisha “San Giorgio”, e cila u ndërtua në vitin 1861 dhe u rindërtua mbi të mëparshmen. Kisha ka një strukturë drejtkëndëshe, me një fasadë të thjeshtë guraleci të suvatuar në të bardhë, e pajisur me një portal dhe një dritare okulare sipër, ndërsa timpani i kornizës është trekëndësh. Kambana është elementi i vetëm origjinal i kishës, e pajisur me një hark të ngushtë në bazë. Kisha ka vetëm një navetë, e zbukuruar me një dritare xhami të njollosur në murin e altarit, ku mund të shihet Madonna Grande “Shemrja Madhe”.

Tek-tuk, rrallë, ndihet jeta arbërore kur banorët e Monteciflone-s këndojnë arbërisht, kur dikush vesh bluzën me simbolin e flamurit



shqiptar, e një tjetër të përshëndet në gjuhën shqipe, apo kur sheh se në të dielën e fundit të korrikut zhvillohet Paliodi San Giorgi.

Falë grupin folklorik “Kamastra”, si dhe shumë aktiviteteve letrare (“Il caffè linguistico letterario”), ndien se gjaku i Arbrit jeton ende. Është dëshira për rigjallërimin e gjuhës shqipe, traditave, folklorit arbëresh, apo të identitetit kulturor të atyre që kërkojnë rrënjët dhe zemrën e një atdheu të braktisur.

Frèngaljt (Torre Francara)

Kolonia më e vjetër në Molise është *Torre Francara*, ose Francano (arbërisht *Frèngaljt*), gjurmët e së cilës mund të shihen tre kilometra në juglindje nga Montecilfone (Contrada Macchia Francara). Më 1454, në këtë zonë pati 88 zjarre dhe banohej nga shqiptarë. Këta shqiptarë nuk ishin të arratisur nga Molise, por ishin stradiotë në shërbim të Baronit të Larino-s. Në të vërtetë, territori i tyre ishte një pjesë integrale e kolonisë së San Leucio.

KAPITULLI VIII: NGULIMET ARBËRESHE NË PULJA

Rajoni i Puglia-s është pjesa bregdetare e Italisë më e afërt me bregdetin shqiptar, Arbërinë e shekullit XV. Distanca e saj më e shkurtër, midis Vlorës dhe Otrantos në provincën e Leçes, nuk i kapërcen 72 kilometra det. Si e tillë, Otranto ishte pika më e mundshme e tokës për emigrantët shqiptarë, i cili u bë më intensiv në mesin e shekullit XV, kur Shqipëria (1478-‘79) u pushtua nga ushtritë osmane. Qindra e mijëra emigrantë nga këto vende morën rrugët e mërgimit përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe Jonit për të shpëtuar nga pushtimi dhe masakrat e osmanëve.

Republika e Raguzës, në Dalmaci, përfundoi duke mbyllur dyert për të arratisurit e shumtë, edhe për shkak të urisë që kishte prekur rajonin, aq sa shumë shqiptarë u nisën drejt bregdetit të Puglia-s. Ata zbarkuan pa ndërprerje, për dekada të tëra.

Shqiptarët e tjerë zbarkuan në Puglia në vitin 1461, kur Skënderbeu erdhi për të ndihmuar pasardhësin e mbretit Alfonso të Napolit, Ferdinando I të Aragonës, për të luftuar rebelimin e feudalëve vendas. Pasi ndihmoi mbretin e Napolit, Skënderbeu u shpërblye me territore në brigjet e Adriatikut, si Trani, San Giovanni Rotondo dhe Monte Sant Angelo, në të cilat u vendosën një pjesë e konsiderueshme e luftëtarëve të tij, dhe më pas familjet e tyre.

Kështu, 112 vendbanime arbëreshe kanë lindur në të gjitha krahinat e Puglia-s: 17 në provincën e Barit; 32 në provincën

e Foggias; 5 në provincën e Barletta-s, Andria-s dhe Trani-t; 11 në provincën e Brindisi-t; 23 në provincën e Taranto-s; 24 në provincën e Leçes. Ishte kjo periudhë (fondi i shekullit XV dhe fillimi i shekullit XVI) që pa lindjen e termit “Albania Tarantina”, duke iu referuar zonës Jono-Tarantine, e cila formonte një territor kompakt me shumë vendbanime shqiptare afër njëri-tjetrit. Quhet edhe “Albania Salentina”, për shkak të vendbanimeve të shumta arbëreshe në Salento, “thembra” e Italisë që ndan detin Adriatik dhe Jon, e cila përfshin krahinat e Lecce-s, Brindisi-t dhe Taranto-s. Karakteristika më tipike e emigrantëve në këtë periudhë ishte lëvizja e tyre e pandërprerë nga një vend në tjetrin, në kërkim të vendeve dhe kushteve më të mira për ndërtimin e jetës së tyre në tokën ku kishin zbritur. Ata mbetën përgjithësisht në grupe të mëdha, por edhe si familje të vogla. Këto familje u vendosën në periferi të qyteteve apo në fshatrat italiane dhe, duke qenë të paktë në numër, u përziën dhe u asimiluan me vendasit, duke humbur identitetin brenda disa dekadave.

Fluksi migrator i fundit të shekullit XIII, përveçse drejt Kalabrisë, ishte njëkohësisht edhe drejt brigjeve më të afërta të Pulias. Pa lënë gjurmë arkivore, për të shpëtuar nga zgjedhja e feudalëve vendas, që nga vitet 1270 shumë shqiptarë u arratisën në Puglia pas tërmetit të Durrësit.

Gjithashtu, në vitin 1461, reparti me 2800 kalorës, të cilët kishin shkuar në ndihmë të mbretit të Napolit, nuk u kthyen më në vendin amë, por qëndruan në Itali, të shpërndarë në disa komuna në Pulias.

Në verën e vitit 1462, pas fitores së ushtrisë shqiptare kundër aleatëve të kontit Orsini, në betejën pranë qytetit Troia në provincën e Foggias, mbreti Ferrante I e konsolidoi pushtetin dhe për të shpërblyer kontributin e Skënderbeut, u dhuroi feudet e San Giovanni Rotondo-s, Monte Sant Angelo-s, Terni-t etj., të cilat nga ajo kohë janë prona të familjes Kastrioti.

Në këto komuna u vendosën kalorësit shqiptarë dhe disa pjesëtarë të familjes së Gjergj Kastriotit. “Nga 60 familje shqiptare, që u vendosën në vitin 1462, në Komunën e Faggiano-s në Puglia, në

vitin 1545, u bënë 190 familje. Në vitin 1560, komuniteti arbëresh kishte 500 familje, madje me dekret mbretëror ishin përjashtuar nga taksa e oxhakut. Si pasojë e epidemive, luftërave dhe migrimit të brendshëm, në vitin 1669, në Faggiano mbetën 123 familje arbëreshe”.¹²⁶

Në këto troje të reja, sidomos aty ku u vendosën si fise dhe në grupe familjesh, shqiptarët i ruajtën traditat, besimin ortodoks, madje në shumicën e këtyre komunave, banorët flasin ende gjuhën e të parëve, arbërishten.^{127*}

8.1. NGULIMET ARBËRESHE NË RAJONIN E FOXHAS

Edhe krahina e Foxhas (Foggia-s), e njohur në shekullin XV si “Capitanata”, ishte vendi i vendbanimit të arbëreshëve, ku qytetet e Chieutit (në arbërisht: Qefti) dhe Casalvecchio di Puglia (në arbërisht: Kazallvechio) ekzistojnë edhe sot. Ndërsa në 30 vende të tjera, ajo ende mbetet pjesë e historisë dhe e kulturës së tyre. Të 30-të vendbanimet janë si më poshtë: Foggia, Accadia, Apricena, Biccari, Bovino, Carpino, Casalnuovo di Monterotaro, Castelluccio dei Sauri, Castelnuovo della Daunia, Deliceto, Faeto, Ischitella, Lesina, Lucera, Manfredonia, Monteleone di Santel Angelo, Panni, Peschici, Poggio Imperiale, Rignano Garganico, Rodi del Gargano, San Giovanni Rotondo, San Paolo di Civitate, San Severo, Serra Capriola, Torremaggiore, Vico del Gargano, Vieste, Volturino.

¹²⁶ Fr. A. Primaldo Coco, *Faggiano – Primo casale albanese nel Tarantino*, Taranto 1930, f. 34.

^{127*}Në vitin 1866, gjatë një vizite në Rokaforxata (Roccaforzata), një historian takoi një arbëreshe të moshuar, e cila këndonte disa këngë në gjuhë shqipe dhe njëra prej tyre ishte kënga e Shën Lazarit, të cilën pasi e dëgjoi disa herë, ai e transkriptoi dhe e botoi. Teksti i këngës është si më poshtë: “O Zoti, madhe Zoti / Se ka deka Lazarini / E Zoti nenja gjender / Vemmi Eklishi / E shohu Lazarini / E thirti Lazari ngridu /E Lazari ngridi uperbissi / neng pavi, neng favi /neng keshi. Transkriptimi në shqipen e sotme: O Zot, i madhi Zot / Ka vdekur Lazari / E ti Zot nuk u gjende / Ne shkojmë në Kishë / Të shohim Lazarin / E thërrasim Lazar ngrihu / Dhe Lazari u ngrit në gjunjë / Nuk shihte, nuk fliste, nuk qeshte/.

8.2. MONTE SANT'ANGELO

Më 1464, Ferdinandi I i Aragonës, mbreti i Napolit, i dha si pronë Gjergj Kastriotit, dukatin e Monte Sant'Angelo-s, i cili përfshinte edhe San Giovanni Rotondo-n. Më pas, në vitin 1484 Gjon Kastrioti, djali i Skënderbeut kërkoi nga mbreti i Napolit shkëmbimin e këtyre dy territoreve me tokat e Soletos dhe të San Pietro-s në Galatina (afër Lecce-s), kërkesë e cila iu realizua.



8.3. CASALVECCHIO (KASALLVEQI)

Kasallveqi i Puljas u popullua midis shekujve XV-XVI nga shqiptarët që erdhën në Itali, pas vdekjes së heroit, Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe pushtimit osman. Popullsia ruan edhe sot identitetin etnik, i cili buron nga ruajtja e zakoneve, fesë, gastronomisë dhe kulturës, të trashëguara gojarisht, e të ruajtura me ngulm edhe nga komuniteti shqiptar.

Casalvecchio di Puglia është një qytet i vogël në Dauno



Subappennino Veriore, i cili ndodhet midis qyteteve të afërta Casalnuovo Monterotaro, Castelnuovo e Daunia.

Fshati ngrihet pothuajse 500 metra mbi nivelin e detit. Historia e Kasallveqit është e njohur vetëm nga shekulli XVI e në vijim, sepse e gjithë kujtesa e mëparshme humbi.

Në vitin 1461 ra një tërmet i fuqishëm dhe këto zona u populluan vetëm pas këtij viti nga një grup emigrantësh shqiptarë, të cilët u larguan nga atdheu gjatë pushtimit osman. Nuk është rastësi që Kasallveqi është një nga të ashtuquajturit “ishuj gjuhësorë”, ku banorët e moshuar ende flasin arbërisht.

Kultura bizantine është një tjetër referim i identitetit të tyre. Casalvecchio di Puglia qëndron krenare, me “diversitetin e saj”, duke filluar nga linjat e bardha të kishës së shekullit XVI të Shenjtorëve Pjetër dhe Pal, e ndërtuar me urdhër të Andrea di Capua, dukës së Termolit. Ajo u hap për adhurim vetëm në vitin 1713 nga kardinali Orsini, i cili priti me nderim mbërritjen e një vepre arti me vlera të çmuara: Madonna del Carmelo, në kanavacë, nga Michelangelo San Marco.

Torre dei Briganti

Torre dei Briganti është ndërtuar në shekullin XI. Nuk ka shumë të dhëna për këtë kullë interesante nga pikëpamja artistike dhe arkitekturore. Janë disa ndërtesa mesjetare si “Kulla e brigandës”, që ndodhet afër varrezave dhe “Casone della Sgurgola”. Kjo e fundit ishte një kullë arbëreshe, ku sipas rrëfenjave ajo shërbente si pikë vëzhgimi gjatë periudhës së saracenëve, e cila qëndron në rrugën krahinore që bashkohet me Casalnuovo në Torremaggiore.

8.4. CHIEUTI (QEFTI)

Chieuti, ose siç i thotë arbëreshët *Qefti*, gjendet në provincën e Foxhas. Shqiptarët e gjetën të themeluar këtë vend, që më parë ishte qyteti antik dhe njihej me emrin *Cliternia Frentana*. Qyteti antik u shkatërrua nga gotët (fis i vjetër gjerman) në vitin 495 pas Krishtit dhe u rithemelua midis viteve 1461 dhe 1470, kur një numër i madh i shqiptarëve u vendosën në Pulja. Kjo ishte një bashkësi arbëreshe kompakte, ku përdorimi i arbërishtes u konsolidua qysh në fillim brenda Qeftit dhe ende përcillet brez pas brezi për të ruajtur kulturën antike të këtij komuniteti.

Kieuti (Chieuti) është një qendër e vendosur në 225 metra lartësi. Zona ngrihet mbi një kodër me pamje nga deti Adriatik, midis rrjedhës Saccione dhe lumit Fortore. Ndër shekuj, kjo tokë u bë pronë e disa familjeve feudale, të tilla si: Carafa, Guevara dhe Gonzaga.

Kisha e San Giorgio Martire-s

Ndërtesa kryesore e adhurimit është kisha famullitare e San Giorgio Martire, që është shenjtja mbrojtëse e qytetit. Brenda ka një kanavacë, që përshkruan Shën Gjergjin dhe dragoin, një vepër e piktorit Alessio D’Elia dhe datuar pas vitit 1746. Këtu ruhet edhe vepra (1534) e piktorit Francesco da Tolentino, që përshkruan Madonna delle Grazie-en. Është vërejtur, gjithashtu, prania e një artifakti prej druri, i cili përshkruan Madonën dhe fëmijën, i cili

mendohet se i përket prodhimtarisë artistike të skulptorit Paolo Saverio di Zinno.

Festa patronare e San Giorgio-s

Festa patronare e San Giorgio-s zhvillohet çdo vit në datat 21-23 prill. Më 22 prill organizohet “Palio di San Giorgio Martire”, i njohur gjithashtu si “Corsa dei Buoi”, në të cilin sheh banorë nga të katër anët e qytetit që sfidojnë njëri-tjetrin në “karresë”¹²⁸.

Gara e qeve

Një ngjarje e spikatur dhe karakteristike në Qefti është gara me qetë e racës podolica, përgjatë një shtegu 4 km e gjysmë, e cila zhvillohet gjatë festës patronare të San Giorgio-s, në datat 22 ose 23 prill të çdo viti. Gjatë garës, një karrocë e ngarkuar me degë dafine tërhiqet nga katër palë qe.

Përgatitjet për garën janë shumë të gjata: gjatë vitit trajtohen kuajt, ndërsa në 21 mbremje kafshët futen në fshat, duke simuluar garën. Qetë pastaj sillen në stallat e Partitit (rrethet e qerreve), ku mbikëqyren me kujdes për të mos lejuar që ata të mashtrohen nga kundërshtarët. Në mëngjesin e 22-të, qetë lahen e zbukurohen dhe pasi kryetari i komunës nxjerr rendin e fillimit, vargu i qeve shkojnë drejt kishës për të marrë bekimin. Turma ndjek shigjetat, ndërsa burrat me kuaj shtyjnë qetë me shkopinj të gjatë. Gara përfundon në rrugën kryesore, ku vagonët vazhdojnë me radhë. Qëllimi i garës është të sigurojë një kapelë shumëngjyrësh që fituesit do ta veshin ditën tjetër kur të sjellin në procesion simulacrum-in e shenjtorit.

Pallati Maurea

Palazzo Maurea gjendet në *Corso San Giorgio*, rreth 50 metra larg hyrjes në portën veriore të qendrës së vjetër të banuar. Vlerësohet se është ndërtuar që nga themelimi i fshatit (shek. XV-XVI) nga familja Maurea, me origjinë fisnike shqiptare, e cila shquhej për prestigjin e madh, bujarinë dhe vlerat patriotike. Në ditët e sotme,

¹²⁸ “karresë”, quhet gara e karrocave të tërhequra nga qetë. Kjo është një garë e përvitshme që organizohet në këtë ngulim arbëresh. (Shënim i redaktorit)

kjo ndërtesë është shndërruar në shtëpinë e *Muzeut të Traditave Arbëreshe*.

Qefti është i njohur në kulturën shqiptare, pasi në këtë ngulim u gjet Kodikun e Kieutit, që mban datën 1737.^{129*}

Marina di Chieuti

Ngulimi arbëresh i Qeftit është i famshëm edhe për vijën bregdetare *Marina di Chieuti*, e vendosur në shpatet Gargano, ku plazhet me rërë përbëjnë një peizazh të mrekullueshëm dhe paqësor. Kieuti, për më tepër, është qyteti arbëresh më afër detit dhe gjatë stinës së verës është ndër plazhet më të frekuentuara.

8.5. SAN MARZANO DI SAN GIUSEPPE (SHËN MARCANI)

San Marzano di San Giuseppe, ose siç njihet në arbërisht me emrin *Shën Marcani*, është një qytet arbëresh me afro 9000 banorë në provincën e Tarantos në Pulia. Sot ka mbetur si i vetmi vendbanim në mesin e 14 vendeve të themeluara, ose të rithemeluara nga shqiptarët (Belvedere estinto, Carosino, Civitella (sot: Masseria Civitella), Faggiano, Fragagnano, Monteiasi, Montemesola, Monteparano, Roccaforzata, San Crispieri (sot një fraksion e Faggiano), San Giorgio Ionico, San Martino (i zhdukur) dhe Kamera Santuario Santa Maria (tani pjesë e Roccaforzata).

Në ditët e sotme, San Marzano di San Giuseppe (*Shën Marcani*),

¹²⁹ Michele Marchianò, *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*. Foxha, 1908; f. 86-89.

*Dorëshkrimi i Kieutit është një nga dorëshkrimet e para të këngëve popullore arbëreshe. U gjend në Kieuti të Kapitanatës (Itali e jugut), prej nga mori edhe emrin. Autori i këtij dorëshkrimi është Nikollë Filja. Përmban 5 kapituj me shkrime dhe poezi të ndryshme. Në kapitullin e tretë të dorëshkrimit jepen 18 këngë popullore, balada, këngë historike dhe lirike popullore, të cilat i përkasin folklorit të arbëreshëve të Sicilisë. U zbulua dhe botua për herë të parë më 1908, nga Mikel Markiano, në “Këngë popullore shqiptare”. Shënimet e fundit në dorëshkrimin e Kieutit janë bërë më 1737, që mbahet edhe si kohë e datimit të tij. (Shënim i redaktorit, marrë nga *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vol. 1, AKSH, Tiranë, 2008-2009)

së bashku me Casalvecchio di Puglia (Kazallveqi) dhe Chieuti (Qefti) janë qendrat e vetme arbëreshe të krahinës së Puljes. Shën Marcani është një qytet i populluar nga shqiptarët në vitin 1530. Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në vitin 1468, Demetrio Capuzzimati (i njohur edhe si Dhimitër Këpucmadhi) kapiten i njohur i tij që ishte ndeshur në betejën e Krujës, u vendos në Taranto. Duke qenë se ishte në shitje feudi i Shën Marcanit, atëherë ai ia bleu për 700 dukatë kardinalit Popmeu Colonna, në korrik të vitit 1530. Kapiteni Demetrio Capuzzimati, i gëzuar që arriti të gjente strehë për bashkëpatriotët e tij, thirri në territorin e San Marzanos, një numër të madh familjesh shqiptare, të cilat u vendosën aty për një periudhë 10-vjeçare. Të gjitha këto familje arritën të marrin nga një copë toke për të jetuar. Në vitin 1639, feudi i San Marzanos iu shit Francesco Lopezit, i cili kishte për grua Elena Kastriotin dhe kështu, pati edhe zotërues të tjerë si Gjergj Kastrioti (Giorgio Castriota) dhe Xhovana Kastrioti Skënderbeu (Giovanna Castriota Skënderbeu) deri në vitin 1744.

Më pas, ajo që mbeti nga feudi i San Marzanos, u udhëhoq nga Giovanni Casalini dhe Donna Eanda, të cilëve iu takon merita e restaurimit të Pallatit Marchesale, e cila njihet si qendra e parë e shqiptarëve në San Marzano.

Në këtë qytet, ka edhe një muze të posaçëm etnografik, i cili ruan edhe sot e kësaj dite sende dhe momente të botës materiale e shpirtërore, të krijuara enkas nga familjet e hershme arbëreshe.

Marchesale Palazzo

Marchesale Palazzo është një pallat që ngrihet në vendin ku dikur ishte një ndërtesë e shkatërruar, për shkak të bastisjeve dhe të plaçkitjeve. Ndërtesa u ngrit në vitin 1530 nga Baron Demetrio Capuzzimati, pikërisht në kufirin midis dy çifligjeve, Li Rizzi-t dhe San Marzano-s. Më vonë, kjo ndërtesë kaloi në pronësi të familjes së Kastriotëve, të cilët e ndërruan pamjen e këtij pallati. Qysh prej vitit 1700, kjo ndërtesë nuk e ndërroi fizionominë e vet dhe është ajo që shihet edhe në ditët e sotme.

Kisha e San Gennaro-s

Kisha e vogël e San Gennaro-s paraqet një vepër elegante dhe imponuese të stilit të Rilindjes, tipike për shekullin XVI-XVII. Të dy ndërtesat, kisha e San Gennaro-s dhe Pallati Marchesale janë të lidhura me njëra-tjetrën nga një korridor që, duke filluar nga dera e kalasë, të çon në kishën e vogël të San Gennaro-s, ku zotërit feudalë donin të merrnin pjesë në festimet fetare.

Kisha bizantine

Arbëreshët që u vendosën këtu themeluan vendbanimin e tyre të parë në këtë fshat, duke gërmuar një vend shkëmbor për ta kthyer në tokë të punueshme. Kisha u ngrit po ashtu prej tyre dhe konsiderohet si vendi më i rëndësishëm, në të cilin arbëreshët luten në gjuhën shqipe, qajnë në gjuhën shqipe, martohen dhe trashëgohen duke dhënë premtime për dashurinë e përjetshme.

“Zjarri i madh”

Në San Marzano di San Giuseppe një nga ritet kryesore është “Zjarri i madh”, i cili organizohet çdo 18 mars. Ky rit ka marrë shkas nga një stuhi e 18 marsit të vitit 1866, e cila shkatërroi vreshtat, pemishtet dhe ullishtat. Kjo datë përkujtohet duke djegur tufa degësh deri në dhe duke e mbajtur zjarrin e ndezur si shenj të pastërtisë e të rilindjes.

Demetrio Capuzzimati

Një figurë e shquar e Shën Marcanit ishte Demetrio Capuzzimati, kapiteni i familjes Kastrioti, i cili siç e përmendëm më lart themeloi këtë ngulim arbëresh dhe ndërtoi edhe pallatin e madh Marchesale, që qëndron në pikën më të lartë të vendit. Ai ndihmoi një numër të madh refugjatësh shqiptarë, që të vendoseshin në San Marzano dhe të ndërtonin jetën në tokat e këtij vendi.

KAPITULLI IX: SICILIA

9.1. FILLIMET E EMIGRIMEVE NË SICILI

Pas luftërave të Vespro-s (1282-1302), shumë shtëpi të fshatrave në Sicili u shpopulluan. Një fenomen i tillë kishte ndodhur në Mezzojuso, Palazzo Adriano dhe në zonën ku, më vonë, do të ngrihej “Piana dei Greci”. Mungesa e fermerëve ishte kritike dhe, veçanërisht në pjesën perëndimore të ishullit, kishte pak banorë. Fshatarët ishin të domosdoshëm për të kultivuar territoret e braktisura. Përcaktimi i momentit të themelimit të vendbanimeve arbëreshe të Sicilisë, sipas të dhënave të përcjella nga historiani sicilian, Tommaso Fazello (jetoj nga viti 1498 deri më 1570) nis në një hark kohor midis vitit 1453 (rënia e Kostandinopojës) dhe vitit 1482 (miratimi i kapitullimeve të Palazzo Adriano-s). Në këtë periudhë duhet të jenë krijuar vendbanimet e para shqiptare në Sicili.

Në Sicili, shqiptarët u pritën mirë në ato territore ku murtaja e vitit 1347 dhe malaria kishin përgjysmuar popullsinë, duke lënë shumë vendbanime të shpopulluara dhe të braktisura. Kështu lindën kolonitë e para shqiptare të Sicilisë. Ato mund t'i ndajmë në dy lloje: Së pari, kolonitë e lindura nga ripopullimi i fermave të braktisura, përkatësisht: Palazzo Adriano (në arbërisht *Pallaci*), themelimi i të cilit daton në vitin 1482; Mezzojuso (në arbërisht *Munxifsi*), themelimi i të cilit daton në vitin 1490 deri në vitin 1501; Contessa

Entellina (në arbërisht *Kundisi*), përfundimi i të cilit daton nga viti 1520. Së dyti, ishin fshatra që u themeluan nga arbëreshët, të tilla si: Biancavilla (në arbërisht *Callicari*), themelimi i të cilit daton në vitin 1482 dhe kapitullimi më 1488; Piana dell’Arcivescovo (sot “Piana degli Albanesi”, ose *Hora e Arbëreshëvet* në arbërisht), themelimi i të cilit daton nga viti 1488, si dhe San Michele di Ganzaria (në arbërisht *Shën Mikeli*), themelimi i të cilit daton në vitin 1517 deri në vitin 1534. Shqiptarët e tjerë u vendosën në Sant’Angelo Muxaro (në arbërisht *Shënt’Engjëlli*), në San Michele di Bagheria, në Lipari dhe Taormina.

Vendbanimet e para shqiptare në Sicili

Ardhja e stratiotëve në Sicili daton rreth vitit 1450. Ishin 200 burra stratiotë, të cilët nën drejtimin e Giorgio dhe Basilio Reres, djemve të Dhimitër Reres (Demetrio Reres) u vendosën në këtë ishull për të mbrojtur nga bastisjet e Valois-Anjou një garnizon në Casale di Bisiri (Mazara), në bregdetin perëndimor të ishullit. Ata u strehuan në kështjellën e lashtë të Saracen-it të Bisiri-t, në një kodër, në bregun e djathtë të lumit Mazaro, dhjetë kilometra larg nga derdhja e tij, në afërsi të fermës së quajtur “Mazarese”.

Ky interpretim historik thuhet se nuk është i vërtetë. Falsiteti historik ishte montuar në vitin 1665 nga Gjergj Reresi (Giorgio Reres), kryepriifti i Mezzojuso-s, si dhe nga bashkëpunëtori i tij,



noteri Diego Barretta i Palermos, i cili pretendoi se ekzistonte një “diplomë” që Mbreti Alfonso I, i kishte lëshuar Dhimitër Reres në vitin 1448. Mbi bazën e këtij pohimi, studiues të shquar si Pietro Pompilio Rodotà, më 1748, konfirmuan ekzistencën e Dhimitër Reres dhe të djemve të tij. E gjithë teoria, mbi të cilën u përcaktua viti i themelimit të të gjitha vendbanimeve arbëreshe të “Calabria Ultra” (sot krahinat e Catanzaro-s dhe Crotona-s) dhe të Sicilisë, u mbështet vetëm në atë që u hartua nga noteri Diego Barretta.

Krahina e Palermos

Mes viteve 1386-1429, një duzinë familjesh, kryesisht nga Durrësi dhe zonat përreth, u vendosën në periferinë e Palermos, në lagjen, ku më vonë do të ngriheshin fshatrat arbëreshe dhe ku vepronte noteri Antonio Bruno, i cili regjistroi aktet përkatëse.

Të gjithë këta ishin katolikë të deklaruar dhe shkonin në Kishën e Shën Nikollës. Bëhet fjalë për bërthama të vogla familjare, që e kishin lënë atdheun për arsye ekonomike. Por kishte edhe skllëvër dhe ushtarë, që u kishin mbijetuar betejave të përgjakshme dhe pushtimit osman të Durrësit dhe Shkodrës në vitet 1300-1306.

Vendbanimet e themeluara nga arbëreshët në Sicili

Numri i madh i arbëreshëve që mbërritën në Sicili, në valë të ndryshme migratore, gjatë shekujve formoi disa ngulime, të cilat po i rendisim, si vijon:

Contessa Entilina u atribuohet stratiotëve shqiptarë, të cilët erdhën nga Casale di Bisiri (afër Mazara del Vallo), ku ata i kishin shërbyer Mbretit të Napolit nga viti 1448. Qyteti u zhvillua vetëm pas vitit 1500.

Në vitin 1482, mërgimtarët shqiptarë u vendosën në **Mezzojuzo**, ku krijuan një bërthamë të konsiderueshme të banuar. Ndërsa në vitin 1600, u themelua Manastiri Basilian, i cili u bë qendra e parë fetare dhe kulturore e arbëreshëve, ku punuan edhe murgjit ikonografë.



(*Contessa Entilina*)

Palazzo Adriano u krijua gjatë shekullit XIV, kur një koloni stratiotësh shqiptarë u vendosën në këtë vend të braktisur, duke e ripopulluar atë.

Piana degli Albanesi (në arbërisht, *Hora e Arbëreshëvet*) mendohet se u themelua më 30 gusht të vitit 1488 nga një grup shqiptarësh, kryesisht nga Himara, të cilët e braktisën vendlindjen për shkak të luftës. Në kërkim të lirisë, ata u shpërngulën përtej detit Adriatik, në Itali. Çdo 30 gusht përkujtohet si një ngjarje e shënuar për këtë komunitet.

Santa Cristina Gela (në arbërisht *Sëndahstina*) u themelua më 31 maj të vitit 1691, kur 82 fermerë nga Hora e Arbëreshëvet morën pronën feudale fqinje të **Santa Cristina** prej kryepeshkopit të Palermos, me qëllim ndërtimin e shtëpive.



(Santa Cristina Gela)

Krahina e Agrigento-s

Sant'Angelo Muxaro (në arbërisht *Shënt'Ëngjëlli*) u popullua fillimisht nga disa stratiotë, të cilët mbërritën në Sicili në vitin 1448 për të mbrojtur bregdetin perëndimor të ishullit nga pushtimet e huaja. Kur, pas dy vjetësh, frika e një pushtimi u zbeh, stratiotët nxitën ardhjen e familjeve të tyre në Shënt'Ëngjëll.



(Sant'Angelo Muxaro)

Krahina e Katanias

Shumë fshatra u themeluan nga mërgimtarët shqiptarë, si: Biancavilla (Callicari), Bronte, San Michele di Ganzaria (CT) dhe Sant'Angelo Muxaro (AG), por ata i humbën karakteristikat etno-gjuhësore shumë herët (rreth shekullit XVII).

Biancavilla

Themelimi i Biancavilla-s daton në shekullin XV, kur, pas vdekjes së Skënderbeut, disa familje shqiptare, nën drejtimin e Çezar Masi (Cesare Masi), morën lejen për të jetuar në një zonë që quhej *Callicari*. Kështu, u ngrit Biancavilla, e cila fitoi privilegjin e themelimit në vitin 1488, nga konti Moncada.

Ngulime të tjera më të vogla arbëreshe në Sicili, përmendim:

Bronte (në arbërisht *Bronti*) u themelua nga stratiotët, të cilët mbërritën në Sicili në vitin 1448.

San Michele di Ganzaria (në arbërisht *Shën Mikeli*) u themelua, po nga stratiotët, të cilët mbërritën në Sicili në vitin 1448.

San Mikeli i Bagarisë është qyteti që përmendet në librin “Casali Albanesi nel Tarentino”, i shkruar në vitin 1921, nga studiuesi Antonio Primaldo Coco. Sot, ky vendbanim nuk ekziston më.

Krahina e Mesinës

Lipari është i vetmi ngulim arbëresh që ndodhet në krahinën e Mesinës në Sicili.



9.2. PIANA DEGLI ALBANESI (HORA E ARBËRESHËVET)



Themelimi i Horës së Arbëreshëvet

Në Horën e Arbëreshëvet, tabelat janë dygjuhëshe dhe natyra është e mrekullueshme. Malet që e rrethojnë këtë vendbanim janë: Pizzuta, Kumeta, Maganoce dhe Xeravulli dhe përmes tyre kalon lumi Gjon. I gjithë ky peizazh, që i qëndron si kurorë mbi krye Horës së Arbëreshëvet, reflektohet në ujërat kristal të pastër të një liqeni artificial. Aty pranë, gjendet edhe kodra me emrin “Sheshi”. “Piana” është një “Horë” (kështu e quajnë arbëreshët Pianën), ku jeton një popull i mrekullueshëm, të cilët për rreth 600 vjet kanë mbajtur të gjallë identitetin e tyre.

Data e themelimit të Horës së Arbëreshëvet është më 30 gusht 1488, kur u nënshkrua marrëveshja e fondacionit midis një grupi arbëreshësh dhe Guvernatorit të Arqipeshkvisë, kardinalit Juan

Borxhia. Atij iu kërkua e drejta e qëndrimit në pronat Mercu dhe Aydingli, në rrethinat malore, afër rrafshit “Fusha”. Pasi u përcaktuan kapitujt, u sanksionua koncesioni zyrtar, i cili u pasua me ndërtimin e qendrës më të madhe shqiptare në ishullin e Sicilisë, Horës së Arbëreshëvet.

Arbëreshët që nënshkruan marrëveshjet ishin: Giovanni Barbato, Pietro Bua, Giorgio Golemi, Giovanni Schirò, Giovanni Macaluso, Tommaso Jani, Antonio Troja, Matteo Mazza, Teodoro Dragotta, Giorgio Burlesci, Giovanni Parrino, Giorgio Ipsari, Giovanni Canniti dhe Giorgio Bruscarì.

Ndërtimi i Horës

Midis fundit të shekullit XVI dhe gjysmës së parë të shekullit XVII, nën ndikimin e personalitetit të fortë artistik të Pietro Novelli-t, Hora u pasurua me kisha dhe ndërtesa të tjera, të cilat i dhanë formën e sotme qendrës historike.

Shumë rrugë, rrugica e sokakë flasin dhe ruajnë gjurmë arbëreshe. “Via Lipari”, “Via Cassara”, “Via Pietro Novelli”, “Piazza Vito Stassi”, “Corso Giorgio Castriota”, “Osteria le Volte”, “Via Matranga”, “Via Guzzetta” etj. Lagjet e tyre si “Shën Gjoni”, “Rrokat”, “Kryqat e Palermos” kanë karakter historik. Ndërtesat si Pallaci Mancuni, Shtëpia e Vicar Forane, Cine-teatro dhe ish-burgu Mandamento, biblioteka “Zef Skirò” që dikur ishte bashki, etj. Të gjitha, së bashku me muret, rrugët, sokakët rrëfejnë historinë e Horës.

Ndryshimi nga “Piana degli Greci” në “Piana degli Albanesi”

Pas rrugës kryesore “Udha Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, një tjetër rrugë interesante është “Udha Posfera”, e shtruar me kalldrëm. Banorët flasin shqip dhe shpjegojnë se fillimisht, zona quhej “Piana dei Greci”. Vetëm gjatë periudhës fashiste, më 30 gusht 1941, u ndryshua në “Piana degli Albanesi”. Disa muaj më vonë, me dekret të Kongregatës së Shenjtë për Kishat Lindore të 25 tetorit 1941, emri i “Planen Graecorum” (Piana degli Greci) u ndryshua gjithashtu në “Planen Albanensium” (Piana degli Albanesi), pasi në të vërtetë banorët e kishin quajtur gjithnjë qendrën Hora e Arbëreshëvet.

Katedralja “San Demetrio Megalomartire”

Katedralja e “San Demetrio Megalomartire” ishte e para dioqezë, e cila u lejua të ndërtohej në një qendër banimi, pas marrëveshjeve midis arbëreshëve dhe feudalëve vendas. Ndodhet në rrugën kryesore “Gjergj Kastrioti” të Horës. Katedralja u ndërtua në vitin 1493, në stilin barok i vonshëm. Në kishë shkohet nëpërmjet një shkalle, e cila, para ndërtimit të manastirit (ngjitur me të) në vitin 1716, zbriste direkt në shesh. Ajo është selia kryesore e ritit bizantin e në të njëjtën kohë kryen ritet solemne si Festa e Ujit të Bekuar (Epifania), Java e Madhe e Pashkëve (Pashkët) dhe Krishtlindjet.

Shkallët e stilit barok i vonshëm të çojnë drejt hyrjes së saj. Fasada është zbukuruar me mozaikë të stilit bizantin. Kisha është pasuruar me ikona të shumta të ikonografëve vendas bashkëkohorë. Brenda ndodhen tre naveta, të ndara me dy rreshta, me nga tetë kolona mermeri dhe harqe të rrumbullakëta. Këtu ndodhet ikonostasi prej druri, më i madhi në Sicili, me ikona të manastirit të Kretës, Manusaki, i cili mbulon të tria majat. Muret anësore të katedrales janë pasuruar me afreske nga ikonografi grek, Eleuterio Hatsaras. Aty paraqitet një treshe ikonash që përshkruajnë jetën e Virgjëreshës, festat kryesore, si dhe baballarët e kishës.

Në murin e djathtë të hyrjes kryesore ndodhet një altar, që paraqet Shën Dhimitrin, Shën Nestorin dhe varrin e Shërbëtorit të Zotit, Gjergj Guxetës, personalitet i shquar arbëresh. Ai jetoi rreth shekullit XVII dhe mbrojti ritin e Lindjes.

Nga viti 1784, katedralja e “San Demetrio Megalomartire” luajti funksionin si selia e peshkopit urdhërues të ritit greko-bizantin në Sicili, ku deri në vitin 1924 ishte e vetmja seli në “Horën e Arbëreshëvet” me një koleg prej katër priftërinjsh. Katedralja vijon të jetë aktive dhe të kryejë ritet bizantine për popullsinë arbëreshe, të cilët këtu ndajnë gëzimet e hidhërimet dhe flasin gjuhën e të parëve.

Familja fisnike Matrënga

Në komunitetin e Horës së Arbëreshëvet gjejmë edhe mbiemrin “Matrënga”. Matrëngat shfaqen në dokumentet historike që më 1297, si sundimtarë të Karavastasë në Shqipëri.

Më 1319, Matrëngat marrin pjesë në koalicionin shqiptaro-ballkanik nën drejtimin e Papa Johanit XXII. Kulmin e lulëzimit e arritën me Vlash Matrëngën, rreth vitit 1360, me qendër administrative në Pìrg (derdhja e dikurshme e Semanit).

Në vitin 1592, familja Matrënga shquhet në komunitetin arbëresh të “Horës së Arbëreshëve” në Sicili me Lekë Matrëngën, me veprën e tij “E mbsuame e krështerë”. Më 1710, shquhet gjithashtu edhe kryepeshkopi Bazil Matrënga, i cili njihet për kontributin bazilian për njësimin e ritit kishtar lindor e perëndimor. Varri i tij ndodhet në Kishën e Shën Mitrit. Moto e emblemës së Matrëngajve ishte: “Bekuarë, Gëzuarë”.

“E Premtja e Zezë” - Veshja tradicionale e zisë

Një nga ditët më të ndjera nga komuniteti i Horës së Arbëreshëve është “E Premtja e Zezë”. Momenti më emocionues është procesioni i madh në mbrëmje, nëpër rrugët e qytetit. Gjatë tij, këngët karakteristike të varrimit (vajtimet) shoqërohen me instrumente prej druri me origjinë bizantine, të quajtura çokë dhe çikarra. Kambanat janë të lidhura në mënyrë që të mos bien, nga e enjtja në mëngjes deri në mesditën e së shtunës.

Kishat e ritit bizantin

Në këtë qytezë, bota arbëreshe shkrihet me zhvillimin kozmopolitan, por ndërkohë ruhen besimi dhe ritet.

Riti bizantin është zyrtarizuar në: Seminarin Eparkial italo-shqiptar; Kishën San Giorgio, Kishën famullitare e Santissima Annunziata; Kishën famullitare e San Giovanni Battista; Kishën famullitare e Sant’Antonio Abate ose “Il Grande”; Kishën famullitare e San Vito Martire; Kishën e Santissimo Salvatore; Kishën e Maria Santissima Odigitria; Kishën e Maria Santissima del Rosario; Kishën e San Nicola di Bari dhe Tolentino. Ashtu si në Kalabri, ku arbëreshët luftonin për të ruajtur ritin e tyre, që i dallonte nga popullsia vendëse, edhe Hora e Arbëreshëve në Sicili pati të njëjtat probleme. Presioni për kthimin e ritit nga ana e kishës latine ishte një trysni e përhershme. Shumë arbëreshë u kthyen në latinë, duke humbur edhe identitetin kombëtar.

Arbëreshët, nga riti bizantin në ritin latin

Kisha e San Vito-s

Kisha e San Vito-s (shek. XVI) e quajtur zakonisht “Sëndu Viti”, është një shembull i artit të vonë barok në qytet, e pasur me altarë të gdhendur në mermer polikrom. Kisha, që fillimisht u përkiste besimtarëve të ritit bizantin, u konvertua në ritin latin. Brenda ruhet statuja e martirit të Shën Vito-s.

Miti i Skënderbeut

Si në të gjithë fshatrat arbëreshe, edhe në Horën e Arbëreshëvet, miti i Skënderbeut jeton dhe është ende i gjallë, nëpër rrugica, rrugë, por edhe nëpër monumente. Në “Villa Comunale” të Horës ngrihet madhështor busti i Skënderbeut.

Gjendja e sotme e “Horës së Arbëreshëvet”

Ngulimet arbëreshe në Sicili kanë pasur disa valë migratore. Pjesa më e madhe e arbëreshëve të Sicilisë emigruan në Amerikë, kryesisht në vitet 1900 dhe 1910, ku popullsia arbëreshe në këtë areal thuajse u përgjysmua. Këto zhvendosje të arbëreshëve, në shumë raste, kanë shkaktuar bjerrjen e kulturës dhe të ruajtjes së identitetit kombëtar.

Në raste të tjera, arbëreshët e vendosur në pjesën tjetër të botës si në Kanada, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Argjentinë dhe në Brazil mundën të krijojnë komunitete të forta dhe ta mbajnë gjallë gjuhën shqipe.

Gjatë viteve 1999-2002, komuna dhe Eparkia e Horës së Arbëreshëvet mirëpritën dhe u erdhën në ndihmë shqiptarëve të Kosovës, të prekur nga lufta. Gjithashtu, karakteristike për këtë qytezë është fakti se shumë djem e vajza arbëreshe janë martuar me shqiptarë/ë.

Kisha “Santissima Madonna dell’Odigitria”

Në Pexuta (Pezzuta) ndodhet kisha e parë e ndërtuar nga arbëreshët, qysh në vitin 1488. Në një gur ndodhet një pllakë, që

simbolizon vendin e shenjtë. Arbëreshët menduan se për të qenë të bashkuar dhe që të mos asimiloheshin, të parën gjë që duhet të bënin ishte ndërtimi i kësaj kishe, e cila quhet “Santissima Madonna dell’Odigitria”.

Ajo qëndron rrëzë malit Pizzuto dhe është një kishë e vogël me planimetri katrore. Kur hyn brenda, bie menjëherë në sy një afresk nga një artist i madh. Kisha ka një altar të shekullit XVIII, në një mermer të përzier, ku është imazhi në kanavacë i “Madonna Odigitria”. Kjo është vepër e Pietro Antonio Novelli, babai i Monreales, në vitin 1612. Në të djathtë dhe të majtë të altarit, dy vepra në vaj, të shekullit XVII, përshkruajnë baballarët e kishës së San Basilio dhe San Giovanni Crisostomo. Dy piktura të tjera në këtë teknikë përfaqësojnë, në mënyrë specifike, shenjtoret Demetri, në aktin e pagëzimit të Nestorit dhe Shën Gjergji, me të gjitha shenjat e martirizimit. Në kishë ndodhet edhe një pllakë, e vendosur përpara altarit, e cila flet për historikun e vendbanimit. Në dy periudha të ndryshme të vitit, në maj dhe në gusht, arbëreshët vijnë para agimit në këtë shenjtërore, për të marrë pjesë në liturgjinë hyjnore.

Mbiemrat me origjinë shqiptare

Mbiemrat më të zakonshëm me origjinë shqiptare janë: Ales, Barbato, Borgia, Calagna, Camarda, Carbone, Cassarà, Clesceri, Ciulla, Cuccia, Cusimano, Damiani, Dorangricchia, Ferrara, Filpi, Fusco, Garofalo, Gazzetta, Mandalà, Marino, Matranga, Musacchia, Norcia, Petta, Plescia, Puglia, Schirò, Spata, Stassi dhe Zuccaro.

Hora e Arbëreshëvet dhe lëvizjet patriotike

Më 1860, arbëreshët pritën në vendin e tyre, emisarët Rosolino Pilo dhe Giovanni Corrao, të cilët mbërritën në Sicili me detyrën për të përgatitur ardhjen e Garibaldit.

Pas zbarkimit në Sicili, Hora e Arbëreshëvet u siguroi garibaldianëve mbështetje logjistike dhe strehë të sigurt strategjike. Shumë shqiptarë ndoqën fushatat ushtarake kundër burbonëve dhe

disa mbetën viktima në fushën e betejës, si në “Rivolta della Gancia” dhe në ngjarjet e ekspeditës “Të Njëmijtë”, të quajtur “Kryengritja e Palermos”.

Carini u bë një pikë kyçe e revoltës kundër burbonëve dhe mbajti kontakte të vazhdueshme me shpërthimet e lëvizjes në Palermo. Më shumë se 400 burra u nisën për në Palermo, ku në mëngjesin e katërt u përleshën me forcat e burbonëve në Porta Carini. Përplasja dështoi, por kryengritësit nuk u ndalën. Ata vendosën një pikëtakimi për të gjithë në Carini. Atyre iu bashkuan rreth 2 mijë burra nga vendet përreth. Më 18 prill, ata u mundën nga mbi 2 mijë ushtarë të burbonëve, të udhëhequr nga gjeneralët Cataldo dhe Gutenberg. Forcat e burbonëve pushtuan Carini-n, ku masakra dhe plaçkitjet ishin të papërshkrueshme.

Atdhetarët e mbijetuar u tërhoqën me 20 prill në Horën e Arbëreshëvet, ku iu bashkuan edhe emisarët Rosolino Pilo dhe Giovanni Corrao. Shkrimtari i madh, Giovanni Pascoli, shkroi se një “masakër monsturoze” kishte ndodhur në Carini. Lëvizja u shua shpejt me gjak për momentin, por Carini mbeti në qendër të rebelëve me Rosolino Pilo-n, i cili koordinoi operacionet. Për të dhënë dënimin shembullor dhe për të përhapur panik dhe terror në popull, të gjithë “rebelët” e Gances u pushkatuan pa gjyq, më 14 prill 1860.

Garibaldi në Horën e Arbëreshëvet

Garibaldi synonte të mblidhte rreth vetes trimat dhe ata që kishin vërtet ideale. Zbarkoi në Sicili, ku arbëreshët, siç dëshmojnë dokumentet, do të ishin nga të parët që e mbështetën dhe luftuan në radhët e tij. Të gjitha katundet arbëreshe u hodhën në kryengritje, mes tyre edhe intelektualët arbëreshë, si: filologu Dhimitër Kamarda, poeti Gavril Dara (I Riu) e deri te fshatarët e thjeshtë të Horës, Palaco Adriano-s, Mezzojuso-s etj. Revolucioni u përqendrua në Horën e Arbëreshëvet, ku dolën rreth 600 vullnetarë, të cilët shkuan në Palermo dhe u bashkuan me kryengritësit në luftë kundër tiranisë monarkiste.

Një figurë komplekse në këto ngjarje do të bëhej revolucionari arbëresh i lëvizjes karbunare, Françesko Krispi, i cili më vonë u bë protagonist në lëvizjen së Garibalidit. Gjithashtu, aktivisti revolucionar italian, Rosalino Pilo, i shoqëruar nga arbëreshi Antonio Guxeta do të njoftonte arbëreshët e Pianës për zbarkimin në brigjet e Sicilisë të Garibalidit. U krijua kështu, “Komiteti i fshehtë i Horës së Arbëreshëve”, me në krye Françesko Petën. Një repart luftëtarësh, në komandën e Pietro Piedeskalci, u nis drejt Palermos dhe u bë pjesë e kryengritjes. Arbëreshi Pietro Piedeskalci dhe Rosalino Pilo luftuan në betejën e Monrealit dhe ranë heroikisht krah njëri-tjetrit. Mbetën të dy në fushë të betejës, me thirrjen “Rroftë Italia!”.

Arbëreshja Giovanna Petta, me flamurin italian në gji

Gjatë betejës së Monrealit, kronikat shkruanin se një vajzë arbëreshe, Giovanna Petta, kishte nxjerrë nga gjoksi flamurin italian, që e kishte qëndisur me fije ari dhe e valëviste në qiellin e çliruar të Italisë. Ky ishte një akt madhështor, që manifestonte shpirtin bujar të arbëreshëve për këtë atdhe të dytë. Arbëreshët më vonë mbetën të zhgënjyer nga kjo luftë, sepse nuk morën atë që meritonin, por kjo është tjetër histori.

Arbëreshët gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore

Gjatë shekujve XIX dhe XX, Arbëreshët e “Horës së Arbëreshëve” morën pjesë aktive në ngjarjet historike të rajonit, si në ato kombëtare po ashtu dhe në ato përtej kufijve kombëtarë, duke luajtur rol domethënës në bashkimin kombëtar italian dhe në pavarësinë e Shqipërisë. Ata ofruan mbështetje vendimtare në sferën politike, ushtarake dhe kulturore.

Komuniteti arbëresh

Shekulli XIX dhe XX shënuan një përparim të jashtëzakonshëm të kulturës dhe të letërsisë italo-shqiptare. Të nxitur nga parimet Romantike dhe Rilindëse, një grup i madh intelektualësh u

interesuan për historinë, gjuhën e traditat poetike popullore të arbëreshëve dhe përuhdën kështu, një proces vendimtar në historinë letrare shqiptare.

Në “Horën e Arbëreshëve” lindën figura dhe personalitete të shquara, që me mënyra dhe mundësi të ndryshme pasuruan trashëgiminë e çmuar stërgjyshore.

Sot, pas pesë shekujsh, Hora e Arbëreshëve ruan me ngulm identitetin etnik-gjuhësor dhe fetar. Vendasit flasin ende gjuhën e origjinës, ruajnë ritin bizantin dhe të gjitha traditat fetare të lidhura me të. Veshjet karakteristike të grave përdoren vetëm në raste të veçanta, si dasma, pagëzime dhe në disa rite liturgjike bizantine, si *Epifania* dhe *Pashkët*. Këto veshje përdoren edhe në periudhën e karnavaleve, nga data 7 janar deri të “Mërkurën e Hinjtë” (“Mercoledì di Ceneri”). Ëmbëlsirat karakteristike të periudhës së karnavaleve janë “loshkat” dhe “petullat”.

Ndër traditat me rastin e Pashkëve, vlen të përmendin specifikën e arbëreshëve të Sicilisë, të cilët organizojnë panaire me veshje arbëreshe.

Flamuri shqiptar me shqiponjën dykrenore duket kudo nëpër rrugë. Kostumet arbëreshe, këngët dhe rapsoditë, të lidhura me traditën dhe besimin, arrijnë kulmin në “Javën e madhe”, të shoqëruara me liturgji hyjnore. Ndërsa riti “San Giovanni e San Pietro” mbahet në datat 24-29 qershor.

Burimet ujore

Burimet tipike (kronjet, kroi/krua al sing.) janë të shpërndara rreth qendrës historike. Ato pasurojnë trashëgiminë artistike të Horës së Arbëreshëve dhe përbëjnë dëshmi të rëndësishme historike. Përveç funksionit të furnizimit me ujë nëpërmjet brokeve (nzirotet), burimet ishin një vend, ku arbëreshët takoheshin dhe shkëmbenin mendime dhe informacione.

Kushdo që viziton Horën e Arbëreshëve, nuk mund të mos befasohet nga bukuria e shatërvanit me tri gryka. Kjo është një vepër madhështore, sepse arbëreshët ishin mjeshtër të ndërtimeve me gur. Shatërvani gjendet në “Piazza Vittorio Emanuele”, dikur “Piazza

Grande” dhe është një burim tipik i shekullit XVII. Në formën e një “tempulli”, shatërvani “Tri gojë” u ndërtua në vitet 1608-1609, me porosi të juristëve dhe me autorizimin e Ipeshkvisë së Monreales nga një arkitekt arbëresh. Në këto burime spikat simboli i diellit, i lënë prej arbëreshëve në shekullin XVI. Simboli i diellit mbi shatërvanë është i njëjtë me simbolin e yllit, që mbante Aleksandri i Madh.

Fusha e Pontit

Ky krua gjendet në “Corso Umberto I” dhe mban emblemën e “Horës së Arbëreshëve”. Kroji ka dy kallinj gruri, të mbledhur me një shirit dhe inicialet “SPQA 1765”, që është data e ndërtimit të tij.

Kroi me një gojë

Në pjesën e sipërme të “Corso Castriota”, afër Katedrales, “kroi me një gojë” është një nga më të vjetrit, me një formë tipike të shekullit XV dhe mban datën e ndërtimit 1567 në një pllakë. Kroji u restaurua në vitin 1989 dhe është mirëmbajtur në vazhdim.

Kroi “Kanalli i ri”

Në rrugën “Fonte Padre Giorgio Guzzetta”, u ndërtua kroji “Kanalli i ri”. Kroji u ndërtua rreth vitit 1700, me urdhër të Apostullit të shqiptarëve të Sicilisë.

“Kroi te Rrokat”

Në rrethin me të njëjtin emër, i ndryshuar më vonë, gjendet “Kroi te Rrokat”.

“Kroi Kastriota”

Shatërvani është ruajtur i paprekur, i punuar me gur dhe mermer vendas. Ndodhet në “Corso Castriota”, në kopshtin aktual “Lord Baden-Powell”.

“Tek Ulliri”

Përpara manastirit SS. Annunziata, i rinovuar, gjendet një tjetër burim, i cili quhet “Kroi tek Ulliri”.

“Kroi te Kriqja” e Palermos

Në rrugën “Francesco Crispi”, njëherë e një kohë, në një kryqëzim në hyrjen të qytetit, ishte një shatërvan monumental tetëkëndor. Shatërvani i shekullit XVII, i punuar në gur, mbante një pllakë përkujtimore në latinisht, e cila tani ka humbur.

Ekzistojnë edhe disa burime të tjera, si:

“Kroi Harkuliuni”

Burimi gjendet nën harkun me të njëjtin emër, i cili në vite ka ndryshuar.

Kroi Mascilli

Në “Piazza Mascilli”, ndodhet ky krua, i cili ka ndryshuar me kalimin e kohës.

“Fontana Shën Janji”

“Shën Janji”, kështu quhet lagjja për hir të shenjtorit San Giovanni, e krijuar në shekullin XVIII dhe e banuar prej arbëreshëve. Sot, kjo vepër e arbëreshëve nuk është më, por kanë mbetur vetëm dëshmi fotografike.

Seminari Arbëresh i Palermos

Seminari Arbëresh i Palermos ishte qendër arsimit, edukimi dhe kulture, vatër e ruajtjes së gjuhës shqipe dhe e traditave arbëreshe në Sicili. U themelua në Horën e Arbëreshëve (Piana degli Albanesi) pranë Palermos nga Gjergj Guxeta. Për 10 vjet, rektor i parë i kësaj qendre ishte Pjetër Andrea, nga Himara. Seminari u bë një vatër e kulturës dhe atdhetarizmit shqiptar, ku u formuan një varg intelektualësh arbëreshë, shkrimtarësh e poetësh të shquar.¹³⁰

Figura të shquara nga Hora e Arbëreshëvet

Lekë Matrënga (Luca Matranga, 1567-1619)

Lekë Matrënga lindi në Horën e Arbëreshëvet (Sicili). Pasi kreu studimet në një kolegji fetar në Romë, u kthye në fshatin e tij ku

¹³⁰ *Fjalor enciklopedik shqiptar. Vëllimi II*, ASHSH, Tiranë, 2008, fq. 568.

shërbeu si prift. Më 1592 përktheu nga italishtja dhe botoi në Romë një katekizëm “E mbsuame e kërshterë”. Vepra ka rëndësi të madhe, sidomos për dokumentimin e një faze të vjetër të të folmeve të arbëreshëve të Sicilisë. Ajo paraqet interes edhe për vjershën e shkurtër botuar në të, që është gjurma e parë e botuar e vjershërimit shqip.

Ai ishte student i Kolegjit të “San Atanasio” në Romë dhe prift i rritit grek. Mbajti pozicionet më të larta kishtarë në komunitetin e Horës së Arbëreshëve. Nga një dëshmi pagëzimi, mësojmë se Matrënga u mor me detyra pastorale midis arbëreshëve të Horës prej muajit dhjetor të vitit 1601. Dëshmia thotë: “Unë, Don Lekë Matrënga, famullitar në këtë kishë të Shën Gjergjit, pagëzova një foshnjë mashkull më tridhjetë të nëntorit të kaluar, birin e Antoni dhe Venera Zalapit, dhe emri iu vu Andrea. Kumbar ishte Françesko i të nderuarve Josep dhe Beatrice Guzeta, kurse kumbare ishte Domenika, e bija e të nderuarve Josep e Beatrice Guzeta, e shoqja e Joan Muzakës nga kjo krahinë e Pianës”¹³¹. Për jetën e Matrëngës nuk dihet gjë tjetër. Vdiq si kryeprift, më 6 maj të vitit 1619.

Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzetta, 1682-1756)

Gjergj Guxeta lindi në ngulimin arbëresh të Sicilisë “Piana degli Albanesi” (Hora e Arbëreshëve). Njihet gjerësisht si themeluesi i Seminarit Arbëresh të Palermos. Seminari i themeluar prej tij në vitin 1734, konsiderohet si qendra e parë albanologjike. Guxeta është vlerësuar si më i madhi intelektual shqiptar në shek. XVIII, apostulli i arbëreshëve të Sicilisë, i cili mbrojti ritin bizantin. Emri i tij është i lidhur edhe me zbulimin e tekstit më të vjetër në gjuhën shqipe, “Meshari” i Gjon Buzukut, të cilin e gjeti rastësisht në Romë, më 1740.

Gjergj Guxeta studioi në Seminarin Arkiepiskopal të Monreale-s. Pas marrjes së doktoratës në “Teologjinë e Shenjtë”, ai u punësua si përkthyes i greqishtes klasike në Gjykatën e Kryepeshkopit Kardinal, Francesco Del Giudice. Pasi la Dioqezën e Monreale-s vendosi

¹³¹Arkivi i Katedrales në Horën e Arbëreshëve. Regjistri i pagëzimeve, vëll. 3, nr. 835, fletë 85.

të bashkohet me Kongregatën e priftërinjve të “Oratory” të San Filippo Neri në Palermo (1706). Më 1716 themeloi Kongregatën e Oratorisë së San Filippo Neri për priftërinjtë e ritit grek në “Piana dei Greci”.

Së bashku me Antonio Brankaton, ai promovoi edhe themelimin e kolegjit “Maria di Piana” (1733). Guxeta ishte njohës i thellë i kulturës klasike. Ai shkroi, ndër të tjera, një Kronikë të Maqedonisë deri në kohën e Skënderbeut. Shkroi etimologjikun “Deublensibus italiae rite excolendis, ut sili lolique Ecclesiae prosint”, e cila përbën një nga kontributet e para për përshkrimin dhe studimin e gjuhës shqipe. Kjo vepër ende nuk është botuar.

Ai vdiq më 21 nëntor të vitit 1756, në manastirin e etërve Karmelitë të Partinikos dhe u varros në kishën e “Sant’Agnazio all’Olivella”, në Palermo.

Marko La Piana (Marco La Piana, 1883-1958)

Marko La Piana lindi në Piana degli Albanesi (asokohe “Piana degli Greci”) më 15 qershor të vitit 1883.

Ai studioi në Universitetin e Palermos dhe u mor me studime albanologjike. Është përfaqësues i brezit të gjuhëtarëve të mirëfilltë ndër arbëreshët e Italisë. La Piana hulumtoi dhe nxori në dritë veprën e Lekë Matrëngës, që është e para përmendore e shkruar në arbërishten e Italisë. Këtë libër të Matrëngës, që i përket vitit 1592, La Piana e botoi në vitin 1912. Më 1937-n, ai botoi një studim të gjerë në lëmin e fonetikës së gjuhës shqipe, kushtuar historisë së zanores (o) të gjatë në elementet vendëse dhe latine të shqipes.

La Piana botoi dy vepra me të njëjtin titull, “Studime Gjuhësore Shqiptare” I dhe II (1939-1949). Në librin e dytë jepet edhe një studim mbi të folmen e arbëreshëve të Sicilisë.

Ka shkruar një varg studimesh, në të cilat ka trajtuar çështje të fonetikës dhe morfologjisë historike të gjuhës shqipe, të etimologjisë dhe të marrëdhënieve të saj me rumanishten. Me interes është sidomos trajtimi i elementit *kentum* dhe *satem* në shqipen e lashtë. Studimet e Marko La Pianës shquhen për mendime origjinale dhe për qëndrime kritike ndaj disa zgjidhjeve të mëparshme. Ka lënë

dorëshkrim dy vepra të vëllimshme: “Gramatikë e krahasuar e gjuhës dhe e dialekteve të shqipes” (rreth 2000 faqe dorëshkrim) dhe “Thesaurus linguae albanensis” (rreth 30 mijë skeda). Vdiq më 20 prill të vitit 1958.

Tommaso Manzone (1819-1893)

I përkiste një familjeje fisnike dhe të pasur. Tommaso Manzone, komplotist dhe atdhetar, u detyrua të emigronte në Torino dhe më pas në Gjenova. Në fund të revolucionit të vitit 1860, ai u kthye në Sicili ku u zgjodh senator i Mbretërisë. Duke mos pasur trashëgimtarë, ai e la një pjesë të madhe të pasurisë për të mirën e zhvillimit rural dhe urban të Palermos dhe donte që pallati i tij në Piana degli Albanesi të përdoret si kopsht për fëmijët e bashkëqytetarëve të varfër. Kjo ndodhi 15 vite pas vdekjes së tij, konkretisht me 12 korrik të vitit 1908. Sot Palazzo Manzone, i restauruar së fundmi, është bërë pjesë e trashëgimisë së Bashkisë së Horës së Arbëreshëvet.

Lorenzo Petta

Klerik i rritit bizantin grek dhe qiramarrësi i shumë çifligjeve të ndryshme. Ishte një nga qytetarët më të pasur dhe më bujarë të kohës së tij. Duke dashur të varrosej në katedralen e San Demetrio-s, ai finançoi, duke i lënë në testament (1642), afresket që pak më vonë (1644) do të pikturoheshin nga piktori i mirënjohur i Monreale-s, Pietro Novelli. Në testament parashikoheshin edhe shpenzime të tjera që do të përdoshin për ndërtimin e kishës së re të S. Maria dell’Odigitha. E veja Pauline punoi shumë dhe arriti të përmbushë me përpikëri vullnetin e tij.

Antonio Brancato (1688-1760)

Ndihmoi At Gjergj Guxetën (Giorgio Guzzetta) në krijimin e *Oratorisë së Etërve Filipine të Pianës* (1716). Në 1733, ai themeloi *Collegio di Maria di Piana* për edukimin e vajzave të reja, i drejtuar nga murgeshat kolegjiale, sipas rregullave të Kardinal Corradini, i cili vijon misionin edhe sot.

Giuseppe Musacchia (1837-1910)

Botoi vargje në greqisht dhe përkthime të librave liturgjikë grekë bizantinë. Shkroi, ndër të tjera, një monografi të Pianës në gjuhën shqipe, të botuar në “Fiamuri Arbërit”, revista e themeluar dhe e drejtuar nga Jeronim de Rada. Përveç disa gabimeve të vlerësimit që janë gjetur (i tillë është rasti i origjinës së supozuar *scutarine* të themeluesve të Horës), vepra mbetet një dëshmi që përmban informacione të dobishme historiografike, veçanërisht në pjesën në të cilën përshkruhet shoqëria dhe ekonomia e thjeshtë.

Paolo Schirò (1866-1941)

Pal Skiroi (Paolo Skiroi) studioi në Seminarin Arbëresh të Palermos. Prift i shenjtëruar në Katedralen e San Demetrio-s, më 8 maj 1892. Më 11 shkurt 1904, mori emërimin e shqiptarëve të Sicilisë nga Selia e Shenjtë dhe më 20 mars të po këtij viti, Skiroi u shenjtërua në Bitonto (BA) në prani të shumë arbëreshëve dhe shqiptarëve të Shqipërisë.

Nga viti 1912 deri më 1915, ai botoi “Fiala dhe t’in’Zoti” (“Fjala e Zotit”), një gazetë fetare e së dielës, e cila përkundër modestisë së tij, tërhoqi vëmendjen e atdhetarëve dhe albanologëve më të mëdhenj të kohës të tillë, si: Norbert Jokl, Holger Pedersen etj.

Pal Skiroi është i njohur, mbi të gjitha, sepse ka zbuluar në mesin e librave të panjohur të Bibliotekës së Vatikanit, librin *Meshari* të Gjon Buzuku - pas gjurmës së komunikimit të Gjergj Guxetës, që daton që nga viti 1740.

Duke marrë shkas nga ky dokument gjuhësor shumë i rëndësishëm, Pal Skiroi la një studim të pabotuar me titull “Tekstet biblike në gjuhën shqipe nga Don Gjon Buzuku”, të pajisura me përkthim dhe shënime letrare në italisht. Dorëshkrimi është një kontribut i mëtejshëm i rëndësishëm në studimin e gjuhës shqipe.

Puna e tij e fundit, sipas rendit kronologjik, ishte përkthimi i Liturgjisë së San Giovanni Crisostomo (Palermo, 1964). Vdiq më 12 shtator 1941, në Horën e Arbëreshëvet.

Paolo Schirò ishte një nga priftërinjtë më të rëndësishëm të Horës së Arbëreshëvet dhe një nga albanologët më të mëdhenj italo-

shqiptarë, i cili, me studimet e tij, dha një impuls të frytshëm në fushën e filologjisë dhe të albanologjisë.

Dhimitër Kamarda (Demetrio Camarda, 1821 – 1882)

Demetrio Camarda (Dhimitër Kamarda në shqip)- Lindi në Horën e Arbëreshëvet, më 23 tetor 1821 dhe ndërroi jetë në Livorno, më 13 prill 1882.

Studioi për prift, në Kolegjin e Propagandës Fides në Romë. Pasi u shugurua në ritin bizantin më 1844, banoi në Napoli e në fshatin e lindjes deri më 1848, kur u dëbua nga Mbretëria e Dy Sicilive prej autoriteteve burbone, me akuzën se kishte bashkëpunuar me liberalët. Në fillim shkoi në Romë e pastaj në manastirin benediktin të Çezenës. Më 1852, u emërua mësues në shkollën e mesme në Livorno, ku kaloi pjesën tjetër të jetës si famullitar.

Studiues i gjuhës arbëreshe dhe asaj greke, historian dhe filolog, ndër më të rëndësishmit e shqipes në shek. XIX. Kamarda përmendet për veprën “Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese”, Livorno, 1864 (“Sprovë e gramatologjisë krahasuese mbi gjuhën shqipe”). Ajo është një nga të parat vepra të filologjisë diakronike shqiptare, ku u orvat të provonte afërsinë e gjuhës shqipe me greqishten, në kundërshtim me gjuhëtarin komparativist gjerman Franc Bop (gjerm. Franz Bopp, 1791-1867), i cili kishte demonstruar prejardhjen e drejtpërdrejtë indoeuropiane të saj më 1854. Kjo vepër u ndoq nga “Appendice al saggio di grammatologia comparata”, Prato, 1866 (“Shtojcë për sprovë e gramatologjisë krahasuese”), një përmbledhje këngësh popullore arbëreshe. Kamarda shkroi edhe një gramatikë të gjuhës shqipe dhe botoi një libër me poezi kushtuar Dora d’Istrias, me titullin “A Dora d’Istria gli Albanesi”, Livorno, 1870, (“Dora d’Istrias, shqiptarët”), që përmbante vjersha nga Preng Doçi, Zef Jubani, Thimi Mitko, Jeronim De Rada, Françesk Anton Santori, Zef Serembe etj.

Ai bashkëpunoi me shumë intelektualë, shkrimtarë dhe gjuhëtarë të kohës: Dora d’Istria, Luigi Luciano Bonaparte, nipi i perandorit të famshëm, i cili e priti në shtëpinë e tij në Londër, Don Pedro II, perandori i Brazilit, Graziadio Isaia Ascoli, Angelo De Gubernatis,

Domenico Comparetti, gjuhëtarë të shquar italianë dhe Jeronim de Radën.

Veprat e tij me rëndësishme

-“Tre canzoni popolari albanesi di Epiri” (“Tri këngë popullore shqipe të Epirit”)

-“Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese” (1864)

-“Appendice al Saggio” (1866)

“A Dora d’Istria gli Albanesi” (1870)

Dha një kontribut të rëndësishëm mbi studimet shqiptare mbi “Alfabeti i përgjithshëm shqiptaro–epiriot”, në vitin 1869.

Zef Kamarda (Giuseppe Camarda)

Vëllai më i vogël i Dhimitër Kamardës, **Zef Kamarda** (ital. Giuseppe Camarda, 1831- 1878), përktheu Ungjillin e Shën Mateut në dialektin e Horës së Arbëreshëvet. Varianti u rishikua nga Dhimitër Kamarda dhe u botua në Londër, më 1868, nga princi Louis-Lucien Bonaparte (1813-1891). Zef Kamarda ishte autor edhe i disa poezive fetare, i një përralle dhe një përmbledhje me këngë popullore arbëreshe. (Koleksioni shqiptar në Kopenhagë ruan një numër tekstesh e dokumentesh të Dhimitër dhe Zef Kamardës, ndër to një dorëshkrim të përkthimit origjinal nga Zef Kamarda të Shën Mateut, të bërë me alfabetin grek; Gangale 1973, f. 62 (IV 6).

Gaetano Petrota (Gaetano Petrotta, 1882-1952)

Gaetano Petrota, ose siç njihet ndër arbëreshë, Papa Tani Petrotë, u edukua në seminarin italo-arbëresh të Horës, me bursë studimi të fituar nga konkursi. U urdhërua prift më 1907 nga Papa Pal Skiroi, në katedralen e Horës. Ka qenë prift i ritit bizantin, shkrimtar, filolog dhe gjuhëtar italo-arbëresh. Është hartuesi i së parës histori të letërsisë shqiptare më 1932.

I trajnuar në Seminarin Arbëresh të Palermos, ku ndërmori hapat e parë në fushën e albanologjisë, Papa Gaetano Petrotta fitoi famën si njohës ekspert i gjuhës dhe kulturës shqipe, duke zbuluar një prirje

të veçantë drejt studimeve historike të letërsisë mbarëshqiptare dhe drejt disiplinave filologjike të ndërlidhura.

Ndër përkrahësit më të bindur dhe më të guximshëm të shqiptarizmit në Sicili, ai luajti një rol të rëndësishëm si organizator i veprimtarive kulturore brenda Eparkisë së Horën e Arbëreshëvet, i zgjedhur me dekret pontifical në vitin 1937, duke ndihmuar së pari, si redaktues, revistën e së dielës “Fiala e t’in Zot”, e themeluar nga Msgr. Paolo Schirò. Më pas themeloi “Revista italo-shqiptare”, të cilën e drejtoi së bashku me vëllain e tij, Rosolino, duke marrë lëvdata nga të gjitha qarqet kulturore arbëreshe.

Në vitet e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, Gaetano Petrotta (i njohur për vendasit me emrin më të njohur Papa Tani), filloi një analizë të thellë filologjike të monumentit më të lashtë të gjuhës shqipe, duke ndërhyrë me qëndrim kritik dhe polemik. Në studimin e tij për një katekizëm shqiptare, ai përshkroi përmes kriterëve të rëndësishme filologjike që ende përbëjnë pjesën më të qëndrueshme të kësaj disipline të aplikuar në albanologji.

Midis 1933 dhe 1934, Gaetano Petrotta u ngarkua të zhvillojë disa kurse të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në Universitetin e Palermos, një post që e mbajti deri në fund të jetës.

Papas Tani i kushtoi një pjesë të madhe të veprimtarive të tij baritore dhe ekumenike, shkencore dhe kulturore Shqipërisë. Falë angazhimit të tij, u realizuan seritë e gjata të takimeve ekumenike të njohura si “Javët Orientale”, të cilat shpërfaqin tipare të vërteta midis Perëndimit dhe Lindjes së krishterë. Vdiq në Horën e Arbëreshëvet më 30 dhjetor 1952, në moshën 70 vjeç.

Nilo Borgia (1870-1942)

Nilo Borgia lindi më 1 janar të vitit 1870, në fshatin Hora e Arbëreshëvet në Sicili. Më 6 tetor 1883, hyri në Manastirin e Grottaferrata-s, një nga qendrat kryesore kulturore të ritit bizantin, pikë referimi për arbëreshët e Italisë. Më 17 mars të vitit 1894, për nder të Shën Nilo di Rossano, themeluesit të urdhrit të Shën Bazilit në Itali, murgu i ri vendosi të merrte emrin “Nilo”. Më 1904 u

emërua bibliotekar i abacisë. Më 31 dhjetor 1907, merr emërimin At Nilo si abat i Manastirit të Grottaferrata-s.

Me nismën e tij, në shtator të vitit 1909, hap një shtypshkronjë, me emrin “San Nilo”. Ai u bë mbështetës i përpjekjeve të Vatikanit për të rigjallëruar studimet dhe kërkimet në lëmin e ritit liturgjik lindor bizantin. At Nilo dha ndihmesë edhe për gjuhën shqipe, në vitin 1927 duke propozuar rigjallërimin e fjalëve të lashta shqipe që dëshmoreshin në të folmet arbëreshe. Në fushën e albanologjisë gjejmë studimin “Pericope Evangelica in lingua albanese del sec. XIV da un manoscritto greco della Biblioteca Ambrosiana”, që u botua në Grottaferrata në vitin 1930. Në vitin 1935, boton vëllimin e parë “Shënin mbi murgjit bazilian në Shqipëri”. Thuhet që në bibliotekën e Vatikanit, Borgi kishte zbuluar një dokument të hershëm të gjuhës shqipe, gjë e cila nuk doli në dritë për shkak të vdekjes së parakohshme. Vëllimi i dytë u botua në dhjetor 1942, kur autori tashmë nuk ishte më në jetë. Dy vëllimet demonstrojnë punën e viteve të fundit të jetës, i cili ia kushtoi projektit të ringjalljes së misioneve baziliane në Shqipëri. Borgia mori shkas nga studimet e Émile Legrand, në vitin 1899, dhe të Cirillo Korolevskij, në vitet 1911-‘12, ku përshkruheshin misionet e vjetra në Himarë. “Edhe pse ishte një murg dhe pjesën më të madhe e kaloi brenda mureve, ai mundi të shikonte qytetet e Shqipërisë si Fieri, Berati, Elbasani mblodhi të dhëna dhe i shkroi në projektin e tij misionar, “Shënimet e historisë misionare”. Borgia vdiq në Grottaferrata, më 3 mars të vitit 1942.

Karlo Dolçe (Carlo Dolce, 1765-1850)

Karlo Dolçe (ose siç i pëlqente ta quante veten Luz Glikjini), ishte një poet popullor dhe ironik që improvizoi vargje e kompozime në gjuhën shqipe.

Studiuesit arritën të mbledhin vargjet e tij vetëm pas vdekjes, por në një mënyrë të pjesshme, duke përdorur dëshmitë gojore, ose traditën e të shkruarit me dorë.

Puna e Dolce-s është interesante nga pikëpamja letrare dhe veçanërisht gjuhësore, pasi dokumenton të folmen e Horës së

Arbëreshëvet, duke theksuar disa veçori të rëndësishme për një studim diakronik të gjuhës.

Rosolino Petrotta (Rosolino Petrotta, 1894-1969)

Rosolino Petrotta mbaroi studimet e rinisë në Seminarin Arbëresh të Palermos, nën drejtimin e Zef Skiroit dhe të peshkopit Pal Skiro, i cili e nxiti atë të përkushtohet me bindje për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve të Sicilisë.

Pionier dhe mbështetës i ekumenizmit, së bashku me vëllanë e tij, Papas Gaetano, bashkëpunoi me disa artikuj në të përjavshmen “Fiala e t’ in Zoti” (1912-1915). Më pas, më 1919, ai themeloi “The Italian-Albanian Review”, revistë prestigjioze, e cila megjithëse ishte jetëshkurtër, punoi shumë për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e kombit shqiptar.

Në vitin 1920, u diplomua në mjekësi dhe më 1922 botoi *Udhëzuesin e ilustruar të Piana dei Greci*, si pjesë e një serie që mbledhi udhëzuesit e të gjitha komuniteteve siciliane-shqiptare.

Gjatë pushtimit ushtarak italian (1939-1945) ai udhëtoi në Shqipëri, ku fitoi besimin dhe vlerësimin e një pjese të madhe të popullsisë vendase, duke kryer edhe rolin e drejtorit të “Institutit Kombëtar të Ndihmës së Italianëve” (INAI). Gjatë qëndrimit në Shqipëri, mbrojti ashpër, para dhe gjatë konfliktit botëror, çështjen e pavarësisë dhe të lirisë së Shqipërisë.

Me ftesë të Ernest Koliqit, ministër i Arsimit Publik në atë kohë, bashkëpunoi, si ekspert, në antologjinë letrare me dy vëllime, botuar në vitin 1941, me titullin *Shkrimtarët Shqiptarë*.

Kur në Shqipëri u vendos regjimi komunist në 1945, u detyrua të kthehej në Itali. Gjatë ndryshimit të pushtetit, me guxim dhe bujari të madhe, shpëtoi shumë ushtarë dhe familje italiane nga internimi dhe burgosja.

Më 1947, Petrotta ishte edhe themeluesi i *Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve* të Palermos, veprimtaria kulturore dhe organizative e së cilës spikati për promovimin dhe zhvillimin e konferencave të rëndësishme ndërkombëtare.

Rosolino Petrotta u shqua, mbi të gjitha si politikan. I zgjedhur

deputet në Asamblenë Rajonale të Sicilisë, ai ishte këshilltar për shëndetësinë në dy legjislatura (1949-1959) dhe punoi pa u lodhur për të mbështetur me burime të konsiderueshme financiare bashkësitë shqiptare dhe Eparkinë, me të cilat u realizuan vepra të rëndësishme publike (shkolla, viadukteve, etj.) dhe i dha një strukturë funksionale ndërtesave të shenjta.

Në aspektin institucional dhe legjislativ, riorganizimi i shëndetit shoqëror pas luftës i rajonit të Sicilisë është i lidhur me emrin e tij dhe në veçanti: me ligjin për krijimin e njëjësive të spitalit të rrethit; për DLP-në në lidhje me krijimin e qendrave shëndetësore dhe të kujdesit shoqëror; për masat për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara psikofizike; për masat për realizimin e Institutit Krahinor për Kujdesin e Fëmijëve (IPAI) për mbrojtjen e foshnjave të vogla të paligjshme dhe nënave të tyre.

Vitet e fundit, si pjesë e veprimtarive të Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve, ai filloi të botojë “Librin Vjetor”, me të cilin në një periudhë trevjeçare të veprimtarisë editoriale, Petrota përçoi ngjarjet më të rëndësishme historike të të gjitha kolonive italiane midis të gjithë shqiptarëve të diasporës.

Zef Skiroi (Giuseppe Schirò, 1865-1927)

Poet, gjuhëtar, folklorist, etnograf dhe publicist i shquar arbëresh. Lindi në Horën e Arbëreshëve më 10 gusht 1865 dhe vdiq në Napoli, më 17 shkurt 1927. Studioi në Seminarin Arbëresh në Palermo, ku u formua me traditën e kulturës shqiptare si dhe të asaj klasike (Dante, Servantesi, Gëte, Shileri, etj.). Zef Skiroi shquhet si poet, prozator, dramaturg, folklorist e studiues. Profesor dhe kryetar i gjuhës shqipe dhe letërsisë në Institutin Oriental të Napolit. Poet neoklasik, prozator dhe studiues.

Ndër intelektualët më të mëdhenj arbëreshë të Sicilisë. Në një moshë shumë të re, Skiroi nisi veprimtarinë si shkrimtar dhe poet. Ai botoi një numër të madh veprash, duke përfshirë “Rapsodie Albanesi” (Palermo, 1887); “Mili e Hajdhia” (Palermo, 1890), “Te dheu i huaj” (1900), “Kthimi” (1914-1917, botuar pas vdekjes në 1965).

Botimi i parë i veprës “Te dheu i huaj” përbëhej nga dhjetë këngë, ndërsa botimi i dytë, është një version më i përpunuar, me nëntë këngë. Këngët e poemës janë: “Nata e madhe”, “Të parët”, “Ali Beg Toptani”, “Ali Pasha Tepelena”, “Vasiliqja”, “Kjyeteza e Shkodrës” “Gjin Kastrioti”, “Donika” dhe “Agullimi” (Agimi). Në poemë dalin në pah shqetësimet e Skiroit për botën arbëreshe. Gjithashtu janë të pranishme figura e Skënderbeut, Ali Pashë Tepelenës, Mahmud Pashës në Shkodër, Marko Boçarit, i cili sjell në shpirt gjakun e “Farës së vjetër”, dhe e krahason me figurën e Skënderbeut. Poeti është shqetësuar se ata nuk e përdornin më gjuhën, elementi më qenësor dallues etnik.

Në vitin 1887 botoi në Palermo, vëllimin poetik në arbërisht “Rapsodie Albanesi”. Poema “Mili e Hajdhia” bashkë me “Këngët e Milosaos” të Jeronim de Radës dhe “Kënga e sprasme e Balës” e Gavril Darës, përbëjnë treshen e poemave romantike arbëreshe të papërsëritshme në letërsinë romantike shqiptare.

Po më 1887, së bashku me Françesk Petën themeluan në Palermo revistën “Arbëri i ri”, si dhe botoi përmbledhjen e parë me vjersha. Bashkëpunoi me De Radën, Françesk Krispin, Gustav Majerin e shumë shqiptarë të asaj kohe.

Më 1889, ai botoi në “Arkiv”, “Traditat Popullore”, me regji të G. Pitrè, esetë e letërsisë popullore të kolonisë shqiptare të Piana dei Greci dhe në revistën “Sicilian Revieë”, ese për përdorimet e dasmave shqiptare, të dyja, mbetën të paplota. Ai kritikon ashpër këngët popullore tradicionale shqiptare të Italisë së Jugut nga Demetrio De Grazia, duke botuar një recesion në Arkivin Pitrè. Pas përgjigjes së De Grazia, ai publikoi një përgjigje me titull “Për një falje” (apologji).

Më 1890 emërohet drejtues i Katedrës për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Napoli. Në vitin 1912 vjen në Shqipëri ku qëndroi dy vjet në Shkodër. Lidhur me këtë udhëtim, shkoi veprën poetike “Kthimi” (1916-17).

Botimet në Palermo të versionit italisht të këngëve të dasmave shqiptare dhe të këngëve të njohura të Shqipërisë datojnë në vitin 1894. Emëruar profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në *Institutin*

Oriental të Napolit, në nëntor 1900, Skiroi vazhdoi kërkimet për letërsinë popullore, duke botuar “Këngët popullore të Shqipërisë” (Palermo, 1901), “Këngët e Shenjta të kolonive shqiptare të Sicilisë” (Napoli, 1907) dhe “Këngë tradicionale, ese të tjera nga kolonitë shqiptare të Sicilisë” (Napoli, 1923).

Gjergj Kostandini (Giorgio Costantini, 1838-1916)

Mësues dhe historian, u shkollua në Seminarin Arbëresh të Palermos. Në vitin 1905, botoi në Palermo “Gjashtëdhjetë ditët e përleshjes së ardhjes së Rosolino Pilo në Sicili”, libër mbi pjesëmarrjen e Pianës në revolucionin e vitit 1860. Autori i kompozimeve poetike në gjuhën shqipe, ku shkroi: “Adresa inauguruese rreth monumentit të ngritur Giuseppe Garibaldi ...”; “Histori - Origjina e shqiptarëve”; “Monografia e Piana dei Greci”; “Shënime për jetën dhe veprat e At Giorgio Guzzetta”. Këto shkrime, të mbledhura në një vëllim, u botuan në vitin 2000 në gjerdanet e Biblos, revista e Bibliotekës Komunale “G. Schiro”. Mbeten ende të pabotuara: “Dyqind vjet histori siciliane” (1300 - 1500); “Treqind vjet të historisë siciliane” (1016-1282); “Zibaldone e lajmeve të ndryshme”.

Nikola Barbato (Nicola Barbato 1856-1923)

Barbato lindi më 5 tetor të vitit 1856 në Horën e Arbëreshëvet. Studioi në Seminarin Arbëresh të Palermos, dhe më pas, përfundoi studimet për mjekësi në këtë qytet. Pas diplomimit, ai punoi në spitalin e Palermos, ku veç kujdesit për pacientët u thellua edhe në studimet në fushën e psikiatrisë. Njëherësh, nisi veprimtarinë si gazetar, duke trajtuar aspekte sociale e problematika që lidheshin me komunitetin shqiptar.

Barbato ishte një ndër themeluesit e Lëvizjes së Punëtorëve në Sicili (në mars 1893), me anë të së cilës iu kundërvu sa mafies siciliane. Jeta e tij ka qenë disa herë në rrezik, madje familjarë të tij u vranë nga mafia.

Barbato ka lënë shkrime të shumta politike dhe një numër të madh artikujsh të botuar kryesisht në shtypin socialist të kohës dhe tani të mbledhura në vëllime: Nicola Barbato, Scritti, Komuna

e Piana degli Albanesi, botuesi Sciascia, Romë - Caltanissetta, 1996 dhe Nicola Barbato, Socializmi i mundshëm, La Zisa, Palermo, 2000. Ai vdiq në Milano, më 23 maj 1923.

Sotir Ferrara

Lindi në Horën e Arbëreshëvet, më 5 dhjetor të vitit 1937. Pas studimeve në përgatitje për priftëri, 19 nëntor 1961, ai u shugurua prift. Ferrara është profesor i matematikës dhe i lëndëve shkencore dhe drejtor i Korit bizantin i Katedrales së Shën Mitrit, e përbërë nga arbëreshët e Sicilisë.

Më 15 tetor 1988, u emërua nga Papa Gjon Pali II në vendin e peshkopit të Eparkisë së Horës së Arbëreshëvet për arbëreshët e Sicilisë. Merr bekimin ipeshkvor në Kryekishën e Shën Mitrit të Horës së Arbëreshëvet më 15 janar 1989.

Brenda Konferencës së Peshkopëve në Itali ishte anëtar i Komisionit për ekumenizmi.

Giorgio Demetrio Gallaro

Lindi në Pozzallo më 16 janar 1948. Është peshkopi shqiptar i kishës bizantine arbëreshe në Sicili. Gallaro është pasuesi i Sotir Ferrarës. Pas studimeve përgatitore për priftëri, në vitin 1972 ai u shugurua prift.

Më 31 mars 2015, ai u emërua nga Papa Françesku peshkopi të Eparkisë së Horës e Arbëreshëvet të Sicilisë. Merr bekimin ipeshkvore në Kryekishën e Shën Mitrit të Horës së Arbëreshëvet, më 29 qershor 2015 nga peshkopi Lungro Donato Oliverio, bashkëshenjtërim me peshkopin Demetrios Salachas dhe Nicholas James Samra.

Gjergj Nikollë Brankati lindi në Horën e Arbëreshëvet. Ishte shkrimtar arbëresh i shekullit të XVIII. Ka përshtatur e parafrazuar këngë fetare, ka shkruar edhe pak vjersha origjinale, ndër to edhe ndonjë me motiv laik.

Historiani **Xhovani Skiroi** (ital. Giovanni Schirò) nga Hora e Arbëreshëvet studioi e analizoi lidhjet midis Shqipërisë dhe Italisë

së Jugut në punimin e tij “*Rapporti tra l’Epiro e il Regno delle Due Sicilie*”, 1834 (“Marrëdhëniet midis Epirit dhe Mbretërisë së Dy Sicilive”). Studimi u botua në periodikun e Palermos “*Giornale di scienze, lettere ed arti di Palermo*”.

Zef Skiro Di Maxhio (ital. Giuseppe Schirò Di Maggio, 1944) është poet, përkthyes dhe dramaturg i shquar nga *Hora e Arbëreshëvet* në Sicili. Skiro Di Maxhio është forcë aktive në jetën kulturore të bashkësisë arbëreshe në Sicili dhe kryeredaktor i revistës “*Il mondo albanese*” (“Bota shqiptare”). Di Maxhio ka shkruar nëntë përmbledhje me vjersha në shqip, mjaft prej tyre të shoqëruara me përkthim në italisht. Ndër këto vepra janë “*Gjuha e bukës*”, Prishtinë, 1981; “*Përtej maleve, prapa kodrës*”, Tiranë, 1985; “*Vjeç të tua 500 anni tuoi*”, Hora, 1988; “*Laerti i jati*”, 1989; “*Mushti 1860*”, 1984; “*Orëmira*”, 1988, dhe “*Për tokën fisnike të Horës*”, 1989. Ka përkthyer edhe veprën e Leopardit, “*Paralipomeni della Batracomiomachia*”, në shqip me titullin “*Lufta e mivet me brethqit*”, 1975.

Kuriozitet, rëndësia e ritit në identitet

Me një akt në kontratën e 30 gushtit 1488, midis shqiptarëve dhe Kryepeshkopit të Monreale-s, zyrat publike thuhej se duhet t’i zinin vetëm shtetasit shqiptarë të ritit grek. Ky privilegj, i njohur vetëm nga arbëreshët e Horës së Arbëreshëvet, mbeti në fuqi deri në vitin 1819 dhe i lejoi mërgimtarët të mbronin traditat etno-gjuhësore dhe mbi të gjitha, ato fetare.

9.3. SANTA CRISTINA GELA (SËNDAHSTINË)

Sëndahstinë (Santa Cristina Gela) është një fshat arbëresh i vogël me 993 banorë në provincën e Palermos në Sicili. Territori iu dhurua Arkipeshvit të Palermos, prej Kontit Rugero të Normandisë, më 31 maj 1691 dhe iu dha në koncesion 82 bujqve arbëreshë, të cilët vinin nga Hora e Arbëreshëvet. Këto toka për shekuj kaluan nga njeri feudal te tjetri deri në shfuqizimin e sistemit feudal në Sicili në 1812. Më vonë, në vitin 1818, u bë pjesë e Mbretërisë së dy Sicilive.

Simboli i qytetit është Chiesa Madre Maggiore, që festohet më 24 korrik. Riti bizantin u ruajt deri në gjysmën e shekullit XIX, ndërsa tani janë konvertuar në ritin latin. Por vijon të ruhet gjuha shqipe dhe kostumet. Të pranishëm janë mbiemrat: Cusimano, Bua, Cuccia, Criscione, Di Maggio, Dorangricchia, Filpi, Matesi, Matranga, Musacchia (Myzeqe), Polizzi, Rocca dhe Schirò. Interesante është ndërtesa Musacchia, e familjes arbëreshe Muzakaj, me një stil elegant dhe shtëpia e kështjellës Vannucci Ramione, e cila ngrihet në rrethin e Pianettos.

Shtëpitë e Muzakajve

Kanë marrë emrin e pronarëve të tyre. Ndërtimet kanë një arkitekturë me dy kate mbi tokë. Fasada e shtëpive Musacchia është e thjeshtë, e përbërë nga katër dyer me harqe të rrumbullakëta dhe me katër ballkone në katin e sipërm. Ndërsa horizontalisht ajo mbyllet nga një kornizë e formuar nga pikat e pllakave. Në pjesën e poshtme të bllokut, sipër shtëpisë Magaseno dhe në vazhdim të shtëpive të Musacchia, është një tarracë e vogël me kangjella murature dhe kolona, nga të cilat ju mund të shijoni peizazhin rural. Pallati aktualisht është selia e Komunës së Santa Cristina Gela.

Kisha Santa Cristina

Kisha, e ndërtuar në vitin 1815, në të njëjtin vend ku ndodhej kisha antike, u themelua nga kolonët e parë dhe iu kushtua shenjtores së qytetit, Santa Cristina. Kisha shpejt u bë një element

i dallueshëm në jetën urbane të vendit, veçanërisht për madhësinë kanonike.

Burimet e ujit

Njëherë e një kohë, burimet e ujit ishin të rëndësishme për furnizimin e familjeve, fshatarëve që kalonin aty, si dhe për përdorim nga kafshët e tyre. Sot, burimet e Santa Cristina Gela janë një element i çmuar dhe dëshmia e një civilizimi arkaik, kujtesa e të cilit gradualisht po humbet. Rikuperimi i tyre dëshmon dëshirën e rizbuluar për të nxjerrë në pah dhe për të forcuar rrënjët e një kulture, që dalëngadalë po e bren asimilimi.

Manastiri i Etërve Bazilikë (Sklica)

Manastiri i Etërve Bazilikë (Sklica) u ndërtua me nismën e murgjve basilianë të abatit të Grottaferrata-s. Murgjit, nga komunitetet shqiptare të Sicilisë dhe Kalabrisë, pasi fituan një pasuri të madhe në vitin 1949, ngritën atje një ndërtesë shkollore për fëmijët e punëtorëve që punonin në fushën e bujqësisë. Pjesë e saj është edhe një bibliotekë e vogël, e lidhur me kulturën shqiptare.

9.4. CONTESSA ENTELLINA (KUNDISA)

Contessa Entellina (Kundisa në gjuhën arbëreshe) me 1742 banorë, ndodhet në Luginën e Belice-s, në shpatet veriore të malit Genuardo dhe shtrihet në shpatin e kodrave me 571 metra mbi nivelin e detit.

Kundisa është një qytet në brendësi të Sicilisë, në të majtë të lumit Hipsas (Belici i tanishëm), në gjysmë të rrugës midis dy brigjeve. Ishte një qytet i Elimos. Kundisa ndodhej në majë të një kodre, e rrethuar nga shkëmbinjtë në tre nga të katër anët dhe me një pllajë të lartë pranë majës. Legjenda thotë se ajo u themelua nga Trojanët, të udhëhequr nga Acestes, i cili i dha emrin e gruas së tij, Entella. Virgjili thotë se ajo u themelua nga heroi Entello, mik dhe shok i Acestes.

Kundisa është vendbanimi më i vjetër shqiptar në Itali. Lindi

rreth vitit 1450, kur një grup mërgimtarësh shqiptarë, arbëreshët me në krye Reresin, erdhën në Sicili ku ata kishin shërbyer për mbretin e Napolit në vitin 1448. Akti i qirasë së tokës u nënshkrua më 14 dhjetor 1517, nga një përfaqësues i komunitetit shqiptar të Kundisës, dhe në vitin 1520, para se të mbaronte qiraja nëntëvjeçare, arbëreshët e Kundisës nënshkruan me Don Alfonso Cardona finalizimin e aktit të koncesionit. Marrëveshjet (Kapitujt zyrtarë) e lindjes, të koncesionit të pronave (feudet), u ngritën në 1520. Ky vit përkon edhe me ardhjen e emigrantëve nga Morea, të cilët nuk donin t'i nënshtroheshin zgjedhës turke, ose të mohonin fenë e tyre të krishterë-bizantine. Ata ikën dhe zbarkuan në brigjet qendrore dhe jugore të Italisë. Duke u regjistruar sipas rrit dhe jo sipas etnisë, banorët e Kundisës gabimisht u quajtën “grekë”.

Arbëreshët e ndërtuan qytetin pranë rrënojave të largëta të një ferme të vogël, Casale di Comitissa ose Vinea Comitissae, e populluar nga ushtarë shqiptarë nga Casale di Bisiri (Mazara). Ata ndërtuan shtëpitë e para, kishën e S. Annunziata dhe themeluan vendbanimin arbëresh, duke i dhënë emrin Contessa (tani *Contessa Entellina*).



Qendra e Contessa Entellina-s

Pas tërmetit të vitit 1968, qyteti u zgjerua disi në pjesën e Fusha Kavalari. Megjithatë, qendra historike është ende e populluar, ku përfshihet rruga “Morea”, “Kastriota”, “Musakchia”, “Kroja” dhe “Piazza Umberto I”. Ushtarë të tjerë shqiptarë u vendosën në Taormina, të tjerët u rikthyen në shtëpi.

Abazia Santa Maria del Bosco

Ndërtesat monumentale përfshijnë kishat e rritit bizantin të modelit arkitektonik oriental: me ikonat, ikonostasin, mozaikët. Një kishë e veçantë është ajo e SS. Annunziata dhe San Nicolò di Mira (Klisha dhe Shën Kolli). Kisha Nënë e Contessa Entellina u ndërtua dhe u përfundua në vitin 1520 nga mërgimtarët e parë arbëreshë, menjëherë pas mbërritjes së tyre. Në të festohet liturgjia hyjnore sipas rritit bizantino-grek. Riti bizantin solemnizohet në të gjitha kishat e tjera të Contessa: Anime Sante (Shpirtrat dhe Shejt), Maria dell’Itria ose Odigitria (Mëria dhe Dhitrjes), San Rocco (Shën Rroku), S. Antonio Abate (Shën Gjoni).

Antikuariumi “G. Nenci”

Antikuariumi është një muze arkeologjik që i ofron vizitorit një udhëtim në zbulim të historisë, kulturës dhe artefakteve të qytetit të Entellës, nga vendbanimet e para neolitike të Elimit, tek ato të epokës helenistike dhe mesjetare deri në shkatërrimin e qytetit, në vitin 1224 nga Federico II.

Rezerva natyrore “Grotta di Entella”

Shpella Entella është një formacion karstik që zhvillohet brenda *Rocca di Entella* (557 metra mbi nivelin e detit). Për ta vizituar, duhet të rezervoni në CAI (Club Alpino Italiano), organ menaxhues, që prej vitit 1995.

Gjuha shqipe

Gjuha arbëreshe u mësohet gjithnjë e më pak brezave të rinj, për fat të keq kjo është një humbje e madhe e identitetit etnik dhe

gjuhësor të komunitetit. Me gjithë përpjekjet etniko-kulturore, për ruajtjen e identitetit të saj dhe aspekteve fetare, gjuha arbëreshe në Contessa Entellina rrezikon të zhduket, për shkak të flukseve migratore të fillimit të shekullit XX dhe mosinteresimit të brezave të rinj, me gjithë që mësimi i saj ishte i detyrueshëm në shkollat fillore dhe të mesme. Kjo bazohet në ligjin e legjislacionit shtetëror (ligji 482/1999) që mbron pakicat etnike dhe gjuhësore.

Contessa Entellina së bashku me Horën e Arbëreshëvet dhe Santa Cristina Gela-n, si bashkësi shqiptare (arbëreshe) të Sicilisë, lindën në shekullin XV. Aty ende flitet gjuha e lashtë shqipe (gluha arbëreshe). Banorët e saj janë arbëreshë, domethënë italo-shqiptarë.

Në 1978 u formua grupi folklorik “Brinjat”, i cili mban gjallë traditën shqiptare me këngë e valle. Falë kësaj përvoje, e cila vijon edhe sot, njohim dhe mësojnë meloditë popullore arbëreshe shqiptare.

Figura te shquara të Contessa Entellina:

Nikollë Keta (Nicolò Chetta, 1741-1803) ishte prift bizantin-grek, poet, shkrimtar, historian, etnograf dhe teolog, rektor i Seminarit Italo-Shqiptar të Palermos. Në Seminar pati mësues Gjergj Guxetën dhe dijetarin Paolo Maria Parrino (1710-1765). Në vitin 1777, Keta u bë vetë rektor i atij Seminari. Keta ishte poet me imagjinatë krijuese, ndonëse vargu i tij, me sa mund të gjykojmë sot për sot, nuk shquhet për ndonjë frymëzim të thellë, për metrikë të përpunuar apo për mjeshtëri gjuhësore. Rëndësia e tij, përgjithësisht, qëndron më fort në larminë dhe shumanshmërinë e interesave dhe përpjekjeve si leksikograf e gjuhëtar, si një historian romantik i ndikuar mjaft nga Parrino dhe Guxeta. Si poet ka shkruar vargje fetare dhe laike në gjuhën shqipe dhe në greqishte. Ai ka meritën të jetë autori i tingëllimës së parë shqiptare (1777): “Farie së ndeeme në Kuntisë u bii Kolë Ketta, vllastar i t’arbrit dhe, Shkoi në Palermë praa tek e Arbrit shpii, Ç’e reshti, si zogu rep në folee”.

Më 1763, Keta hartoi një fjalor italisht-shqip prej 240 faqesh, i cili më 1779 u pasurua me rreth 10.000 fjalë, deri në 640 faqe. Një kopje e këtij “Vocabulario italiano-albanese”, ende e pabotuar,

ruhet në Koleksionin Shqiptar në Bibliotekën Mbretërore në Kopenhagë. Libri i tij, “Tesoro di notizie su de’ Macedoni”, 1777 (“Thesar njoftimesh mbi maqedonasit”) është një trajtesë historike etnografike në italishte, deri diku jo pa atë shkallë fantazie tipike për kohën, për prejardhjen dhe historinë e shqiptarëve e të emigrimit të tyre në Itali. Ajo u botua pjesërisht në revistën “La Sicilia”, në Palermo, më 1867. Vëllimi i parë trajton etnogenezën e shqiptarëve deri në periudhën romake dhe përhapjen e krishterimit; vëllimi i dytë trajton historinë e shqiptarëve nga periudha romake e deri në ditët tona, kurse vëllimi i tretë - emigrimin nga Shqipëria dhe Greqia në Italinë e Jugut si dhe themelimin e Seminarit Arbëresh në Palermo. Gangale në vitin 1973, faqe 57, thotë se në dorëshkrime ka gjetur të dhëna që të bëjnë të mendosh se Keta ka lindur më 1723, dhe ngul këmbë se viti 1740, që mbahet përgjithësisht si vit i lindjes, është gabim i Petrotta-s.

Ndër figurat intelektuale përmendim: **Antonino Cuccia** (1850-1938), një poet popullor, veprat e të cilit përbëjnë një dëshmi domethënëse të gjuhës shqipe të folur në Contessa Entellina.

Leonardo Lala (1906-2000), poet dhe shkrimtar popullor arbëresh, ekspert në gjuhën, historinë dhe traditat shqiptare. Ai njihej me pseudonimin (Ofiqe) në shqip “Narduci”.

Papà Michele Lojaco (1907-1957), një prift i ritit të bizantit, prift famullitar i kishës italo-shqiptare të Palermos, mësues dhe publicist. Angazhimi më i rëndësishëm kulturor ishte buletini italo-shqiptar “Biga”, që synonte përhapjen e informacionit rreth dioqezës bizantine të Horës së Arbëreshëvet dhe komuniteteve shqiptare të Italisë.

Papàs Matteo Sciambra (Mateu Shembra në arbërisht, 1914-1967), lindi në Kundisa. Ishte prift i ritit bizantin dhe profesor universitar, i cili u përkushtua me angazhim të madh në thellimin e gjuhës shqipe, në ruajtjen dhe pasurimin e muzikës bizantine liturgjike të shqiptarëve të Sicilisë, duke shkruar dorëshkrime të rëndësishme në greqisht dhe disa punime me tema arbëreshe.

Ishte ndër të parët që studioi dhe publikoi veprat e autorëve shqiptarë dhe i përmbloodhi në monografitë: “Mbi malin e

trëndafilave”, “E mbësue me e kërshterë”, “Bogdanika”, “Çeta e profetëve”, etj. Vdiq papritur dhe para kohe në vitin 1967.

9.5. PALAZZO ADRIANO (PALLACI)



Qyteza e Pallacit shtrihet në një nga shpatet veriore të *Monte delle Rose* (arbërisht, Mali i Trëndafilët).

Mijëra shqiptarë, në vitin 1480, u nisën nga Lezha dhe zbritën në Catania. Erdhën nga trojet shqiptare, por edhe nga Morea. Pallaci është vendi i Gavril Darës, i cili nuk harroi kurrë rrënjët. Kjo duket edhe tek pasardhësi i tij, Gavril Dara (I Riu), i cili në një letër i shkruan De Radës se “*banorët e hershëm... (prindërit tanë) erdhën drejt e nga Kruja dhe viset afër Krujës pas betejave të fundit që bënë me turqit*”. Dhe rreth 100 vjet me vonë erdhën edhe vëllezërit nga Korona”.

Në këtë qytezë arbëreshe dikur lulëzonte Arbëria. Karakteristika kryesore e Pallacit konsiston në faktin se, nga pikëpamja e besimit, si banorët e ritit bizantin, qoftë ato të ritit latin jetojnë së bashku në harmoni. Nga pikëpamja fetare, shumë arbëreshë kanë humbur ritin bizantin, por ka një interesim të arbëreshëve për konvertimin në ritin bizantin, për të ruajtur identitetin.

Kisha bizantine Maria SS. Assunta

Kisha S. SS. Assunta u ndërtua në vitin 1532 dhe u zgjerua në vitin 1770. Kisha greko-bizantine, kushtuar Maria Santissima Assunta ndodhet në sheshin “Umberto I”. Shkallët anësore janë në blloqe. Kjo për shkak të traditës popullore të mbretit Ferdinand IV, i cili mbërrinte me kalë deri në hyrjen e kishës, sa herë që shkonte në Pallaci.

Kjo kishë është panteoni i bashkësisë shqiptare të Pallacit. Në të, ekzistojnë varret e disa prej bijve të saj të shquar dhe gurët e varreve të parë janë në gjuhën shqipe. Këto kanë rëndësi të madhe historike dhe kulturore.

Kisha ka një sakristi dhe një kullë kambanore, e rindërtuar në fund të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Disa kapela u stolisën ndoshta me ndihmesën e njerëzve të pasur vendas, siç ishin fisi Di Maggio që kontribuoi për navetën e djathtë, apo fisi Mancuso (nga të cilat Baroni Pietro Mancuso) për kapelën në të djathtë.

Ndërtesat fetare, ku është zyrtarizuar riti bizantin

Ndërtesat fetare, ku është zyrtarizuar riti bizantin janë: Shenjtorja e Maria Santissima delle Grazie; Kisha famullitare e Maria Santissima Assunta; Kisha famullitare e Maria Santissima del Lume; Kisha e San Nicola di Mira; Kisha e Santa Maria del Rosario e njohur si Pietà; Kisha e San Giovanni Battista; Kisha e Maria Santissima del Carmelo; kapela e Sant’Anna.

Kisha Maria Santissima del Lume

E ndërtuar nga Baroni Schirò në vitin 1840, ajo ndodhet në zonën ku qëndronte dikur kisha e San Sebastianos. Fasada kryesore ka tri nika, që përmbajnë statujat e San Pietro, San Paolo dhe San Michele Arcangelo. Brenda, ndërtesa është e ndarë në tre naveta, me dymbëdhjetë kolona me dy blloqe dhe altarët e zbukuruar me kanavacë dhe disa afreske që i atribuohen Zoppo di Gangi. Fasadat anësore janë prej guri, ndërsa kasaforta dhe absida janë zbukuruar me disa afreske. Kisha ka dhe një kambanore, e cila ka një orë mekanike, e ndërtuar në shekullin XX. Ajo i është nënshtruar një restaurimi rrënjësor në fasadë në fund të shekullit XX.

Në sheshin “Umberto I” ndodhet shatërvani i ndërtuar nga arbëreshët dhe i përket shekullit XVI. Elegant në stilin e tij, me formë tetëkëndore, pra me simbolikën e numrit tetë, numri i pafundësisë. Banorët vendas tregojnë se te ky shatërvan u xhiruan sekuenca të filmit fitues të çmimit “Oscar” për filmin më të mirë të huaj, “Nuovo Cinema Paradiso” të regjisorit Giuseppe Tornatore.

“Mali i Trëndafilët”

“Mali i Trëndafilët”, siç i thonë arbëreshët malit *Monte delle Rose* është i lartë 1436 metra mbi nivelin e detit. Ndodhet në luginën e Sosio-s (Pallaci) dhe ngrihet në një zonë ku natyra është e paprekur dhe pak e populluar. Mali i Trëndafilët është përmendur edhe nga Aristoteli e nga Plini Plaku, pasi në lashtësi ishte i famshëm për bimët e tij të egra të virtytshme, objekt i studimeve për shumë botanistë. Hipoteza më e mundshme është se emri rrjedh nga lulja dhe më saktë nga trëndafilat e peonies, të cilët lulëzojnë në shkurt, pa gjemba dhe rriten mbi të gjitha në këtë mal. Thuhet se trëndafilat u rritën kur kaloi Shën Rosalia, vajza e fisnikut Sinibaldo, zot i Quisquina-s dhe i Malit të Trëndafilët. Këto trëndafila janë të bardhë, të verdhë, rozë dhe të kuq.

Mbi të është vendosur një kryq i ritit arbëresh. Më 1 gusht përkujtohet ardhja e etërve shqiptarë që themeluan Pallacin, pikërisht me 1 gusht të vitit 1482 (data përkon me Festën e Grurit). Arbëreshët e Pallacit në këtë ditë organizojnë një marshim dhe sapo

mbërrijnë në majë këndojnë këngën “Moj e bukura More”, duke vështruar nga Shqipëria.

Në shesh është ndërtuar kroi (shatërvani) me dy gojë, që njihet si vepër e arbëreshëve të shekullit XVI. Muret e vjetra të shtëpive karakteristike arbëreshe, arkitektura e qytezës, harqet, muret e trasha, gjitonia, janë vetëm disa prej gjurmëve të tyre. Ndihet një heshtje melankolike në këtë hapësirë. Shtëpitë e Darenjve, Bastave, Biderave, Krispëve, Kjarajve, janë atje, edhe pse shekujt kalojnë.

Piktori francez Jean-Pierre Houwl dhe kostumet arbëreshe

Më 1782, piktori francez, J. Houwl përshkroi veshjet për raste dhe veshjet e përditshme të grave të Pallacit me detaje. Ai u magjeps aq shumë prej tyre, sa që donte t'i bënte ato të pavdekshme. Thuhet se ai bëri një përzierje të bojërave të ujit me qymyr druri dhe krijoi gjallërinë e veshjeve për festa, fustanet gjysmëfestive, kostumin e dasmës për femra dhe meshkuj, fustanin e gruas së martuar, atë të vajzës dhe në fund veshjen e përditshme. Mendohet se punimet e tij janë ndër dëshmitë më të hershme që riprodhojnë veshjet tradicionale të një vendi arbëresh.

Mbiemrat me origjinë shqiptare

Mbiemrat më të zakonshëm me origjinë shqiptare janë: Alessi, Barbata, Barcia, Cuccia, Francaviglia, Gagliano, Granà, Grisafi, Longo, Marino, Masaracchia, Raggio, Russo, Sabella, Schirò, Sciarba, Sulli.

Pallaci, “bashki e pakicës shqipfolëse”

Pallaci konsiderohet si “bashki e pakicës shqipfolëse”, sipas ligjit 482/99 (Norma në lidhje me mbrojtjen e pakicave historike gjuhësore). Gjuha e lashtë shqipe nuk është më gjuha e komunitetit. Sot ka humbur thujt plotësisht dhe flitet vetëm nga disa të moshuar.

Figura të shquara të Pallacit

Giuseppe Crispi

Zef Krispi (ital. Giuseppe Crispi, 1781-1859), nga Pallaci i Sicilisë. Ai ishte prift, profesor i letërsisë greke në Universitetin e Palermos dhe rektor i Seminarit Grek.

Mbahet mend për punimin e tij “*Memoria sulla lingua albanese*”, Palermo, 1831 (“Shënime mbi gjuhën shqipe”), i cili hedh dritë mbi tezën e prejardhjes pellazgjike të popullit shqiptar, një teori e përhapur asokohe, që as vitet e fundit nuk është lënë përfundimisht.

Ai është autor i një përmbledhjeje këngësh popullore arbëreshe të Sicilisë, shoqëruar nga përkthime në italishte, të titulluara “*Canti degli Albanesi di Sicilia*” (“Këngë të shqiptarëve të Sicilisë”), botuar në “*Canti popolari siciliani*”, Catania, 1857 (“Këngë popullore siciliane”), të Leonardo Vigos dhe i “*Memorie storiche di alcune costumanze appartenenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia*”, Palermo, 1853 (botuar në periodikun e Palermos ‘*Giornale di scienze, lettere ed arti di Palermo*’).

Familja Dara

Gavril Dara, Plaku, lindi më 15 korrik 1765 dhe vdiq më 19 maj 1832. Studioi në Seminarin Arbëresh të Palermos dhe më vonë u diplomua në mjekësi e në drejtësi. Mblodhi nga pleqtë “Kënkat e pleqërisë” dhe hartoi disa vjersha në gjuhën shqipe dhe këngën e Shën Lazarit që këndohet edhe sot tek arbëreshët e Sicilisë. Përmbledhja me këngë popullore arbëreshe e tij ka humbur.

Andrea Dara, i biri i Gavrililit, lindi më 17 maj 1796 dhe vdiq më 2 prill 1872. U diplomua në drejtësi. Shfaqti interes për folklorin arbëresh. Është autor i një përmbledhjeje me këngë popullore arbëreshe të Sicilisë, i një veprë mbi “Usi e costumi di Palazzo Adriano” (“Zakonet dhe veshjet e Pallacit”), 1859; një fjalori me 5000 fjalë shqip-italisht (1862-1868); një gramatike të shkurtër të shqipes (1830) dhe një përkthimi të Ungjillit të Shën Mateut. Shumica e këtyre veprave mbetën të pabotuara dhe ruhen në formë dorëshkrimi në Koleksionin Shqiptar të Bibliotekës Mbretërore në Kopenhagën.

Gavril Dara (I Riu), autori i veprës epiko-lirike “Kënka e Sprasme e Ballës”. Dara i Ri ishte poet, gazetar, jurist. Lindi më 8 dhjetor 1825 dhe vdiq më 19 nëntor 1885. Ishte i biri i Andrè Darës dhe i Françeska Dragotës. Studioi në Seminarin Arbëresh të Palermos dhe u diplomua për drejtësi. Fillon punë në Agrigento. Merr pjesë në lëvizjet e Rilindjes italiane, si anëtar i Komitetit kryengritës të Agrigento-s e më 1860, emërohet me dekret të Xhuzepe Garibaldit, sekretar i përgjithshëm i qeverisë së atij qyteti. Më 1867, emërohet prefekt i Trapanit. Me 1870, e la këtë detyrë për arsye politike, shkoi në Romë e aty drejtoi për disa vjet (1871-1874) gazetën “La Riforma”, ku u dallua edhe si gazetar. Pas disa vitesh kthehet në Agrigento dhe jetoi aty deri në fund të jetës. Arbëreshët shkruan në gjuhën shqipe mbi lapidarin e familjes Dara, ku prehen eshtrat e tyre: “Burrë i dijëshëm nga më të dijëshmit” - 19 maj 1832.

Emanuel Bidera (ital. Emmanuele Bidera, 1784-1858) nga Pallaci i Sicilisë. Përsiatjet e tij tepër të lirshme për prejardhjen e shqiptarëve si popull u botuan në librin me katër vëllime “*Quaranta secoli racconti su le Due Sicilie*” (“Dyzet shekuj të rrëfyera për Dy Sicilitë”), Napoli, 1846-1850. Themelues dhe drejtor i një shkolle të gojëtarisë në Napoli, Bidera shkroi edhe librete operash për kompozitorin Gaetano Donixeti (ital. Gaetano Donizetti, 1797-1848) në rininë e tij.

Pjetër Kjara (ital. Pietro Chiara, 1840-1915), lindi në Pallaci, në Sicili. Kushëri i Gavril Darës së Riut (1826-1885), Kjara bëri udhëtime në Shqipëri e në Ballkan më 1879 dhe, si shqipfolës që ishte, arriti të depërtojë thellë në gjendjen politike gjatë atyre viteve të ndera e vendimtare të Lidhjes së Prizrenit. Është autor i dy librave në italisht për Shqipërinë: “*L’Albania*”, Palermo 1869 (Shqipëria), monografi në dymbëdhjetë krerë për gjuhën, letërsinë, historinë dhe politikën shqiptare, dhe “*L’Epiro, gli Albanesi e la Lega*” (“Epiri, shqiptarët dhe Lidhja”), Palermo 1880, përmbledhje shkrimesh informative të botuara së pari në gazetën e Romës “*La Riforma*”, redaktuar në vitet 1871 deri 1874 nga Gavril Dara i Riu. Kjara, i cili

ishte edhe deputet në Parlament, botoi artikuj në të përmuajshmen e De Radës “*Fiàmuri Arbërit*”, e themeluar më 1883, si dhe shkroi disa poezi lirike modeste.

Mosè Troiano nga Pllatani në veri të Kozencës, njihet si përkthyes i dy vjershave italiane në shqipe, duke përdorur alfabetin e përhapur nga Jeronim de Rada. Ato datojnë nga fillimi i mesit të shekullit të XIX.

Nikollë Suli (ital. Nicolò Suli, vd. 1785), prift nga Pallaci dhe zëvendësrektor i Seminarit Arbëresh në Palermo; ka qenë autor i një vjershe shqip që daton në vitin 1757.

Xhuzepe Barça (ital. Giuseppe Barcia) nga Pallaci, autor i një vjershe didaktike, të shkruar më 1753, me titullin “Njeriu i harroshëm”.

9.5. MEZZOJUSO (MUNXIFSI)

Mezzojuso u themelua si një qytezë arbëreshe, por me kalimin e shekujve u asimilua. Nga Mezzojuso arbëreshe ka ngelur vetëm një vizatim, i cili ndodhet i varur në komunën e Mezzojuso-s. Vizatimi paraqet Mezzojuso-n e shekullit XV. Duken qartë dy kodrat, më e madhja quhet Brinja (Brigna) dhe tjetra më e ulët, quhet Durrachion – Durrësi, emra të cilët janë në gjuhën shqipe dhe që arbëreshët e sollën me vete.

Mbiemrat më të zakonshëm me origjinë shqiptare janë: Barcia, Barone, Bisulca, Burriesci, Como, Cuccia, D’Amico, D’Orsa, Figlia, Musacchio, Schirò, Schilizzi, Spata, Zito. Rrugicat ruajnë karakteristikat e saj dhe sensin e gjitonisë.

Zemra e Mezzojuso-s është sheshi, ku qëndrojnë kishat e rritit katolik dhe bizantin. Fshati e ruan ende frymën e kulturës arbëreshe në arkitekturën e vet. Në sheshin kryesor të fshatit Mezzojuso ka dy objekte kulti: Kisha e San Nicolò di Mira, e rritit bizantin, e

themeluar në 1516 nga mërgimtarët shqiptarë dhe Kisha Annunziata e ritit latin. Kisha Annunziata, e cila dikur i përkiste ritit bizantin, u ndërtua nga mërgimtarë shqiptarë, në vitin 1572.

Manastiri Bazilian

Në skajin e largët të qytetit qëndron Manastiri Bazilian, i ndërtuar në vitin 1609. Ai ishte një qendër e rëndësishme fetare dhe kulturore e shqiptarëve në Sicili, ku punuan murgjit ikonografikë. I themeluar nga Andrea Reres në vitin 1609, ishte e para qendër arsimore kishtarë e Arbërisë siciliane dhe më e rëndësishmja deri në gjysmën e shekullit XVIII.

Aty studionin dhe vepronin “grekë” të ndryshëm: shumica arbëreshë vendas, grekë “venedikas” të Gadishullit të Moresë (Peloponezi i sotëm) dhe të ishullit Kandja (Kreta e sotme), si dhe ndonjë italian i kishës “italo-greke”, që mbijetonte ende në Italinë e Jugut në atë periudhë, si pasojë e sundimit të gjatë bizantin në ato treva. Në këtë manastir studiohej greqishtja liturgjike, por kishte



interes edhe ndaj arbërishtes, që u shërbente murgjve në misionet fetare në Shqipërinë e Jugut, sidomos në Himarë, ku u duhej doemos të përdornin shqipen, krahas greqishtes.

Ndër murgjit bazilianë arbëreshë, por edhe italianë, katolikë të ritit bizantin, të cilët morën pjesë nga gjysma e shek. XVII deri në gjysmën e shek. XVIII në këto misione të përkrahura nga Kongregata “De Propaganda Fide”, përmendim misionarët: Nilo Catalano, italian me origjinë nga Messina, i cili më pas u arbëreshizua nga ana kulturore dhe gjuhësore; Filoteo Zassi e Callinico Granà nga Munxifsi; Basilio Matranga e Giuseppe Schirò, të dy nga Hora e Arbëreshëvet. Misionarët arbëreshë që vinin nga manastiri bazilian i Munxifsit hapën shkollat e para shqipe në Jugun e Shqipërisë: qëllimi i këtyre shkollave në Himarë ishte kryesisht fetar – mbrojtja e besimit të krishterë sipas ritit bizantin, por brenda kishës katolike – që kërcënohej qoftë nga sundimi osman, qoftë edhe nga Kisha ortodokse greke. Shqipja, siç dëshmojnë tekstet e botuara dhe dorëshkrimet që na kanë mbërritur nga disa prej misionarëve, si ato të Imzot Zef Skiroit, njihej dhe përdorej nga misionarët që vinin nga Munxifsi si gjuhë ndërmjetësimi për të lehtësuar ungjillëzimin e këtyre trevave shqiptare, të lidhura ngushtë qoftë me Mbretërinë e Napolit, qoftë me Republikën e Venedikut.

Në manastir ndodhet Kisha e Santa Maria delle Grazie, e ndërtuar në vitin 1501 dhe e ndryshuar në shekullin XVIII në një projekt nga Nilo Gizza. Kisha është e pasur me ikona të stilit të vonë bizantin. Dy panelet kryesore të saj shfaqin “Shëlbuesin Krishti, mbretin e mbretërve dhe kryepriftin” dhe “Virgjëreshën”. Në muret e navetës ka gjashtë medaljone me afresket e shenjtorëve dhe peshkopët: Partenio, Gregorio Theologian, Spiridione, Epifanio, Cirillo, Nicola dhe Atanasio. Në kishë ndodhet sarkofagu i shqiptarit Andrea Reres, themeluesi i Manastirit.

Dy kishat nënë në sheshin qendror të qytetit: Kisha e Shpalljes, e ritit latin dhe San Nicolò di Mira, e ritit bizantin, janë simbol i bashkëjetesës mijërvjeçare të identiteteve kulturore.

Biblioteka

Manastiri i Mezzojuso-s kishte një bibliotekë të pasur me libra, dokumente e dorëshkrime të vjetra. Ai ishte një institucion kulture, ku murgjit e palodhur i dhanë dituri dhe kulturë komunitetit arbëresh të Sicilisë. Në arkivin e Manastirit dhe të famullisë Shën Nikolla, ndodhen dokumente interesante, ndër to një dorëshkrim antik në dy vëllime me titull: “Memoria per il Monastero di San Basilio di Mezzojuso”. Një nga këto vëllime është transkriptuar nga Karmelo Filia-Spata, murg arbëresh nga Mezzojuso. Memoriali fillon me një koment të shkurtër, rreth testamentit të Andrea Reresit dhe vazhdon me fakte dhe ngjarje fetare, sociale dhe kulturore në manastir. Informacioni i dokumentuar vijon deri më 16 tetor 1706, ditën kur vdiq arbëreshi Don Nunzio Schirò, i cili e pasuronte rregullisht kronikën e manastirit. Me rëndësi janë dokumente dhe dorëshkrime të tjera, të sistemuara në vëllime të veçanta dhe të arkivuara në bibliotekën e manastirit nga murgu arbëresh, Kalliniko Granà.

Në vitin 1920, Konfraterniteti vendosi që fondacioni “Andrea Reres”, të shndërrohet në “Instituti Andrea Reres”, me objektiv edukimin dhe formimin kulturor të rinisë arbëreshe të ritit ortodoks. Misioni iu besua Eërve Basilianë të Manastirit të Grottaferrata, ku ruhen libra të shumtë dhe dokumente me vlera për historinë, kulturën dhe krishterimin në trojet arbërore, por për fat të keq, ende të pastuduara. Në këtë manastir, historiani i krishterimit, murgu Nilo Borgia (Borshi), kishte zbuluar një shkrim në gjuhën shqipe, që mendohet se i përkiste shekullit XIII, por ai vdiq dhe nuk arriti ta bënte publik atë. Ndërtesa e rinovuar e manastirit ka dhe bibliotekën e re. Në të janë depozituar pjesa e librave antikë, që u shpëtuan nga djegiet, vjedhjet dhe shkatërrimet, të cilat është e nevojshme të hulumtohen.

Mezzojuso, familja Reres

Familja Reres, krahas kontributeve ushtarake dhe administrative, u integrua dhe në jetën shoqërore e shpirtërore të arbëreshëve dhe italianëve. Në veçanti shquhet murgu Andrea Reres, stërnipi i

Dhimitrit, i cili themeloi Manastirin Basilian të Mezzojuso-s.

Murgu Andrea Reres, i biri i Teodor Reres dhe Agnese Reres, vdiq në Mezzojuso në vitin 1609.

Jeta dhe aktiviteti i Andrea Reres lidhen me manastirin e Mezzojuso-s. Në një memorial rreth Mezzojuso-s, arbëreshi Nikolla Filia, shkruan se arbëreshët, me nismën e murgut Andrea Reres, në vitin 1601, kërkuan themelimin e një manastiri të ritit bizantin, pranë kishës së Shën Maries në Mezzojuso. Këtë fakt e konfirmon dhe arbëreshi Nikolla Keta, i cili tregon se ky akt u firmos nga noteri arbëresh Luka Kuçia (Luca Cuccia) më 12 janar 1601, ku dokumenton se manastiri basilian i Mezzojuso-s u themelua nga Andrea Reres.¹³²

Figura të shquara të Munxifsit

Nikollë Filja (ital. Nicolò Figlia, 1682-1769). Lindi e Munxifsi. Ishte kryepriфт në Cheuti dhe njihet edhe si mbajtës i kodit të Cheuti-t (Qeuti), për të cilin thuhet se e ka pasur këtë kodik të tijin nga viti 1736 deri më 1746. Veprimtarinë si kryepriфт e zhvilloi në fshatin e tij Munxifsi (ital. Mezzojuso). Është autor i vjershave fetare, pa ndonjë meritë artistike të veçantë. Ka përkthyer, gjithashtu, një katekizëm të titulluar “I Cristèu i Arbrësc mbesùare ne mistiriet kliscese scèite” (“I krishteri arbëresh i mësuar me të fshehtat e kishës së shenjtë”) në dialektin sot të zhdukur të Munxifsit. Përveç kësaj, mendohet se Filja ka përmbledhur të 18 këngët popullore arbëreshe të përfshira në këtë kodik *Këngëzë të pleqrijsë*, që përbën përmbledhjen më të hershme ekzistuese të këngëve popullore arbëreshe.¹³³

Jovan Thoma Barbaçi (ital. Giovanni Tommaso Barbaci, 1742-1791) nga Munxifsi, famullitar i Kishës Ortodokse në Napoli dhe, ashtu si Andrea Filja, kapelan i Regjimentit Maqedonas Perandorak, për të cilin thuhet se ka qenë mësues i greqishtes në Trapani. Barbaçi

¹³² Nicolò Chetta, *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*, Contessa Entellina 2002, f. 454.

¹³³ Robert Elsie, *History of Albanian Literature*, 1995, f.76.

përmendet për një vjershë fetare me titullin “O ti çë helme shkove”, kushtuar Shën Mërisë.

Neofit Rodinosë (Neofito Rodinò, 1576-1659), misionar qipriot. Rodinoja ka kaluar disa vjet në ngulimet arbëreshe në Italinë jugore, përfshirë Munxifsin, në Sicili dhe Barill (ital. *Barile*) në Potenzë.

Nilo Katalano (Nilo Catalano, 1637-1694)

Nilo Katalano lindi afër Mesinës. U emërua kryepeshkop i Durrësit dhe famullitar apostolik i Himarës, më 1693. Vdiq një vit më pas, me 3 qershor 1694. U dha mësim të gjuhës shqipe arbëreshëve të Munxifsit.

Dorëshkrimi i veprës së tij “Vocabolario albanese-italiano et italiano-albanese” (“Fjalor shqip-italisht dhe italisht-shqip”) u bë i njohur nga Xhuzepe Krispi (Giuseppe Crispi, 1781-1859), pasi e gjet në Bibliotekën e Seminarit Arbëresh në Palermo, më 1831. Më vonë, ai ra në duart e studiuesit dhe shkrimtarit arbëresh Zef Skiroi, plak, (Giuseppe Schirò senior, 1865-1927).

9.6. KRAHINA E AGRIGENTO-S

Sant’Angelo Muxaro (Shënt’Engjëlli)

Sant’Angelo Muxaro është Mu-Assar i lashtë, një fshat i fortifikuar me origjinë arabe. Shqiptarët e parë që u vendosën në Sant’Angelo Muxaro ishin disa stratiotë, të cilët mbërritën në Sicili në vitin 1448 për të mbrojtur bregdetin perëndimor të ishullit nga sulmet e Valois-Anjou. Pas dy vjetësh, frika e një pushtimi bëri që stratiotët të sillnin familjet e tyre.

Në vitin 1511 qyteti u ndërtua, duke favorizuar kolonizimin nga arbëreshë që lëvizën në drejtim të qytetit të afërt të Pallacit. Sot komuniteti arbëresh është integruar plotësisht me popullsinë vendase, duke ruajtur vetëm pjesërisht kulturën origjinale ndërsa riti bizantin është zhdukur përfundimisht.

Figura të shquara të Agrigentos:

Franchesko Krispi (Francesco Crispi)

Lindi në Ribera (Agrigento) më 4 tetor 1818. Mbaroi studimet në Seminarin Arbëresh të Palermos, ku ishin edhe Antonio Gramshi dhe shumë arbëreshë të tjerë. Studimet e larta i kreu për drejtësi dhe për njëfarë kohe ushtroi profesionin e avokatit, në Palermo, më 1837.

Më 1839, Franchesko Krispi drejtoi gazetën “L’Oreteo” për tre vjet rresht. Në vitin 1844 u përfshi në politikë, duke zhvilluar ide dhe propagandë liberale. Në vitin 1848, ai mori pjesë në revolucionin që shpërtheu në Palermo dhe ishte anëtar i Qeverisë së Përkohshme. Bashkë me arbëreshin tjetër, Rosalino Pilo, në janar të vitit 1848, ai e udhëhoqi kryengritjen e Sicilisë kundër burbonëve. Zhvendoset në Piemonte ku për katër vjet ishte në mërgim, duke kryer hulumtime historike dhe aktivitete botuese. Në 1853 u dëbua nga Piemonte, dhe iku në Maltë, ku themeloi një tjetër gazetë, “La Staffetta”, dhe u martua me Rosalia Montmasson (1823-1904). Pasi u dëbua edhe nga Malta, Krispi shkoi në Londër, ku u takua me Giuseppe Mazzini (1805-1872), idetë e të cilave, ai tashmë kishte bërë të vetat.

U kthye fshehurazi në Sicili në vitin 1859 dhe u bë asokohe Sekretar i Shtetit i diktaturës garibaldiane. Më 1861 u zgjodh zëvendës i Dhomës së Deputetëve të Mbretërisë së re të Italisë, ku ishte kundërshtar i Camillo Benso di Cavour (1810-1861) dhe Bettino Ricàsoli (1809-1880). Më 18 mars 1865, ai u shkëput përfundimisht nga Mazzini, duke kaluar në Monarki dhe duke refuzuar postet e ofruara nga Ricàsoli dhe më pas, nga Urbano Rattazzi. Në qeverinë e Depretisit (1877-1878) ishte ministër i Brendshëm (u emërua më 27 dhjetor 1877). Ishte kryeministër i Italisë së bashkuar në dy mandate (1887-1891) dhe (1891-1895). Në kohën sa ishte kryeministër, Krispi u bë politikani më i njohur në Europë, krahas me kryeministrin gjerman, Bismarkun, me të cilin kishte miqësi dhe takime të shpeshta. Vetë arbëreshët e Italisë dhe rilindësit tanë, sidomos vëllezërit Sami, Naim dhe Abdyl Frashëri, kishin një simpati dhe shpresë se Krispi, me pozitën që kishte dhe

me autoritetin që gëzonte, do ta ndihmonte pavarësinë e Shqipërisë. Samiu shkruante në “Kamus Al-Alam”: “Në Itali kanë ardhur nga gjaku shqiptar shumë dijetarë, poetë e shkrimtarë; kujtoj se është mjaft të përmendim se është bir i këtij kombi edhe Krispi, që sot ka në dorë frenat e administratës së Italisë”.

Në vitin 1880, Krispi paraqiti dorëheqjen si deputet, por kërkesa iu refuzua. Në prill 1887, ai përsëri pranoi pozicionin e ministrit të Brendshëm. Në korrik të të njëjtit vit u bë president i Këshillit të Ministrave. Më 31 janar 1891, pas votimit të kundërt të shprehur nga Dhoma e Deputetëve, Krispi u tërhoq nga qeveria, kryesinë e së cilës ai e mbylli më 15 dhjetor të vitit 1893. Qeveria ra dhe Francesco Krispi, pasi u tërhoq nga pushteti, jetoi në një pozicion shumë të pasigurt ekonomik, me një sëmundje të rëndë në sy.

Familja e Françesko Krispi ishte nga qyteti i Pallacit, një komunitet i vogël bujqësor afër Palermos, që i përkiste pakicës shqiptare (arbëreshe) të Sicilisë. Gjyshi atëror i Krispit, gjithashtu Françesko (1763-1837), ishte prift i klerit bizantin italo-shqiptar.

Çështja shqiptare për Krispin

Mosbesimin ndaj politikës së Krispit kundrejt Shqipërisë e shprehnin edhe Dora d’Istria dhe De Rada, në korrespondencën e shpeshtë që zhvillonin midis tyre.

Sado që shqiptarët kudo që ishin krenoheshin me arritjet dhe me afirmimin e Krispit, në qarqet kombëtare në Itali dhe në relacione ndërkombëtare, sado që shpresonin se ai do ta shfrytëzonte autoritetin dhe pozitën për të ndihmuar kauzën e kombit të origjinës së vet, Krispi i ishte përkushtuar imperializmit, donte të shfrytëzonte rrethanat e kohës pas Kongresit të Berlinit, që ta bënte Italinë, Fuqi të Madhe në Europë. Kështu, Krispi për Italinë dhe Europën ngeli njeri i madh, ndërsa për Shqipërinë ishte një arbëresh i cili, përveç ndjenjave private dhe simpatisë që kishte, nuk bëri ndonjë përpjekje për ta ndihmuar çlirimin dhe pavarësinë e saj.

Krispi u prezantua me pseudonimin “Nik Krie-Shpisë” dhe u mor edhe me krijimtari publicistike dhe letrare.

Origjina shqiptare, “Shqiptari i gjakut dhe zemrës”

Françesko Krispi ishte krenar për origjinën e tij shqiptare dhe e donte Shqipërinë. Mbiemri *Krispi* në Sicili dhe Kalabri është me të vërtetë një mbiemër tipik arbëresh, që bart kuptimin “Kryeshpi” (Capocasa). Për Shqipërinë, Krispi kishte marrë një pozicion në kauzën e tij të pavarësisë nga Perandoria Osmane. Përveç letrave të ndryshme drejtuar Jeronim de Radës në vitin 1887, si ministër i Punëve të Brendshme të Mbretërisë së Italisë, ai dërgoi një “donacion” në favor të shtrimit në spital të fermerëve me aftësi të kufizuara të Horën e Arbëreshëve në Sicili, ku komiteti organizativ telegrafoi: «kësaj kolonie ata lidhin gjakun, tradita, një histori aq e vjetër sa e lavdishme e patriotike që nuk u mohua kurrë prej tij dhe të kësaj fisnikërie që pësoi fatkeqësi”.

Në “Giornale di Sicilia”, të 1 janarit 1898, ka një referencë për një vizitë që Françesko Krispi dëshironte të bënte në Seminarin Italo-Shqiptar në Palermo, ku ai kishte marrë arsimin e tij të parë, dhe ndër të tjera lexohet një shprehje e Krispit: “Me fjalë fisnike kam shpresën se, sa më shpejt të jetë e mundur, Shqipëria do t’i trondisë osmanët, dhe unë rekomandoj veçanërisht për studentët studimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe; duke u zotuar që qeveria më në fund dëshiron të krijojë katedrën në Institutin Mbretëror Oriental të Napolit”.

9.7. KRAHINA E CATANIA-S

San Michele di Ganzaria (Shën Mikeli)

Shqiptarët e parë që u vendosën në Shën Mikeli ishin stratiotë (mercenarë nga Ballkani) që arritën në Sicili në vitin 1448 për të mbrojtur bregdetin perëndimor të ishullit nga pushtuesit. Pas dy vjetësh, kur frika e një pushtimi të Valois-Anjou u zbeh, stratiotët shqiptarë tërhoqën aty edhe familjet nga Shqipëria.

Në 1554, mbërritën 30 familje shqiptare, të cilëve baroni Antonio Gravina u besoi tokat e veta.

Sot, ky komunitet arbëresh është integruar plotësisht me popullsinë vendase, duke ruajtur vetëm kulturën e të parëve, ndërsa riti bizantin është zhdukur.

9.8. KRAHINA E MESINËS

Lipari

Nga një artikull i shkruar nga Papàs Emanuele Giordano në faqet 20 deri 24, në revistën “Zëri i Arbëreshvet”, botimi 12, i vitit 1979, mund të lexojmë “Shumë prej këtyre shqiptarëve u ndalën në Napoli, të tjerët në Lipari, ndërsa shumica zgjodhën të vendoseshin në vende të ndryshme të Italisë së Jugut dhe izoluese të banuara tashmë nga vëllezërit e tyre, shpëtuan nga Shqipëria në emigrimet e mëparshme. Gjurmët e sigurta të Coronei gjenden jo vetëm në vendet shqiptare të Kalabrisë dhe Lucania, por edhe në Puglia dhe Sicili”. Sot komuniteti arbëresh është integruar tërësisht me popullsinë vendase, duke e humbur përfundimisht kulturën e të parëve. Vetëm, një gjurmë ka mbetur prej kulturës arbërore, pikërisht ruajtja e ritit bizantin.

KAPITULLI X: GJURMËT ARBËRESHE NË VENECIA

Kontaktet politike, ushtarake, ekonomike dhe tregtare midis Republikës së lashtë të Venedikut me vendet që anashkaluan detin Adriatik dhe Jon, si dhe shumë ishuj mesdhetarë, ishin të vjetra. Republika mijëvjeçare e Venedikut, e njohur si “Serenissima”, u kujdes të mbante nën kontroll të gjithë bregdetin, ishujt dhe rrugët detare që filluan nga Venecia dhe arritën në ishujt grekë të Mesdheut. Me fillimin e shekullit të pesëmbëdhjetë, fuqia politike e ekonomike plot dinamikë e ‘Serenissima-s’ kishte përhapur kulturën e idetë e Rilindjes Evropiane nëpër bregdetin dalmat e deri në Shqipëri.

Ndonëse vetë Shqipëria për shkaqe historike, politike e ekonomike nuk do të zhvillonte një kulturë qytetëse të lulëzuar si ajo në Dubrovnik (Ragusa), Shibenik (Sebenico), Split (Spalato), Trogir (Traù) dhe Zadar (Zara) sipër në veri të bregdetit dalmat, një numër shqiptarësh që u vendosën në Itali, do të linin gjurmët e tyre në kulturën latine të Rilindjes Evropiane. Shumë nga këto figura qenë pasardhësit e asimiluar të refugjatëve nga Shqipëria veriore katolike, që kishin ikur nga vendi gjatë pushtimit turk e ishin vendosur në fillim në territoret e ‘Serenissima-s’, brenda dhe përreth Venedikut. Në historinë e letërsisë shqiptare këto figura përgjithësisht përmenden si “humanistë shqiptarë”. Gjurmët e shqiptarëve në Venezia, sot gjenden edhe në Palazzo Ducale, në toponime, në skulptura etj.

Lidhjet që Republika e Venecias kishte me principatat shqiptare, veçanërisht ato tregtare, janë të njohura. Lëvizja e shqiptarëve në Venecia midis shekujve XIII dhe XV, kryesisht për shërbime tregtare dhe ushtarake, por edhe për punë, arsim, etj., ishte një dukuri e zakonshme. Megjithatë, shpërngulja masive e popullsisë shqiptare në Venecia ndodhi pas rrethimeve të Shkodrës nga ushtritë e Perandorisë Osmane në vitet 1475 dhe 1479, në veçanti kur, pas një rezistence të gjatë, ra kështjella e Shkodrës.

Republika e Venedikut, e cila ishte dorëzuar kishte rënë dakord që shqiptarët, të cilët i mbijetuan masakrës, kryesisht gra, fëmijë dhe ata pak burra që i mbijetuan rrethimit, mund të largoheshin lirshëm nga qyteti.

Republika e Venedikut u kujdes për transportin dhe akomodimin e aleatëve të tyre shqiptarë në Venecia dhe në krahinat e tjera të Republikës, duke siguruar mjetet e nevojshme për të mbijetuar. Në



Venecia shqiptarëve iu dha e drejta e varrosjes pranë Bazilikës së Santi Giovanni e Paolo dhe u lejuan të organizoheshin në vëllazëri në “Shkollën e Shqiptarëve në San Maurizio” (fjala “shkolla” tregonte një vëllazëri fetare). Fasada e Shkollës së Shqiptarëve në San Maurizio është zbukuruar me relieve elegante, të cilat përshkruajnë Virgjëreshën dhe fëmijën midis shenjtorëve Gallo dhe Maurizio. Ajo që është më e habitshme, është relievi i pjesës së sipërme, në të cilin tregohet Sulltan Mehmeti II, që vëzhgon kështjellën e Shkodrës; është një aludim për përparimin osman në Ballkan dhe në Shqipëri.

Shkolla Santa Maria e San Gallo degli Albanesi

Shkolla *Santa Maria e San Gallo degli Albanesi* u themelua nga fisnikët shqiptarë, me 22 tetor të vitit 1442 dhe përreth 200 vjet vazhdoi të funksionojë për arsimimin e shqiptarëve deri në fund të shekullit të 18-të. Godina e shkollës ishte ideuar nga shqiptari Viktor Karpaçi, artist i njohur gjatë periudhës së Rilindjes Europiane. Ai mbikëqyri ndërtimin dhe dekorin e fasadave të shkollës.

Kjo shkollë ishte kryesisht shkollë për arte, artizanë dhe zejtarë. E konsiderojnë gjithashtu si qendër të parë fetare, në të cilën mbaheshin shërbesat në gjuhën arbërore. Si tekste mësimi janë përdorur edhe veprat e dy humanistëve shqiptarë Marin Beçikemi dhe Marin Barleti. I pari ka qenë dhe mësues në këtë shkollë. Ndërsa shkolla e shqiptarëve, me vlera historike në fushën e artit, u ndërtua me kontributet e bashkëvëllazërisë të të mërguarve shqiptarë të Venedikut, e cila ishte mjaft e organizuar në atë kohë. Përveç humanistëve që përmendëm më lart, në këtë bashkëvëllazëri bënin pjesë edhe humanistë të tjerë si Mark Bazaiti (1460-1530), Viktor Karpaçi (1455-1525) dhe Nikollë Leonik Tomeu (1456-1531). Aktualisht, ndërtesa është kthyer në një shtëpi private.

Figura të shquara arbëreshe në Venedik

Viktor Karpaçi (Vittorio Carpaccio)

Viktor Karpaçi ishte një nga piktorët e mëdhenj të Rilindjes italiane. Familja e tij u shpërngul nga Korça për në Venedik, në

fundin e shekullit XV. Bazuar në dokumentet e arkivit të Venedikut, pinjollët e fundit të kësaj familjeje janë shuar në vitin 1817, me vdekjen e Antonio Karpaçit, i njohur me pseudonimin *Carippo Megalense*, anëtar i Arkadave Romake.

Siç e përmendëm edhe më lart, Viktor Karpaçi punoi si arkitekt dhe skulptor i ndërtesës të Shkollës së Shqiptarëve. Ai stolisi fasadat e saj me basorelieve, që paraqesin aspekte të luftës së popullit shqiptar për liri, gjurmët e të cilave kanë ekzistuar deri vonë e që mund të jenë ende edhe sot e kësaj dite. Gjithashtu, vend të veçantë në opusin shumë të pasur të këtij artisti zënë pikturat që bëri për shkollën e bashkëvëllezërve të tij, të cilat ruhen në muzetë më të mëdha të botës.

Viktor Karpaçi në vitin 1465 ushtroi ciklet e para të punimeve të tij në kanavacë. Rreth viteve 1501-1502, ai pikturoi në pallatin Dukal, ku bëri disa punime në kanavacë, për dhomën e Këshillit të Madh. Më pas, pikturoi njëseri kanavacash për shkollën e San Giorgio degli Schiavoni, që paraqet një cikël tregimesh të S. Giorgio, S. Gerolamo, S. Trifone dhe dy tregime të Ungjillit etj. Në të njëjtat vite, ai bëri shumë piktura të tjera, përfshirë të ashtuquajturat “Courtesans dhe Portretin e një kalorësi”.

Gjon Gazulli (1400-1465), i njohur në latinisht si Johannes Gazulus (Gazoli)

ka qenë astronom e matematikan i njohur me prejardhje shqiptare, që studioi në Padovë dhe jetoi në Dubrovnik, ku dha mësimë filozofie, matematike e astronomie dhe iu përkushtua shpikjes së instrumenteve astronomike. Astronomi dhe matematikani bashkëkohës gjerman Johanes Myler (Johannes Müller, 1436-1476), i njohur edhe si *Regiomontanus*, e përmend në veprën e vetë. Gjon Gazulli gjithashtu kryesoi një numër misionesh diplomatike në shërbim të Dubrovnikut e Venedikut dhe ishte aleat i heroit kombëtar shqiptar Skënderbeut (1405-1468).

Marin Barleti (rreth 1450-1512), i njohur në latinisht si Marinus Barletius

Barleti mendohet të ketë lindur në Shkodër, ku përrjetoj nga afër rrethimin e dytë të qytetit nga turqit më 1478. Kur Shkodra më në fund ra, Barleti, si shumë bashkatdhetarë, u largua në Itali e u vendos në Venedik e më pas në Romë. Atje ra në kontakt me kulturën dhe idetë e Rilindjes italiane, të cilat e frymëzuan për të dokumentuar historinë e turbullt të Shqipërisë gjatë pushtimit turk dhe qëndresën kombëtare të saj nën udhëheqjen e Skënderbeut. Barleti është autor i tri veprave në gjuhën latine: *De obsidione Scodrensi*, (Rrethimi i Shkodrës) Venedik, 1504; *Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis*, (Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, princit të Epirit) Romë, rreth viteve 1508-1510; *Compendium vitarum summorum pontificium et imperatorum romanorum usque ad Marcellum II*, (Përmbledhje e jetës së papëve dhe perandorëve romakë deri te Marcellus II) Romë 1555.

“Historia e Skënderbeut” e Barletit është lexuar e përkthyer gjerësisht në shekujt e gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë dhe përbën një burim themelor të dhënash mbi Shqipërinë e shekullit të pesëmbëdhjetë. I ndikuar fort në stil e në mendim nga historianët romakë, sidomos nga Tit Livi (vitet ‘59 para erës sonë – ‘17 të erës sonë), Barleti e frymëzoi lexuesin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, pikërisht kur turqit ishin në portat e Vjenës më 1529 dhe që përherë e më shumë po e zinte ankthi i mundësisë së një pushtimi turk të Evropës Perëndimore. Barleti gjithashtu, hodhi themelet e asaj çka vetëm mund të quhet *kult i Skënderbeut* për shqiptarët brenda vendit dhe në diasporë, duke shprehur një nderim të thellë, pothuajse si shenjtor për heroin kombëtar shqiptar, si simbol dhe thelb i qëndresës ndaj sundimit të huaj¹³⁴.

Mikel Maruli (Michele Marullo Tarchaniotes, 1453-1500), i njohur në latinishte si Michaelis Marullus

Mikel Maruli mendohet se ka lindur nga një familje greko-

¹³⁴ Dhimitër Shuteriqi, *Mbi Barletin dhe shkrime të tjera*, Naim Frashëri, Tiranë, 1979, f. 44-85.

shqiptare me prejardhje nga Moreja, pak muaj pas rënies së Kostandinopojës. Familja e tij iku në Raguzë (Dubrovnik), ku që në vogëli, ndjeu së pari ndikimin e qytetërimit të Rilindjes italiane. Më 1470 ai i hyri një karriere ushtarake dhe shërbeu dhjetë vjet si ushtar energjik i fatit në vise të ndryshme të Italisë. Më 1491-1492 ai rivalizoi me Politianin (1454-1494) në Firenze dhe më 1495 u martua me poeteshën Alesandra Skala (Alessandra Scala, 1475-1506), ndonëse martesë nuk zgjati shumë. Neaera, së cilës ai i drejtonte vargjet e tij katuliane të dashurisë, duket se ka qenë personifikimi kolektiv i shumë marrëdhëniesve pasionante. Maruli është autor i katër librave me epigrame latine, mjaft prej tyre të mbujtura me një notë melankolie, si dhe i katër librave me ‘himne për natyrën’, në të cilët ai, me një stil lukrecian, ngre lart forcat mitologjike të natyrës.

Maruli, për rimit të gjuhës së tyre për të

të cilin Sandro Botiçeli (Sandro Botticelli, 1444-1510) ka realizuar një portret klasik rilindës, u mbyt aksidentalisht në lumin *Cecina*, më 11 prill 1500.

Leonik Tomeu (Leonicus Thomeus, 1456-1531), i njohur në italishtë si Niccolò Leonico Tomeo

Leonik Tomeu lindi në Venedik nga një familje me origjinë nga Durrësi. Ai studioi letërsi klasike dhe filozofi në Firenze dhe u bë profesor i filozofisë në Padovë, ku thuhet se i ka dhënë mësim, mes të tjerëve, edhe Kopernikut. Më pas u vendos në Venedik dhe dha mësim në *Scuola degli Albanesi* (Shkolla e shqiptarëve). Tomeu qe një dijetar i shquar klasik, i çmuar mjaft nga Erazmi. Ai përktheu veprat e Aristotelit e të filozofëve të tjerë të Greqisë së Lashtë në italisht. ¹³⁵

Maksim Greku (rreth 1480-1556)

Maksim Greku, i njohur edhe me emrat *Michael Trivolis*, *Maksim Hagioriti*, në shqipe Maksim ose Mihal Artioti, dhe në

¹³⁵ Mikel Prenushi, *Kontributi shqiptar në Rilindjen Evropiane*, 8 Nëntori, 1981, f. 117-130.

italishte Massimo d'Arta. Ai pati lindur në Artë, një qytet në Epir i populluar mjaft nga shqiptarë, dhe studioi latinisht, greqisht, filozofi dhe teologji në Ferrarë, Firenze dhe Padovë. Rreth dhjetë vjet, ai jetoi si murg në Malin Atos dhe më 1518 u thirr në liturgjike greke. Maksim Greku luajti një rol të madh në ringjalljen e kishës ortodokse ruse, duke bërë të njohur në Rusi arritjet e filologjisë dhe të studiuesve bizantinë. Ai është autori i më se 150 veprave, ndër to traktate filozofike, teologjike e gramatike, predikime morale dhe përkthime.

Marin Beçikemi (Marinus Becichemus Scodrensis, 1468-1526), i njohur në italishte Marino Becichemi

Marin Beçikemi ishte nga Shkodra dhe qe mësues në Dubrovnik e në Breshie para se të bëhej profesor i retorikës në Universitetin e Padovës. Ai është autor i një numri veprash latinisht, ndër to një panegjirikë që merret me rrethimet e vendlindjes së tij, Shkodrës, më 1474 dhe 1478. 'Humanistët shqiptarë' të përmendur më sipër, shkrimtarë dhe mendimtarë të shekujve të pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë, patën pak rëndësi të drejtpërdrejtë për lindjen e letërsisë shqiptare. Ata ishin produkt i kulturës humaniste të Rilindjes italiane dhe, me talentin e tyre, dhanë ndihmesë në zhvillimin e kësaj ringjalljeje të madhe kulturore, që do të kishte një ndikim të tillë mbi qytetërimin evropian. Duke përdorur latinishten si gjuhë universale të shkollës, shkencës dhe artit, ata nuk patën lidhje të tjera me Shqipërinë përveç atyre të krijuara ndoshta nga rrënjët e tyre etnike. Megjithatë, pikërisht në këtë periudhë energjia krijuese e intelektualëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit filloi për herë të parë të kanalizohet drejt përdorimit të gjuhës së tyre për të shkruar. Një letërsi e re ishte në prag të agimit të saj.¹³⁶

GJERGJ BASHTA (Giorgio Basta)

Gjergj Bashta lindi në një fshat të quajtur *Ulpino* në provincën e Monferratos, në vitin 1544. Babai i tij, një fisnik shqiptar, Demetër

¹³⁶ Mikel Prenushi, *Kontributi shqiptar në Rilindjen Evropiane*, 8 Nëntori, 1981, f. 131-148.

Bashta, nga rajoni i Epirit, i kishte shërbyer mbretit të Spanjës. Në vitin 1542 shkoi në Piemonte bashkë me stratotët e tij për të luftuar me ushtrinë e mbretit të Francës. Njihet me Magdalena Rosinin, një vajzë nga familje fisnike e Aleksandrise, dhe martohet me të. Nga kjo martesë lind Gjergji. Në moshën 14 vjeçare i ati transferohet dhe Gjergji meson profesionin e ushtarakut. Ai është e një prej figurave më të rëndësishme evropiane në fushën ushtarake. Njihet gjerësisht si strateg, teoricien ushtarak dhe gjeneral me famë botërore. Basta shkroi tri vepra teorike dhe praktike ushtarake, të cilat u njohën në Europë: “Il maestro di campo generale” (“Mjeshtri i kampit të përgjithshëm”, 1606); “Governo della cavalleria leggera” (“Për drejtimin e kalorësisë së lehtë”, 1612); “Mbi drejtimin e artilerisë” (1612). Vdiq në qytetin Kuartre (Belgjikë).

Lufta osmane-venedikase (1499-1503)

Lufta osmane-venedikase (1499-1503) përfundoi me traktatin e paqes, nga ku Sulltan Bajaziti II u betua në Kuran në Kostandinopojë, më 20 mars 1503 dhe Leonardo Loredan u betua në Venecia mbi Ungjillin, më 20 maj 1503. Traktati i paqes i vitit 1503 përcaktonte që osmanët të zotëronin Modone dhe Corone, Santa Maura (ose Lefkada) në Jon dhe Alessio, (Lezha) duke braktisur (Nafplio), Navarino, Malvasia, Kefalonia dhe Zante, në këmbim të një haraçi vjetor prej 500 dukateve të arta.

Vendbanimet shqiptare në rajonin e Venedikut

Shqiptarët që mbërritën në Republikën e Venedikut, përveçse ishin ushtarakë, u përkushtuan kryesisht në ndërtim të banesave, ndërtim të anijeve, punë bujqësore, prodhimin e pëlthurave të pambukut dhe mëndafshit, por edhe si argjendarë, mjekë, kishtarë etj.

Emigrantët që përshkuan Republikën e Venecias ishin aq të shumtë saqë, përveç Venecias, u shpërndanë edhe në qytete të tjera si Briana dhe Moniego (fraksionet e Noale); Sant’Angelo di Sala (pjesë e Santa Maria di Sala); në Provincën e Padovës në Sant’Ambrogio (fraksioni i Trebaseleghe); në Provincën e Treviso në Casale sul Sile,

në Castelfranco Veneto dhe fshatrat e saj të Poisolo dhe Treville, në Cendon (fraksioni i Silea), në Lancenigo (fraksioni i Villorba), në Quinto di Treviso dhe San Cipriano. Kjo masë, së bashku me faktin se pjesa më e madhe e saj vinte nga veriu i Shqipërisë, të cilët ishte katolikë të rritit latin, çoi në italianizmin e shpejtë të tyre.

Bibliografia kryesore e shfrytëzuar:

- Ernesto Pontieri, *La Calabria a metà del secolo XV e le rivolte di Antonio Centelles*, F. Fiorentino, Napoli, 1963.
- I. Bergamo, *Vittore Carpaccio, gli Albanesi, la loro scuola in Venezia e i quadri di Carpaccio*, Milano, Italia, 1906.
- Luigi Settembrini, *Ricordanze della mia vita, Volume 1*, Morano, Torino 1944.
- Mateo Mandala, “Poezia Popullore dhe Poezia e Artit në Rilindja: Kërkime dhe studime të italo-shqiptarëve”, në: “Punimet e Kongresit XIV Ndërkombëtar të Studimeve Shqiptare”, Palermo, 25-28 nëntor 1988.
- Matteo Mandala, *Mundus vult decipi: Mitet e historiografisë arbëreshe*, Naimi, Tiranë, 2018.
- Mikel Prenushi, *Kontributi shqiptar në Rilindjen Evropiane*, 8 Nëntori, 1981.
- Mirie Rushani, “Gli Illiri, un fattore importante nella storia e la cultura Europea”, in *Miti e Cultura Arbëreshë a Cura Di Gianfranco Romagnoli*, Sicilia, 2007.
- N. Cortese, “Kalabria në Risorgimento Italiane”, në “Punimet e Kongresit të 2-të Historik të Kalabresit”, Napoli 1961.
- Nicolò Chetta, *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*, Contessa Entellina 2002.
- Paolo Petta, “Eksodi i Coronei - Një faqe e historisë së italo-shqiptarëve”, në: Takimet Jugore 1/3, 1996.
- Polpeo G. Molmenti, *La storia di Venezia nella vita privata, dalle origini alla caduta della Repubblica*, De Bastiani, Italia, 2020.
- Raffaele De Cesare, *La fine di un Regno, Napoli*: 1894; Città di Castello: S. Lapi, 1900; Città di Castello: Lapi, 1908-1909.

- Robert Appleton, *Catholic Encyclopedia*. New York 1913. Vol. III.
- Robert Elsie, *Albanian literature: a short history*, Palgrave Macmillan, New York, 1991.
- Robert Elsie, *History of Albanian literature*, 1995. Botimi shqip: Robert Elsie, *Histori letërsisë shqiptare* (përktheu Abdurrahim Myftiu), 2001.
- Rodota Pietro Pompilio, *Dell'origine progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi libri tre*, Vol III, rist. Brenner, Kozencë 1986.
- Shkrimtarët shqiptarë* (pjesa e parë 1462-1878), Ministria e Arsimit, Tiranë, 1941.
- Teodor Ippen, *V. Stare crkve*, në *Glasnik Bosni i Herzeg*, 1901.
- Tournée in Calabria, Colonna mobile in Calabria nell'anno 1852, chirurgo aggregato al 13° Battaglione Cacciatori*, prefazione e traduzione italiana di Agostino Formica, Collana "Traduzioni di testi stranieri", 2, Jason Editrice srl, Reggio Calabria 1991 (con la riproduzione di 203 illustrazioni originali a penna dello stesso De Rilliet).
- Vincenzino Ducas Angeli Vaccaro, "Albanesi in Grecia dal protomedievo agli inizi dell'Età moderna. Esegesi storica attraverso fonti Veneziane e Catalane", Firmo, Italy, 2020.

Bibliografia e konsultuar:

ADDUCI Caterina-ADDUCI Giulia, *Antologia degli autori frascinetesi - Profili bio-bibliografici*, vv. I, II, Frascineto 2009.

ARGONDIZZA Antonio, *Il collegio di S. Adriano*, Corigliano 1884.

-, *Il rito greco nell'Italia meridionale*, Lajme, 1, 2004, 13-22.

A. Ducellier., *Bisance et le monde orthodox Paris*, 1986 (traduzione taliana Torino 1987).

BASILE Angelo, *Inno per l'incoronazione della vergine SS. del Pilerio*, Migliaccio, Cosenza 1836.

-, *Ines de Castro*, Tipografia Trani, Napoli 1839.

-, *Raccolta di canti popolari albanesi dal 1847 al 1848*, Cosenza 1850.

BELLIZZI Lino, *Centenario di Skanderbeg*, Bollettino di Lungro, 2, 1968, 54.

-, *Villa Badessa-Oasi orientale in Abruzzo*, Ed. Trace, Pescara 1994, 78-80.

-, *La comunità arbëreshe di Villa Badessa*, Lajme, Lungro, 1, 1994, 37.

BELLUSCI Antonio, *Canti sacri tradizionali albanesi - Raccolti a S. Costantino Albanese, S. Sofia d'Epiro e in alcune comunità albanesi di Grecia e trascritti in musica*, Centro Ricerche, S. Costantino A. 1971.

-, *Il telaio/Argalia - Testi originali nelle parlate arbëreshe con traduzione italiana, Ricerca etnografica tra gli albanesi - Testi arbëreshë con traduzione italiana*, Centro Ricerche, Cosenza 1977.

-, *Magia miti e credenze Popolari – Testi arbëreshë con traduzione italiana*, Centro Ricerche, Cosenza 1983.

-, *Dizionario fraseologico degli albanesi d'Italia e di Grecia - - Ricerca sul campo in 115 comunità albanofone, Testi arbëreshë con traduzione italiana, inglese e francese*, Centro Ricerche, Cosenza 1989.

- , *Vatra Jonë/Il nostro focolare - Periodico di cultura italo-greco-albanese (1966-1973)*, S. Costantino Albanese, Centro Ricerche, Cosenza 1991.
- , *La pastorizia a Frascineto-Testi originali nelle parlate arbëreshe con traduzione italiana*, Centro Ricerche, Cosenza 1991.
- , *Ricerche e studi tra gli arberori dell'Ellade - Kërkime dhe studime ndër arbëroret e Helladhes - Da radici arbëreshe in Italia a matrici arberore in Grecia - Testi e documenti - Introduzione di A. Kolljas (Atene) e Gj. Shkurtaj (Tirana)*, Centro Ricerche, Cosenza 1994.
- , *Antologia Arbëreshe – Ninnananne, strambotti, filastrocche, indovinelli, formule augurali, presagi fausti e infausti, giochi, usanze e credenze popolari-Trascrizione nelle parlate arbëreshe con traduzione italiana*, Centro Ricerche, Frascineto 2003.
- , *Gli Arberori-Arvaniti / Un popolo invisibile – Arbëroret Arvanitë një popull i padukshëm - Ricerche etnografiche nell'Ellade (1965-2000)*, Centro Ricerche, Frascineto 2004.
- , *Regesto – Manoscritti d'Archivio nella Biblioteca Internazionale "A. Bellusci" di Frascineto dal 11522 al 1966 – Segmenti di vita giuridica, sociale, economica, politica, storica, religiosa e letteraria a Frascineto, comunità albanofona calabrese di rito bizantino-greco dal secolo XV- Premessa di T. Bellusci*, Centro Ricerche, Frascineto 2007.
- , *Antologia Arbëreshe - Antologji Arbëreshe – Prozë dhe poezi gojore, Veshja, të ngrënit, bujqësia, blegtoria, martesë, vjershe, vajtime, fjalortho mbi argalinë, frazeologjia, dorëshkrime të shekullit XIX – Transkriptim në të folmet arbëreshe dhe përkthim italisht*, Centro Ricerche, Frascineto 2009.
- , *La parrocchia bizantina –Famullia bizantine "SS. Maria Assunta" di Frascineto – Storia, Rito, Cronaca, Letteratura (1490-2009)*, Centro Ricerche, Frascineto 2008.
- , *Biblioteca Arbëreshe Bizantine - Biblioteka Arbëreshe Bizantine "A. Bellusci"*, Centro Ricerche, Frascineto 2018.
- , Bellusci A./Burigana R., *Storia dell'eparchia di Lungro – Le comunità albanofone di rito bizantino in Calabria 1439-1919*, Ecumenica, Pratovecchio Stia (Arezzo), 2019.
- , *Il telaio a Frascineto-Veku në Frasnitë*, Shejzat, Roma, 3, 1962; 5, 1963.
- , *La pastorizia a Frascineto-Blegtoria në Frasnitë*, Shejzat, 1, 1964; 3, 1964; 3, 1965; 5, 1965; 7, 1965; 1, 1968; 7, 1968; 4, 1969; 7, 1969; 1, 1970; 4, 1971; 7, 1971.

- , *Viaggio tra gli albanesi di Grecia-Udhëtim midis shqiptarëve në Greqi*, Zgjimi, 7-9, 1965, 18-20.
 - , *Rilievi sulle comunità albanesi di Grecia-Shënime mbi komunitetet shqiptare në Greqi*, Shejzat, 9, 1967.
 - , *Un arbresh tra gli arvanites di Corinto-Një arbëresh midis arvanitet të Korintit në Greqi*, Shejzat, Roma, 4, 1970.
 - , *Katundet arbërorë në More (Greqi)*, Katundi Ynë, 27, 1978, 9.
 - , *Kjo gjuhë arbërishte ishtë një gjuhë trimerishte (Greqi)*, Katundi , Ynë 28, 1978, 12.
 - , *Arbëroret këndojnë në More (Greqi)*, Katundi Ynë, 29, 1979, 19.
 - , *Monolog në More (Greqi)*, Katundi Ynë 30, 1979, 8.
 - , *Kallzime dhe këngë popullore në Struga (Maqedoni)*, Katundi Ynë, 34, 1980, 14.
 - , *Un manoscritto con una raccolta di canti albanesi*, Katundi Ynë, 35, 1980, 11.
 - , *Dati biografici su V. Dorsa*, Lidhja, 2, 1981, 10.
 - , *Catechesi in arbëresh di A. Argondizza*, Lidhja, 4, 1981, 13.
 - , *Le maledizioni-Mallkimet*, Katundi Ynë, 37, 1981, 12.
 - , *La figura di mons. Domenico Bellusci*, Lidhja, 8, 1983, 140.
 - , *Le vicende della famiglia Dorsa di A.Dorsa*, Lidhja, 3, 1994, 1100; 33, 1995, 1166; 34, 1995, 205; 40, 1998, 1385.
 - , *Arbëreshët të Eparkisë së Ungrës*, Lidhja, 42, 1999, 1443.
 - , *Kënga fetare në Bernardo Bilotta*, Lidhja, 60, 2009, 1988-1991.
 - , *Mons. D. Bellusci (1774-1833) e la rinascita della coscienza albanese*, in "Il Veltro" – Rivista della Civiltà Italiana, 3-6, 2012, 247-137.
 - , *Fenomeni ndërkulturor arbëresh në çështjen e bavaresisë së lombit shqiptar-Veprimtaria të klerit arbëresh (1444-1912)*, në Ndue Gjergji, *Nj'qind vjet pavaresi-Simpozium shkencor*, Detroit 2012, 44-92.
 - , *Il contributo religioso e culturale del clero arbëresh delle Eparchia di Lungro per l'Indipendenza dell'Albania*, Lajme, 2, 2013, 60-67.
 - , *Gli indomiti alferi dell'autonomia ecclesiastica di Lungro: Papàs Michele Bellusci, Papàs Vincenzo Dorsa, Mons. Pietro Caomodeca de Coronei*, Lajme, 1, 2018, 70-82.
- Bellusci Costantino**, *Poesie e scritti di pedagogia di C. Brunetti da Plataci*, Trebisacce 1991.
- , *Poesie e scritti inediti di Pedagogia del prof. Carlo Brunetti*, Tip. Jonica, Trebisacce 1996.
 - , *Plataci-Pllätani - Cronistoria generale dal Medioevo ad oggi*, Trebisacce 1998.
 - , *K'shtëtù a fjasmi na*, Grafica Pollino, Castrovillari 2011.

- , *Il contributo degli arbëreshë all'Unità d'Italia*, Katundi, 141, m2011, 10.
- , F. D'Agostino, 2018, *Arbashkuar-Fjalor italisht-Arbërisht-Shqip i ilustruar*, vv. I, II, III, IV, Ed. Expressiva, Spezzano Albanese 2018.
- Bellusci Michele**, *Alla relazione di monsignor Cardamone arcivescovo di Rossano al delegato della real giurisdizione contra l'arciprete albanese di S. Giorgio – Risposta di Filalete*, Napoli 1796.
- Bellusci Tommaso**, *Michele Scutari (1762-1830) – Fiero antesignano dell'etnia arbëreshe*, Lidhja, 4, 1981, 6.
- , *Il sentimento di appartenenza nelle comunità arbëreshe dalla Lega di Lezhë ai comitati-pro Patria per l'indipendenza dell'Albania (1444-1912)*, Lajme, 2, 2013, 69-78.
- , *Identità, spiritualità, giurisdizione religiosa: il caso degli arbëreshë (italo-albanesi)*, Lajme, 3, 2014, 32-57.
- , *La basilica bizantina (sec. IX-X) e il cenobio basiliano di S. Pietro di Frascineto*, Lajme, 2, 2017, 96-96-120; 1, 2018, 92-115.
- Berisha Anton Nik**, *Gërmime në dhimbje*, Cosenza 1998.
- , *Vepra letrare di Dushko Vetmo* (F.Solano), UNICAL, Cosenza 2007.
- Bilotta papà Bernardo**, *Psicologia della lingua albanese*, Yli i Arbëreshëvet, 2, 1896.
- , *Versi lugubri*, Castrovillari 1898.
- , *Canti albanesi (Ridda)*, Castrovillari, 1916.
- , *Shpata e Skanderbeut ndë Dibrët Poshtë* (E.Giordano), Tirana 1967.
- , *Zakonet e Frasnitës*, Katundi, 98, 1999, 11.
- Bisignano O.A.**, *Il volo delle aquile – Storia d'Albania e degli albanesi in Italia*, Macri ed., S. Demetrio Corone 2003.
- Camodeca Pietro de' Coronei**, *Addio allapatria – Sull'emigrazione albanese in America*, Befari, Roma 1890.
- , *L'autonomia ecclesiastica degli italo-albanesi*, Roma 1903.
- Campolongo Amato**, *Notizie storiche su Frascineto*, Katundi Ynë, 73, 1990, 7.
- Canadè Giovan Battista**, *Il rito greco nelle colonie italo-albanesi - Appunti e documenti – Sulle colonie e sulla formazione del collegio italo-greco Corsini in Calabria - Appunti e documenti*, RSC, Cosenza, aprile-settembre 1907, 190-214.
- Cassiani Gennaro**, *Orazione in onore di Giorgio Kastrioti Skandebërg*, Shejzat, 4, 1968.
- , *Ritratto di Ernest Koliqi*, Shejzat, 1, 1975.
- Cava Giovanni**, *Gli Italo-Albanesi nel Risorgimento Italiano*, Shejzat, 7, 1964.

- Cassiano Domenico**, *V. Dorsa e la storiografia arbëreshe*, Katundi Ynë, 20, 1976, 24-25; 1, 1977, 23-25.
- , *S. Adriano - La Badia e il Collegio italo-albanese, v.I (955-1806)*, Marco Ed., Lungro 1997.
- , *Le comunità arbëreshe nella Calabria del XV secolo*, Brenner Ed., Cosenza 1977.
- , *L'educazione con mons. D. Bellusci*, Katundi, 29, 1979, 25.
- , *S. Adriano-Educazione e politica, v I (1807-1923)*, Marco Ed., Lungro 1999.
- , *S. Adriano-Educazione e politica, v.II (1807-1923)*, Marco Ed., Lungro 1999.
- , *Strigari, genesi e sviluppo di una comunità calabro-arbëreshe*, Cosenza 2004.
- , *Il processo del 1857 ai patrioti di S. Demetrio Corone, Macchia, S. Cosmo, Vaccarizzo, S. Giorgio*, Ed. Coscile, Castrovillari 2009.
- Cucci Maria Franca**, *Il processo di latinizzazione del collegio Corsini (1834-1923)*, Lidhja, 8, 1983, 143-145.
- , *Chiesa cattolica bizantina in Italia*, Katundi Ynë, 105, 2000, 21.
- , *Il pontificio collegio Corsini degli albanesi di Calabria – Evoluzione storica e processo di laicizzazione*, Brenner Ed., Cosenza 2008, 129-145.
- De Rada Girolamo**, *Alla memoria di mons. Domenico Bellusci vescovo di Sinope in San Adriano morto il 2 marzo dell'anno 1833*, Napoli 1838,
- , *Opera Omnia*, vol. XI (a cura di M. Mandalà), Rubettino, Rende 2009, pp.24-36.
- , *Sulla tomba dell'arciprete Luca Tocci di Strigari morto il 26 febbraio 1862*, parole G. De Rada, Cosenza
- , *Il Collegio Albanese S. Adriano*, Tip. Economica, Catania 1891.
- , *Autobiografia* (M. La Luna), Rubettino, Università Cosenza 2008.
- Dorsa V.**, *Su gli Albanesi-ricerche e pensieri*, Tipog. Trani 1847 Napoli (Rist. Edit. Brenner Cosenza 1979, 1989
- Elmo Italo Costante**, 1, *La storia di S. Benedetto Ullano e Marri attraverso le fonti documentarie dall'età preistorica al sec. XV.*, v. I, Arbutalia Ed., S. Demetrio Corone 2011.
- , 2, *La storia di S. Benedetto Ullano e Marri attraverso le fonti documentarie, dal sec. XVI al sec. XX*, v. II, Arbutalia Ed., S. Demetrio C. 2011.
- , *I casali italo-albanesi in un documento del 1488*, in *La storia di S. Benedetto Ullano e Marri attraverso le fonti documentarie dall'età*

- preistorica al sec. XV., v. I, 824-831.
- , *Un significativo recupero della chiesa di S. Rocco in S. Benedetto Ullano*, Lajme, 3, 2016, 33-42.
- Elmo Nando**, *Da papàs G. Capparelli a papàs Vincenzo Matrangolo passando per Acquafomosa*, Katundi Ynë, 77, 1991, 20.
- Elmo Vittorio**, *Le idee dell'illuminismo nel pensiero degli italo-albanesi alla fine del XVIII secolo*, Marco Ed., Lungro 1992, 72-88.
- , *Pasquale Scura ministro arbëresh*, Comune di Vaccarizzo Albanese 1993, 15.
- , *Proprietà e possesso nella società contadina arbëreshe*, Marco Ed., Lungro 1997, 27.
- , *Le idee dell'illuminismo nel pensiero degli italo-albanesi alla fine del XVIII secolo*, Marco Ed., Lungro 1992, 72-88.
- Emmanuele Demetrio**, *Papàs Antonio Argondizza (1839-1918)*, Katundi Ynë, 23, 1977, 18.
- , *Inaugurazione della biblioteca "A. Bellusci" a Frascineto*, Katundi Ynë, 104, 2001, 31.
- , *Arberia - Cultura storia folklore*, Publisfera Ed., Civita 2014.
- Esposito papàs Giorgio**, *Celebrazioni per G. De Rada*, Bollettino Lungro, 160, 1964, 2195.
- , *V centenario della morte di Skanderbeg a S. Demetrio Corone*, Bollettino, Lungro, 2, 1968, 60.
- , *Usanze pasquali e tradizioni*, Zjarri, marzo 1971, 17-22.
- , *Commemotazione dei defunti a S. Demetrio Corone*, Zjarri, marzo 1971, 4-6.
- Fabbricatore Raffaella**, *S.Sofia d'Epiro storia, rito, tradizioni e lingua*, Cosenza 1998.
- Famiglietti Michele**, *L'educazione nel collegio Corsini con mons. Domenico Bellusci*, Katundi Ynë, 29, 1979, 25.
- Faraco papàs Giuseppe**, *Salvatore Braile poeta italo-albanese (1872-1961)*, Zjarri, 1991
- Ferrari Giuseppe**, *Kendime t'shejta shqip t'Frasnites qytet italo - shqiptar t'Kalabris*, Castrovillari 1941.
- , *Kaljimere*, Ed. Patitucci, Castrovillari 1946, 16.
- , *Documenti di storia e letteratura albanese*, Shejzat, 2-3, 1957, 48-52.
- , *La letteratura degli Albanesi d'Italia*, Atene 1957.
- , *Giulio Variboba nel giudizio di G. De Rada*, Shejzat, Roma, n.1, 1958, 89; 3, 1958.
- , *Rapsodie e scene di vita degli albanesi di Calabria*, Cosenza 1959, 74.
- , *L'Albania e gli italo-albanesi*, Shejzat, Roma, 7/1959, 243.

- , *Il contributo degli italo-albanesi al Risorgimento Italiano*, Rassegna di Studi Albanesi, I, Cosenza, novembre 1960, 4-38.
- , *G. Variboba e la sua opera poetica albanese*, Bari 1963, 16.
- , *Canti Albanesi - Raccolta di Michele Bellusci del '600*, Bari 1963.
- , *Vita Italo-Albanese nel 1700*, Bollettino di Grottaferrata, XVIII/1964.
- , *Greci e albanesi in Calabria nei sec. XVI-XVII*, Atti III Congresso Studi Calabresi, 1963, Napoli 1964, 393-399.
- , *Vita italo-albanese nel 700 - Una vertenza di Diritto Bizantino tra Michele Bellusci (1754-1806) e P. Pompilio Rodotà (1707-1789)*, Bollettino di Grottaferrata, v.XVIII/1964, 37-84.
- , *Appunti di un recente viaggio in Albania*, Oriente Cristiano, Palermo, 2, 1965, 6-9.
- , *Grammatica albanese - Parte I*, Molfetta 1971, 88.
- , *Alla relazione di mons. Cardamone arcivescovo di Rossano al delegato della real giurisdizione contra l'arciprete albanese di S. Giorgio - Risposta di Filalete (Michele Bellusci), S. Benedetto Ullano 25 marzo 1788*, Bollettino di Grottaferrata, XVIII, 1974.
- , *Un manoscritto inedito albanese di V. Dorsa*, Studi e Ricerche, Bari 1980.
- , *Gli italo-albanesi fra Costantinopoli e Roma*, Nicolaus, Bari, IX, 1981, 355.
- , *La figura di Luigi Gurakuqi*, Bari 1988.
- Feraudo Vincenzo**, *La comunità di S. Cosmo Albanese ha festeggiato il 50° di sacerdozio del protopresbitero P. Minisci*, Lajme, 3, 2015, 55-57.
- Filardi Demetrio**, *La comunità arbëreshe di Lungro*, Zëri, 2-3, 1972, 9.
- Formica Annibale**, *Quadro storico della presenza degli albanesi in Lucania*, Katundi Ynë, 119, 2005, 4.
- Fortino Eleuterio Francesco**, *Ricordo di G. Variboba*, Zgjimi, 1, 1963, 3-7.
- , *Gli italo-albanesi di rito greco*, Zgjimi, 3-6, 1963, 3-4.
- , *Pietro Pompilio Rodotà*, Zgjimi, 7-8, 1963, 3-4.
- , *Gli albanesi di Calabria agli albori (1821) dell'eparchia di Lungro-Relazione sugli albanesi di K. Korolevskij sugli albanesi di Calabria nel 1821*, Zgjimi, 1-2, 1979, 6-30.
- , *Gli albanesi di Calabria nel 1841-Relazione sulla visita apostolica agli albanesi di Calabria nel 1841*, Zgjimi, 1-2, 1979, 31-39.
- , *La chiesa bizantina albanese in Calabria-Tensioni e comunione*, Ed. Bios, Cosenza 1994.
- , *Acquaformosa: comunità bizantina*

- arbëreshe*, Besa, 190, 2007, 2-9.
- , *In memoria di papà Michele Scutari di S. Costantino Albanese*, Besa, 190, 2007, 10.
- , *L'archimandrita Pietro Scarpelli (Angjeli Muzaku)*, Besa, 195, 2007, 2-4.
- , *l vescovo Giuseppe Bugliari*, Besa, 194,
- , *Falconara Albanese: comunità biantina arbëreshe*, Besa, 207, 2009, 4.
- , *La Madonna del Buon Consiglio – L'Odigitria degli arbëreshë (a cura di Agnese Jerovante)*, Besa, Roma 2009.
- , *L'archimandrita Pietro camodeca e l'Eparchia di Lungro*, Besa, febbraio 2010, 8-10.
- Fortino Italo Costante**, *Rilevamento della lingua di G. Variboba*, Zgjimi, 3-4, 1979, 37-63; 1-3, 1980, 11-50.
- , *Il Fjalor di E. Giordano*, Lajme, Lungro, 3, 1996, 59-65.
- , *Il collegio Corsini*, Lidhja, 4, 1983, 139
- , *La vita di Maria di G. Variboba (a cura di I.C. Fortino)*, Ed. Brenner, Cosenza 1984.
- , *Pietro P. Rodotà*, Katundi, 52, 1985, 13.
- , *Sintesi sulle colonie di Calabria*, Bollettino di Grottaferrata, vol. 1974, 83-1992
- , *L'identità arbëreshe*, Lajme, 3, 1998, 5-18.
- Foscolos Marc**, *I vescovi ordinanti per il rito greco a Roma*, Zgjimi, 2, 1973, 22-36.
- Frega Alfredo**, *Vita ed opere di mons. G. Stamati*, Katundi Ynë, 61, 1987, 20.
- Frega Maria**, *I congressi linguistico-albanesi di Corigliano Calabro (1885) e di Lungro (1887)*, Katundi Ynë, 110, 2003, 10.
- Gattabria Antoniiio**, *Giochi musicali*, Bashkim Kulturor Arbëresh, Tint, Spezzano Albanese 2003.
- , *I canti quaresimali di Spezzano Albanese*, in F. Altimari.E.Conforti, a cura di, "La figura e l'opera di Girolamo De Rada". Atti del V seminario internazionale di studi italo-albanesi, 181-192.
- , *Analisi etnomusicologica dei canti tradizionali di Rota Greca*, in V. Perrellis,, a cura di, *Rota Greca. storia e tradizioni*, Arti Grafiche Barbieri - Editore, Cosenza 2004, 157-178.
- , *La polivocalità in Calabria. Forme e comportamenti dell'attuale tradizione tra arbëreshë e calabresi in provincia di Cosenza*, Tesi di dottorato, Università di Roma "Tor Vergata", Roma 2007.
- , *Spezzano Albanese. Guida turistico-culturale*, Spezzano Albanese 2008.

- , *Le Vallej: l'identità arbëreshe in mostra*, in AA.VV., “*La Danza Fuori dalla scena - cultura, media educazione*”, Quaderni di Rivista Abruzzese n. 81 (2010), 69-80.
- , S. Avolo, *Mungrasana: katund arbëresh*, documentario audio-video, Mongrassano 2009.
- , *Gjuha e Mungrasanës. Repertorio linguistico della comunità arbëreshe di Mongrassano*, Mongrassano 2009.
- , *Mongrassano: storia, luoghi e tradizioni*, Mongrassano 2009.
- , *Mungrassana. Comunità arbëreshe/Katund arbëresh*, Mongrassano 2010.
- Giannone Pietro**, *Un collegiale alla tomba di mons. Domenico Bellusci*, Cosenza 1837, 37.
- Giordano Agostino**, *Il fidanzamento in B. Bilotta*, *Zër i Arbëreshëvet*, i, 4, 1972, 14-19; 5, 1973, 16-21.
- , *La poetica di B. Bilotta*, *Zër i Arbëreshëvet*, 1, 1972, 10-12.
- , *La poetica del papàs Bernardo Bilotta*, *Zër i Arbëreshëvet*, 1, 1972, 8-10.
- , *La “shkulqia” del papàs Bernardo Bilotta*, *Zër i Arbëreshëvet* i, 4, 1972, 14-19; 5, 1973, 16-21.
- , *Culto della lingua e movimento risorgimentale in B. Bilotta*, *Zëri i Arbëreshëvet*, 10, 1977, 29-44.
- , *Scheda biografica di Vorea Ujko*, *Lidhja*, 21, 1989, 651.
- , *Vorea Ujko, il poeta*, *Katundi Ynë*, 67, 1989, 14.
- , *In memoria di Giordano protopresbitero Emmanuele (1920-2015)*, *Breve biobibliografia*, *Lajme*, 1, 2015, 45-51.
- , *Poezi të prasmë të zotit papàs Bernardo Bilotta*, *Jeta Arbëreshe*, janartheristi 2020, 45-50.
- Giordano Emmanuele**, *Mbë Shën Mërinë Pulin*, *Shejzat*, 7-8, 1958, 208.
- , *Papàs B. Bilotta*, *Shejzat*, 5-6, 1959, 175-181.
- , *Urim peshkopit Jon Mele*, *Shejzat*, 7, 1959.
- , *Priru*, *Shejzat*, 9, 1959.
- , *Vocabolario arberesh-italiano-Lettera “Z”*, *Shejzat*, 7, 1960.
- , *Pasqua folclorica albanese in Frascineto*, *Shejzat*, 1, 1961.
- , *Urja e vllzervet, Paçurati*, *Shejzat*, 9, 1961.
- , *Dizionario degli Albanesi d'Italia*, Bari 1963, 15.
- , *Il lessico albanese di Girolamo De Rada*, *Shejzat*, 7, 1964.
- , *Viaggio in Albania*, *Zgjimi*, 7-12, 1966, 82-83.
- , *V centenario di Skanderveg in Ejanina*, *BEL*, 2, 1968, 9.
- , *La basilica di S. Pietro in Frascineto*, *Zëri i arbëreshëvet*, 1, 1972, 20-22.

- , *Come scrivere in albanese*, *Zër i Arbëreshëvet*, 1, 1972, 18.
- , *L'inno degli italo-albanesi*, *Zër i Arbëreshëvet*, 1, 1972, 33.
- , *Regole e note grammaticali sul nominativo dei nomi*, *Zër i Arbëreshëvet*, 2-3, 1972, 20-22.
- , *Stato attuale e prospettive della cultura arbëreshe*, *Zër i Arbëreshëvet*, 2-3, 1972, 35.
- , *Vdekja e Skënderbeut në muzikë*, *Zër i Arbëreshëvet*, 2-3, 1972, 40.
- , *T'folmet arbëreshe*, *Zër i Arbëreshëvet*, 5, 1973, 11-15; 6-7, 1973, 15-19.
- , *Ernest Koliqi dhe unë*, *Shejzat*, 1, 1975.
- , *Vjershe e graxeta në Frasnitë*, *Zër i Arbëreshëvet*, 14, 1981, 117-122.
- , *Kënka e Skënderbeut*, *Zër i Arbëreshëvet*, 2, 1979, 47.
- , *Vangjeli i Shën Matesë*, *Lungro* 2000.
- , *Sepse do të rronjë gjuha jonë arbëreshe*, *Lidhja*, 47, 2002, 1584.
- , *Zëri i arbreshvet rivista e ndershme dhe bujareshe*, *Lidhja*, 51, 2004, 1722.
- , *Hymne liturgjike bizantino-arbëreshe*, *Ejanina* 2005.
- , *Gramatikë arbëreshe*, *Manduria* 2005.-, 2006
- Giura V.**, *Storie di minoranza, Ebrei, Greci, Albanesi nel regno di Napoli* 1987
- GIOVANNI D'ANGELO.**, *Vita di Padre Giorgio Guzzetta a cura di PIETRO MANALI SALVATORE SCIASCIA EDITORE Caltanissetta - Roma* 2009
- Gramsci A.**, *Lettere dal carcere 1926-1937(1947)*, Sellerio, Palermo 1996, *La nuova diagonale*, 2voll., 946pp
- Godino Francesco**, *Gli albanesi e la difesa del rito greco in Calabria*, Ed. MIT, Cosenza 1971, 103.
- Grandinetti Mario**, *Vincenzo Dorsa giornalista*, *Lidhja*, 16, 1987, 437.
- Massaro M.**, *Dizionario comparativo delle parlate arbëreshe di Casalvecchio e Chieuti*, Malatesta ed., Foggia 2010.
- Mazziotti I.**, *Immigrazioni albanesi in Calabria nel XV secolo e la colonia di S. Demetrio Corone (1471-1815)*, *Il Coscile ed., Castrovillari* 2004.
- Mazzeo D.**, *Albania di Basilicata, Rionero in Volturo* 1985.
- Mayerà S.**, *Ad Agesilao Milano, italo greco, assassinato in Napoli nel 1856 da F. Borbone d'nfame memoria*, *Napoli, tip. Gargiulo*, 1857
- Mazziotti G.**, *Monografia del Collegio italo-greco di Sant' Adriano*, *Tip. Italia - Roma*, 1908
- Nadin L.**, *Ikona dhe Skënderbeu në shërbime kulturore dhe artistike të Venedikut (nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)*, *Akademia dhe*

- studimet albanologjike, Tiranë, 2018.*
- Napoletano P.**, Vocabolario italiano-arbëresh con epitome di grammatica, Il Coscile, Castrovillari 2002.
- Pedio T.**, *Un Foculario del Regno di Napoli del 1521 e la tassazione focatica dal 1447 al 1595*, Studi Storici Meridionali, XI, 3, Potnza 1991,
- Padula V.**, *Calabria prima e dopo l'unita* – Bari, 1977
- Rennis G. B.**, *Elenco dei testi verbali e delle trascrizioni musicali*, Il Coscile ed., Castrovillari 2010.
- Rodotà L.**, *Canti di Vespero*, Cosenza 1962
- Rotelli C.**, *Gli albanesi in Calabria*, Orizzonti M. ed., Cosenza 1988.
- , *La tradizione bizantina della comunità albanese di Lungro*, Progetto 2000, Cosenza 1993.
- Scutari M.**, *Notizie storiche sulla origine e stabilimento degli albanesi nel regno delle due Sicilie*, Potenza 1825.
- Scutari P.**, *I nomi delle piante nella comunità albanese del Pollino lucano*, Unical, Cosenza 2005.
- Shuteriqi Dh.**, *Drita, Tiranë, 4 dhjetorit 1966*, 2
- Tocci G.**, *Titoli di fondazione del collegio italo-greco (1732-1923)*, Corigliano Calabro 1889.
- Vaccaro A.**, *Italo-Albanensia – Repertorio bibliografico sulla storia religiosa, sociale, economica e culturale degli arbëreshë dal sec. XVI ai nostri giorni*, Bios, Cosenza 1994.
- Variboba G.**, *La vita di Maria – Prolegomeni, trascrizione e note di I. Fortino*, Brenner, Cosenza 1984.
- Zangari D.**, *Le colonie italo-albanesi in Calabria, - secoli XV-XIX, Napoli 1941.*
- Zavarroni A.**, *Biblioteca calabra (1753) rist. Ed. Forni Sala Bolognese*
- Riviste arbëreshe**
- Illi i arbresvet / La stella deli italo-albanesi, fondata a Lungro nel 1887 da A. Argondizza.**
- Katundi Ynë/Il nostro paese, rivista mensile di cultura albanese, fondata a Civita nel 1970 da D. Emmanuele.**
- Kamastra, rivista bilingue di cultura e attualità delle minoranze linguistiche degli Arbershe e croati del Molise.**
- Istituto di studi bisantini e neo greci(diretta da Lavagnini) Palermo**
- Lajme/Notizie, rivista di cultura e di spiritualità bizantina, fondata nel 1989 a Lungro da E. Lupinacci.**
- Lidhja/L'unione, rivista semestrale italo-greco-albanse, fondata nel 1980 a Cosenza da A. Bellusci.**

Mondo albanese, *Annale pubblicato da Giuseppe Schirò di Maggio - Piana degli albanesi (PA)*

Rilindja Jug /Rinascità Sud, *Revista di Farneta, frazione di Castroreggio Uri(il Tizzone)-Organ i bashkimit kultural arberesh te Spezzano albanese.*

Studime historike, *Università di tirana dal 1946*

Shejzat / Le pleiadi, *rivista bimestrale di cultura albanese fondata a Roma nel 1957 e diretta da E. Koliqi.*

Zëri i arbëreshëvet/La voce degli italo-albanesi, *rivista bimestrale di cultura albanese, fondata nel 1980 ad Ejanina di frascineto da E. Giordano.*

Zgjimi/Il risveglio, *rivista bimestrale di cultura albanese, fondata nel 1962 a Marri-S.Beneetto Ullano da A. Grco.*

Zjarri/Il fuoco, *rivista mensile di cultura albanese, fondata nel 1970 a S. Demetrio Corone da G. Faraco.*

SITI WEB

Arbitalia, *fondata a S. Demetrio Corone e diretta da G. Cacoza.*

Jemi, *fondata a Lungro e diretta da Boccia.*

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bellusci, Antonio

Frugëtim në ngulimet arbëreshe : (50 kartolina gjigante arbërore në tokën italiane) / Antonio Bellusci, Ornella Radovicka ; rec. Neritan Ceka, Sadik Bejko ; red. shkenc.

Jolanda Lila, Dorina Arapi, Alma Tirana, Mira Leka.

– Tiranë : Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, 2020

450 f. : me il. ; 16.5x24 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4664-2-6

I.Radovicka, Ornella

1.Historia 2.Arbëreshë 3.Pasuria kulturore
4.Vendbanime 5.Njerëz të shquar dhe kultura 6.Itali
94(=18:450)



UNIVERSITÀ
DELLA CALABRIA

BASHKËSITË ARBËRISHTFOLËSE TË ITALISË COMUNITÀ ALBANOFOFONE D'ITALIA



A CURA DELLA CATTEDRA DI LINGUA E LETTERATURA ALBANESE DELL' UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA

